Muhamed ibn Salih el Uthejmin

Komenti i Librit të Teuhidit

Vëllimi II

Muhamed ibn Salih el Uthejmin

Komenti i Librit të Teuhidit

Titulli i origjinalit: *El Kaulul Mufid Ala Kitab et-Teuhid* (Fjala e dobishme në shpjegimin e librit të Teuhidit)

Përktheu nga arabishtja *Azem Bardhoshi*
Redaktor *Ilir Haxhiaj*
Faqosja dhe korrektimi *Elton Gjeçi*

© të gjitha të drejtat janë të rezervuara për përkthyesin.

– *vijon nga Vëllimi I* –

Tema 29

Studimi i yjeve dhe besimi në ndikimin e tyre (astrologjia)

Studimi i yjeve bëhet për dy qëllime kryesore: 1. për të besuar se ato ndikojnë në ngjarjet që ndodhin në tokë; 2. për orientim në hapësirë dhe në kohë.

Besimi në ndikimin e tyre është tri llojesh:

1- Besimi se ato kanë ndikim në jetën tonë ose që bëjnë të mundur ndodhitë a fatkeqësitë. Ky është shirk i madh, sepse kush pretendon se me Allahun ka krijues tjetër, është idhujtar që ka bërë idhujtari të madhe, sepse krijesa e nënshtruar është bërë krijues që nënshtron!

2- Besimi se yjet janë shkak për rrjedhën e fatit në të ardhmen. Për shembull, besimi se jeta e një njeriu do të jetë e lumtur, sepse ka lindur në një yll të caktuar, apo se jeta e një njeriu tjetër do të jetë e vështirë, sepse ka lindur në një yll tjetër. Sipas këtij besimi, yjet janë mjet për të zbuluar të ardhmen, e cila është e fshehtë për njeriun. Ndërkaq, të pretendosh njohjen e çështjeve që mbeten të fshehta për njeriun është kufër i madh, që të nxjerr nga feja, sepse Allahu thotë: "Thuaj: 'Askush në qiell dhe në tokë nuk e di *gajb*-in (të fshehtën) veç Allahut …" (Neml, 60). Ky lloj përkufizimi është nga më të fuqishmit, sepse përmban në vete mohim dhe pohim. Rrjedhimisht, ai që pretendon se njeh *gajb*-in, ka mohuar Kuranin.

3- Besimi se yjet janë shkak për të mirat dhe të këqijat që kanë ndodhur. Kjo do të thotë ta lidhësh një ngjarje të shkuar me një yll. Ky është shirk i vogël.

Ky qëndrim mund të kundërshtohet duke sjellë si dëshmi hadithin që flet për eklipset: "Vërtet dielli dhe hëna janë dy nga shenjat e Allahut. Allahu frikëson me to robërit e Tij."[1]

Kjo do të thotë që ato janë shenja paralajmëruese. Por ne japim këtë përgjigje:

Së pari, nuk pranohet se eklipsi ka ndikim në ngjarjet apo ndëshkimet si: thatësirat, krizat, luftërat etj. Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) thotë: "Ato të dyja nuk eklipsohen për shkak të vdekjes së ndonjërit dhe as të lindjes së tij."[2] Nuk eklipsohen as për ngjarjet që kanë kaluar, as për ato që do të ndodhin në të ardhmen, por me anë të tyre Allahu frikëson robërit, se ndoshta ashtu kthehen në rrugë të drejtë. Ky është shpjegimi më afër të vërtetës.

Së dyti, nëse pranojmë se këto dukuri kanë ndikim, për aq sa tregon hadithi, sepse është detyrë ta pranosh argumentin, themi se ky është rast i veçantë.

Megjithatë, shpjegimi i parë është më afër të saktës. Ne nuk pranojmë që ato dy dukuri kanë ndonjëfarë ndikimi. Në hadith thuhet se ato shërbejnë për frikësim, por kjo nuk merret sipërfaqësisht, sepse frikën e sjell vetëm Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Frikësimi është ndëshkim prej Tij, kurse eklipsi nuk ndikon, pasi ai është vetëm një shenjë.

Studimi i yjeve për orientim bëhet me dy funksione:

1- Për të lehtësuar çështje të fesë. Ky qëllim është i lavdëruar. Nëse ai ndihmon për çështje fetare që janë detyrë, atëherë edhe mësimi i tyre është detyrë. Për shembull, me anë të yjeve mund të gjesh drejtimin e Kiblës, mund të përcaktosh një të tretën e natës etj.

2- Për të lehtësuar çështje të kësaj bote. Edhe ky qëllim nuk ka asgjë të keqe. Me anë të tij mund të orientohesh në hapësirë dhe kohë:

a) Në hapësirë; për shembull kur përcakton anët e horizontit

[1] Tansmeton Buhariu dhe Muslimi.
[2] Tansmeton Buhariu dhe Muslimi.

nëpërmjet yllit polar, i cili ndodhet në veri. Kjo lejohet. Allahu thotë: "Ai ka vënë edhe shenja treguese në tokë (për ditën) dhe me yjet (për natën), nëpërmjet të cilave njerëzit orientohen." (Nahl, 16).

b) Në kohë; për shembull, për të përcaktuar stinët. Disa nga selefët e kanë urryer këtë njohuri, ndërsa të tjerë e kanë lejuar. Ata që e kanë urryer, thonë se ajo mund të bëhet shkak që kur thuhet, për shembull, se kur del aksh yll është stina e dimrit, disa njerëz të thjeshtë mund të besojnë se është ai që sjell të ftohtët, reshjet ose erërat. Megjithatë, qëndrimi i saktë është që kjo dije nuk është e urryer, siç do të shpjegohet më pas, në dashtë Allahu.

> Buhariu në "*Sahih*-un" e tij thotë se Katade ka thënë: "Allahu i ka krijuar yjet për tri qëllime: zbukurues të qiellit, gjuajtës për shejtanët dhe shenja orientuese. Kush u jep funksione të tjera, ka gabuar, e ka çuar jetën dëm duke u marrë me diçka të padobishme dhe e ka ngarkuar veten me diçka që nuk mund ta njohë".

– *"... Allahu i ka krijuar yjet për tri qëllime ...*" – Kjo do të thotë se yjet janë krijuar për tri urtësi, të cilat janë:

1. Zbukurimi i qiellit. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Ne e kemi zbukuruar qiellin më të afërt me yje të ndritshme ..." (Mulk, 5).

Nëse vëzhgon qiellin e pastër, në një natë pa hënë dhe pa ndriçim artificial, dallon bukurinë madhështore të yjeve, si një pyll i zbukuruar me argjend vezullues: një yll vjen si i kuq, një tjetër si i kaltër, njëri ndriçon fort, tjetri më pak. Kushdo mund ta vërejë këtë.

Po a mund të themi se në pamje të parë ajeti tregon se yjet janë të fiksuar lart në qiell, apo kjo nuk është e thënë?

Jo, ajeti nuk tregon domosdoshmërisht për këtë, sepse sërish Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë në një ajet tjetër: "Allahu është Ai, i Cili krijoi natën dhe ditën, diellin dhe hënën, e të gjitha këto lundrojnë në gjithësi (orbitë)." (Enbija, 33) Kjo do të thotë se ata vërtiten, e çdonjëri nga këta trupa qiellorë ka orbitën e vet. Përfundimisht, themi se yjet lëvizin në largësi të ndryshme.

Pyetje: Si kuptohet fakti që me yjet është zbukuruar qielli më i afërt?

Përgjigje: Kjo nuk do të thotë që yjet ndodhen të ngulura në

qiellin e parë. Kur vendos, për shembull, drita e fenerë rreth një kështjelle, pa qenë e nevojshme t'i ngulësh llambat nëpër mure, nëse vështron nga larg këtë kështjellë, do ta shohësh të zbukuruar me drita, edhe pse ato nuk janë të ngjitura pas mureve të saj.

2. Gjuajtës për shejtanët. Ata shërbejnë si gjuajtës për të larguar shejtanët; ata shejtanë që janë xhindë. Nuk bëhet fjalë për shejtanët njerëz, sepse ata nuk mund të ngrihen në qiell. Shejtanët-xhindë janë më të fuqishëm se shejtanët-njerëz dhe kanë forcë të madhe depërtuese. Kur Allahu përshkruan forcën e tyre, thotë: "... edhe shejtanët-xhindë, ndërmjet të cilëve kishte ndërtues dhe zhytës në ujë, si dhe të tjerë të lidhur në pranga". (Sad, 37-38). Këta ishin xhindët që iu nënshtruan Sulejmanit. Gjithashtu Ai thotë: "Një xhind *ifrit* tha: 'Unë do të ta sjell atë para se ti të ngrihesh nga vendi; dhe vërtet që jam i fortë dhe i besueshëm për një shërbim të tillë." (Neml, 39). Këtu flitej për transportin e fronit të madh të mbretëreshës së Sebejit (Belkisës), nga Sebeja deri në Sham. Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë: "Dhe uleshim atje (në qiell) në vende, për të përgjuar, por kushdo që përgjon tani, do të hasë në shigjeta të zjarrta, që rrinë gati." (Xhin, 9).

3. Orientimi i njerëzve. Për këtë dëshmon ajeti: "Ai ka vendosur male të palëvizshme në Tokë, që ajo të mos tundet bashkë me ju, dhe ka vendosur në të lumenj e rrugë për të arritur aty ku synoni. Ai ka vënë edhe shenja treguese në tokë (për ditën) dhe me yjet (për natën), nëpërmjet të cilave njerëzit orientohen." (Nahl, 15-16). Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) tregon për dy lloje shenjash, me të cilat arrihet drejtimi:

a- Shenjat e tokës, të cilat përfshijnë çdo gjë që Allahu e ka krijuar në tokë, si: malet, lumenjtë, rrugët, luginat etj.

b- Shenjat e qiellit, yjet. Fjala "*en-nexhm*" (yll) shënon çdo lloj ylli, me anë të cilit mund të orientohesh. Nuk është vetëm një yll që shërben si orientues. Çdo popull ka një mënyrë të caktuar orientimi me anë të yjeve. Është mirësi e Allahut, që bëri shenja lart në qiell, të pambuluara nga errësira. Natën nuk mund të shohësh as mal, as luginë, as rërë. Gjithçka i është nënshtruar Allahut: "Ai nënshtroi për ju çdo gjë që ndodhet në qiej e në tokë; gjithçka është prej Tij ..." (Xhathijeh, 13).

> Katadeja e urrente studimin e cikleve të hënës, ndërsa Ibn Ujejne nuk e lejonte. Këto qëndrime të tyre i ka dëshmuar Harbi. Ndërsa Ahmedi dhe Is'haku e kanë lejuar studimin e tyre[1].

– *"Katadeja e urrente studimin e cikleve të hënës …"* – Kur diçka urrehet, tregon se ajo është haram. Në të shumtën e rasteve, ky ka qenë kuptimi i këtij termi për muslimanët e parë.

Studimi i cikleve të hënës ka dy kuptime në arabisht:

1- Njohja e ciklit hënor për çdo natë. Cikli hënor është i dukshëm derisa plotëson 28 net, ndërsa natën e 29-të dhe të 30-të zakonisht nuk duket.

2- Njohja e cikleve të yjeve, pra, aksh yll del në filan ditë. Janë njëzetë e tetë yje që Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) i ka bërë tregues të stinëve: 14 ndodhen në hemisferën qiellore të jugut dhe 14 të tjerë në hemisferën qiellore të veriut. Nëse dielli shkon në hemisferën e veriut, moti nis e ngrohet, e nëse shkon nga jugu, nis të ftohet.

– *"… Ibn Ujejne nuk e lejonte …"* – Flitet për Sufjan Ibn Ujejnen, kishte të njëjtin mendim me Kataden.

– *"… Këto qëndrime të tyre i ka dëshmuar Harbi. …"* – Harbi ka qenë një nga nxënësit e Ahmedit, dhe na ka treguar shumë qëndrime të këtij të fundit.

– *"… ndërsa Ahmedi dhe Is'haku e kanë lejuar studimin e tyre …"* – Is'haku është Is'hak Ibn Rrahavejhi.

E vërteta është se nuk ka asgjë të keqe në studimin e lëvizjeve të trupave qiellorë, sepse kjo nuk përmban shirk. Një lloj shirku është kur studimi bëhet duke besuar se ato sjellin reshjet apo motin e ftohtë, por nëse bëhet për të dalluar me anë të tyre stinët, nuk ka ndonjë problem.

[1] Këta dijetarë e kanë lejuar mësimin e cikleve të Hënës vetëm për njohjen e kohës, por jo për të lidhur me to gjërat që ndodhin në Tokë apo reshjet e shiut.

> Ebu Musa tregon se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Tre grupe nuk futen në Xhenet: pijaneci, ai që i ndërpret lidhjet farefisnore dhe ai që i beson magjisë[1].”[2]

– *“... nuk futen në Xhenet ...”* – Xheneti (kopshti) është vendi të cilin Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e ka përgatitur për të afërmit e Tij të devotshëm. Është quajtur ashtu, për shkak të pemëve të shumta të tij, dhe se ato mbulojnë banorët e tij.

– *“... pijaneci ...”* – Kështu quhet ai që pi rregullisht pije alkoolike. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka bërë një përcaktim për verën: “Çdo pije dehëse është si vera, për sa i përket ndalimit të saj.”[3] “Dehëse” do të thotë që “të humb mendjen”. Jo çdo gjë që të humb mendjen është alkool. Narkoza, për shembull, ta humb mendjen, por nuk është pije alkoolike. Mund të pish edhe yndyrë dhe të bie të fikët, por nuk do të thotë se ke pirë alkool. Pije alkoolike është ajo që të humb mendjen dhe që shoqërohet me shijim dhe gjendje kënaqësie. Pijaneci ndjehet sikur është në kulmin e kënaqësisë.

Kush e quan hallall alkoolin, është qafir, me përjashtim të rastit kur ky njeri jeton në ndonjë zonë të thellë, i painformuar, ose që është i ri në Islam dhe nuk e di gjykimin e fesë për të. Ky njeri duhet të mësohet dhe nuk bëhet kafir.

– *“... ai që i ndërpret lidhjet farefisnore ...”* – Farefis quhen ata për të cilët Allahu i Lartësuar thotë: “Por farefisi i gjakut është më i afërt me njëri-tjetrin ...” (Enfal, 75). Te farefisi, sipas fesë, nuk hyjnë lidhjet e krushqisë, siç mendojnë njerëzit e thjeshtë.

Të ndërpresësh lidhjet fisnore, do të thotë të mos mbash lidhje me të afërmit. Për ruajtjen e lidhjeve nuk ka ndonjë kufizim në

---

[1] Astrologjia është një lloj magjie siç është përmendur më parë ne temën 25. “Kush mëson një degë nga fusha e astrologjisë, ka mësuar një degë nga degët e magjisë. Sa më tepër të thellohet, aq më shumë e shton (gjynahun ose magjinë).”

[2] Ahmedi, Ibn Hibani në “Sahihun” e tij dhe Hakimi. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

[3] Muslimi.

Kuran dhe Sunet. Allahu i Lartësuar thotë: "Ata të cilët mbajnë lidhjet që ka urdhëruar Allahu ..." (Rrad, 21), ndër të cilat janë edhe lidhjet farefisnore. Kur një rregull vjen i pashtjelluar, atëherë ndiqet tradita. Për shembull, ruajtja e lidhjeve në kohë urie e varfërie bëhet duke ushqyer dhe veshur të afërmit, ndërsa në kohë bollëku nuk është detyrë një mënyrë e tillë.

Farefisi ndahet në "të afërt" dhe "të largët". Më i afërti meriton më shumë sesa më i largëti. Edhe "të afërtit" ndahen në kategori të ndryshme. Disa të afërm mendojnë se kanë të drejta që duhet t'i përmbushësh patjetër, ata dëshirojnë që t'i mbash lidhjet me ta vazhdimisht. Ndërsa disa të tjerë vlerësohen sipas rrethanave, duke e vendosur secilin në vendin që i takon. Pra, cecili grup ka statut të veçantë. Përsa i përket ndërprerjes së lidhjeve në konsideratë merret tradita. Mirëpo mbështetja te tradita nuk respektohet nëse kjo traditë është për mosruajtjen e lidhjeve fisnore, siç ndodh sot në botën perëndimore. Nëse atje nuk ruhen lidhjet, ne nuk mund ta mohojmë këtë detyrë fetare, për të cilën na ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

Ruajtja e lidhjeve fisnore nuk nënkupton lidhjen vetëm me ata që i ruajnë lidhjet me ty, sepse ky është kompensim, shlyerje dhe jo ruajtje e lidhjeve. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Respektuesi më i mirë i lidhjes farefisnore është ai që, nëse i afërmi i tij nuk i jep a nuk e viziton, ai u jep, u bën mirë dhe i viziton."[1] Ky është ai që e do shpërblimin e Allahut dhe botën tjetër.

Ruajtja e lidhjeve me të afërmit, është e drejtë e Allahut apo e njerëzve? Në dukje të parë, ajo është e drejtë e njerëzve. E nëse nisemi nga fakti se Allahu ka urdhëruar për të, atëherë është e drejtë edhe e Tij.

– *"... dhe ai që i beson magjisë."* – Kjo është edhe pjesa e hadithit që lidhet me temën në fjalë, sepse astrologjia është një lloj magjie. Kush i beson asaj, ka besuar në një lloj magjie. Më parë kemi cituar hadithin: "Kush nis të mësojë një degë nga fusha e astrologjisë, ka nisur të mësojë një nga degët e magjisë. Sa më tepër të thellohet, aq më shumë e shton."[2]

---

[1] Buhariu.

[2] Hadithi është përmendur në një temë të mëparshme.

Kush beson në magji, beson tek astrologët, dhe nëse beson astrologët, nuk futesh në Xhenet, sepse beson që dikush tjetër përveç Allahut e di *gajb*-in, misterin: "Thuaj: 'Askush në qiej dhe në tokë nuk e di *gajb*-in veç Allahut ..." (Neml, 65).

Pyetje: Pse koncepti "magji", në këtë rast, nuk është i përgjithshëm, që të përfshijë në të edhe astrologjinë?

Përgjigje: Paralajmërimi për mosfutje në Xhenet është këtu për atë që beson se çfarë tregon magjistari për misterin, ndërsa atë që beson se magjia ka ndikim nuk e kap ky kërcënim, pasi nuk ka dyshim se magjia ka ndikim. Por ndikimi i magjisë është iluzor, si në rastin me magjistarët e Faraonit, të cilët magjepsën sytë e njerëzve, duke i bërë që litarët dhe shkopinjtë t'u dukeshin si gjarpërinj që lëviznin, edhe pse kjo nuk ishte e vërtetë. Magjia mund ta bëjë njeriun që të dojë një person ose të urrejë një tjetër. Magjia është ndikuese: "Dhe nga ata të dy, njerëzit mësuan atë që shkaktonte ndarjen e burrit nga bashkëshortja e tij ..." (Bekare, 102). Besimi në ndikimin e magjisë nuk përfshihet në paralajmërimin e hadithit, sepse ai lloj ndikimi është i vërtetë. Por nëse beson se magjia ndikon në ndryshimin real të gjërave, si për shembull, të besosh se e kthen në të vërtetë drurin në flori, atëherë nuk ka dyshim se kërcënimi është edhe për ty, sepse këto ndryshime dhe ndikime nuk mund t'i bëjë askush përveç Allahut të Lartësuar.

Pyetje: Numri tre i grupeve që përmenden në hadith është kategorik, pra, veç këta nuk do të futen në Xhenet?

Përgjigje: Jo, sepse ka edhe të tjerë, që nuk do të futen në Xhenet.

Pyetje: A janë këto tri grupe jobesimtarë, sepse kush nuk futet në Xhenet është jobesimtar?

Përgjigje: Dijetarët kanë mendime të ndryshme për këtë hadith dhe për hadithe të tjera që përmbajnë kërcënim. Thëniet e tyre vijojnë si më poshtë:

Mendimi i parë: Ky është qëndrimi i *mutezil*-ëve dhe *havarixh*-ëve, të cilët e marrin drejtpërdrejt tekstin e kërcënimit, duke i parë këto gjynahe si humbje totale të imanit. Ndryshimi është se *havarixhët* thonë se, me këto gjynahe, njeriu bëhet qafir, kurse *mutezilët* thonë se ai mbetet në një pozitë të ndërmjetme. Të dy grupet bashkohen

në një mendim: se ai do të jetë përjetësisht në Zjarr.

Ata, këtë hadith dhe të ngjashëm me të, e marrin me kuptimin e drejtpërdrejtë të tij, pa parë hadithet e tjera, të cilët tregojnë se kush ka iman në zemër, sado i pakët të jetë, patjetër që një ditë do të futet në Xhenet.

Mendimi i dytë: Ky kërcënim është për ata që i quajnë të lejuara vepra të tilla, duke u bazuar në dëshmitë e shumta që tregojnë se kush ka iman në zemër, sado i pakët të jetë ky iman, patjetër që do të futet një ditë në Xhenet.

Ky mendim nuk është i saktë, sepse kush i quan të lejuara haramet, është jobesimtar, edhe nëse nuk i vepron ato. Për shembull, ai që e quan të lejuar ndërprerjen e lidhjeve farefisnore ose pirjen e alkoolit, është qafir, edhe nëse vetë nuk i ndërpret lidhjet farefisnore apo nuk pi alkool.

Mendimi i tretë: Ky është një nga llojet e haditheve kërcënuese, të cilët lihen ashtu siç janë, pa u thelluar në kuptimin e tyre, por thuhet se kështu ka thënë Allahu i Lartësuar e i Dërguari i Tij dhe heshtim, shembull për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar: "Dhe kushdo që vret një besimtar qëllimisht, shpërblimi i tij është Xhehenemi për të banuar atje, Zemërimi e Mallkimi i Allahut është mbi të dhe për të është përgatitur ndëshkimi i madh." (Nisa, 93). Ky ajet është një tekst kërcënues, të cilin ne e besojmë dhe nuk i futemi komentit të tij dhe mospërputhjes që ka ai me argumente të tjera, por themi se kështu ka thënë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Allahu e di më mirë se çfarë ka për qëllim.

Ky është qëndrimi i shumë selefëve, siç qe Maliku, dhe në fakt ky qëndrim ka efekt më të fortë për parandalimin nga ky gjynah.

Mendimi i katërt: Mohimi i futjes në Xhenet, për ata grupe, duket si i pakufizuar, por ne themi se është i kufizuar. Kështu, thuhet se ata nuk do të futen në Xhenet menjëherë, por do të ndëshkohen më parë për gjynahet e tyre, e pastaj fundi i tyre do të jetë në Xhenet. Kjo, sepse argumentet e Sheriatit vërtetojnë njëri-tjetrin dhe përputhen me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë, çdo gjë mbetet e qartë, pa kontradikta.

Ekziston edhe një mendim tjetër: njeriu që e mbyll jetën me të tilla gjynahe, meriton të vdesë si qafir. Atëherë, ky kërcënim është për ata që vdesin duke bërë këto vepra. Kësisoj, gjithçka është e

qartë, sepse ai që vdes si qafir, nuk ka për t'u futur në Xhenet, por do të jetë përgjithmonë në Zjarr. Ndoshta këtë e përforcon edhe hadithi i Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Njeriu vazhdon të jetë në gjerësi në fenë e tij, përderisa nuk ka derdhur gjak të ndaluar."[1] Ky, në fakt, ishte mendimi i pestë.

Dobitë e temës

- Urtësia e krijimit të yjeve.

Ato kanë tri funksione: zbukurues për qiellin, gjuajtës për shejtanët dhe orientues për njerëzit. Ndoshta ka edhe urtësi të tjera, të cilat ne nuk i dimë.

- Qëndrimi ndaj atyre që mendojnë të kundërtën.

Sipas Katades: "Kush u jep funksione të tjera, ka gabuar, ka humbur pjesën e tij dhe e ka ngarkuar veten me diçka që nuk mund ta njohë." Ajo që do të thotë Katadeja me "funksione të tjera" është për ndikimin e yjeve në ngjarjet që ndodhin në tokë, ndërsa për çështje të tjera, që s'kanë lidhje me këtë, nuk ka problem.

- Sjellja e mendimeve të ndryshme për studimin e cikleve të hënës.

[1] Sipas një varianti është thënë se nëse derdh gjak të pa fajshëm i ngushtohet feja e tij. Në këtë aludohet për kërcënimin që ka vrasja e besimtarit me qëllim siç kërcënohet për të qafiri. Një kuptim tjetër është se ai do të jetë në ngushtësi për shkak të mëkatit të tij. Në këtë aludohet për mos faljen e tij, për shkak të ngushtësisë së vazhdueshme që përmendet. Ndërsa Ibn El Arabij thotë: Gjerësia në fe është gjerësia e punëve të mira, derisa veprohet vrasja, atëherë ngushtohet, sepse ato nuk e balancojnë ose kompensojnë këtë mëkat. Ndërsa gjerësia në mëkat do të thotë t'i falen mëkatet duke iu pranuar tobja derisa kryen vrasje atëherë nuk i pranohet tobja. Mesa duket ai e ka komentuar sipas mendimit të Ibn Umerit, që vrasësit nuk i pranohet tobja.

- Kërcënimi me ndëshkim ndaj atij që i beson sadopak magjisë, edhe nëse e di se ajo është e kotë.

Kush shpreh me gjuhë ndonjëfarë besimin tek astrologjia ose magjia, edhe nëse me zemër beson se ato janë të kota, pret mbi vete këtë kërcënim. E si mund të besosh, kur e di se ato janë mashtrime? Kjo mund të bëhet shkak që të mashtrohen njerëz të tjerë.

Tema 30

Lidhja e reshjeve me yjet[1].

Ka dy lloje të lidhjes së reshjeve me yjet. Lloji i parë përbën idhujtari të madhe dhe shfaqet në dy forma:

1- Të lusësh yjet për të rënë shi, si të thuash: "o yll, na jep shi!" ose "o yll, na shpëto!" Kjo është idhujtari, sepse kështu lutet diçka tjetër përveç Allahut. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Ai që krahas Allahut lut zot tjetër, duke mos pasur kurrfarë prove për këtë, me siguri do të japë llogari vetëm te Zoti i tij. Me të vërtetë, nuk ka shpëtim për mohuesit." (Mu'minun, 117). "Xhamitë janë për adhurimin e Allahut, prandaj mos iu lutni askujt krahas Allahut!" (Xhin, 18). "Përveç Allahut, mos iu lut tjetërkujt nga ata që nuk të sjellin as dobi, as dëm. Nëse do ta bëje këtë, atëherë, ti do t'i kishe bërë padrejtësi vetes." (Junus, 106). Ka edhe shumë ajete të tjera që tregojnë për ndalimin e lutjes së dikujt tjetër përveç Allahut, dhe se ajo përbën idhujtari të madhe.

---

[1] Arabët e kohës së paditurisë paraislamike besonin se reshjet e shiut binin për shkak të cikleve të Hënës. Hëna ka njëzet e tetë cikle, ku në çdonjërin prej tyre lind ose perëndon një yll. Këtë lloj besimi Pejgamberi e quajti shirk. Kështu, nëse njeriu beson se reshjet e shiut i lëshon Allahu, por si shkak për rënien e reshjeve të shiut ka bërë ndonjë cikël të Hënës ose e ka bërë ligj që reshjet të bien kur shfaqet iks yll, bën shirk të vogël. E nëse beson që reshjet e shiut i lëshon cikli i Hënës ose ylli, ai bën shirk të madh. Ndërsa, nëse njeriu shprehet që reshjet e shiut ranë ndërkohë që Hëna ishte në këtë cikël ose ndërkohë që u shfaq filan yll, kjo nuk është shirk sepse ai nuk ka për qëllim t'i lidhë reshjet e shiut me ciklin e Hënës apo ndonjë yll, por të tregojë kohën kur ra shiu. Megjithatë, edhe në rastin e fundit, më e mira është të mos përdoret një shprehje e tillë

2- Rënien e shiut t'ia atribuosh këtyre yjeve. Pra, të besosh se vetë yjet e lëshojnë shiun, pa ndërhyrjen e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Edhe nëse nuk i lut ato, ky është shirk i madh në *rrububije*, sepse do të thotë ti bësh shok Allahut në veprat që i përkasin vetëm Atij. Ndërkaq, forma e parë ishte shirk në adhurim, sepse lutja është adhurim, por përveç kësaj, përmban edhe shirk në rrububije (në veprat e Allahut), pasi njeriu i lut ata vetëm pasi beson se ata veprojnë dhe mund t'ia plotësojnë nevojat që ka.

Lloji i dytë i lidhjes së reshjeve me yjet është kur ato i konsideron si shkak, duke besuar se Allahu është Krijuesi dhe Vepruesi. Ky është shirk i vogël. Çdo njeri që konsideron diçka si shkak, ndërkohë që Allahu nuk e ka bërë të tillë, as me Shpallje, as me kaderin e Tij[1], ka rënë në shirk të vogël.

> Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Dhe në vend që ta falënderoni Allahun për mirësitë (rrizkun) që ju ka dhënë, ju i mohoni ato" (Uakia, 82)

Kjo do të thotë: ju mohoni se mirësia është nga Allahu, sepse ju ia atribuoni atë dikujt tjetër veç Tij.

Mirësia nënkupton diçka më të përgjithshme sesa shiun. Ajo ka dy kuptime:

1. Dituria, sepse Allahu ka thënë: "Betohem në çastin e perëndimit të yjeve, e vërtet ky është betim i madh, veç sikur ta dinit, se ky është vërtetë një Kuran i nderuar, në Librin e ruajtur. Atë (Kuranin) e prekin vetëm të pastërtit. Ai është shpallje prej Zotit të botëve. A është fjalë e tillë (ky Kuran) saqë ju të mohoni, dhe në vend të falënderimit të Allahut për mirësitë (*rrizk*un) që ua ka dhënë, ju e mohoni atë." (Uakia, 75-83). Pra: ju u frikësoheni dhe u bëni lajka atyre. Në vend që ta falënderoni Allahun për diturinë dhe shpalljen që ju ka dhënë, ju i mohoni ato. Kjo kuptohet nga konteksti i ajetit.

2. Shiu. Për këtë është edhe një hadith nga Profeti (sal-lAllahu

[1] Është fjala për ligjësitë e gjithësisë të cilat janë krijuar nga Allahu dhe veprojnë ose e japin efektin veçse me fuqinë dhe vullnetin e Tij. Për shembull në rastin konkret, Allahu ka krijuar disa shkaqe të njohura të cilat sjellin reshjet e shiut atëherë kur dëshiron Allahu.

‘alejhi ue sel-lem), por ai është i dobët. Është një dëshmi e saktë nga Ibn Abasi, i cili komenton këtë ajet e që thotë se *rrizk*-u është shiu, ndërsa mohimi është t’ia përshkruash atë yjeve [1]. Ky transmetim tregon edhe lidhjen e ajetit me temën.

Një rregull i tefsirit thotë: Kur ajeti përmban dy kuptime njëherazi, jo kontradiktore, duhet t’i mbrosh të dy kuptimet. Nëse njëri bie ndesh me tjetrin, kërkohet kuptimi më i saktë.

Kuptimi i ajetit në fjalë është: Allahu i qorton ata të cilët e kthejnë falënderimin për *rrizk*-un në mohim e mendjemadhësi.

Falënderimi për mirësitë arrihet me besim, pranim dhe me bindje ndaj Allahut, Dhuruesit të tij. Po kështu, natyrshmëria nuk e pranon mohimin e dhuruesit, furnizuesit. Natyrshmëria, mendja dhe feja, veç e veç dhe së bashku, të çojnë në përfundimin se Ai që të jep mirësi duhet të falënderohet, cilido qoftë kuptimi i *rrizk*-ut: shiu, me të cilin mundësohet jeta në tokë, apo zbritja e Kuranit, me të cilin mundësohet jeta e zemrave, e cila është dhe mirësia më e madhe.

Mohimi bëhet me dy mënyra:

1- Me anë të gjuhës, duke deklaruar se shirat vijnë prej një ylli të caktuar, e të ngjashme me këto.

2- Me gjendje, duke madhëruar yjet dhe duke besuar se ato janë shkak. Omer Ibn Abdulazizi, në një fjalim që po mbante përpara njerëzve, tha: “O ju njerëz, nëse besoni dhe nuk punoni, jeni budallenj, e nëse e mohoni, jeni të shkatërruar.” Kjo është e vërtetë. Ai që beson dhe nuk punon, është pa mend, ndërsa mohuesi është i shkatërruar. Çdokujt që bën gjynahe i themi se është ndërmjet dy gjendjeve: ose e beson pasojën gjynahut, ose është mohues. Nëse e beson, je pa mend, sepse nuk frikësohesh e nuk ruhesh nga ajo pasojë. Nëse nuk beson, je akoma më keq: je jobesimtar dhe i shkatërruar.

> Ebu Malik el Eshariu tregon se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Katër gjëra në umetin tim janë tipare të kohës së injorancës, të cilat njerëzit nuk i lënë:

[1] Siç do të përshkruhet në hadithin e Zejd ibë Halidit i cili do të përmendet më pas po në këtë temë.

> mburrja me fisërinë, sharja e prejardhjes së njeriut, besimi se shiu bie nëpërmjet yjeve ose se reshjet lidhen me shfaqjen e ndonjë ylli dhe vajtimi me kujë për të vdekurin." Po kështu ka thënë: "Nëse vajtorja nuk pendohet para vdekjes së saj, në Ditën e Kijametit ajo do të ngrihet me veshje zifti dhe mbulesë zgjebeje."[1]

– *"... Katër gjëra në umetin tim ..."* – Katra nuk tregon kufizim me këtë numër, por shërben për sistemimin e njohurive që përcillen, për t'i bërë ato më të lehta për t'u memorizuar. Ndërsa me togun "umeti im" nënkuptohet umeti që i është përgjigjur thirrjes së Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

– *"... janë tipare të kohës së injorancës ..."* – Lidhja me kohën e injorancës[2] shërben për dënimin dhe përçmimin e këtyre tipareve. Çdokush, nëse i thua se veprimi i tij është njëlloj si ai i injorantëve, nuk ka dyshim që do të zemërohet, sepse askush nuk dëshiron të ketë cilësi të tyre.

Lidhja me kohën e injorancës bëhet për dy arsye:

1- Për t'u larguar nga ato cilësi.

2- Për të sqaruar se të gjitha ato tipare janë injorancë dhe budallallëk për njeriun, prandaj ato nuk meritojnë kujdes. Ai që u kushton rëndësi atyre është injorant. Injoranca këtu nënkupton epokën përpara shpalljes së Islamit, sepse njerëzit asokohe ishin në injorancë dhe humbje të madhe. Arabët ishin më të padituri ndër krijesat e Allahut, prandaj quheshin "analfabetë", se nuk dinin as të lexonin dhe as të shkruanin. Por më pas, atyre iu dërgua Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), gjë për të cilën Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), thotë: "Allahu u ka dhënë besimtarëve mirësi, kur u solli një Pejgamber (Muhamedin) nga gjiri i tyre, i cili ua lexonte vargjet e Tij (Kuranit), i pastron nga gjynahet dhe ua mëson Librin (Kuranin) dhe Urtësinë, edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në humbje të qartë." (Ali Imran, 164). Ishte mirësi e madhe që Allahu, në mesin

[1] Muslimi.

[2] Me injorancë nënkuptohet periudha kohore para se njeriu të pranojë Islamin, pra, para se të konsiderohet musliman. (shën. i redaktorit)

e tyre, dërgoi Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për këto çështje të larta:

1- T’u lexonte atyre ajetet e Allahut.

2- T’i pastronte ata nga morali i keq e adhurimi i padrejtë dhe t’i bënte ata të përparonin.

3- T’u mësonte atyre Librin.

4- T’u mësonte atyre Urtësinë, Sunetin.

Katër dobi të mëdha që, sikur njëra prej tyre të vendosej në një peshore me tërë botën, do peshonte më rëndë, për atë që e njeh këto vlera.

Pastaj Allahu përshkruan gjendjen e tyre të mëparshme: “... edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në humbje të qartë.”

Përfundimisht, epoka e injorancës qe periudha përpara dërgimit të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), sepse njerëzit atëherë ishin mjaft të paditur. Injoranca e tyre ishte e gjithanshme: për të drejtën e Allahut dhe për të drejtat e robërve të Tij. Prej injorancës së tyre ishin idhujt dhe adhurimi i tyre. Ata vrisnin bijat e tyre, që gjoja të mos turpëroheshin me to, ose vrisnin fëmijët, meshkuj apo femra, nga frika e varfërisë.

– *“... të cilat njerëzit nuk i lënë ...”* – Pra, nuk janë zhveshur prej këtyre cilësive: disa kanë një cilësi, të tjerë një tjetër, e kështu me radhë. Ndoshta ato mund të jenë tipare të një grupi, kurse një grup tjetër mund të mos ketë asnjërën prej tyre, por tek umeti në përgjithësi, patjetër do të ekzistojnë, sepse këtë e ka treguar i Besueshmi, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Qëllimi i të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte largimi prej këtyre veseve. Ndonjëherë, kur Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) parathoshte se do të ndodhë diçka, qëllimi i tij nuk ishte që ajo të ndodhte, si për shembull, në hadithin: “Ju keni për të ecur në rrugën e atyre që ishin para jush ...”, që do të thotë: Ruhuni nga kjo gjë! Po kështu, i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka parathënë: “... Vërtet udhëtarja ka për të dalë nga Sanaja për në Hadrameut, e nuk ka për t’iu frikësuar askujt veç Allahut ...”[1], që do të thotë se ajo do të dalë e vetme. Kjo qe një profeci nga ana e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), dhe jo pranim i asaj

[1] Buhariu.

dukurie nga ana e fesë.[1]

– *"... mburrja me fisërinë ..."* – Për shembull, të mburresh se i përket fisit Benu Hashim apo se rrjedh nga familje e njohur për trimëri. Kjo është cilësi e injorancës, sepse mburrja e vërtetë është për devotshmërinë ndaj Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), e cila e ndalon njeriun nga mbajtja me të madh. I devotshëm është ai që, sa më shumë t'i shtohen begatitë e Allahut, aq më tepër i shtohet thjeshtësia ndaj së vërtetës dhe krijesave. Meqë mburrja me fisërinë është karakteristikë e injorancës, ajo nuk lejohet për ne. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) u është drejtuar grave të Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "... dhe mos i zbuloni stolitë tuaja, ashtu siç zbuloheshin në kohën e xhahilijetit ..." (Ahzab, 33). Dije se çdo gjë që i mvishet injorancës, është e urryer dhe e ndaluar.

– *"... sharja e prejardhjes së njeriut ..."* – Pra, ta ofendosh tjetrin për prejardhjen e tij, t'i thuash për shembull: "o biri i lëkurëregjësit" etj.

– *"... besimi se shiu bie nëpërmjet yjeve ose se reshjet lidhen me shfaqjen e ndonjë ylli ..."* – Kjo ndodh kur rënien e shiut ia atribuon yjeve, duke besuar se vepruesi është Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Ndërsa nëse beson se ato që i krijojnë retë dhe reshjet janë yjet, ose i lut yjet që të bjerë shi, ky është shirk i madh, që të nxjerr krejtësisht nga feja.

– *"... vajtimi me kujë ..."* – Flitet për vajtimin e të vdekurit me zë të lartë, qëllimisht. Ky lloj vajtimi është prej injorancës, por do të ekzistojë edhe në këtë umet. Ajo është prej çështjeve të injorancës; ose për shkak të padijes, e cila është e kundërta e diturisë, ose nga budallallëku, që është i kundërti i urtësisë. Vajtimi me kujë është i tillë për disa arsye:

- Ai veçse ia shton pikëllimin dhe dhimbjen vajtuesit.
- Ai shpreh hidhërim ndaj caktimit dhe paracaktimit të Allahut, si dhe kundërshtim ndaj Tij.

[1] Sipas Sheriatit, nuk lejohet që gruaja të udhëtojë e pashoqëruar nga një i afërm i saj. (shën. i redaktorit)

- Ai nxit hidhërimin e të tjerëve. Tregohet për Ibn Akilin (Allahu e mëshiroftë) – një nga dijetarët tanë hanbelinj – se, kur ishte duke përcjellë xhenazen e të birit, Akilit, më i madhi i fëmijëve të tij dhe gjithashtu nxënës dije, një burrë klithi duke cituar një ajet kuranor: "I thanë: 'O prijës i nderuar, ai e ka babanë shumë plak, andaj merr ndonjërin prej nesh në vend të tij. Ne po shohim se ti je bamirës'." (Jusuf, 78).

Ibn Akili iu drejtua këtij burri: "Kurani ka zbritur për ta shuar mërzinë e jo për ta shtuar atë.

- Me gjithë këto të këqija, vajtimi përsëri nuk e kthen caktimin e Zotit dhe as nuk e largon të keqen që ka rënë.

Vajtimi me kujë është gjynah si për burrat dhe për gratë, por më shumë ai është problem te gratë, prandaj Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Nëse njehatorja nuk pendohet para vdekjes së saj, në Ditën e Kijametit do të ngrihet me veshje zifti dhe mbulesë zgjebeje". Pra, nëse ajo pendohet para vdekjes, Allahu ia pranon pendimin. Nga hadithi shihet se këtë gjynah e fshin vetëm pendimi, sepse është një nga gjynahet e mëdha, të cilët nuk mund të fshihen me vepra të mira. Ato i fshin vetëm pendimi.

– *"... Ditën e Kijametit do të ngrihet me veshje zifti dhe mbulesë zgjebeje."* – Me këtë lloj dënimi ajo do të ngrihet nga varri i saj.

Zgjebja është sëmundje lëkure, e cila shkakton edhe pagjumësi, ndërsa kafshën ajo mund ta ngordhë. Kuptimi i hadithit është se lëkura e njehatores do të jetë e gjitha e zgjebosur. Kur asaj i bashkohet edhe zifti, vuajtja bëhet edhe më e madhe, sepse lëkura e zgjebosur është mjaft e ndjeshme nga prekjet. Po kur prekja është me zift?!

Urtësia e këtij lloj dënimi qëndron në faktin se vajtuesja mbulohet me këto shtresa, sepse ajo nuk e ka mbuluar fatkeqësinë me durim, dhe gjithmonë dënimi jepet sipas veprës.

Dobitë e hadithit

- Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) lajmëroi për këto dukuri, të cilat ndodhën ashtu siç kishte parathënë ai.

- Domosdoshmëria e largimit nga katër veset që përshkruhen në hadith: mburrja me origjinën, sharja e prejardhjes së njeriut,

kërkimi i shiut prej yjeve dhe vajtimi me kujë mbi të vdekurin.

- Vajtimi i të vdekurit me kujë është gjynah i madh, sepse për të ka një paralajmërim për ndëshkim në ahiret. Çdo gjynah që ka kërcënim me ndëshkim në botën tjetër, është gjynah i madh.

- Gjynahet e mëdha nuk shlyhen me vepra të mira, sipas fjalës: "Nëse njehatorja nuk pendohet para vdekjes së saj …".

- Një kusht i pendimit, është që të bëhet përpara vdekjes, sipas hadithit: Nëse njehatorja nuk pendohet para vdekjes së saj …" dhe ajetit: "Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e që, kur u afrohet vdekja, thonë: 'Unë tani po pendohem me të vërtetë". (Nisa, 18).

- Shirku i vogël nuk të nxjerr nga feja. Ka dijetarë që thonë se ai që bën shirk të vogël, mbetet në dëshirën e Allahut: nëse Ai dëshiron ta dënojë, e dënon dhe nëse dëshiron ta falë, Ai e fal. Disa të tjerë thonë se ai nuk është nën dëshirën e Allahut, por patjetër do të dënohet. Nga ky mendim anon dhe shejhu i Islamit Ibn Tejmija, për shkak të përgjithësimit që bën ajeti: "Vërtet, Allahu nuk fal që të shoqërohet dikush apo diçka me Të ." (Nisa, 116). Pra Allahu nuk e fal shirkun, edhe nëse është i vogël.

Kjo tregon rrezikun e madh që vjen nga e keqja e politeizmit. Ibn Mesudi ka thënë: "Të betohem në Allahun duke gënjyer, është më e dashur për mua sesa të betohem në dikë tjetër, duke thënë të vërtetën." [1], sepse betimi në dikë tjetër veç Allahut është politeizëm, kurse betimi në Allahun duke gënjyer është mëkat i madh, ndëresa e keqja e politeizmit është më e madhe se e keqja e mëkatit.

- Pohimi i shpërblimit dhe i ringjalljes pas vdekjes.

- Shpërblimi prej Zotit bëhet sipas llojit të veprës.

> Sërish Buhariu dhe Muslimi sjellin rrëfimin e Zejd Ibn Halidit, i cili tregon: "Njëherë, në Hudejbije, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) fali me ne namazin e sabahut, ndërkohë që natën kishte rënë një shi i lehtë. Pasi mbaroi, u kthye nga njerëzit dhe tha: 'A e dini çfarë tha Zoti juaj?' Të pranishmit u përgjigjën: 'Allahu dhe i

[1] Abdurr-Rrezaku dhe Tabarani në "El-Kebir". Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

> Dërguari i Tij e dinë!' Ai tha: 'Disa nga robërit e Mi janë gdhirë besimtarë dhe disa jobesimtarë ndaj Meje. Ai që tha: 'Shiu ra me mirësinë e Allahut dhe mëshirën e Tij', është besimtar ndaj Meje dhe jobesimtar ndaj yjeve, ndërsa ai që tha: 'Shiu ra për shkak të këtij apo atij ylli', është jobesimtar ndaj Meje dhe besimtar ndaj yjeve."

– *"... Njëherë, në Hudejbije, Profeti (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) fali me ne namazin e sabahut ..."* – Hudejbije ishte emri i një pusi, nga i cili kishte marrë emrin edhe vendi. Është thënë gjithashtu se "Hudejbije" vjen prej "Hadba", që është emri i një peme. Shumica e shpjeguesve mendojnë se ishte emri i një pusi.

Ky vend është afër Mekës, një pjesë e të cilit ndodhet brenda territorit të shenjtë. Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) vajti atje në vitin 6 hixhri, kur u nis për të kryer umren, por u pengua nga idhujtarët të hynte në Shtëpinë e Shenjtë. Sigurisht, ata nuk ishin miqtë e tij, miqtë e tij janë vetëm të devotshmit.

– *"... A e dini çfarë tha Zoti juaj? ..."* – Fjalia pyetëse këtu shërben për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesve, pasi Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ishte i sigurt që ata nuk e dinin se ç'kishte thënë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), sepse Shpallja nuk zbriste tek ata.

Shprehja "Zoti juaj" iu drejtohet posaçërisht besimtarëve, ashtu sikurse adhurimi i tyre ndaj Tij është i posaçëm. Por e posaçmja nuk bie ndesh me të përgjithshmen, pasi kjo e fundit i përfshin të dyja.

– *"... Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë! ..."* – Këtu ka diçka të paqartë: lidhja e emrit të Allahut me emrin e të Dërguarit të Tij është bërë me lidhëzën "dhe", megjithëse Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), kur një burrë i tha atij: "Çfarë të dëshirojë Allahu dhe ti (bëhet)", ia ktheu: "E si më bëre të barabartë me Allahun!?"[1]

Përgjigja është se, në këtë rast, kemi të bëjmë me një çështje fetare, dhe Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ishte ai të cilit i

[1] Ahmedi dhe Buhariu në "El edeb el mufred". Sipas Abdul Kadir Arnautit hadithi është i mirë.

zbriti Shpallja. Ndërsa shprehja tjetër: "Çfarë të dëshirojë Allahut dhe ti bëhet", lidhet me një çështje të krijimit, të cilat nuk i përkisnin Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Nga ana tjetër: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë", tregon se njohja e asaj çështjeje i përkiste Allahut dhe të Dërguarit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), ndërsa sahabët nuk kishin si ta dinin.

– *"... Ai që tha: 'Shiu ra me mirësinë e Allahut dhe mëshirën e Tij' ..."* – Domethënë ai që e tha me gjuhë dhe me zemër. Mirësia është dhënie dhe mbarësi, kurse mëshira është një nga cilësitë e Allahut, prej së cilës vjen begatimi dhe mirësia te krijesat.

– *"... besimtar në Mua dhe jobesimtar në yjet ..."* – Sepse rënien e shiut ia atribuon Allahut dhe jo yllit. Ai nuk mendon se ylli ka ndikim në rënien e shiut, por e di që shiu bie për shkak të mirësisë së Allahut.

– *"... ndërsa ai që tha: 'Shiu ra për shkak të këtij apo atij ylli', është jobesimtar ndaj Meje dhe besimtar ndaj yjeve. ..."* – Ai është jobesimtar ndaj Allahut, për arsye se mohoi mirësinë e Tij dhe e lidhi atë me një "shkak" që Allahu nuk e ka bërë të tillë. Ai u lidh me këtë shkak të rremë dhe e harroi mirësinë e Allahut.

Ky lloj kufri nuk të nxjerr nga feja, sepse beson që ylli është vetëm shkak, e jo veprues. Ai ka thënë: "Shiu ra për shkak të këtij apo atij ylli'" dhe jo "Shiun na e solli ky yll". Po të thoshte këtë shprehje të fundit, kjo do të ishte si pohim që ylli ishte burimi, ai që e ka krijuar shiun. Kësisoj, janë të gabuar ata që thonë se kjo shprehje do të thotë se ylli është burimi i shiut dhe jo shkak.

Përfundimisht, qëllimi në hadith është për ata që e pohojnë se shiun e krijon dhe e sjell Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), por ylli është një shkak. Ai bën kufër, sipas këtij rregulli, por kufër të vogël, që nuk të nxjerr nga feja.

Lidhja e reshjeve me yjet mund të bëhet në tri forma:

- Duke besuar se janë yjet që sjellin shiun. Ky është shirk i madh.
- Duke besuar se janë vetëm shkak. Ky është shirk i vogël.
- Duke thënë se shiu bie në kohën e aksh ylli. Kjo lejohet, sepse

tregon vetëm kohën.

> Po nga ata të dy (Buhariu dhe Muslimi) vjen hadithi i Ibn Abasit, me kuptimin e tij: "Disa thonin: 'Doli i vërtetë ai yll'." Atëherë Allahu zbriti këto ajete: "Betohem në çastin e perëndimit të yjeve, e vërtet ky është betim i madh, veç sikur ta dinit, se ky është vërtetë një Kuran i vyer (*kerim*), në Librin e ruajtur. Atë e prekin vetëm të pastërtit. Ai është shpallje prej Zotit të botëve. A është fjalë e tillë (ky Kuran) saqë ju të mohoni, dhe në vend që të falënderoni Allahun për mirësitë (rrizkun) që u ka dhënë, ju i mohoni ato." (Uakia, 75-83)

– *"... Po nga ata të dy ..."* – Me sa duket, ky është një gabim në të shkruar, sepse hadithi ndodhet vetëm në "Sahih-un" e Muslimit dhe jo te Buhariu.

Kuptimi i hadithit është se kur binte shi, disa e lidhnin me mëshirën e Allahut, ndërsa disa të tjerë thonin: "Doli i vërtetë ai yll", sikur ishte ylli shkaktar i shiut. Kjo gjë nuk lejohet, sepse Allahu ua ka ndaluar robërve të Tij. Ky është shirk i vogël. Edhe sikur ta shoqërosh me shprehjen: "me lejen e Allahut", sërish nuk lejohet, sepse të gjitha shkaqet janë krijuar nga Allahu, ndërsa yjet Ai nuk i ka bërë shkak për shiun.

– *"... Betohem në çastin e perëndimit të yjeve ..."* – Cila është dobia e betimit të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), duke qenë se Ai thotë gjithnjë të vërtetën, pa qenë e nevojshme të betohet, dhe Ai iu drejtohet njerëzve që besojnë në Të, që e besojnë si të vërtetë fjalën e Tij? Nëse do të ishte për njerëz që nuk besojnë në Të, atëherë edhe betimi nuk do të kishte dobi. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Edhe sikur t'u sillni të gjitha provat atyre që u është dhënë Libri, ata prapëseprapë nuk do të pranonin Kiblën tënde ..." (Bekare, 145).

Ka disa argumente në përgjigjeje të kësaj pyetje:

1. Betimi është një mënyrë e arabëve për të dhënë siguri, në çfarëdo lloj marrëdhënieje, dhe dihet se Kurani ka zbritur në gjuhën

arabe.

2. Betimi ia shton sigurinë besimtarit. Nuk ka ndonjë ndalesë për ato përforcues që shtojnë sigurinë e besimit. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë për Ibrahimin (alejhi selam): "Zoti im! Më shfaq mua se si Ti i ngjall të vdekurit. Allahu iu përgjigj: "A nuk beson?" Ibrahimi i tha: "Po, besoj, por dua të më qetësohet zemra." (Bekare, 260).

3. Allahu betohet në gjëra madhështore, që tregojnë për fuqinë, madhështinë dhe dijen e plotë të Tij (Subhanehu ue Te'Ala). Nëpërmjet betimit, Ai dëshmon për madhështinë e objektit mbi të cilin bie betimi dhe sigurinë e asaj për të cilën bëhet betimi.

4. Betimi është lavdërim për objektin mbi të cilin bie betimi, sepse ai betohet vetëm mbi gjëra madhështore. Ky argument dhe ai i mësipërmi nuk kanë të bëjnë me vërtetësinë e kumtit, por me objektin mbi të cilin bie betimi.

5. Betimi i jep rëndësi asaj për të cilën bëhet, prandaj ajo meriton vëmendje dhe përqendrim.

Në këtë ajet, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) flet në vetën e parë njëjës, për të dëshmuar se Ai është Një. Ai (Subhanehu ue Te'Ala) është Një, pa ortak. Kurse veta e parë e shumësit përdoret nga Allahu për të treguar Madhështinë e Tij, si: "Vërtet, Ne e kemi zbritur Kuranin dhe Ne do ta ruajmë atë me siguri." (Hixhër, 9); "Sigurisht, Ne i ringjallim të vdekurit dhe shënojmë veprat që kanë bërë dhe gjurmët e (punëve të) tyre, Ne e kemi shënuar çdo gjë në një Libër të qartë." (Jasin, 12). Por Ai nuk flet për Veten e Tij me dyjësin,[1] sepse ai është i kufizuar në numrin dy.

Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) betohet në yjet, të cilët, me sistemin e përkryer të tyre, dëshmojnë për fuqinë absolute të Krijuesit. Vetë Kurani, kur zbriti, u ruajt me anë të yjeve gjuajtës.

Një shpjegim tjetër është se, fjalët e ajetit tregojnë që betimi është bërë për afatin e zbritjes së Kuranit. Për këtë, sipas tyre, dëshmon fakti se Kurani ka zbritur pjesë-pjesë.[2] Po kështu, juristët thonë se për skllavin që lirohet kundrejt një shume të paguar nga vetë ai, duhet ta shlyejë këtë shumë me dy këste e më shumë. Ky ishte një interpretim tjetër, dhe ne kemi përmendur më parë një rregull, që

[1] Dyjësi është një kategori gramatikore e arabishtes, që tregon domosdoshmërisht dy subjekte.

[2] Është bërë një lidhje mes fjalës *nexhm*-"yll" dhe *munexhemen*-"me pjesë".

thotë: kur jepen dy kuptime që nuk janë kontradiktorë, atëherë ato pranohen të dy, përndryshe duhet të pranohet veç njëri si i saktë.

– *"... e vërtet ky është betim i madh, veç sikur ta dinit ..."* – Allahu e ka fuqizuar këtë betim me pjesëzat përforcuese (të gjuhës arabe) *inne* dhe *lam*, si lavdërim dhe madhërim të asaj për të cilën është betuar.

Ndërsa "veç sikur ta dinit" është përforcuesi i tretë, pra, sikur Ai thotë që ju duhet që ta mësoni patjetër këtë çështje, se ajo është tepër e madhe për të qenë e panjohur. Ajo ka nevojë për njohje dhe vëmendje. Sikur ta njihnit ashtu siç e meriton ajo të njihet, do ta kuptonit madhështinë e saj, prandaj kini mendjen!

– *"... se ky është vërtet një Kuran i vyer (kerim). ..."* – Fjala "Kuran" ka dy domethënie:

1. Përmbledhës i librave hyjnorë të mëparshëm, për sa i përket të mirave dhe dobive. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin (Kuranin) me të vërtetën, dëshmues për vërtetësinë e librave të mëparshëm dhe ruajtës i tyre." (Maideh, 48)

2. Libër i përmbledhur në të shkruar.

Ndërsa cilësimi "kerim" ka kuptimi "bujar", që jep e fal shumë, dhe Kurani fal përsosmërinë. Gjithashtu, "kerim" tregon diçka të këndshme e të mirë, si në hadithin: "Mos merr më të mirën e pasurisë së tyre për zekat."[1] Pra, Kurani është i mirë, i çmuar, i vyer.

Kurani i përmban të dyja cilësitë. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Të përkryera janë fjalët e Zotit tënd në vërtetësi dhe drejtësi ..." (En'am, 115). Kurani u jep besimtarëve të tij mirësi ahireti e dynjaje, fizike e shpirtërore. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Mos i dëgjo mohuesit, por luftoji ata me forcë nëpërmjet këtij (Kuranit)." (Furkan, 52). Ai është armë për atë që është i kapur pas tij, por kapja duhet të jetë me fjalë, besim dhe vepra, pasi besimin duhet që ta vërtetojë vepra. Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Me të vërtetë në trup është një copë mishi, e cila kur rregullohet, rregullohet i gjithë trupi; e nëse ajo prishet, prishet i

[1] Buhariu.

gjithë trupi: ajo është zemra."[1] Ndërsa në një ajet tjetër, Kurani është përshkruar si *mexhid*. *Mexhid* tregon madhështi, krenari dhe fuqi. Kurani i ka këto cilësi: ai është i fuqishëm, e po ashtu ka plot mirësi për atë që kapet pas tij.

– *"... në Librin e ruajtur. ..."* – Komentuesit e Kuranit kanë dy mendime për fjalën "Libër":

Mendimi i parë: Ai është *Leuhi Mahfudh*, në të cilin Allahu ka shkruar çdo gjë.

Mendimi i dytë: "Libri" këtu nënkupton shkrimet, që gjendet në dorën e melekëve, përshkruar në ajetin: "(Ai është) Në shkrime (fletushka) të mbajtura lart në nderim, të lartësuara, të pastra. Në duart e (melekëve) udhëtuesve." (Abese, 11-15). Nga ky mendim ka anuar edhe Ibn Kajimi. Ky është qëndrim mbizotërues, ajeti i mësipërm përqaset me ajetin tjetër: "... në duart e (melekëve) udhëtuesve ..." Sipas kësaj, "Libri" këtu tregon llojin dhe jo një libër të caktuar.

– *"... Atë e prekin vetëm të pastërtit..."* – Përemri "atë" është në vend të "Librit të Ruajtur", sepse ai është emri më i afërt me të. E themi këtë, me qëllim që të mos ngatërrohemi me një mendim tjetër, sipas të cilit "atë" i referohet "Kuranit", prandaj këtu kemi të bëjmë me një ndalesë, dhe më konkretisht: që Kuranin ta prekin vetëm të pastrit. Por në ajet nuk ka tregues të këtij kuptimi, përkundrazi, është e qartë se "atë" i referohet "Leuhi Mahfudh-it", pasi ai është emri më i afërt i përmendur.

Po kështu, është e qartë se kjo fjali është thjesht një kumt, dhe ai nuk duhet të komentohet si urdhër apo ndalesë, pa pasur ndonjë fakt që ta tregojë këtë. Përkundrazi, këtu ka fakte që dëshmojnë se ai është thjesht një kumt, që flet për *Leuhi Mahfudh*-in.

Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "vetëm të pastrit", dhe nuk thotë: "vetëm ata që pastrohen", siç thotë, për shembull, në ajetin tjetër: "Pa dyshim që Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen." (Bekare, 222). Të pastrit janë ata, të cilët i ka pastruar Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) nga mëkatet dhe papastërtitë e tyre. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "... të cilët

[1] Buhariu.

nuk kundërshtojnë urdhrat që marrin nga Allahu, por zbatojnë atë që u është urdhëruar." (Tehrim, 6). "Ata (melekët) e lavdërojnë (Atë) natën dhe ditën, paprerë." (Enbija, 20). "Ata (melekët) janë robër të nderuar. Ata nuk flasin para (Fjalës së) Tij dhe veprojnë me urdhrin e Tij." (Enbija, 26-27). Ka ndryshim mes atij që "pastrohet", duke kërkuar të përsosë veten e tij, dhe "të pastrit", i cili tashmë është i tillë, sepse e ka përsosur dikush tjetër; "të pastrit melekët". Ky është një argument që përforcon qëndrimin tonë, nga i cili ka anuar edhe Ibn Kajimi, se "Libri" këtu nënkupton fletët që ndodhen në duart e melekëve.

Gjithashtu, nga ajeti kuptohet se për atë që e pastron veten nga mëkatet, Kurani i bëhet më i kuptueshëm, ndërsa për atë që e ka nxirë zemrën me mëkate, Kurani është më i vështirë për t'u kuptuar. Kjo për vetë faktin se përderisa Allahu nuk ua bën të mundur atyre që s'janë të pastër të prekin fletët që ndodhen në duart e melekëve, atëherë e këtillë është edhe kapja e kuptimeve të Kuranit.

Shejhu i Islamit ka nxjerrë nga ky ajet mësimin se mëkatet janë shkak për moskuptimin e Kuranit, siç thuhet në ajetin tjetër: "Jo, kurrë nuk është kështu! Por në zemrat e tyre ka mbulesë nga gjynahet, që ata kanë bërë." (Mutafifin, 14). E këta janë ata për të cilët Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Kur vargjet Tona i këndohen atij, ai thotë: 'Përralla të të parëve!'" (Kalem, 15). Pra, ata nuk i kapin kuptimet e tij, sepse zemrat e tyre janë të mbuluara me perden e gjynaheve.

Disa dijetarë thonë se kush jep fetva, para fetvasë duhet t'i kërkojë falje Zotit, për të fshirë ndikimet e mëkateve në zemrën e tij, në mënyrë që t'i qartësohet e vërteta. Këtë e kanë nxjerrë nga ajeti: "Ne (o Muhamed) ta kemi zbritur Librin (Kuranin) me të drejtën, në mënyrë që ti të gjykosh ndërmjet njerëzve sipas asaj që të mësoi Allahu. Dhe mos u bëj mbrojtës i tradhtarëve. Kërko falje nga Allahu, se Allahu është Falës e Mëshirues." (Nisa, 105-106).[1]

[1] Ibn Abasi ka thënë: "Librin që është në qiell." Në një përcjellje tjetër: "Nuk e prek atë askush veç melekëve." Ndërsa Katadja ka thënë: "Askush nuk mund ta prekë atë që është tek Allahu, veç të pastërve, ndërsa në dynja atë e prek zjarrëputisti i pistë dhe munafiku i poshtër." Buhariu ka thënë për këtë ajet në "Sahihun" e tij: "Shijen e tij e ndjen vetëm ai që

– *"... Ai është shpallje prej Zotit të botëve. ..."* – Nga ky ajet mësohet se:

a) Kurani është shpallje për të gjitha krijesat. Kjo tregon se edhe Muhamedi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) u dërgua për mbarë botën.

b) Kurani zbriti nga Zoti i tyre, prandaj shërben si gjykues për ta.

c) Zbritja e Kuranit erdhi nga përsosmëria e Allahut si Zot. Nëse shohim edhe ajetin: "Shpallje nga i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti. Një libër në të cilin Vargjet e tij shtjellohen me imtësi ...", mësojmë se Kurani është mëshirë për krijesat dhe se zotërimi dhe mbikëqyrja e Allahut është e bazuar në mëshirë. Allahu ka thënë: "Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti." Çdo gjë për të cilën Allahu i ka urdhëruar robërit e Tij ose i ka ndaluar ata prej saj, është mëshirë për ta.

d) Kurani është fjalë e Allahut, meqë është Ai që e ka zbritur. Kurani nuk është fjalë e dikujt tjetër, ai nuk është i krijuar, sepse asnjë cilësi e Allahut nuk është e krijuar.

Dikush mund të pyesë: Vallë, çdo gjë "e zbritur" nuk është e krijuar? Ne përgjigjemi: Jo, por çdo përshkrim që i atribuohet Allahut, siç është fjala e Tij, nuk është i krijuar ndërsa gjërat e tjera janë të krijuara, për shembull, Allahu thotë se zbret ujë nga qielli, dhe uji është i krijuar; Allahu thotë: "Ne e kemi zbritur hekurin ..." (Hadid, 25), dhe hekuri është i krijuar; Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Ai zbriti për ju bagëti, nga tetë çifte ..." (Zumer, 6), dhe bagëtitë janë të krijuara. Atëherë, nëse ajo që zbret nga Allahu është një atribut që nuk mund të ekzistojë në mënyrë të mëvetësishme pa një qenie, por domosdo varet nga një qenie, kjo do të thotë se ajo nuk është krijesë, por një cilësi e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

– *"... A është fjalë e tillë (ky Kuran) saqë ju ta mohoni ...?"* –

---

beson në të." Ibn Kajimi ka thënë: "Në këtë ajet aludohet dhe paralajmërohet se me Kuranin, leximin, kuptimin dhe meditimin e tij, kënaqet vetëm ai person që dëshmon se ai është fjalë e Allahut, Ai ka folur me të realisht dhe e ka zbritur atë shpallje tek i Dërguari i Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Domethëniet e Kuranit i arrin vetëm atij të cilit nuk i ngushtohet zemra prej tij në asnjë lloj mënyre. (Marrë shkurtimisht nga "Tejsirul Azizi el Hamid".)

Funksioni i pyetjes këtu është qortues. "Fjala" është Kurani, ndërsa mohues është i frikësuari nga diçka tjetër, të cilën e favorizon me fjalën dhe veprën e tij. Kuptimi është: a e mohoni këtë fjalë, sepse keni frikë?! Nuk ju takon ta bëni këtë. Përkundrazi, ai që ka Kuranin, duhet ta publikojë haptas atë, ta sqarojë dhe të bëjë përpjekje me të. Allahu ka thënë: "... por luftoi ata me forcë nëpërmjet Kuranit." (Furkan, 52)

– *"... dhe në vend të falënderimit të Allahut për mirësitë që ju ka dhënë, ju i mohoni ato?"* – Shumë nga komentuesit e Kuranit, thonë se këtu kemi të bëjmë me një fjali eliptike[1], që do të thotë: Në vend të falënderimit për gjithçka që Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) u ka dhënë, si: zbritjen e shiut apo të Kuranit, pra, në vend të falënderimit për këto të mira madhështore, ju, përkundrazi, i mohoni ato? Edhe pse Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e ka përmendur për rënien e shiut, ky ajet përfshin dhe të tjera gjëra veç shiut.

Ndërsa disa komentues të tjerë thonë se në ajet nuk ka elipsë, prandaj kuptimi i tij është: Ju falënderimin e kthyet në mohim. Këta komentues thonë se falënderimi është mirësi e falur, dhe ky shpjegim është mjaft i saktë, madje falënderimi është nga mirësitë më të mëdha.

Një poet këndon:

Falënderimi i Allahut, në është mirësi për mua,
ta falënderoj për të e kam për detyrë.
Po si ta arrij falënderimin që dua,
Pa mirësinë e Tij, qoftë kjo jetë e shtyrë!?

Mirësia ka nevojë për falënderim, e nëse ti e falënderon atë, kjo është një mirësi tjetër, që ka nevojë për një falënderim të dytë, që nëse ti e bën, kjo është një mirësi që do falënderim të tretë, e kështu pa mbarim. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Nëse do t'i numëroni mirësitë e Allahut, nuk do të mund t'i llogaritnit ato ..." (Nahl, 18).

[1] Formë gjuhësore që ka të bëjë me heqjen e një gjymtyre ose e më shumë gjymtyrëve të nënkuptueshme në një fjali, me qëllim që, pa e vështirësuar kuptimin, mendimi të shprehet më shkurt.

– *"... ju i mohoni ato?"* – Nuk ka dyshim se është mendjelehtësi kur njeriu e kthen të mirën e Zotit të tij me mohim. Nëse është Shpallje hyjnore, mohon fjalën e Tij, nuk zbaton urdhrat dhe nuk u largohet ndalesave të Tij. Nëse është mirësi tjetër, ia atribuon atë dikujt tjetër veç Allahut, si për shembull yjeve, ose thotë se ka ardhur prej zotësisë së tij, siç tha Karuni: "Ai tha: 'Kjo më është dhënë mua, vetëm për shkak të zgjuarsisë që kam ..." (Kasas, 78).

Dobitë e temës

- Komenti i ajetit të sures Uakia.

"... dhe në vend të falënderimit të Allahut për rrizkun (mirësitë) që ua ka dhënë, ju i mohoni ato?".

- Veçimi i katër tipareve të kohës paraislame.

Këto tipare janë: mburrja me origjinën, sharja e prejardhjes së tjetrit, kërkimi i shiut me anën e yjeve dhe vajtimi me kujë mbi të vdekurin.

- Nga hadithet kuptohet se disa punë të *xhahilijetit* janë vepra kufri.

Ato janë: kërkimi i shiut me anën e yjeve, sharja e prejardhjes dhe vajtimi me kujë mbi të vdekurin, siç thuhet në hadithin: "Dy dukuri ndër njerëz janë nga veprat e kufrit dhe çështjet e injorancës, ose që të çojnë në kufër: sharja e prejardhjes së tjetrit dhe vajtimi me kujë mbi të vdekurin."

- Ka kufër që nuk të nxjerr krejtësisht nga feja.

Siç është vepra e kërkimit të shiut me anën e yjeve. Megjithatë, ka forma të kësaj vepre të cilat përbëjnë kufër që të nxjerrin nga feja, siç e sqaruam më lart.

- "Disa nga robërit e Mi u gdhinë besimtarë dhe disa jobesimtarë ndaj Meje" – kur zbriti begatia.

Kjo do të thotë se njerëzit ndahen në besimtarë dhe jobesimtarë ndaj Allahut, përkundrejt ardhjes së begatisë. Njeriu e ka detyrë që, kur i vjen ndonjë begati, të mos ia atribuojë krejtësisht shkakut, duke harruar mirësinë e Allahut, i Cili e mundësoi atë shkak. Përkundrazi, ai duhet ta besojë thjesht si shkak, nëse është vërtet shkak. Për shembull, është duke u mbytur një njeri në ujë, por aty pranë qëllon një burrë i fuqishëm, që hidhet në ujë dhe e shpëton. Njeriu që shpëtoi duhet të njohë mirësinë e Allahut ndaj tij, se sikur të mos kishte dashur Allahu që ta shpëtonte, ai nuk do të shpëtonte. Nga ana tjetër, nëse ai pretendon se e shpëtoi filan velij (të ashtuquajtur njeri i mirë), ky është shirk i madh, sepse ai nuk është shkak i saktë. Pastaj kur ai shpëtimin ia atibuon atij, me sa duket ai me këtë nuk ka për qëllim se ai veliu ishte shkak, por ka për qëllim se ishte ai vetë që e shpëtoi, sepse të besosh se ai është shkak, ndërkohë që ai ndodhet në varr, kjo nuk shkon.

Ndaj ata që janë të lidhur pas eulijave (shenjtorëve, njerëz të ashtuquajtur të mirë), kur bien në vështirësi, u luten atyre dhe jo Allahut. Kështu ata janë në shirk të madh, me ose pa dashje. Ata ndonjëherë edhe sprovohen duke e arritur atë që dëshirojnë kur u është lutur eulijave, e jo përmes duasë, sepse ne e dimë që eulijatë nuk mund të përgjigjen, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t'ju përgjigjeshin ..." (Fatir, 14); "Kush është në rrugë më të gabuar sesa ai, i cili, në vend të Allahut, u lutet atyre që nuk mund t'i përgjigjen atij deri në Ditën e Kijametit." (Ahkaf, 5).

- Zbulimi i besimit me anë të kësaj çështje.

Domethënë kur shiun e njeh si mirësi dhe mëshirë të Allahut.

- Zbulimi i kufrit me anë të kësaj çështje.

Domethënë kur rënien e shiut e lidh me yje të caktuara.

- Qartësimi dhe zbërthimi i shprehjes: "Doli i vërtetë ai yll, që na erdhi shiu".

Kjo del si e përafërt me shprehjen: "Na erdhi shiu prej atij ylli", se pretendimi që ylli ka dalë i vërtetë, do të thotë se shiu vjen si pasojë e asaj që premtohet nga ai yll.

- Mësuesi mund t'ia parashtrojë çështjen nxënësit në formë pyetjeje, siç bëri Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "A e dini çfarë tha Zoti juaj?"

Mësuesi e bën këtë që nxënësi të përqendrohet. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ishte i sigurt që sahabët nuk e dinin çfarë kishte thënë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), por ai donte që ata të ishin të vëmendshëm.

- Paralajmërimi me ndëshkim për vajtueset.

Siç përmendet në hadith: "'Njehatorja, nëse nuk pendohet para vdekjes, në Ditën e Kijametit do të ngrihet me veshje zifti dhe mbulesë zgjebeje." Ky është një kërcënim i madh.

Tema 31

Thënia e Allahut: “E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë si të barabartë me Allahun. Ata i duan idhujt siç duhet Allahu ...”. (Bekare, 165)

Autori (Allahu e mëshiroftë!) e ka vendosur ajetin e mësipërm si titull të temës. Mundet që kjo temë të quhet edhe tema e dashurisë.

Burimi i të gjitha veprave është dashuria. Njeriu bën atë që do, për dy arsye: ose për arritjen e dobisë, ose për shmangien e dëmit. Nëse bën diçka, e bën sepse e do: ose për shkak se është e mirë në vetvete, siç është marrja e ushqimit, ose për rrjedhojat që vijnë prej saj, siç është ilaçi.

Adhurimi i Allahut është ndërtuar mbi dashurinë, madje ajo është thelbi i adhurimit. Nëse adhurimi bëhet pa dashuri, ai është si trup pa shpirt. Nëse njeriu do Xhenetin e Allahut, ai do të bëjë gjithçka që të çon atje. Ndërsa dashuria e idhujtarëve mekas ndaj idhujve të tyre arriti deri atje sa i adhuruan ata përveç Allahut apo bashkë me Të.

Dashuria ndahet në dy lloje:

1- Dashuria e adhurimit. Kjo është dashuria që shoqërohet me nënshtrim dhe madhërim, që sjell si pasojë bindjen ndaj urdhrave të atij që e duam. Kjo lloj dashurie i përket veç Allahut. Ai që do dikë tjetër bashkë me Allahun, me këtë lloj dashurie, ka rënë në shirk të madh.

2- Dashuria që nuk është adhurim në vetvete. Kjo është disa llojesh:

a- Dashuri për hir të Allahut dhe ndaj Allahut. Kjo vjen për shkak të dashurisë ndaj Allahut dhe do të thotë të duash diçka ose dikë për hir të Allahut. E tillë është dashuria për Profetët, të sinqertët, shehidët dhe të mirët, për namazin, zekatin, veprat e mira në përgjithësi etj. Kjo lloj është rrjedhojë e dashurisë ndaj Allahut.

b- Dashuria në formën e keqardhjes dhe mëshirës, siç është dashuria për fëmijët, të vegjlit, të dobëtit dhe të sëmurët.

c- Dashuria në trajtën e respektit dhe nderimit, por jo të adhurimit, siç është dashuria për prindin, mësuesin, bamirësit e mëdhenj etj.

d- Dashuria si nevojë, siç është ajo për ushqimin, pijen, veshmbathjen, mjetet e udhëtimit dhe banesat.

Më e mira dashuri është lloji i parë. Edhe llojet e tjera janë të lejuara, të cilat, nëse i bën për hir të dashurisë së parë, edhe ato kthehen në adhurime të Zotit. Prindin e respektojmë dhe e nderojmë, por kur me këtë respekt synon shpërblimin e Allahut, ai kthehet në adhurim ndaj Zotit. Po kështu, e duam fëmijën dhe na dhimbset, por kur e bën këtë për të zbatuar urdhrin e Allahut, ajo kthehet në adhurim. Gjithashtu edhe nevojat që kemi për të ngrënë, pirë apo veshur, nëse i plotësojmë me qëllimin që, nëpërmjet tyre, të jemi të fortë për të adhuruar Zotin, ato kthehen në adhurime ndaj Zotin. Për Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), nga gjërat e kësaj dynjaje, ishin të dashura gratë dhe era e mirë[1]. Gratë, sepse është diçka e natyrshme dhe që ka mjaft dobi; ndërsa parfumet, sepse ato e kënaqin, gjallërojnë trupin dhe qetësojnë shpirtin. Shkak tjetër, gjithashtu, është se të mirat janë për të mirët. Allahu është i Mirë dhe pranon vetëm të mirën.

Përfundimisht, nëse ato gjëra i kemi dhe i kryejmë me qëllimin që të kënaqim Allahun, ato kthehen në adhurim. Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Vërtet punët shpërblehen sipas qëllimeve. Çdo person do të arrijë atë që ka pasur për qëllim ..."[2] Dijetarët kanë thënë se ajo pa të cilën s'mund të kryhet një detyrë fetare, është vetë detyrë. Kanë thënë, gjithashtu, se mjetet kanë të njëjtën trajtesë ligjore si synimet (objektivat) e tyre, dhe për këtë

[1] Ahmedi dhe Nesaiu. Sipas Albanit në *"xhami es sagir"* hadithi është i saktë.

[2] Buhariu.

dijetarët kanë rënë në ujdi.

Autori (Allahu e mëshiroftë) në këtë temë ka përmendur dy ajete. Ajeti i parë, me të cilin ka titulluar edhe temën:

"E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë (duke i konsideruar) si të barabartë me Allahun. Ata i duan idhujt siç duhet Allahu ...".

Pra, i duan si Allahun, me dashurinë e adhurimit, dhe i duan idhujt aq sa Allahun, madje më shumë. Ata e madhërojnë të dashurin e tyre dhe bëhen xhelozë për të më shumë sesa ç'madhërojnë dhe bëhen xhelozë për Allahun. Ata mund të betohen në Allahun duke gënjyer, pa i dhënë rëndësi, por kurrë nuk betohen në idhullin e tyre duke gënjyer, e ky është shirk i madh.

– *"... Ata i duan idhujt siç duhet Allahu ..."* – Për këtë komentuesit kanë dhënë dy shpjegime:

1. Shprehja merret sipas kuptimit të saj të drejtpërdrejtë: i duan idhujt me të njëjtën dashuri si për Allahun, pra, i bëjnë ortakë të Allahut në dashuri. Por besimtarët e kanë dashurinë për Allahun më të madhe se ata. Ky është më i sakti.

2. Dashuria e tyre është si dashuria e besimtarëve për Allahun. Ata i duan këta të adhuruar, ashtu si besimtarët duan Allahun.

Ky kuptim, edhe pse mund ta përmbajë shprehja, kundërshtohet nga konteksti, sepse do të ishte kontradiktor me vijimin e ajetit: "... por ata që besojnë, e duan Allahun më shumë ...". Pra, dashuria e besimtarëve për Allahun është më e madhe, sepse ajo është dashuri e pastër, pa shirk.

Dikujt mund t'i shkojë në mendje se ata që duan të tjerë njëlloj si Allahun janë besimtarë. Cila do të ishte përgjigjja për këtë?

Përgjigjja është se, shpesh, në gjuhën arabe, kur shprehet parapëlqim për një objekt të krahasuar me një tjetër, ky parapëlqim – në dukje – është në fakt mohim i plotë i anës tjetër të krahasimit. Kështu ndodh në ajetin, që thotë: "Banorët e Xhenetit atë Ditë, do të kenë banesën më të mirë dhe do të kenë vendet më të këndshme për prehje." (Furkan, 24), kur dihet se banorët e Xhehenemit nuk kanë për të gjetur kurrfarë mirësie në vendbanimin e tyre. Po kështu, edhe në ajetin: "Kush është më i mirë, Allahu apo ata (zota) që ia shoqërojnë Atij?" (Neml, 59), kur është e sigurt se pala tjetër

nuk ka asnjë të mirë të krahasueshme. Këto janë forma të shprehuri të cilat i qartëson konteksti.

Lidhja e ajetit me këtë temë qëndron në faktin se njeriu është i ndaluar të dojë dikë apo diçka tjetër aq sa do Allahun, sepse ky është shirk i madh, që të nxjerr nga feja. Kjo lloj dashurie ekziston te disa adhurues dhe disa shërbëtorë. Disa adhurues i madhërojnë dhe i duan disa varre apo eulijave, njëlloj si Allahun apo më tepër. Po kështu disa shërbëtorë i duan dhe i madhërojnë prijësit e tyre më shumë sesa duan dhe madhërojnë Allahun. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Dhe do të thonë: 'O Zoti ynë, ne iu bindëm prijësve dhe eprorëve tanë, por ata na shmangën prej rrugës së drejtë. O Zoti ynë, atyre jepu dënim të dyfishtë dhe mallkoi ata me nëmë të madhe.'" (Ahzab, 67-68).

Ajeti i dytë, i sjellë nga autori, është:

> "Thuaju: 'Nëse baballarët tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkoj mirë dhe vendbanimet ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, Pejgamberi i tij dhe lufta në rrugën e Allahut, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij." (Teube, 24)

Fjala "thuaju" i është drejtuar Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sellem), kurse: "Nëse baballarët tuaj ..." i referohet umetit. Urdhri "... atëherë prisni ...", është kërcënues, që do të thotë: Pritni ndëshkimin e Allahut, prandaj vijon: "... derisa Allahu të sjellë vendimin e Tij" për ndëshkim. Ky ndëshkim do të jetë për ata që i japin përparësi atyre tetë kategorive të përmendura në ajet, duke i dashur më shumë sesa Allahun, Pejgamberin e Tij dhe xhihadit në rrugën e Tij. Ajeti argumenton se dashuria për ato kategori, − edhe pse nuk është dashuri adhurimi, − nëse vlerësohet më tepër se dashuria për Allahun, bëhet shkas për dënim. Nga kjo mësojmë se, nëse i nënvlerëson urdhrat e Allahut, për shkak të urdhrave të prindit, kjo tregon se do prindin më shumë sesa Krijuesin.

Çfarë mban zemra nuk e di askush tjetër veç Allahut, mirëpo për të dëshmojnë pjesët trupit. Përcillet se Hasan el Basriu ka thënë:

"Çdokush që fsheh diçka në zemër, nuk shpëton, sepse Allahu e bën ta shfaqë atë në pamjen e fytyrës dhe në fjalët që nxjerr gjuha pa kontroll." Pjesët e trupit janë pasqyrë e zemrës.

Dashuria – mund të thotë dikush – është në zemër, dhe njeriu nuk mund ta kontrollojë. Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "O Allah! Kjo është pjesa që unë mund ta kontrolloj, prandaj mos më qorto mua për atë pjesë të tepruar të dashurisë dhe animit të zemrës, që unë nuk mund ta kontrolloj, sepse Ti je rrotulluesi i zemrave."[1] Si mund të dojë njeriu diçka, ndërkohë që ai e urren atë? A nuk është kjo përpjekje për ta bërë të pamundurën të mundur?

Ne përgjigjemi, duke thënë se kjo nuk është e pamundur. Mund të ndodhë që dashuria të kthehet në urrejtje ose anasjelltas. Këto vijnë prej ndonjë shkaku të qartë, ose prej vetë vullnetit. Mund të kesh një shok që e do, por nëse ai të vjedh ose të cenon, fillon ta urresh. Por ky ndërrim mund të vijë edhe prej vullnetit personal, për shembull, të pëlqen të pish duhan, por me vullnetin për ta lënë, dashuria të kthehet në urrejtje për duhanin.

Omeri (r.a.) i tha njëherë të Dërguarit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Ti je për mua më i dashur se çdokush, përveç vetes sime." Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i tha: "Jo, për Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, imani yt nuk do të përsoset derisa të jem për ty më i dashur sesa vetja jote." Atëherë Omeri tha: "Tani, për Zotin, ti je më i dashur për mua sesa vetja ime." Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i tha: "Tani po, o Omer."[2] Pra, Omerit iu shtua dashuria për të Dërguarin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Kështu, Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) pohoi se dashuria mund të ndryshojë.

Ndoshta, prej fjalëve që ke dëgjuar për një person, ti e urren atë, pasi merr vesh se fjalët nuk ishin të vërteta, atëherë e kthen dashurinë për të.

> Enesi (r.a.) tregon se Pejgamberi i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Askush nga ju nuk beson, derisa unë të jem më i dashur për të sesa fëmija e tij,

[1] Ahmedi, Ebu Daudi,Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i dobët.
[2] Buhariu.

prindëri i tij dhe të gjithë njerëzit e tjerë."[1]

– *"... nuk beson ..."* – Ky është mohim imani. Kur mohohet imani, ndonjëherë nënkuptohet mohimi i imanit të plotë, e ndonjëherë mohimi i plotë i imanit. Në këtë hadith, nënkuptohet mohimi i imanit të plotë, por nëse në zemër nuk ka aspak dashuri për Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), atëherë kemi të bëjmë me mohim të plotë të imanit.

– *"... sesa fëmija e tij ..."* – Përfshihen fëmijët meshkuj dhe femra. Nis me dashurinë për fëmijët, sepse lidhja e zemrës së njeriut me to është më e madhe sesa lidhja e zemrës me prindërit, në të shumtën e rasteve.

– *"... prindëri i tij ..."* – Kjo përfshin babain, gjyshin dhe më lart, si dhe nënën, gjyshen e më lart.

– *"... të gjithë njerëzit e tjerë ..."* – Kjo përfshin vëllezërit, xhaxhallarët, bijtë e tyre, shokët dhe veten e personit, sepse edhe ai është njeri. Imani nuk plotësohet, derisa Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), të jetë më i dashur se të gjitha krijesat. Nëse kjo është për të Dërguarin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), ç'mund të thuhet për dashurinë ndaj Allahut (Subhanehu ue Te'Ala)?!

Dashuria për Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është e domosdoshme për këto arsye:

- ai është Pejgamberi i Allahut. Nëse Allahu është për ty më i dashur se çdo gjë, edhe Pejgamberi i Tij duhet të jetë më i dashur se çdo krijesë;
- për adhurimin që i ka kushtuar Allahut dhe për përcjelljen e fesë;
- për moralin e lartë dhe veprat e mira, që ia dha Allahu;
- ai është shkak për udhëzimin, mësimin dhe orientimin tënd;
- për durimin e tij ndaj vështirësive gjatë përcjelljes së fesë;
- për sakrificën e tij me pasuri dhe trup, për ngritjen e fjalës së Allahut.

[1] Buhariu dhe Muslimi.

Dobitë e hadithit

- Domosdoshmëria e përparësisë së dashurisë për Profetin mbi dashurinë për vetveten.
- Të sakrifikosh për Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) me veten dhe pasurinë tënde, sepse është detyrë t’i japësh përparësi dashurisë ndaj tij, mbi dashurinë ndaj vetes dhe pasurisë tënde.
- Njeriu e ka detyrë të ndihmojë Sunetin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe të sakrifikojë për të me veten, pasurinë dhe gjithë fuqinë e tij, sepse kjo tregon dashurinë e plotë ndaj Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Për këtë arsye, disa dijetarë kanë thënë për ajetin: “Kush të urren ty (Muhamed), pikërisht ai është fatzi.” (Keuther, 3), se ai që urren Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), e po ashtu edhe ai që urren fenë e tij, është fatzi dhe i pashpresë.
- Lejimi i dashurisë si mëshirë dhe respekt. Argument është hadithi: “... më i dashur për ju sesa bijtë tuaj, prindërit tuaj ...”. Ajo dashuri është natyrshme që askush nuk mund ta mohojë.
- Domosdoshmëria e përparësisë së fjalës së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) mbi fjalën e të gjithë njerëzve, sepse një nga treguesit e dashurisë eprore për të është përparësia që i jepet fjalës së tij, madje edhe ndaj fjalës tënde.

Nëse Pejgamberi i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është më i dashur për ty sesa vetja jote, atëherë ti e përkrah Profetin më shumë sesa ndihmon veten tënde. Ti e kundërshton veten tënde për hir të fjalës së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe të bindjes ndaj tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem); kjo është shenjë që ti e do atë më shumë se veten. Për këtë disa thonë:

Zotit s’i bindesh, por që e do, mëton,
Betohem se e dyta me të parën s’shkon.
I sinqertë nëse je, të duhet nënshtrim,
Mosbindja ndaj tij, jo nuk ka kuptim.

Hadithi dëshmon se fjala e Profetit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) qëndron mbi fjalën e të gjithë njerëzve, qofshin ata edhe Ebu Bekri, Omeri, Othmanit, katër imamët e medhhebeve dhe të tjerëve mbas tyre. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe

Pejgamberi i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyren ...” (Ahzab, 36). Por nëse një hadith bie në kundërshtim me hadithet e tjera, ose është në kundërshtim me shumicën e dijetarëve, atëherë duhet të mos nxitohemi, por ta verifikojmë hadithin, sepse ndjekja e një parregullsie shpie në çrregullime.

Lidhja e hadithit me temën në fjalë është e qartë, pasi dashuria për të Dërguarin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) vjen prej dashurisë për Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala). Kur besimi nuk u plotësoka derisa Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të jetë më i dashur te njeriu se vetja e tij dhe të gjithë njerëzit e tjerë, atëherë dashuria ndaj Allahut ka më tepër përparësi dhe duhet të jetë më e madhe se çdo dashuri tjetër.

> Po te Buhariu dhe Muslimi, tregohet se Pejgamberi i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Nëse një person ka tri cilësi, ka gjetur ëmbëlsinë e imanit: kur Allahu dhe Pejgamberi i Tij janë më të dashur për të se gjithçka tjetër; kur do një njeri veç për hir të Allahut dhe kur urren kthimin në kufër, pasi Allahu e shpëtoi prej tij, ashtu siç urren që të hidhet në zjarr.”[1]

– *“... Nëse një person ka tri cilësi, ka gjetur ëmbëlsinë e imanit ...”* – Ëmbëlsia e imanit është qetësi shpirtërore, rehati e zemrës. Ajo nuk shijohet me gjuhë e gojë, por veç me zemër.

– *“... kur Allahu dhe Pejgamberi i Tij janë më të dashur për të se gjithçka tjetër ...”* –Kjo është cilësia e parë që renditet në hadith. Është detyrë të duash Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), e po kështu të gjithë Profetët e tjerë. Ai duhet të jetë më i dashur se e gjithë dynjaja, vetja, fëmijët, bashkëshortja etj.

Pse janë bashkuar me lidhëzën dhe “Allahu dhe Pejgamberi i Tij”? Sepse dashuria për Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) është prej dashurisë për Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala). Edhe shehadeti “Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut dhe

[1] Buhariu dhe Muslimi.

se Muhamedi është i Dërguari i Tij" është bërë një kusht i vetëm, sepse shehadeti nuk përmbushet pa ndjekur rrugën e Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

– *"... kur do një njeri ..."* – Fjala "njeri" nënkupton mashkullin dhe femrën.

– *"... veç për hir të Allahut ..."* – Për hir të Allahut, sepse ai adhuron Allahun (Subhanehu ue Te'Ala). Dashuria për një person ka shumë shkaqe: për interes dynjaje, për afërsi farefisnore, për afërsi pune, e do bashkëshorten për shkak të plotësimit të epsheve me të, e do atë që të bën bamirësi etj., por nëse një person e do për hir të Allahut, ky është një shkak që sjell ëmbëlsinë e imanit.

– *"... kur urren kthimin në kufër, pasi Allahu e shpëtoi prej tij, ashtu siç urren që të hidhet në zjarr."* – Kjo vlen për jomuslimanin që është bërë musliman. Ai duhet të urrejë të kthehet prapë në kufër, pasi Allahu e ka shpëtuar prej tij, ashtu siç urren të hidhet në zjarr. Në këtë rast, ky musliman i njeh gjërat që ka bërë kur ka qenë kafir, ndryshe nga ai që nuk i ka njohur, prandaj kur e urren kthimin në kufër, ashtu siç urren të hidhet në zjarr, mund të shijojë ëmbëlsinë e imanit.

> Në një variant tjetër, hadithi nis: "Nuk e gjen askush ëmbëlsinë e imanit, derisa ...(deri në fund)."[1]

Arsyeja pse e ka përmendur autori këtë variant të hadithit në fjalë është se mohimi i ëmbëlsisë (përsosjes) së imanit në variantin e parë është i nënkuptuar, ndërsa në këtë variant është i formuluar shprehimisht, dhe siç dihet, dëshmia e formuluar është më e fortë sesa dëshmia e nënkuptuar.

> Ibn Abasi (r.a.) ka thënë: "Kush do për hir të Allahut dhe urren për hir të Tij, miqëson për hir të Allahut dhe armiqëson për hir të Tij, ka për të gjetur ndihmën e

[1] Buhariu.

> Allahut; njeriu nuk ka për ta provuar shijen e imanit, – edhe nëse ka shumë namaze dhe agjërime, – pa i bërë ato. Njerëzit, në përgjithësi, vëllazërohen për çështje të dynjasë, por kjo nuk u sjell atyre asnjë dobi"[1]

– *"... Kush do për hir të Allahut ..."* – Pra, kush do për shkak të Allahut, për hir të fesë ose devotshmërisë së tij, e jo për qëllime dynjaje.

– *"... urren për hir të Tij ..."* – Pra, kush urren për Allahun, kur e shikon që kundërshtohet Ai.

– *"... miqëson për hir të Allahut ..."* – Miqësia përfshin dashurinë, ndihmën e të ngjashme me këto.

– *"... dhe armiqëson për hir të Tij ..."* – Armiqësia është e kundërta e miqësisë; pra kur largohesh prej njerëzve dhe i urren ata për hir të Allahut.

– *"... ka për të gjetur ndihmën e Allahut ..."* – Pra, kështu njeriu arrin ndihmën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), sepse ai, dashurinë dhe urrejtjen, miqësinë dhe armiqësinë e tij, i bëri për hir të Allahut.

Ky transmetim është i dobët. Kuptimi i tij është se njeriu nuk e gjen shijen dhe ëmbëlsinë e imanit, derisa të plotësohen kushtet e duhura, edhe nëse falet dhe agjëron shumë.

Si mund të guxojë një i mençur, pa diskutuar besimtarin, të miqësojë armiqtë e Allahut, ata që i bëjnë shok Krijuesit të tyre, që e mohojnë Atë, që i mveshin Atij të meta? Ky, edhe nëse e kalon gjithë natën duke u falur, edhe nëse i agjëron të gjitha ditët, nuk mund ta arrijë shijen e imanit. Zemra duhet të jetë e mbushur me dashurinë e Allahut dhe miqësinë e Tij, me urrejtjen për armiqtë e Allahut dhe me armiqësinë ndaj tyre. Ibn Kajimi thotë: "Të duash armiqtë e të dashurit tënd dhe të pretendosh pastaj dashurinë e tij: kjo është e pamundur." Ndërsa imam Ahmedi ka thënë: "Kur shoh ndonjë të krishterë, i mbyll sytë nga urrejtja, që të mos e shoh me sy armikun

[1] Ibn Xheriri.

e Allahut." Ky është ai që ndjen shijen e besimit. Ndërsa kush beson se çifutët apo të krishterët kanë fe të pëlqyer e të pranuar nga Allahu, pas dërgesës së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), ka dalë nga Islami dhe është mohues i ajeteve të Kuranit: "... dhe zgjodha për ju Islamin si fe ..." (Maide, 3); "Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami." (Ali Imran, 19); "Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe në Botën tjetër do të jetë i humbur." (Ali Imran, 85).

Për shkak të numrit të madh të çifutëve, të krishterëve dhe idhujtarëve, kjo çështje është bërë e rrezikshme për shoqërinë, sepse shumë besimtarë tani nuk bëjnë dallim ndërmjet muslimanit dhe qafirit, nuk e dinë se çdokush tjetër, veç muslimanëve, janë armiq të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) dhe armiq të tyre, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "O ju që keni besuar! Mos i bëni armiqtë e Mi dhe armiqtë tuaj (mosbesimtarët) miq e shokë ..." (Mumtehine, 1). Ata janë armiqtë tanë, edhe pse hiqen si të sinqertë. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "O ju që keni besuar! Mos i zini çifutët dhe të krishterët për miq. Ata janë shokë, miq e mbrojtës vetëm për njëri-tjetrin, dhe nëse ndonjëri nga ju i zë ata miq, atëherë nuk ka dyshim se ai është një prej tyre ..." (Maide, 51).

Ne tani jemi në një sprovë të madhe, pasi ekziston rreziku që bijtë e kombit tonë të afrohen drejt këtyre njerëzve me besime të tjera, t'i miqësojnë e t'i duan. Prandaj, është detyrë që veçanërisht këto vende[1] të pastrohen prej tyre, sepse edhe Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Do t'i nxjerr çifutët dhe të krishterët nga gadishulli Arabik, derisa të mbeten aty vetëm muslimanët."[2] Ndërsa sipas një transmetimi tjetër, ka thënë: "Nxirrini çifutët dhe të krishterët nga gadishulli Arabik."[3] Gjithashtu ai ka thënë: "Nxirrini idhujtarët nga gadishulli Arabik!"[4] E gjithë kjo, me qëllim që njerëzit të mos ngatërrohen e që të mos përzihen miqtë e Allahut me armiqtë e Tij.

– *"Njerëzit, në përgjithësi, vëllazërohen për çështje të dynjasë, por*

[1] Autori ka për qëllim këtu vendet arabe.
[2] Muslimi.
[3] Telhis el Habiri.
[4] Buhariu.

kjo nuk u sjell atyre asnjë dobi." – Pra, lidhjet më të madhe ndërnjerëzore kanë në themel të tyre çështjet e dynjasë. Këtë, Ibn Abasi e ka thënë për kohën e vet, po për kohën e sotme ç'mund të thuhet? Njerëzit lidhen mes tyre, me shumë pak përjashtime, për çështjet e dynjasë. Gjithsesi, më e keqja është kur ata shesin fenë për dynjanë e tyre. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "O ju besimtarë! Mos e tradhtoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e mos i tradhtoni amanetet me vetëdije." (Enfal, 27). Meqenëse në shumicën e rasteve, ato që i çojnë njerëzit në tradhti dhe mashtrim janë pasuria dhe dashuria ndaj dynjasë, Allahu e pason këtë me ajetin tjetër: "Ta dini se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm provë dhe se vetëm tek Allahu është shpërblimi i madh." (Enfal, 28)

Nga fjala e Ibn Abasit (r.a.) mësohet se Allahu ka të afërt, gjë që është pohuar edhe me tekst kuranor: "Allahu është Mik i atyre që e besojnë ..." (Bekare, 257); "Miqtë dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm Allahu, Pejgamberi i Tij dhe besimtarët ..." (Maide, 55). Allahu ka të afërt që e zbatojnë urdhrin e Tij, e praktikojnë fenë e Tij, prandaj dhe Ai i ndihmon ata me udhëzim, ruajtje dhe sukses. Kriteri i kësaj miqësie e afërsie është fjala e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë, as frikë, e as do të pikëllohen; ata që besojnë dhe i frikësohen Allahut ..." (Junus, 62-63).

Shejhu i Islamit ka thënë: "Kush është besimtar dhe ka frikë Allahun, është mik i Tij."

Më përpara sqaruam se *uela*-je (miqësia) është ndihmë dhe mbështetje.

Uela-ja ndahet në: *uela* të Allahut për robin dhe *uela* të robit për Allahun. Për të parën argumenton fjala e Allahut: "Allahu është Mik i atyre që e besojnë ..." (Bekare, 257). Për të dytën, dëshmon fjala e Allahut: "Pa dyshim ata që marrin për mik e mbrojtës Allahun, të Dërguarin e Tij dhe besimtarët ..." (Maide, 56).

Ndërsa *uela*-ja e Allahut për robin ndahet në: të përgjithshme dhe të posaçme.

Uela e përgjithshme është kujdesi ndaj robërve në rregullimin dhe administrimin e çështjeve të tyre. Ky kujdes përfshin besimtarët, qafirët dhe të gjitha krijesat. Allahu është Ai që ka

marrë përsipër rregullimin, administrimin, sundimin e të tjera. Për këtë flet fjala e Tij: "Pastaj të gjithë do të kthehen tek Allahu, Kujdestari i tyre i vërtetë. Vetëm Atij i takon të gjykojë dhe Ai është më i Shpejti në llogari." (En'am, 63).

Uela e posaçme është përkujdesja, suksesi dhe udhëzimi që Allahu i bën robit të Tij. Kjo është e posaçme për besimtarët. Allahu thotë: "Allahu është Mik i atyre që e besojnë Atë; Ai i nxjerr nga errësira në dritë. Ndërsa për ata që nuk besojnë, miq janë shejtanët; këta i nxjerrin ata nga drita dhe i zhysin në errësirë ..." (Bekare, 257).

> Për ajetin: "... midis tyre do të këputet çdo lidhje (*sebeb*)." (Bekare, 166) Ibn Abasi ka thënë se flitet për dashurinë[1].

Në fakt, ajeti i plotë është: "Kur ata që janë pasuar do t'i braktisin pasuesit e tyre, kur të gjithë do të shohin dënimin e midis tyre do të këputet çdo lidhje (*sebeb*)." (Bekare, 166).

Në ajet përdoret fjala "*sebeb*". *Sebeb* quhet gjithçka që shërben për të arritur diçka. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Kushdo që mendon se Allahu s'do ta ndihmojë atë (Muhamedin) në këtë botë dhe në Botën Tjetër, le të zgjasë një litar (*sebeb*) në tavan e të varet ..." (Haxh, 15). Edhe litari është quajtur *sebeb*, sepse me anë të tij njeriu arrin të nxjerrë ujë nga pusi.

Transmetimin nga Ibn Abasi disa dijetarë e kanë quajtur të dobët, mirëpo kuptimi i tij është i saktë, pasi çdo gjë që mban idhujtarët lidhur me njëri-tjetrin do të shkëputet, dhe njëra prej tyre është dashuria dhe shenjtërimi i idhujve të tyre, e cila nuk do t'u bëjë dobi. Ndoshta Ibn Abasi (r.a.) e ka nxjerrë këtë shpjegim nga konteksti i ajetit. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Dhe ka njerëz, të cilët zgjedhin (për adhurim) të tjerë përveç Allahut si shokë (ortakë) të barabartë me Të. Ata i duan këta të adhuruar të tjerë si Allahun ..." (Bekare, 165). Pastaj thotë: "Kur ata që janë pasuar do t'i braktisin pasuesit e tyre, kur të gjithë do të shohin dënimin e midis tyre do të këputet çdo lidhje (*sebeb*)." (Bekare, 166).

Nga ky shtjellim, mësojmë se qëllimi i autorit ka qenë dashuria e

[1] Ibn Xheriri. Hakimi thotë se hadithi është i saktë.

politeizmit. Ndërkaq, dashuria e besimit, siç është dashuria e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) dhe dashuria për atë vepër e person që do Ai, është e dobishme dhe të çon drejt synimit. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Shokët, atë ditë, do të jenë armiq me njëri-tjetrin, përveç të përkushtuarve." (Zuhruf, 67).

Dobitë e temës

- Komenti i ajetit të sures Bekare.

"E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë (duke i konsideruar) si të barabartë me Allahun. Ata i duan idhujt siç duhet Allahu ...".

- Komenti i ajetit të sures Teube.

"Thuaju: 'Nëse baballarët tuaj, bijtë tuaj ...".

- Domosdoshmëria e dashurisë për Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) mbi veten, familjen dhe pasurinë.

Ndoshta më e saktë është të thuhet ashtu si në hadith: domosdoshmëria e dhënies përparësi dashurisë së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Ky mësim del nga hadithi që rrëfen Enesi, si dhe nga ajeti 24 i sures Teube.

- Mohimi i imanit te dikush, nuk tregon gjithmonë për daljen e tij nga Islami.

Më parë thamë se dashuria fitohet. Për këtë përmendëm hadithin e Omerit (r.a.), kur i tha Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Ti je më i dashur për mua se çdo gjë, përveç vetes time. Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i tha: "Jo, për Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, imani yt nuk do të përsoset, derisa të jem për ty më i

dashur se vetja jote." Omeri tha: "Tani, për Zotin, ti je më i dashur për mua se vetja ime." Fjala "tani", tregon se kjo dashuri ndodhi rishtas, kjo është diçka e qartë..

Mohimi i imanit të përmendur në fjalën e Pejgamberit (s.a.u.s): "Askush nga ju nuk beson, derisa të jem unë më i dashur për ju ….", nuk tregon për daljen e tij nga Islami, ashtu siç thuhet më qartë në hadithin tjetër: "Nëse një person ka tri cilësi, ka për të provuar ëmbëlsinë e imanit …". Ëmbëlsia e besimit është shtesë, mbi thelbin e besimit.

Mohimi i diçkaje, në të shprehur, ka tri raste. Parimisht ai është mohim i egzistencës, si për shembull, kur thua se idhujtarët nuk kanë iman. Mirëpo nëse ka ndonjë pengesë që pengon mohimin e egzistencës, atëherë kemi të bëjmë me mohim të saktësisë; për shembull, kur thuhet: "Nuk ka namaz pa avdes". Nëse ka ndonjë pengesë që e pengon mohimin e saktësisë, atëherë kemi të bëjmë me mohim të përsosmërisë; për shembull: "Nuk ka namaz në praninë e ushqimit." Ndërsa qëllimi i mohimit në thënien e Profetit: "Askush nga ju nuk beson, derisa të jem unë më i dashur për ju …" është për mohimin e plotësimit të detyrueshëm e jo të atij të pëlqyeshëm[1]. Shejhu i islamit Ibn Tejmije thotë: "Nuk mohohet diçka vetëm nëse në të mungon diçka e detyrueshme dhe që nuk e pengon nga kjo ndonjë ndalesë".

> - Imani ka ëmbëlsi, siç thotë hadithi, por njeriu mund ta shijojë ose jo atë, në varësi të plotësimit të kushteve.

Kjo del nga thënia e Profetit ('alejhis–selam): "Nëse një person ka tri cilësi, ka gjetur ëmbëlsinë e imanit..." Ky hadith është argument se mos egzistenca e embëlsisë së imanit tregon për mos egzistencën e këtyre gjërave.

> - Janë katër akte të zemrës pa të cilat nuk arrihet miqësia e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) dhe askush nuk e provon shijen e imanit pa to.

[1] Pra, nuk e ka të plotë besimin që është detyrë, por, ka origjinën e tij.

Ato janë: dashuria dhe urrejtja për hir të Allahut; miqësia dhe armiqësia për hir të Tij. Vetëm përmes tyre arrihet ndihma e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Nëse një person falet e agjëron dhe, nga ana tjetër, miqëson armiqtë e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), nuk ka për ta arritur miqësinë e Tij (Subhanehu ue Te'Ala). Ibn Kajimi thotë: "Të duash armiqtë e të dashurit tënd dhe pretendosh pastaj dashurinë e tij: kjo është e pamundur." Këtë edhe fëmijët nuk e pranojnë. Shprehja: "... nuk e provon shijen e imanit", është marrë nga Ibn Abasi.

- Kuptimi i sahabit për aktualitetin, se: njerëzit, në përgjithësi, vëllazërohen për çështje të dynjasë.

Këtu flitet për sahabin Ibn Abas (r.a.) që ka thënë: "Njerëzit, në përgjithësi, vëllazërohen për çështje të dynjasë, por kjo nuk u sjell atyre asnjë dobi"

- Komenti i ajetit: "... e midis tyre do të këputet çdo lidhje".

Fjala lidhje është komentuar si dashuri. Nëse ajeti është gjithëpërfshirës, interpretimi i një sahabi merret si dhënie e një shembulli. Tek ajeti në fjalë, kemi të bëjmë me dhënien e një shembulli, ku fjala "*sebeb*" shpjegohet edhe si "dashuri". Kjo tregon, gjithashtu, se në ahiret do të zhvlerësohet çdo lloj "*sebeb*-i", çdo lloj rruge që idhujtarët ndjekin për t'u afruar tek Allahu (Subhanehu ue Te'Ala).

- Ka idhujtarë që e duan shumë Allahun.

Siç del nga ajeti: "E megjithatë, disa njerëz zgjedhin në vend të Allahut (zota) të tjerë (duke i konsideruar) si të barabartë me Allahun dhe duke i dashur ata siç duhet Allahu, por ata që besojnë, e duan Allahun më shumë ...." (Bekare, 165). Por ata duan shumë edhe idhujt e tyre. Krahasimi i përdorur tregon se dy anët e tij kanë një element të përbashkët: dashurinë për Allahun, e cila është më e

madhe tek njëra anë, tek besimtarët.

> ➢ Paralajmërimi ndaj atyre që kanë tetë gjëra më të dashura sesa feja.

Këto tetë gjëra renditen në ajetin: "Thuaju: 'Nëse baballarët tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkoj mirë dhe vendbanimet ku e ndieni veten rehat ..." (Teube, 24). Kërcënimi vjen më pas: "... atëherë pritni ...". Autori (Allahu e mëshiroftë!) ka deklaruar se ky urdhër është për kërcënim.

> ➢ Nëse dashuria për dikë ose diçka barazohet me dashurinë për Zotin, ky është shirk i madh[1].

[1] Dashuria për diçka tjetër veç Allahut është dy llojesh. Njëri lloj është *shirk*, dhe ajo është dashuria e idhujtarëve për idhujt e tyre. Idhujtarët i duan zotat e tyre krahas Allahut, ashtu siç duan Allahun. Kjo është dashuri adhurimi. Dashuria e adhurimit përmban përulje dhe madhërim, por shoqërohet edhe me frikë, shpresë dhe lutje nga adhuruesi për hyjnitë.
Lloji i dytë është dashuria e natyrshme, e cila nuk e çrrënjos teuhidin dhe nuk të nxjerr nga feja, por në ndonjë rast mund të bëjë që muslimani të mos ketë sinqeritet dhe dashuri të plotë ndaj Allahut. E tillë është dashuria për gratë, për fëmijët, për arin dhe argjendin, për pasurinë etj. Njeriu mund të tërhiqet pas gjërave të tilla, ashtu si i urituri pas ushqimit dhe i eturi pas ujit. Njerëzit në raport me këtë dashuri ndahen në tri kategori:
- Kategoria e parë janë ata që i duan për hir të Allahut, duke i përdorur pra si mjete për të arritur tek Allahu. Kështu, nëse njeriu i do këto gjëra, që t'i shfrytëzojë si rrugë për të arritur tek Allahu dhe si mundësi për t'i bërë ibadet Atij e për të bërë atë që pëlqen Ai, shpërblehet për to. E tillë ka qenë dashuria e njeriut më të përsosur për gratë dhe erën e mirë, siç shprehet vetë në një hadith të vërtetë. Pasioni për këto dy gjëra e ndihmonte Pejgamberin për të dashur më fort Allahun dhe për të përçuar sa më mirë mesazhin e Tij te njerëzit.
- Kategoria e dytë janë ata që pasionohen pas këtyre gjërave thjesht nga prirjet e natyrshme dhe dëshira vetjake, por gjithsesi ata nuk i parapëlqejnë ato kundrejt asaj që pëlqen Allahu. Në këtë rast, pasionimi pas këtyre gjërave nuk quhet gjynah dhe njeriu nuk dënohet për to, sepse ato konsiderohen të lejueshme. Megjithatë, pasionimi pas tyre bëhet pengesë për përsosjen e dashurisë ndaj Allahut.
- Kategoria e tretë janë ata që pasionohen aq shumë pas këtyre gjërave, sa që i shndërrojnë ato në qëllimin e jetës. Ata u japin përparësi atyre kundrejt asaj që pëlqen Allahu. Në këtë rast, njeriu konsiderohet gjynahqarë dhe pasues i epshit. [Marrë nga libri i Ibn Kajjimit *"Shpirti"*].

Kjo del prej thënies së Allahut: "... Ata i duan idhujt siç duhet Allahu ...". në kontekstin e ajeteve më pas ka sqaruar se ata janë idhujtarë që kanë rënë në shirk të madh, gjë që dëshmohet edhe nga ndëshkimi i paralajmëruar.

Tema 32

> **Thënia e Allahut: “Kjo është prej shejtanit, që ju frikëson me ndihmësit e vet. Ju mos kini frikë prej atyre, por frikësohuni vetëm prej Meje, nëse jeni besimtarë.” (Ali Imran, 175)**

Menjëherë pas temës së dashurisë, autori sjell temën e frikës, pasi adhurimi përqendrohet në dashuri dhe frikë. Prej dashurisë bëhet e mundur zbatimi i urdhëresave, kurse prej frikës bëhet i mundur largimi nga haramet. Është e vërtetë që, kush largohet nga gjynahet kërkon të arrijë kënaqësinë e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), por ky është rezultati i largimit nga mëkati, dhe jo shkaku. Nëse e pyet atë që i largohet imoralitetit, pse e bën këtë, do të thotë se e bën për shkak të frikës nga Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala). Nga ana tjetër, nëse pyet dikë, përse fal namaz, do të thotë se e bën për shkak të dëshirës për shpërblimin e Allahut dhe dashurisë që ka për Të. Çdonjëra prej tyre e bën të domosdoshme tjetrën. I frikësuari dhe i binduri synojnë shpëtimin nga ndëshkimi i Allahut dhe arritjen e mëshirës së Tij.

Po a është më mirë për njeriun që të anojë më shumë nga frika apo nga shpresa? Për këtë ka mendime të ndryshme.

Kështu, është thënë se njeriu duhet të anojë nga frika, me qëllim që kjo ta shtyjë larg mëkateve dhe pastaj ta nxisë drejt adhurimeve. Të tjerë thonë se duhet të anojë nga shpresa, me qëllim që të jetë optimist, pasi edhe Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i pëlqente optimizmi.

Është thënë gjithashtu, se, kur flitet për adhurim, njeriu duhet të

ketë më shumë shpresë, sepse atij të cilit Allahu i ka dhënë sukses në kryerjen e adhurimeve, do t'i japë sukses edhe në pranimin e atyre veprave nga ana e Tij. Disa selefë kanë thënë se, nëse Allahu të jep sukses për ta bërë lutjen, atëherë prit përgjigjen, sepse Allahu thotë: "Zoti juaj ka thënë: 'Lutmuni Mua, se Unë do t'ju përgjigjem ..." (Gafir, 60). Nga ana tjetër, kur flitet për mëkate, njeriu duhet të ketë më tepër frikë, në mënyrë që t'u largohet atyre dhe sepse, nëse frikësohet nga ndëshkimi, ai do të pendohet.

Ky qëndrim i fundit është më afër të saktës, por nuk është tërësisht i saktë, sepse Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "... kur japin atë që japin, zemrat e tyre janë të frikësuara, ngaqë janë të sigurt në kthimin te Zoti i tyre." (Mu'minun, 60). Kuptimi është që ata druhen se vepra e mirë e tyre nuk do të pranohet prej Zotit, por thuhet se, ndoshta, kjo kundërshtohet nga hadithe të tjera, si hadithi *kudsij*: "Unë jam te mendimi i robit Tim për Mua, Unë jam me të kur ai më përmend Mua ...".[1]

Po kështu, është thënë se, kur është i sëmurë, njeriu duhet të anojë nga shpresa, ndërsa kur është shëndoshë, duhet të anojë nga droja.

Ndërsa imam Ahmedi ka thënë se duhet që frika dhe shpresa të jenë të barabarta: nëse njëra është më e madhe, ajo e shkatërron njeriun. Ato duhet të jetë si dy krahët e një shpendi, të cilët kur nuk janë të barabartë, e rrëzojnë atë.

Frika ndaj Allahut është e ndryshme në njerëz të ndryshëm. Disa njerëz kanë frikë të tepruar, disa të tjerë nuk kanë fare dhe disa kanë frikë mesatare. Frikë mesatare është vetëm ajo që të përmban nga të ndaluarat e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Nëse është më e madhe, ajo të çon në humbjen e shpresës nga mëshira e Allahut. Ka njerëz që iu zbehet frika, aq sa nuk i pengon nga haramet.[2]

---

[1] Buhariu.

[2] Frika është nga gradat më të vlefshmet të fesë dhe më të lartat e saj. Prandaj dhe dijetari –Allahu e mëshiroftë – ka thënë se është detyrë që ajo të jetë vetëm për Allahun e Lartësuar. Allahu i Lartësuar në Librin e Tij e ka përmendur atë si cilësi të krijesave më të zgjedhura dhe më të afërta të Tij, melekët, të Dërguarit dhe të mirët. Allahu i Madhëruar ka thënë: "I frikësohen dhe i përulen Zotit të tyre lart mbi ta ..." (Nahl, 50); "... e ata nga frika prej Tij janë të kujdesshëm." (Enbija, 28); "Vërtet, ata të cilët ndaj madhërisë së Zotit të tyre kanë frikë." (Mu'minun, 57); "(Vepër e

Frika është dy llojesh:

1- Frika e adhurimit dhe nënshtrimit.

Kjo quhet ndryshe edhe frikë nga e fshehta. Njeriu duhet ta ketë këtë ndjenjë frike vetëm nga Allahu i Lartësuar. Ai që e ka këtë lloj frike nga dikush ose diçka tjetër veç Allahut, ka bërë shirk të madh, si për shembull, ata që frikësohen nga idhujt apo të vdekurit apo nga ata që i pretendojnë si *eulija* (të ashtuquajtur njerëz të mirë). Besojnë se ata mund të bëjnë ndonjë të keqe ose mund të sjellin ndonjë të mirë, siç veprojnë adhuruesit e varreve; ata kanë frikë nga ai që është në varr i vdekur më shumë sesa nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala).

2- Frika e natyrshme.

Kjo lloj frike lejohet, sipas ajetit kuranor: "Kështu që ai iku prej andej, duke u endur i frikësuar ..." (Kasas, 21). Ose ajeti që flet për Musën (alejhi selam): "Ai tha: 'O Zoti im! Unë kam vrarë njërin prej tyre dhe kam frikë se do të më vrasin ...'" (Kasas, 33). Mirëpo nëse kjo frikë të çon në lënien e detyrimeve ose në haram, ajo është e ndaluar, dhe nëse të shtyn tek e lejuara, ajo është e lejuar.

Kështu, nëse dikush ka frikë diçka që, në realitet, nuk e cenon, dhe kjo frikë e çon në lënien e namazit me xhemat, edhe pse ai është detyrim, atëherë ajo është haram. Njeriu e ka detyrë që të mos ndikohet prej saj. Nëse dikush e kërcënon të bëjë një haram, ndërkohë që kërcënimi është i parealizueshëm, frika është e ndaluar, sepse të çon në veprimin e haramit, pa arsye. Nëse largohesh prej një zjarri për të shpëtuar, frika është e lejuar, madje mund të jetë detyrim, kur me anë të saj arrin të shpëtosh.

Ka edhe një lloj tjetër frike, që lidhet me vegimet ose imagjinatën, domethënë që nuk është frikë e vërtetë. Për shembull, sheh hijen e një peme që lëviz, dhe mendon se është një armik. Kjo nuk duhet të ekzistojë për besimtarin. Ai duhet t'i largojë këto mendime të pavërteta, përndryshe do ta shkatërrojnë.

Lidhja e frikës me teuhidin qëndron në faktin se disa lloje të

---

atyre) Që përçojnë Mesazhin e Allahut, i frikësohen Atij dhe nuk i frikësohen askuj tjetër veç Allahut." (Ahzab, 39). Gjithashtu, ka urdhëruar që ajo të jetë vetëm për Të (Subhanehu ue Te'Ala): "... dhe vetëm Mua m'u frikësoni." (Bekareh, 40); "Kësisoj, mos kini frikë nga njerëzit, por m'u frikësoni Mua." (Maide, 44); "A do të keni frikë tjetërkënd përveç Allahut ..." (Nahl, 52). (Marrë nga "Tejsir el Aziz el Hamid")

frikës përbëjnë shirk, i cili është në kundërshtim me teuhidin.

Në këtë temë, autori (Allahu e mëshiroftë!) ka sjellë tri ajete:

Ajeti i parë është ajeti i përdorur si titull teme: "Kjo është prej shejtanit, që ju frikëson me ndihmësit (*eulija*) e vet. Ju mos kini frikë prej atyre, por frikësohuni vetëm prej Meje, nëse jeni besimtarë".

Pra, kjo frikë është prej shejtanit. Ai ju frikëson, ju fut frikë në zemra, me ndihmën e tyre.

– *"... ndihmësit e vet ..."* – Domethënë ata të cilët ndihmojnë për veprat e ulëta, të shëmtuara e të urryera. Shejtani urdhëron për këto gjëra, dhe çdonjëri që ndihmon për vepra të shëmtuara është ndihmës i tij. Nëse ndihma është për idhujtari dhe për vepra që kundërshtojnë teuhidin, atëherë ajo është e rëndë, por ajo mund të jetë edhe nën këtë.

– *"... ju frikëson me ndihmësit e vet ..."* – Flitet për frikën që përshkruhet në një ajet më sipër: "Vërtet populli (idhujtar) është bashkuar kundër jush, kështu që frikësojuni atyre ..." (Ali Imran, 173). Kjo u bë për t'i penguar besimtarët nga një detyrë e fesë. Kjo mund të ndodhë me njerëzit në përgjithësi, të cilët duan të urdhërojnë për një punë të mirë dhe të ndalojnë nga një e keqe, por që shejtani i frikëson, për t'i penguar. Si përfundim, themi se shejtani frikëson çdonjë që dëshiron të zbatojë një detyrim fetar. Nëse ai të frikëson, duhet të dish se guximi për thënien e fjalës së drejtë nuk të afron vdekjen. Zoti ta ka caktuar vdekjen, dhe as heshtja, as frika nuk mund ta largojnë atë. Sa e sa thirrës në të Vërtetën vdiqën në shtratin e tyre dhe sa e sa frikacakë janë vrarë?! Halid Ibn Uelidi, për shembull, ishte trim i madh dhe i guximshëm, por vdiq në shtratin e tij. Njeriu, përderisa është duke kryer urdhrin e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), le të ketë besim se Allahu është me ata të cilët i frikësohen Atij dhe që janë bamirës. Pala me Allahun është ngadhënjimtare.

– *"... Ju mos kini frikë prej atyre ..."* – Kjo është ndalesë dhe nuk ka dyshim se kush bën të kundërtën ka bërë haram. Shprehja thotë: vazhdoni të zbatoni urdhrin dhe detyrimin tuaj dhe mos i kini

frikë ata. Kur Allahu është me dikë, askush nuk mund ta mposhtë atë njeri. Ne kemi nevojë për nijet të pastër, sinqeritet dhe mbështetje të plotë tek Allahu.

Nga ky ajet mësohet se shejtani fut vesvese në zemrën e njeriut, siç është edhe frika nga armiqtë e tij. Shumë njerëz vuajnë nga kjo sot, duke u bërë viktima të tyre. Nëse ata i mbështeten Allahut dhe i frikësohen Atij, para gjithçkaje tjetër, atëherë të tjerët do të kenë frikë prej tyre. Prandaj thuhet: Kur dikush ka frikë Allahun, nga ai ka frikë çdo gjë. Kur dikush ka frikë dikë tjetër veç Allahut, ai ka frikë nga çdo gjë.

Nga ajeti, kuptohet se frika nga shejtani dhe ndihmësit e tij e mohon besimin. Nëse frika të çon në shirk, ajo e mohon krejtësisht imanin, e nëse jo, atëherë mohon plotësinë e tij.

> Ajeti i dytë: "Xhamitë e Allahut i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë të udhëzuar." (Teube, 18)

– *"Xhamitë e Allahut i mirëmbajnë …"* – Këtu flitet, së pari, për mirëmbajtjen e tyre nga ana e shfrytëzimit, duke falur namaz, duke bërë dhikër, duke lexuar Kuran etj. Ajo është gjithashtu edhe mirëmbajtje fizike e ndërtesave të tyre.

Mirëmbajtja e xhamive duhet të bëhet vetëm nga ata që ka përshkruar Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), sepse ai që i mirëmban ato ndërkohë nuk beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit, nuk i ka mirëmbajtur në realitet, për shkak të mos përfitimit nga kjo mirëmbajtje. Mirëmbajtja e vlefshme, materiale dhe shpirtërore, bëhet nga ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Gjykimit. Për këtë arsye, kur idhujtarët u mburrën për mirëmbajtjen e xhamisë së Qabes, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) tha: "Xhamitë e Allahut i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë të udhëzuar." (Teube, 18). Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) ja ka atribuuar xhamitë Vetes së Tij si nderim për to, sepse ato janë vende adhurimi.

– *"... ata që besojnë Allahun ..."* – Besimi tek Allahu përbëhet nga katër elementë:

a) Besimin në ekzistencën e Tij.
b) Besimin në veprat e Tij.
c) Besimi se Ai meriton të adhurohet.
d) Besimin në emrat dhe cilësitë e Tij.

– *"... dhe Ditën e Fundit ..."* − Dita e Fundit është Dita e Kijametit. Është quajtur e tillë, sepse nuk ka ditë tjetër pas saj. Për të, shejhu i Islamit Ibn Tejmije, ka thënë: "Besimi në Ditën e Fundit përfshin gjithçka për të cilën ka lajmëruar Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) se do të ndodhë pas vdekjes, si sprova e varrit, ndëshkimi dhe shpërblimi në të, sepse kur njeriu vdes, për të është bërë Kijameti, dhe ai ka kaluar në vendin e shpërblimit."

Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e ka vënë në shumë raste besimin tek Ai pranë me besimin në Ditën e Fundit, sepse besimi në Ditën e Fundit e shtyn njeriun në bindje. Nëse beson se ka ringjallje dhe llogari, kjo e shtyn atë të punojë për atë ditë. Ndërsa ai që nuk beson në Ditën e Fundit, nuk punon për të; e si të punojë për diçka që nuk e beson?!

– *"... që falin namazin ..."* – Pra, që e falin atë rregullisht, pa mangësi. Kjo vepër përmban:

a) Veprimi i farzeve, që do të thotë të veprosh detyrimet e tij: kushtet, shtyllat dhe vaxhibet.

b) Veprimi i suneteve, që do të thotë të bësh edhe veprimet e pëlqyeshme.

– *"... dhe japin zekatin ..."* − Zekati quhet pasuria që Allahu e ka bërë detyrim të jepet një herë në vit. Sasia e tij ndryshon sipas rregullave që ka përcaktuar urtësia e Tij.

– *"... e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut ..."* – Ky përkufizim përmban mohim dhe pohim. Shprehja "që nuk i frikësohen" përmban mohim, ndërsa "përveç Allahut" ka pohim. Me fjalë të tjera, frika e kësaj kategorie njerëzish është e kufizuar vetëm ndaj Allahut dhe askujt tjetër veç Tij nuk i frikësohen.

El hashjetu (në arabisht) është një lloj frike, ashtu si *hauf*-i, por e para dallon nga e dyta sepse:

a) *El hashjetu* është frikë që buron nga njohja reale e atij që i frikësohesh, siç thotë Allahu: "Vërtet ata që i frikësohen më shumë Allahut nga robërit e Tij, janë dijetarët...", ndërsa *"hauf"* mund të ketë edhe një i paditur.

b) *El hashjetu* lind për shkak të madhështisë së atij që i frikësohesh, ndryshe nga *hauf*, i cili vjen si pasojë e dobësisë së atij që frikësohet dhe jo nga fuqia e atij që të frikëson.

– *"... Sigurisht që këta janë të udhëzuar."* – Në ajet është përmendur fjala "*asaa*" (ndoshta), por Ibn Abasi ka thënë se "ndoshta" e Allahut është e sigurt. Përdoret ashtu, me qëllim që njeriun të mos mashtrohet se e ka arritur këtë cilësi, siç thuhet në ajetin tjetër: "Me përjashtim të burrave të pafuqishëm, grave dhe fëmijëve, të cilët nuk kanë as fuqinë e as mundësinë të drejtohen në rrugë (për shpërngulje). Për këta ka shpresë se Allahu do t'i falë, se Allahu është Shlyes dhe Falës i gjynaheve." (Nisa, 98-99). Allahu nuk e detyron asnjë përtej mundësive të tij. Ata të cilët nuk mund ta gjejnë një rrugëdalje dhe ata që nuk kanë mundësi të shpërngulen, meritojnë faljen.

Pjesa e ajetit që dëshmon për çështjen në fjalë është: "... e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut ...". Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Prandaj, mos kini frikë nga njerëzit, por kini frikë vetëm prej Meje ..." (Maide, 44).

Nga shenjat e besimit të vërtetë është që të mos i frikësohesh askujt veç Allahut, në gjithçka që thua dhe vepron. Kushdo që dëshiron të jetë i garantuar, le të meditojë rreth thënies së Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Dije se, sikur një popull të mblidhen për të të bërë dobi, nuk do të të bëjnë dobi më tepër se ajo që ka shkruar Allahu për ty, dhe sikur të mblidhen për të të dëmtuar, nuk mund të të dëmtojnë më tepër se ajo që e ka shkruar Allahu për ty ...."[1]

Ajeti i tretë: "Ka njerëz që thonë: 'Ne besojmë Allahun', por

[1] Ahmedi, Tirmidhiu. Grada e hadithit është përmendur më parë.

> kur vuajnë për çështjen e Allahut, e trajtojnë provën e njerëzve njësoj si dënimin e Allahut. ...” (Ankebutë, 10)

– *“Ka njerëz që thonë ...”* − Janë ata që nuk u ka arritur imani në thellësinë e zemrës së tyre. Të tillët thonë se e besojnë Allahun, por imani i tyre është sipërfaqësor, siç thuhet në ajetin tjetër: “Ka njerëz që e adhurojnë Allahun me mëdyshje. Nëse u ecën mbarë, janë të kënaqur, por nëse u bie fatkeqësi, ata kthehen në mohim.” (Haxh. 11). Këtu, “me mëdyshje” do të thotë që, nëse Allahu i provon me mundime nga armiqtë, për shkak të besimit të tij tek Allahu, mundimin e njerëzve e shohin si ndëshkimin e Allahut.

– *“... kur vuajnë për çështjen e Allahut ...”* – Pra, kur vuajnë për shkak të besimit në Allah dhe praktikimit të fesë së Tij, ose kur mundohen në këtë fe.

– *“... e trajtojnë provën e njerëzve ...”* – Fjala “provë” ka kuptimin “mundim, vuajtje”. Njeriu provohet dhe pengohet në rrugën e Allahut, siç thotë Ai: “Vërtet ata të cilët i vënë në provë besimtarët dhe besimtaret, dhe pastaj nuk pendohen ...”.

– *“... njësoj si dënimin e Allahut ...”* – Dihet se njeriu i largohet ndëshkimit të Allahut nëse i bindet urdhrave të Tij. Ndërsa këta njerëz, që përshkruhen në ajet, provën e barazojnë me ndëshkimin e Allahut dhe u largohen mundimeve, duke u pajtuar me dëshirat dhe urdhrat e tyre. Ata e shohin këtë mundim si ndëshkimin nga Zoti. Në këtë rast, ata frikësohen nga njerëzit ashtu siç frikësohen ndaj Allahut, sepse e konsiderojnë mundimin e shkaktuar nga ata njerëz njëlloj si ndëshkimin e Allahut. Ata shmangen prej Tij, duke ndjekur urdhrat e atyre.

Nga ajeti del një urtësi e madhe: Allahu e provon njeriun, me qëllim që të pastrojë besimin e tij. Provimi bëhet në dy mënyra:

1. Drejtpërdrejt prej Allahut, siç thuhet në ajetet: “Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të lashtave! Prandaj përgëzoji të duruarit. Të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: ‘Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!’” (Bekare, 155-156).

2. Nëpërmjet krijesave, sipas përcaktimit të Allahut, si rastin e ajetit që po komentohet.

Disa njerëz, kur u bien fatkeqësitë, nuk durojnë, por mohojnë apo ndoshta lënë edhe fenë, − Allahu na mbroftë! Ndoshta mohojnë për shkak të kundërshtimit që i bëjnë urdhrit të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), ose edhe u pakësohet imani. Muslimani duhet të jetë i kujdesshëm. Allahu është i Urtë. Ai i provon robërit e Tij që të dallohet imani i vërtetë. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Ne do t'ju provojmë, derisa t'i njohim ata midis jush, që luftojnë dhe durojnë, po edhe veprat tuaja do t'i provojmë." (Muhamed, 31).

Ajeti 10 në suren Ankebutë vazhdon: "Kur t'u vijë fitorja prej Zotit tënd, ata, me siguri, kanë për të thënë: 'Ne ishim me ju'. Vallë, a nuk e di Allahu më së miri se ç'ka në zemër të gjithçkaje?"

Ata pretendonin se mundimet e tyre, vinin për shkak të besimit, por nëse fitonin muslimanët, thonin: "Ne ishim me ju, prandaj duam edhe ne pjesë nga plaçka e luftës."

"... Vallë, a nuk e di Allahu më së miri se ç'ka në zemër të gjithçkaje?" − Allahu e di më mirë ç'ka bart në veten tënde sesa ti vetë, dhe e di shumë mirë se çfarë fshihet në zemrat e të tjerëve, pasi dija e Allahut është absolute.

Fjala "gjithçkaje", në ajet, tregon gjithçka tjetër që ekziston veç Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Ato janë shenja që dëshmojnë për Krijuesin e tyre. Çdo krijesë dëshmon për përsosmërinë e Allahut, fuqinë dhe veprat e Tij. Përfundimisht, Allahu të njeh ty më mirë sesa njeh ti veten tënde, ashtu siç njeh dhe të tjerët.

Në ajet paralajmërohet njeriu që thotë të kundërtën e asaj që ka në zemër. Prandaj, kur Kab Ibn Maliku nuk shkoi në Betejën e Tebukut, i tha këto fjalë Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Vërtet, unë jam aq i gojës, saqë nëse do të dilja para ndonjë mbreti, veç teje, do të dija të justifikohesha, por unë nuk dua që ti të më justifikosh e më pas të më demaskojë Allahu."[1]

Pjesa e ajetit që lidhet me çështjen në fjalë, është: "... por kur vuajnë për çështjen e Allahut, e trajtojnë provën e njerëzve njësoj si dënimin e Allahut...", pra u frikësohen njerëzve njëlloj si Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

[1] Buhariu.

> Ebu Seidi përcjell se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Të kënaqësh njerëzit duke zemëruar Allahun, tregon bindje të dobët. Bindje të dobët tregon edhe t’i falënderosh ata për të mirat që të jep Allahu dhe t’i shash ata për atë që nuk të ka dhënë Allahu, sepse të mirat e Allahut nuk mund t’i sjellë dëshira e fortë e dikujt, e as nuk mund t’i kthejë mbrapsht urrejtja e dikujt.”[1]

– *“Të kënaqësh njerëzit duke zemëruar Allahun, tregon bindje të dobët …”* – Kjo do të thotë të këmbesh kënaqësinë e njerëzve me zemërimin e Allahut. Ky ndërrim tregon siguri të dobët. Siguria është grada më e lartë e besimit. Ndoshta ajo tregon diturinë, sepse kur e kemi mësuar diçka mirë, largohet çdo lloj dyshimi. Të kënaqësh njerëzit duke zemëruar Allahun, tregon bindje të dobët, sepse kështu u frikësohesh njerëzve më shumë sesa Allahut.

Kjo është sprova e sotme e umeti islam: shumë lavdërojnë dikë për cilësitë – që ndoshta në mjaft raste ai nuk i ka – dhe nuk i tregojnë për të metat që ai ka. Kjo është shenjë hipokrizie dhe jo këshillë e dashuri. Këshilla është kur ia tregon dikujt të metat, me qëllim që ai t’i shmangë ato. Gjithashtu, nuk ka asgjë të keqe nëse i përmend atij edhe të mirat, për t’i dhënë kurajë, nëse sigurohesh se nuk i rritet mendja.

– *“… t’i falënderosh ata për të mirat që të jep Allahu …”* – Falënderim do të thotë t’i shprehësh dikujt mirënjohjen për një mirësi që të ka bërë. Falënderimi shoqërohet shpesh me dashuri e respekt. Fjalia do të thotë: të falënderosh ata që të japin diçka, duke harruar Atë që i bëri ata shkak: Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala). Ai që të jep diçka, është vetëm shkak, ndërsa dhënësi i vërtetë është Allahu. Për këtë arsye, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Unë vetëm ndaj; është Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) që jep.”[2]

---

[1] Tasmeton Ebu Nueim në “Hilje”, Bejhakiu. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

[2] Buhariu.

Nëse e di me zemër se është Allahu Ai që t'i fal mirësitë, pastaj falënderon personin që të jep, kjo është e ligjëruar, siç thotë Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Atij që bën ndonjë të mirë ndaj jush, shpërblejani, e nëse nuk gjeni me se t'ia shpërbleni, lutuni për të, derisa të mendoni se ia keni shpërblyer."[1] Kësisoj, hadithi nuk duhet të merret sipas kuptimit të drejtpërdrejtë në të gjitha aspektet, pasi ai flet për falënderimin absolut të tyre, duke harruar Krijuesin e shkakut i Cili është Allahu i Lartësuar.

Kjo është bindje e dobët, sepse duket sikur harron Mirëbërësin kryesor, Allahun (Subhanehu ue Te'Ala). Ajo është edhe mendjelehtësi, pasi personi që të jep diçka, nuk e ka krijuar vetë atë, por është Allahu Ai që e ka krijuar. Po kështu, është Allahu që ia zbut zemrën njeriut që ai të të japë ty. Për shembull, dikush i jep të birit ca para, për t'ia dërguar dikujt tjetër. Ai tjetri, nëse do t'i shprehte mirënjohje vetëm fëmijës, do të konsiderohej si mendjelehtësi, sepse fëmija është vetëm korrier.

Përfundimisht, kur falënderon njerëzit dhe harron Allahun, tregon dobësi të imanit, por nëse i falënderon ata, duke i konsideruar thjesht si shkak, sepse falënderimin e vërtetë ia njeh Allahut, kjo është e drejtë dhe nuk tregon për bindje të dobët.

– *"... t'i shash ata për atë që nuk të ka dhënë Allahu ..."* – Kjo është e kundërta e së parës. Nëse një njeri shpërndan para, por ty nuk të jep, dhe për këtë ti e shan dhe e ofendon, atëherë ke gabuar, sepse ç'ka dëshiron Allahu bëhet, e ç'ka nuk e dëshiron Ai, nuk bëhet. Megjithatë, ai që nuk të jep atë që e ka detyrim për ta dhënë, qortohet për këtë arsye, por jo për shkak se nuk të dha ty. Pra, ai nuk shahet në aspektin e përcaktimit të Zotit, sepse nëse Allahu do ta kishte përcaktuar atë, do të dilnin shkaqet e realizimit të saj.[2]

---

[1] Ahmedi dhe Buhariu në "Edebul mufred". Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

[2] Pra, kur ti u kërkon diçka, ndërsa ata nuk ta japin, i shan për këtë. Nëse ti do ta dije me siguri se në dhënie dhe në mosdhënie, Allahu është i vetëm dhe se krijesa është nën pushtetin e Allahut (ajo nuk sundon për veten e saj as dëm as dobi, jo më për të tjerat; sikur Allahu të kishte përcaktuar rrizk për ty, ai do të të vijë ty, edhe sikur të përpiqen krijesat për shmangien e tij, e nëse dëshiron për ty mos ardhjen e tij, nuk do të të vijë ajo që dëshiron ti, edhe sikur të grumbullohen të gjitha krijesat për

– *"... të mirat e Allahut nuk mund t'i sjellë dëshira e fortë e dikujt, e as nuk mund t'i kthejë mbrapsht urrejtja e dikujt."* – Dëshira për arritjen e të mirave pa dyshim është shkak. Kur dikush kërkon rrizkun duke vepruar shkaqet, ai atëherë ka vepruar shkaqet që sjellin rrizkun, por kjo nuk do të thotë që ky shkak i sjell të mirat në mënyrë të pamvarur. Në të vërtetë Ai që sjell furnizimin është Allahu i Lartësuasërish. Sa e sa njerëz bëjnë shkaqe të shumta për arritjen e të mirave, por ato përsëri nuk u jepen? Sa e sa të tjerëve bëjnë pak shkaqe, mirëpo furnizohen. Sa e sa të tjerëve iu vijnë të mirat pa u përpjekur fare, për shembull kur gjejnë ndonjë thesar, ose kur i vdes ndonjë një i afërt pasanik të cilin e trashëgon, e të tjera si këto?

– *"... e as nuk mund t'i kthejë mbrapsht urrejtja e dikujt ..."* – Kjo do të thotë se të mirat e përcaktuara nga Allahu për njeriun nuk i pengon urrejtja e ndonjërit për të. Shumë njerëz, që kanë zili të tjerët, përpiqen t'u pengojnë atyre të mirat e Allahut, por nuk ia dalin dot.

> Aishja tregon se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Kush kërkon kënaqësinë e Allahut në hidhërimin e njerëzve, Allahu kënaqet prej tij dhe i bën edhe njerëzit të kënaqen prej tij, ndërsa kur dikush kërkon kënaqësinë e njerëzve në hidhërimin e Allahut, Allahu hidhërohet prej tij dhe i bën dhe njerëzit të hidhërohen prej tij." [1]

---

mbërritjen e tij tek ti) kishe për t'i shkëputur lidhjet nga krijesat e do të ishe drejtuar me zemrën tënde te Krijuesi i Lartësuar. Kjo është vërtetuar në thënien në hadith: "... të mirat e Allahut nuk mund ta sjellë dëshira e fortë e ndonjërit, e as nuk mund ta kthejë mbrapsht urrejtja e dikujt." Prandaj, mos i kënaq krijesat në atë që zemëron Krijuesin, as mos i falëndero ata për rrizkun e Allahut, as mos i shaj për ata që nuk ta ka dhënë Allahu duke kërkuar arritjen e rrizkut nga ana e tyre. Atë që Allahu ua dhuron njerëzve (prej të mirave) nga mëshira e Tij, nuk ka kush që ta pengojë, e atë që Ai e ndal, nuk ka kush që ta dhurojë përveç Tij. Ai është i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues (Marrë nga "Tejsir el Aziz el Hamid".)

[1] Ibn Hibani dhe Bejhakiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

– *"Kush kërkon kënaqësinë e Allahut ..."* – Pra, kur kërkon shkaqet e kënaqësisë së Tij.

– *"... në hidhërimin e njerëzve* ..." – Domethënë, kur kërkon atë që kënaqet Allahu edhe sikur njerëzit të zemërohen me të. Nëse plotësohet kushti, atëherë Allahu kënaqet me ty dhe i bën edhe njerëzit të kënaqen me ty. Kur robi kërkon kënaqësinë e Zotit të tij me sinqeritet, Allahu kënaqet me të, sepse Ai është më Bujar se robi i Tij dhe i bën edhe njerëzit që të kënaqen me të. Ai fut dashuri në zemrat e tyre për të, sepse zemrat janë ndërmjet dy gishtave prej gishtave të Mëshirëplotit, e Ai i rrotullon ato si të dëshirojë.

– *"... ndërsa kur dikush kërkon kënaqësinë e njerëzve në hidhërimin e Allahut* ..." – Domethënë, kur kërkon atë që kënaqen njerëzit edhe sikur të zemërohet Allahu me të, rezultati që merr është i kundërt me atë që synon, sepse Allahu fut në zemrat e tyre zemërimin dhe urrejtjen ndaj tij.

Hadithi lidhet me temën, sepse nëse kërkon kënaqësinë e njerëzve, duke zemëruar Allahun, këtë e bën nga frika ndaj tyre.

Dobitë e hadithit:

- Domosdoshmëria e kërkimit të asaj që kënaq Allahun edhe nëse zemërohen njerëzit, sepse Allahu është Ai që sjell të mirat dhe të këqijat.
- Nuk lejohet të kërkosh atë që zemëron Allahun për shkak të kënaqësisë së njerëzve, kushdo qofshin ata.
- Pohimi se Allahu kënaqet dhe zemërohet, por pa përngjasim me krijesat, sipas ajetit: "Asgjë nuk i shëmbëllen Atij dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi." (Shura, 11). Ky është edhe qëndrimi i *Ehli Sunetit.*

Ndërsa ata që e mohojnë, thonë se zemërimi është vlim i gjakut të zemrës për t'u hakmarrë, e kjo nuk i përshtatet Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Kjo është e gabuar, sepse kështu ata e krahasojnë zemërimin e Allahut me zemërimin e krijesave. Ne nuk pranojmë që zemërimi i Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) ngjan me zemërimin e krijesave.

Ndërsa *esharive* u themi: ju e pranoni se Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) dëshiron, por siç dihet tek njeriu dëshira është prirje e brendshme drejt të mirës ose larg së keqes, një përshkrim ky që nuk i përshtatet Zotit. Nëse ata thonë se këtë natyrë ka dëshira e krijesave, por ajo e Krijuesit nuk është e tillë, ne u përgjigjemi duke u thënë se edhe ai zemërim që ju përshkruani është, në fakt, vetëm zemërimi i krijesave.

Kur dikush braktis argumentet e drejtpërdrejta për të kaluar te paralelizmi logjik, themi se ky paralelizëm është i papranueshëm, për disa arsye:

Së pari, kështu bëhen të pavlefshme argumentet e drejtpërdrejta, dhe kjo është e papranueshme.

Së dyti, kjo do të thotë të flasësh rreth Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) pa pasur dituri, sepse të bësh të pavlefshëm kuptimin e drejtpërdrejtë të një teksti do të thotë t'i japësh një kuptim tjetër. Nga e ke mësuar ti që Allahu ka pasur për qëllim atë domethënie dhe jo kuptimin e drejtpërdrejtë të tekstit? Kjo është gënjeshtër ndaj Allahut, sepse mohon kuptimin e qartë dhe pohon diçka që teksti nuk e tregon.

Së treti, kjo është padrejtësi ndaj argumenteve pasi beson se ato flasin për ngjashmëri dhe gjëra të përafërta. Kjo mënyrë të kuptuari e Kuranit dhe Sunetit të Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është kufër dhe humbje.

Së katërti, kjo metodë është një lloj akuze ndaj Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe Halifëve të Drejtë, pasi pretendohet se ata nuk i dinin këto kuptime që dalin nga analogjia! Nëse thonë se ata i kanë ditur, por nuk i kanë sqaruar, atëherë kjo është akuzë për neglizhencë të tyre ndaj misionit.

Njeriu duhet t'u shmanget dy gjërave në të tilla çështje:

Përngjasimit të atributeve të Zotit me ato të krijesave dhe përpjekjes për t'i konkretizuar këto në formë dhe mënyrë, sepse Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "… mos përngjasoni asnjë me Allahun …" (Nahl, 74); "Mos shko pas gjërave që nuk i di …" (Isra, 36). Nëse Allahu i pohon Vetes fytyrë apo dorë, mos u alarmo, sepse Ai që të ka treguar e njeh më mirë Veten, është më i vërtetë në fjalë dhe e më i bukur në shprehje sesa të tjerët. Ai dëshiron udhëzimin për krijesat e Tij. Po kështu, nëse Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue

sel-lem) ia pohon Allahut këto përshkrime, përsëri mos u alarmo, sepse ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte njeriu më besnik, më i dituri i njerëzve rreth Allahut, më i qarti i tyre në të shprehur dhe më i sinqerti.

Kushdo që mohon ndonjë cilësi që Allahu e ka pohuar për Veten e Tij, ose ia ka pohuar Atij Pejgamberi i Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), me pretendimin se këtë nuk ia pranon zemra, themi se ai e ka zemrën të sëmurë, sepse zemra e besimtarit nuk i kundërshton ato, por përkundrazi, është e qetë kur i dëgjon ato. Ne jemi detyruar t’u bindemi vetëm fakteve që na janë përcjellë. Allahu dëshiron që robërit e Tij të jenë të qartë dhe të udhëzuar: “Allahu dëshiron t’ju sqarojë, t’ju udhëzojë në rrugën e të Dërguarve të mëparshëm …” (Nisa, 26). Ai nuk do që t’ua errësojë të vërtetat, kështu që Ai nuk mund të thotë se zemërohem, nëse zemërim nuk është një atribut i Tij, e as nuk mund të thotë se eci me shpejtësi (*hervele*), nëse ky nuk është një veprim i Tij, sepse kjo bie ndesh me qartësimin për të cilin flitet në ajet.[1]

---

[1] Ajo që e shtyn njeriun për të arritur kënaqësinë e krijesave, duke zemëruar Krijuesin, është frika prej tyre. Sikur frika e tij të ishte vetëm nga Allahu, nuk do t’i kishte kënaqur ata, duke e zemëruar Allahun. Robërit janë nevojtarë dhe të pamundur, ata nuk kanë asnjëfarë mundësie për dëm apo dobi. Nuk gjendet ndonjë e mirë tek ata, vetëm se ajo është nga Allahu. Atëherë, si mund të jetë e vlefshme për njësuesin e sinqertë që t’i japë përparësi kënaqësisë së tyre, mbi kënaqësinë e Zotit të botëve, të Cilit i përket i gjithë sundimi e falënderimi, në dorën e Tij është e gjithë mirësia, prej Tij është e gjithë e mira dhe tek Ai kthehen të gjitha çështjet, nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Tij, i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) në fjalën e Tij na ka lajmëruar se kjo është cilësi e munafikëve: “Me të vërtetë që ju (besimtarë të Allahut në Islam) jeni më të frikshëm në gjokset e tyre sesa Allahu. Kjo, ngaqë ata janë popull që nuk kuptojnë." (Hasher, 14). Sa e bukur është fjala:

Dashuria për Ty në është e plotë,
qëllim tjetër nuk ka më të lartë,
pasi çdo send që është mbi tokë,
nuk është gjë tjetër, por dhé e baltë.

Ibn Rexhepi ka thënë: “Kujtdo që i është vërtetuar se çdo krijesë që është mbi tokë, do të jetë tokë, atëherë si i jep përparësi në bindje asaj që është tokë kundrejt Zotit, Zotëruesit të gjithçkaje!? Ose e thënë ndryshe: si e kënaq tokën duke zemëruar Sunduesin, Dhuruesin!? Vërtet, kjo është një gjë e çuditshme.”

Dobitë e temës

- Komenti i ajetit të sures Ali Imran.

"Kjo është prej shejtanit, ju frikëson me evlijatë (ndihmësit) e vet, ju mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni vetëm prej Meje, nëse jeni besimtarë".

- Komenti i ajetit të sures Teube.

"Xhamitë e Allahut i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë të udhëzuar."

- Komenti i ajetit të sures Ankebut.

Nga hadithi del se ai që u frikësohet njerëzve dhe i jep përparësi kënaqësisë së tyre ndaj kënaqësisë së Allahut do të ndëshkohet. Ndëshkimi mund të jetë në fe – Allahu na ruajtë. E keqja që të godet në fe, është më e madhe se e keqja që të godet në pasuri dhe trup.
Po kështu, nga hadithi del se njeriu duhet të ketë frikë të madhe nga ndëshkimet e mëkateve, pasi ka shumë njerëz që punojnë mëkate, duke i nënvlerësuar ato e duke mos parë pasojat që vijnë prej tyre. Këta të mjerë nuk e dinë me se janë goditur, e ndoshta goditja që kanë marrë është në zemrat e tyre, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Kështu, Ai i ndëshkoi ata, duke u futur hipokrizi në zemër deri në Ditën në të cilën do të takojnë Atë, sepse ata e thyen marrëveshjen me Allahun, të cilën vetë ia kishin premtuar Atij dhe për atë se ata gjithnjë thurnin gënjeshtra." (Teube, 77)
O Allah, të lutemi që me kënaqësinë Tënde të na mbrosh nga Zemërimi Yt, me faljen Tënde nga ndëshkimi Yt. Të lutem Ty, prej Teje. Unë nuk mundem dhe nuk e arrij dot numrin e lavdërimeve për Ty, ashtu siç e ke lavdëruar Ti Veten Tënde (shprehja 'me Ty, prej Teje' do të thotë: të lutem të më mbrosh Ti Vetë prej pasojave që vijnë nga veprimet dhe atributet e Tua, p.sh: të më mbrosh prej ndëshkimit që vjen si pasojë e zemërimit Tënd). (Marrë nga "Tejsir el Aziz el Hamid")

"Ka njerëz që thonë: 'Ne besojmë Allahun', por kur vuajnë për çështjen e Allahut, e trajtojnë provën e njerëzve njësoj si dënimin e Allahut."

- Bindja dobësohet dhe forcohet.

Kjo gjë mësohet nga fragmenti i hadithit: "Të kënaqësh njerëzit duke zemëruar Allahun, tregon bindje të dobët".

- Shenjë që tregon bindje të dobët janë edhe tre çështjet e përmendura në hadithin e Ebu Seidit.

Ato janë: të kënaqësh njerëzit duke zemëruar Allahun, t'i falënderosh ata për të mirat që të jep Allahu dhe t'i shash ata për atë që nuk të ka dhënë Allahu.

- Është detyrim që të kemi frikë vetëm nga Allahu.

Kjo del nga fjala e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Kur dikush kërkon...". Pra është përmendur ndëshkimi për atë që i jep përparësi kënaqësisë së njerëzve mbi kënaqësinë e Allahut.

- Njeriu shpërblehet nëse bën atë që do Allahu.

Kur njeriu bën atë që do Allahu pavarësisht se zemërohen njerëzit ai fiton kënaqësinë e Allahut dhe Ai do t'i bëjë edhe njerëzit të kënaqen me të; ky është dhe përfundimi i mirë.

- Njeriu ndëshkohet nëse nuk bën atë që do Allahu.

Nëse nuk bën atë që do Allahu për të fituar kënaqësinë e njerëzve, merr mbi vete zemërimin e Allahut dhe Ai do t'i bëjë edhe njerëzit të zemërohen me të.

Përmbledhje e temës

Është detyrë që frika ndaj Allahut të jetë mbi çdo frikë tjetër. Njeriu nuk duhet t'i kushtojë rëndësi askujt në lidhje me fenë e

Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Ai duhet ta dijë se Përfundimi i atij që kërkon kënaqësinë e Allahut, edhe nëse i zemërohen njerëzit, do të jetë i mirë. E nëse kërkon kënaqësinë e njerëzve, dhe lidhet me ta duke zemëruar Allahun (Subhanehu ue Te'Ala), do t'i përmbysen çështjet dhe nuk ka për të arritur synimin, madje fiton të kundërtën e tij: zemërimin e Allahut dhe zemërimin e njerëzve.

Tema 33

Thënia e Allahut: “Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek Allahu.” (Maide, 23)

Lidhja e kësaj teme me atë paraardhëse qëndron në faktin se kur njeriu i mbështetet veç Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), kjo do të thotë se i mbështetet veç Atij, dhe tek askush tjetër, për të arritur qëllimin e vet dhe për t’u larguar nga ajo që urren.

Teuekuli (mbështetja): Ajo është mbështetja tek Allahu për arritjen e të dëshiruarës dhe shmangien e të urryerës, duke pasur besim te Ai dhe duke realizuar shkaqet e lejuara. Ky është përkufizimi më i saktë. Pra, duhet të plotësohen dy kushte:

- mbështetja te Allahu të jetë e vërtetë;
- të realizohen shkaqet e lejuara.

Ai që më të shumtën mbështetje e ka te shkaqet, e ka të mangët mbështetjen tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), në këtë mënyrë ai ka cënuar bindjen se Zoti është i mjaftueshëm për të. Ai sikur shkakun më vete e ka bërë bazë për arritjen e të dëshiruarës dhe shmangjen e të urryerës. Nga ana tjetër, nëse vetëm mbështetesh tek Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) duke mos përfillur shkaqet, ke kundërshtuar urtësinë e Allahut, sepse Allahu për çdo gjë ka krijuar dhe caktuar shkaqe. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) është i Urtë; Ai i ka lidhur pasojat me shkaqet e tyre. Kjo do të thotë që, për shembull, të mbështetesh tek Allahu për të pasur fëmijë, por pa u martuar.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte më i dalluari ndër ata që i mbështeten Allahut, e megjithatë ai i vepronte shkaqet. Ai (sal-

lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) merrte ushqim për udhëtimet e tij; kur u nis drejt betejës së Uhudit, vuri dy mburoja[1]; kur emigroi për në Medinë, mori një udhërrëfyes, që t’i tregonte rrugën[2] dhe nuk tha: “Unë vetëm do t’i mbështetem Allahut”; ai mbrohej nga të nxehtët e të ftohtët, sipas stinëve, dhe të gjitha këto nuk e cenonin mbështetjen e tij tek Allahu.

Thuhet se, njëherë, nga Jemeni erdhën disa njerëz për haxh, pa furnizime me vete. Omeri (r.a.) i pyeti se pse kishin ardhur ashtu, e ata iu përgjigjën: “Ne i jemi mbështetur Allahut.” Omeri tha: “Ju nuk jeni të mbështetur tek Allahu, por vetëm pretendoni se i jeni mbështetur Atij.”

Mbështetja te Zoti është gjysma e fesë, prandaj ne, në namazet tona themi: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty ndihmë të kërkojmë.” Ne kërkojmë nga Allahut që të na ndihmojë, duke u mbështetur tek Ai, sepse është Ai që na ndihmon për adhurimin e Tij.

Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “... Adhuroje Atë dhe vetëm tek Ai mbështetu ...” (Hud, 123); “... tek Ai mbështetem dhe Atij i drejtohem me pendim.” (Hud, 88). Adhurimi mund të realizohet vetëm me mbështetje. Nëse njeriu mbështetet veç te vetvetja, është mbështetur në dobësi dhe paaftësi, e kështu nuk mund ta kryejë adhurimin. Kur adhuron Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala) ai ndjen se i është mbështetur Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), e kështu arrin shpërblim e adhurimit dhe shpërblimin e mbështetjes.

Por ne, shpeshherë kemi dobësi në mbështetje. Kur duam të kryejmë një adhurim ose diçka të zakonshme, nuk e kemi mbështetjen e duhur tek Allahu për arritjen e këtij veprimi. Gjithashtu, në shumë raste ne mbështetemi në shkaqet e dukshme, por harrojmë ç’ka pas tyre, e kështu na humb shpërblimi i madh, ai i mbështetjes tek Allahu; gjithashtu nuk na jepet as suksesi i kërkuar, për shkak se na dalin pengesa të ndryshme.

Mbështetja është tri llojesh:

1- Mbështetja e adhurimit dhe nënshtrimit. Ajo është siguria e plotë tek ai ku je mbështetur, duke besuar se në dorën e tij është arritja e të mirës dhe shmangia e të keqes. Kështu i mbështetesh

[1] Ahmedi dhe Ebu Daudi. Sipas Albanit ky tregim është i vërtetë.
[2] Siç shënohet në sahihun e Buhariut.

atij plotësisht, duke ndjerë se ke nevojë për të. Kjo lloj mbështetje duhet të jetë vetëm tek Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Nëse e drejton këtë te dikush tjetër, je idhujtar, politeist, si ata që mbështeten te njerëzit e mirë të vdekur dhe tek ata që nuk janë të pranishëm. Një mbështetje e tillë ndodhë vetëm prej atij që beson se ata veprojnë në mënyrë të fshehtë në univers. Kështu ai u mbështetet atyre për arritjen e dobive dhe shmangjen e dëmeve.

2- Mbështetja te një person për çështje furnizimi për çështje të jetës së kësaj bote. Ky është shirk i vogël, e disa kanë thënë se është shirk i fshehtë. Shumë njerëz, për shembull, mbështeten te profesioni i tyre për arritjen e furnizimit, duke e konsideruar atë më shumë sesa thjesht shkak.

3- Mbështetja te një person, për diçka që ia ke lënë atij në dorë (përfaqësimi), për shembull për blerjen ose shitjen e diçkaje. Kjo nuk ka asgjë të keqe, sepse i mbështetesh atij, duke e pasur të nevojshme dhe duke e ditur se qëndron në pozitë më të lartë se ai. Kështu, Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka ngarkuar Ali Ibn Ebu Talibin që të therte bagëtitë që kishin mbetur nga haxhi *kiran*; ka ngarkuar Ebu Hurejren për zekatin, si edhe Urvetu Ibn el Xhadin që t'i blinte kurbane. Kjo lloj ndryshon nga lloji i dytë, sepse te lloji i dytë ai ndjente nevojë për të duke e parë mbështetjen tek ai si mbështetje nevoje.

Përfundimisht, mbështetja te Zoti është një gradë e lartë e adhurimit dhe për njeriun është detyrë që ta ketë atë në të gjitha çështjet e tij.

Shejhu i Islamit Ibn Tejmije, ka thënë: "Nuk ka mundësi që mohuesit e cilësive të Zotit apo *mutezilët* të mbështeten tek Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), sepse mohuesit besojnë se Allahu nuk ka cilësi, ndërsa njeriu i mbështetet dhe dëshiron t'i mbështetet vetëm atij që është me cilësi të përkryera e të merituara." Po kështu edhe *kaderitë*, që thonë se njeriu është i pavarur në veprat e tij, pra që Allahu nuk ka pushtet në veprat e njeriut. Rrjedhimisht, rruga e selefëve ishte më e mira, sepse me të përmbushen të gjitha adhurimet dhe plotësohen të gjitha gradat e adhuruesve.

Në këtë temë, autori ka sjellë katër ajete, të parin e të cilëve e ka vendosur në titull të saj.

"Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek Allahu."

Kjo do të thotë: mbështetu veç tek Allahu dhe tek askush tjetër. Fjala e shokëve të Musait (alejhi selam) në këtë ajet, tregon se mbështetja është pjesë e imanit dhe element i detyrueshëm i tij. Kur themi: "Nëse je bujar, respektoje mikun", nënkuptojmë se respektimi i mikut është shenjë e bujarisë.

Ky ajet pohon se imani nuk është i plotë nëse mbështetja nuk është e plotë, e nëse mbështetja e plotë është te dikush tjetër veç Allahut, atëherë kemi të bëjmë me shirk të madh, me mungesë të plotë imani.[1]

---

[1] Qëllimi i dijetarit (Allahu e mëshiroftë) me këtë temë është përcaktimi i *teuekul*-it si detyrim dhe se është detyrë që ai të jetë vetëm për Allahun, pasi është nga më të vlefshmet adhurime dhe më e larta e gradëve të Teuhidit. Madje, nuk mund ta realizojnë atë në formë të plotë vetëm se besimtarë të veçantë, siç e kemi shpjeguar te cilësitë e shtatëdhjetë mijë personave që do të futën në Xhenet pa llogari dhe pa ndëshkim. Prandaj, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) ka urdhëruar për të në më tepër se një ajet kuranor, më shumë seç ka urdhëruar për avdesin dhe larjen nga xhunubllëku, madje e ka bërë atë kusht në iman dhe Islam. Domethënia e kësaj, është se humbja e imanit dhe Islamit vjen me humbjen e tij, siç thuhet edhe në ajetin e temës, si dhe në fjalën e Allahut: "... Nëse besoni Allahun, mbështetjuni tek Ai, nëse jeni muslimanë." (Junus, 84); "... Adhuroje Atë dhe mbështetu tek Ai ..." (Hud, 123), e të tjera ajete. Ndërsa në hadith përcillet: "Kujt i pëlqen të jetë njeriu me besimin më të fortë le të mbështetet te Allahu". Trasmeton Ibn Ebi Dun'ja, Ebu Ja'la dhe Hakimi. Kurse në një hadith tjetër përcillet: "Sikur ju t'i mbështeteni Allahut ashtu siç meriton t'i mbështetesh Atij, do t'ju furnizonte ashtu siç furnizon shpendët, që dalin me barkun bosh dhe kthehen të ushqyer." (Ahmedi, Ibn Maxhja). Ahmedi ka thënë: "*Teuekul*-i është punë zemre." Ebu Ismail el Ensari ka thënë: "*Teuekul*-i është dorëzimi i çështjes atij që e sundon dhe të keshë besim te përfaqësia e tij".
Pas këtij sqarimi themi se kuptimi i ajetit të temës është: Musai (alejhi selam) e urdhëroi popullin e tij për t'u futur në tokën e shenjtë, të cilën Allahu e kishte bërë detyrim për ta, dhe që të mos ktheheshin atje ku ishin nga frika e njerëzve të fuqishëm, por të ecnin përpara e të mos frikësoheshin, duke u mbështetur në Allahun për thyerjen e tyre dhe duke besuar në premtimin që Allahu u kishte dhënë, nëse ishin besimtarë. Ibn Kajimi ka thënë: "Mbështetjen tek Allahu Ai e ka bërë kusht të besimit, e atëherë kjo argumenton se humbja e imanit është me humbjen e saj."
Në një ajet tjetër Musai u ka thënë: "... Nëse besoni Allahun, mbështetuni tek Ai, nëse jeni muslimanë." (Junus, 84). Pra, mbështetjen e bëri tregues të saktësisë së Islamit. Po kështu, në fjalën e Tij: "... Besimtarët le të mbështeten vetëm tek Allahu." (Ibrahim, 11), përmendja e emrit të besimit këtu, pa përmendur emrat e tjerë të tyre, argumenton për lidhshmërinë

> Ajeti 2. “Besimtarë të vërtet janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi dhe vetëm te Zotit i tyre mbështeten.” (Enfal, 2)

– *“Besimtarë të vërtet janë vetëm ata …*” – Kjo do të thotë se besimtarë janë vetëm ata që kanë këto pesë cilësi:

1. Kur u përmendet Allahu, zemrat e tyre fërgëllojnë, domethënë iu frikësohet zemra nga Madhështia e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Për shembull, nëse dikush mendon të bëjë një gjynah dhe i thua t’i frikësohet Allahut, ai, nëse është besimtar, do të frikësohet; kjo është shenja e imanit.

2. Kur u lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi, domethënë u shtohet bindja. Ky ajet dëshmon se, ndonjëherë, njeriu mund të përfitojë nga leximi i dikujt tjetër më shumë sesa nga leximi i tij. Përcillet se, njëherë, Profeti e urdhëroi Abdullah Ibn Mesudin t’i lexonte Kuran. Ai i tha: “Si të ta lexoj ty, kur mbi ty ai u zbrit?” Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ia ktheu: “Unë dëshiroj ta dëgjoj atë prej dikujt tjetër.” Ai nisi t’i lexonte suren Nisa, derisa arriti te ajeti: “Si do të bëhet kur, prej çdo populli, Ne të sjellim dëshmitarë, ndërsa ty do të sjellim si dëshmitar mbi të gjithë ata.” (Nisa, 41). Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: “Mjaft!”. “Në këtë kohë − tregon Abdullah Ibn Mesudi − pashë sytë e tij të lotonin.”

3. Cilësia e tretë është: “… dhe vetëm te Zotit i tyre mbështeten.”

---

thelbësore mes imanit dhe *teuekul*-it. Forca e *teuekul*-it dhe dobësia e tij, varet nga forca e imanit dhe dobësia e tij. Kurdo që forcohet imani i robit, forcohet edhe *teuekul*-i i tij, dhe me dobësimin e imanit, dobësohet edhe *teuekul*-i i tij. Nëse *teuekul*-i është i dobët, kjo detyrimisht tregon për dobësinë e imanit. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) ka bashkuar *teuekul*-in me adhurimin, *teuekul*-in me imanin, *teuekul*-in me *takua*-në, *teuekul*-in me Islamin, si dhe *teuekul*-in me udhëzimin. Atëherë, qartësohet se *teuekul*-i është baza për të gjitha gradat e besimit, *ihsanit* e të gjitha punët e Islamit. Ndërsa grada e tij në lidhje me to, është si grada e trupit në lidhje me kokën: ashtu siç qëndron koka mbi trup, po ashtu imani dhe gradët e tij qëndrojnë në trungun e *teuekul*-it. (Marrë nga “Tejsir el Aziz el Hamid”)

Pra, mbështeten vetëm tek Allahu e tek askush tjetër, megjithëse i veprojnë shkaqet. Kjo është edhe pjesa që dëshmon për çështjen në fjalë.

4. Cilësia e katërt tregohet në ajetin: "që e falin namazin ..." Pra, e kryejnë namazin në mënyrë të përpiktë. Fjala "namaz" përfshin farzet dhe nafilet.

5. Cilësia e pestë tregohet në ajetin: "... shpenzojnë nga ato që Ne u kemi dhënë." Parafjala "nga" tregon pjesë të së tërës. Sipas kësaj, Allahu ka lavdëruar ata që shpenzojnë një pjesë të pasurisë së tyre, jo të gjithë atë. Por parafjala "nga" mund të tregojë edhe të tërën. Atëherë, lavdërimi përfshin ata që shpenzojnë një pjesë të pasurisë dhe ata që shpenzojnë të gjithë pasurinë. Ata që shpenzojnë të gjithë pasurinë përfshihen në lavdërim atëherë kur i mbështeten Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) për furnizimin që Ai u jep atyre dhe familjeve të tyre, siç veproi Ebu Bekri (r.a.)[1]. Megjithatë, nëse familja jote është në nevojë, apo nëse nuk është e domosdoshme të shpenzosh të gjithë pasurinë, atëherë nuk duhet shpenzuar e gjithë ajo.

> Ajeti 3. "O *Nebij*, i mjaftueshëm për ty është Allahu dhe (për) ata besimtarë që të pasojnë." (Enfal, 64)

– *"O Nebij* ..." – Këtu është fjala për Profetin tonë, Muhamedin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Ndonjëherë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) i është drejtuar si "Lajmëtar - *Nebij*", e ndonjëherë si "i Dërguar - *Resul*". Kur e urdhëron për Shpalljen, e thërret si *"Rresul"*, ndërsa kur ka të bëjë me rregulla të posaçme, në të shumtën e rasteve, e thërret si *"Nebij"*. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "O *Nebij*-Profet! Përse po ia ndalon vetes atë që ta ka lejuar Allahu ..." (Tahrim, 1). Po kështu Ai (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "O *Nebij*-Profet! Nëse i ndani gratë ..." (Talak, 1). Pra, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka qenë i lajmëruar nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) dhe lajmërues për robërit e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

[1] Ebu Daudi dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi ku përmendet kjo ndodhi është i mirë.

– *"... i mjaftueshëm për ty është Allahu ..."* – Mundet që kuptimi të jetë: "ty të mjafton vetëm Allahu", dhe kjo duket më e saktë.

– *"... dhe (për) ata besimtarë që të pasojnë ..."* – Ajeti interpretohet në dy mënyra. Sipas njërit shpjegim, kuptimi i tij është: Ty të mjafton Allahu dhe ata besimtarë që të pasojnë. Lidhëza "dhe" bashkërendit përemrin "ata" me emrin "Allah", sepse ky është emri më i afërt. Ky rast është si tek ajeti: "... është Ai, i Cili të ka mbështetur ty me Ndihmën e Tij (të pakursyer) dhe (me) besimtarët ..." (Enfal, 62). Pra, Allahu e forcoi të Dërguarin e Tij me besimtarët. Po kështu, ata janë të mjaftueshëm për të, ashtu siç është i mjaftueshëm për të Allahu. Megjithatë, ky mendim është i dobët, për disa arsye:

1. Argumenti se lidhëza bashkërendit përemrin "ata" me emrin "Allah" (sepse ky është më i afërti) nuk është i saktë, sepse e vërteta është që mund të ndodhë edhe ndryshe, madje disa gjuhëtarë (të gjuhës arabe) kanë thënë se kur lidhen me bashkërenditje më shumë se dy gjymtyrë, atëherë ato bashkërendohen me gjymtyrën e parë[1].

2. Nuk është e vërtetë që duhej patjetër të kishte përsëritje të ndonjë gjymtyre, me qëllim që të kuptohej diçka e tillë.

3. Krahasimi me ajetin: "... është Ai, i Cili të ka mbështetur ty me Ndihmën e Tij (të pakursyer) dhe me besimtarët ...", nuk qëndron, sepse ndihma e njerëzve është ndryshe nga mjaftueshmëria me Zotin. Të mjaftohesh me Zotin nuk do të thotë që të mos pranosh ndihmën e të tjerëve.

4. Kur Allahu flet për mjaftueshmërinë, e ka bërë të posaçme atë veç për Veten e Tij. Ai (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Sikur ata të kënaqeshin me atë që u dha Allahu dhe Pejgamberi i Tij dhe të thoshin: 'Allahu është më se i Mjaftueshëm për ne! Allahu do të na dhurojë neve nga Begatitë e Tij dhe Pejgamberi i Tij ...'" (Teube, 59). Pra, bëhet dallim mes mjaftueshmërisë dhe pranimit të asaj që të jepet. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Thuaju: 'Më se i Mjaftueshëm për mua është Allahu dhe tek Ai le të mbështeten ata që kërkojnë mbështetje." (Zumer, 38). Mbështetja e plotë duhet të jetë vetëm tek Allahu, e po kështu vetëm Allahu duhet të jetë i

[1] Kjo do të thotë se Allahu u mjafton edhe besimtarëve.

mjaftueshëm për besimtarët. Nëse do të lejohej mbështetja te dikush tjetër, do të lejohej edhe të mjaftoheshe me dikë tjetër, por nuk është kështu.

5. Ka diçka tjetër që e hedh poshtë interpretimin se sahabët ishin të mjaftueshëm për Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), sepse ata ishin ndjekës të tij. Si mund të jetë pasuesi, i mjaftueshëm për atë që ai pason? Kjo kurrë nuk qëndron.

Përfundimisht, kuptimi i sakta është: Allahu u mjafton edhe besimtarëve që të ndjekin ty, prandaj që të gjithë mbështetjuni Atij: ti dhe ata që të ndjekin ty.

> Ajeti 4. “… dhe kujtdo që mbështetet tek Allahu, Ai do t’i mjaftojë…” (Talak, 3)

Nga kjo fjali mësohet se Allahu do t’i mjaftojë kujtdo që i mbështetet Atij, duke ia lehtësuar edhe çështjet më të vështira, vuajtjet dhe mundimet. Allahu do ta mbrojë atë, pa lejuar që ato mundime të kalojnë përtej kufijve. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), prijësi i të mbështeturve tek Allahu, ka kaluar mjaft mundime, por nuk e kanë dëmtuar, sepse Allahu i ka mjaftuar atij. Gjithashtu, kush i mbështetet Allahut, ka për të qenë i mjaftueshëm me Atë për t’u ushqyer.

Nga ana tjetër, kush mbështetet në dikë tjetër përveç Allahut, nuk do të ndihmohet, sepse askush tjetër veç Allahut nuk është i mjaftueshëm, siç u tha më parë. Kush mbështetet në dikë apo diçka tjetër përveç Allahut, Ai e lë të mbështetur në të, dhe në atë gjendje ai nuk ka për t’ia arritur qëllimit të tij, sepse është larguar nga Allahu.

> Ibn Abasi tregon: “‘Allahu na mjafton neve dhe Ai është Mbrojtësi më i mirë!’ Kështu ka thënë Ibrahimi, kur e hodhën në zjarr, dhe Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kur i thanë: ‘Vërtet populli (idhujtar) është bashkuar kundër jush, kështu që frikësojuni atyre. Por kjo gjë, në të vërtetë, vetëm u shtoi besimin.’” (Ali Imran, 173) [1]

[1] Buhariu dhe Nisaiu.

Ky ajet zbriti kur Ebu Sufjani u largua nga Uhudi e donte të kthehej prapë te Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe shokët e tij, që t’i shfaroste ata, sipas tij. Rrugës ai u takua me një grup njerëzish, të cilët i pyeti se ku po shkonin. Ata i thanë se po shkonin në Medinë. Atëherë Ebu Sufjani u tha që t’i përcillnin Muhamedit dhe shokëve të tij se ai do të kthehej sërish për t’i asgjësuar. Ky grup njerëzish shkoi në Medinë dhe ua përcollën lajmin Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe shokëve të tij. Ata u përgjigjën: “Allahu na mjafton neve, Ai është Mbrojtësi më i mirë!” Menjëherë u nisën rreth shtatëdhjetë kalorës, të cilët shkuan deri në vendin e quajtur *Hamraul Esed*, mirëpo Ebu Sufjani ndërroi mendim dhe u kthye për në Mekë. Ky qe rezultati i mjaftueshmërisë së Allahut për Pejgamberin dhe besimtarët kur iu mbështetën Atij.

Për sa i përket fjalës së Ibn Abasit (radijallahu anhu) se “Ibrahimi e ka thënë atë kur e hodhën në zjarr”, themi se për këtë nuk mund të jepet mendim. Atëherë, gjykohet se ai e ka dëgjuar atë nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Ibn Abasi (r.a.) është prej atyre që kanë përcjellë rrëfime nga Beni Israilët, kështu që mund ta ketë marrë edhe prej tyre, mirëpo siguria e tij në të shprehur dhe lidhja që i ka bërë me Muhamedin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), të bëjnë të mendosh se ai nuk e ka marrë nga Beni Israilët.

Pjesa e ajetit që dëshmon për çështjen në fjalë, është: “Allahu na mjafton neve, Ai është Mbrojtësi më i mirë!”

Shënim: Për sa i përket ndërhyrjes sonë se Ibn Abasi (r.a.) ka përcjellë rrëfime nga Beni Israilët, kjo njihet nga studiuesit e haditheve. Mirëpo kjo ka nevojë për sqarim, sepse Ibn Abasi (r.a.) është prej atyre që e kanë kundërshtuar marrjen e argumenteve nga Beni Israilët. Në “Sahihun” e Buhariut shënohet se ai ka thënë: “O muslimanë! Si ka mundësi që ju pyesni *ehlil kitab*-ët *(ithtarët e librit)*, ndërsa Libri juaj, i cili iu zbrit Profetit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), është libri më i afërt që Allahu ka zbritur, që nuk është përzier dhe nuk është ndryshuar? Allahu ju ka treguar në të se *ehlil kitab*-ët e ndryshuan Librin e Allahut. Ata e ndryshuan Librin me duart e tyre, dhe pastaj thanë se kështu qe nga Allahu,

me qëllimin për të bërë tregti me të, për një çmim të ulët. E përse të mos ju shtyjë dija e mjaftueshme që u erdhi nga Allahu të hiqni dorë nga pyetja e *ehlil kitab*-ëve?! Jo, vallahi, nuk kam parë asnjë prej tyre t'ju pyesë ju për ato që u zbritën te ju."

Dobitë e temës

- Mbështetja te Zoti është detyrë.

Sepse Zoti (Subhanehu ue Te'Ala) e ka lidhur atë me imanin në ajetin: "Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek Allahu." Ky ajet u komentua më lart.

- Mbështetja te Zoti është një prej kushteve të imanit.

Siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) në ajetin më lart: "Në qoftë se jeni besimtarë ...".

- Komenti i ajetit të sures Enfal.

"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi dhe vetëm te Zotit i tyre mbështeten." Qëllimi me "besimin" këtu, është besimi i plotë, se njeriu është besimtar edhe nëse nuk është i përshkruar me këto cilësi, por ka esencën e besimit. Komenti i këtij ajeti u përmend më lart.

- Komenti i ajetit në fundin e sures Enfal.

"O *Nebij*-Profet, i mjaftueshëm për ty është Allahu dhe (për) ata besimtarë që të pasojnë", që do të thotë: Ai të mjafton ty dhe besimtarëve që të ndjekin ty. Ky është shpjegimi më i saktë, siç u tha më lart.

- Komenti i ajetit të sures Talak.

"... dhe kujtdo që mbështetet tek Allahu, Ai do t'i mjaftojë atij ...".

- Vlera e madhe e shprehjes: "Allahu na mjafton neve, Ai është mbrojtësi më i mirë", të cilën e kanë thënë Ibrahimi (alejhi selam) dhe Muhamedi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) kur kanë qenë në vështirësi.

Në këtë temë ka dobi të tjera, të cilat autori nuk i ka përmendur, si për shembull:

- Besimi shtohet, sipas fjalës së Allahut: "... kur u lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi ...".

- Kur njeriu është në vështirësi, duhet të mbështetet tek Allahu, duke vepruar shkaqet, ashtu si Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe shokët e tij, të cilët ia dorëzuan çështjen Allahut dhe thanë: "Allahu na mjafton ne, Ai është mbrojtësi më i mirë."

- Ndjekja e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe besimi janë shkaqe që njeriut t'i mjaftojë Allahu.

Tema 34

Thënia e Allahut: "A janë të sigurt ata nga plani i Allahut? Planit të Allahut nuk i frikësohen vetëm ata që janë të humbur." (Araf, 99)

Kjo temë përfshin dy çështje: sigurinë nga plani i Allahut dhe humbjen e shpresës për mëshirë nga Allahu, të cilat janë dy të kundërta.

- Çështja e parë del nga fjala e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "A janë të sigurt ata nga plani i Allahut?" Këtu bëhet fjalë për banorët e qendrave të banuara, sepse para këtij, është ajeti tjetër: "A janë të sigurt banorët e këtyre qyteteve, se nuk do t'iu vijë dënimi Ynë natën, ndërkohë që flenë? A janë të sigurt banorët e këtyre qyteteve, se nuk do t'iu vijë dënimi Ynë ditën, ndërkohë që argëtohen?!" Më pas vijon: "A janë të sigurt ata nga plani i Allahut? Planit të Allahut nuk i frikësohen vetëm ata që janë të humbur". (Araf, 97-99)

"A janë të sigurt banorët e këtyre qyteteve, se nuk do t'iu vijë dënimi Ynë natën, ndërkohë që flenë?" – Kjo dëshmon për sigurinë e plotë që ata kishin në vendbanimet e tyre, pasi i frikësuari nuk fle.

"A janë të sigurt banorët e këtyre qyteteve, se nuk do t'iu vijë dënimi Ynë ditën, ndërkohë që argëtohen?! – Kjo dëshmon gjithashtu për sigurinë dhe bollëkun e plotë që ata kishin, si dhe moskokëçarjen se kur të gjendeshin në vështirësi, nuk do të luanin e dëfrenin më, por do të shkonin të kërkonin rrizkun dhe mjetet e jetesës e, sdo të kishin kohë për të lozur në kulmin e ditës.

Pyetjet këtu, shprehin mospranimin dhe habinë për gjendjen e tyre. Ata flinin të qetë e të kënaqur dhe vazhdonin në mosbindjen ndaj Allahut, me lojra dhe argëtime, duke gëzuar luksin e tyre, duke harruar Allahun, Krijuesin e tyre. Natën flinin gjumë, kurse tërë ditën merreshin me lojra. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) sqaron se një situatë e tillë ishte pjesë e planit të Tij për ta: "A ishin të sigurt ata nga plani i Allahut?" Pastaj ajetin e ka mbyllur: "Planit të Allahut nuk i frikësohen vetëm ata që janë të humbur".

Ai që ka marrë prej Allahut begati e kënaqësi, ndërkohë që vazhdon në mëkate, mendon se është i fituari, por në realitet ai është i humburi. Nëse Allahu të ka furnizuar nga të gjitha anët, të ka dhënë të ushqehesh, të ka siguruar nga frika e të ka veshur, dhe ti vazhdon të mos i bindesh Allahut, mos mendo se je i fituar, por je i dështuar, sepse kjo është pjesë e planit të Allahut për të ndëshkuar ty.

– *"A janë të sigurt nga plani i Allahut?"* – dëshmon se Allahu ka plane për ndëshkim *(mekër)*. "*Mekër*" quhet arritja e goditjes së kundërshtarit andej nga nuk e pret. Ky është kuptimi i hadithit të Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Lufta është dredhi."[1]

Lind pyetja: Si mund të përshkruhet Allahu me këtë atribut, i cili duket si një cilësi e ulët? Për këtë themi se, kur plane të tilla bëhen në vendin e duhur, janë merita, të cilat tregojnë për fuqinë e atij që i ndërton ato dhe epërsinë e tij mbi kundërshtarin. Prandaj ky nuk është një atribut i përhershëm i Allahut, pra, nuk lejohet të thuhet se Allahu është komplotist, sepse ajo cilësi vlen vetëm për rastet e duhura, siç thotë Allahu: "... ata po kurdisin plane, por edhe Allahu po u thurte plane dhe (pa dyshim që) Allahu është më i Miri i planifikuesve." (Enfal, 30); "Dhe ata kurdisën një plan (kurth), por edhe Ne ndërtuam një plan, pa e ndjerë ata." (Neml, 50); "A janë të sigurt nga plani i Allahut (për ndëshkimin e tyre)?" (Araf, 99).

Nga ana tjetër, kjo cilësi gjithashtu nuk i mohohet Atij në formë absolute, përkundrazi, kur ajo është për lavdërim, Ai përshkruhet me të, e kur nuk është për lavdërim, nuk përshkruhet me të. Po kështu, nuk thuhet se El Makir (komplotist) është një nga emrat Allahut.

[1] Buhariu.

Kurse, për sa i përket tradhtisë, Allahu në mënyrë absolute nuk përshkruhet me të, sepse ajo është një cilësi negative në të gjitha aspektet. Ajo është mashtrim në diçka që lihet në mirëbesim. Ajo është e dënuar: "Por në qoftë se ata mundohen të të tradhtojnë ty, ata vërtet që e kanë tradhtuar Allahun. Kështu që Ai tashmë të dha forcë mbi ta ..." (Enfal, 71). Allahu nuk thotë: "Ai i tradhtoi ata".

Për sa i përket dredhisë, ajo është e ngjashme me komplotimin. Kur është si lavdërim Allahu mund të përshkruhet me të, siç thotë ajeti: "Pa dyshim që hipokritët përpiqen t'i bëjnë dredhi Allahut, por është Allahu Ai, i Cili u bën dredhi atyre ..." (Nisa, 142)

Planifikimi është atribut veprues, që varet nga dëshira e Allahut.

Dobitë e ajetit

- Paralajmërimi i Allahut për begatitë që i fal njeriut që të mos bëhen shkak për rrëshqitje drejt dënimit. Për çdo mirësi duhet të jesh mirënjohës ndaj Allahut, dhe kjo arrihet me bindje ndaj Dhuruesit. Nëse nuk e bën këtë, atëherë dije se mirësitë që gëzon janë tregues të planit të Allahut për të të ndëshkuar.

- Të jesh i sigurt nga plani i Allahut për ndëshkim, është haram, dhe kjo për dy arsye.

1. Forma pyetëse e fjalisë shpreh mospranim dhe habi.
2. Vetë përmbajtja e ajetit: "Planit të Allahut nuk i frikësohen vetëm ata që janë të humbur".

- Çështja e dytë e kësaj teme është humbja e shpresës për mëshirën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala)[1].

[1] Nuk bashkohet besimi i fortë me pesimizmin. Ai që ndjen pesimizem nuk duhet të mjekojë pesimizmin por besimin e tij, pasi rënia në pesimizëm do të thotë se besimi i tij në Allahun është i dobët. Pra është dobësuar besimi në Allahun cilësit e Tij mëshirën e Tij fuqin e Tij përsosmërin e Tij urtësin e Tij dhe ndihmën e Tij. Pesimizmi nuk hyn tek njeriu vetëm nëse gjenë ndonjë derë nga dyert e besimit të dobët, dhe prej saj ai hyn.
Nuk ka ndonjë njeri vetëm se pesimizmi vërtitet rrotull tij, si puna e hajdutit që pret tek porta për t'u hapur e të futet prej saj. Kur njeriut i dobësohet besimi fillimisht ndodh dyshimi që më pas pesimizmi të gjejë vend për depërtim, kur besimi i tij është i dobët. Si shembulli i hajdutit i cili nuk futet tek porta e mbyllur dhe brenda ka burra të armatosur. Mirëpo kur ai ndjen së pari se dera është e hapur dhe së dyti se në shtëpi ka vetëm gra dhe fëmijë ai hyn brenda dhe bën kërdinë. Po kështu pesimizmi kur mëkëmbet tek personi, me kalimin e kohës ai ndikon në çështje të tjera nga ajo prej së cilës u bë

> "Askush nuk e humb shpresën (*kunut*) në mëshirën e Zotit të vet, përveç atyre që janë në rrugë të humbur.'" (Hixhr, 56)

Për të ilustruar këtë çështje autori ka sjellë ajetin e mësipërm, në të cilin fjala "*kunut*" tregon kulmin e pesimizmit, kur njeriu heq çdo shpresë dhe ndërpret çdo përpjekje për të realizuar qëllimin e vet.

I humbur është ai që nuk orientohet dot, që nuk e di se çfarë atributesh e veprash i përshtaten madhërisë së Allahut. Pra, një njeri si ky, që nuk e njeh madhërinë, mëshirën dhe urtësinë e Zotit, i pret shpresat, megjithëse koha kur Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) do ta ndryshojë gjendjen është e afërt. Prandaj, një hadith thotë: "Zoti ynë habitet se si robërit e Tij humbin shpresat tek Ai, dhe se sa e afërt është koha kur Allahu do ta ndryshojë gjendjen. Ai shikon tek ju ngushtësinë e madhe dhe pesimizmin, e vazhdon të qeshë, duke e ditur se dalja juaj nga vështirësia është e afërt."[1]

Konteksti i ajetit lidhet me Ibrahimin (alejhi selam), i cili, kur melekët e përgëzuan me një djalë të mençur e të ditur, u tha atyre: "Po ma sillni këtë lajm të mirë, edhe pse më ka goditur pleqëria? Mbi ç'bazë po ma sillni këtë lajm?' Ata (melekët) u përgjigjën: 'Ne të sjellim ty lajmin e gëzuar me vërtetësi, prandaj mos u bëj shpresëhumbur.' (Ibrahimi) tha: 'E kush mund ta humbë shpresën nga mëshirën e Zotit të vet, përveç atyre që janë të humbur?!'" (Hixhr, 54-56).

Humbja e shpresës për mëshirën e Allahut nuk lejohet, sepse ajo do të thotë të mendosh keq për Allahun (Subhanehu ue Te'Ala) në dy aspekte:

Së pari, ajo është shpifje ndaj fuqisë së Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), sepse kush beson se Allahu është Fuqiplotë, nuk përjashton asgjë nga fuqia e Tij (Subhanehu ue Te'Ala).

---

pesimist. Kësisoj hyn pesimizmi dhe e bën të dyshojë në fuqinë e Allahut dhe urtësin e Tij etje.
Rregulli për largimin e pesimizmit është të besosh se Allahu nuk e thyen premtimin me besimtarët të cilët realizojnë kushtet e ndihmës.

[1] Ahmedi, Ibn Maxhja. Në burimet origjinale të hadithit gjendet me këtë tekst: "habitet se si robërit e Tij humbin shpresat tek Ai", por: "qesh se si robërit e Tij humbin shpresat tek Ai". Sipas Albanit hadithi është i mirë.

Së dyti, është shpifje ndaj mëshirës së Allahut të Madhëruar, sepse kush beson se Allahu është i Mëshirshëm, nuk e quan të pamundur që Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) ta mëshirojë. Për këtë arsye, pesimisti ndaj mëshirës së Allahut është i humbur.

Njeriu kur bie në vështirësi nuk duhet ta quajë të pamundur daljen prej saj. Sa e sa njerëz kanë qenë në hall të madh dhe kanë menduar se nuk do të shpëtojnë prej tij, por Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) i ka shpëtuar. Ky rezultat ka ardhur ose me falënderimin e Allahut, sikurse i ndodhi Junusit: "... po të mos ishte nga ata që e falënderonin Allahun, ai me siguri do të mbetej në barkun e saj, deri në Ditën e Ringjalljes." (Safat, 143-144), ose me veprat e mira, siç qe duaja e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) në Bedër[1] apo në betejën e Ahzabit[2], ose duaja e njerëzve që iu bllokua hyrja e shpellës[3].

Autori (Allahu e mëshiroftë!) kërkon që njeriu të gërshetojë në rrugën e tij për tek Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) frikën, duke mos u siguruar nga plani i Allahut për ndëshkim, dhe shpresën, duke mos u bërë i pashpresë për mëshirën e Allahut. Siguria nga plani i Allahut për ndëshkim është mangësi në frikën ndaj Tij, ndërsa humbja e shpresës nga mëshira e Allahut, është mangësi në shpresën ndaj Tij.

> Ibn Abasi përcjell se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është pyetur për gjynahet e mëdha dhe është përgjigjur: "Politeizmi, humbja e shpresës nga rrugëdalja që sjell Allahu dhe siguria nga plani i Allahut." [4]

– *"Ibn Abasi përcjell se Profeti (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) është pyetur për gjynahet e mëdha ..."* – Kjo pyetje dëshmon se gjynahet ndahen në të vogla dhe në të mëdha. Këtë e tregon edhe Kurani: "Në qoftë se ju i mënjanoni gjynahet e mëdha, që jeni të ndaluar t'i

[1] Buhariu.
[2] Buhariu.
[3] Buhariu.
[4] Bezariu dheTaberani. Sipas shqyrtimit të Abdul Kadir Arnautit senedi i hadithit ka dobësi, por mundësia më madhe është të jetë thënie e Ibn Abasit.

kryeni, Ne do t'ju shkarkojmë nga gjynahet (e lehta) ..." (Nisa, 31); "Ata që u largohen gjynaheve të mëdha dhe marrëdhënie imorale ..." (Nexhm, 32). Edhe gjynahet e mëdha nuk janë në një gradë: disa janë më të rëndë se të tjerët.

Dijetarët nuk kanë mendim të njëjtë për mëkatet e mëdha: a janë përcaktuar me numër apo është dhënë vetëm përkufizimi i tyre. Disa thonë se janë përcaktuar me numër dhe i kanë numëruar ato, duke sjellë argumente. Të tjerë thonë se për to është dhënë vetëm përkufizimi. Shejhu i Islamit Ibn Tejmije ka dhënë përkufizimin e gjynaheve të mëdha: "Çdo gjynah për të cilin ka dënim të posaçëm, qoftë ky në dynja ose në ahiret, qoftë me humbjen e së pëlqyerës ose me arritjen e së urryerës." Ky përkufizim është shumë i gjerë dhe përmbledh shumë gjynahe. Ai është nisur nga parimi se mëkatet ndahen në dy lloje:

1. Mëkatet për të cilat ka vetëm ndalesë dhe nuk është përmendur ndonjë kërcënim. Mëkatet e tilla falen me anë të kryerjes së adhurimeve, siç ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sellem): "Pesë namazet, xhumaja deri në xhuma dhe Ramazani deri në Ramazan, fshinë mëkatet që janë bërë ndërmjet tyre, nëse u largohesh të mëdhave."[1] Po kështu ndodh me umren deri në umren tjetër[2], apo edhe me avdesin, të cilat fshijnë gjynahet[3]. Këto lloj mëkatesh janë të vogla.

2. Mëkatet për të cilat ka ardhur ndëshkim i posaçëm, siç është mallkimi i Zotit, zemërimi i Zotit, largimi i Tij prej tyre, ndëshkimi penal në dynja, ose mohim i imanit etj. Këto janë mëkate të mëdha, të cilat gjithashtu kanë grada të ndryshme.

Pyetësi në këtë hadith ka dashur të njohë gjynahet e mëdha, për t'u larguar prej tyre, krejt ndryshe nga gjendja e shumë njerëz sot, të cilët pyesin vetëm për t'i ditur. Për këtë arsye janë pakësuar frytet e diturisë së tyre.

– *"Politeizmi ..."* – Në mënyrë të drejtpërdrejtë kuptohet se bëhet fjalë për shirkun e madh dhe të vogël, sepse shirku i vogël është më i rëndi ndër gjynahet e mëdha. Ibn Mesudi ka thënë: "Të betohem

[1] Muslimi.
[2] Buhariu.
[3] Muslimi.

në Allahun duke gënjyer, është më e dashur për mua sesa të betohem në dikë tjetër, duke thënë të vërtetën."[1] Kjo, për arsye se e keqja e politeizmit është më e madhe se e keqja e gënjeshtrës. Atëherë, politeizmi është absolutisht një nga mëkatet e mëdha dhe mund të bëhet në aspektin e veprave unike të Allahut (*rrububije*), në aspektin e adhurimit dhe atë të emrave e cilësive të Tij.

– *"... humbja e shpresës nga rrugëdalja që sjell Allahu ..."* – Ky është nga mëkatet e mëdha për shkak të përfundimeve të këqija që sjell.

– *"... siguria nga plani i Allahut ..."* – Kjo do të thotë të kundërshtosh Allahun, ndërkohë që Ai është duke të falur plot të mira. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Ata që nuk pranojnë argumentet Tona, Ne pak nga pak do t'i mbërthejmë me dënime e nga rrugë që as do ta kuptojnë. Dhe Unë do t'u jap kohë. Pa dyshim që plani Im është i fuqishëm." (Araf, 182-183).

Nga kuptimi i drejtpërdrejtë i hadithit duket se mëkatet e mëdha janë të kufizuara në këto tri vepra. Mirëpo nuk është kështu, sepse ka edhe të tjera mëkate të mëdha, por Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) përgjigjej sipas gjendjes së atij që e pyeste. Ndoshta Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka vënë re se njeriu që e pyeti ka qenë disi i sigurt nga ndëshkimi i Allahut, ose me shpresa të humbura tek Ai, prandaj deshi që t'ia sqaronte këto gjëra.

Në çështje të tilla, njeriu duhet të jetë i vëmendshëm. Argumentet e Sheriatit që, në kuptimin e drejtpërdrejtë, duken si kontradiktore, duhet të merren e shqyrtohen sipas rrethanave dhe kontekstit të tyre, me qëllim që ato të përputhen.

> Ibn Mesudi ka thënë: "Më të mëdhatë e gjynaheve të mëdha janë: politeizmi, siguria nga plani i Allahut, humbja e shpresës për mëshirë nga Allahu dhe humbja e shpresës për rrugëdaljen që jep Allahu."[2]

---

[1] Abdurr-Rrezaku dhe Tabarani në "El-Kebir". Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

[2] Abdu Rrezaku, Ibn Xheriri dhe Taberani. Sipas Albanit ky është një hadith i mirë.

– *"... politeizmi ..."* – Ky është më i rëndi i mëkateve të mëdha, sepse është përdhosje e së drejtës më të madhe, të drejtës së Allahut, për të cilën Ai të bëri të ekzistosh, të përgatiti dhe të fali të mira, aq shumë sa askush tjetër.

Përmbledhje

Njeriut i dalin dy pengesa gjatë rrugës për te Zoti i tij: siguria nga plani i Allahut dhe humbja e shpresës për mëshirën e Tij. Kur e godet diçka e keqe ose humb diçka të dashur, atë – nëse nuk e përfshin mirësia e Zotit të tij – mund ta sundojë pesimizmi e, si rrjedhojë, nuk pret për ardhjen e lehtësimit dhe as nuk përpiqet për shkaqet e tij. Nga ana tjetër, kur është i sigurt nga plani i Allahut për ndëshkim, e sheh atë ta kundërshtojë Allahun, megjithëse mbi të janë derdhur plot mirësi të Tij. Ai mendon se është në të vërtetën, dhe kështu vazhdon në humbje, sepse kjo është rruga e tij drejt humnerës.

Dobitë e temës

- Komenti i ajetit të sures Araf.

"A janë të sigurt ata nga plani i Allahut? Planit të Allahut nuk i frikësohen vetëm ata që janë të humbur.".

- Komenti i ajetit të sures Hixhër.

"... Askush nuk e humb shpresën në mëshirën e Zotit të vet, përveç atyre që janë në rrugë të humbur."

- Paralajmërimi i rëndë për atë që është i sigurt nga plani i Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

Kjo për arsye se siguria nga plani i Allahut për ndëshkim është nga më të mëdhat. Kjo del nga ajeti dhe dy hadithet.

- Paralajmërimi i rëndë për humbjen e shpresës tek Allahu.

Kjo del nga ajeti i dytë dhe dy hadithet.

Tema 35

Durimi ndaj caktimit të Allahut është pjesë e besimit.

"Durim" në kuptimin etimologjik do të thotë "frenim", për shembull: "U vra, duke duruar torturat".

Ndërsa kuptimi me të cilin ai përdoret është: frenim i vetes nga disa gjëra, si: frenimi i zemrës nga zemërimi i ndaluar, i gjuhës nga fjalët e ndaluara dhe frenimi i gjymtyrëve nga kryerja e të ndaluarave.

Durimi është tri llojesh:

1- Durim në bindjen ndaj Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Urdhëro familjen tënde që ta falë namazin dhe ti vetë ji i vazhdueshëm në kryerjen e tij." (Ta Ha, 132). "Në të vërtetë Ne ta kemi zbritur Kuranin (o Muhamed) kohë pas kohe. Prandaj, ki durim për vendimin e Zotit tënd ..." (Insan, 23-24). Flitet për durimin ndaj urdhrave të Allahut. Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i zbriti Kurani për ta përcjellë atë, dhe ai u urdhërua të duronte në bindjen ndaj Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), i Cili thotë sërish: "Dhe mbaje veten tënde me durim duke qëndruar me ata që i drejtohen Zotit të tyre mëngjes e mbrëmje, duke dëshiruar Fytyrën (kënaqësinë, shpërblimin) e Tij..." (Kehf, 28).

2- Durim ndaj ndalesave të Allahut. I tillë ishte durimi i Jusufit në mospërgjigjen ndaj gruas së ministrit, kur ajo – me pozitën që kishte – e ftoi drejt vetes. Ajo kishte fuqi dhe pushtet mbi të, e megjithatë ai duroi dhe tha: "O Zoti im, burgu është më i dashur

për mua, sesa ajo që më ofrojnë ato. Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë mund të anoj nga ato e të bëhem injorant." (Jusuf, 33). Ky është durimi ndaj ndalesave të Allahut.

3- Durim ndaj caktimit të Allahut. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Prandaj ki durim për vendimin e Zotit tënd ..." (Insan, 24). Ky ajet flet për caktimin e Allahut, ashtu si ajeti tjetër: "Prandaj ti bëhu i durueshëm (o Muhamed), ashtu siç kanë duruar të Dërguarit e vendosur, dhe mos kërko shpejtimin e dënimit për ta ..." (Ahkaf, 35). Ky është durim në përcjelljen e fesë dhe ndaj lëndimeve që i shkaktonte populli i tij. Këtë tregon edhe fjala e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) për një nga vajzat e tij: "Urdhëroje atë të durojë dhe të shpresojë shpërblimin!"[1]

Kështu, janë tri lloje durimi. Më i vlefshmi prej tyre është durimi në bindjen ndaj Allahut, pastaj durimi ndaj ndalesave të Tij, e në fund, durimi ndaj caktimit të Tij.

Kjo renditje nuk është gjithmonë e vërtetë për raste të veçanta, sepse ndonjëherë durimi ndaj ndalesave të Allahut mund të jetë më i vështirë sesa durimi në bindjen ndaj Tij. Nëse dikush, për shembull, sprovohet nga një grua e bukur, që e fton në një vend pa njerëz, ku nuk e shikon askush përveç Allahut, ndërsa ky njeri është në kulmin e rinisë dhe fuqisë epshore, durimi ndaj këtij harami mund të jetë shumë më i vështirë për të se falja e njëqind namazeve. Po kështu, durimi ndaj ndonjë fatkeqësie − për shembull, vdekja e një të afërmi apo të dashuri − mund të jetë shumë më i vështirë sesa durimi në bindjen ndaj Allahut. Me këtë shpjegim largohen paqartësitë e disave që thonë se renditja e mësipërme ka nevojë për shqyrtim, pasi durimi ndaj disa mëkateve është më i vështirë sesa durimi në disa adhurime, apo se durimi ndaj disa caktimeve.

Durimi në bindje ka gradë më të lartë, për arsye se përmban detyrim dhe veprim, për shembull, i detyron vetes namazin dhe e fal atë, i detyron agjërimin dhe agjëron, i detyron haxhin dhe e kryen etj. Detyrimi dhe veprimi sjellin vështirësi dhe lodhje. Pastaj vjen durimi ndaj mëkateve, sepse ai është detyrim dhe mosveprim, që do të thotë ta detyrosh veten për të mos vepruar. Ndërsa durimi ndaj caktimeve të Zotit është më i lehtë sepse nuk është as veprim, as

[1] Buhariu dhe Muslimi.

mosveprim.

Autori (Allahu e mëshiroftë!) ka veçuar durimin ndaj caktimit të Allahut, sepse ai lidhet me njësimin e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) në veprat unike të Tij (rrububije), për shkak se përcaktimi çështjeve të krijesave është vepër e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

Fjala "caktim" tregon vendimin dhe rezultatin e vendimit të Përcaktuesit, që është Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Njeriu e ka detyrë që të jetë i kënaqur me vendimin e Përcaktuesit dhe të bëjë durim; ndërsa në lidhje me pasojën e caktimit, durimi ndaj tij është detyrë, ndërsa kënaqja me të është e pëlqyeshme. Për shembull, Allahu ka caktuar dikujt t'i digjet makina. Njeriu e ka detyrë të kënaqet me këtë vendim, sepse ai duhet të jetë plotësisht i kënaqur me Allahun si Zot. E për sa i përket pasojës së vendimit, që është djegia e makinës, detyrë është veç durimi ndaj tij, ndërsa të jesh i kënaqur me të është e pëlqyer, por jo detyrë, sipas mendimit më të saktë.

E përcaktuara (pasoja e përcaktimit) mund të jetë adhurim por mund të jetë edhe mëkat, ose mund të jetë thjesht prej veprimeve të Allahut. Për adhurimin, është detyrë të jesh i kënaqur me të; për mëkatin nuk lejohet të kënaqesh me të si vepër e caktuar për ty, ndërsa në vështrimin e saj si caktim të Zotit, është detyrë që të kënaqemi me të, sido qoftë ajo. Prandaj Ibn Kajimi ka thënë: "Ne kënaqemi me caktimin dhe zemërohemi me pasojën e tij, kur ajo është mëkat."

Një gjynah që është duke u kryer, nëse e sheh si përcaktim hyjnor, e ke detyrë të kënaqesh me të, sepse Përcaktuesi është Allahu dhe Ai ka urtësi në caktimin e Tij. Por nëse e vlerëson atë gjynah si vepër, nuk lejohet të kënaqesh me të, sepse ai është haram. Ky është edhe ndryshimi ndërmjet caktimit si vendim i Zotit, dhe të përcaktuarës si rezultat i atij vendimi.

> "Kush e beson Allahun, Ai ia udhëzon zemrën e tij. Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo send." (Tegabun, 11). Për këtë, Alkame ka thënë: "Flitet për atë njeri të cilit i ndodh një fatkeqësi, dhe e di se ajo ka ardhur nga Allahu, prandaj ai kënaqet dhe i dorëzohet caktimit të Tij."
> Ebu Hurejra (r.a.) përcjell se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue

> sel-lem) ka thënë: "Dy dukuri ndër njerëz janë kufër: sharja e prejardhjes dhe vajtimi i të vdekurve me kujë."[1]

– *"Kush e beson Allahun ..."* – Qëllimi me besimin te Allahu këtu, është besimi te kaderi (caktimi).

– *"... Ai ia udhëzon zemrën e tij ..."* – Domethënë: i jep atij qetësi. Kjo tregon se besimi ka lidhje me zemrën. Kur zemra udhëzohet, udhëzohet edhe trupi, siç ka thënë Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Vërtet në trup ndodhet një copë mishi. Kur ajo rregullohet, rregullohet i gjithë trupi, e kur ajo prishet, prishet i gjithë trupi; ajo është zemra."[2]

– *"... Alkame ka thënë ..."* – Alkame ka qenë një nga dijetarët më të mëdhenj të tabiinëve.

– *"... Flitet për atë njeri të cilit i ndodh një fatkeqësi ..."* e deri në fund të fjalisë. – Komenti i Alkames shpjegon një nga elementët e domosdoshëm të besimit, sepse kush beson Allahun (Subhanehu ue Te'Ala) e di që vendimi ka qenë i Tij, prandaj kënaqet dhe dorëzohet. Për këtë arsye, besimi në caktimin e Allahut është një nga burimet më të vyera të rehatisë dhe qetësisë të zemrës.[3]

---

[1] Muslimi.

[2] Buhariu.

[3] Atë që e godet ndonjë fatkeqësi, kur e di se ajo është nga caktimi i Allahut dhe duron, shpreson shpërblimin dhe i dorëzohet caktimit të Tij, Allahu e shpërblen duke ia udhëzuar zemrën, në të cilën është burimi i çdo mirësie në dynja dhe ahiret. Ndoshta ia kompenson në dynja atë që i ka humbur, ose i jep diçka më të mirë se ajo, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Dhe sigurisht që ne do t'ju provojmë me gjëra të tilla si frikë, uri, humbje të pasurisë, jetës e frutave, por përgëzimet janë për të duruarit. Të cilët thonë kur u bie fatkeqësia: 'Vërtet të Allahut jemi dhe padyshim tek Ai do të kthehemi. Ata janë mbi të cilët derdhen salauatet (bekimet, faljet) nga Zoti i tyre dhe mu këta janë ata mbi të cilët derdhet Mëshira e Tij, mu këta janë ata të drejtuarit." (Bekare, 155-157)
Ibn Abasi ka thënë: "Ia udhëzon zemrën me siguri, e atëherë ai e mëson se ajo që e goditi nuk mund të mos e godiste, ndërsa ajo që nuk e goditi nuk kishte për ta goditur."
Në një hadith të saktë përcillet se i Dërguari (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Është për t'u çuditur me besimtarin. Çdo gjë që ka përcaktuar

– *"... Dy dukuri ndër njerëz janë kufër ..."* – Pra, këto janë dy cilësi të kufrit, por prania e tyre te një besimtar nuk do të thotë se ai është qafir. Po kështu, nëse një qafir gëzon disa cilësi të besimit, si: turpi, trimëria dhe bujaria, kjo nuk do të thotë se ai është besimtar.

Për këtë hadith, shejhu i Islamit Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë se ai është ndryshe nga hadithi tjetër: "Ndërmjet njeriut, *shirk*-ut dhe *kufr*-it është lënia e namazit"[1], ku fjala "*kufr*" është në trajtë të shquar, që tregon plotësinë e konceptit; me fjalë të tjera, është për kufrin që të nxjerr nga feja. Ndërsa kur fjala "*kufr*" është e pashquar, nuk tregon për dalje nga Islami.

– *"... sharja e prejardhjes ..."* – Mund të jetë sharje e prejardhjes së njeriut ose mohimi i saj.

– *"... vajtimi i të vdekurve me kujë."* – Domethënë vajtimi mbi të vdekurin me të bërtitura e klithma. Kjo vepër tregon mosdurim, duke shkelur kështu një detyrim fetar. Kjo fjali është edhe pjesa që lidhet me temën.

Kur njerëzve u bie ndonjë fatkeqësi, kalojnë në njërën prej këtyre gjendjeve:

1- Zemërim. Kur njeriu zemërohet me Zotin e tij, për çfarë Ai ka caktuar për të, ndoshta kjo e çon edhe në kufër: "Dhe nga mesi i njerëzve është edhe ai, i cili adhuron Allahun me luhatje: nëse i bie ndonjë e mirë, kënaqet me të, por nëse e godet ndonjë sprovë, kthehet në fytyrën e vet të vërtetë, duke i humbur kështu të dyja, edhe këtë botë edhe Jetën Tjetër. Kjo është humbje e qartë." (Haxh, 11). Zemërimi mund të shprehet me gjuhë, siç janë mallkimet, por edhe me gjeste, siç është goditja e fytyrës, grisja e rrobave, shkulja e flokëve etj.

2- Durim. Vargjet e një poeti përshkruajnë këtë veti:

Allahu për të është mirësi. Nëse e godet ndonjë e keqe dhe ai duron, është mirësi për të; nëse i vjen ndonjë e mirë dhe ai falënderon, është mirësi për të, e kjo është vetëm për besimtarin." Ndërsa në lidhje me fjalën e Allahut: "... Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.", duhet të kemi parasysh se kjo ka ardhur nga dija e Tij që përmban urtësi të plotë, e kjo detyrimisht të shtyn për durim dhe kënaqësi. (Marrë nga "Tejsir el Aziz el Hamid")

[1] Muslimi.

Është durim, as shumë, as pak,
i hidhur fort, shijen farmak,
por fund-sheqer, i ëmbël mjaltë'.

Njeriu sheh fatkeqësinë si të rëndë dhe të urryer, por e mban veten dhe duron. Ndodhja dhe mosndodhja e saj nuk është e njëjtë për të, përkundrazi, ai e urren, mirëpo imani i tij e mbron nga zemërimi.

3- Kënaqësi. Kjo ndjenjë qëndron më lart se durimi. Njeriu e përjeton fatkeqësinë sikur të mos kishte ndodhur, sepse e sheh si caktim të Allahut, ndonëse mund të mërzitet paksa. Sido që të jetë ai caktim, lehtësi apo vështirësi, begati apo varfëri, për të është i njëjtë, jo se zemra e tij është e vdekur, por sepse kënaqësinë ai e gjen me Zotin e tij, ai jeton me Të.

4- Falënderim. Kjo është grada më e lartë e gjendjeve të përshkruara, dhe do të thotë që ta falënderosh Allahun për atë fatkeqësi që të ka rënë. Kështu bën vetëm falënderuesi i Allahut.

Kur mendon se ka fatkeqësi më të mëdha se ajo që i ka rënë atij, që fatkeqësitë e dynjasë janë më të lehta se ato të fesë, se ndëshkimi i kësaj bote është më i lehtë se ndëshkimi i botës tjetër dhe se kjo fatkeqësi është shkak për fshirjen e gjynaheve, e ndoshta edhe për shtimin e të mirave të tij, ai e falënderon Allahun për këtë. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Nuk ka brengë, vështirësi apo diçka që e godet besimtarin, që të mos i fshijë atij gjynahet, qoftë edhe një gjemb që e shpon."[1] Po ashtu, me anë të falënderimit, shtohet edhe besimi.

> Ibn Mesudi rrëfen se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Nuk është prej nesh[2] ai që godet faqet, gris rrobat e veta dhe klith si në kohën e xhahilijetit."[3]

– *"... godet faqet ..."* – Ky është një ilustrim i veçantë për një sjellje të përgjithshme, që është reagimi në rast fatkeqësie.

---

[1] Buhariu dhe Muslimi.

[2] Qëllimi i Profetitit me thënien "Nuk është prej nesh" është se ai nuk është plotësisht në rrugën tonë, nuk zbaton udhëzimet tona. Ai nuk ka patur për qëllim se ky njeri është krejtësisht jasht fesë islame.

[3] Buhariu dhe Muslimi.

– *"... gris rrobat e veta ..."* – Flitet për rrobat në pjesën e sipërme të trupit, të cilat njerëzit i grisin kur u ndodh ndonjë fatkeqësi, prej pikëllimit dhe mospërmbajtjes.

– *"... klith si në kohën e xhahilijetit."* – Kjo shprehje mund të kuptohet në dy mënyra:

1. Sipas kuptimit të përgjithshëm, që ia jep gjuha arabe, ku përfshihet çdo thirrje e pavlefshme e kohës së *xhahilijetit*.

2. Sipas kuptimit të veçantë që i jep konteksti, sepse goditja e faqeve apo grisja e rrobave bëhen në raste fatkeqësie, kështu që nënkupton vetëm vajtimin me ligje në raste fatkeqësie, siç është vajtimi me klithmat: "E mjera unë! M'u këput shpina!"

Më e sakta është të anohet nga forma përgjithësuese, pasi konteksti nuk e veçon atë. Atëherë, shprehja nënkupton çdo thirrje e klithmë që ngjan me ato të kohës së *xhahilijetit*.

Janë përmendur tri dukuri përfaqësuese, të cilat ndodhin zakonisht në raste fatkeqësish, pasi ka edhe forma të tjera manifestimi të dhimbjes, si: shembja e shtëpisë, thyerja e enëve, prishja e ushqimit e të tjera, të ngjashme me to.

Tri veprat e përshkruara janë gjynahe të mëdha, sepse Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është distancuar nga ai që i vepron ato.

Hadithi nuk përfshin goditjet e fytyrës në raste të tjera, siç mund të godasë prindi fëmijën, e cila gjithsesi është vepër e urryer, me argument fetar. Po kështu, ai nuk përfshin edhe grisjen e rrobave jo në raste fatkeqësie.

> Enesi tregon se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Nëse Allahu dëshiron të mirën për robin e Tij, ia shpejton ndëshkimin, duke ia dhënë në këtë botë. Nëse dëshiron të keqen për robin e Tij, atëherë ia shtyn ndëshkimin që ai meriton për gjynahun për në Ditën e Kijametit"[1].

[1] Trasmeton Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

– *"Nëse Allahu dëshiron të mirën për robin e Tij …"* – E mira dhe e keqja e robit, varet nga vullneti i Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), vetëm se Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) nuk ka për qëllim të keqen në vetvete, por arritjen e diçkaje tjetër të mirë. Kjo, mbështetur në thënien e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Sherri nuk të atribuohet Ty."[1] Nëse dikush do të synonte të keqen në vetvete, atëherë ajo do t'i atribuohej vetë atij, por Allahu e synon të keqen për një urtësi të caktuar. Kështu që ajo është mirësi, duke marrë parasysh urtësinë që ajo përmban (ose urtësitë që arrihen).

– *"… ia shpejton ndëshkimin, duke ia dhënë në këtë botë …"* – Ndëshkimi është dënimi i mëkatarit për shkak të veprës së tij. Kjo do të thotë se ndëshkimi në këtë botë është më i mirë sesa në botën tjetër, pasi ky këtu mbaron dhe zhduket. Për këtë arsye, Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë për mallkuesit e njëri-tjetrit: "Vërtet ndëshkimi i kësaj bote është më i lehtë sesa ndëshkimi i botës tjetër."[2]

Por është edhe një e mirë tjetër më e madhe: falja e mëkatit, megjithëse më e mira nga të gjitha është mosndëshkimi as në dynja e as në ahiret. Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e ka quajtur më të mirë ndëshkimin në këtë botë, duke pasur parasysh se në botën tjetër ai është më i ashpër, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "… e dënimi në jetën tjetër, është shumë më i ashpër dhe më i vazhdueshëm …" (Ta Ha, 127).

Ndëshkimet janë të shumëllojshme:

a) Ndëshkime në fe. Këta janë më të rëndit, sepse mund të jenë të pakuptueshëm nga njeriu, përveç atij të cilit Allahu i jep sukses. Ndëshkimi fetar të bën ta nënvlerësosh mëkatin, të lësh detyrat fetare, të mos ndiesh xhelozi për gjërat që Allahu i ka bërë të shenjta, të mos urdhërosh për të mirën dhe të mos ndalosh nga e keqja, të cilat janë të gjitha fatkeqësi. Argument për këtë është fjala e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "Por nëse ata largohen, atëherë dije se Allahu do t'i ndëshkojë për disa mëkate të tyre …" (Maide, 49).

b) Ndëshkime ndaj vetë trupit të njeriut, siç janë sëmundjet e

[1] Muslimi.
[2] Muslimi.

ndryshme.

c) Ndëshkime që lidhen me familjen, siç është humbja e saj ose sëmundjet që prekin pjesëtarët e saj.

d) Ndëshkime që lidhen me pasurinë, siç është pakësimi ose shkatërrimi i saj etj.

– *"Nëse dëshiron të keqen për robin e Tij, atëherë ia shtyn ndëshkimin që ai meriton për gjynahun për në Ditën e Kijametit..."* – Që do të thotë se nuk e ndëshkon në këtë botë. Kjo nuk do të thotë se Allahu nuk vepron, përkundrazi, Ai vepron gjithçka që dëshiron. Nëse nuk kryen një veprim, e bën për ndonjë urtësi të caktuar. Në veprimet dhe mosveprimet e Tij ka gjithnjë urtësi.

– *"... për në Ditën e Kijametit ..."* – Dita e Kijametit është dita kur njerëzit do të dalin nga varret e tyre, para Zotit të botëve. Ajo është quajtur "Dita e Kijametit" (Dita e Ngritjes) me këtë emër për tri arsye:

1- Atë ditë, njerëzit do të ngrihen nga varret e tyre, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Ditën kur njerëzit do të ngrihen, për të dalë para Zotit të botëve?!" (Mutafifin, 6).

2- Atë ditë do të ngrihen dëshmuesit, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Sigurisht që Ne do t'i nxjerrim fitimtarë të Dërguarit Tanë dhe ata që besojnë, në jetën e kësaj bote dhe Ditën kur do të ngrihen e të paraqiten dëshmitarët." (Gafir, 51)

3- Do të ngrihet drejtësia, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Ne do ngremë peshojat e drejtësisë në Ditën e Llogarisë ..." (Enbija, 48).[1]

Autori e ka sjellë këtë hadith, sepse argumenton që njeriu nuk duhet të pikëllohet shumë kur i ndodh ndonjë fatkeqësi, pasi ndoshta ajo është një mirësi. Ndëshkimi në këtë botë është më i lehtë se në botën tjetër, prandaj ai duhet të falënderojë Allahun që nuk ia shtyu për atje.

Nëse supozojmë se dikush nuk ka bërë gjynahe dhe e godet ndonjë fatkeqësi, i themi se ky është sprovim i tij për durim dhe për t'ia ngritur gradën me shpërblime, por sërish nuk lejohet që ai të thotë se nuk ka gabuar, sepse ky është pastrim i vetes nga

[1] Në tre ajetet e mësipërme është përmendur fjala *kijam*.

mangësitë. Kjo fatkeqësi nuk përballet me mëkatni për ta fshirë, por përballet me zemrën për ta pastruar. Pra, Aallahu e provon ndonjë njeri me fatkeqësi për të parë se a do të duroj apo jo.

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), − njeriu që i frikësohej më shumë Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) dhe më i devotshmi, − sëmurej sa dyfishi i një burri të zakonshëm.[1] Kjo bëhej me qëllim që ai të arrinte gradën më të lartë të durimit dhe të durimtarëve. Ai, edhe agoninë e vdekjes e pati më të rëndë, megjithëse zemra qe gjithnjë e përqendruar. Kur u fut në dhomë Abdurrahman Ibn Ebu Bekri, duke pastruar dhëmbët me *misvak*, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e drejtoi shikimin tek ai. Aishja (radijallahu anha) e kuptoi se ai donte *misvakun*, prandaj i tha: “A të ta sjell atë?” Ai pohoi, duke lëvizur kokën. Aishja e mori misvakun, e brejti me dhëmbë, duke e zbutur për Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), dhe ia dha. Ai e mori dhe pastroi dhëmbët. Për këtë rast, Aishja ka thënë: “Nuk e kam parë t’i pastrojë (dhëmbët) më mirë se këtë herë.” Pastaj Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ngriti dorën e tij dhe tha: “Më bashko dhe më fut në turmën e shokëve që i ke veçuar me gradat e larta, në Xhenetet më të larta.”[2]

Shih çfarë përqendrimi, sigurie dhe durimi, megjithë ato vështirësi! Qëllimi ishte që Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të arrinte gradën më të lartë të durimtarëve. Ai duroi për hir të Allahut, me ndihmën e Allahut dhe në rrugë të Allahut, derisa e arriti gradën më të lartë.

Kush pëson ndonjë fatkeqësi dhe shpirti i thotë se fatkeqësia është më e madhe se gjynahu i tij, duke iu mburrur dhe duke ia përmendur këtë Allahut, le të ruhet!

Përfundimisht, dalin dy mësime të qarta:

1- Goditja e njeriut me fatkeqësi konsiderohet ndëshkim në dynja dhe fshirje e mëkateve të tij. Kjo është më e mirë sesa t’i shtyhet ndëshkimi për në botën tjetër.

2- Ndoshta goditjet mund të jenë më të mëdha se gjynahet, me qëllim që personi të arrijë gradën më të lartë të durimtarëve. Durimi në raport me besimin, është si koka në raport me trupin.[3]

---

[1] Buhariu.

[2] Buhariu.

[3] Shejhu i Islamit ka thënë: “Fatkeqësitë janë mirësi, sepse ato fshijnë

> Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Shpërblimi i madh vjen me sprovën e madhe. Nëse Allahu i do disa njerëz, i sprovon ata. Kush kënaqet *me caktimin e Allahut, do fitojë kënaqësinë e Tij, e kush nuk kënaqet me atë caktim,*, do të marrë pakënaqësinë e Tij”[1]

Këtë hadith Tirmidhiu e ka sjellë nga Enes Ibn Maliku (r.a.), i cili është i njëjti sahab që ka transmetuar edhe hadithin e mësipërm.

– *“Shpërblimi i madh vjen me sprovën e madhe. ...”* – Kjo do të thotë se shpërblimi baraspeshohet me sprovën. Kur sprova është mjaft e ashpër dhe njeriu duron, edhe shpërblimi është mjaft i madh, sepse Allahu është i Drejtë dhe nuk shpërblen më pak sesa njeriu meriton. Shpërblimi që merr muslimani kur e shpon një gjemb nuk është si shpërblimi që merr kur i thyhet një gjymtyrë. Kjo tregon drejtësinë absolute të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) i Cili nuk i bën padrejtësi askujt. Gjithashtu, ky është qetësim për të

---

gjynahet, të ftojnë në durim, shpërblehesh për to, të çojnë në kthim tek Allahu dhe përulje ndaj Tij, të bëjnë t’u kthesh shpinën krijesave, e të tjera dobi të mëdha. Me vetë sprovën Allahu fal gjynahet dhe gabimet e kjo është nga më të mëdhatë begati. Pra, fatkeqësitë janë mëshirë dhe begati në mënyrë të përgjithshme te krijesat. Vetëm nëse personi për shkak të saj, futet në një gjynah më të madh sesa ishte më parë, atëherë ajo është e keqe, duke e marrë në aspektin e goditjes në fenë e tij. Ka njerëz që kur sprovohen me varfëri, sëmundje ose dhimbje, ndodh që bëjnë dyfytyrësi, pikëllohen tepër (nuk durojnë), u sëmuret zemra, bëjnë mohim të qartë, i lënë disa detyrime dhe punojnë disa të ndaluara, çka u shkakton dëm në fenë e tyre. Për këtë, është më e mirë që të mos goditej, duke e marrë në aspektin e pasojave që la fatkeqësia, jo në aspektin e vetë goditjes. Ashtu sikurse atë që e shtyn fatkeqësia në durim dhe bindje të Allahut, për të është mirësi fetare, sepse në qenien e saj ajo është veprim i Krijuesit (Subhanehu ue Te‘Ala) dhe mëshirë për krijesat. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) është i lavdëruar për të. Ai që sprovohet dhe furnizohet me durim, i është dhuruar mirësi në fenë e tij. Ky njeri, pasi i fshihen gjynahet, përfiton mëshirën dhe arrinë me anë të lavdërimit që bëri ndaj Zotit të tij, përmendjen e Zotit ndaj tij (e lavdëron atë te melekët), Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: ‘Ata do të kenë përmendje të mirë nga Zoti i tyre dhe mëshirë.’ (Bekare, 157). Ai përfiton faljen e gjynaheve dhe ngritjen e gradës. (Marrë nga “Fet’hul Mexhid”)

[1] Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i mirë.

godituri nga fatkeqësia.[1]

– *"... Nëse Allahu e do një popull, i sprovon ata ..."* – I sprovon me gjëra që janë *kader*, si sëmundje, humbje të familjes etj., ose me detyrimet fetare. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Vërtet, Ne ta kemi zbritur Kuranin (o Muhamed) kohë pas kohe. Prandaj, ki durim për vendimin e Zotit tënd ..." (Insan, 23-24). Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) i përmend Profetit të Tij mirësinë dhe pastaj e urdhëron atë për durim, sepse Shpallja që iu zbrit ishte një detyrim për të.

Provë tjetër është durimi ndaj harameve, siç thuhet në hadith: "... një burrë që e fton një grua e bukur me pozitë,[2] por ai i thotë: 'Unë i frikësohem Allahut...'[3]".[4] Shpërblimin i këtij burri është që Allahu ta strehojë nën Hijen e Tij, ditën kur nuk ka hije tjetër veç saj.

– *"... Kush kënaqet me sprovën që i ka caktuar Allahu, do fitojë kënaqësinë e Tij ..."* − Kur Allahu kënaqet me një person, bën që të

---

[1] Në të ka nxitje për përqendrim, shpresimin në të mira dhe për të pasur mendim të mirë për Allahun në atë që të ka caktuar, siç thotë Ai (Subhanehu ue Te'Ala): "Ndoshta ju e urreni diçka, por ajo është e mirë për ju, ndoshta ju e doni diçka, por ajo është më e keqe për ju. Allahu di e ju nuk dini."
Ibn Kajimi, për hadithin e mësipërm thotë: "Shpërblimi i sprovave është vetëm shlyerje gjynahesh, por nëse bëhen shkak për një punë të mirë si durim, kënaqësi, pendim apo kërkim faljeje, në këtë rast shpërblehet për atë që rrodhi prej tyre. Për këtë thuhet se shpërblimi i madh është me sprovën e madhe, nëse bën durim dhe llogarit shpërblimin për durimin. (Marrë nga "Fet'hul Mexhid")

[2] Gruaja që ka cilësitë e përmendura në hadith, është më e lakmueshmja nga burrat, sepse është e vështirë që ato të bashkohen të gjitha. Këto cilësi të bashkuara, bëjnë që dëshira për të, të jetë edhe më e madhe, sidomos kur ajo e kërkon një gjë të tillë vetë, pa qenë e nevojshme të hasen vështirësi për joshjen e saj, kështu që durimi dhe vetëpërmbajtja për të mos iu afruar asaj, për shkak të frikës nga Allahu, megjithëse ajo është e bukur e me pozitë dhe e kërkon vetë një gjë të tillë, është një nga gradat më të përkryera.

[3] Me sa duket, këtë e thotë me gojë për ta parandaluar nga ky ves i shëmtuar, ose për t'i treguar arsyen se pse nuk e pranon. Ekziston mundësia që ta thotë me zemër (d.m.th. ta mendojë dhe ta vendosë me zemër). Kurtubiu ka thënë: "Nuk ka dyshim që fjalë dhe qëndrime të tilla, burojnë nga frika dhe turpi i madh prej Allahut të Lartësuar."

[4] Buhariu.

gjithë njerëzit të kënaqen me të. Këtu flitet për kënaqësinë me caktimin e Allahut, duke e marrë në aspektin e caktimit të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

– *"... e kush nuk kënaqet me atë sprovë,* do të marrë pakënaqësinë e Tij..." – Kjo tregon që është detyrë të kënaqesh me sprovën, përndryshe fiton të kundërtën e kënaqësisë së Zotit, sepse nuk ke duruar ndaj fatkeqësive të përcaktuara prej Tij.[1]

---

[1] Ndërsa lidhur me fjalën e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) - "Nëse Allahu e do një popull i sprovon ata..." - përcillet në hadithin e Seidit se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është pyetur: "Cilët njerëz sprovohen më shumë?" Ka thënë: "Profetët, pastaj më të fortët në besim. Njeriu sprovohet sipas fesë së tij. Nëse është i fortë në fenë e tij, i shtohet sprova e tij dhe nëse është i dobët në fenë e tij, sprovohet sipas fesë së tij. Nuk largohet sprova nga robi, derisa të ecë mbi tokë pa gjynahe." (Deramiu, Ibn Maxhja, e saktëson Tirmidhiu).
Kur njeriu shikon se Profetët dhe eulijatë preken më shumë nga sprovat – që në të vërtetë janë mëshirë – dhe nuk mund t'i largojnë ato, kupton se ata nuk posedojnë asnjë lloj dobie për veten e tyre, jo më për të tjerët.
Fjala e Profetit: "... kush kënaqet ka kënaqësi ...". Pra, do të ketë kënaqësi prej Allahut. Allahu e ka përshkruar Veten e Tij që kënaqet në shumë ajete në librin e Tij: "Shpërblimi për ta, te Zoti i tyre, janë vendet në Xhenetet e Adnit poshtë të cilëve rrjedhin lumenj, të përhershëm në të. Allahu është i kënaqur prej tyre dhe ata janë të kënaqur prej Tij." (Bejineh, 8)
Nëse Allahu kënaqet prej tij, arrihet për të çdo e mirë dhe shpëton nga çdo e keqe. Kënaqësia është që robi ta dorëzojë çështjen e tij tek Allahu, të mendojë vetëm mirë për Të e të pëlqejë shpërblimin e Tij. Ndoshta gjen për këtë qetësinë, furnizimin, dashurinë dhe sigurinë e Allahut, siç thotë Ibn Mesudi (radijallahu anhu): "Allahu me drejtësinë e Tij e bëri qetësinë, gëzimin e sigurinë, në kënaqësinë e Tij, si dhe e bëri brengën e mërzitjen, në dyshim dhe hidhërim."
Fjala e Profetit: "... Ai që nuk kënaqet (zemërohet) ...". Ebu Sadati thotë: "Zemërimi është urrejtja e një gjëje dhe moskënaqja me të."
Pra, kush zemërohet me Allahun për atë që i caktoi, do të ketë hidhërim prej Tij dhe mjafton ky si dënim.
Imam Ahmedi thotë: "Sabrin (durimin) e ka përmendur Allahu në nëntëdhjetë vende në librin e tij." Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) në një hadith të saktë thotë: "Sabri është ndriçim." Po ashtu, përcillet nga Buhariu dhe Muslimi se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Nuk i është dhënë askujt ndonjë dhuratë më e mirë dhe më e bollshme sesa durimi." Ndërsa Ebu Nuejm dhe Bejhakiu, kanë përcjellë se i Dërguari (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Durimi është gjysma e besimit."
Ibn Umeri (radijallahu anhu) ka thënë: "Jetesën tonë më të mirë e gjetëm

Dobitë e hadithit

Pohimi i disa atributeve të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), si dashuria, zemërimi dhe kënaqësia. Ato janë cilësi vepruese, për shkak se varen nga dëshira e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

Në hadith përmendet: "Nëse Allahu e do një popull, i sprovon ata." Pra, atributi i dashurisë është veprues i kushtëzuar. Allahu e do dikë kur ekziston shkaku i dashurisë dhe e urren dikë kur ekziston shkaku i urrejtjes. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) mund ta dojë dikë një ditë dhe ta urrejë një ditë tjetër, sepse pasoja rrjedh nga shkaku i saj. Ndërsa disa kategori veprash, Allahu i do gjithnjë, si: të mirat, të drejtat, veprat e bamirësisë e të tjera.

Keqinterpretuesit i mohojnë këto cilësi. Ata thonë se dashuria dhe kënaqësia e Zotit janë "shpërblimi i Tij" ose "dëshira e Tij për shpërblim", ndërsa zemërimi i Zotit është "ndëshkimi i Tij" ose "dëshira e Tij për ndëshkim". Ata thonë se pohimi i këtyre cilësive është përngjasim i tyre me ato të krijesave. Por ne themi se më e drejta është pohimi i cilësive të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) ashtu siç i përshtaten Atij.

Për çdo cilësi që Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e ka pohuar për Veten e Tij, është detyrë të kihen parasysh dy gjëra:

1. Pohimi i tyre si të vërteta, me domethënien e tyre të drejtpërdrejtë.

2. Ruajtja nga përngjasimi ose përshkrimi i formës a i mënyrës se si ajo është.

---

në durim." (Buhariu)

Aliu (radijallahu anhu) ka thënë: "Vlera e durimit në iman, është si vlera e kokës në trup; nëse këputet koka, trupi mbetet pa kokë." Pastaj e ngriti zërin dhe tha: "S'ka iman ai që s'ka durim." Hadithet dhe transmetimet për të janë të shumta.

Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Nuk godet ndonjë fatkeqësi, veçse me lejen e Allahut." Pra, me përcaktimin dhe urdhrin e Tij, siç thotë në suren Hadid, 22: "Asnjë fatkeqësi nuk bie në tokë ose mbi ju, e që të mos jetë e shkruar në librin (e vendimeve, në Leuhi Mahfudh), para se Ne ta sjellim atë në zbatim. Sigurisht që kjo është e lehtë për Allahun." Ibn Abasi, për fjalën "veçse me lejen e Allahut", ka thënë se do të thotë: vetëm me urdhër të Allahut, pra nga përcaktimi dhe dëshira e Tij. (Marr nga "Fet'hul Mexhid" me shkurtime)

Dobitë e temës

- Komenti i ajetit të sures Tegabun.

"Kush beson Allahun, Ai ia udhëzon zemrën e tij. Allahu është i Gjithëdijshmi për çdo send." Atë e ka komentuar Alkame, siç u përmend më parë, në përshtatje me temën.

- Ky është tregues i besimit në Allah.

Përemri "ky" i referohet durimit ndaj caktimeve të Allahut.

- Sharja e prejardhjes së njeriut.

Sharja ose mohimi i prejardhjes është prej veprave të kufrit, por nuk të nxjerr nga feja.

- Kërcënimi i ashpër për atë që godet faqet, gris rrobat dhe klith si në *xhahilijet*.

Kjo pasi Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është distancuar prej një njeriu të tillë.

- Shenja që tregon se Allahu dëshiron të mirën për robin e Tij.

Kjo shenjë është shpejtimi i ndëshkimit në këtë botë.

- Shenja që tregon se Allahu dëshiron të keqen për robin e tij.

Kjo shenjë është shtyrja e ndëshkimit për gjynahet, deri në botën tjetër.

- Shenja e dashurisë së Allahut për robin e Tij.

Kjo shenjë është sprovimi.

- Pakënaqësia ndaj sprovës është haram.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: “… kush nuk kënaqet me atë sprovë, do të marrë pakënaqësinë e Tij.” Ky është një kërcënim.

- Shpërblimi që merr njeriu kur e pëlqen sprovën si një pasojë e caktimit dhe veprës së Zotit.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë: “… Kush kënaqet me sprovën që i ka caktuar Allahu, do fitojë kënaqësinë e Tij …”.

Tema 36

Argumentet në lidhje me syefaqësinë.

Autori (Allahu e mëshiroftë!) ka titulluar temën dhe nuk e ka shprehur gjykimin e tij, me qëllim që lexuesi të gjykojë vetë mbi këtë dukuri, sipas argumenteve që ekzistojnë.

Përkufizimi i syefaqësisë: të bësh një vepër, me qëllim që ta shikojnë njerëzit. Por këtu përfshihet edhe kryerja e një vepre, me qëllim që të dëgjojnë njerëzit. Në një hadith thuhet: "Atë që punon me qëllim ta shohin ose ta dëgjojnë njerëzit, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) do t'ia nxjerrë në shesh të vërtetën, duke e fëlliqur atë."[1]

---

[1] Trasmeton Buhariudhe Muslimi. Është thënë se kur dikush ka për qëllim me veprën e tij pozitën dhe gradën te njerëzit e nuk ka për qëllim shpërblimin e Allahut, Allahu do të bëjë të mundur që të flasin njerëzit te të cilët kishte për qëllim të arrinte pozitë dhe gradë e nuk do të ketë shpërblim për të në botën tjetër.
Gjithashtu, është thënë se ai që me veprën e tij synon ta dëgjojnë dhe ta shikojnë njerëzit, me qëllim që ta madhërojnë dhe të ngrihet grada e tij tek ata, e arrin atë që dëshiron. Ky është dhe shpërblimi për veprën e tij, ndërsa në botën tjetër nuk do të ketë shpërblim për atë vepër. Është thënë se atij që dëgjon për mangësitë e njerëzve dhe i përhap ato, Allahu do t'ia shfaqë mangësitë dhe do ta bëjë të dëgjojë gjëra që i urren.
Gjithashtu është thënë se kush i atribuon vetes së tij një vepër të mirë që nuk e ka vepruar, duke pretenduar një të mirë që nuk e ka vepruar, Allahu do ta fëlliq dhe do të shfaqë hapur gënjeshtrën e tij.
Po kështu, është thënë se atij që e bën veprën e tij me qëllim që ta shohin njerëzit, Allahu do t'ia tregojë shpërblimin e asaj vepre dhe do ta privojë prej tij.
Gjithashtu, është thënë se do të shfaqë dhe do të mbushë veshët e njerëzve me përkujtim të keq ndaj tij në dynja dhe në Ditën e Kijametit, për atë pjesë të së keqes që ai fsheh në zemrën e tij. (Marrë nga "Fet'h el

Syefaqësia është pjesë e moralit të ulët dhe një nga cilësitë e hipokritëve. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Padyshim që hipokritët mundohen të mashtrojnë Allahun, por është Ai që i mashtron ata. Ata, kur ngrihen për falje, qëndrojnë me përtaci dhe sa për t'u parë nga njerëzit, duke e përmendur Allahun fare pak." (Nisa, 142).

Nëse e gjykojmë syefaqësinë më vete, si fenomen, themi se ajo është element i shirkut të vogël, sepse njeriu − përmes adhurimit të tij − synon dikë tjetër veç Allahut. Por ajo mund të arrijë edhe në shirk të madh. Ibn Kajimi, kur flet për shirkun e vogël, sjell si shembull syefaqësinë e lehtë. Kjo do të thotë se kur syefaqësia është e madhe, mund të arrijë në shirk të madh.

Nëse shqyrtojmë adhurimin që përzihet me syfaqësi, paraqiten tri raste:

1- Kur syefaqësia bëhet shkaku i nisjes së adhurimit, si për shembull, dikush ngrihet për të falur namaz, me qëllim që ta shohin njerëzit, e jo për hir të Allahut. Një vepër e tillë është shirk, ndërsa adhurimi është i papranueshëm.

2- Kur syefaqësia e shoqëron adhurimin në kryerje e sipër. Pra, shtytësi i fillimit të veprës është sinqeriteti për Allahu, më pas, gjatë kryerjes së adhurimit, lind syefaqësia.

Kur adhurimi është një vepër që në tërësinë e vet konsiderohet "e ndashme", atëherë themi se fillimi i veprës është i saktë, ndërsa fundi i saj është i pavlerë. Për shembull: dikush ka njëqind rijalë, të cilët i ka përgatitur për t'i dhënë sadaka. Pesëdhjetë rijalët e parë i jep për hir të Zotit, ndërsa pesëdhjetëshen e dytë e jep për t'u dukur te njerëzit. Atëherë, paratë e dhëna në fillim janë të vlefshme te Zoti si sadaka, ndërsa pjesa e dytë e tyre janë të papranueshme.

Kur adhurimi është një vepër "e pandashme" në tërësi, atëherë shqyrtohen dy mundësi:

a. Nëse njeriu përpiqet ta shmangë syfaqësinë dhe nuk qetësohet me të, nëse ai e refuzon dhe e urren atë, në këtë rast ajo nuk ndikon aspak tek ai, sipas fjalës së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Vërtet Allahu nuk e merr në përgjegjësi umetin tim për mendimet që i vijnë, përderisa nuk vepron ose nuk flet."[1]

---

bari")

[1] Buhariu, Muslimi.

Ja një shembull: Dikush ngrihet për të falur dy rekatë namaz, me sinqeritet për Allahun. Në rekatin e dytë ndjen se po bën syefaqësi, por e lufton dhe e shmang atë. Rrjedhimisht, syefaqësia e lindur nuk e cenon atë dhe nuk ndikon aspak në namazin e tij.

b. Nëse njeriu gjen qetësi me shtirjen e vet dhe nuk përpiqet ta shmangë atë, ajo ia bën të papranueshëm të gjithë adhurimin, sepse vepra që po kryen është e pandashme. Një shembull: dikush nis të falë dy rekatë namaz me sinqeritet për Allahun, por rekatin e dytë e fal me syefaqësi, për shkak se ndjen që dikush tjetër është duke e parë. Ai vazhdon i qetë me atë syfaqësi deri në fund. Kësisoj, i gjithë namazi bëhet i papranueshëm, për shkak se fundi i tij lidhet në mënyrë të pandashme me fillimin.

3- Kur syfeaqësia ndodh pas përfundimit të adhurimit. Kjo nuk ndikon aspak në adhurim, përveç rastit kur teprohet, siç ndodh me sadakanë, nëse ia përmend atij që ia ke dhënë dhe nëse e lëndon atë. Mëkati i teprimit me fjalë përballet me shpërblimin e sadakasë dhe e asgjëson atë, siç thotë Allahu: "O ju që keni besuar! Mos e jepni sadakanë duke e ndjekur me përmendje dhe lëndime ..." (Bekare, 264).

Nga ana tjetër, nuk konsiderohet syefaqësi që njeriu të gëzohet se njerëzit e dinë adhurimin e tij, sepse kjo ka ndodhur pas përfundimit të adhurimit. Po kështu, nuk konsiderohet syfaqësi që njeriu të gëzohet në vetvete me adhurimin, madje përkundrazi, ai është tregues i besimit të tij, pasi Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Ai që gëzohet me veprat e veta të mira dhe mërzitet me të këqijat e veta, ai është besimtari."[1] Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është pyetur për këtë çështje dhe është përgjigjur: "... ai është shpejtim i përgëzimit për besimtarin."[2]

> Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Thuaj: 'Unë jam vetëm një njeri si ju, që më është shpallur se i adhuruari juaj është Një i Adhuruar i Vetëm, Allahu; kështu, kushdo që shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë asnjë në adhurim Zotit të

[1] Ahmedi dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i saktë.
[2] Muslimi.

vet." (Kehf, 110)

– *"Thuaj: 'Unë jam vetëm një njeri si ju …'."* – Allahu e urdhëron të Dërguarin e Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) t'u thotë njerëzve: Unë jam njeri, si ju. Kjo do të thotë se Muhamedi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk dilte jashtë kufijve njerëzorë; ai nuk ishte as perëndi, as engjëll. Fakti që ai ishte njeri përforcohet me krahasimin: "si ju", i cili vërteton edhe një herë atë çka thuhet në fillim.

– *"… që më është shpallur …"* – "Shpallja", në kuptimin gjuhësor, do të thotë: "kallëzim i shpejtë dhe i fshehtë", siç është fjala e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "Pastaj doli nga vendi i tij i faljes para popullit të tij dhe u kallëzoi atyre me shenjë që të falënderonin Allahun mëngjes e mbrëmje." (Merjem, 11). Ndërsa në terminologjinë fetare do të thotë: "kallëzim prej Zotit i normave e ligjeve".

Shpallja hyjnore bën ndryshimin midis nesh dhe Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), ashtu sikurse edhe lajmëtarët dhe të dërhuarit e tjerë të Allahut.

– *"… se i adhuruari juaj është Një i Adhuruar i Vetëm …"* – Përderisa pohohet kjo, atëherë nuk ka përse t'i shoqërosh Atij dikë tjetër në adhurim, në të drejtën e Tij ekskluzive. Prandaj Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) më pas thotë: "… kështu, kushdo që shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira e të drejta dhe të mos i bashkojë Zotit të vet asnjë tjetër në adhurim."

– *"… kështu, kushdo që shpreson për takimin me Zotin e vet …"* – Këtu flitet për takimin e posaçëm, sepse ka dy lloje takimesh me Zotin:

1- Takimi i përgjithshëm, me të gjithë njerëzit. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "O ti njeri! Vërtet që përpiqesh për te Zoti yt, pastaj do ta takosh." (Inshikak, 6). Dhe vazhdon: "Ai, të cilit do t'i jepet libri i tij (i veprave të kryera) në dorën e djathtë, do të ketë të lehtë llogarinë dhe do të kthehet i gëzuar te familja e tij. Kurse ai, të cilit do t'i jepet libri i tij pas shpinës …" e më tej. (Inshikak, 7-10)

2- Takimi i posaçëm, me besimtarët. Ky është takim kënaqësie dhe begatie, siç thuhet edhe në këtë ajet. Këtu përfshihet edhe shikimi i Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), sipas disa dijetarëve.

– *"... le të bëjë vepra të mira ..."* – Kushdo që dëshiron ta takojë Zotin e tij në atë formë që Ai (Subhanehu ue Te'Ala) është i kënaqur, le të bëjë vepra të mira.

Vepra e mirë duhet të jetë e sinqertë dhe e qëlluar. E sinqertë është kur me të synohet veç Fytyra e Allahut. Këtë e dëshmon hadithi: "Vërtet, punët shpërblehen sipas qëllimeve ...".[1]

E qëlluar është kur vepra bëhet sipas normave të Allahut, e argument për këtë është hadithi: "Kur dikush bën një vepër që nuk është në përputhje me fenë tonë, ajo është e refuzuar."[2]

Për këtë arsye, dijetarët i kanë quajtur dy hadithet e mësipërme si "peshoret e veprave". I pari për veprat e zemrës, të brendshme, ndërsa i dyti për veprat e dukshme, të jashtme.

– *"... dhe të mos i shoqërojë asnjë në adhurim Zotit të vet*" – Është veçuar adhurimi, sepse ai është e drejtë ekskluzive e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Fjala "Rab" (Zot) tregon arsyen: ashtu sikurse Zoti të krijoi, pa qenë askush tjetër pjesëmarrës në këtë krijim, po kështu është detyrë që adhurimi yt të jetë vetëm për Të. Pra, vetë fjala "Rab" jep shpjegimin, ashtu si në ajetin tjetër: "O njerëz! Adhuroni Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju dhe ata që ishin para jush ..." (Bekare, 22). Ndërsa fjala "asnjë" mohon gjithçka.

Ajeti lidhet me temën sepse syefaqësia është element i shirkut, prandaj ajo është e ndaluar. Ajeti dëshmon gjithashtu për takimin me Allahun (Subhanehu ue Te'Ala). Disa dijetarë e përdorin këtë ajet si provë që njerëzit do ta shohin Allahun (Subhanehu ue Te'Ala), sepse "takim" do të thotë edhe përballje. Po kështu, ajeti dëshmon se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ishte njeri, kësisoj nuk meriton të adhurohet. Kufijtë e tij ishin brenda njerëzores, ndërsa adhurimi i tij qe veç për Allahun.

Ebu Hurejra përcjell se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-

[1] Buhariu, Muslimi.
[2] Buhariu dhe Muslimi.

> lem) ka thënë: "Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: 'Unë nuk kam nevojë për pjesën e punës që ma kushtojnë bashkë me të tjerë.[1] Kush bën një vepër duke më shoqëruar Mua, në qëllimin e tij, me dikë tjetër, Unë e lë atë person dhe shoqërimin e tij.'"[2]

– *"Ebu Hurejra përcjell se Profeti (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë: 'Allahu (*Subhanehu ue Te'Ala*) thotë* ..." – Ky hadith, që Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e përcjell nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), quhet hadith *kudsij*.

– *"... Unë nuk kam nevojë për pjesën e punës që ma kushtojnë bashkë me të tjerë..."* – Kjo do të thotë se Allahu nuk pranon asnjë vepër që përmban shirk. Ai pranon vetëm punën e sinqertë veç për Të. Ai është Krijuesi i vetëm, prandaj si t'ia kushtosh meritën e Tij dikujt tjetër?! Kjo nuk është drejtësi, e për këtë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) citon Llukmanin që ka thënë: "Idhujtaria është padrejtësia më e madhe." (Llukman, 13). Allahu është Ai që të krijoi, të aftësoi, të pajisi me çdo gjë të nevojshme, kurse ti shkon dhe ia kushton dikujt tjetër atë që Ai meriton! Nuk ka dyshim se kjo është padrejtësia më e madhe.

– *"... Kush bën një vepër ..."* – Flitet për çdo lloj vepre adhurimi, si: namazi, agjërimi, zekati, haxhi etj.

– *"... Unë e lë atë person dhe shoqërimin e tij."* – Domethënë, nuk e shpërblej atë veprën, në të cilën më shoqëroi.

Ky mund të arrijë edhe në shirk të madh, dhe atëherë Allahu i hedh poshtë gjitha veprat e njeriut, sepse shirku fshin gjithçka, nëse vdes duke e vepruar atë.

Qëllimi me "shoqërimin e tij" është vepra dhe jo "ortaku", sepse ky mund të ketë qenë edhe Profet ose njeri i mirë, dhe Allahu nuk i

---

[1] Kjo nuk do të thotë se Allahu ka nevojë për veprën që i kushtohet vetëm Atij, pa i shoqëruar diçka tjetër, por se Ai nuk e shpërblen, nuk e pranon dhe nuk e quan të vlefshme një vepër në të cilën i bëhet shok.

[2] Trasmeton Muslimi. Togu "Unë e lë atë dhe shirkun (shoqërimin) e tij" do të thotë: Unë nuk e shpërblej për veprën në të cilën më ka bërë shok.

braktis Profetët apo njerëzit e mirë.

Dobitë e hadithit

- Mësimi se Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) nuk ka nevojë për asgjë.
- Mësimi se e drejta e Allahut është e shenjtë dhe nuk lejohet për asnjë që t'i shoqërojë Allahut dikë tjetër në të drejtën e Tij.
- Vepra që bëhet për syefaqësi nuk vlen.
- Syefaqësia është haram, sepse lënia e njeriut dhe e veprës së tij nga ana e Allahut tregon se Ai është i hidhëruar. Gjithçka që e hidhëron Allahun është haram.
- Cilësitë vepruese të Zotit nuk kufizohen në kohë, sepse Ato janë të lidhura me veprimet e Allahut. Allahu ka qenë dhe vazhdon të jetë veprues.

> Ebu Seidi rrëfen se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "A t'ju kallëzoj se çfarë më tremb më shumë për ju sesa Mesihu Dexhal?" – "Sigurisht." – thanë të pranishmit. Atëherë ai tha: "Shirku i fshehtë: njeriu ngrihet të falet, por e zbukuron namazin kur kupton se dikush po e shikon."[1]

– *"... çfarë më tremb më shumë për ju ..."* – Pejgamberi i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), për shkak të mëshirës së tij, u druhej të gjitha provave të rënda për besimtarët. Prova më e madhe në tokë ka për të qenë Dexhali, por shirku i fshehtë e trembte më shumë atë, sepse shpëtimi prej tij është shumë më i vështirë sesa prej Dexhalit. Për këtë, disa selefë kanë thënë: "Nuk jam përpjekur më shumë me veten time për diçka, sesa jam përpjekur për sinqeritetin." Ndërsa Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Më i lumturi njeri në ndërmjetësimin tim do të jetë ai që thotë *La ilahe il'All-llah* me sinqeritet nga zemra."[2] Nuk mjafton pra thjesht ta thuash, por duhet patjetër sinqeriteti dhe veprat që tregojnë bindje ndaj Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

---

[1] Ahmedi. Sipas Albanit hadithi është i mirë.
[2] Buhariu..

– *"... sesa Mesihu Dexhali ..."* – Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka treguar dy lloje mangësish të Dexhalit:

1. Mangësi fizike (shqisore). Dexhali e ka të verbër syrin e djathtë, siç ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Vërtet Allahu nuk është i paqartë për ju. Ai nuk është i verbër, ndërsa Dexhali është i verbër në syrin e djathtë."[1]

2. Mangësi morale: Ai është mashtrues, gënjeshtar, dhe kjo është një cilësi e pandarë e tij. Ai është njeri, por Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) me urtësinë e Tij, do ta nxjerrë për të provuar me të njerëzit. Prova e tij është shumë e madhe, aq sa që kur Allahu krijoi Ademin e deri sa të bëhet Kijameti, nuk ka për të pasur provë më të madhe në dynja sesa prova e Dexhalit.

Ka mjaft hadithe rreth Dexhalit. Njohja e çështjes së tij është bërë e domosdoshme, sepse Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e ka urdhëruar umetin e tij që të kërkojë mbrojtjen e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) prej Dexhalit në çdo namaz.

Disa janë përpjekur që ta mohojnë atë si çështje, duke thënë se përshkrimet e ardhura janë kontradiktore, prandaj nuk mund të besohen. Por nuk është kështu, sepse këta njerëz i vlerësojnë hadithet duke u mbështetur veç te logjika dhe botëkuptimi i tyre, e duke barazuar fuqinë e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) me fuqinë e tyre. Për shembull, − thonë ata − si mund të jetë një ditë e vetme sa një vit, ndërsa dielli ka një sistem, që nuk mund të ndryshohet. Ky arsyetim është pa dyshim injorancë e tyre në lidhje me Allahun (Subhanehu ue Te'Ala). Ne themi se Ai që e ka ngritur këtë sistem është Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), prandaj Ai ka fuqi që ta ndryshojë atë kur të dëshirojë. Ditën e Kijametit, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) do ta mbledhë diellin dhe do t'ia humbë shkëlqimin, yjet do t'i rrëzojë dhe do të zhveshë qiellin, e të gjitha këto me fjalën "Bëhu!". Mospranimi i këtyre haditheve me arsyetime të tilla, tregon për besimin e dobët dhe mosvlerësimin siç duhet të fuqisë së Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Ata nuk e kanë vlerësuar siç duhet fuqinë e Allahut ..." (Zumer, 67).

Ajo që ne besojmë është se Dexhalit do të dalë në fazën e fundit të

[1] Buhariu, Muslimi.

botës, dhe prej tij do të ndodhë gjithçka, ashtu siç na ka kallëzuar Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Ne besojmë se Allahu është i Plotfuqishëm për të bërë çdo gjë. Ai ka fuqinë absolute që t’u dërgojë njerëzve provën në fenë e tyre, me qëllim që të dallohet besimtari nga qafiri, i keqi nga i miri.

Allahu sprovoi Beni Israilët me peshqit në ditën e shtunë, pikërisht kur ata e kishin të ndaluar gjuetinë. Atë ditë peshqit vinin me shumicë, ndërsa në ditët tjera, që nuk e kishin të ndaluar gjuetinë, nuk vinin. Allahu provoi besimtarët, që ta dinte se kush i druhej Atij në fshehtësi. Ai e bën këtë edhe me të tjerë me prova të ndryshme, siç thotë Ai: “Dhe nga mesi i njerëzve është edhe ai që e adhuron Allahun me luhatje: nëse i bie ndonjë e mirë, ai kënaqet me të, por nëse e godet ndonjë provë, kthehet në fytyrën e vet të vërtetë, duke i humbur kështu të dyja: edhe këtë botë, edhe botën tjetër. Kjo është humbje e qartë.” (Haxh, 11)

– *“... Shirku i fshehtë ...”* – Shirku është dy llojesh: i dukshëm dhe i padukshëm.

I dukshmi është me fjalë, si për shembull betimi jo në Allah apo shprehja: “Çfarë të dëshirojë Allahu dhe ti”, ose me vepra, siç është përulja në shenjë madhërimi ndaj dikuj tjetër veç Allahut.

Shirku i padukshëm ndodh në zemër, siç është syefaqësia, e cila nuk duket, sepse çfarë ka në zemra nuk e di askush tjetër, veç Allahut. Emërtohet gjithashtu edhe shirk me vepra të fshehta, siç thotë Allahu: “Ditën kur të gjitha të fshehtat do të shqyrtohen.” (Tarik, 9), sepse në Ditën e Kijametit llogaria do të jetë edhe për veprat e fshehta. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) gjithashtu thotë: “A nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre. Dhe të bëhet e njohur çfarë ka në gjoksin e njerëzve.” (Adijat, 9-10). Në një hadith të saktë, për atë që urdhëron për të mirën, ndërsa vetë nuk e bën, ndalon nga e keqja, ndërsa vetë e bën të keqen, thuhet se: “Do të hidhet në Zjarr, e do t’i dalin menjëherë zorrët e barkut. Do të sillet rrotull me to, siç sillet gomari me gurin për bluarjen e farave. Banorët e Zjarrit mblidhen rreth tij dhe e pyesin. Ai do t’u tregojë se urdhëronte për të mirën, ndërsa vetë nuk e bënte, dhe ndalonte nga

e keqja, ndërsa vetë e vepronte."[1]

– *"... njeriu ngrihet të falet, por e zbukuron namazin kur kupton se dikush po e shikon."* – Kjo vlen si për burrat, edhe për gratë. Është thënë "burri" thjesht si shembull, jo për ta veçuar.

– *"... por e zbukuron namazin ..."* – Domethënë, e fal më shtruar, ngre duart në tekbire etj.

– *"... kur kupton se dikush po e shikon."* – Pra, zbukurimi i namazit vjen si pasojë e shikimit të dikujt, me qëllim që ta lavdërojë me gjuhë ose ta nderojë me zemër. Ky është shirk.[2]

---

[1] Buhariu, Muslimi.

[2] Ajo që e shtyu ta bëjë këtë, është dashuria për pozitë dhe gradë të lartë te njerëzit. Tibi ka thënë: "Kjo është nga më të rrezikshmet e të këqijave të *nefsit* dhe kurtheve të tij të fshehta. Sprovohen me të *ulematë* (dijetarët), *ubadët* (adhuruesit) dhe ata që i kanë hyrë seriozisht rrugës së Ahiretit. Sado që ata t'i nënshtrojnë *nefset* e tyre, t'i shkëpusin nga dëshirat e t'i mbrojnë nga dyshimet, ato – pasi nuk mundën të veprojnë mëkatet e dukshme që bëhen me gjymtyrë – kërkuan të rehatohen me dukjen e së mirës, shfaqjen e dijes dhe punës. Atëherë, gjeti *(nefsi)* rrugëdalje, nga vështirësia e përpjekjes, te kënaqësia e pranimit nga krijesat. Nuk u kënaq me vështrimin e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) dhe u kënaq me lavdërimin e njerëzve; nuk u kënaq me lavdërimin e Allahut të Vetëm, duke dashur lavdërimin e tyre, begatimin e tyre duke e vështruar atë, shërbimin, nderimin e tij dhe daljen përpara nëpër mexhlise. *Nefsi* arrin nëpërmjet kësaj kënaqësinë më të madhe, dhe dëshirat më të mëdha. Ai mendon se jeta e tij është me Allahun dhe adhurimin e Tij, e në të vërtetë ajo është epsh i fshehtë që e verbon logjikën kritike për perceptimin e tij. Emri i tij është vendosur tek Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) si pjesë e *munafikëve*, ndërsa ai mendon se është tek Allahu si një nga adhuruesit e Tij të afërt. Kjo gjë është kurth nga *nefsi*. Prej kësaj shpëtojnë vetëm *sidikin*-ët (besnikët). Prandaj është thënë se gjëja e fundit që del nga kokat e *sidikin*-ëve, është dëshira për të drejtuar të tjerët (për të qenë prijës)."
Në hadith ka disa dobi:
- Mëshira e Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) për umetin e tij dhe këshilla e tij për ta.
- *Rijaja* është më e frikshme për të mirët sesa fitneja e Dexhalit.
- Paralajmërimi për ruajtjen nga syfaqësia dhe shirku i madh. (Marrë nga "Tejsir el Aziz el Hamid")

Dobitë e temës

- Komenti i ajetit të sures Kehf.

- Mësimi se vepra e mirë nuk pranohet, nëse ajo i kushtohet edhe diçkaje apo dikujt tjetër veç Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Ky mësim është i rëndësishëm.

Sepse kjo vepër i sjell humbje atij që e kryen. Hadithi tregon se Allahu zemërohet me të.

- Përmendja e arsyes së mospranimit të veprës së mirë kur përzihet me syefaqësi, e cila është se Allahu nuk pranon asnjë vepër që i kushtohet me ortakëri.

Në të vërtetë, Ai nuk ka nevojë për asnjë lloj vepre, por veprën e mirë e pranon dhe e shpërblen.

- Një nga arsyet që Allahu nuk pranon asnjë vepër që i kushtohet me ortakëri, është se Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) është më i miri i "ortakëve".

- Droja e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) për shokët e tij nga syefaqësia.

Kjo shprehet në hadithin: "A t'ju kallëzoj se çfarë më tremb më shumë për ju sesa Dexhali?" Kur ai druhej për sahabët, frika për pasardhësit e tyre është akoma më e madhe.

- Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dha si shembull për shirkun e fshehtë dhe për syefaqësinë njeriun që e fillon namazin për Allahun, por që e zbukuron atë kur kupton se dikush po e sheh.

Themi se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i druhej më shumë për ne syefaqësisë sesa Dexhalit.

Autori nuk e ka trajtuar drojën që kishte Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për umetin e tij nga Dexhali, sepse këtu flitet për syefaqësinë, e jo për çështjet të cilat Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u druhej për umetin e tij.

Tema 37

Formë shirkut është edhe kur njeriu, me anë të veprave të tij, synon dynjanë.

Për temën ka tri variante shpjegimi:

1. Ajo është e njëjtë me temën paraardhëse. Kjo është e pamundur, pra që autori (Allahu e mëshiroftë!) të ketë shkruar dy tema të njëjta njëra pas tjetrës.

2. Ajo temë është më e përgjithshme se ajo paraardhëse, e cila ishte e posaçme për syefaqësinë. Ky është një variant i mundshëm.

3. Ajo është temë e pavarur nga paraardhësja. Kjo është më e mundshmja, sepse tema paraardhëse trajton çështjen e njeriut që bën një vepër për syefaqësi, që të lavdërohet me adhurimin e tij dhe të thuhet se është adhurues, pa synuar dobinë materiale. Në këtë temë flitet për rastin kur, me adhurimin e bërë, nuk është për qëllim lavdërimi dhe as dukja në sy të njerëzve. Adhurimi është i sinqertë për Allahun, por synohet diçka edhe nga dynjaja, si: pasuri, pozitë, shëndet për veten, familjen dhe fëmijët, etj., duke qenë i shkujdesur ndaj shpërblimit në botën tjetër.

Disa shembuj kur, me veprat e tij, njeriu ka qëllim dynjanë:

a) Të bësh punën e muezinit për të marrë rrogën, ose të bësh haxhin veç për tregti.

b) Të studiosh në një universitet fetar, për të siguruar një pozitë të lartë.

c) Të kryesh adhurimet, me qëllim që Allahu të ta shpërblejë në këtë botë, duke larguar prej teje të këqijat si: sëmundje dhe rreziqe etj.

d) Të adhurosh Allahun, duke synuar tërheqjen e njerëzve, me

qëllim që ata të të duan e respektojnë, etj. Shembuj të tillë ka plot.

Atyre që mësojnë në fakultete ose shkolla të tjera, u themi:

Së pari, mos kini për qëllim pozitën e dynjasë, përkundrazi, këto diploma le të shërbejnë si mjet për të punuar në fusha të dobishme për njerëzit, sepse punët sot bazohen te diploma. E nuk mund të arihet te dobia e njerëzve vetëm se me këtë mënyrë. Kësisoj edhe nijeti është i rregullt.

Së dyti, kush synon diturinë në vetvete, e gjen atë vetëm nëpër universitete, prandaj mund të futesh në to me këtë qëllim, pa pyetur për pozitën që të japin.

Së treti, nëse me punën tënde synon dy të mirat – të mirën e kësaj bote dhe të mirën e botës tjetër – nuk ka asgjë të keqe, sepse Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Dhe kushdo që ka frikë Allahun, Ai do t'i gjejë rrugëdalje dhe do t'i japë të mira nga nuk e pret ..." (Talak, 2-3). Frika ndaj Allahut është e lidhur me rrugëdaljen nga çdo lloj vështirësie dhe me furnizimin andej nga nuk e mendon.

Dikush mund të pyesë: Si ka mundësi të quhet i sinqertë në adhurim, ai që me punën e tij synon edhe të mirat e dynjasë? Ne përgjigjemi duke thënë se adhurimi, në këtë rast, i kushtohet tërësisht Zotit, dhe nuk bëhet për sy e faqe të njerëzve, që ata ta lavdërojnë. Synimi i diçkaje materiale vërtet nuk e bën sinqeritetin e plotë, sepse ka shirk, por ai nuk është si shirku i syefaqësisë që synon të lavdërohet për afrimin te Allahu. Ndërsa ky nuk synon lavdërimin e njerëzve, por sonon diçka tjetër të ulët. Nuk ka ndonjë pengesë që gjatë namazit, njeriu të lusë Allahun që ta furnizojë me pasuri, por ai duhet që të mos e falë namazin vetëm me këtë qëllim, sepse kjo është një gradë e ulët. Nga ana tjetër, nëse kërkojmë të mirat e dynjasë me punët e kësaj bote, siç janë tregtia apo bujqësia, nuk ka asgjë të keqe.

Parimisht, nuk duhet që në adhurime të bëjmë vend edhe për dynjanë. Më lart, në temën e syefaqësisë, është dhënë gjykimi i adhurimit kur përzihet me syefaqësinë.[1]

---

[1] Dijetari Abdurrahman es-Sa'di thotë: "Nëse robi me anë të veprave të tij synon vetëm dynjanë dhe dobitë e saj, duke mos dëshiruar kënaqësinë e Allahut dhe shpërblimin e ahiretit, ky njeri nuk ka pjesë në Botën Tjetër. Kjo vepër, në këtë formë, nuk mund të burojë nga besimtari. Besimtari,

Vërejtje: Disa njerëz, kur flasin për adhurimet, përmendin vetëm të mirat e tyre në aspektin e dynjasë. Ata thonë, për shembull, se namazi është gjimnastikë për trupin dhe qetësi për nervat. Për agjërimin thonë se është i dobishëm për metabolizmin dhe regjimin e ngrënies. Por ne nuk duhet që dobitë e kësaj bote t'i shohim si parësore, sepse Allahu nuk i përmend ato në Librin e Tij. Allahu thotë se namazi ndalon nga veprat e shëmtuara dhe nga haramet, ndërsa për agjërimin thotë se ai është shkak për devotshmëri. Dobitë fetare të adhurimeve janë baza, kurse ato të dynjasë janë dytësore. Kur flasim me njerëzit në përgjithësi, u shpjegojmë atyre të mirat në aspektin fetar, ndërsa kur flasim me ata që kënaqen vetëm me gjërat materiale, u shpjegojmë të mirat në aspektin fetar dhe në atë të dynjasë. Sipas vendit bëhet edhe kuvendi.

> "Këdo që dëshiron jetën e kësaj bote dhe bukuritë e saj, Ne do ta shpërblejmë krejtësisht për veprat e bëra në dynja, pa i lënë asgjë mangët. Këta janë ata që në botën tjetër nuk do të kenë kurrgjë, përveç Zjarrit. Kështu, veprat e tyre që i kryen atje (në dynja), janë pa dobi; e pa asnjë vlerë do të jetë gjithçka që ata kanë bërë." (Hud, 15-16)

---

edhe nëse e ka imanin të dobët, patjetër e do kënaqësinë e Allahut dhe Botën Tjetër (ahiretin).

Për sa i përket punës që bëhet për hir të Allahut dhe për shkak të dynjasë (të përfitimeve të kësaj bote), pra për dy qëllime të barabarta, një njeri i tillë, edhe pse është besimtar, ka besim, Teuhid dhe sinqeritet të mangët, pra, puna e tij është e mangët, për shkak se ai nuk e ka të plotë sinqeritetin. Kush punon një punë për Allahun e Vetëm dhe me sinqeritet të plotë, por merr një pagë të caktuar me të cilën ndihmohet (për vazhdimin) në punën dhe fenë e tij – siç janë pagat për punët e bamirësisë, rasti i muxhahidit që i jepet plaçkë lufte ose furnizim, vakfet të cilat u lihen xhamive, shkollave dhe institucioneve të tjera fetare, për të paguar ata që kryejnë detyrën në to – kjo nuk e dëmton imanin dhe Teuhidin e tij, për arsye se ai nuk kishte për qëllim dynjanë, por fenë. Qëllimi me këtë pjesë pasurie që mori ishte si ndihmë për funksionimin e fesë. Për këtë arsye, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), ka bërë që një pjesë e mirë e pasurisë së ligjëruar, siç janë zekatet, plaçka e marrë në luftë, pa luftë, etj., janë për atë që shërben në institucione të dobishme fetare dhe dynjaje. (Marrë nga referenca e botimit të parë.)

– "Këdo që dëshiron jetën e kësaj bote ..." – Pra, qëndrimin në dynja.

– *"... dhe bukuritë e saj ..."* – Këto janë: pasuria, fëmijët, gratë, toka pjellore, bagëtitë, kuajt e mirë e të fortë, ashtu siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) në Kuran: "Njerëzve u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por kthimi tek Allahu është shumë më i mirë." (Ali Imran, 14).

– *"... Ne do ta shpërblejmë krejtësisht për veprat e bëra në dynja ..."* – Kuptimi është: do t'i jepet ajo çfarë dëshiron, në këtë botë. Jobesimtarët përpiqen vetëm për këtë botë dhe stolitë e saj, andaj edhe të mirat u jepen që këtu. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Atë ditë, kur ata që nuk besuan do të vendosen përpara Zjarrit (do t'u thuhet): 'Ju i morët gjërat tuaja të mira në jetën e dynjasë dhe u kënaqët me të.'" (Ahkaf, 20).

Njëherë, Omeri (r.a.), kur pa që shtroja i kishte lënë shenjë Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) në brinjën e tij, qau. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i tha: "Përse qan?" Ai u përgjigj: "O Pejgamberi i Allahut! Mbretërit e romakëve dhe persianëve jetojnë në begati, kurse ti ndodhesh në këtë gjendje." Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i tha: "Atyre u janë shpejtuar të mirat në këtë botë."[1] Në të vërtetë, ai është dënim i madh për ta, sepse kur të kalojnë prej vendit të qejfeve drejt e në Xhehenem, do t'u bëhet më e rëndë humbja e këtyre kënaqësive.

– *"... pa i lënë asgjë mangët ..."* – Pra, nuk do t'u preket pjesa e shpërblimit që meritojnë. Allahu është i Drejti që nuk bën kurrë padrejtësi, prandaj atyre u jepet ajo që duan.

– *"... Këta ..."* – Domethënë ata që dëshirojnë jetën e kësaj bote dhe bukuritë e saj.

[1] Buhariu dhe Muslimi.

– *"... janë ata që në botën tjetër nuk do të kenë kurrgjë, përveç Zjarrit ..."* – Kjo do të thotë se ata nuk kanë për t'u futur në Xhenet, sepse kush nuk ka vend tjetër veç Zjarrit, është i privuar nga Xheneti – Allahu na ruajtë!

Ajeti: "Kushdo që dëshiron jetën e kësaj bote dhe bukuritë e saj, Ne do ta shpërblejmë krejtësisht për veprat e bëra në dynja, pa i lënë asgjë mangët...", specifikohet nga ajeti tjetër: "Kushdo që dëshiron këtë botë, Ne ia japim atij menjëherë çfarë Ne duam dhe për atë që Ne duam. Pastaj, Ne kemi përcaktuar për të Xhehenemin në të cilin do të përvëlohet i turpëruar dhe i dëbuar ..." (Isra, 18).

Po pse të mos themi që ajeti i sures Hud përcakton kuptimin e ajetet të sures Isra, e kështu Allahu kërcënon atë që dëshiron kënaqësitë e kësaj bote, duke i dhënë aq sa dëshiron dhe për kë dëshiron? Por pas kësaj nëpërmjet ajeteve të sures Hud, ka premtuar t'i japë këtij njeriu gjithfarë dëshiron?

Ky kuptim nuk qëndron për dy arsye:

E para, rregulli i Sheriatit, për sa u përket citateve, është se citati përcaktues ka përparësi ndaj citatit të papërcaktuar, ose citati përjashtues ka përparësi ndaj citatit përgjithësues. Ajeti i sures "Hud" është i përgjithshëm, sepse çdokush që dëshiron jetën e kësaj bote dhe bukuritë e saj, do ti shpërblehet plotësisht këtu puna e tij dhe do t'i jepet ajo që dëshironte që t'i jepej. Ndërsa ajeti i sures "Isra" është përjashtues: "Ne ia japim atij menjëherë çfarë Ne duam dhe për atë që Ne duam...", kështu që ajeti me kuptim përgjithësues nuk mund të përcaktojë ajetin me kuptim të përcaktuar.

E dyta, realiteti dëshmon atë që tregon ajeti i sures "Isra", pasi ndër jobesimtarët e varfër, ka edhe më keq sesa muslimanët e varfër. Atëherë, ajeti i përgjithshëm i sures "Hud" specifikohet me ajetin e sures "Isra", që do të thotë se çështja është në dëshirën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

Për çështjen se kujt i referohet ajeti i sures "Hud", janë dhënë mendime të ndryshme:

1. Thuhet se ka zbritur për jobesimtarët, sepse ata dëshirojnë vetëm jetën e kësaj bote. Këtë e provon konteksti i ajetit, që flet për shpërblimin e tyre. Me këtë shpjegim, lidhja e ajetit me temën qëndron në faktin se, meqë jobesimtarët synojnë me veprat e tyre vetëm të mirat e dynjasë, atëherë çdokush që i përafrohet atyre në

këtë aspekt, ka marrë diçka nga shirku dhe kufri i tyre.

2. Thuhet se ka zbritur për ata që shtiren në veprat e tyre, sepse ata punojnë vetëm për dynjanë, prandaj kjo nuk ka për t'u bërë dobi në Ditën e Kijametit.

3. Thuhet se ajeti flet për ata që dëshirojnë pasurinë me anë të veprave të tyre të mira.

Në fakt, konteksti i ajetit mbështet mendimin e parë: "Këta janë ata që në botën tjetër nuk do të kenë kurrgjë, përveç Zjarrit. Kështu, veprat e tyre që i kryen atje (në dynja), janë pa dobi; e pa asnjë vlerë do të jetë gjithçka që ata kanë bërë." (Hud, 16) .

Shënim: Autori ka ndaluar tek analiza e ajetit të parë, se ndoshta ka harruar, prandaj ne shtuam edhe ajetin tjetër; mbase kështu është më mirë.

> Ebu Hurejre përcjell hadithin e saktë se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Ka dështuar robi i arit, ka dështuar robi i argjendit, ka dështuar robi i veshjes së bukur, ka dështuar robi i shtresës së butë. Nëse i jepet, kënaqet, nëse jo, hidhërohet. Ka dështuar dhe ka marrë të kundërtën! Nëse e shpon një gjemb, mos past mundësi ta nxjerrë për të larguar dhimbjen![1]
> Mirësia e madhe (*tuba*) qoftë për robin që e merr për freri kalin e tij në rrugë të Allahut, me flokë të prishur, me këmbë të pluhurosura; që, nëse e lë në vigjëlim, qëndron në vigjëlim, e nëse e lë në prapavijë, qëndron në prapavijë; që, po të kërkojë leje, nuk i jepet leje, e po të kërkojë ndërmjetësim, nuk i merret parasysh ndërmjetësimi."[2]

– *"Ka dështuar robi i arit, ka dështuar robi i argjendit …"* – Konsiderohet si "rob i floririt", sepse ai është i lidhur me të, ashtu siç lidhet robi me Zotin e tij. Interesi i tij më i madh është paraja, së cilës ai i jep përparësi mbi bindjen ndaj Zotit të vet. I tillë është edhe "robi i argjendit".

---

[1] Që do të thotë: mos u mëshiroftë nëse bie në bela.

[2] Trasmeton Buhariu dhe Muslimi.

Dijetari (Allahu e mëshiroftë!) e sjell këtë hadith, sepse ka njerëz që adhurojnë dynjanë, i përulen dhe i nënshtrohen asaj. Dynjaja është qëllimi më i lartë i tyre: zemërohen kur e humbin dhe kënaqen kur e gjejnë atë. Për këtë arsye, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka quajtur “rob” të saj.

– *“... ka dështuar robi i veshjes së bukur, ka dështuar robi i shtresës së butë ...”* – Ky është ai që e shqetëson vetëm paraqitja e jashtme e tij dhe komoditeti. Ai është “rob”, sepse të gjithë mundin dhe përpjekjet u kushton atyre.

E ç’mund të thuhet për atë që, me anë të veprave të mira e duke shfrytëzuar fenë, synon diçka nga dynjaja? Kjo është edhe më e rëndë.

– *“... Nëse i jepet, kënaqet, nëse jo, hidhërohet ...”* – Mundet që dhënësi të jetë edhe Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), e në këtë rast kemi të bëjmë me caktimin e Tij: nëse Allahu cakton furnizim për të, ai kënaqet e lumturohet; por nëse Allahu nuk i ka caktuar të mira e bereqet, ai hidhërohet në zemër dhe e shpreh me fjalë, si për shembull: “Përse unë jam i varfër, kurse ky është i pasur?” etj. Ky është zemëruar me caktimin e Allahut, sepse Allahu ia ndaloi furnizimin.

Allahu jep dhe nuk jep sipas urtësisë së Tij. Ai ia jep dynjanë atij që e do dhe atij që nuk e do, por fenë ia jep vetëm atij që e do. Për muslimanin është detyrë që të jetë gjithnjë i kënaqur me caktimin e Allahut: nëse Ai i jep, duhet ta falënderojë, e nëse e privon, duhet të durojë.

Por “dhënia” mund të jetë edhe nga dikush tjetër, sipas ligjit të fesë. Me këtë kuptim, nëse i jepet nga të ardhurat, prej të cilave përfiton me ligj, kënaqet, e nëse nuk i jepet, zemërohet.

Të dyja domethëniet janë të vërteta dhe tregojnë se njerëz të tillë kënaqen dhe zemërohen vetëm për pasuri, prandaj Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka quajtur “robër” të saj.

– *“... Ka dështuar dhe ka marrë të kundërtën! ...”* – Domethënë është shkatërruar dhe nuk gjen atë që do, nuk gjen lehtësim. Prandaj thuhet më pas: “Nëse e shpon një gjemb, mos past mundësi

ta nxjerrë për të larguar dhimbjen".

Këto fjali përshkruajnë gjendjen e personave të tillë: ata janë të dështuar, të shkatërruar dhe pa shpëtim nga e keqja. Por ato mund të jenë edhe si mallkim mbi atë kategori, e cila interesohet vetëm për dynjanë. Në këtë kuptim, ai është lutur kundër tyre që të shkatërrohen, të mos arrijnë asgjë nga dynjaja dhe të mos kenë asnjë mundësi të shmangin vuajtjet e tyre.

Ata njerëz arrijnë deri në shirk, nëse angazhimi i tyre i pengon nga bindja ndaj Allahut.

– *"... Mirësia e madhe (tuba) qoftë për robin që e merr për freri kalin e tij në rrugë të Allahut ..."* – Tani flitet për një kategori të kundërt me të parën. Ata nuk angazhohen për dynjanë, por gjithmonë për ahiretin. Ata janë gjithnjë në përgatitje e në përpjekje për ngritjen lart të fjalës së Allahut.

"*Tuba"* do të thotë "mirësia e madhe" për një njeri, por kanë thënë gjithashtu se "*tuba*" quhet një pemë në Xhenet. Kuptimi i parë është më i goditur dhe më përmbledhës. Në të njëjtën mënyrë, për fjalën *"Uejl"* thonë se është fjalë mallkimi, e po kështu thonë se ajo është një luginë në Xhehenem; edhe këtu, kuptimi i parë është më përmbledhës.

– *"... në rrugë të Allahut ..."* – Qëllimi i luftës së këtij njeriu është që fjala e Allahut të jetë më e larta, dhe jo për fanatizëm, për nacionalizëm e për objektiva të ngjashme. Por nëse lufton për mbrojtjen e vendit, që ai të jetë vend i muslimanëve, atëherë kur është detyrë mbrojtja e tij, një person i tillë është në rrugë të Allahut. Po ashtu, edhe ai që lufton për të mbrojtur veten, pasurinë ose familjen e tij. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë që kush vritet në mbrojtje të tyre është dëshmor. Ndërsa kush lufton thjesht për nacionalizëm, nuk është në rrugë të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), sepse kjo luftë është për fanatizëm. Me këtë qëllim, besimtari dhe qafiri bëhen të barabartë, sepse edhe kafiri lufton për atdheun e vet.

– *"... me flokë të prishur ..."* – Pra, nga ecja në rrugë të Allahut. Ai nuk interesohet për gjendjen e tij, përderisa ajo është e tillë si

rezultat i bindjes ndaj Allaut (Subhanehu ue Te'Ala).

– *"... me këmbë të pluhurosura ..."* – Pra, nga ecja në rrugën e Allahut. Kjo tregon se gjëja më e rëndësishme për të është xhihadi në rrugë të Allahut, ndërsa pastërtia e flokëve, rrobave dhe shtrojës së tij, nuk është shqetësimi i tij.

– *"... nëse e lë në vigjëlim, qëndron në vigjëlim, e nëse e lë në prapavijë, qëndron në prapavijë ..."* – Që të dyja këto pozicione nuk janë në pararojë të ushtrisë. "Në vigjëlim" do të thotë "në ruajtje të ushtrisë", ndërsa të rrish në prapavijë do të thotë të qëndrosh në fundin e saj.

Këto shprehje kanë dy domethënie:

1. Atij nuk i intereson se ku vendoset: nëse i thuhet të vigjëlojë, rri atje e vigjëlon, edhe nëse i thuhet të rrijë në prapavijë, qëndron atje. Pra, ai nuk kërkon ndonjë pozitë më të lartë, siç është, për shembull, pararoja e ushtrisë.

2. Nëse është në vigjilencë, ose edhe në prapavijë, e kryen detyrën sa më mirë të mundet.

Hadithi i përmban të dyja kuptimet, pasi ndërmjet tyre nuk ka mospërputhje.

– *"... kur kërkon leje, nuk i jepet leje, e kur kërkon ndërmjetësim, nuk i merret parasysh ndërmjetësimi."* – Pra, ai nuk ka pozitë te njerëzit, aq sa po të kërkojë leje, nuk do ia japin. Po ashtu edhe tek pushtetarët nuk ka peshë, prandaj nëse do të kërkonte ndërmjetësim, nuk do t'ia pranonin, por ai është i nderuar dhe me pozitë të lartë tek Allahu, sepse ka luftuar në rrugën e Tij.

Fjala "ndërmjetësim" (*esh shefat*) do të thotë: ndërhyrje për dikë, që të arrijë diçka të mirë ose të largojë diçka të keqe.

Hadithi i ndan njerëzit në dy lloje.

Lloji i parë janë ata që interesohen vetëm për dynjanë, për arritjen e pasurisë ose zbukurimin e pamjes, aq sa këto gjëra ua robërojnë zemrën dhe i largojnë nga përmendja e Allahut.

Lloji i dytë janë atë që interesin më të madh kanë ahiretin, për të cilin ndërmarrin përpjekjet më të mëdha, siç është xhihadi, duke e kryer detyrën e tyre sa më mirë të jetë e mundur.

Dobitë e hadithit

- Mësimi se njerëzit janë dy llojesh, siç u tha pak më lart.

- Atij që i intereson vetëm dynjaja, mund t'i kthehen çështjet në të kundërtën e dëshirës së tij, duke mos pasur mundësi pastaj të largojë as më të voglin mundim, siç është një gjemb.

- I vendosuri, të cilit nuk i intereson dynjaja, dëshiron Ahiretin, duke mos harruar pjesën e tij nga kjo botë. Ai është i kënaqur me atë që i ka përcaktuar Allahu (Subhanehu ue Te'Ala).

- Ai që lufton në rrugë të Allahut, duhet që të mos interesohet për pozitën. Përkundrazi, interesimi i tij duhet të jetë veç për detyrën që ka marrë: qoftë në vigjëlim, në prapavijë, qoftë në mes a në anë të ushtrisë, ku të jetë.

- Pozita e ulët e dikujt te njerëzit, nuk do të thotë që ai të ketë pozitë të ulët tek Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Për njeriun që, po të kërkojë leje, nuk i jepet, dhe po të kërkojë ndërmjetësim, nuk i merret parasysh, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Më e mira qoftë".

Thuhet: "… po të kërkojë …", dhe jo: "nëse kërkon", sepse atij njeriu nuk i intereson aspak dynjaja, që të kërkojë nga ajo, por i intereson mirësia. Megjithatë, ai mund të ndërmjetësojë për njerëzit dhe të kërkojë leje për t'u futur tek ata që kanë pushtet, për ndonjë dobi të përgjithshme.

Dobitë e temës

- Nëse njeriu synon dynjanë me anë të veprave të ahiretit, kjo hyn tek format e shirkut.

Kur njeriu punën e ahiretit e bën mjet për dynjanë, sepse zemrën e tij e ka mbuluar dashuria për dynjanë, aq sa i jep përparësi asaj mbi botën tjetër. Ndërsa vendosmëri dhe sinqeritet ke atëherë kur punët e dynjasë t'i bësh për botën tjetër.

- Komenti i ajetit të sures Hud.

- Emërtimi i muslimanit si “rob i arit”, “rob i argjendit” dhe “rob i veshjes së bukur”.

Kjo robëri nuk e fut në shirk të madh, përderisa nuk ka kaluar cakun, por ajo cenon sinqeritetin, sepse njeriu mban në zemër një dashuri që konkurron dashurinë për Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala) dhe dashurinë për punët e botës tjetër.

- Interpretimi i “... rob i arit, rob i argjendit, rob i veshjes së bukur ...” nga vetë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili thotë: “... Nëse i jepet, kënaqet, nëse jo, hidhërohet.”

Fakti që ai kënaqet dhe zemërohet për shkak të atyre gjërave, është shenjë e robërimit të tij nga ato.

- Mësimi se njerëz të tillë kanë dështuar dhe kanë për të marrë të kundërtën e asaj që duan.

Tri fjalitë, që përmendëm më lart, mund të jenë përshkrim nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për atë kategori njerëzish, por mund të jenë edhe mallkim për ta.

- Nëse e shpon një gjemb, mos pastë mundësi ta nxjerrë për të larguar dhimbjen.

Mundet që tre shprehjet të jenë për të treguar një lajm, por mundet të jenë edhe dua. Kjo çështje është sqaruar më parë.

- Lavdërimi për luftëtarin në rrugë të Allahut që ka ato cilësi që përshkuhen në hadith.

Urimi: “Më e mira qoftë ...”, është lavdërim për të. Ai meriton të lavdërohet, e jo ata që kanë ar dhe argjend apo kapital e pozitë.

Tema 38

Kush u bindet dijetarëve dhe prijësve në ndalimin e asaj që e ka lejuar Allahu ose në lejimin e asaj që Ai e ka ndaluar, i ka konsideruar ata si zota[1].

– *"Kush u bindet dijetarëve dhe prijësve* ..." – Me "dijetarët" nënkuptohen ata që kanë dituri nga feja e Allahut, ndërsa me "prijësit" nënkuptohen zbatuesit e ligjeve të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Këta përmenden në ajetin: "O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut, bindjuni Profetit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja ..."

[1]Por kur quhet shirk bindja dhe pasimi në kundërshtim me ligjet e Zotit? Këtë na e shpjegon Ibn Tejmije: "Këta që i bënë rabinët dhe murgjit e tyre zota në vend të Allahut duke iu bindur atyre në lejimin e asaj që e ka ndaluar Allahu dhe në ndalimin e asaj që e ka lejuar Allahu ndahen në dy kategori:
Kategoria e parë: Ta dinë që të parët e tyre kanë ndryshuar fenë e Allahut dhe t'i ndjekin në këtë ndryshim, e kështu të besojnë lejimin e asaj që ka ndaluar Allahu dhe ndalimin e asaj që ka lejuar Allahu, duke pasuar kryetarët e tyre – megjithëse janë në dijeni që ata kanë kundërshtuar fenë e të Dërguarve- kjo është kufër. Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë konsideruar diçka të tillë shirk, edhe pse nuk falen për ta dhe nuk u bëjnë sexhde atyre.
Kategoria e dytë: Të jetë besimi dhe imani i tyre i saktë, për sa i përket asaj që quhet e lejueshme dhe asaj që quhet e ndaluar, por ju binden atyre (kryetarëve ose eprorëve) në kundërshtimin me ligjin e Allahut (në gjynah) ashtu siç bën muslimani gjynahet për të cilat beson se janë gjynahe. Këta kanë të njëjtin gjykim si gjynahqarët e tjerë të ngjashëm me ta, ashtu sikurse shënohet në dy sahihët se Pejgamberi 'alejhis–selam ka thënë: "Bindja bëhet veçse në gjërat e ligjshme e të pranueshme fetarisht." [Mexhmuul fetava: 7/70, ose libri "el iman"]

(Nisa, 59). Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e ka veçuar bindjen ndaj Tij, e po kështu edhe bindjen ndaj Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sellem). Ndërsa bindjen ndaj drejtuesve e ka bërë dytësore, prandaj nuk e ka përsëritur foljen "bindjuni", pasi nuk ka bindje ndaj krijesës në kundërshtim me Krijuesin.

Ata që drejtojnë punët, janë edhe përgjegjës. Ata janë dijetarët, të cilët mbajnë përgjegjësi për njohjen e Sheriatit, por janë edhe dhe prijësit, të cilët mbajnë përgjegjësi për zbatimin e Sheriatit. Nëse dijetarët dhe prijësit janë në rregull, atëherë ashtu do të jenë edhe çështjet; me prishjen e tyre, prishen edhe çështjet, sepse dijetarët janë orientuesit, ndërsa prijësit janë zbatuesit e ligjit.

– "*... në ndalimin e asaj që e ka lejuar Allahu ...*" – Pra, duke e bërë haram në besim ose në vepra.

– "*... ose në lejimin e asaj që Ai e ka ndaluar ...*" – Domethënë, duke e bërë të lejuar në besim ose në vepra.

Mëkati i ndalimit të asaj që e ka lejuar Allahu, nuk është në gradë më të ulët sesa lejimi i asaj që Ai e ka ndaluar. Shumë njerëz që janë xhelozë në fe, i sheh të priren më shumë nga ndalimi i asaj që Allahu e ka lejuar, sesa nga lejimi i haramit. Ndërkohë, neglizhentët bëjnë të kundërtën. Që të dy janë gabim.

Megjithatë, lejimi i haramit, kur në zanafillë ai është i lejuar, është diçka më e lehtë sesa ndalimi i së lejuarës. Kjo, sepse lejimi i haramit, nëse nuk është i qartë ndalimi i tij, bazohet në faktin se në zanafillë ai është i lejuar. Mëshira e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) e kalon zemërimin e Tij, kështu që mund të ndalojmë vetëm atë që është ndaluar në mënyrë të qartë. Po kështu, rrethi i ndalimit është më i ngushtë dhe më i ashpër.

Parimisht, gjërat duhet të konsiderohen të lejuara gjerësisht, derisa të bëhet i qartë ndalimi. Ndërsa në lidhje me adhurimet, ndalimi është më kategorik, sepse parimisht ato ndalohen dhe konsiderohen haram, derisa të jenë argumentuar qartë në fe, siç ka thënë dikush:

E lejuar gjithçka është në parim,
Por pa Sheriat, mos bëj adhurim!

– *“ ... i ka konsideruar ata si zota.”* – “Zota” është shumësi i fjalës “Zot”. Zot është Ai që bën çfarë të dëshirojë dhe është Sunduesi i gjithçkaje. Veprimi hyjnor ndahet në: veprim që ka të bëjë me krijimin dhe veprim që ka të bëjë me çështjet e fesë.

Kush u bindet dijetarëve në çështjet e fesë, duke qenë në kundërshtim me Allahun dhe Profetin e Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i ka bërë ata zota veç Allahut, sepse i ka konsideruar ata si ligjbërës, ndryshe nga prijësit, që janë vetëm zbatues.

Në rastin kur prijësit vendosin vetë për diçka në kundërshtim me Allahun dhe të Dërguarin e Tij (s.a.u.s), duke e ditur këtë kundërshti, e pastaj urdhërojnë edhe të tjerët me të, pasimi i tyre në këtë rast do të thotë t’i bësh ata zota.

> Njëherë, Ibn Abasi u ka thënë disa njerëzve: “Gati sa nuk po ju bien gurë nga qielli! Unë them: “ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)”, e ju thoni: “ka thënë Ebu Bekri dhe Omeri”!”[1]

– *“... Gati sa nuk po ju bien gurë nga qielli! ...”* – Domethënë, t’u bien gurë mbi ju, si dënim prej Zotit. Rënia e gurëve nga qielli nuk është diçka e pamundur, përkundrazi. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë për Ngjarjen e Elefantit: “... duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh, të cilët i gjuajtën me gurë prej baltës së pjekur?” (Fil, 3-4). Ndërsa për popullin e Lutit thotë: “Ne dërguam një rrebesh gurësh mbi ta, përveç familjes së Lutit, të cilën e shpëtuam në orën e fundit të natës.” (Kamer, 34).

– *“... Unë them: “ka thënë Pejgamberi (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*)”, e ju thoni: “ka thënë Ebu Bekri dhe Omeri”!”* – Ebu Bekri dhe Omeri kanë qenë më të mirët e këtij umeti dhe më afër së vërtetës. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Nëse u binden Ebu Bekrit dhe Omerit, janë në rrugë të drejtë.”[2] Po kështu, është përcjellë se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Pas

[1] Ahmedi.
[2] Muslimi.

meje, merrni si shembuj ata të dy, Ebu Bekrin dhe Omerin."[1] Po kështu, ka thënë: "... Kapuni fort pas Sunetit tim dhe sunetit të *halifëve* të udhëzuar dhe të drejtë. Kapuni fort pas tij, duke e shtrënguar me dhëmbë ..."[2]

Nuk njihet që Ebu Bekri të ketë kundërshtuar ndonjë argument fetar me mendimin e tij. Nëse nga qielli gati sa s'bien gurë kur njeriu kundërshton fjalën e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) me fjalën e Ebu Bekrit dhe të Omerit, atëherë ç'mund të thuhet kur e kundërshton fjalën e tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) me të dikujt tjetër me pozitë më të ulët sesa ata? Dallimi është si largësia mes qiellit e tokës, ndërsa dënimi është akoma edhe më i afërt.

Kjo thënie e sahabit është paralajmërim për imitimin e verbër dhe fanatizmin pas *medhhebeve*, kur qëndrimet e tyre nuk janë mbi themele të shëndosha. Disa njerëz bëjnë gabime të turpshme, e kur u tregohet se çfarë ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), të përgjigjen: "Por në librin e filanit thuhet kështu e ashtu!" Njerëz të tillë duhet t'i frikësohen Allahut, i Cili thotë në Librin e Tij: "Atë Ditë, Ai do t'i thërrasë duke u thënë: 'Ç'përgjigje u dhatë të Dërguarve?" (Kasas, 65), e nuk thotë: Ç'përgjigje i dhatë filanit?

Për sa u përket dijetarëve, fjalët e të cilëve merren si argument, nëse është e sigurt se ata kanë synuar të mirën dhe të vërtetën, por kanë gabuar, atëherë lutemi për ta që Zoti t'i falë dhe mëshirojë, e nuk thuhet se ata janë të pagabueshëm, duke kundërshtuar me qëndrimin e tyre hadithet e Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

> Ahmed Ibn Hanbeli thotë: "Çuditem me ata që e njohin *sened*-in dhe saktësinë e tij, e përsëri shkojnë te mendimin e Sufjanit, ndërsa Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij (e të Dërguarit) nga ndonjë sprovë, që mund t'u vijë ose nga një dënim i dhembshëm, që mund t'i godasë." (Nur, 63). A e dini ç'është "sprova" në këtë ajet? Është "*shirk*-u", ndoshta ngaqë njeriu, kur refuzon ndonjë

[1] Ahmedi. Sipas Albanit hadithi është i dobët.
[2] Ahmedi, Ebu Daudi, Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

> thënie të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), mund t’i devijojë zemra, e pastaj të shkatërrohet.”[1]

– *“... Ahmed Ibn Hanbeli thotë: ‘Çuditem ...’* – Fjala “çudi” *(El-Axheb)*, në arabisht, përdoret me dy kuptime:

1. Me kuptimin e pëlqimit, siç është në hadithin e Aishes (radijallahu anha!): “Të Dërguarit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i pëlqente fillimi nga e djathta në mbathjen e këpucëve, në krehjen e flokëve (ose lyerjen e tyre), në pastrim dhe në të gjitha punët e tjera.”[2]

2. Me kuptimin e mosmiratimit, siç është në ajetin: “Ti çuditesh (pse ata s'të besojnë), ndërsa ata të përqeshin (pse çuditesh).” (Safat,12). Edhe në thënien e imam Ahmedit ka këtë kuptim.

– *“... që e njohin sened-in ...”* – Fjala “*sened*” këtu nënkupton transmetuesit e haditheve. Kësisoj shprehja do të thotë që ata njerëz e njohin saktësinë e hadithit, sepse njohin mirë transmetuesit e tij.

– *“... e përsëri shkojnë te mendimi i Sufjanit ...”* – Bëhet fjalë për Sufjan Theurin, i cili ka qenë dijetar me një *medhheb* të njohur, si dhe me pasues, por që nuk ekzistojnë më. Pra, ata kërkonin mendimin e Sufjanit, të dijetarit, dhe braktisnin hadithin e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

– *“... Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij (e të Dërguarit) nga ndonjë sprovë, që mund t’u vijë ose nga një dënim i dhembshëm, që mund t’i godasë. ...”* – Fjala në njëjës “urdhrin” është përmbledhëse, që do të thotë se nënkupton të gjithë urdhrat. Ndërsa fjalën “sprovë”, imam Ahmedi e ka komentuar si “shirk”. Atëherë, përfundimisht, paralajmërimi është me njërën nga dy të këqijat: ose me rënien në shirk ose me ndëshkim të dhembshëm.

> Adij Ibn Hatimi tregon: “E dëgjova njëherë të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të lexonte këtë ajet:

[1] Sjellë nga Ibn Bata në "El-Ibane El-Kubra".
[2] Buhariu, Muslimi.

> "Ata i bënë rabinët dhe murgjit e tyre si zota në vend të Allahut, si dhe Mesihun, birin e Merjemes, ndërkohë që janë urdhëruar të adhurojnë vetëm një Hyjni, përveç të Cilit nuk ka tjetër që meriton të adhurohet. I lartësuar qoftë Ai mbi gjithçka që ia shoqërojnë!" (Teube, 31). Unë i thashë: "Ne nuk i adhuronim ata!" Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) tha: "A nuk e bënin ata haram atë që e kishte lejuar Allahu, edhe ju, pas atyre e bënit haram? A nuk jua bënin të lejuar atë që Allahu kishte bërë haram, dhe ju gjithashtu e bënit të lejuar?" – "Po" – iu përgjigja unë. Ai tha: "Ky ishte adhurimi që ju u bënit atyre."[1]

– *"... Ata i bënë ..."* – Përemri "*ata*" u referohet të krishterëve, sepse çifutët nuk e konsideruan Isain, birin e Merjemes, si zot. Përkundrazi, ata pretenduan se ai qe fëmijë i një gruaje të përdalë dhe u përpoqën ta vrisnin, madje pandehën se e vranë.

Mundet që përemri t'u referohet edhe çifutëve, por duke theksuar të krishterët. Kjo është ajo që të shkon menjëherë në mendje, duke e parë bashkë me ajetin paraardhës.

– *"... rabinët dhe murgjit e tyre ..."* – Fjala "*rabin*" vjen nga njëjësi i fjalës arabe "*hibr*" që do të thotë: dijetar i madh. Ndërsa "murgj" është shumësi i fjalës "murg", që do të thotë: adhurues asket.

– *"... si zota në vend të Allahut ..."* – Pra, si ortakë me Allahun në ligjvënie, sepse ata ua bënin të lejuar atë që Allahu kishte ndaluar, dhe ndjekësit e tyre e quanin gjithashtu të lejuar; ata bënin të ndaluar atë që e kishte lejuar Allahu dhe ndjekësit e tyre e quanin gjithashtu të ndaluar.

– *"... si dhe Mesihun, birin e Merjemes ..."* – Kjo do të thotë se ata e konsideruan Isain si zot të tyre, bashkë me Allahun. Më poshtë Allahu thotë: "... ndërkohë që ata janë urdhëruar të adhurojnë vetëm një Zot". Adhurimi është përulësi dhe nënshtrim.

---

[1] Ahmedi dhe Tirmidhiu, i cili e ka konsideruar hadith të mirë. Sipas Albanit hadithi është i mirë.

– *"... vetëm një Hyjni ..."* – Ai është Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). "*Ilah*" (Hyjni), në arabisht, është Zoti që adhurohet dhe rrespektohet. Kuptimi i asaj fjale nuk është: Krijues, siç thonë disa *mutekelimun*-ë ose ndjekës të tyre, sepse – sipas tyre – kuptimi i shprehjes "*La ilahe il'All-llah*" do të ishte: nuk ka krijues tjetër veç Allahut. Ky nuk është teuhidi i kërkuar, se po të qe ashtu, idhujtarët, të cilët Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i luftoi, do të quheshin monoteistë, pasi ata e deklaronin se nuk ka krijues tjetër veç Allahut. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Pyeti: 'Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zoti i Arshit Madhështor?' Ata do të thonë: 'Allahu.'" (Mu'minun, 86-87).

– *" ... përveç të Cilit nuk ka tjetër që meriton të adhurohet. I lartësuar qoftë Ai mbi gjithçka që ia shoqërojnë (në adhurim)! ..."* – Fjala "lartësim" këtu nënkupton të qenit e Allahut i dëlirë nga çdo e metë. Nuk ka nevojë të thuhet: "i lartësuar qoftë nga përngjasimi me krijesat", sepse përngjasimi i Tij me krijesat është një e metë. Megjithatë, nëse e themi, e bëjmë për të qenë më të qartë, që të mos mendohet se krahasimi i Krijuesit me krijesën në përkryerje, është përkryerje. Atëherë, domethënia e shprehjes është: i lartësuar qoftë Allahu nga çdo gjë që nuk i përshtatet Atij, e metë qoftë ose ngjashmëri me krijesat.

Ndërsa: "mbi gjithçka që ia shoqërojnë!", do të thotë: gjithçka veç Tij, si për shembull, Isain, birin e Merjemes, rabinët apo murgjit. Allahu është i Lartësuar dhe larg nga çdo shoqërim dhe shoqërues.

Një shprehje e tillë është tregues i retorikës së Kuranit, sepse "mbi gjithçka", mund t'i referohet politeizmit si fenomen, ose shoqëruesve që i vënë Zotit. Të dyja kuptimet janë të sakta. Lejohet të pranohen dy kuptime njëherësh, nëse ato nuk janë kontradiktore.

– *"... Ne nuk i adhuronim ata ..."* – Pra, "nuk i adhuronim rabinët dhe murgjit, nuk bënim sexhde, as ruku, e as nuk bënim kurbane apo zotoheshim për ta". Ky kuptim është i saktë, nëse u referohet rabinëve dhe murgjve, siç thotë edhe hadithi, por nuk vlen nëse dikush e lidh me Isain (alejhi selam), i cili ishte Profet i Allahut dhe,

si i tillë, ai quante të lejuar atë që e kishte lejuar Allahu dhe e quante haram atë që e kishte bërë të tillë Allahu.

Disa janë përpjekur ta quajnë hadithin të dobët, për shkak të kësaj domethënieje, me gjithë dobësinë në senedin e tij. Hadithin e kanë konsideruar si të mirë Tirmidhiu, Albani dhe të tjerë. Mirëpo disa të tjerë e kanë quajtur të dobët.

Kur thoshte: "Ne nuk i adhuronim ata", Adij Ibn Hatimi e kishte fjalën për rabinët dhe murgjit, dhe jo për Isain (alejhi selam), sepse për Isain tashmë dihej se ata e adhuronin.

Allahu e ka filluar me ndalimin e hallallit, sepse ai është më i përhapur sesa lejimi i haramit, por gjithsesi, që të dyja veprat janë të ndaluara. Allahu thotë: "… Prandaj, mos thoni me gjuhën tuaj të rreme: "Kjo është hallall e kjo është haram", që kështu të trilloni gënjeshtra për Allahun …" (Nahl, 116).

– *"… Ky ishte adhurimi që ju u bënit atyre."* – Një kuptim i adhurimit është bindja. Kështu, bindja ndaj dikujt, është adhurim ndaj tij, nëse kundërshton Allahun, por nëse është në pajtim me urdhrat e Allahut, atëherë bindja ndaj dikujt tjetër nuk është adhurim për atë tjetrin. Nëse babai të urdhëron, për shembull, për faljen e namazit dhe ti e fal, kjo nuk do të thotë se ke adhuruar babain me bindjen tënde, por Allahun, sepse ti je bindur ndaj dikujt tjetër, duke qenë në përputhje me fenë e Allahut dhe zbatimi i urdhrit të tij është njëkohësisht edhe zbatim i urdhrit të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

Dobitë e hadithit

- Bindja është një lloj adhurimi, në rrethana të caktuara. Bindja ndaj dikujt, duke qenë në kundërshtim me fenë, është adhurim i atij që i bindesh; e nëse ajo pajtohet me fenë e Allahut, atëherë është adhurim i Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

- Pasimi i të diturve dhe adhuruesve, duke qenë në kundërshtim me fenë e Allahut, është konsiderim i tyre si zota.

Pasimi i dijetarëve dhe prijësve në lejimin e asaj që e ka ndaluar Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) ose e kundërta, bëhet në tri mënyra:

1. T'i pasosh ata, duke qenë i kënaqur me qëndrimin e tyre dhe duke urryer gjykimin e Allahut. Ky veprim është kufër dhe kush e

bën atë është qafir, sepse urren ligjin e Allahut, prandaj Allahu i zhduk veprat e tij. Asgjë veç kufrit nuk i asgjëson veprat, dhe çdokush që urren Shpalljen e Allahut, është qafir.

2. T'i pasosh ata, duke qenë i kënaqur me gjykimin e Allahut dhe duke e ditur se gjykimi i Allahut është më i miri për njerëzit dhe vendet, por zgjedh ndjekjen e tyre për shkak të dëshirës personale, si për shembull, për një vend pune. Kush e bën këtë nuk është qafir, por gjynahqar i madh, si të gjithë gjynahqarët e tjerët.

3. T'i pasosh ata me padije, duke menduar se ajo që thonë ata është ligji i Allahut. Këtu paraqiten dy raste:

a) Ke mundësi ta mësosh të vërtetën, por e ke lënë mbas dore. Në këtë rast, konsiderohesh gjynahqar, sepse Allahu ka urdhëruar që, kur nuk di, të pyesësh të diturit.

b) Të mos kesh dije dhe asnjë mundësi të mësosh, por i pason dhe i imiton dijetarët, duke menduar se ashtu është e vërteta. Në një rast të tillë, njeriu është i arsyetuar dhe pa përgjegjësi, pasi ashtu ai zbaton atë për të cilën është urdhëruar. Nga Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është përcjellë se: "Nëse dikush jep fetva pa dije, gjynahu do të rëndojë mbi atë që e dha fetvanë."[1] Nëse ne do të thoshim se ai është mëkatar për gabimin e tjetrit, kjo do të sillte vështirësi të mëdha, e kështu njerëzit nuk do t'i besonin askujt, për shkak të mundësisë së gabimit të tij.

Pyetje: Po pse të mos konsiderohen qafirë personat e grupit të dytë?

Përgjigje: Nëse do të thoshim se ata janë qafirë, atëherë rrjedhimisht do të quanim "qafir" çdo mëkatar që e njeh dhe e pranon ligjin dhe gjykimin e Allahut.

Shtojcë:

Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) u ka vënë tri emërtime atyre që nuk gjykojnë sipas Sheriatit të Tij:

1. "Kushdo që nuk gjykon sipas Shpalljes së Allahut, është qafir." (Maide, 44).

2. "Kushdo që nuk gjykon sipas Shpalljes së Allahut, është zullumqar (*dhalimun*)." (Maide, 45).

[1] Ahmedi dhe Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i mirë.

3. “Dhe kushdo që nuk gjykon me Shpalljen e Allahut, është i pabindur.” (Maide, 47).

Dijetarët kanë mendime të ndryshme për këtë çështje. Është thënë se të tria këto emërtime janë për jobesimtarët, sepse ata janë zullumqarë, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “... jobesimtarët janë zullumqarë.” (Bekare, 254). Ata janë edhe të pabindur, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala): “Ndërsa ata që nuk iu bindën Allahut vendbanimi i tyre do të jetë Zjarri..." (Sexhde, 20). Është thënë, gjithashtu, se emërtimet shënojnë kategori të ndryshme, të cilat gjykohen sipas rastit. Ky është qëndrimi më i saktë.

Njeriu bëhet qafir nëse plotëson njërin nga këto tri kushte:

1. Nëse beson lejimin e gjykimit jo me ligjin e Allahut. Argument është thënia e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “A mos kërkojnë ata gjykimin e *xhahilijetit*? ...” (Maide, 50). Çdo gjykim që është në kundërshtim me ligjet e Allahut, është gjykim i *xhahilijetit*. Ky është edhe mendimi i të gjithë dijetarëve muslimanë. Kush beson diçka të tillë, ka dalë nga feja, siç është, për shembull, ai që e quan të lejuar alkoolin apo imoralitetin, ose quan haram bukën apo qumështin.

2. Nëse beson se gjykimi me ligje të tjera është njëlloj si gjykimi me ligjet e Allahut.

3. Nëse beson se gjykimi me ligje të tjera është më i mirë se gjykimi me ligjet e Allahut, e dëshmuar kjo nga ajeti: “E kush është më i mirë në gjykim sesa Allahu, për njerëzit që besojnë bindshëm?” (Maide, 50). Ajeti nënkupton se gjykimi i Allahut është gjykimi më i mirë. Në një ajet tjetër thuhet: “A nuk është Allahu Gjykatësi më i drejtë?” (Tin, 8).

Atëherë, kush beson se gjykimi me ligje të tjera është si gjykimi me ligjet e Allahut, ose edhe më i mirë, është qafir, sepse është mohues i Kuranit.

Njeriu bëhet zullumqar kur, pavarësisht se beson që gjykimi me ligjin e Allahut është më i mirë dhe më i efektshëm për të gjithë popujt dhe vendet, dhe se zbatimi i tij është detyrë, atë, urrejtja ose smira për të pandehurin e shtyn të gjykojë jo sipas ligjit të Allahut.

Ndërsa “*fasik*”, i pabindur, njeriu është kur nuk gjykon sipas ligjit të Allahut, jo nga urrejtja për atë ligj dhe as për të dëmtuar ndonjë, por për shkak të dëshirës së tij, për shkak të interesit ndaj

të pandehurit. Për shembull, kur gjykon në favor të dikujt, për shkak të ryshfetit që përfiton, ose ngaqë është i afërt apo shok me të, por duke besuar se gjykimi i Allahut është më i larti dhe se zbatimi i tij është detyrë. Një person i tillë është i pabindur *(fasik)*, e gjithashtu është edhe zullumqar, por emërtimi "*fasik*" është më i përshtatshëm.

Nga ana tjetër, kush përcakton dispozita ligjore, duke njohur ligjet e Allahut dhe kundërshtimin që këto dispozita i bëjnë ligjeve të Tij, meqenëse ka zëvendësuar Sheriatin me këto ligje, ai është qafir. Ai i ka zgjedhur këto dispozita veç duke besuar se ato janë më të dobishme për njerëzit dhe vendet sesa ligji i Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Kur themi qafir, nënkuptojmë se kjo punë e çon atë në kufër.

Por personi që i ka vendosur këto ligje mund të jetë i justifikuar, për shembull, mund të jetë mashtruar, pasi i kanë thënë se ato nuk bien ndesh me Islamin, ose që janë "interesat e papërcaktuara" (*mesalihul murseleh*), ose që Islami i ka lënë ato çështje në dorë të njerëzve.

Ka disa dijetarë, të cilët edhe pse janë gabimtarë, thonë se çështjet e marrëdhënieve ndërnjerëzore, për shembull, nuk kanë lidhje me Sheriatin, por ato duhet të rregullohen sipas kërkesave të ekonomisë së çdo vendi. Kështu, nëse gjendja e kërkon që të hapen bankat me kamatë ose të vendosen taksat mbi njerëzit, sipas tyre nuk ka asgjë të keqe. Ky, patjetër, është një gabim i rëndë. Nëse ata janë dijetarë *muxhtehid*-ë,[1] Allahu i faltë, në të kundërt, ata janë në një rrezik të madh. Këtyre u përshtatet nofka "dijetarë të qeverisë" e jo "dijetarë të fesë".

Një nga parimet e padiskutueshme është se Sheriati ka ardhur për të rregulluar marrëdhëniet ndërmjet robit dhe Zotit të tij, e po kështu, edhe marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet njerëzve në kontrata, martesë, trashëgimi etj. Sheriati është i plotë në të gjitha aspektet. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "... Sot jua përsosa fenë tuaj ..." (Maideh, 3). E si mund të thuhet se marrëdhëniet ndërmjet njerëzve nuk kanë lidhje me Sheriatin, ndërkohë që ajeti më i gjatë në Kuran, ka zbritur në lidhje me to?! Sikur të mos ishin

[1] *Muxhtehid*, quhet dijetari që ka kapacitet shkencor dhe aftësi intelektuale të nxjerrë norma ligjore nga argumentet e Sheriatit.

normat e Sheriatit për marrëdhëniet e ndërsjella, njerëzit do të ishin shkatërruar.

Unë nuk them që të mos pranojmë asgjë nga mendimet e dijetarëve të fikhut, sepse ata mund t'ia qëllojnë të vërtetës ose mund të gabojnë, por është detyrë që të respektojmë gjithë ç'ka thënë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) dhe Pejgamberi i Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Nuk ka situatë në të cilat mund të ndodhen njerëzit, e që në Librin e Allahut dhe Sunetin e Profetit të Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) të mos ekzistojë zgjidhja e saj, por problemi është se sa mirë dhe drejt i njohim dhe i kuptojmë ne ato. Pra, problemi qëndron te mosnjohja dhe mosthellimi i njeriut në këto dy baza të diturisë. Nëse njeriut i jepet sukses në dituri dhe në kuptim, në përpjekjet për të arritur të vërtetën, patjetër që do ta arrijë atë, qoftë edhe në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "A nuk përsiatin ata mbi Kuranin?" (Nisa, 82); "Vallë, a nuk kanë medituar ata mbi Fjalën (Kuranin) ..." (Mu'minun, 68); "Ky është një Libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij ..." (Sad, 29); "... Ne ta zbritëm ty Librin (Kuranin), si shpjegim për çdo çështje ..." (Nahl, 89). Pra, çdo gjë e fesë dhe e dynjasë për të cilën njeriu ka nevojë, Kurani e ka sqaruar plotësisht.

Ai që krijon ligje të cilat kundërshtojnë Sheriatin, dhe pretendon se ato janë "interesa të papërcaktuara" (*mesalihul murseleh*), ka pretendim të rremë. "Interesat e papërcaktuara" janë të vlefshme nëse janë në përputhje me Sheriatin; në të kundërt, ato nuk janë më "interesa" dhe nuk kanë vlerë. Interesa janë ato që Sheriati i konsideron të tilla, e nëse ai i mohon, atëherë nuk janë interesa. Nga ana tjetër, çështjet për të cilat Sheriati ka heshtur, janë falje.

Shumë njerëz e kanë zgjeruar mjaft kornizën e "interesave të pakufizuara", duke futur në to disa vepra që janë të urryera, bidate etj., siç është, për shembull, festimi i Mevludit. Ata pretendojnë se kjo "festë" nxit vullnetin dhe devotshmërinë e njerëzve që e kanë harruar Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Por kjo është e papranueshme, sepse të gjithë muslimanët, në çdo namaz, dëshmojnë se Muhamedi është rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij si dhe dërgojnë salavate për të. Atij që nuk i ngjallet zemra me këtë, ndërkohë që falet para Zotit të tij, si mund t'i ngjallet zemra për një

orë, me vargje e poezi me përmbajtje plot gabime e ekzagjerime, të cilat vetë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka kundërshtuar?! Ky është dëm dhe jo dobi.

Është e vërtetë që *mesalihul murseleh* janë përcaktuar nga disa dijetarë të mëdhenj, e nuk ka dyshim se qëllimi i tyre ishte ndihma në fenë e Allahut dhe të Profetit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), por të tjerë njerëz e kanë shfrytëzuar këtë terren me një qëllim ndryshe, duke e tepruar me të.

Përfundimisht, “interesat e papërcaktuara” vlerësohen sipas kriterit të përputhshmërisë së tyre me Sheriatin: nëse pajtohen me të, pranohen, në të kundërt – siç ka thënë imam Maliku: “Çdokujt i merret the i kthehet fjala, me përjashtim të atij që ndodhet në këtë varr (varri i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).” Përveç tyre, ka edhe rregulla të tërësishme ligjore, prej të cilave merren dispozitat nënligjore.

Njeriu e ka për detyrë t’i frikësohet Zotit të tij në të gjitha gjykimet e të mos nxitohet t’u japë formë të prerë, veçanërisht kur kanë të bëjnë me *tekfir*-in,[1] ku disa fanatikë të rrëmbyer, e lëshojnë gjuhën pa u menduar dhe pa u matur. E themi këtë sepse, nëse dikush e quan një tjetër qafir, ndërkohë që ky i fundit në realitet nuk është i tillë, atëherë ai cilësim i kthehet të parit. Dhe dihet se, nëse një person gjykohet si qafir, ka mjaft pasoja të rënda: për shembull, gjaku dhe pasuria e tij bëhen të cenueshme, e shumë të tjera.

Nuk lejohet në asnjë mënyrë që ta cilësojmë një person të caktuar si qafir, derisa kushtet e këtij gjykimi të jenë plotësuar qartë. Gjithashtu, është detyrë që të mos kemi frikë të quajmë “qafirë” ata që Allahu dhe Pejgamberi i Tij i kanë quajtur të tillë, por duke pasur parasysh se duhet të bëjmë dallim mes gjykimit të përgjithshëm, si kategori, dhe gjykimit të veçantë, për njerëz konkretë.

Gjykimi i posaçëm, ndaj një personi konkret, duhet të plotësojë dy parakushte: së pari, sigurinë se vepra që ai ka bërë është vepër kufri; së dyti, plotësimi i kushteve të gjykimit ndaj tij, më i rëndësishmi prej të cilëve është që personi të ketë qenë i vetëdijshëm se vepra që ka kryer të bën jobesimtar. Nëse nuk e ka ditur këtë gjë, nuk konsiderohet qafir. Për këtë arsye, dijetarët

[1] *Tekfir*, është cilësimi i dikujt si qafir.

thonë se një kusht për zbatimin e dënimit penal, është se i akuzuari duhet të ketë qenë i vetëdijshëm që vepra e kryer ishte haram. Nëse ky rregull është për zbatimin e dënimit penal, atëherë në çështjen e *tekfir*-it duhet të jemi akoma më të matur e më të kujdesshëm.

Allahu thotë: "... në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të Dërguarve ..." (Nisa, 165); "Ne nuk dënojmë asnjë popull, para se të çojmë të Dërguar!" (Isra, 15); "Allahu kurrë nuk e çon në humbje një popull që më parë e ka udhëzuar në rrugë të drejtë, pa i bërë të njohur se prej çfarë duhet të ruhet..." (Teube, 115). Pra, duhet patjetër që në plotësimin e kushteve të mos ketë asnjë paqartësi. Nëse dikush, për shembull, bën një vepër kufri duke qenë i detyruar me forcë ose nga hutimi, ai nuk del nga feja, sipas fjalës së Allahut: "Kushdo që mohon Allahun, pas pranimit të besimit (do të dënohet ashpër), përveç atij që është i detyruar me forcë, ndërkohë që zemra e tij është plot besim." (Nahl, 106). Ndërsa, argument që edhe hutimi nuk e bën njeriun me përgjegjësi, është ngjarja me atë njeriun që e gjeti kafshën e vet në momentet e fundit dhe, gabimisht, nga gëzimi i madh, tha: "O Allah! Ti je robi im dhe unë jam Zoti Yt!"[1] Pra, ai nuk u mor në përgjegjësi për këtë gjë.

Dobitë e temës

- Komenti i ajetit të sures Nur.

"Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij (e të Dërguarit) nga ndonjë sprovë, që mund t'u vijë ose nga një dënim i dhembshëm, që mund t'i godasë."

- Komenti i ajetit të sures Teube.

"Ata i bënë rabinët dhe murgjit e tyre si zota në vend të Allahut, si dhe Mesihun, birin e Merjemes, ndërkohë që janë urdhëruar të

[1] Buhariu dhe Muslimi.

adhurojnë vetëm një Zot, përveç të Cilit nuk ka tjetër që meriton të adhurohet. I lartësuar qoftë Ai mbi gjithçka që ia shoqërojnë."

- Sqarimi më i hollësishëm i konceptit të adhurimit, - në hadithin e përcjellë - të cilin e mohoi Adiji

Adiji mohoj adhurimin e tyre duke menduar se adhurimi i tyre është nështrim ndaj tyre me bindje, përulje ndaj tyre me ruku, sexhde, zotim e tje. Por, Profeti ('alejhis–selam) sqaroi se kush ishte qëllimi për adhurimin e tyre, se ai është bindje ndaj tyre në lejimin e haramit dhe në ndalimin e hallallit.

- Shembulli që Ibn Abasi ka dhënë me Ebu Bekrin dhe Omerin, si dhe shembulli që ka dhënë Ahmedi me Sufjanin.

Përderisa fjala e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk mund të kundërshtohet me fjalën e Ebu Bekrit apo të Omerit, atëherë ç'mund të thuhet për kundërshtimin e fjalës së tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) me fjalët e të tjerëve?! Kjo është akoma më e rëndë dhe më e shëmtuar. Ndërsa imam Ahmedi e ka pasqyruar me Sufjan Eth Thorin. Ai e ka kundërshtuar atë që merr mendimin e tij duke lënë atë që vjen me zinxhirë të saktë transmetimi nga i Dërguari (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), duke u argumentuar me fjalën e Allahut: "Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij (e të Dërguarit) …".

- Njerëzit arritën deri aty sa adhurimin kushtuar murgjve e quajtën veprën më të mirë dhe mënyrë për shprehjen e dashurisë e dashamirësisë ndaj tyre, ndërsa adhurimin e rabinëve e quajtën dije dhe njohuri juridike (fikh). Pastaj situata ndryshoi përsëri, derisa po adhuroheshin në vend të Allahut, − me një kuptim tjetër, − edhe njerëz jo të mirë, madje edhe injorantë.

– *" Njerëzit arritën deri aty sa adhurimin kushtuar murgjve e*

quajtën veprën më të mirë …". − Kjo, pa dyshim, është më e rëndë sesa kundërshtimi i fjalës së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) me fjalën e Ebu Bekrit dhe Omerit (r.a.).

– *"… Pastaj situata ndryshoi përsëri, derisa po adhuroheshin në vend të Allahut, edhe njerëz jo të mirë, …."* – Që do të thotë se po u bëhej ruku dhe sexhde, i madhëronin si madhërohet Allahu dhe përshkruheshin me përshkrime që nuk i meritonin. Këtë dukuri e has te mjaft poetë, të cilët lavdërojnë e madhërojnë mbretër dhe pushtetarë, të cilët nuk janë kurrsesi në gradën e Ebu Bekrit dhe Omerit.

– *" … madje − me një kuptim tjetër − po adhuroheshin edhe injorantë …*". Kjo formë adhurimi bëhet duke iu bindur dhe ndjekur injorantët në fe, në ndalimin e asaj që Allahu e ka lejuar dhe lejimin e asaj që Ai e ka ndaluar. Kështu ndodh me disa sisteme apo ligje që janë në kundërshtim me Sheriatin, të cilat janë krijuar nga njerëz që nuk dinë asgjë nga feja.

Kështu ishte në kohën e autorit, po për kohën tonë ç'mund të thuhet?! Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), sipas hadithit të sjellë nga Buhariu dhe të treguar nga Enesi (r.a.), ka thënë: "Çdo periudhë kohore që kalojnë njerëzit ka për të qenë gjithnjë më e keqe se ajo e mëparshmja, derisa të takoni Zotin tuaj."[1] Po kështu, Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) u ka thënë sahabëve: "… ai që do të jetojë nga ju pas meje, do të shohë sprova të shumta …",[2] duke ditur se koha e sahabëve ishte më e afërt me udhëzimin sesa ajo e njerëzve më pas.

Në fakt, njerëzit nuk e ndiejnë ndryshimin, sepse ai është i ngadaltë, por sikur ndonjëri të largohej për një kohë të gjatë e të kthehej përsëri, do të shihte se ndryshimi është i madh e i neveritshëm, Allahu na ruajtë!

Ne duhet të jemi të kujdesshëm dhe duhet të dimë se Sheriati i Allahut duhet mbrojtur. Ne nuk duhet t'i bindemi askujt në ndalimin e asaj që Allahu e ka lejuar dhe në lejimin e asaj që Ai e ka ndaluar, çfarëdolloj pozite të ketë ai. Detyrë për ne është që të jemi

[1] Buhariu.
[2] Ebu Daudi, Tirmidhiu, Ibn Maxhja.

robër të Allahut, me përulje, nënshtrim dhe bindje.

Tema 39

> **Thënia e Allahut: "A nuk i ke parë ata që pretendojnë se e besojnë atë që të është shpallur ty dhe Profetëve të tjerë para teje? Ata kërkojnë gjykimin e zotave të rremë, ndërkohë që janë urdhëruar t'i mohojnë ata. Shejtani dëshiron që t'i nxjerrë ata krejtësisht nga Udha e Drejtë." (Nisa, 60)**

Kjo temë lidhet ngushtë me temën paraardhëse, e cila fliste për bindjen ndaj dijetarëve dhe prijësve në lejimin e asaj që e ka ndaluar Allahu dhe në ndalimin e asaj që e ka lejuar Ai. Kurse tema e tanishme flet për paralajmërimin që u bëhet atyre të cilët kërkojnë të gjykohen te dikush tjetër përveç Allahut dhe Profetit të Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

Autori (Allahu e mëshiroftë!) ka sjellë katër ajete kuranore në këtë temë. Ajeti i parë është ai që ndodhet në titull të temës.

– *"A nuk i ke parë …"*– Me pyetjen është për qëllim njoftimi dhe habia për gjendjen e tyre. Fjala i është drejtuar Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

– *"… ata që pretendojnë se e besojnë atë që të është shpallur ty dhe Profetëve të tjerë para teje?…"* – Nuk thuhet: "ata që besojnë", sepse ata nuk besuan, por e mëtuan diçka të tillë, si gënjeshtarë.

Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) iu shpall Kurani dhe

Suneti: "Allahu të ka zbritur ty Librin dhe Urtësinë ..." (Nisa, 113). Komentuesit thonë se "Urtësia" është "Suneti". Njerëzit, për të cilët flitet në ajet, pretendonin se e kishin besuar Shpalljen, por veprimet e tyre i përgënjeshtronin thëniet e tyre, duke qenë se ata kërkonin të gjykoheshin te zotat e rremë, e jo nga Allahu dhe Pejgamberi i Tij.

– *"... Ata kërkojnë gjykimin e zotave të rremë* (*tagut*) *..."* – Qëllimi këtu është për çdo gjykim që është në kundërshtim me gjykimin e Allahut dhe të Profetit të Tij dhe për çdo gjykatës që nuk gjykon sipas Shpalljes që Allahu i solli Pejgamberit të Tij.

Ndërsa përkufizimi i përgjithshëm i *tagut*-it është ai që ka dhënë Ibn Kajim el Xheuzije: "Tejkalimi i kufirit që bën njeriu ndaj atij që ndjek, adhuron ose i bindet." Më lart, në fillim të këtij libri është folur më gjerë për të.

– *"... ndërkohë që janë urdhëruar t'i mohojnë ata ...*" – Pra, Allahu ka urdhëruar qartë e prerë që të mohohen *tagut*-ët. Kush shkon të gjykohet tek ata, e bën me vetëdije, pasi të gjithë e dinë mirë këtë urdhër.

– *"... Shejtani dëshiron ...*" – Këtu flitet për shejtanët-njerëz dhe ata xhindë.

– *"... që t'i nxjerrë ata krejtësisht nga Udha e Drejtë."* – Domethënë në rrugë të gabuar, larg së vërtetës. Nuk është kusht që t'i nxjerrë përnjëherë tek e kota, sepse ai mund ta bëjë edhe gradualisht.

Allahu thotë: "Po kur u thuhet: 'Ejani tek ajo që ka zbritur Allahu dhe tek Pejgamberi i Tij', i sheh hipokritët se si largohen prej teje me neveri". (Nisa, 61).

"Po kur u thuhet atyre: 'Ejani tek ajo që ka zbritur Allahu dhe tek Pejgamberi i Tij'...". Pra njerëzit ftohen tek "ajo që ka zbritur Allahu", pra, te Kurani, "dhe tek Pejgamberi i Tij", pra te vetë Pejgamberi, kur ai qe gjallë, dhe te Suneti i tij, pas ai vdiq. Në ajet flitet për Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) kur ishte gjallë.

"... i sheh hipokritët se si largohen prej teje me neveri." Folja

“shoh” këtu nuk është me kuptimin e parë, të kapjes me sy të diçkaje, sepse në ajet thuhet: “Ejani …”, që do të thotë se ata nuk ishin aty të pranishëm. Kuptimi i “i sheh” është: “sikur t’i kesh parë”.

Emërtimi “hipokritët” është përdorur pasi në fillim janë përdorur përemrat zëvendësues “ata” dhe “atyre”, pra, jo ashtu siç ndodh zakonisht. Kjo ka disa arsye:

Së pari, është e kuptueshme që kush pretendon se beson e në të vërtetë nuk beson është hipokrit.

Së dyti, kush kërkon gjykim tjetër përveç atij të Allahut dhe Profetit të Tij, tregon që nuk është besimtar i vërtetë, por i rremë, sepse besimtari i vërtetë i nënshtrohet pa diskutim ligjit të Allahut.

Së treti, ndryshimi i stilit të zakonshëm të ligjërimit arrin të tërheqë më tepër vëmendjen e njeriut.

Allahu thotë: “Si do të jetë gjendja e tyre, kur t'i godasë fatkeqësia, për shkak të asaj që ata vetë kanë punuar, e të vijnë te ti duke u betuar në Allahun e duke thënë: ‘Ne kemi dashur vetëm mirësi dhe pajtim’?!” (Nisa, 62).

“Fatkeqësia”, në këtë ajet, mund të merret si fatkeqësi në fe, por edhe në çështje të kësaj bote, dhe nuk ka kontradiktë mes këtyre dy domethënieve. Fatkeqësi të kësaj bote janë, për shembull, varfëria, thatësira etj. Fatkeqësi fetare për ata qe kur Allahu bëri që Pejgamberi i Tij të fitonte epërsi kundër tyre. Kur e kuptuan këtë, atyre u hyri frika, prandaj shkuan tek ai e i thanë: “O Pejgamberi i Allahut, ne nuk kishim qëllim tjetër, veç mirësisë dhe pajtimit.”

“… për shkak të asaj që ata vetë kanë punuar …”. Pra, për shkak të veprave të këqija që kanë bërë.

“Ne kemi dashur vetëm mirësi dhe pajtim.” Pra: Deshëm vetëm mirësi për vete, që të shpëtonim nga demaskimi dhe turpi, si dhe pajtim ndërmjet besimtarëve dhe jobesimtarëve ose ndërmjet rrugës së kufrit dhe imanit, e kështu të ecnim me ju dhe me qafirët. Të tillë ishin hipokritët. Ata donin të “pajtonin” të dyja palët, sipas një mënyre të tyre.

Allahu thotë: “Këta janë ata që Allahu e di se ç’ka në zemrat e

tyre. Largohu prej tyre, këshilloji dhe thuaju fjalë që i prekin në zemër". (Nisa, 63)

Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) i frikëson ata duke u thënë se Ai ia dinte hipokrizinë, mashtrimin dhe tradhtinë që ata mbanin në zemër. Allahu është njohësi i të fshehtave: "Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç'i pëshpërit atij shpirti i vet ..." (Kaf, 16). Madje Allahu e njeh njeriun më mirë sesa njeriu veten: "... dhe ta dini se Allahu ndërhyn midis njeriut dhe zemrës së tij ..." (Enfal, 24). Ky është një fakt i njohur. Prandaj kur një beduin u pyet se si e kishte njohur Zotin, ai tha: "Nga ndryshimi i vendimeve dhe i dëshirave", që do të thotë se, shpesh, njeriu merr një vendim, e pastaj, pa e kuptuar, heq dorë, pa ndonjë shkak të qartë.

"Largohu prej tyre ...". Ky është nënçmimi më i madh.

"... këshilloji ...". Kuptimi është: Këshilloji dhe frikësoji ata, por pa qenë shqetësimi yt kryesor. Mos u tremb prej tyre, por zbato atë që e ke detyrë, duke i paralajmëruar ata, me qëllim që të mos kenë justifikim.

"... dhe thuaju fjalë që i prekin në zemër." Komentuesit kanë dhënë tri interpretime për këtë shprehje:

1. Thuaju fjalë prekëse, që lënë ndikim në zemrat e tyre.
2. Këshilloji ata në fshehtësi.
3. Thuaju fjalë që lidhen me gjendjen e tyre dhe që i prekin në zemër.

Ajeti i përmban të tria interpretimet, ndërmjet të cilëve nuk ka mospajtim, dhe dijetarët kanë thënë se kur një ajet përmban disa domethënie dhe ato nuk bien në kundërshtim me njëra-tjetrën, atëherë janë të gjitha të pranueshme.

Ligjërimi i efektshëm arrihet përmes këtyre elementëve:

1. Nëpërmjet sjelljes dhe paraqitjes së folësit. Kur ligjëronte Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), i skuqeshin sytë, e ngrinte zërin dhe nxehej a thua se po paralajmëronte për mbërritjen e një ushtrie armike, duke thënë: "armiku do të sulmojë në mëngjes, ose do tu sulmojë në mbrëmje[1]."[2]

[1] Pra, mënyra sesi Pejgamberi 'alejhis–selam paralajmëronte nga dënimi i Allahut ishte e ngjashme me paralajmërimin për afrimin e armikut.
[2] Muslimi.

2. Fjalët e ligjëruesit duhet të jenë të lidhura me njëra-tjetrën e të kufizuara vetëm në temën e diskutimit.

3. Fjalitë të jenë të sakta si nga ana e kuptimit, ashtu edhe nga ajo e ndërtimit.

Për ajetin e mësipërm, shejhu i Islamit Ibn Tejmije thotë: "Ky ajet i shkon për shtat plotësisht atyre që ndryshojnë dhe keqinterpretojnë Cilësitë e Allahut, sepse ata thonë që besojnë në Allahun dhe të Dërguarin e Tij, por kur i fton të shohin se çfarë ka sjellë Allahu dhe Pejgamberi i Tij, ata shmangen e varin turinjtë dhe thonë se ata i referohen dikujt tjetër. E kur u del në shesh e vërteta, thonë se nuk kishin qëllim tjetër, vetëm se mirësinë dhe pajtimin, si dhe gërshetimin e kuptimit logjik me atë të Sheriatit." ("*Fetaua Hameuije*").

> Allahu thotë: "Kur u thuhet: 'Mos sillni prishje në tokë!' - ata thonë: 'Ne bëjmë vetëm rregullime në tokë!'" (Bekare, 11)
> Ai thotë gjithashtu: "Mos sillni prishje në tokë, pasi është vënë rregulli ..." (Araf, 56)
> "A mos kërkojnë ata gjykimin e (kohës së) *xhahilijetit* ..." (Maide, 50)

– *"... Mos sillni prishje në tokë! ..."* – Prishja në tokë është dy llojesh:

1- Prishje fizike, materiale, si për shembull shembja e shtëpive, prishja e rrugëve etj.

2- Prishje shpirtërore, që bëhet me anë të gjynaheve, e kjo përbën shkatërrimin më të madh në tokë, siç thotë Allahu: "Prishja në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë "të shijojnë" pjesë nga ajo që e kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim)." (Rrum, 41). "Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vetë; por Ai fal shumë." (Shura, 30). "Sikur banorët e atyre qyteteve të kishin besuar dhe të ruheshin prej gjynaheve, Ne do t'u dërgonim bekime nga qielli dhe toka, por ata mohuan, prandaj i dënuam për atë që bënë." (Araf, 96). "Sikur ithtarët e Librit të besonin dhe të ruheshin nga të ndaluarat, Ne do t'ua mbulonin veprat e këqija dhe

do t'i shpinim në Kopshtet e Kënaqësisë (në Xhenet). Sikur ata t'i përmbaheshin Teuratit e Ungjillit dhe asaj që është shpallur nga Zoti i tyre (në Kuran), ata do të kishin marrë furnizim nga lart (reshje) dhe poshtë tyre (të mbjella)". (Maide, 65-66)

– *"... Ne bëjmë vetëm rregullime në tokë! ..."* – Ky pretendim i tyre është i rremë. Prandaj Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Jo! Në të vërtetë, janë pikërisht ata shkaktarët e çrregullimeve ...".

Lidhja e ajetit me temën është e qartë: mosgjykimi sipas ligjit të Allahu është një ndër shkaqet më të mëdha të prishjes në tokë.

– *"... Mos sillni prishje në tokë, pasi është vënë rregulli ..."* – Prishja është materiale dhe shpirtërore, siç u tha më lart.

Pjesë e çrregullimit është qëndrimi kundër thirrjes së dijetarëve, kundër thirrjes së selefëve, kundër atyre që ftojnë në gjykimin sipas Librit të Allahut dhe Sunetin të Profetit të Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

– *"... pasi është vënë rregulli ..."* − Ky është përforcim i qortimit. Përse të prishet ajo çfarë është e rregullt?! Kjo është kulmi i idiotësisë dhe i së keqes, më e keqe sesa prishja përpara rregullimit.

Lidhja e ajetit me temën është: gjykimi me ligjin e Allahu është rregullim, ndërsa mosgjykimi me të, është prishje.

– *"A mos kërkojnë ata gjykimin e xhahilijetit?..."* – Pyetja këtu është qortuese. Ajo përmban dy kuptime:

1- A mos kërkojnë gjykimin e kohës para Islamit? Pra, a mos duan ta kthejnë këtë umet në epokën e injorancës, me ato ligjet e famshme, si ai për devetë që nuk mileshin kurrë për dobi të njerëzve, por që qumështin e tyre ua blatonin idhujve; apo për devetë që nuk shfrytëzoheshin për punë, por liheshin të lira për idhujt e tyre, apo ligji që lejonte vrasjen e fëmijëve?!

2- A mos kërkojnë gjykime injorante, që nuk bazohen në dituri, njësoj si ato të injorancës para Islamit. Ky kuptim është edhe më përfshirës.

Cilësimi i të tilla gjykimeve si "*xhahile*" është poshtërim për ta. Çdo lloj gjykimi që bie ndesh me ligjin e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), është injorancë dhe mendjelehtësi: nëse bëhet duke pasur

dije nga Sheriati, është mendjelehtësi; nëse bëhet duke mos e njohur Sheriatin, atëherë është injorancë. Mendjelehtësi do të thotë të veprosh gabim nga mosvlerësimi, jo nga padituria. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Allahu është pranues i pendimit vetëm për ata që bëjnë ndonjë të keqe nga mendjelehtësia dhe pendohen shpejt ..." (Nisa, 17). Ndërsa ai që bën një të keqe nga injoranca, nuk ka mëkat, por e ka detyrë që të mësojë.

Allahu thotë: "E kush vë ligje më të mira sesa Allahu, për njerëzit që besojnë bindshëm?" – Pyetja ka kuptimin se askush nuk gjykon më mirë sesa Allahu. Kjo pyetje është edhe sfiduese, dhe me këtë interpretim ajo është më e goditur.

Ligjet e Allahut të Lartësuar të cilat përmenden në ajetin e porsapërmendur përfshijnë edhe ligjet e krijimit dhe të rregullimit të punëve të krijesave, edhe ligjet fetare.

Dikush mund të thotë se disa ligjësi të krijimit janë të dëmshme, si për shembull tërmetet, përmbytjet etj., por ne përgjigjemi se qëllimet finale të tyre janë të mira, prandaj edhe ato nëse gjykohen në tërësi janë të mira. Për shembull, prindi ndonjëherë godet fëmijën me qëllimin për ta edukuar, prandaj goditja në këtë rast quhet veprim i mirë, po kështu edhe Allahu i godet disa njerëz me ato fatkeqësi për t'i edukuar. Allahu thotë për vendbanimin, njerëzit e të cilit i shndërroi në majmunë të përbuzur: "Këtë dënim e bëmë paralajmërim për bashkëkohësit dhe për brezat e tyre pasardhës, si edhe një këshillë për ata që i frikësohen Allahut." (Bekare, 66). Mirësi të tilla nuk janë të qarta për këdo, prandaj dhe ajeti vijon: "... për njerëzit që besojnë bindshëm?"

Kurdo që shtohet besimi, rritet njohuria rreth mirësisë së gjykimeve të Allahut dhe kurdo që pakësohet besimi dhe bindja, shtohet injoranca për mirësitë e tyre. Prandaj dijetarët, ajetet që të tjerët nuk i kanë shumë të qarta, i kuptojnë plotësisht, pa asnjë problem. Kështu, besimin dhe bindjen ndaj Zotit mund t'i matim me shkallën e të kuptuarit të përsosmërisë së ligjeve të Allahut, si për krijimin, ashtu edhe për fenë.

Ajeti "E kush vë ligje më të mira sesa Allahu, për njerëzit që besojnë bindshëm?", përmban një lajm që në asnjë rast nuk mund të jetë i rremë dhe as nuk mund të anulohet. Me vullnetin e Vet, Allahu i ka udhëzuar besimtarët që ta kuptojnë të vërtetën, në ato

çështje që të tjerët i kanë të ngatërruara. Kështu, besimtarët arritën të harmonizojnë të gjitha tekstet, përfshi edhe ato që nuk janë fort të qarta, duke deklaruar kësisoj faktin se: "Të gjitha ato janë nga Zoti ynë ..." (Ali Imran, 7). Ata njohin mirësinë e vendimeve të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) dhe janë të vetëdijshëm se ato vendime janë më të mirat e më të dobishmet për njerëzit, për krijesat e tjera, për këtë botë dhe për botën tjetër, dhe nuk duan kurrsesi që t'i ndërrojnë ato me të tjera.

> Abdullah Ibn Omeri tregon se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Nuk beson askush nga ju[1], derisa dëshira e tij të pasojë atë që kam sjellë unë." (Imam Neveviu thotë që hadithi është i saktë, dhe që ai gjendet në librin "*El Huxhe*", me *sened* të saktë.) [2]

– *"... Nuk beson askush nga ju ..."* – Pra, nuk e ka besimin të plotë, por nëse nuk e pëlqen të gjithë kumtin hyjnor të Muhamedit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), atëherë nuk ke aspak besim. Kush urren Shpalljen e Allahut, është në kufër të madh dhe, për këtë shkak, i asgjësohen veprat që ka bërë: "Për shkak se ata urrejnë atë që ka shpallur Allahu, Ai i ka zhvlerësuar veprat e tyre." (Muhamed, 9).

– *"... derisa dëshira e tij të pasojë atë që kam sjellë unë."* – Dëshira nënkupton pëlqim, tërheqje e brendshme. Mesazhi i Muhamedit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ishte Kurani dhe Suneti. Nëse dëshira e njeriut e ndjek mesazhin që ka sjellë Muhamedi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), kjo do të thotë që ai të besojë dhe të zbatojë pa diskutim urdhrat dhe porositë e atij mesazhi.

Dije se dëshira, në të shumtën e rasteve, është përmendur në tekstet hyjnore me kuptim negativ, si prirje për humbje, e jo për udhëzim: "A e ke vënë re atë njeri që dëshirat e veta i mori për Zot ..." (Xhathijeh, 23); "... dhe lëshohen pas pasioneve të veta?" (Muhamed, 14). Ka edhe ajete të tjera që flasin për aspektin negativ

[1] Që do të thotë se nuk mund ta përsosi askush nga ju besimin e tij.
[2] Hadithi është te dyzet hadithet e imam En-Neveviut. Sipas Albanit zinxhiri i transmetimit të hadithit është i dobët.

të dëshirave të njeriut. Megjithatë, nëse dëshira ndjek mesazhin e Muhamedit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ajo është lavdërueshme, madje tregues i imanit të plotë.

Më lart thamë se kush beson se një ligj që nuk është i Allahut, është njëlloj si ligji i Allahut, ose është më i mirë, apo kush beson se lejohet që të gjykohesh me një ligj tjetër, përveç ligjit të Allahut, ai është jomusliman. Ndërsa, kush nuk ndjek atë që solli Pejgamberi ‘alejhis–selam, duke e urryer atë, ai është jomusliman; ndërsa kush nuk e urren atë, por i jep përparësi dashurisë së dynjasë, ky nuk është qafir, por e ka besimin të dobët.

Neveviu dhe të tjerë e kanë quajtur këtë hadith si të saktë, ndërsa një grup dijetarësh – njëri nga të cilët është Ibn Rexhebi në librin “*Xhami el Ulum ue el Hikem*” – e kanë quajtur të dobët, por kuptimi i tij gjithsesi është i saktë.

> Shabiu tregon: “Pati një mosmarrëveshje ndërmjet një munafiku dhe një çifuti. Çifuti tha: ‘Shkojmë për t’u gjykuar te Muhamedi, pasi e dinte se ai nuk pranon ryshfet.’ Munafiku tha: ‘Jo, shkojmë te çifuti!’, − pasi e dinte se ai merrte ryshfet. Së fundi, ranë dakord që të shkonin te një fallxhor në Xhuhejneh për t’u gjykuar. Atëherë zbriti ajeti: “A nuk i ke parë ata që pretendojnë se e besojnë atë që të është shpallur ty dhe Profetëve të tjerë para teje? Ata kërkojnë gjykimin e zotave të rremë, ndërkohë që janë urdhëruar t’i mohojnë ata. Shejtani dëshiron që t’i nxjerrë ata krejtësisht nga Udha e Drejtë.”” (Nisa, 60) [1]
>
> Thuhet gjithashtu se ky ajet ka zbritur kur dy burra patën një mosmarrëveshje. Njëri prej tyre tha që ta ngrinin këtë çështje te Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ndërsa tjetri tha që ta ngrinin te Kab Ibn Eshrefi. Pastaj shkuan tek Omeri dhe i treguan se si kishte ndodhur. Omeri e pyeti edhe njëherë atë që nuk kishte

[1] Ibn Xheriri dhe Uahidiu në "Esbabu nuzul". Hadithi është *"mursel"*, pra i dobët.

> qenë i kënaqur me Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) si gjykatës, nëse vërtetë ishte ashtu. Pasi ai e pohoi, Omeri e goditi me shpatë dhe e vrau.[1]

– *“Shabiu tregon …”* – Pra, në komentin e ajetit.

– *“… ndërmjet një munafiku …”* – Munafik është ai që shfaqet si musliman, por që fsheh në vete mosbesimin. Fjala “*munafik*” (hipokrit) vjen nga “*en nafika*”, që është vrima që një lloj brejtësi bën në tokë. Ai bën një vrimë nga e cila futet dhe një kanal nga i cili del. Kanalin dalës ai e gërmon deri afër sipërfaqes dhe, kur i ka mbetur vetëm pak, aq sa ka mundësi ta shtyjë dheun me kokë, ndalon. E kështu, nëse i bllokohet hyrja, ai del nga ky kanal.

– *“… dhe një çifuti …”* – Çifutët janë ata që pretendojnë se ndjekin fenë e Musait (alejhi selam). Fjala (në arabisht) “*jehud*” lidhet ose me fjalën kuranore “*hudna*”, e përdorur në ajetin 156 të sures Araf, ose me emrin e paraardhësit të tyre *Jehudha*, ku *dh*-ja në arabisht është kthyer në “*d*”.

– *“… te Muhamedi …”* – Pra, te Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ata nuk e kanë përshkruar si Pejgamberi i Allahut, sepse nuk besonin në Shpalljen e tij, duke mëtuar se Profeti i premtuar do të vinte më vonë.

– *“… dihet se ai nuk pranon ryshfet …”* – Ryshfet quhet pasuria që jepet për të arritur diçka. Dijetarët thonë se ryshfeti është i ndaluar vetëm kur njeriu kërkon të arrijë përmes tij diçka të padrejtë, ose që të shpëtojë nga e drejta. Ndërsa kur dikush e jep atë për të fituar të drejtën e tij të mohuar ose për të shpëtuar prej padrejtësisë, atëherë për dhënësin ryshfeti nuk është i ndaluar, por për marrësin mbetet haram.

– *“… Së fundi, ranë dakord që të shkonin te një fallxhor në Xhuhejneh për t’u gjykuar …”* – Me sa duket, ata kishin pasur

[1] Uahidij në "Esbabu en-nuzul" edhe Begaviu në "tefsir". Hadithi është i dobët.

mosmarrëveshje, pasi munafiku kishte refuzuar të gjykohej te Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

“Fallxhor” quhet ai që pretendon se di se ç’do të ndodhë në të ardhmen. Arabët kishin fallxhorë, të cilëve u shkonin shejtanë me lajme të marra nga qielli. Herë e gjenin se çfarë ndodhte, e herë gabonin. Kur ia qëllonin, pretendonin se njihnin të ardhmen. Arabët shkonin tek ata për t’u gjykuar. Atëherë, Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) zbriti ajetin: “A nuk i ke parë ata që pretendojnë se e besojnë atë që të është shpallur ty dhe Profetëve të tjerë para teje?...”

– *“Thuhet gjithashtu ...”* – Autori e ka nisur rrëfimin e variantit tjetër të ngjarjes në një formë që tregon dobësi të saktësisë, por në “*Tejsir el Aziz el Hamid*” përmendet se kjo ndodhi është përcjellë në rrugë të shumta. Ajo është histori e njohur dhe ka qarkulluar ndërmjet selefëve dhe brezave pasardhës, aq sa nuk ka nevojë për sened. Kësisoj, themi që dobësia e senedit nuk e cenon vërtetësinë e rrëfimit.

– *“... dy burra patën një mosmarrëveshje ...”* – Dy burrave nuk u janë përmendur emrat. Ata mund të kenë qenë besimtarë, mund të kenë qenë munafikë ose edhe të tjerë.

– *“... te Kab Ibn Eshrefi ...”* – Ky ka qenë një nga prijësit e fisit Benu Nadir.

– *“... Omeri e goditi me shpatë dhe e vrau.”* – Kjo ngjarje dhe ajo para saj, provojnë se kush nuk kënaqet me gjykimin e Profetit të Allahut, është qafir, prandaj duhet të dënohet me vdekje. Kjo qe arsyeja që Omeri (r.a.) e vrau atë.

Si e vrau Omeri, kur kjo çështje i takonte kryetarit të besimtarëve, i cili ishte Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)? Themi se, nga çka shihet, Omeri nuk e ka përmbajtur dot veten, për shkak të xhelozisë së madhe për fenë, pasi dihej që ajo vepër ishte dalje nga Islami. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Atë që ndërron fenë e tij, vriteni.”[1]

[1] Buhariu.

Dobitë e temës

- Nga shpjegimi i ajetit të sures Nisa' arrin të kuptosh fare qartë konceptin e *tagut*-it.

Ai është siç u trajtua më lart.

- Komenti i ajetit të sures Bekare: "Kur u thuhet: 'Mos sillni prishje në tokë!' - ata thonë: 'Ne bëjmë vetëm rregullime në tokë!'."

Ky ajet dëshmon se hipokrizia është shkatërrim në tokë, sepse ajeti flet për hipokritët. Fjala "prishje" i përfshin të gjitha mëkatet.

- Komenti i ajetit të sures Araf: "... Mos sillni prishje në tokë, pasi është vënë rregulli ...".

- Komenti i ajetit: "A mos kërkojnë ata gjykimin e *xhahilijetit*?..." [1].

---

[1] Sipas qëndrimit të sahabëve dhe dijetarëve të ehli sunetit gjykimi, qeverisja ose administrimi jo sipas ligjit të Sheriati nuk është në çdo rast, pa shkoqitje, kufër i madh apo shirk i madh, por ka raste që është kufër i madh dhe ka një rast kur është kufër i vogël. Për të pasur një përfytyrim më të qartë mbi këtë çështje po bëj më poshtë klasifikimin e rasteve në vija të përgjithshme:

1- Kur beson se nuk është detyrë gjykimi apo qeverisja me ligjin e Allahut, kur beson se lejohet gjykimi, qeverisja, apo ligji në kundërshtim me ligjin e Allahut, kur përgënjeshtron a mohon ligjin e Allahut, kur beson se ligji që bie në kundërshtim me ligjin e Allahut është më i mirë sesa ligji i Allahut, ose i barabartë me të, nëse beson se Sheriati Islam nuk është i plotë, se ligjet e tij nuk janë të përshtatshme për kohën apo se ato janë më të mira, por lejohen dhe të tjerat, kur beson se Sheriati Islam nuk përfshin rregullat e marrëdhënieve ndërnjerëzore dhe dënimet penale, kur zëvendëson një ligj të Sheriatit me një ligj tjetër, me pretendimin se ky ligji tjetër është ligj i Allahut, ligj i Sheriatit të shpallur nga Allahu apo ligj i fesë së Allahut; të gjitha këto janë kufër i madh.

2- Rasti kur lënia e ligji të Sheriatit në gjykim ose në qeverisje dhe zëvendësimi i tij me një ligj tjetër a vendosja e një ligji tjetër në vend të tij,

kryhet në një mënyrë të tillë që përmban a përbën pashmangmërisht besimin se lejohet gjykimi a qeverisje me ligjin tjetër që bie në kundërshtim me ligjin e Sheriatit ose përmban mungesën e pëlqimit dhe nështrimit të zemrës ndaj këtij ligji. Ky rast përmban a tregon në mënyrë të padiskutueshme se zemra nuk e ka bindjen në ligjin e Allahut (*koulul kalbi*) dhe as pëlqimin e nështrimin ndaj tij (*amelul kalbi*), ose se zemra nuk e pëlqen ligjin e Allahut dhe nuk është e nënshtruar ndaj këtij ligji (d.m.th.: zemrës i mungon *amelul kalbi* qoftë dhe sadopak*).* Pra, në këtë rast kemi të bëjmë me një veprim që në vetvete është kufër i madh, por ama ai është i tillë sepse përmban pashmangmërisht mungesën e plotë: ose të dy elementëve të imanit të zemrës: edhe të *kaulul kalbi* edhe të *amelul kalbi*, ose vetëm njërit prej tyre e që është *amelul kalbi*. Pra në këtë rast është e pamundur që njeriu të ketë ndopak iman në zemër tek ligji i Allahut. S'ka asnjë dyshim që njeriu në këtë rast nuk ka aspak iman në zemër. Veprimi në këtë rast nuk mund të ketë shpjegim tjetër apo mundësi tjetër veç këtij. Ky rast quhet kufër i madh që e nxjerr njeriun nga feja, edhe pse njeriu nuk e shpreh me gojë lejimin, ose mospranimin, ose mospëlqimin dhe mosnënshtrimin

3 - Kur merr vendime gjyqësore ose merr vendime dhe kryen veprime qeverisje në kundërshtim me ligjin e Sheriatit, duke qene i vetëdijshëm se veprimi është në kundërshtim me Sheriatin, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër duke besuar në detyrueshmërinë e gjykimit a qeverisjes me ligjin e Sheriatit, duke e parë veten si gjynahqarë dhe duke e pranuar se meriton dënim nga Allahu, në këtë rast veprimi është kufër i vogël, kufër që nuk e nxjerr njeriun nga feje. Ky veprim atëherë është gjynah i madh, por jo kufër që e nxjerr njeriun nga feja. Për veprimin në kundërshtim me ligjin e Sheriatit në këtë rast njeriun e shtyn dëshira e nefsit (*el heva*), por jo mungesa e bindjes në obligueshmërinë e gjykimit dhe qeversijes me ligjin e Sheriatit apo mungesa e pëlqimit dhe nënshtrimit ndaj këtij ligji. Muslimanin mund ta nxisë për një veprim të tillë, përshembull: ryshfeti, lidhja farefisnore ose shoqëria me palën e favorizuar, armiqësia apo inati ndaj një pale, hakmarrja, apo ndonjë interes tjetër dynjaje. Në ndryshim nga rasti i dytë, veprimi i gjyqtarit ose qeveritarit në këtë rast nuk mund të quhet kufër i madh përveç nëse shpreh lejimin ose pëlqimin e tij, sepse është mundësia ta ketë kryer nga dëshira e nefsit si një gjynah dhe jo nga mosbesimi në detyrueshmërinë e ligjit të Allahut apo mospëlqimi dhe mosnënshtrimi ndaj tij.

Ibn Xheriri sjell me sened të saktë se Ibn Abasi për shpjegimin e ajetit: "Kushdo që nuk qeveris e nuk gjykon sipas Shpalljes së Allahut, është kafir", ka thënë: "Kjo punë i quhet kufër, por jo kufër në Allahun, melaiket e Tij, librat e Tij dhe të Dërguarit e Tij". Albani thotë se sendi i kësaj dëshime është i saktë. Hakimi në Mustedrek shënon se Ibn Abasi në shpjegimin e këtij ajeti ka thënë: "Nuk flitet këtu për kufrin që mendojnë ata (e ka fjalën për havarixhët). Ky nuk është kufër që e nxjerr njeriun nga feja, por kufër nën gradën e kufrit (të madh). Hakimi thotë se isnadi është i saktë. Edhe Dhehebiu pajtohet me vlerësimin e tij. Sipas shejh Albanit senedi është sipas kushtit të Buhariut dhe Muslimit. Ibn Xheriri sjell nga Ali Ibn Ebi Talha se Ibn Abasi ka thënë: "Kush mohon atë që ka shpallur Allahu, bën kufër, ndërsa kush e pranon dhe nuk gjykon me të, ai është zullumqar (dhalim) dhe i pabindur (fasik)". Albani thotë: "Ibn Ebi Talha nuk ka dëgjuar prej Ibn Abasit, por transmetimi i tij është i

Më parë u sqarua se qëllimi me gjykimin e xhahilietit është çdo gjë që kundërshton sheriatin. Ai i atribuohet xhahilietit me qëllim që të jetë i neveritshëm si dhe për të treguar shëmtin e tij dhe, se ai është bazuar në injorancë e humbje.

- Thënia e Shabiut në lidhje me shkakun e zbritjes së ajetit të parë.

- Shpjegimi i besimit të vërtetë dhe atij të rremë.

Besimi i vërtetë bën të domosdoshëm nënshtrimin e plotë dhe dorëzimin ndaj gjykimit të Allahut dhe Profetit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ndërsa besimi i rremë është e kundërta e tij.

- Mësimi që nxirret nga ngjarja e Omerit (r.a.) me munafikun.

Omeri e quajti faktin që munafiku i bëri bisht parashtrimit të çështjes për gjykim te Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) si shkak të mjaftueshëm për lejimin e derdhjes së gjakut të tij, ngase kishte dalë nga feja. Ai mori guximin ta vriste, sepse nga xhelozia e madhe nuk e përmbajti dot veten.

---

mirë, duke marrë parasyshë dëshmitë përforcuese”. Ibn Xheriri shënon se Atau Ibn Ebi Rabah në shpjegimin e tri ajeteve thotë: “Është fjala për kufër nën gradën e kufrit që e nxjerr njeriun nga feja, për mosbindje (fisk) nën mosbindjen që e nxjerr njeriun nga feja dhe për zullum nën zullumin që e nxjerr njeriun nga feja”. Sipas Albanit senedi është i saktë. Ibn Xheriri gjithashtu sjell se Tavusi në shpjegimin e ajetit: “Kushdo që nuk qeveris e nuk gjykon sipas Shpalljes së Allahut, është kafir” [el Maide: 44], ka thënë: “Nuk është kufër që e nxjerr njeriun nga feja”. Albani thotë se Isnadi është i saktë. Ataja dhe Tavusu janë dijetarët të mëdhenj tefsiri. Ata e kanë marrë tefsirin nga Ibn Abasi. Ibn Tejmije thotë: “Ibn Abasi dhe të tjerë prej selefëve, në shpjegimin e fjalës së Allahut: “Kush nuk qeveris a nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu, ai është kafir” … “ai është i padrejtë”… “ai është pabindur”, kanë thënë: “Ky është kufër nën kufrin që e nxjerr njeriun nga feja, fisk (mosbindje) nën mosbindjen që e nxjerr njeriun nga feja dhe padrejtësi nën padrejtësinë që e nxjerr njeriun nga feja. Këtë gjë e ka përmendur dhe Ahmedi, Buhariu dhe të tjerë veç tyre” [Mexhmuul Fetava].

- Askush nuk e arrin besimin e plotë, derisa dëshira e tij të pasojë atë që ka sjellë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Tema 40

Gjykimi mbi mohuesin e emrave dhe atributeve të Allahut.[1]

Mohimi në këtë fushë është dy llojesh:

1- Mohim me karakter përgënjeshtrimi, i cili padyshim është kufër. Nëse dikush mohon një emër ose një cilësi të Allahut që përmendet në Kuran ose Sunet – si për shembull, të thotë se Allahu nuk ka dorë, Allahu nuk është ngritur mbi Fronin e Tij, ose nuk ka sy – një person i tillë është qafir, sipas mendimit të përbashkët të muslimanëve, sepse mohimi i kumtit të Allahut dhe Profetit të Tij, të nxjerr nga feja.

2- Mohimi me karakter interpretimi *(te'vili)*. Personi nuk e mohon përshkrimin, por e interpreton, duke i ndryshuar kuptimin e drejtpërdrejtë. Ky interpretim është dy llojesh:

a) Interpretim që rrjedh prej kuptimeve në gjuhën arabe.[2] Nëse

---

[1] Këtu autori flet për gjykimin që jepet mbi atë që mohon ndonjë cilësi apo ndonjë emër të Zotit, se a shpëton apo jo. Duke qenë se besimi tek *emrat dhe cilësitë* e Zotit është pjesë e Teuhidit, besimit në një Zot, autori bën të ditur se besimi në to është detyrë. Në mësimet e mëparshme kemi sqaruar se Teuhidi ndahet në tre lloje: *Teuhid rrububije*, *Teuhid i emrave dhe cilësive* dhe *Teuhidi i adhurimit*. Nëpërmjet besimit në dy llojet e para të teuhidit, arrihet tek lloji i treti, pasi Teuhidi në adhurim është qëllimi dhe urtësia e krijimit dhe urdhërimit. Meqenëse tri llojet e teudidit janë të bashkëlidhura, sqarimi i teuhidit të emrave dhe cilësive është më se i përshtatshëm. (Marrë nga "Tejsir el Aziz el Hamid".

[2] D.m.th. interpretimi që i kanë bërë fjalës, të jetë një ndër variantet e kuptimit të saj në gjuhën arabe, thënë me fjalë të tjera: të ketë një farë lidhjeje gjuhësore ndërmjet fjalës dhe interpretimit që i kanë bërë, qoftë

është i tillë, nuk e bën të detyrueshme daljen nga feja.

b) Interpretim që nuk gjen shpjegim në gjuhën arabe. Në këtë rast është kufër, sepse bëhet mohim i vërtetë, i pa arsyetuar, si për shembull, të thuash se kuptimi i fragmentit të ajetit: "… lundronte nën Sytë Tanë", (Kamer, 14) është: "… lundronte në tokat Tona." Ai që e thotë këtë është qafir, sepse e ka mohuar krejtësisht kuptimin e ajetit. Një shembull tjetër: kush thotë, për fjalën e Allahut: "… përkundrazi, të dyja Duart e Tij janë të hapura …" (Maide, 64), se qëllimi me "dy Duart" janë qiejt dhe toka, është qafir, sepse nuk gjen shpjegim në gjuhën arabe e as në fe. Por nëse dikush thotë se "Dora" nënkupton begatinë ose fuqinë, nuk ka bërë kufër, sepse fjala "dorë" në gjuhën arabe e përmban edhe kuptime të tilla.

Ka pasur mendime të ndryshme në lidhje me rrënjën e fjalës *"ism"* (emër). Është thënë se vjen nga fjala "*es sumu*" (ngrihet), sepse emri e ngre, e dallon të emërtuarin. Është thënë, gjithashtu, se vjen nga fjala "*es simetu*" (shenjë), sepse ai është shenjë për të emërtuarin. Qëndrimi më i saktë është se "*ism*" rrjedh nga të dyja këto fjalë.

Tema flet për emrat dhe atributet e Allahut. Ndryshimi ndërmjet emrit dhe atributit të Allahut, qëndron në faktin se emri është fjala me të cilën quhet Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), kurse atribut është fjala ose grup fjalësh me të cilat cilësohet Allahu.

Në studimin e emrave të Allahut, duhet të kemi parasysh disa rregulla kryesore:

1. Emrat e Allahut janë njëkohësisht shenjues dhe atribute.

Pra, ata nuk janë thjesht emra. Si emra, ata tregojnë Qenien e Allahut, duke e dalluar Atë nga të tjerët, por ata kanë edhe domethëniet e tyre, e si të tillë ata shërbejnë si fjalë përshkruese të Zotit, si atribute të Tij.

Kësisoj, emrat e Zotit nuk janë si emrat e njerëzve. Dikush mund ta quajë djalin e vet *Ali* (i Lartë) ose *Muhamed* (i Lavdëruar), por këta emra nuk kanë domosdo lidhje me cilësitë reale të fëmijës, i cili mund të quhet Ali, mirëpo në realitet mund të jetë ndër njerëzit më të ulët, ose mund të quhet *Abdullah* (rob i Allahut), por mund të jetë njeriu më mohues i Allahut.

---

edhe të largët.

Ndërsa domethënia e një emri të Allahut tregon një atribut real të Tij. Allahu quhet edhe *El Alij* (i Larti), dhe ky emër tregon se Ai dhe atributet e Tij janë vërtet të larta; Ai quhet *El Aziz* (i Plotfuqishmi), që do të thotë se Ai është vërtet Fuqiplotë. Emri *El Hakim* (i Urti) tregon se Allahu gjykon me drejtësi dhe urtësi, e kështu me radhë.

Emrat i shprehin atributet e Zotit në tre mënyra:

1. Me anë të kuptimit që përputhet me të tërë domethënien e emrit (*mutabaka*).

2. Me anë të një pjese të domethënies që përmban vetë emri. Ky është *kuptimi i përfshirë* (*tedamun*).

3. Me anë të kuptimit që rrjedh pashmangshmërisht nga emri, të cilin në fakt nuk e përmban vetë domethënia e emrit, por është një rrjedhim i domosdoshëm i tij. Ky quhet nënkuptimi i pashmangshëm (*iltizam*).

Shembull: Emri *El Khalik* (Krijuesi), duke marrë parasysh atë që përfshinë, shënon veças qenien e Allahut dhe veças atributin e krijimit. Ndërsa, duke marrë parasysh kuptimin që përputhet me të tërë domethënien shënon njëherësh edhe qenien e Allahut, edhe atributin e krijimit. Dhe së fundi, në mënyrë të pashmangshme nënkupton edhe dijen e fuqinë e Tij, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Allahu është Ai, që ka krijuar shtatë qiej dhe po aq toka. Urdhrat e Tij zbresin përmes tyre, që ju ta dini se Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë dhe se Ai përfshin gjithçka në diturinë e Tij." (Talak, 12). Ai na mëson se, meqenëse Ai ka krijuar qiejt dhe i tokën, kjo tregon se ai është i Plotfuqishëm dhe, gjithashtu, i Ditur, sepse ky krijim i madh ka nevojë patjetër për dituri, pasi ai që nuk di, nuk ka se si të krijojë diçka që nuk e di.

2. Emrat e Allahut janë njëkohësisht sinonimikë dhe polisemikë.

Sinonimikë janë emrat e ndryshëm që kanë të njëjtin kuptim, ndërsa polisemikë janë emrat e ndryshëm që kanë kuptime të ndryshme.

Të gjithë emrat e Allahut, si shenjues, janë sinonimikë, sepse ata emërtojnë të gjithë të njëjtën qenie, Allahun. *Es Semi* (Gjithëshikuesi), *El Basir* (Gjithëdëgjuesi), *El Aziz* (i Plotfuqishmi), *El Hakim* (i Urti), të gjithë këta janë emra të një qenieje të vetme, që

është Zoti.

Kurse në aspektin e domethënieve që ata kanë, janë polisemikë, sepse, për shembull domethënia e emrit *El Hakim* ndryshon nga domethënia e *Es Semi* apo e emri tjetër *El Basir*, e kështu me radhë.

3. Numri i Emrave të Allahut nuk është i kufizuar.

Këtë e dëshmon hadithi i përcjellë nga Abdullah Ibn Mesudi, ku Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë:

"Nëse ndonjërin e kap ndonjë brengë, pikëllim apo vështirësi dhe ai thotë: 'O Allah, unë jam robi Yt, biri i robit Tënd dhe biri i robëreshës Tënde! Unë jam në dorën Tënde dhe në të drejtën time zbatohet gjykimi Yt. Caktimi Yt për mua është i gjithi i drejtë. Të lus Ty me çdo emër që Ti ke, me të cilin e ke quajtur Veten Tënde, që e ke zbritur në Librin Tënd, që ia ke mësuar ndonjërës nga krijesat e Tua ose që *e ke ruajtur në dijen Tënde të fshehtë, që ndodhet tek Ti*!...".[1]

Emrat që Allahu i ka ruajtur në *gajb*, asnjë nga krijesat e Tij nuk mund t'i dijë, dhe e panjohura nuk mund të kufizohet.

Ndërsa hadithi që thotë: "Me të vërtetë Allahu ka nëntëdhjetë e nëntë emra, të cilët, kush i mëson përmendësh, ka për të hyrë në Xhenet."[2] - nuk tregon se Allahu ka gjithsej 99 emra, por nëse njeriu i mëson ato nëntëdhjetë e nëntë emra, duke i kuptuar dhe duke punuar me ta, do të futet në Xhenet. Për shembull, dikush thotë: "Kam njëqind dërhemë, të cilët i kam bërë gati për t'i dhënë sadaka në rrugë të Allahut." Kjo nuk do të thotë se ai nuk ka dërhemë të tjerë, veç tyre, por kuptimi është thjesht se këta njëqind dërhemë i ka përgatitur për këtë gjë.

4. Çdo emër i Allahut tregon edhe për qenien e Allahut, edhe për atributin që përmban.

Siç u përmend më lart, emrat e Allahut tregojnë edhe qenien e Tij

---

[1] Ahmedi, Ibn Hibani dhe Hakimi. Sipas Albanit hadithi është i saktë. Ndërsa pjesa tjetër e hadithit është: "... Bëje Kuranin e Madhëruar pranverën e zemrës sime dhe dritën e gjoksit tim, të tillë që të më largojë brengën, mërzitjen dhe vështirësinë time!', Allahu ka për t'ia zhdukur brengën, mërzitjen dhe vështirësinë e tij, dhe ka për t'ia zëvendësuar ato me gëzim e lumturi."

[2] Buhariu dhe Muslimi.

edhe atributet që përmbajnë. Prandaj, e kemi detyrë t'i besojmë si emra të Zotit dhe të besojmë edhe atributet që përmbajnë këto emra. Por përveç kësaj kemi detyrë të besojmë edhe në gjurmën, efektin dhe veprimin për cilat tregon atributi, nëse emri është kalimtarë. Për shembull, besojmë se *Es-Semi'* – Gjithëdëgjuesi është një prej emrave të Allahut, besojmë në atributin që përmban ky emër dhe gjithashtu besojmë edhe në veprim apo rrjedhimin e këtij atributi, që është fakti se Allahu dëgjon, sikurse thotë Allahu i Lartësuar: "Allahu i dëgjoi fjalët e asaj, që diskutoi me ty (Muhamed) për burrin e vet dhe iu ankua Atij. Allahu e dëgjoi bisedën tuaj, sepse Ai është Dëgjues dhe Shikues." (Muxhadele, 1)

E nëse emri është jokalimtarë, që nuk jep rrjedhim apo pasojë, si: *El Adhim* – I Madhërueshmi, *El Haj* – i Gjalli, i Përjetshmi, në këtë rast pohojmë emrin dhe atributin që përmban, pasi emri nuk ka ndonjë rrjedhim.

5. Emrat e Allahut, si ndërtime fonetike janë veç fjalë, ndërsa si shenjues ata tregojnë Allahun.

Nëse një emër të Allahut e shohim si bashkim tingujsh, ai është thjesht një fjalë, dhe jo Allahu, e nëse e shohim si njësi kuptimore, themi se ai tregon Allahun.

Shembull: Shohim një fjali: "Allahu është Ai që ka krijuar qiejt dhe tokën." Emri "Allahu", si bashkim i tingujve A-ll-a-h-u është veç një fjalë, dhe nuk janë këta tinguj që kanë krijuar qiejt dhe tokën.

Le të shohim një shembull tjetër: Të vjen një urdhër me shkrim, që thotë: "Rrihe Zejdin!". Nëse ti rreh fjalën "Zejdin" të shkruar në letër, nuk e ke zbatuar urdhrin, sepse urdhri synon të shenjuarin me atë emër, personin që e ka emrin Zejd, dhe jo germat.

Ndërsa në studimin e atributeve të Allahut duhet të kemi parasysh rregullat e mëposhtme:

1. Atributet e Allahut janë:
   a) *Dhatije* (veti të kurdohershme, të përhershme të qenies së Allahut).
   b) *Fi'lije* (veprat e Zotit).
   c*) Khaberije* (cilësitë që vërtetohen veçse me lajmet e Kuranit dhe të Sunetit).

Atributet *dhatije* janë veti të përhershme të Allahut, me të cilat Ai ka qenë dhe do të jetë vazhdimisht i cilësuar, siç janë: Dëgjues, Shikues etj.

Atributet *fi'lije* janë aktet dhe veprimet e Allahut që varen nga dëshira e Tij: nëse Ai dëshiron, i vë në veprim dhe nëse nuk dëshiron, nuk i vë në veprim, siç është ngritja e Tij mbi Fron dhe zbritja e Tij në qiellin e dynjasë.

Të folurit, si proces që realizohet, është cilësi *fi'lije,* sepse varet nga dëshira e Allahut, por si aftësi është atribut *dhati*-j i Allahut. I tillë është edhe atributi i të krijuarit.

Atributet *khaberije* janë nocione, që në rrafshin njerëzor kuptohen si përshkrime të pjesëve përbërëse të një qenieje, por kur flasin për Allahun, nuk duhet të kuptohen si të tilla, por thjesht duhen pranuar si nocione përshkruese të Allahut, ashtu siç janë pohuar në Kuran dhe Sunet. Të tilla janë, për shembull, Fytyra e Zotit, Syri i Zotit, Kërciri apo Dora e Tij. Atributet *Khaberije* vërtetohen dhe pohohen veçse me lajmet e Kuranit dhe të Sunetit, pasi nuk mund t'i kapë logjika e njeriut, ndaj dhe janë quajtur *khaberije*, që do thotë se mbështeten veçse në lajmet e Kuranit dhe të Sunetit.

2. Atributet e Zotit janë më shumë në numër sesa emrat e Tij, sepse çdo emër i Tij përmban një cilësi, por jo çdo cilësi është edhe emër i Tij.

Ka shumë atribute të Allahut, që nuk janë emra të Tij, për shembull, Allahu flet, por nuk quhet Folës, Allahu dëshiron, por nuk quhet Dëshirues.

3. Çdo atribut me të cilin Allahu ka përshkruar veten e Tij, është i vërtetë, por Ato janë larg ngjasimeve, larg dhënies formë dhe përshkrimit njerëzor të mënyrës së tyre.

Allahu thotë: "Asgjë nuk i shëmbëllen Atij dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi." (Shura, 11); "Andaj, mos krahasoni asnjë me Allahun! Në të vërtetë Allahu di, ndërsa ju nuk dini." (Nahl, 74).

Ajo që mohohet në Kuran dhe në Sunet është ngjashmëria dhe

krahasimi i Allahut me Krijesat, por ama kjo nuk do të thotë se Allahu nuk ndan asnjë farë koncepti të përbashkët me ekzistencat e tjera, sepse ndërmjet dy qenieve ekzistuese ka patjetër diçka të përbashkët, edhe pse ka secila prej tyre të veçantën e saj. Për shembull, "jeta" është një atribut që i pohohet Krijuesit dhe krijesave, e në këtë atribut ka diçka të përbashkët ndërmjet tyre, por jeta e Krijuesit është në përshtatje me Krijuesin dhe jeta e krijesave është në përshtatje me krijesat. Kështu, e përbashkëta është se secili prej tyre jeton, ndërsa pakrahasueshmëria qëndron në faktin se realiteti i jetës së Krijuesit ndryshon nga realiteti i jetës së krijesës.

Disa njerëz duke mos pranuar asnjëfarë përbashkësie mes Krijuesit dhe krijesave, kanë arritur deri aty, sa kanë mohuar edhe ato cilësi që Allahu ia ka pohuar Vetvetes.

Ndërsa dhënia formë dhe përshkrimi i mënyrës se si janë atributet e Allahut nuk lejohen. Ne duhet ta lartësojmë Allahun nga të tilla gjëra. Kush i jep formë ose përshkruan mënyrën se si është një nga cilësitë e Allahut, është gënjeshtar dhe mëkatar. Gënjeshtar, sepse ka thënë diçka që nuk e di, dhe mëkatar sepse ka bërë diçka që Allahu e ka ndaluar, në ajetet: "Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dije..." (Isra, 36); "Thuaj: 'Me të vërtetë, 'Zoti im ka ndaluar vetëm veprat e pahijshme, qofshin të hapëta ose të fshehta ..." dhe më tej vazhdon: "... dhe (ka ndaluar) të thoni për Allahun atë që nuk e dini." (Araf, 33). Arsyeja është se kurrë nuk mund të arrihet të mësohet forma reale e atributit të Zotit ose mënyra se si është ai, siç thotë Allahu i Lartësuar: "... Ai di çka para tyre dhe çka pas tyre, kurse ata nuk mund ta ngërthejnë Atë me dije" (Ta Ha, 110); "Shikimet (se si është Ai) nuk mund ta arrijnë Atë, ndërkohë që Ai i arrin shikimet e të gjithëve ..." (En'am, 103). Ky gjykim është i njëjtë, si për rastin kur njeriu e shpreh me gjuhë, ashtu edhe kur e përshkruan me gjeste.

Imam Maliku (Allahu e mëshiroftë!) kur është pyetur për mënyrën e ngritjes së Allahut mbi Fron, ka thënë: "Mënyra se si, është e panjohur, ndërsa pyetja rreth saj është bidat." Megjithatë, duhet të dimë se fakti që ne nuk e njohim mënyrën apo formën, nuk do të thotë se ato nuk kanë mënyrë dhe formë. Atributet e Allahut kanë një mënyrë dhe formë, por ne nuk i njohim ato. Kështu ngritja e

Allahut mbi Fron, zbritja e Tij, Fytyra, Syri dhe Dora e Tij e kanë një formë, por ne nuk e dimë atë. Ka ndryshim të madh ndërmjet pohimit të një forme të caktuar, qoftë kjo edhe një imazh në mendje, dhe besimit se ato cilësi e kanë një formë të tyre, të panjohur për ne, besim të cilin e kemi detyrë.

Nëse bëhet pyetja se si mund të besohet që diçka ka formë, ndërsa ne nuk e dimë atë, përgjigjemi se kjo është krejtësisht reale. Për një kështjellë që nuk e kemi parë kurrë, për shembull, ne jemi të sigurt se ajo ka një formë, por derisa ta shohim vetë ose dikush të na e përshkruajë atë, për ne ajo formë mbetet e panjohur.

> Allahu thotë: "… ata nuk e besojnë Mëshirëplotin. Thuaj: 'Ai është Zoti im, s'ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij. Tek Ai mbështetem dhe tek Ai kthehem'!" (Rrad, 30)

– *"... ata ..."* – Pra, idhujtarët kurejshë.

– *"... nuk e besojnë Mëshirëplotin ..."* – Kuptimi është që ata mohonin emrin dhe jo të emërtuarin, sepse në realitet ata e pohonin ekzistencën e Tij, siç thotë Allahu: "Nëse ti (o Muhamed) i pyet ata (idhujtarët e Mekës): 'Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?', me siguri që do të thonë: 'Allahu!'..." (Llukman, 25).

Në hadithin e Suhejl Ibn Amrit, tregohet se kur Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) po shkruante marrëveshjen e paqes në Hudejbije, i tha shkruesit: "Shkruaj: '*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!*'." Ai ia ktheu: "Për Zotin, unë nuk e di se kush është Mëshirëploti, prandaj shkruaj "*Me emrin tënd, o Allah!*"."[1] Ky është një shembull, që tregon se shprehja në ajet ka për qëllim emrin dhe jo të emërtuarin.

Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Thuaj: 'Thirrni Allahun ose thirrni Mëshirëplotin, me cilindo emri që ta thirrni ju Atë, Ai ka emrat më të bukur..." (Isra, 110) – Pra: lutjuni me cilindo nga emrat e Tij, Ai ka emrat më të bukur. Të gjithë emrat e Tij janë më të bukurit, prandaj luteni Atë me cilin të dëshironi. Ky ajet ishte për të

[1] Buhariu.

kundërshtuar kurejshët.

Ajeti që po analizojmë tregon se kush mohon një nga emrat e Allahut, ka bërë kufër: "... ata nuk e besojnë Mëshirëplotin ...". Kjo, sepse kush e bën këtë, ka mohuar Allahun dhe Profetin e Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Kjo është edhe lidhja e ajetit me çështjen në fjalë.

– *"... s'ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij ..."* – Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij, sepse të adhuruar pa të drejtë ka shumë. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Kjo është kështu, sepse Allahu është i Vërteti, ndërsa gjithçka që lusin përveç Tij është e pavërteta ..." (Lukman, 30)

– *"... Tek Ai mbështetem ..."* – Kjo do të thotë: "vetëm Atij i mbështetem", sepse vendosja e fjalëve "tek Ai" para foljes "mbështetem", në arabisht, tregon kufizimin e këtij veprimi vetëm tek ai objektiv. Për mbështetjen te Zoti është folur më lart.

– *"... dhe tek Ai kthehem."* – Ky është pendimi tek Allahu, kalimi nga mëkati te bindja. Pranimi i pendimit ka pesë kushte:

1. Të jetë me sinqeritet për Allahun (Subhanehu ue Te'Ala), pa u shtyrë nga respektimi apo favorizimi i dikujt apo diçkaje tjetër.
2. Të jetë në kohën e duhur, që do të thotë: para lindjes së diellit nga perëndimi dhe para ardhjes së vdekjes.
3. Të ndjesh keqardhje për atë që ka kaluar, duke dëshiruar që të mos kishte ndodhur kurrë.
4. Pastrimi nga pasojat e atij gjynahu. Sipas kësaj, kur gjynahu ka qenë padrejtësi ndaj krijesave, duhet patjetër t'ua kompensosh atë padrejtësi atyre ose t'u kërkosh që të të falin.
5. Vendosmëria për të mos u kthyer më te gjynahu.

Kur pendesa bëhet para Zotit, ajo është adhurim, ndërsa kur pendohesh para të tjerëve, nuk është adhurim. Njëherë, kur Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) shkoi tek Aishja, pa atje një jastëk të vizatuar me figura frymorësh, prandaj qëndroi te dera e nuk po futej brenda. Aishja tha: "Pendohem tek Allahu dhe

Pejgamberi i Tij! Ç'gjynah kam bërë!"[1]. Me fjalën pendim *(teube)* këtu ajo nuk ka pasur për qëllim teube adhurimi, sepse pendimi i tillë nuk mund të bëhet tek i Dërguari i Allahut apo tek ndonjë krijesë tjetër, por veçse tek Allahu. Atëherë, me këtë fjalë ajo nënkuptonte thjeshtë një kthim. Shembull tjetër, është kur fëmija, pasi ka marrë dënimin nga prindi për ndonjë prapësi që ka bërë, i thotë të atit: "Më fal! Jam penduar!"

> Në "*Sahih*-un" e Buhariut gjendet dëshmia se Aliu (r.a.) ka thënë: "Tregojuni njerëzve gjërat që i kuptojnë. A dëshironi ju që ata të mohojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij?"

– *"Tregojuni njerëzve gjërat që i kuptojnë ..."*– Kuptimi është: Thuajuni fjalë që mund t'i kuptojnë, me qëllim që të mos sprovohen. Në lidhje me këtë, përcillet se Ibn Mesudi ka thënë: "Nëse ti u flet njerëzve me fjalë që ata nuk arrijnë t'i perceptojnë, ato bëhen provë për disa prej tyre."[2]. Prandaj, është urtësi në thirrje që njerëzve të mos u thuash gjëra që ata s'i kapin dot, por t'i ftosh me kujdes, derisa të jenë të përqendruar.

T'u flasësh ashtu si kuptojnë, nuk do të thotë që t'u tregosh gjëra që i kanë ditur më parë, domethënë për gjëra që ata nuk kanë nevojë.

– *"A dëshironi ju që ata të mohojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij?"* - Pyetja është retorike, pra i dihet përgjigjja. Nëse ti u tregon në një mënyrë të pakuptueshme për ata se çfarë ka thënë Allahu dhe Pejgamberi i Tij, ata mund t'i quajnë ato fjalë si broçkulla. Kështu ata, në një mënyrë të tërthortë, kanë mohuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij.

Lind pyetja: A duhet të heqim dorë nga gjërat që njerëzit nuk arrijnë t'i perceptojnë, edhe nëse ata kanë nevojë për to? Jo, nuk duhet të heqim dorë, por duhet t'u flasim pak nga pak, derisa të bëhemi të kuptueshëm dhe ata ta pranojnë. Për shembull, njerëzit

[1] Buhariu.
[2] Muslimi.

nuk e njohin një sunet, madje e kanë të vështirë ta pranojnë, sepse e shohin si veprim negativ. Atëherë ne, pasi ua kemi shpjeguar, e zbatojmë vetë atë sunet, në mënyrë që për ta të bëhet më e thjeshtë dhe e kuptueshme.

Nga kjo thënie e sahabit mësojmë se sa e rëndësishme është urtësia dhe mençuria gjatë thirrjes në fenë e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Thirrësi duhet të ketë gjithmonë parasysh nivelin e njerëzve që fton, duke i dhënë çdonjërit pozitën që meriton.

Lidhja e këtij citimi me temën tonë është e qartë, sepse ndonjëherë njerëzit e thjeshtë nuk arrijnë t'i kuptojnë disa atribute të Allahut. Mundet që kur ua hap të tilla çështje, të ndikosh negativisht tek ata. Për shembull, është hadithi që flet për zbritjen e Allahut në qiellin e dynjasë[1], megjithëse Ai është lart mbi Fronin e Tij. Nëse i thua një njeriu të rëndomtë se Allahu zbret në qiellin e dynjasë, megjithëse është lart mbi Fron, ndoshta ai e kupton se, kur Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) zbret, qiejt ndodhen përmbi Të dhe Froni mbetet bosh. Atëherë duhet patjetër që të shpjegosh në një mënyrë të thjeshtë, aq sa kupton ai tjetri, se Allahu zbret me një mënyrë që nuk i përngjan zbritjes së krijesave, duke qenë gjithnjë lart mbi Fronin e Tij, dhe zbret për shkak të mirësisë dhe mëshirës së Tij të plotë, për të thënë: "Kush më lutet Mua, që t'i përgjigjem atij...". Njeriut të thjeshtë i mjafton që të kapë kuptimin e përgjithshëm dhe qëllimin e mirë të kësaj zbritjeje të Allahut në atë orë të caktuar të natës.

> Abdurrezaku përcjell nga Mamer Ibn Taus, ky nga i ati, e ky nga Ibn Abasi (r.a.), se ky i fundit ka parë një burrë që u drodh, në shenjë kundërshtimi, kur dëgjoi një hadith nga Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) për atributet e Allahut. Atëherë Ibn Abasi ka thënë: "Çfarë frike kanë këta?! Pranojnë me lehtësi të qartën e plotë (të Kuranit), dhe shkatërrohen kur flitet për jo plotësisht të qartën"[2].

– *"... ka parë një burrë që u drodh ..."* – Burrit nuk i është

[1] Buhariu dhe Muslimi.
[2] Abdurrezaku dhe Ibn Ebi Asim në "Es Suneh".

përmendur emri. Po kështu, edhe mënyra se si iu fol, nuk është sqaruar, por kjo nuk është e rëndësishme këtu. Burri u drodh në shenjë mohimi, jo nga droja për Allahun. Ky është problem i madh, sepse kur njeriut i vjen kumt i saktë nga Allahu dhe Pejgamberi i Tij, duhet që ta pranojë dhe besojë atë, ashtu si dijetarët e thelluar, edhe nëse nuk e ka dëgjuar apo paramenduar më parë.

– *"...Çfarë frike kanë këta?! ..."* – Pra, si kanë frikë nga pranimi i cilësive që Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) i ka pohuar për Veten e Tij apo i ka pohuar për Të Pejgamberi i Tij. Kjo sjellje u shkon për shtat plotësisht mohuesve dhe shtrembëruesve të atributeve të Allahut.

Sipas një varianti tjetër, fjala që është përkthyer "frikë", mund të ketë kuptimin "ndarje", e kësisoj kuptimi është: Si nuk bëjnë ndarje ndërmjet të vërtetës dhe të pavërtetës? Për shkak të argumenteve jo krejtësisht të qarta, ata mohuan edhe ato që janë plotësisht të qarta.

Po kështu, kuptimi mund të jetë: Çfarë i trembi ata, që i bëri të besonin në argumentet krejtësisht të qarta dhe të shkatërrohen për ato jo krejtësisht të qarta?!

– *"... Pranojnë me lehtësi të qartën e plotë (muhkem) ..."* – Flitet për ajetet plotësisht të qarta të Kuranit.

– *"... dhe shkatërrohen kur flitet për jo plotësisht të qartën (muteshabih)."* – Këtu flitet për ajetet jo plotësisht të qarta të Kuranit.

"Muhkem" do të thotë "kumt i qartë dhe i dukshëm", ndërsa "*muteshabih*" do të thotë "kumt që mbart një kuptim të fshehtë" të cilin njerëzit nuk e dinë. Ky është kuptimi i tyre kur përmenden bashkë në një tekst.

Kur nocioni "*muhkem*" paraqitet në tekst i veçuar, pa "*muteshabih*", kuptimi i saj është "i përkryer, i kulluar, i përsosur", siç thotë Allahu: "Të kulluara janë fjalët e Zotit tënd në vërtetësi dhe drejtësi ..." (En'am, 115), ose: "Këto janë ajetet e Librit të përkryer." (Junus, 1); "... Ky është një libër, me ajete të përsosura ..." (Hud, 1).

E nëse "*muteshabih*" paraqitet si nocioni i veçuar, pa "*muhkem*", atëherë kuptimi i tij është: "të ngjashëm në përkryerjen e tyre, që

vërtetojnë njëri-tjetrin dhe nuk përplasen", si në ajetin: "Allahu zbriti Fjalën më të shkëlqyer, një Libër, pjesët e të cilit i përngjasin njëra-tjetrës në mirësi e vërtetësi, shpesh të përsëritura ..." (Zumer, 23).

Paqartësia e një kuptimi është dy llojesh: paqartësi për të gjithë dhe paqartësi për një pjesë. Kështu, lloji i parë është i paqartë për cilindo, ndërsa i dyti është i paqartë për disa njerëz dhe jo për disa të tjerë.

Allahu thotë: "... Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di veç Allahu. Dhe ata që janë thelluar në dije, thonë: "Ne i besojmë ...."" (Ali Imran, 7). Në këtë ajet, në fjalinë e parë, nëse ndalesa e madhe (ku vendoset pika) gjatë leximit bëhet pas fjalës: "Allahu", atëherë themi se ajeti flet për ato kumte hyjnore që janë të paqarta për të gjithë njerëzit. Nga ana tjetër, nëse e lexon ndryshe ajetin, duke mos bërë ndalesë tek fjala "Allahu", por duke e vazhduar leximin dhe duke i bashkuar dy fjalitë në një të vetme, atëherë themi se ajeti flet për kumtet hyjnore që janë të paqarta për një pjesë njerëzish, jo për të gjithë. Ajeti do të lexohej kështu: "Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di veç Allahu dhe ata që janë thelluar në dije."

Këto dy mënyra leximi janë hasur te selefët, me këto interpretime:

1. Ndalesa bëhet në fjalën "Allahu". Këtë mendim ka dhënë shumica e selefëve. Sipas tyre, ajeti flet për kumtet që janë të paqarta për të gjithë njerëzit, dhe që i di veç Allahu, si për shembull, realiteti i cilësive të Allahut apo realiteti i mirësive të Xhenetit dhe i ndëshkimit të Xhehenemit. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë për begatitë e Xhenetit: "Askush nuk di se çfarë kënaqësish janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për veprat e mira që kanë bërë." (Sexhde, 17). Pra, nuk dihet se si janë ato. Ibn Abasi ka thënë: "Në Xhenet nuk ka asgjë nga gjërat e kësaj bote, përveç emrave të tyre."[1]

2. Leximi i ajetit vazhdon në këtë mënyrë: "... Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di veç Allahu dhe ata që janë thelluar në dije." Sipas këtij interpretimi, ajeti flet për kumtet që janë të paqarta për një pjesë njerëzish, jo për të gjithë. Ato janë të qarta për të thelluarit në dije, ndërsa për të tjerët janë *muteshabih*. Për shembull, është përcjellë se Ibn Abasi ka thënë: "Unë jam një nga *të thelluarit në*

[1] Ibn Hazmi. Sipas Albanit dëshmia është e vërtetë.

dije, që i dinë kuptimet e fshehta të tij (Kuranit).” Këtë ai nuk e ka bërë për t’u lavdëruar, por për ta mësuar njerëzit se në Librin e Allahut nuk ka asgjë që nuk i dihet kuptimi. Të gjitha kuptimet e Kuranit janë të qarta, por disa pjesë të tij nuk janë krejtësisht të qarta për disa njerëz.

Edhe të thelluarit në dije kanë mospërputhje në lidhje me disa kuptime të Kuranit, sepse disa nga këta dijetarë nuk i kanë krejt të qarta disa kuptime. Nëse mospërputhja nuk ka të bëjë me thelbin e kuptimit, atëherë pa dyshim që njëri prej tyre ka të drejtë, e nëse kemi të bëjmë me variante të të njëjtit kuptim, pa u ndryshuar bërthama e tij, atëherë ato janë të pranueshme të gjitha bashkë.

Disa dijetarë − vazhdon argumentimi sipas qëndrimit të dytë − mendojnë se Kurani përmban kumte, kuptimi i të cilave nuk mund të arrihet nga askush, si për shembull ajetet që flasin për atributet e Allahut. Ky është gabim i madh, pasi nuk është e logjikshme që Allahu të thoshte: “Ky është një Libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për t’u thelluar mbi ajetet e tij …” (Sad, 29), e nga kjo të përjashtonte ajetet që përmbajnë atributet e Tij, të cilat janë më të vyera dhe më të shumta se ajetet që përmbajnë rregulla. Kështu, çështjet më të vlefshme në Kuran, do të ishin të paqarta, ndërsa ajeti: “… për t’u thelluar mbi ajetet e tij …”, do të ishte vetëm për ajetet që përmbajnë rregulla. Kjo është e papranueshme logjikisht.

Kurani kuptohet i plotë. Është e pamundur që ky umet, që nga Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e deri tek i fundit, të mos i kuptojë domethëniet e Kuranit. Në të kundërt, del se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), Ebu Bekri, Omeri dhe të gjithë sahabët, i kanë lexuar ajetet mbi atributet e Zotit, por thjesht si fjalë e grumbuj tingujsh, pa i kapur domethëniet e tyre.

E vërteta është se në Kuran nuk ka asgjë të paqartë, për të gjithë njerëzit, por problemi qëndron te njerëzit, nga të cilët, disa nuk arrijnë t’i kapin domethëniet e tij ose i kuptojnë ato në mënyrë të gabuar. Mirëpo, për sa i përket çështjeve të *gajb*-it, për të cilat na ka treguar Allahu, ato janë të pakuptueshme dhe të panjohura realisht për të gjithë njerëzit.

> Kurejshët, kur dëgjuan të Dërguarin e Allahut të

përmendë emrin Err-Rrahman "Mëshirëploti", e mohuan Atë. Atëherë Allahu zbriti ajetin: "... ata nuk e besojnë Mëshirëplotin ...".[1]

Historia e këtij rrëfimi nis kështu: Suhejl Ibn Amri ishte njëri prej përfaqësuesve të kurejshëve, që ishte dërguar për të biseduar me të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) në Hudejbije, për marrëveshjen e paqes. Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) urdhëroi të shkruhej në krye të traktatit: "Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!" Suhejli iu përgjigj: "Për Zotin, unë nuk e di se kush është Err-Rrahman (Mëshirëploti). Ne nuk njohim tjetër Rrahman, veç atij të Jemames." Kështu, ata mohuan emrin dhe jo të emërtuarin, e atëherë Allahu zbriti ajetin: "... ata nuk e besojnë Mëshirëplotin ...", i cili provon se kush mohon një nga emrat e Allahut të pohuar në Kuran, është qafir.

– *"Kurejshët, kur dëgjuan ..."* – Me sa duket – dhe Allahu është më i Ditur – këtu nuk flitet për të gjithë idhujtarët e Mekës, por për një pjesë të tyre. Mirëpo nëse e pohon një pjesë e tyre dhe i gjithë populli nuk i kundërshton, atëherë e meritojnë që t'u atribuohet të gjithëve. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), në kohën e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), u atribuoi çifutëve atë që kishin bërë të parët e tyre në kohën e Musait (alejhi salam): "Kujtoni (o jehud) kur morëm besën tuaj dhe ngritëm mbi ju malin Tur, duke thënë: 'Merreni seriozisht atë që ju dhamë ...'." (Bekare, 63). Kjo ngjarje nuk kishte ndodhur në kohën e atyre që iu është drejtuar fjala.

Dobitë e temës

- Nëse mohon ndonjë prej emrave dhe atributeve të Zotit, besimi zhduket.

Kjo është shpjeguar më lart.

[1] Ibn Xheriri.

- Komenti i ajetit të sures Rrad.

"... ata nuk e besojnë Mëshirëplotin ...".

- Nuk duhet t'i flasësh dikujt gjëra që ai nuk i kupton.

Ky rregull nuk merret në formë absolute, siç u sqarua më lart.

- Arsyeja pse nuk duhet t'i flitet dikujt gjëra që nuk i kupton është se ato mund ta çojnë atë në mohimin e Allahut dhe Profetit të Tij, qoftë edhe pa qëllim.

Kur logjika e tij nuk e percepton atë që i thuhet. Ai mohon sepse i duket e pamundur. Kjo ndodh shpesh me disa njerëz, sidomos kur flitet për ngjarjet e Ditës së Kijametit. Për shembull, Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Vërtet toka, në Ditën e Kijametit, do të jetë si një bukë e vetme, dhe i Gjithëpushtetshmi do ta kthejë me dorën e Tij, ashtu siç ktheni ju bukën tuaj."[1]. Po kështu, Ura e Siratit do të jetë më e mprehtë se shpata dhe më e hollë se fija e flokut, e shumë përshkrime të tjera. Nëse ia thua ndonjë njeriu të rëndomtë, ai mund t'i mohojë, prandaj është detyrë që t'i sqarohen pak nga pak, ashtu siç mësojmë fëmijët, derisa të kuptojë.

Kur autori thotë: "...pa qëllim...", nënkupton: edhe nëse kundërshtuesi nuk ka për qëllim mohimin e Allahut dhe të Profetit të Tij. Por nëse mohon përshkrime të tilla që kanë lidhje me Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai ka mohuar fjalën e Allahut dhe të Profetit të Tij.

- Ibn Abasi çuditet me ata që nuk i pranojnë ato gjëra që përmenden në tekstet që duken të paqarta. Kjo gjë i çon ata në shkatërrim.

Kjo është thënia e tij: "Çfarë frike kanë këta?! Pranojnë me lehtësi

[1] Buhariu dhe Muslimi.

e kënaqësi të qartën e plotë, dhe shkatërrohen kur flitet për jo plotësisht të qartën.

Tema 41

Thënia e Allahut: "Ata i njohin mirësitë e Allahut, por pastaj i mohojnë, se shumica e tyre janë jobesimtarë". (Nahl, 83)

– *"Ata i njohin ..."* – Ata, me logjikën e tyre, e kuptojnë faktin se mirësitë vijnë nga Allahu.

– *"... por pastaj i mohojnë ..."* – Ata ia mohojnë Allahut, duke bërë sikur e harrojnë që Ai është Dhënësi i vërtetë e duke i lidhur mirësitë veç me shkaqet e tyre, shkaqe të cilat i ka krijuar Allahu. Kësisoj, ata nuk mohojnë mirësitë, për shembull, nuk thonë se nuk bie shi, ose nuk kemi fëmijë ose nuk kemi shëndet, por mohimi qëndron në faktin se ia atribuojnë dikujt tjetër veç Allahut, duke harruar kështu Atë që ka krijuar shkaqet prej të cilave vijnë këto mirësi.

– *"... se shumica e tyre janë jobesimtarë ...."* – Kjo do të thotë se shumica e atyre që e njohin faktin se mirësitë vijnë nga Allahu, e mohojnë këtë, ose janë mohues të Allahut të Lartësuar. Këta janë shumica, por ndër ta ka njerëz të rëndomtë që nuk i njohin faktet dhe nuk i kuptojnë.

Kjo temë lidhet me teuhidin, sepse ai që ia përshkruan dikujt tjetër begatitë e Krijuesit, e ka bërë Krijuesin ortak me një tjetër në çështjet e krijimit dhe furnizimit në këtë botë. Duke ia përshkruar ato mirësi shkaqeve, duke i konsideruar shkaqet si burues të mirëfilltë, ata nuk falënderojnë atë që duhet falënderuar, Allahun.

Mosfalënderimi i Allahut është gjithashtu në kundërshtim me teuhidin, sepse Krijuesi, Begatuesi, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) duhet të falënderohet, e kështu bëhet lidhja e teuhidit rrububije (veprave unike të Allahut) me teuhidin në adhurimin kushtuar Allahut, sepse falënderimi është adhurim. T'ia njohësh mirësinë një shkaku, duke menduar atë si veprues në vetvete, është mangësi në teuhidin rrububije (veprave të Allahut), ndërsa mosfalënderimi është mangësi në teuhidin e adhurimit.

> Muxhahidi, në komentin e ajetit, thotë – kuptimisht – se ai flet për atë burrë që shprehet në një mënyrë të tillë: "Kjo është pasuria ime, të cilën e kam trashëguar nga prindërit e mi[1]".
> Sipas Aun Ibn Abdullahit, ajeti bën fjalë për ata që thonë: "Sikur të mos ishte filani, nuk do të ishte kështu".
> Ndërsa sipas Ibn Kutejbes, ajeti flet për ata që thonë: "Kjo e mirë erdhi me ndërmjetësimin e zotave tanë".

Muxhahidi është i pari i komentuesve të Kuranit tek tabiinët. Ai ia ka paraqitur Kuranin Ibn Abasit dhe në çdo ajet qëndronte dhe e pyeste për komentin e tij. Sufjan Theuri ka thënë: "Nëse të vjen komenti i Muxhahidit, ai mjafton, por megjithatë nuk është i pagabueshëm."

Dijetari nuk e ka sjellë komentin e Muxhahidit shprehimisht, por vetëm kuptimisht.

– *"… ai flet për atë burrë që shprehet në një mënyrë të tillë …"* – Në fakt, ajeti përfshin burrat edhe gratë, por thuhet "burrë" në formë

[1] Nëse do ta shohim këtë thënie në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk ka ndonjë problem, nëse është thjesht një lajmërim, pasi njeriu mund të trashëgoj pasuri nga prindërit, por nëse thotëë që e kam trashëguar pasurin nga prindërit, duke harruar Atë që e ka bërë këtë shkak për kalimin e pasurisë nga prindi tek trashëgimtarët e tyre, kjo është një formë shirku, ndonëse nuk e nxjerrnjeriun nga feja, por cënon përsosje e teuhidit. Kështu nëse njeriu ia atribuon një shkaku qoftë edhe shkak i pranueshëm dhe i ligjshëm nga ana fetare, siç është kalimi i pasurisë me anë të trashëgimisë, duke harruar Krijusin e shkakut, ai bën njëfarë shirku që cënon teuhidin, por ky është shirk i vogël.

nderimi, pasi burri është më i vlefshëm se gruaja dhe e meriton më tepër përfaqësimin, edhe pse në gjykim janë të njëjtë.

– *"... Kjo është pasuria ime, të cilën e kam trashëguar nga prindërit e mi. ..."* – Në pamje të parë, kjo shprehje nuk ka ndonjë të keqe. Nëse dikush të pyet se si e ke marrë këtë shtëpi, për shembull, i thua se e ke trashëguar nga prindërit, dhe këtu nuk ka asgjë të keqe, përderisa është thjesht një kumt. Por komenti është për rastin kur atë që zotëron ti ia njeh plotësisht shkakut, që në këtë rast është trashëgimia, duke harruar Krijuesin e shkakut, i Cili është Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Vetëm me caktimin e Allahut pasurohen prindërit e tu, duke e bërë pronë të tyre shtëpinë, dhe sërish me ligjin e Allahut, kjo shtëpi kaloi nën zotërimin tënd me anë të trashëgimisë. E si e harron pra Krijuesin e shkaqeve *kaderi*-je [1] dhe shkaqeve *sher'je* [2] duke ia përshkruan pasurinë tënde sundimit të prindërve dhe të trashëgimisë tënde pas tyre!? Me këtë kuptim, kjo shprehje është mohim i begatisë, por kur është thjesht kumt, ashtu siç thamë më lart, nuk ka ndonjë gjë të keqe. Përcillet në rrugë të saktë se në Ditën e Çlirimit të Mekës, Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i kanë thënë: "A do të zbresësh në shtëpinë tënde?" Ai u përgjigj: "A ka lënë Akili shtëpi për ne?"[3] Kështu Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) tregoi se shtëpia ka kaluar tek Akili, me anë të trashëgimisë.

– *"... Sipas Aun Ibn Abdullahit, ajet bën fjalë për ata që thonë: "Sikur të mos ishte filani, nuk do të ishte kështu. ..."* – Kjo duhet shtjelluar. Nëse thënia është thjesht një kumtim, është në përputhje me realitetin, atëherë nuk ka asgjë të keqe, por nëse qëllimi i saj është të tregohet "filani", si shkaktar, atëherë ka tri mundësi:

1. Të besosh se një shkak i fshehtë që nuk ka asnjëfarë ndikimi mund të ketë fuqi për veprim, si rasti kur dikush thotë: po të mos ishte filan njeri i mirë nuk do të ndodhte kështu. Ky është shirk i

[1] Shkaku quhet *kaderij* kur efekti, pasoja apo ndikimi i tij mësohet nga përvoja, provimi ose eksperimentimi shkencor.
[2] Shkaku quhet *fetar* ose *sher'ij* kur efekti apo ndikimi i tij mësohet nga argumentet fetare.
[3] Buhariu dhe Muslimi.

madh, pasi kjo do të thotë se ky njeri i mirë ka në dorë rregullimin e çështjeve të gjithësisë, edhe pse ai është i vdekur.

2. Ta besosh thjesht si shkaktar, dhe shkaku është i vërtetuar nga feja ose përvoja praktike. Kjo lejohet, me kusht që të mos besosh se shkaku ka vetë fuqi dhënëse, por është Allahu që e ka bërë shkak.

3. Ta besosh thjesht si shkak, por që në fakt ai nuk është pohuar si shkak as nga feja, as nga përvoja praktike. Ky lloj është formë e shirkut të vogël, siç janë vargjet ose fijet, për të cilat thuhet se pengojnë syrin e keq etj. Në këtë rast, personi ka quajtur shkak, diçka që Allahu nuk e ka bërë të tillë, duke u bërë ortak me Allahun në përcaktimin e shkaqeve.

Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë për xhaxhain e tij, Ebu Talibin: "Sikur të mos isha unë, ai do të ishte në gradën më të ulët të Zjarrit."[1] Nuk ka dyshim se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ishte njeriu më larg politeizmit dhe njeriu me teuhidin më të pastër. Ai e quajti veten vetëm shkak të lehtësimit të dënimit për Ebu Talibin, por duke pasur parasysh që ishte një shkak fetar real, sepse atij i kishte dhënë leje Allahu që të ndërmjetësonte për xhaxhain. Ebu Talibit iu lehtësua ndëshkimi: do të mbajë veshur dy këpucë prej zjarri, nga të cilat do t'i vlojnë trutë. Megjithatë, ai nuk do të shohë ndonjë që do të ndëshkohet më rëndë se ai, sepse ky do të ishte një lehtësim tjetër për të, siç thotë Hansa në elegjinë për vëllanë e saj, Sahrin:

Sikur mos kish vajtues kaq shumë,
Që vëllezërit qajnë, njësoj si dhe unë,
Veten do vrisja, por ja që m'ngushëllojnë,
S'e njohin tim vëlla, por mua m'shoqërojnë.

Po kështu, Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë!) – edhe pse fjala e dijetarit nuk është argument, por ndjen njëfarë qetësie tek ajo – në "*Kaside Mimije*", duke lavdëruar sahabët, thotë:

Ndjekës të Profetit, gjithnjë i ndenjën pranë,
Të mos qenë ata, sot s'kishte muslimanë.
Toka me banorë do tundej, pa karar,
Por malet janë ata, që dridhje s'keni parë.

[1] Buhariu dhe Muslimi.

Errësirë do të ishte, natën - terr i plotë,
por hënë e yj i kemi, falë të madhit Zot!

Pra, duket se këto mirësi i ka lidhur me një shkak real.

– *"... Ndërsa sipas Ibn Kutejbes, ajeti flet për ata që thonë: "Kjo e mirë erdhi me ndërmjetësimin e zotave tanë."* – Këta njerëz janë më të poshtër se dy kategoritë e përshkruara më parë, sepse janë idhujtarë. Ata adhurojnë dikë tjetër veç Allahut, e pastaj thonë se begatitë vijnë me ndërmjetësimin e zotave të tyre. Ata thonin, për shembull, se El Uza ndërmjetësonte tek Allahu që të binte shi. Këta pohojnë një shkak të gënjeshtërt, sepse Allahu nuk e pranon ndërmjetësimin e zotave të tyre: "Atë Ditë nuk do të bëjë dobi ndërmjetësimi i askujt, përveç ndërmjetësimit të atij që i jep leje Mëshirëploti dhe fjala e të cilit është pranuar prej Tij." (Ta Ha, 109). Allahu nuk i lejon idhujt që të ndërmjetësojnë. Kjo rrugë është më e kotë se e atyre më lart, sepse përmban dy harame: idhujtarinë dhe pohimin e një shkaku të rremë.

> Ebu Abasi, për hadithin e përcjellë nga Zejd Ibn Halidi: "Allahu tha: "Disa nga robërit e Mi u gdhinë besimtarë ndaj Meje dhe disa jobesimtarë ..."[1], thotë **se "në shumë vende në Kuran dhe Sunet, Allahu i Lartësuar i qorton ata që ia atribuojnë begatitë e Tij dikujt tjetër, duke bërë shirk**.
> Disa selefë **(dijetarë të hershëm) kanë thënë se kjo është për shprehje të tilla si: "Ishte erë** e mbarë" apo " Ishte kapiteni i anijes i zoti", e plot fjalë të tjera si këto.

Ebu Abasi është shejhu i Islamit Ibn Tejmije.

– *"... në shumë vende në Kuran dhe Sunet, Allahu i Lartësuar i qorton ata që ia atribuojnë begatitë e Tij dikujt tjetër, duke bërë shirk..."* – Kjo është njëlloj si të kërkosh shiun me anë të yjeve. Nëse tek ti vjen një skllav me një dhuratë nga zotëriu i tij, dhe ti falënderon skllavin e jo pronarin, kjo është një sjellje e keqe ndaj

[1] Hadithi gjendet i plotë në temën e 30

pronarit dhe mohim i mirësisë së tij. Më e keqe se kjo, është që begatinë t'ia atribuosh shkakut dhe jo Krijuesit të tij, për disa arsye:

- E para, sepse Krijuesi i shkaqeve është Allahu, kështu që Ai duhet të falënderohet dhe vetëm Atij duhet t'i njihet begatia.

- E dyta, sepse ka shkaqe që nuk ndikojnë, ashtu siç përcillet në rrugë të saktë, në "*Sahih*-un" e Muslimit, se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Nuk është viti i thatë kur nuk bie shi, por vit i thatë është kur bie shi, e toka nuk prodhon."[1]

- E treta, sepse mund të ketë faktorë të tjerë që e ndalojnë ndikimin e shkakut. Me këtë sqarim mësohet pasaktësia e atribuimit të diçkaje shkakut, duke mos vështruar te Krijuesi i shkakut i Cili e bën atë të jetë i efektshëm.

– *"... Ishte erë e mbarë. ..."* – Këtë njerëzit e thonë për udhëtimet me anije me vela, që lëvizin me anë të erës. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "... E kur gjenden në anije, që lundron me erën e favorshme, ata gëzohen ..." (Junus, 22). Kur anija u ecte mirë, thoshin se era ishte e mirë dhe kapiteni ishte i zoti në drejtimin e saj; pra, ua atribuonin shkaqeve dhe harronin Krijuesin (Subhanehu ue Te'Ala).

Dobitë e temës

- Shpjegimi i njohjes së mirësisë dhe mohimit të saj.
- Njohja e faktit se shprehje të tilla përdoren nga shumë njerëzit.

Si p.sh. thënia e disave: "era ishte e mbarë", ose "kapiteni ishte i zoti" e të ngjashme.

- Konsiderimi i shprehjeve të tilla si "mohim i mirësisë".

[1] Muslimi.

Kjo do të thotë: mohim i faktit se ato janë dhuruar nga Allahu, e jo mohim i ekzistencës së tyre.

- Bashkimi i dy ndjenjave të kundërta në zemër.

Kjo del nga ajeti: "Ata i dinë mirësitë e Allahut, por pastaj i mohojnë ...". Pra, në fillim kanë në zemër njohjen dhe pastaj mospranimin, ashtu siç mund të bashkohen në një person cilësitë e besimit dhe cilësitë e kufrit, cilësitë e mëkatit dhe cilësitë e drejtësisë.

Tema 42

Thënia e Allahut: “Prandaj mos i vini shokë Allahut, duke e ditur!” (Bekare, 22)

Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) e thotë këtë pasi përmend ato vepra të Tij, që njerëzit i pohojnë, e të cilat nuk mund t’i bëjë askush tjetër veç Atij: “I Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni, i Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin ndërtesë; i Cili prej së larti zbret ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju. Prandaj mos i vini shokë Allahut, duke e ditur!” (Bekare, 21-22). Çdokush që e pohon se këto vepra i përkasin vetëm Allahut e ka detyrë që të adhurojë vetëm Atë, sepse ai që nuk mund t’i bëjë ato, nuk e meriton adhurimin, e kësisoj, mos i bëni Allahut të barabartë.

– *“Prandaj mos i vini shokë Allahut …*” – Mos i vini shokë në adhurim. Ashtu sikur nuk i njihni shokë Atij në veprat e Tij, mos i vini shokë as në emrat dhe cilësitë e Tij. Se ndoshta ata mund të përshkruajnë dikë tjetër me cilësitë e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), siç ka ndodhur me formimin e emrit “*El Uza*” nga “*El Aziz*”, apo emërtimi *Rrahmanul Jemameh*.

– *“… shokë …*” – Ky term nënkupton: zota të barabartë në adhurim.

– *“… duke e ditur…*” – Pra, duke e ditur se Ai nuk ka të barabartë. Ky qe një qëndrim i shëmtuar i tyre: sajonin zota të barabartë me

Allahun, duke e ditur se Ai ishte unik në veprat e Tij. Në Kuran tregohet se ata thanë për Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “A mos kërkon ai, që të gjithë zotat t'i bëjë një Zot të Vetëm? Vërtet që kjo është diçka e çuditshme!” (Sad, 5). Po kështu, në thirrjen e tyre të haxhit thoshin: “Të përgjigjemi Ty! S’ka ortak me Ty, përveç njërit, por që Ti e sundon atë dhe gjithçka që ai zotëron.” Kjo qe mendjelehtësi e tyre. Kur ishte i sunduar, si mund të ishte edhe ortak me Të?! Për këtë, Ai i kundërshtoi ata: “Prandaj mos i vini shokë Allahut, duke e ditur!” Fjala “shokë” është gjithëpërfshirëse – pa marrë parasysh këtu se Ai u është drejtuar njerëzve që e njohin atë si Zot unik në veprat e Tij – dhe përfshin edhe ata që i bëhen të barabartë në adhurim dhe në emra e cilësi.

> Ibn Abasi, për këtë ajet ka thënë: “Flitet për ato shprehje idhujtarie të cilat janë më të fshehta për njerëzit sesa gjurmët e milingonës mbi një gur të zi e të lëmuar, në errësirën e natës, si për shembull: “Betohem për Zotin dhe për kokën tënde!”, ose “Për kokën time!”, ose “Po të mos ishte ky qen i vogël, hajdutët do të kishin bërë kërdinë!”, ose “Po të mos ishin patat në shtëpi, hajdutët do të kishin hyrë!’, ose “Çfarë të dojë Allahu dhe ti bëhet!”, ose ‘Sikur të mos ishte Allahu dhe filani …” etj. Mos përmend në shprehje të tilla emër tjetër veç Allahut sepse e gjithë kjo është shirk”.[1]

– *“Ibn Abasi, për këtë ajet, ka thënë …”* – Kjo do të thotë që ai ka bërë komentimin e ajetit.

– *“… Flitet për ato shprehje idhujtarie …”* – Atëherë, ky koment tregon qëllimin e ajetit.

Ka dy lloje komentesh: 1- koment që tregon se çfarë nënkupton shprehja, pa analizuar pjesët e saj; 2- koment që bën analizën kuptimore të fjalëve. Në rastin tonë, komenti tregon se çfarë nënkupton shprehja.

Për shembull, kur themi se “shokë” ka kuptimin: “të ngjashëm

[1] Ibn Ebi Hatim.

dhe të barabartë", kemi bërë analizën kuptimore të fjalës. Por kur e komentojmë se flitet për idhujtarinë, kjo do të thotë se kemi nxjerrë në pah qëllimin.

– *"... sesa gjurmët e milingonës ..."* – Domethënë gjurmët që lë milingona gjatë ecjes, dhe jo veprimet e saj.

– *"... mbi një gur të zi e të lëmuar ..."* – Pra, jo mbi gur të bardhë, se ashtu gjurma duket më shumë.

– *"... në errësirën e natës ..."* – Ky është kulmi i fshehtësisë.

Kur shirku në zemrat e njerëzve është më i fshehtë se kaq, atëherë i kërkojmë Allahut të na ndihmojë në shpëtimin prej tij. Prandaj, disa selefë kanë thënë: "Nuk jam përpjekur më shumë për diçka tjetër, sesa për ta bërë veten time të sinqertë." Përcillet se, njëherë, kur Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) tha diçka si kjo, u pyet: "E si të shpëtojmë prej saj?" Ai u përgjigj: "Thoni: '*Allahumme in-ni eudhu bike en ushrike bike, ue ene a'alemu ue estagfiruke lima la a'alemu* (O Zot, kërkoj mbrojtje prej Teje nga shirku që e di dhe kërkoj faljen Tënde për atë që nuk e di!)."[1]

– *"... Betohem për Zotin dhe për kokën tënde!..."* – Kjo përmban dy lloje shirku:

1. Betimi jo në Allahun.

2. Shoqërimi i Allahut me dikë tjetër. Lidhja me bashkërenditësen "dhe", rrjedhimisht tregon barazi, dhe përmban njëfarë shirku. Ndërsa betimi jo në Allah, kur besohet se tjetri ka madhështinë e Allahut, është shirk i madh, e nëse jo, atëherë është shirk i vogël.

– *"... Për kokën time! ..."* – Ky betim është jo për Allahun, pra është shirk.

– *"... Po të mos ishte ky qen i vogël, hajdutët do të kishin bërë kërdinë! ..."* – Qeni mund të jetë i dobishëm për gjah, për të ruajtur bagëtitë ose të mbjellat. Shprehja e mësipërme është shirk, nëse

[1] Ahmedi dhe të tjerë. Sipas Albanit hadithi është i mirë.

personi i mbështetet shkakut, duke mos vështruar te Krijuesi i shkakut, i Cili është Allahu (Subhanehu ue Te'Ala).

Për mbështetjen në shkaqe të ligjëruara në Sheriat ose të provuara në praktikë, kemi folur më parë dhe kemi thënë se nuk ka asgjë të keqe, pasi edhe vetë Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Sikur të mos isha unë, ai (Ebu Talibi) do të ishte në gradën më të ulët të Zjarrit."[1] Por në të tilla raste, duhet pasur kujdes sepse njeriu mund të harrojë Krijuesin e shkakut, që është Allahu (Subhanehu ue Te'Ala).

– *"... Po të mos ishin patat në shtëpi, hajdutët do të kishin hyrë! ..."* – Në një shtëpi me pata, nëse futet një i huaj, ato klithin, e kështu hajduti largohet, pasi lajmërohen banorët e shtëpisë.

– *"... Çfarë të dojë Allahu dhe ti bëhet! ..."* – Shprehja përmban shirk, sepse është shoqëruar Allahu me dikë tjetër, duke përdorur lidhëzën "dhe". Nëse besohet se ai person është i barabartë me Allahun në rregullimin e çështjeve dhe në pushtet, ky është shirk i madh, e nëse beson se Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) është mbi gjithçka, atëherë është shirk i vogël. Po kështu edhe shprehja: "Po të mos ishte Allahu dhe ai."

– *"... e gjithë kjo është shirk."* – Pra, gjithçka që u përmend më lart. Shirku mund të jetë i madh ose i vogël, dhe kjo varet nga besimi që ka njeriu në zemër.

> Omer Ibn Hatabi (r.a.) përcjell se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Kush betohet jo në Allahun, ka bërë kufër ose shirk." [2]

– *"Omer Ibn Hatabi përcjell ..."* – E sakta është: "Nga Ibn Omeri

[1] Buhariu.

[2] Tirmidhiu i cili thotë se hadithi është i mirë, ndërsa Hakimi thotë se hadithi është i saktë. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë. Disa formula betimi për diçka tjetër veç Allahut të Lartësuar të përhapura në vendin tonë përshembull janë: "për këtë qiell"; "për këtë tokë", "për këtë pikë uji", "për këtë bukë", "për kokë të babait", "për kokë të fëmijëve", "për nderin", "pasha tyrben", "pasha dervish filanin" etj.

(r.a.) përcillet se...", siç thuhet në "*Tejsir el Aziz el Hamid*".

– *"... ka bërë kufër ose shirk."* – Në këtë thënie, transmetuesi nuk është i sigurt nëse është fjala për *kufër* apo *shirk*, por nga kuptimi i hadithit më e sakta është se ka bërë *shirk*.

– *"Kush betohet jo në Allahun ..."* – Kjo përfshin çdo gjë përveç Allahut, si: Qaben, Profetët, qiellin etj, por nuk përfshin betimin në cilësitë e Allahut, sepse cilësitë gjykohen njësoj me të cilësuarin e tyre. Atëherë, sipas kësaj, lejohet të thuash: "Për Madhështinë e Allahut, do ta veproj këtë!"

– *"... jo në Allahun ..."* – Nuk është qëllimi te ky emër konkret, por tek i emërtuari me të. Të betohesh në Allahun, në Rrahmanin ose në Semiun, është njëlloj si betimi në Allahun.

Po a e fal Allahu shirkun e vogël? Disa dijetarë thonë se ajeti: "Vërtet Allahu nuk e fal t'i bësh shok Atij ..." (Nisa, 116), do të thotë se nuk e fal shirkun e madh, dhe: "...Ai i fal kujtdo që Ai dëshiron, gjynahe të tjera përveç këtij", do të thotë se e fal shirkun e vogël dhe mëkatet e tjera të mëdha. Ndërsa shejhu i Islamit Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë se Allahu nuk e fal shirkun, edhe nëse është i vogël, sepse ajeti: "... nuk e fal t'i bësh shok Atij ...", përfshin shirkun e vogël dhe të madhin.

Po ç'mund të thuhet për ajetet: "(Betohem) për diellin dhe shkëlqimin e tij!" (Shems, 1), "(Betohem) për këtë vend (Mekën)!" (Beled, 1), "(Betohem) për natën që mbulon!" (Lejl, 1), ku Allahu betohet për krijesat?

Së pari, ky është një veprim i Allahut, dhe Ai nuk i jep llogari askujt për veprat e Tij. Ai betohet në cilën krijesë të dojë. Ai merr në llogari dhe nuk pyetet, Ai gjykon dhe nuk gjykohet.

Së dyti, betimi i Allahut në këto krijesa, tregon Madhështinë, Përsosmërinë, Fuqinë dhe Urtësinë e Tij. Betimi në to tregon gjithashtu madhështinë dhe ngritjen e vlerës së tyre, e kjo të çon në falënderimin e Allahut, sepse ato dëshmojnë për Madhështinë e Tij. Ndërsa ne nuk betohemi në krijesat e Allahut, sepse e kemi të ndaluar.

Për sa i përket transmetimit në "*Sahih*-un" e Muslimit se Profeti

(sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Ka shpëtuar, për babanë e tij, nëse tha të vërtetën!”, janë këto shpjegime:

1. Disa dijetarë e kanë mohuar këtë shprehje, duke thënë se nuk është përdorur në hadith, pasi mohon teuhidin dhe diçka e tillë nuk është e saktë t’i atribuohet Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), pra, është e pasaktë.

2. Është gabim në shkrim nga përcjellësit. Në origjinë është: “Ka shpëtuar, për Allahun, nëse tha të vërtetën.” Më parë, nuk shënoheshin diakritikët e shkronjave, e kështu fjala arabe “*Ebu*” (baba) i ngjason fjalës “*Allah*”, nëse i hiqen diakritikët e poshtëm.

3. Kjo është një nga shprehjet që përdorej asokohe pa ndonjë qëllim, ndërsa Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Allahu nuk ju ndëshkon për betimin që e bëni pa qëllim, por ju ndëshkon për betimin e bërë me qëllim …” (Maide, 89). Si e paqëllimtë, ajo nuk është e dënueshme.

4. Atë e ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), i cili ishte njeriu më larg shirkut. Kështu themi se qe lejim veç për Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ndërsa të tjerët e kanë të ndaluar, sepse ata nuk mund të barazohen me të (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në sinqeritet dhe teuhid.

5. Në fjali ka elipsë, që do të thotë se ajo nënkuptohet e tillë: “Ka shpëtuar, për Zotin e babait të tij …”.

6. Ky veprim është shfuqizuar më pas, që do të thotë se tani nuk lejohet. Kjo përgjigje është dhe më afër të vërtetës.

Dikush mund të thotë: Ne po ua kthejmë çështjen, duke thënë se ndalimi është abroguar, duke u bërë i lejuar, për shkak se njerëzit sapo e kishin lënë kufrin, njësoj siç u ndaluan në fillim që të vizitonin varrezat[1]. Por për këtë qëndrim, ne përgjigjemi se ky betim ishte mjaft i përdorur atëherë, prandaj u lanë fillimisht ta përdornin atë, por kur iu forcua besimi, u ndaluan. Kjo është si pranimi i pirjes së alkoolit fillimisht, i cili pastaj u ndalua rreptësisht[2].

Për sa i përket shpjegimit të parë, ai është i dobët, sepse hadithi është i konfirmuar si i saktë, e përderisa ai mund të interpretohet në një mënyrë të saktë, nuk lejohet që të mohohet.

Shpjegimi i dytë është i pamundur. Ajo mund të ndodhë, por jo

[1] Muslimi.

[2] Siç përmendet në ajetin 90 të sures Maide.

me thënien e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Kur e pyeti dikush, në një rast tjetër, se cila sadaka qe më e mira, ai u përgjigj: “Për babanë tënd, ke për ta marrë vesh …”.[1]

Shpjegimi i tretë nuk është i saktë, sepse ndalesa mbeti e tillë, megjithëse ajo vepër kishte qenë shprehje e zakonshme për njerëzit. Edhe për Sadin kishte qenë zakon, mirëpo Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) përsëri e ndaloi atë[2]. Në të kundërt, do të ishte e saktë t’i thuhej atij që i ka pasur zakon veprat e shirkut, që të mos heqë dorë prej tyre, sepse ashtu është mësuar, por kjo nuk është e vërtetë.

Në lidhje me shpjegimin e katërt, pretendimi se vepra qe e posaçme për Pejgamberin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) duhet të faktohet, se përndryshe, në parim, ne duhet të bëjmë ashtu si ai.

Shpjegimi i pestë është i dobët, pasi parimisht fjalia nuk duhet të ketë elipsa, sepse heqja e një fjale këtu i jep kuptim të pasaktë fjalisë. Është e pamundur që Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ta bënte diçka të tillë, pa e sqaruar qëllimin.

Rrjedhimisht, më i afërt me të vërtetën është shpjegimi i gjashtë, pra që lejimi i një veprimi të tillë është shfuqizuar më vonë. Megjithatë, edhe këtë nuk e themi në mënyrë të prerë, sepse nuk e njohim kohën e abrogimit. Ja përse themi: “më i afërt me të vërtetën”, dhe Allahu është më i ditur.

Imam Neveviu (Allahu e mëshiroftë!) ka përkrahur mendimin se ajo ka qenë një shprehje e rëndomtë, e paqëllimtë, por ky qëndrim – siç thamë – është i dobët. Gjithashtu, kam konstatuar se disa dijetarë kanë thënë në mënyrë të prerë që ky hadith është *shadh*,[3] për arsye se atë e ka sjellë veç Muslimi, dhe jo Buhariu, dhe se ai bie në kundërshtim me hadithet të tjera që sjellin transmetues të besueshëm. Allahu është më i Ditur.

> Ibn Mesudi thotë: “Të betohem në Allahun duke gënjyer, është më e dashur për mua sesa të betohem në dikë tjetër

[1] Muslimi.
[2] Ahmedi. Sipas Albanit hadithi është i dobët.
[3] *Shadh* quhet hadithi i sjellë nga një përcjellës i drejtë e i përpiktë, duke kundërshtuar atë që është më i saktë se ai.

duke thënë të vërtetën." [1]

– *"... Të betohem në Allahun duke gënjyer, është më e dashur për mua ..."* – Ibn Mesudi nuk donte as njërën, as tjetrën, por betimi në Allah duke gënjyer, ishte më i lehtë për të sesa betimi jo në Allahun duke thënë të vërtetën.

Betimi i gënjeshtërt është i ndaluar për dy arsye: 1- është gënjeshtër, dhe gënjeshtra është e ndaluar në vetvete; 2- kjo gënjeshtër është e shoqëruar me betim.

Betimi në Allah është madhërim i Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), e nëse ai është i rremë, bëhet njëfarë cenimi ndaj Allahut, pasi emri i Tij përdoret për të besuar një gënjeshtër. Për disa dijetarë, betimi i rremë është betim jo në të drejtë, prandaj ai të zhyt në gjynah, e pastaj në Zjarr.

Ndërsa betimi jo në Allahun duke thënë të vërtetën, është i ndaluar për një arsye të vetme, që është shirku. Por e keqja e shirkut është më e madhe se e keqja e gënjeshtrës, më e madhe se e keqja e betimit të gënjeshtërt në Allah dhe më e madhe se e keqja e betimit jo në të drejtë – nëse pranojmë se betimi i rremë në Allah është betimit jo në të drejtë – sepse Allahu nuk e fal shirkun: "Vërtet Allahu nuk e fal t'i bësh shok Atij ..." (Nisa, 116).

Allahu i dërgoi Profetët dhe i ka zbritur librat vetëm për të zhdukur shirkun, i cili është më i madhi i gjynaheve: "Vërtet idhujtaria është padrejtësia më e madhe." (Llukman, 13). Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është pyetur se cili është gjynahu më i madh dhe ai është përgjigjur: "T'i bësh shok Allahut, ndërkohë që Ai të ka krijuar."[2]

Por shirku përmban edhe gënjeshtrën, sepse ai që i bën Allahut ortak, është gënjeshtar, madje gënjeshtari më i madh, sepse Allahu nuk ka ortak.

Hudhejfe përcjell se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Mos thoni: 'Çfarë të dëshirojë Allahu dhe filani

[1] Abdurr-Rrezaku dhe Tabarani në "El-Kebir". Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

[2] Buhariu dhe Muslimi.

…', por thoni: 'Çfarë të dëshirojë Allahu, pastaj filani …"[1]

– *"… Çfarë të dëshirojë Allahu dhe filani …"* Arsyeja e kësaj ndalese është se lidhëza bashkërenditëse "*dhe*" e barazon gjymtyrën e parë të fjalisë me të dytën, pra barazohet dëshira e Allahut me dëshirën e krijesës, dhe kjo vepër është shirk. Pastaj, nëse beson se krijesa është më madhështore se Krijuesi ose e barabartë me Të, ky është shirk i madh, e nëse beson se krijesa është më e ulët, atëherë është shirk i vogël.

– *"… por thoni: 'Çfarë të dëshirojë Allahu, pastaj ai …"* – Pasi u tregoi shprehjen që ishte haram, Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) u mësoi shprehjen e lejuar. Fjala "pastaj" tregon renditje më të ulët, që do të thotë se ai që vjen pas është në një kategori më të ulët.

Dobitë e hadithit

Pohimi se njeriu ka dëshirë, vullnet, siç thotë hadithi: "… Çfarë të dëshirojë Allahu, pastaj ai." Kjo është kundërpërgjigje ndaj *xhebrive*, të cilët thonë se nuk ka vullnet njerëzor dhe liri zgjedhjeje.

Ai që u mbyll njerëzve një derë të ndaluar, duhet t'u hapë një derë të lejuar, ashtu siç bëri Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Kështu ka bërë edhe Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), kur thotë: "O ju që keni besuar! Mos thoni "*Ra'ina*",[2] por thoni: "*Undhurna*"!'…" (Bekare, 104). Po kështu, Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), një herë tjetër, i sollën hurma të mira. Ai që ia solli i tha se kishte këmbyer dy masa hurmash të këqija me një masë hurmash të mira, por Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e mësoi: "Mos e vepro kështu, por shiti ato që ke me para, dhe pastaj bli me para të mirat."[3] Pra, i mësoi mënyrën e lejuar, pasi ia ndaloi mënyrën që ishte haram.

Këtu dalin dy mësime të mëdha:

---

[1] Transmetron Ebu Daudi me zinxhir të saktë. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

[2] Kjo fjalë në hebraishten-arabe të asaj kohe ishte me kuptimin e sharjes dhe me këtë kuptim e përdornin çifutët.

[3] Buhariu dhe Muslimi.

1- Përsosmëria e Sheriatit dhe gjithëpërfshirja e tij, i cili nuk ka mbyllur ndonjë portë për njerëzit e të mos ketë hapur për ta një tjetër, më të vlefshme se e para.

2- Lehtësimi për njerëzit dhe largimi i vështirësive prej tyre. Zbatoje këtë rregull me njerëzit sa të mundesh. Sa herë që t'i pengosh nga ndonjë haram, drejtoji te hallalli, që të mos bien në vështirësi.

> Thuhet se Ibrahim Nehaiu e urrente shprehjen: "Mbrohem me Allahun dhe me ty!". Megjithatë, lejohet të thuhet: "Mbrohem me Allahun, pastaj me ty!" Ai porosiste: "Thoni: 'Po të mos ishte Allahu, pastaj filani …', e jo: 'Po të mos ishte Allahu dhe filani …'"

Ibrahim Nehaiu ka qenë një nga dijetarët e tabiinëve, por ka qenë i dobët në hadithe, siç ka thënë Hamad Ibn Zejdi.

– *"… Mbrohem me Allahun dhe me ty! …"* – Kjo shprehje është e ndaluar, sepse bashkohet emri i Allahut dhe i krijesës me lidhëzën "*dhe*", që tregon barazi mes tyre.

Por lejohet të thuhet: "Mbrohem me Allahun, pastaj me ty!", sepse lidhëza "pastaj" tregon nënrenditje.

Dikush mund të ngrejë pyetjen se më parë u tha që kërkimi i mbrojtjes te dikush apo diçka tjetër veç Allahut të Lartësuar, është shirk dhe, sipas kësaj, shprehja "Mbrohem me Allahun, pastaj me ty!" është haram? Por ne përgjigjemi se kërkimi i mbrojtjes nga dikush që ka mundësi të të mbrojë, është i lejuar, sipas fjalës së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), të shënuar në "Sahih-un" e Muslimit dhe në libra të tjerë: "Kush gjen ndonjë mbrojtje nga ajo e keqe, le të mbrohet!"[1]

Mirëpo nëse thua: "Mbrohem me Allahun, pastaj me filanin", kur ky i fundit është i vdekur, atëherë ke bërë shirk të madh, sepse i vdekuri nuk ka mundësi të të mbrojë.

Një argument që ka sjellë imam Ahmedi për faktin se Kurani nuk është i krijuar, është hadithi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem):

[1] Buhariu dhe Muslimi.

"Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut nga e keqja që Ai ka krijuar!", duke shpjeguar se mbrojtja nuk kërkohet nga krijesat. Kjo do të thotë se fjala tek e cila kërkohet mbrojtje, pra fjala e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), nuk është e krijuar. E folura ka natyrën e folësit të saj: nëse ai është i krijuar, edhe ajo është e krijuar; nëse ai nuk është i krijuar, edhe ajo nuk është e krijuar.

Dobitë e temës

- Komenti i ajetit të sures "Bekare", që flet për politeizmin.

- Sahabët, në komentin e ajetit që flet për shirkun e madh, kanë thënë se ai përfshin edhe të voglin.

Megjithatë, ajeti: "Prandaj, mos i vini shokë Allahut, duke e ditur!", ka zbritur për shirkun e madh, sepse ai iu është drejtuar idhujtarëve. Ibn Abasi thotë se ai përfshin edhe shirkun e vogël, sepse fjala *'nidd'* e përmendur në ajet përfshin edhe rivalin absolut (në gjithçka), edhe rivalin në disa gjëra.

- Betimi në dikë tjetër veç Allahut është shirk.

Sipas hadithit të Ibn Omerit (r.a.).

- Të betohesh në dikë tjetër veç Allahut duke thënë të vërtetën, është mëkat më i madh se betimi i rremë.

"Betim i rremë", sipas hanbelive, quhet betimi në Allahun duke gënjyer. Disa të tjerë kanë thënë se është betimi në Allahun duke gënjyer për të përfituar nga pasuria e një muslimani.

- Ndryshimi ndërmjet lidhëzave "*dhe*" dhe "*pastaj*" në të

shprehur.

Lidhëza “dhe” tregon barazi mes gjymtyrëve të lidhura, ndërsa lidhëza “*pastaj*” tregon nënrenditje, pra nuk ke vendosur barazi.

Tema 43

Paralajmërimet për atë që nuk kënaqet me betimin në Allah.

Kjo temë lidhet me teuhidin për arsye se kënaqja me betimin në Allah tregon shenjtërim të Tij, pasi betim do të thotë të përmendësh diçka të shtrenjtë a të shenjtë, për ta siguruar dikë se po thua të vërtetën ose se do ta kryesh diçka patjetër. Kështu që të mos kënaqesh me betimin në Allah, tregon mungesë respekti ndaj madhështisë së Tij, gjë e cila cenon teuhidin e pastër.

Kënaqja me betimin në Allahun mund të jetë:

1- Detyrim ligjor. Kjo ndodh, për shembull, kur të pandehurit në gjyq i kërkohet të betohet, dhe ai e ka detyrë ta pranojë me kënaqësi këtë kërkesë.

2- Detyrim moral. Nëse personi që betohet është i besueshëm, atëherë duhet ta pranosh betimin e tij, përndryshe mund ta refuzosh. Njëherë, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha Huvejisës dhe Muheisës: “A ju shfajësohet juve çifuti me 50 betime?” Ata i thanë: “E si t’i pranojmë, o Pejgamberi i Allahut, betimet e çifutëve?!”[1] Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ua pohoi atë që thanë.

> Ibn Omeri tregon se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Mos u betoni në etërit tuaj! Kush betohet në Allahun, le të thotë të vërtetën, dhe kujt i betohen në

[1] Buhariu dhe Muslimi.

> Allahun, le të kënaqet. Kush nuk kënaqet, është larg prej Allahut"[1].

– *"... Mos u betoni në etërit tuaj! ..."* – Fjala "etërit" përfshin babain, gjyshin e më lart. Pra, nuk lejohet betimi në ta, sepse është shirk.

– *".... Kush betohet në Allahun, le të thotë të vërtetën, dhe kujt i betohen në Allahun, le të kënaqet. Kush nuk kënaqet, është larg prej Allahut."* – Këtu ngrihen dy çështje:

1- Kush betohet është urdhëruar të thotë të vërtetën. E kundërta është gënjeshtra, e cila është në kundërshtim me realitetin.

A është kusht që të jetë në përputhje të plotë me realitetin, apo mjafton të anojë më shumë nga realiteti? Mjafton që të anojë më shumë nga realiteti dhe njeriu mund të betohet. Kështu iu betua dikush Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Vallahi, nuk ka ndërmjet këtyre dy kodrave familje më të varfër se e imja." Dhe Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e pranoi atë.

2- Njeriu është urdhëruar që ta pranojë betimin që bëhet para tij. Nëse i lidhim dy çështjet me njëra-tjetrën, themi betimi duhet pranuar kur bëhet nga dikush që njihet si njeri që thotë gjithnjë të vërtetën. Nëse mëtohet se ne e besojmë atë kur thotë të vërtetën, edhe nëse nuk betohet, përgjigjemi se betimi shërben për të shtuar sigurinë.

– *"... Kush nuk kënaqet, është larg prej Allahut."* – Pra, kush nuk kënaqet me betimin, ai është larg Allahut. Ky distancim tregon se kjo vepër është gjynah i madh.

Megjithatë, duhet të kemi parasysh hadithin që flet për betimin e çifutit, i cili tregon se kur njeriu nuk është i besueshëm, mund të mos e pranosh betimin e tij. Gjithashtu, nëse dikush betohet: "Për Zotin, kjo valixhe është prej druri", kur ajo duket që është prej lëkure, lejohet që të mos e pranosh, sepse ti je i sigurt se ai gënjen. Feja nuk urdhëron të bësh diçka që bie ndesh me logjikën dhe realitetin, edhe pse mendja njerëzore nuk i arrin ndonjëherë t'i kapë

[1] Ibn Maxhe me zinxhir të mirë transmetimi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

përmasat e mirësisë së fesë.

Gjithmonë duhet të jesh i sigurt se Sheriati urdhëron vetëm për diçka që është e mirë: "E kush është më i drejtë në gjykim sesa Allahu, për njerëzit që besojnë bindshëm?" (Maide, 50). Nëse nuk arrin të njohësh mirësinë e një gjykimi të Sheriatit, dobësinë dhe mangësinë duhet ta shohësh te vetja jote, dhe jo te Sheriati. Gjithçka që përcillet në rrugë të sakta nga Allahu dhe Pejgamberi i Tij, është e vërtetë dhe gjykimi më i mirë.

Dobitë e temës

- Ndalesa e betimit në prindërit.

Ndalimi nënkuptom se kjo gjë është harram.

- Urdhëri për pranimin me kënaqësi të betimeve në Allah.

- Paralajmërimi për dënimin e atij që nuk pranon betimet në Allah.

Këtu duhet të shtojmë një dobi që nuk e ka përmendur autori: urdhërimi i atij që betohet, të thotë të vërtetën. Njeriu duhet të thotë të vërtetën edhe pa u betuar, po kur betohet?! Për gjykimin e kësaj çështjeje folëm më lart, kur thamë se ai që betohet duke gënjyer, është mëkatar.

Por, a duhet ta besojmë gjithnjë dikë që betohet? Paraqiten pesë situata të ndryshme:

1- Dihet qartë se ai gënjen. Në këtë rast, askush nuk thotë se është detyrë ta besosh.

2- Është thuajse e sigurt se ai gënjen. Edhe në këtë rast nuk është detyrë ta besojë.

3- Edhe mund të thotë të vërtetën, edhe mund të gënjejë. Kësaj here është detyrë ta besosh.

4- Më e sakta është se thotë të vërtetën. Në këtë rast, gjithashtu,

është detyrë ta besosh.

5- Është e sigurt që thotë të vërtetën. Patjetër, edhe në këtë rast, duhet që ta besosh.

Këto janë raste të jetës praktike, ndërsa në çështjet ligjore, kur betimi është element i një gjyqi, është gjithnjë e detyrueshme të pranosh atë, sepse është tregues i pranimit të gjykimit të Sheriatit.

Tema 44

Shprehja: “Çfarë të dëshirojë Allahu dhe ti.”

Kjo temë lidhet me teuhidin, pasi shprehja “çfarë të dëshirojë Allahu dhe ti” është një formë e shirkut të madh ose të vogël. Nëse beson se ai që vjen pas lidhëzës “dhe” është i barabartë me Allahun, është shirk i madh, e nëse beson se ai nuk është i barabartë me Allahun, por është shoqëruar me Të vetëm në të shprehur, atëherë është shirk i vogël.

Disa dijetarë thonë se një mënyrë e përcaktimit të shirkut të vogël është: Çdo gjë që të çon në shirkun e madh, quhet shirk i vogël.

> Nga Kutejle përcillet se një çifut kishte shkuar te Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe i kishte thënë: “Ju bëni shirk, kur thoni: ‘Çfarë të dëshirojë Allahu dhe ti’ dhe kur betoheni: ‘Për Kaben!’” Atëherë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) urdhëroi që kur të betoheshin, të thonin: “Për Zotin e Kabes!” e gjithashtu të thoshin: “Çfarë të dëshirojë Allahu, pastaj ti”.[1]

Prejardhja e emrit “*jehud*” është shpjeguar më lart.

– *“... Ju bëni shirk ...”* – Pra: ju o muslimanë, shprehni idhujtari.

– *“... Çfarë të dëshiroj Allahu dhe ti ...”* – Politeizmi këtu qëndron

[1] Ahmedi dhe En-Nesaiu i cili edhe e ka saktësuar. Edhe sipas Albanit është i saktë.

në faktin se dy gjymtyrët e fjalisë që lidhen me lidhëzën "dhe" bëhen të barabarta.

– *"... Për Kaben. ..."* – Politeizmi në këtë rast ishte betimi në diçka tjetër veç Allahut.

Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk e mohoi atë çfarë tha çifuti, por urdhëroi që shprehja të korrigjohej e të bëhej: "Për Zotin e Kabes!". Po kështu, ai i urdhëroi të thonin: "Çfarë të dëshirojë Allahu, pastaj ti". Lidhëza "*pastaj*" e nënrendit dëshirën e krijesës pas dëshirës së Allahut.

Dobitë e hadithit

- Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk e mohoi fjalën e çifutit, sepse ishte e vërtetë, ndonëse ai synonte poshtërimin dhe goditjen e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe sahabëve.
- E vërteta pranohet edhe nga ai që nuk e zbaton atë.
- Ndryshimi i një norme duhet të bëhet me diçka të përafërt.

Pyetje: Si është e mundur që dukurinë e kishte shquar vetëm ai çifut?

Përgjigje: Ndoshta Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk e kishte dëgjuar e as nuk e kishte ditur atë. Por ishte Allahu që e dinte! Kështu që, ky shpjegim mbetet i paqëndrueshëm.

Një përgjigje tjetër është se ajo dukuri ishte një formë e shirkut të vogël për muslimanët, ndërsa për çifutët ishte provë, sepse ata kritikonin muslimanët për ato shprehje, ndërkohë që vetë bënin shirk të madh dhe nuk e shihnin si të metë.

> Ibn Abasi tregon se, njëherë, një burrë i tha Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Çfarë të dëshirojë Allahu dhe ti ...". Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ia ktheu: "E si më bëre të barabartë me Allahun?! Thuaj: "Çfarë të dëshirojë Allahu i Vetëm ..."".[1]

[1] Nisai, Ahmedi dhe Buhariu në "Edebul Mufred". Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

– *"... Çfarë të dëshirojë Allahu dhe ti ..."* – Me sa duket, shprehja ishte si madhërim për Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), duke ia dorëzuar çështjen dëshirës së Allahut dhe dëshirës së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

– *"... E si më bëre të barabartë me Allahun?! ..."* – Pyetja këtu shërben për kundërshtim, madje është edhe një shprehje habie, sepse kush i vë të barabartë Krijuesit, ka bërë diçka të çuditshme.

– *"... Çfarë të dëshirojë Allahu i Vetëm."* – Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk e mësoi që të thoshte: "Çfarë të dëshirojë Allahu, e pastaj ti ...", në mënyrë që t'ia priste atij të gjitha rrugët e shirkut.

Dobitë e hadithit

- Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) vuri re një rrezik të madh në shprehjet që e barazonin atë me Krijuesin, si forma të politeizmit. Nëse e beson vërtetë se janë të barabartë, është shirk i madh, e nëse beson se krijesa është më poshtë, ato shprehje përbëjnë shirk të vogël.

Kur vetëm një shprehje është shirk, atëherë ç'mund të thuhet kur meritën e Krijuesit ia kushton Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem)?! Kjo është edhe më e rëndë. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk kishte asgjë nga vetitë unike krijuese dhe sunduese të Allahut. Ai ishte njeri që mbante mburojë, armë, që e merrte uria, që ndiente dhimbje, që sëmurej dhe e merrte etja, ashtu si të gjithë njerëzit e tjerë. Por Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e favorizoi mbi të gjithë njerëzit me Shpalljen hyjnore. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Thuaj: 'Unë jam veç një njeri, ashtu si ju ...'." (Kehf, 110). Ai ishte njeri, e përforcuar kjo me krahasimin "ashtu si ju". Më pas cilësohet dallimi midis tij dhe njerëzve të tjerë: "... që më është shpallur se i adhuruari juaj është një i Vetëm ..." (Kehf, 110). Nuk ka dyshim se Allahu i kishte falur atij moral të lartë, i dha atij durim dhe bujari të madhe, por të gjitha këto në kufijtë e njerëzores, pa u futur në atributet e Krijuesit. Kush pretendon të kundërtën, e ka mohuar Muhamedin dhe Atë që e dërgoi.

E rëndësishme është se ne nuk duhet ta teprojmë në raport me të

Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): nuk duhet ta ngremë atë në një pozitë që ai e urrente, por gjithashtu nuk duhet të lëmë anash detyrat ndaj tij, ato që ai i meriton. Ne i japim vendin që meriton dhe e lusim Allahun që të na ndihmojë në kryerjen e detyrave ndaj tij, pa e ngritur në gradën e Zotit.

- Ndalimi i së keqes, qoftë ajo edhe “në favorin” tënd. E tillë qe ndërhyrja që bëri Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), edhe pse personi e kishte për të shenjtëruar vetë Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Prej këtej nxjerrim një rregull: nëse dikush përkulet para teje kur të përshëndet, është detyrë për ty ta ndalosh.

- Nga mirësitë e thirrjes në rrugë të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala) është që të tregosh hallallin, kur përmend haramin. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), kur ndaloi një shprehje, lejoi një shprehje tjetër.

> Ibn Maxhja përcjell se Tufejli, vëllai i Aishes nga nëna, ka treguar njëherë për një ëndërr që kishte parë: “Pashë sikur shkova te një grup çifutësh dhe u thashë: ‘Sa popull i mirë jeni ju, po të mos thoni se Uzejri është bir i Allahut!’ Ata thanë: ‘Sa popull i mirë jeni ju, po të mos thoni: Çfarë të dojë Allahu dhe Muhamedi.’ Pastaj kalova te një grup të krishterësh dhe u thashë: ‘Sa popull i mirë jeni ju, po të mos thoni se Mesihu është bir i Allahut.’ Ata thanë: ‘Edhe ju, sa popull i mirë jeni, sikur të mos thoni: Çfarë të dojë Allahu dhe Muhamedi.’ Pasi zbardhi dita, ua tregova këtë disave dhe më pas Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ai më pyeti: ‘A ia ke treguar ndonjë tjetri?’ – ‘Po’ - iu përgjigja.. Ai falënderoi dhe lartësoi Allahun, e pastaj tha: ‘Tufejli ka parë një ëndërr dhe ua ka treguar disave prej jush. Ju keni një shprehje, të cilën më kanë penguar disa arsye[1] që t’jua ndaloja. Mos thoni: ‘Çfarë të dojë Allahu dhe Muhamedi’, por thoni: ‘Çfarë të dojë

[1] Në një transmetim tjetër përcillet se më vinte turp. Pra i vinte turp nga Allahu, sepse nuk ishte i urdhëruar për ta ndaluar këtë shprehje.

Allahu i Vetëm …'".[1]

– *"… shkova te një grup çifutësh …"* – Fjala arabe "*nefer*" (grup), e përdorur në hadith, tregon një grup njerëzish nga tre deri në nëntë vetë. Çifutët janë ndjekësit e Musait (alejhi selam).

– *"… po të mos thoni se Uzejri është bir i Allahut …"* – Uzejri ishte një burrë i mirë, për të cilin jehudët pretendonin se ishte bir i Zotit. Kjo qe një nga profkat e tyre dhe kufër i qartë. Çifutët kanë plot të meta, por është veçuar kjo, sepse është më e rrezikshmja dhe më e përhapura ndër ta.

– *"… Çfarë të dojë Allahu dhe Muhamedi …"* – Ky ishte shirk i vogël, sepse sahabët, që e thoshin këtë, sigurisht që nuk besonin se vullneti i Muhamedit qe i barabartë me vullnetin e Allahut.

Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i kritikoi muslimanët për vënien e shenjës së barazisë, në të shprehur, midis dëshirës së tij dhe dëshirës së Allahut, pavarësisht se cenimi që i bënin jehudët shenjtërisë së Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) ishte akoma më i madh dhe më i rëndë.

– *"… po të mos thoni se Mesihu është bir i Allahut. …"* – Mesihu është Isai, biri i Merjemes. Ai është quajtur Mesih (Fërkues), sepse ai fërkonte personat e sëmurë si për shembull, të verbrit apo lebrosët, dhe ata shëroheshin, me lejen e Allahut.

Shejtani ka luajtur me të krishterët. Ata thonë ai është bir i Allahut, sepse ka ardhur në jetë pa baba, siç thotë Allahu në Kuran: "Ne frymë në rrobën e saj (me anë të Xhibrilit) nga shpirti Ynë …" (Enbija, 91). Ata thonë se ai është pjesë e Allahut, sepse Allahu ia ka atribuuar atë Vetes së Tij, e meqë i përket Atij është biri i Tij.

Shpirti, sipas mendimit më të saktë të *ehli sunet*-it, është një qenie e hollë, e butë, që futet në trup dhe depërton në të ashtu si uji në tokën e tharë. Meleku i vdekjes e nxjerr atë nga trupi dhe, pasi mbështillet me qefin, e ngre lart. Në këtë çast të vdekjes, njeriu e shoqëron me sy shpirtin e vet. Pra, sipas të vërtetës, shpirti është

[1] Ibn Maxhe. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

qenie, edhe pse disa njerëz thonë se ai është një veti e trupit. Është e saktë se jeta është një veti e trupit, ndërsa shpirti është një qenie që depërton dhe zë vend në trupin e njeriut.

Rrjedhimisht, të krishterëve u themi se Allahu ia ka atribuuar vetes së Tij shpirtin e Isait, ashtu siç ka bërë me Qaben, xhamitë, Devenë[1] e të tjera, si shenjë nderimi dhe shenjtërimi për to. Nuk ka dyshim se gjithçka që i atribuohet Allahut, fiton nderim dhe respekt. Disa poetë thonë për të dashurën e tyre:

Më thirrni, o njerëz, veç "O robi i saj",
Kryelartë do t'jem, që emrin ta mbaj!

– *"... A ia ke treguar ndonjë tjetri? ..."* – Po të mos ia kishte treguar kujt deri në atë çast, ndoshta Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) do t'i thoshte që të mos e bënte më, – me aq sa kuptohet nga situata – dhe gjykimin e asaj çështjeje do ta sqaronte më vonë. Por, meqë disa e kishin marrë vesh, atëherë duhet ta dinin edhe njerëzit e tjerë, sepse kur përhapet diçka, është detyrë që të sqarohet për të gjithë, e nëse jo, mund të sqarohet vetëm ai që e ka parë ose dëgjuar.

– *"... Ai falënderoi Allahun ..."* – Falënderimi është ta cilësosh si të përsosur, duke e dashur dhe madhëruar.

– *"... më kanë penguar disa arsye ..."* – Ishte turpi që e kishte penguar, siç thuhet në një transmetim tjetër; jo turpi për ndalimin e së keqes, por turpi që ta ndalonte pa e urdhëruar Allahu. Këtë kemi detyrë të themi për shpjegimin e saj, nëse fjalia është e saktë. Nuk ishte turpi për ta ndaluar atë, sepse Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk kishte turp nga e vërteta. Ai kishte ngurruar sepse ende nuk ishte urdhëruar për ndalimin, siç ndodhi edhe me alkoolin, të cilin njerëzit vazhdonin ta pinin, derisa u ndalua përfundimisht në suren "Maide". Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) kishte heshtur derisa ende nuk kishte marrë urdhër, por kur çifutët dhe të krishterët e vunë re atë dukuri, ai (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e pa të domosdoshme të bënte ndalimin, për shkak se

[1] Flitet për një deve të veçantë, që Allahu e bëri si mrekulli për Profetin Salih. (Shih në suren Hud, ajeti 64).

muslimanët po ofendoheshin.

Dobitë e temës

- Njohja nga ana e çifutëve e shirkut të vogël.
- Njeriu e kupton të gabuarën nëse ai dëshiron.

E kupton atë edhe nëse vetë bën diçka të ngjashme ose më të rëndë se ajo. Çifutët i kritikuan muslimanët për shprehjen: 'Çfarë të dojë Allahu dhe ti …", ndërsa vetë ata thonin shprehje më të rëndë se kjo: që Uzejri ishte biri i Allahut, ose që e përshkruanin Allahun me të meta.

Kështu bëjnë sot edhe disa muslimanë, të cilët i kuptojnë argumentet sipas qejfit të tyre, madje duke u dhënë shpjegime të paqena. Të tjerë u japin teksteve interpretime pa lidhje, me qëllim që ato të përputhen patjetër me zbulimet bashkëkohore të shkencës në mjekësi, astronomi etj., por njeriu nuk lavdërohet për këtë. Ai e ka detyrë t'i kuptojë tekstet ashtu siç janë në të vërtetë. Të kuptuarit e njeriut duhet të jetë pasues i tekstit, jo teksti t'i nënshtrohet të kuptuarit të njeriut apo bindjeve të tij, prandaj thonë: argumento, pastaj beso, e jo beso, pastaj të argumentosh. Po të besosh e pastaj të argumentosh, besimi yt mund të ndikojë në shtrembërimin e kuptimit real të argumentit. Kjo gjë vihet re në të gjitha fetë dhe sektet që kundërshtojnë rrugën e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Ata devijojnë kuptimet e teksteve, që ato të përputhen me besimin e tyre. Si përfundim, nëse njeriu dëshiron, atëherë ai mund t'i interpretojë argumentet sipas dëshirës së tij, duke tejkaluar kuptimin real të tyre.

- Thënia e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "E si më bëre të barabartë me Allahun?!".
  Po ai poeti që thotë:
  "Kur të zezat t'më kenë pushtuar,

ndihmë veç ty kam për t'kërkuar"?!

Pjesa e fundit është aludim i autorit (Allahu e mëshiroftë!) për vargjet e Busirit në "*El Burde*":

O krijesa më e nderuar,
Kur të zezat t'më kenë pushtuar,
Ndihmë veç ty kam për t'kërkuar!
Në s'më shpëton në t'Gjykimit Ditë,
Thuaj "mjerë" për mua, që kam rrëshqitë.
Dynja dhe ahiret – prej bujarisë që pate,
Prej dijes që ke ti, janë shkruar këto fate.

Ky është kulmi i kufrit dhe i kalimit të caqeve, pasi nuk është lënë gjë për Allahun. Nderi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është statusi i tij si rob i Allahut dhe si Pejgamber i Tij, e jo thjesht si biri i Abdullahit.

- Shprehja që përdornin ata nuk ishte shirk i madh, sepse në të kundërt, asgjë nuk do ta pengonte Profetin nga ndalimi i saj. Por meqë ishte shirk i vogël Profeti tha: "*më kanë penguar disa arsye që t'jua ndaloja*".

- Ëndrra e mirë është një nga llojet e shpalljes hyjnore.

Kjo del nga hadithi i Tufejlit, si edhe nga hadithi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Ëndrra e mirë është një nga dyzet e gjashtë pjesët e profecisë."[1] Kjo përputhet me të vërtetën, sepse së pari shpallja hyjnore i erdhi Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nëpërmjet ëndrrave të mira, nga muaji *Rabiul euel* deri në *Ramazan*, pra gjashtë muaj. Kjo periudhë lidhet me kohën tjetër të Shpalljes, dhe bëhen njëzet e tre vjet e gjashtë muaj.

Kjo lloj ëndrre është e mirë dhe e kthjellët, e jo e turbullt. Ka edhe ëndrra të trazuara e të liga, si ajo që kishte parë një burrë, i cili vajti

[1] Buhariu dhe Muslimi.

e ia tregoi Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Pashë kokën që m’u këput, ndërsa unë shkoja pas saj me nxitim.” Por Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha: “Mos u trego njerëzve lojën që shejtani bën me ty gjatë gjumit.”[1]

Në të shumtën e rasteve, ëndrrat e këqija janë nga shejtani. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Intrigat e fshehta vijnë vetëm nga djalli, për t'i dëshpëruar besimtarët. E megjithatë ai nuk mund t'u shkaktojë kurrfarë të keqeje, përveç nëse Allahu e lejon atë...” (Muxhadele, 10). Për këtë arsye, Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka mësuar se kush shikon në ëndërr diçka të urryer, duhet të pështyjë në të majtën e tij, ose të fryjë me pështymë tri herë, e të thotë: “*Eûdhu bil-lâhi minesh-shejtânir-raxhîm ue min sher-ri mâ ra’ejtu*” [2] Pastaj të kthehet në krahun tjetër e të mos ia tregojë ëndrrën askujt. [3] Ndërsa sipas një transmetim tjetër, thuhet që duhet të marrë abdes dhe të falet.[4]

> ➢ Nëpërmjet ëndrrave kanë ardhur ndonjëherë urdhra e dispozita ligjore[5].

E tillë qe ëndrra e Ibrahimit (alejhi selam), ku ai pa që po therte të birin, si dhe hadithi për të cilin jemi duke folur. Gjithashtu, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka pohuar ëndrrën e Abdullah

---

[1] Muslimi.

[2] Përkthimi: “Mbrohem me Allahun nga e keqja e shejtanit dhe e keqja e asaj që pashë!”

[3] Buhariu dhe Muslimi.

[4] Siç përmendet në “Sahihun” e Buhariut.

[5] Ëndra e këtij sahabiu është vërtetuar nga i Dërguari i Allahut, dhe prandaj shërben si argument për çështjet fetare në fjalë, ndërsa ëndrat e mira që shikojnë njerëzit e mirë assesi nuk shërbejnë si argumente për çështjet e fesë; ato mund të shërbejnë vetëm si sihariqe apo paralajmërime për gjëra që do të ndodhin në të ardhmen, ose thjeshtë si një faktor qetësues kur flasin për ndonjë çështje fetare, ose si rrethanë ndihmëse kur bëjnë fjalë për zbulimin ose vërtetimin e diçkaje, por aspak si argument për çështje fetare. Dijetarët kanë shpjeguar se profecia është vulosur, por meqë ëndrra ishte njëra nga mënyrat e inspirimit të pejgamberëve për ngjarjet që do të ndodhnin në të ardhmen, edhe ëndrra e mirë që shikon njeriu i mirë është një mënyrë për të mësuar diçka të fshehtë që lidhet me të ardhmen; në këtë kuptim, ajo është një nga dyzet e gjashtë pjesët e profecisë, siç ka thënë Pejgamberi (‘alejhis–selam) në një hadith të vërtetë.

Ibn Zejdit në lidhje me ezanin, duke i thënë: "Ajo është një ëndërr e vërtetë."[1]

Ebu Bekri (r.a.) ka pranuar njëherë ëndrrën e dikujt që pa Thabit Ibn Kajs Ibn Shemasin, duke i thënë: "Ju do të gjeni mburojën time nën një enë guri. Atje është një kalë që vrapon, i palodhur në drejtimin e tij." Kur gdhiu, ky burrë shkoi te Halid Ibn Uelidi dhe i rrëfeu ç'kishte parë. Njerëzit shkuan atje dhe e gjetën mburojën nën enën e gurit, ku ndodhej edhe kali[2]. Pra, Ebu Bekri e zbatoi porosinë e dalë në ëndërr, për shkak të fakteve që dëshmonin për vërtetësinë e saj. Megjithatë, nëse ëndrrat flasin e udhëzojnë për gjëra që bien në kundërshtim me Sheriatin, ato nuk duhet të merren në konsideratë, sepse nuk janë më ëndrra të mira.

[1] Ahmedi, Ebu Daudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhja. Sipas Albanit hadithi është i mirë.

[2] Trasmeton Hejthemiu në "Mexhma Ez-Zevaid" dhe ka thënë që këtë e trasmeton Tabaraniu.

Tema 45

Kush shan kohën, ka fyer Allahun.

Ka tri mënyra të sharjes së kohës:

1- Kur synohet vetëm kumti e jo sharja. Kjo lejohet, si për shembull, kur thuhet: "ç'ditë e nxehtë dhe e lodhshme sot", ose "ç'ditë e ftohtë", sepse veprat gjykohen sipas qëllimit të tyre. E tillë është thënia e Lutit (alejhi selam): "Kjo është ditë e rëndë" (Hud, 77).

2- Kur beson se ajo vepron në vetvete, se ajo i sjell çështjet në të mira dhe të këqija. Ky është shirk i madh, sepse besohet që, bashkë me Allahun, ka krijues tjetër dhe ndodhitë i atribuohen dikujt tjetër veç Allahut. Çdokush që beson se bashkë me Allahun ka krijues tjetër, është qafir, ashtu sikurse është qafir edhe ai që beson se bashkë me Allahun ka një të adhuruar tjetër që meriton të adhurohet.

3- Kur e shan kohën jo nga besimi se ajo është ndikuese – sepse beson se Allahu është veprues – por e shan sepse atëherë të vjen diçka që ti e urren. Kjo është haram, por nuk arrin në shkallën e shirkut. Është logjikë e dobët dhe humbje në fe, sepse në të vërtetë ofendimi i kalon Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), pasi Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) është Ai që e lëviz kohën, duke bërë që gjatë saj të ndodhin ato çfarë Ai dëshiron, qofshin të mira apo të këqija. Kështu që kjo sharje nuk është kufër, sepse nuk shahet Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) në mënyrë të drejtpërdrejtë.

– *"... ka fyer Allahun."* – Nuk është e thënë që fyerja të jetë dëmtuese. Mund të fyhesh kur dëgjon ose shikon diçka që s'të pëlqen, por pa u dëmtuar, ashtu sikur ndjen erën e keqe të qepës a hudhrës dhe nuk dëmtohesh nga ato. Allahu thotë në Kuran: "Pa

dyshim, ata që fyejnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, Allahu i mallkon në këtë botë dhe në tjetrën. Ai ka përgatitur për ta ndëshkim poshtërues." (Ahzab, 57). Në një hadith kudsij, Allahu i Lartësuar thotë: "Më fyeu biri i Ademit: shan kohën, kur Unë jam koha, Unë sjell ndryshimin e natës dhe të ditës."[1] Por Ai e ka mohuar që mund të dëmtohet, kur thotë: "... nuk mund t'i bëjnë kurrfarë dëmi Allahut ..." (Ali Imran, 177), si dhe në hadithin kudsij: "O robërit e Mi! E keqja juaj nuk mund të arrijë tek Unë, e ju nuk mund të më dëmtoni Mua ...".[2]

> "Ata thonë: 'Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë dhe vetëm koha na shkatërron ...'". (Xhathijeh, 24)

– *"... Ata thonë: 'Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë ...*" – Kështu thonin idhujtarët, të cilët janë njëlloj si ateistët. Ata besojnë se koha është ajo që i vë gjërat në lëvizje, besojnë se nuk ka jetë dhe botë tjetër përveç kësaj. Jeta për ta është: disa vdesin, disa vijnë në jetë, disa varrosen, disa lindin e jeton; njeriu del nga barku i nënës, ndërsa toka e gëlltit dhe nuk ka asgjë tjetër veç kësaj.

– *"... dhe vetëm koha na shkatërron ...*" – Pra, shkatërrimi nuk vjen me urdhrin dhe caktimin e Allahut, por nga kalimi i shumë viteve, për jetëgjatët, si dhe nga sëmundjet, brengat e sikletet, për ata që vdesin shpejt. Pra, është koha ajo që shkatërron.

Ajeti vazhdon: "... Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, ata vetëm hamendësojnë ashtu."

"Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, por vetëm hamendësojnë" do të thotë ata nuk dinë gjë, sepse dija dhe realiteti i kundërshtojnë ata.

Qëndrimin e tyre, se nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, se jetojmë e vdesim dhe kaq, e hedhin poshtë e argumentet e Sheriatit dhe logjika e pastër e njeriut:

[1] Buhariu dhe Muslimi.
[2] Muslimi.

Argumentet e Sheriatit; Kurani dhe Suneti tregojnë për egzistencën e botës tjetër, dhe se besimi në të është detyrë. Njerëzit përveç jetës së kësaj bote do të kenë edhe jetën e botës tjetër. Edhe librat e tjerë qiellorë flasin për këtë, dhe e përforcojnë.

Logjika; Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e ka bërë detyrë për njerëzit Islamin, ftesën në të, si dhe xhihadin për ngritjen e fjalës së Allahut, edhe pse këto shoqërohen shpesh me humbje jete, me robërim të grave dhe e fëmijëve. Atëherë, është jashtë logjike që njerëzit të përballeshin me të gjitha këto detyrime dhe më pas të bëheshin dhe e pluhur, pa pasur ringjallje, as jetë tjetër, as shpërblim, as dënim. Urtësia e Allahut e kundërshton këtë: "Me të vërtetë, Ai që të ka zbritur ty (o Muhamed) Kuranin dhe ta ka bërë detyrë komunikimin dhe të kapurit pas tij, patjetër do të të kthejë në botën tjetër." (Kasas, 85). Pra, Ai që të zbriti Kuranin dhe ta bëri detyrë të punosh me të dhe që të thërrasësh në rrugën e Tij, patjetër që do të të shpjerë në vendin ku do të shpërblehesh, dhe kjo vlen për të gjithë.

Edhe qëndrimin e tyre se: "vetëm koha na shkatërron", e hedhin poshtë argumentet e Sheriatit dhe përvoja:

Argumentet e Sheriatit; Kurani dhe Suneti tregojnë se jeta dhe vdekja janë në Dorën e Allahut: "Ai jep jetën dhe vdekjen, dhe tek Ai do të ktheheni." (Junus, 56). Allahu thotë për Isain (alejhi selam): "... i ngjall të vdekurit me lejen e Allahut ..." (Ali Imran, 49).

Ndërsa për sa i përket përvojës, ne e dimë se ka pasur njerëz jetëgjatë, si Nuhu e të tjerë, që nuk i shkatërroi koha. Shikojmë gjithashtu foshnja që vdesin në muajin e parë të lindjes, apo të rinj që vdesin në kulmin e moshës së tyre. Pra, nuk është koha ajo që i vdes ata.

Ajeti lidhet me temën sepse kush ia atribuon ngjarjet kohës, nëse i ndodh diçka që e urren, do ta shajë atë.

> Ebu Hurejre përcjell hadithin e saktë se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka treguar: "Allahu i Lartësuar thotë: Më fyeu biri i Ademit: shanë kohën, kur Unë jam koha, Unë sjell ndryshimin e natës dhe të ditës."[1]

[1] Buhariu dhe Muslimi.

Ky është një hadith kudsij. Hadithet kudsij janë të gjitha ato që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka përcjellë nga Zoti i tij i Lartësuar. Më parë, në temën “Vlera e teuhidit dhe gjynahet që ai fshin”, kemi folur në lidhje me këtë çështje.[1]

– *“... Allahu i Lartësuar thotë ...”* – Fjala “i Lartësuar” tregon se Ai (Subhanehu ue Te‘Ala) është larg nga çdo gjë e mangët dhe e ulët. Ai është i Lartësuar në Qenien dhe cilësitë e Tij. Po kështu, ajo fjalë

---

[1] Për hadithet *kudsij* nuk ka po ato rregulla që ka për Kuranin.
- Lejohet prekja e tyre pa abdes.
- I lejohet personi që është xhunub dhe gruas me menstruacione, që t’i lexojë.
- Nuk lexohen në namaz.
- Lejohet shitja e tyre.
- Transmetohet edhe duke treguar vetëm kuptimin.

Në lidhje me hadithin *kudsij*, dijetarët janë kundërshtuar, a i atribuohet Allahut shprehja dhe domëthënia (kuptimi), apo vetëm shprehja.
E sakta është se ai është fjalë e Allahut si domethënie (kuptim), ndërsa shprehja është nga i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Shprehja është e krijuar, ndërsa kuptimi nuk është i krijuar, se po të ishte fjalë e Allahut, do të ishte muxhize (mrekulli), pasi fjalës së Tij nuk i ngjason fjala e njerëzve. Gjithashtu, po të ishte fjalë e Allahut, nuk do të kishte kontradiktë në shprehje dhe transmetime, sepse fjala e Allahut është e ruajtur, prandaj në Kuran nuk shtohet e as nuk pakësohet.
Nëse dikush do të thoshte se i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ia ka atribuuar Allahut, e nëse fjala i atribuohet thënësit të saj, i përket atij si në shprehje ashtu edhe në kuptim, përgjigjemi se në parim kjo është e sakta, përderisa nuk ka ndonjë ndalesë, mirëpo këtu ka një ndalesë që e nxjerr nga origjina. Kjo ndalesë qëndron në faktin se po të ishte fjalë e Allahut në shprehje dhe kuptim, atëherë do të zbatoheshin për të rregullat e Kuranit, sepse Sheriati nuk bën dallim ndërmjet dy gjërave të barabarta. Nuk është e çuditshme që ti atribuohet fjala dikujt, duke pasur në konsideratë kuptimin e saj. E gjithë ç’ka ardhur në Kuran nga fjalët që u atribuohen të Dërguarve dhe popujve të tyre, u është atribuar në aspektin e kuptimit, sepse ato janë shprehur në gjuhën arabe, ndërsa gjuha e tyre nuk ka qenë arabishtja. Po kështu, Allahu ka përmendur fjalën e të njëjtit thënës, me shprehje të ndryshme, duke ia përshtatur metodës së Kuranit, siç vjen në fjalën e Tij për magjistarët e Faraonit: “dhe thanë: ‘Ne besojmë në Zotin e botëve. Zotin e Musait dhe Harunit!’” (Shuara, 47-48) Në një ajet tjetër Allahu thotë: “Atëherë, magjistarët ranë në sexhde dhe thanë: ‘Ne besojmë në Zotin e Harunit dhe Musait.’” (Ta Ha, 70) Pra, është vendosur në ajetin e fundit Haruni para Musait, për arsye të përshtatjes së krerëve të ajeteve (Kjo pjesë është marrë nga botimi i parë.)

shërben si dëlirësim i Tij nga ajo që thonë ata.

– *"... Më fyeu biri i Ademit ..."* – Pra, biri i Ademit më ofendoi. Fyerja ndaj Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) është e pohuar nga Vetë Ai, prandaj edhe ne duhet ta pohojmë atë, sepse ne nuk e njohim Atë më shumë sesa ai Vetveten.

Megjithatë, ajo nuk është si fyerja e krijesës, siç thotë Allahu: "Asgjë nuk i shëmbëllen Atij; Ai është Dëgjuesi, Shikuesi." (Shura, 11). Në këtë ajet, mohimi është vendosur para pohimit, me qëllim që pohimi të zërë vend në një zemër që është e zbrazur nga iluzioni i shëmbëllimit, duke e bërë pohimin në atë mënyrë që i përshtatet Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Nuk shëmbëllehen as cilësitë e Tij, as Qenia e Tij. Çdo përshkrim që Allahu i ka bërë Vetes së Tij ose që ia ka bërë i Dërguari i Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), nuk ka mundësi shëmbëllimi, se po të ishte ashtu, atëherë do të pranohej edhe mundësia e kufrit në fjalën e Tij dhe fjalën e Profetit të Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

– *"... biri i Ademit ..."* – Ky term përfshin meshkujt dhe femrat. Ademi është babai i njerëzimit. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e krijoi atë nga balta, i dha formë, i fryu shpirtin e krijuar prej Tij, i urdhëroi melekët që t'i bënin sexhde dhe i mësoi atij të gjithë emrat e gjërave.

Është për të ardhur keq që ekziston një teori mohuese, se njerëzit rrjedhin nga majmuni e jo nga balta. Çështja ka shkuar deri atje saqë thuhet që njerëzit, me kalimin e viteve, mund të evoluojnë e të përparojnë, derisa të bëhen engjëj. Nuk ka dyshim se një teori e tillë është kufër dhe mohim i qartë i Kuranit. Ne e kemi detyrë që ta kundërshtojmë fort dhe të mos e vendosim në tekstet shkollore. Ndërsa mbështetësve të saj u thuhet se janë majmunë në formë njeriu. Kjo ngjan me një rast tjetër, me një palo poet që shkruante:

Kur kujtojmë Ademin dhe se ç'bëri ai,
Martesën e dy bijave me dy bijtë e tij,
Mësojmë se njerëzit nga kurvëria vijnë,
Kopila të gjithë janë në origjinë.

Disa dijetarë i kanë thënë këtij: "Meqë e ke pranuar për veten se je kopil, i tillë je! Por për të tjerët nuk e pranojmë". Ose i janë

kundërpërgjigjur me dy vargje:

Pohimi i atij robi veç atij i shkon,
Por aspak të tjerëve, si feja na mëson!

Mirëpo, në realitet, mua më vjen keq që këto ide i has në të rinjtë tanë, disa prej të cilëve mendojnë se ato janë të mundshme, kur e vërteta është që ato janë veç gënjeshtra. Ato ndihmojnë të fusin dyshime te muslimanët për mënyrën e krijimit të Ademit dhe të bijve të tij, ashtu siç ka treguar Allahu (Subhanehu ue Te'Ala).

Gjithashtu, diçka tjetër nga e cila duhet pasur kujdes, është zëvendësimi i konceptit "feja islame" me shprehjen "mendimi islam", duke e thjeshtuar Islamin në një mendim, i cili edhe mund të kundërshtohet, si të gjithë mendimet e tjera. Këtë ide të rrezikshme e kanë futur tinëzisht ndër ne armiqtë tanë, pasi Islami është ligj nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) dhe nuk është mendim njerëzor.

– *"... shan kohën ..."* – Pra, e shan atë, duke përdorur fjalë të ulëta për të, ndoshta edhe e mallkon. Kështu ai fyen Allahun.

– *"... kur Unë jam koha ..."* – Pra: Unë jam Planifikuesi i kohës dhe Zotëruesi i saj. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Ato ditë (fitoreje apo humbje) Ne i ndërrojmë midis njerëzve ..." (Ali Imran, 140).

– *"... Unë sjell ndryshimin e natës dhe ditës."* – Dita dhe nata janë kohë. Nuk thuhet se Allahu është vetë koha, pasi kështu e bën Krijuesin krijesë dhe Ndryshuesin e bën të ndryshueshëm.

Po a nuk është i ndaluar figuracioni në thëniet e Allahut dhe të Profetit të Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem)?

Thënia ka kuptim real, i dalë nga konteksti dhe vijimi i kumtit. Fjalia ka elipsë, dhe kuptimi i saj është: "Unë jam Ndryshuesi i kohës", kuptim të cilin Ai e shpjegon në vijim: "Unë sjell ndryshimin e natës dhe ditës." Logjika, gjithashtu, nuk mund ta bëjë të krijuar krijuesin dhe të ndikuar ndikuesin, ashtu si nuk mund ta bëjë të ndryshuar ndryshuesin.

Shpjegimi i mësipërm nxjerr në pah qëndrimin e gabuar të disave, – si Ibn Hazmi, për shembull (Allahu e mëshiroftë!), – se *Dehr* (Koha) është një nga emrat e Allahut. Kjo është një shkarje në

të kuptuarit e këtij hadithi dhe në parimet themelore mbi emrat e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

Për sa i përket kuptimit të hadithit, sharësit e kohës nuk kishin si qëllim fyerjen e Allahut, por vetëm kohën në vetvete. Nga ana tjetër, një parim në lidhje me emrat e Allahut, është që ata të jenë të bukur, pra të kenë kuptimet më të mira që mund të ekzistojnë, nëse i analizon. Nuk ka emër të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) që të jetë i pazbërthyeshëm, pa domethënie. Një emër i pazbërthyeshëm nuk ka domethënie të mirë apo jo të mirë, por emrat e Allahut janë që të gjithë të bukur, e kjo do të thotë se ato kanë domethënie. Kështu, fjala "*dehr*" (kohë) nuk ka ndonjë kuptim tjetër, prandaj ajo nuk mund të jetë emër i Allahut.

Përfundimisht, "*dehr*" nuk është emër i Allahut, për dy arsye: 1- kundërshtohet nga konteksti; 2- emrat e Allahut janë të bukur, ndërsa "*dehr*" nuk tregon gjë tjetër veç kohës.

– "*... Unë sjell ndryshimin e natës dhe ditës.*" – Pra: ndryshoj qenien e tyre dhe çka ndodh në to. Nata dhe dita ndryshojnë në kohëzgjatjen e tyre, deri sa bëhen të barabarta. Ndodhitë ndryshojnë në kohë, në orë, ditë, javë, muaj dhe vite. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Thuaj (o Muhamed): 'O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë.'" (Ali Imran, 26).

Kjo është e dukshme. Ky ndryshim përmban urtësi, të cilat mund t'i njohim ose jo. Urtësia e Allahut është më e gjerë sesa mund ta përfshijnë mendjet tona. Vetëm shfaqja e sundimit të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) dhe pushtetit absolut të Tij janë urtësi, sepse kështu njeriu i frikësohet Atij që e ka këtë sundim dhe pushtet, i përulet e kthehet tek Ai.

> Sipas një transmetimi tjetër, thuhet: "Mos e shani kohën, se vërtet Allahu është koha."[1]

[1] Muslimi.

Dobia e këtij transmetimi është se ai e ndalon qartë sharjen e kohës. Një element i retorikës në fjalën e Allahut dhe Profetit të Tij, është shoqërimi i një gjykimi me arsyen e tij. Arsyeja tregon urtësinë e Allahut, ajo shton qetësinë te njeriu dhe e ndihmon këtë të fundit të gjykojë për raste të tjera. Këto janë tri të mirat e shoqërimit të një gjykimi me arsyetim.

Dobitë e temës

- Ndalimi i sharjes së kohës.
- Sharja e kohës është fyerje për Allahun.
- Komenti i shprehjes: "Allahu është koha."

Kjo do të thotë se Allahu është Ndryshuesi dhe Zotëruesi i kohës dhe jo se Allahu është vetë koha.

- Njeriu bëhet ofendues, edhe nëse nuk e ka qëllim në zemër.

Kjo del nga hadithi: "Më feu biri i Ademit ...", ku nuk flitet për qëllimin e njeriut.

Sikur autori të kishte thënë: "Njeriu bëhet ofendues, edhe nëse nuk e ka qëllim në zemër", do të ishte më e qartë dhe më e saktë, sepse dihet që veprimet maten me qëllimet e tyre.

Autorit (Allahu e mëshiroftë!) nuk ka renditur disa pika të tjera, njëra prej të cilave është komenti i sures "Xhathijeh".

Tema 46

Emërtimi “gjykatësi i gjykatësve”.

Flitet për rastin kur njeriu quan veten me këtë emër ose kënaqet kur thirret me këtë emër.

Emërtimet “gjykatësi i gjykatësve” apo “mbreti i mbretërve”, “sunduesi i sunduesve” etj., tregojnë fuqi dhe pushtet të madh.

Gjykatësi ka në dorë vendimin dhe detyrimin për ekzekutimin e vendimit, ndryshe nga dhënësi i fetvasë, i cili nuk e ka këtë detyrim. Prandaj thuhet se gjykatësi ka tri atribute: dëshmitar, ekzekutues dhe myfti. Ai dëshmon se po jep gjykimin e Allahut, ai jep vendimin sipas të drejtës së Allahut dhe i detyron dy palët në gjyq të zbatojnë vendimin e tij.

Kjo temë lidhet me teuhidin, sepse kush vetëquhet me këtë emër, e ka konsideruar veten si të barabartë me Allahun në një titull që nuk e meriton askush përveç Tij. Askush tjetër nuk e meriton të quhet “gjykatës i gjykatësve”, “sundues i sunduesve” apo “mbret i mbretërve”, përveç Allahut të Madhëruar. Allahu është Gjykatës mbi çdo gjykatës, në Dorën e Tij është gjykimi dhe tek Ai kthehen të gjitha çështjet, siç thotë Ai vetë në Kuran.

Më lart, kemi thënë gjykimi (apo përcaktimi) i Allahut është dy llojesh: 1- juridik; 2- universal, mbi të gjithë krijimin.

Përcaktimi juridik mund të zbatohet ose jo, dhe përfshin vetëm atë që Allahu e do, siç thotë Ai: “Ndërsa Zoti yt ka përcaktuar (*kada*) që të mos adhuroni asgjë tjetër përveç Tij, dhe që të jesh respektues ndaj prindërve”. Ky përcaktim mund të zbatohet ose jo, sepse jo të gjithë njerëzit e adhurojnë Allahun të Vetëm.

Ndërsa gjykimi mbi të gjithë krijimin zbatohet patjetër, dhe

përfshin atë që e do Allahu dhe atë që Ai nuk e do. Shembull për këtë është thënia e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "Dhe Ne përcaktuam për bijtë e Israilit në Libër (Teurat) se 'vërtet ju do të bëni dy herë padrejtësi në tokë ...'" (Isra, 4). Këtu bëhet fjalë për përcaktimin e një ligji universal, sepse Allahu nuk ligjëron e as nuk e do padrejtësinë në tokë.

Shtrohet pyetja: A lejohet që këtë emërtim ta përcaktojmë dhe kufizojmë me një grup të caktuar, vend të caktuar ose kohë të caktuar, si për shembull të themi: gjykatës i gjykatësve në jurisprudencë, gjykatës i gjykatësve në Arabinë Saudite, ose gjykatës i gjykatësve në Egjipt, Jordani etj.?

Kufizimi me vend lejohet, sepse gjykimi i Allahut është i pakufizuar, kështu që pohimi nuk vë barazi me Allahun e Madhëruar. Megjithatë, edhe pse lejohet, nuk është mirë që njeriu të përdorë të tilla emërtime, pasi është e vështirë ta kontrollojë veten, nëse i thonë "gjykatësi i gjykatësve" në një zonë të caktuar. Ashtu atij mund t'i pëlqejë vetja ose të vetëmashtrohet, aq sa të mos e pranojë më të vërtetën, nëse bie ndesh me mendimin e tij. Është e rrezikshme kur njeriut i pëlqen mendimi i vet, deri atje sa t'ua imponojë atë edhe të tjerëve.

Edhe me kufizim në një disiplinë të caktuar lejohet, por nëse thuhet, për shembull: "dijetari i dijetarëve në *fikh*", me kuptim të përgjithshëm, duhet pasur kujdes, sepse *fikh*-u përfshin bazat e fesë dhe degëzimet e saj, siç thotë Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Atë që Allahu i do të mirën, e bën të kuptojë fenë".[1] Por në rastin tonë flitet për atë që njerëzit e pyesin mbi çështjet e Sheriatit.

Nëse shprehja kufizohet me një grup të caktuar, përsëri lejohet, por përsëri duhet pasur kujdes që njeriu të mos gënjehet e t'i pëlqejë vetja. Dikush lavdëroi shokun e vet, por Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i tha: "Ia preve qafën shokut tënd!"[2]

Ndërsa emërtimi "Shejhu i Islamit", – si për shembull, Shejhu i Islamit Ibn Tejmije ose Shejhu i Islamit Muhamed Ibn Abdul Uehabi, – do të thotë: dijetari absolut, tek i cili mbështetet Islami dhe, si i tillë, nuk qëndron, pasi po të kishte ndonjë që do ta meritonte më shumë këtë titull, do të ishte Ebu Bekri, njeriu më i

[1] Buhariu, Muslimi.
[2] Buhariu, Muslimi.

mirë pas Profetëve. Por, nëse ky titull vendoset për ata njerëz që njihen si përtëritës të fesë, si kontribuues të mëdhenj në pastrimin dhe ruajtjen e saj, atëherë nuk ka asgjë të keqe në përdorimin e tij.

Titulli "*imam*" është shumë më i lehtë sesa "Shejhu i Islamit", sepse vetë Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e ka emërtuar "imam" drejtuesin e xhamisë, qofshin në xhami vetëm dy persona. Megjithatë, duhet të tërheqim vërejtjen se ky titull duhet të përdoret vetëm për ata që janë model për të tjerët dhe kanë pasuesit e tyre, si për shembull, imam Ahmedi, imam Buhariu, imam Muslimi, që kanë lënë gjurmë në Islam. Titulli që nuk meritohet është shkatërrim për umetin, pasi kur pandehet për imam një që s'është i tillë, atëherë do të nënçmohet imami i vërtetë, siç thonë vargjet:

A s'e sheh, vallë, si shpatën përçmojnë,
kur me një shkop atë e krahasojnë?

Ofiqe të tjera janë gjithashtu: *ajatullah* (shenjë ose argument i Allahut), *huxhetullah* (shenjë ose argument i Allahut), apo *huxhetul Islam* (shenjë ose argument i Islamit), të cilat janë të gjitha të shpikura dhe nuk duhen përdorur. Nuk ka njerëz që janë argumente apo shenja të Allahut, përveç Profetëve.

Nëse këto fjalë përdoren me kuptim të përgjithshëm, ato nuk janë tituj lavdërues, sepse gjithçka në këtë botë është shenjë, dëshmi e Allahut, siç thonë:

Gjithçka dëshmon, çdo gjë,
që Zoti ynë është Një.

Por nëse u jepet kuptim i posaçëm, duke e quajtur shenjën një mrekulli, atëherë në të shumtën e rasteve kemi të bëjmë me teprim, me tejkalim caqesh.

Emërtime të rregullta, janë: *alim* (dijetar), *myfti*, *kadi* (gjykatës), *hakim* (prijës) dhe *imam*, për ata që i meritojnë.

> Sipas një hadithi të saktë, përcjellë nga Ebu Hurejra, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Emri më i ulët për Allahun është ai i një burri të vetëquajtur "Mbreti i mbretërve", se nuk ka sundues tjetër absolut veç Allahut!" [1]

[1] Buhariu, Muslimi.

– *"... Memri më i ulët ..."* – Nënkuptohet "më i ulëti njeri që mban këtë emër". Ky është emri më i ulët te Allahu për një njeri, sepse e ka ngritur veten më lart se ç'duhet. Mbreti është në pozitën më të lartë të njerëzve, në aspektin e pushtetit, ndërsa ngritja mbi këtë nivel vlen vetëm për Allahun e Madhëruar. Për këtë arsye, ai është emri më i ulët tek Allahu dhe ndëshkohet me nënçmim, nëse synohet madhërimi mbi mbretërit e tjerë. Emrat më të dashur për Allahun janë ata që tregojnë nënshtrim e përulje, si: Abdullah (Rob i Allahut) dhe Abdurrahman (Rob i Mëshiruesit), ndërsa më të urryerit janë ata që tregojnë lartësim dhe sundim tej mase.

– *"... Nuk ka sundues tjetër absolut veç Allahut!"* – Nuk ka mbret (*malik*) mbi mbretërit, mbret absolut, veç Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Po kështu, nuk ka mbisundues (*melik*) tjetër veç Allahut. Prandaj, ajeti i Fatiha-së ka ardhur me dy leksime: "*Meliki jeumiddin*" dhe "*Maliki jeumiddin*", duke bashkuar sundimin dhe pushtetin e plotë. Ai është *Malik* dhe *Melik*. Ai është *Malik*, Mbret që drejton punët e të gjitha krijesave të Tij, po kështu është edhe *Melik*, me pushtet, madhështi dhe fjalë të realizueshme.

Të Allahut janë krijimi, sundimi, rregullimi i çështjeve të krijesave të Tij. Nuk ka Krijues, Sundues dhe Administrues përveç Tij. Allahu i Madhëruar thotë:

- "A ka ndonjë krijues, veç Allahut, i cili ju furnizon nga qielli dhe Toka? S'ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij. Atëherë si largoheni ju?" (Fatir, 3). Pyetja e parë është me kuptimin e mohimit, e ndoshta edhe me kuptimin e sfidës, që do të thotë: nëse i gjeni, sillini ata.

- "Vërtet, Zoti yt është Krijuesi Madhështor, i Gjithëdijshmi." (Hixhr, 86). Kjo dëshmon se Ai është i vetëm në krijim.

- "Vërtet, ata që ju i adhuroni në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe nëse bashkohen të gjithë për këtë. E, nëse miza u merr atyre diçka, ata nuk do të mund t'ia marrin." (Haxh, 73). Përemri "ata" përfshin gjithçka që njerëzit u luten, përveç Allahut. Shprehja "nuk mund të krijojnë as edhe një mizë", është figurative, që do të thotë se nuk mund të krijojnë asgjë, më e vogël apo më e madhe qoftë.

- “Qoftë i lartësuar Ai, në Dorën e të Cilit është pushteti suprem …”. (Mulk, 1)

- “Thuaj: ‘O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit!’…” (Ali Imran, 26). Ky është argument se Ai është i vetëm në sundim.

- “Thuaju: ‘Kush ju sjell furnizim nga qielli dhe nga toka dhe kush është Zotëruesi i dëgjimit dhe shikimit? Kush e nxjerr të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush është Rregulluesi i të gjitha çështjeve?’ Do të thonë të gjithë: ‘Allahu’…” (Junus, 31).

> Sufjani thotë që ky titull (mbret i mbretërve) është si “Shahu i shahëve”.
> Ndërsa sipas një transmetimi tjetër, hadithi nis: “*Njeriu më zemërues për Allahun në Ditën e Kiametit dhe më i keqi…*”.[1]

Sufjani (Ibn Ujejene) ka dhënë variantin në gjuhën perse të emërtimit “mbret i mbretërve”.

– *“Njeriu më zemërues për Allahun në Ditën e Kijametit dhe më i keqi …*” - Përderisa mbajtja e një titulli të tillë është shkak për zemërimin e Allahut, atëherë kuptohet që është mëkat i madh.

Fjala “*ag’jedh*” (më zemërues), që përmendet në hadith, lidhet me “*el gajdh*” – zemërimim. Gjithashtu në hadith, pohohet për Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala) cilësia e zemërimit. Kjo cilësi e Allahut është ashtu siç i përshtatet Atij. Ashtu sikrse edhe cilësit e tjera.

Dobitë e temës

- Ndalimi i emërtimit “mbret i mbretërve”.

Ndalimi fetar nuk kuptohet veç nga një deklaratë e drejtpërdrejtë, por del edhe nga forma të tjera, siç është qortimi ose sharja ndaj

[1] Muslim.

vepruesit të saj e të ngjashme, tregojnë për ndalesë.

> ➢ Të njëjtin gjykim ka edhe çdo titull që ka atë kuptim, siç tregoi Sufjani.

Shprehje që kanë atë kuptim janë: "gjykatës i gjykatësve", "sundues i sunduesve" apo "Shahu i shahëve" në gjuhë perse.

> ➢ Qëndrimi i ashpër ndaj dukurive të tilla, edhe pse nuk janë të qëllimshme.

"Nuk janë të qëllimshme", do të thotë se njeriu mund të mos i përdorë me kuptimin e drejtpërdrejtë që ato mbajnë, por për të thënë thjesht se pushteti i titullarit është i madh apo se gjykimi i tij është mjaft i përpiktë.

Nga ana tjetër, nëse e emërtojmë dikë "gjykatës i gjykatësve" ose "prijës i prijësve", ndërkohë që ai nuk është i tillë, por është më i padituri i gjykatësve apo më i dobëti i prijësve, atëherë kemi rënë në dy harame: në gënjeshtër dhe në përdorimin e një shprehjeje të ndaluar. E nëse është vërtet më i dituri i kohës së vet ose më i dituri i atij vendi, aq sa shkojnë për ta pyetur edhe gjykatësit e tjerë, ky emërtim, – edhe pse me këtë kuptim është i vërtetë, – është përsëri i ndaluar.

> ➢ Shkaku i ndalesës në këtë temë është Allahu (Subhanehu ue Te'Ala).

Kjo del nga thënia vijuese në hadith: "Nuk ka sundues tjetër absolut veç Allahut!". Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) tregoi arsyen: Si mund të thuash "mbret i mbretërve", kur nuk ka të tillë përveç Allahut?!

- Ndryshimi ndërmjet emërtimeve "*Melik*" dhe "*Malik*". Jo çdo "*melik*" është edhe "*malik*". Dikush mund të jetë *melik*, mirëpo nuk ka në dorë drejtimin e të gjitha çështjeve. Nga ana tjetër, dikush mund të jetë *malik*, por që komandon vetëm atë që zotëron. Nëse *melik*-u ka në dorë edhe drejtimin, atëherë është edhe *malik*. *Malik* quhet ai që drejton, që komandon diçka, si *malik el bejt* (pronari i

shtëpisë), *malik es sejareti* (zotëruesi i makinës) e të tjera.

Gjithashtu prej hadithit del:

- Pohimi se Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) zemërohet dhe urren, madje në shkallë të ndryshme.

- Urtësia e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) në mësimdhënie, duke treguar edhe arsyen pse ai emërtim ishte më i ulët dhe më i urryeri. Prandaj, çdo mësues duhet që t'i shoqërojë rregullat që u mëson të tjerëve me argumentet e Sheriatit ose me arsye logjike të pranueshme, në mënyrë që zemrat të jenë më të qeta. Ibn Kajimi thotë: "Dija është njohja e udhëzimit me argumentin e tij. Ajo dhe imitimi i verbër nuk barazohen."

Dija është shoqërimi i njohjes së rregullave dhe normave me provat e sakta të përcjella deri tek ne, ose ato të pranueshme. Provat e përcjellat tek ne janë ato të Kuranit, Sunetit dhe të qëndrimit unik të dijetarëve, ndërsa të pranueshme janë arsyet që pranohen nga Sheriati.

Tema 47

Respektimi i emrave të Allahut dhe ndryshimi i emrit, për shkak të Tij.

Emrat e Allahut të Madhëruar janë fjalët me të cilat Allahu ka emërtuar Vetveten, apo ato me të cilat e ka emërtuar Pejgamberi i Tij. Ne kemi folur edhe më lart për këtë çështje, e kemi thënë, pak a shumë:

1. Emrat e Allahut janë sinonimikë apo polisemikë?

Të gjithë emrat e Allahut, si shenjues, janë sinonimikë, sepse ata emërtojnë të gjithë të njëjtën qenie, Allahun. Kurse në aspektin e kuptimit dhe vetisë që përmban, japin kuptime të ndryshme (polisemikë), megjithëse disa prej tyre mund të tregojnë për një atribut që përmban një emër tjetër me anë të asaj që kuptohet pashmangshmërisht. Shembull: "Krijues" përfshin në mënyrë të pashmangshme 'dijen' që rrjedh nga emri El-Alim "i Ditur", po kështu tregon edhe për fuqinë që rrjedh prej emrit El-Kadir "i Plotfuqishëm", por si një nënkuptim i pashmangshëm.

2. Emrat e Allahut janë vetëm shenjues apo janë edhe atribute?

Si emra, ata tregojnë Qenien e Allahut, duke e dalluar Atë nga të tjerët, por ata kanë edhe domethëniet e tyre, e si të tillë ata shërbejnë si fjalë përshkruese të Zotit, si atribute të Tij.

Emrat e Zotit nuk janë si emrat e njerëzve. Dikush mund të quhet *Muhamed* (i Lavdëruar), por në realitet mund të jetë ndër njerëzit më të ulët, ose mund të quhet *Abdullah* (rob i Allahut), por mund të jetë njeriu më i prishur.

Ndërkaq, emrat e Allahut, emrat e Profetit, emrat e Kuranit,

emrat e Ditës së Gjykimit e të ngjashëm, janë edhe atribute reale.

3. Disa nga emrat e Allahut janë të njohur, e disa të tjerë janë të panjohur për ne.

Dëshmi për këtë është lutja e pikëllimit, e bërë nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “...Të lus Ty me çdo emër që Ti ke, me të cilin e ke quajtur Veten Tënde, që e ke zbritur në Librin Tënd, që ia ke mësuar ndonjërës nga krijesat e Tua ose që e ke ruajtur në dijen Tënde të fshehtë, që ndodhet tek Ti! Bëje Kuranin e Madhëruar pranverën e zemrës sime dhe dritën e gjoksit tim, të tillë që të më largojë brengën, mërzitjen dhe vështirësinë time! ...”[1]. Dihet se atë çfarë Allahu ruan në Diturinë e Tij, nuk mund ta dijë askush tjetër.

4- A ka një numër të caktuar të emrave të Allahut?

Jo nuk ka. Këtë çështje e kemi shtjelluar më lart, duke shpjeguar edhe thënien e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Allahu ka nëntëdhjetë e nëntë emra. Kush i mëson ata, futet në Xhenet.”[2]

5- Këta nëntëdhjetë e nëntë emra nuk janë të caktuar, por është lënë në dorën tonë që t’i kërkojmë e t’i mësojmë, derisa të arrijmë në nëntëdhjetë e nëntë.

Urtësia e fshehjes së tyre është që ne t’i kërkojmë, derisa t’ia arrijmë qëllimit. Kjo është si fshehja e Natës së Kadrit, orës së përgjigjes së lutjes në ditën e Xhuma, orës së përgjigjes së lutjes gjatë natës, etj., që njerëzit të përpiqen për gjetjen e tyre.

6. T’i mësosh këta emra për t’u futur në Xhenet, nuk do të thotë që thjesht t’i mësosh përmendësh, por, së pari, t’i mësojmë përmendësh; së dyti, të dimë domethënien e tyre; së treti, ta adhurojmë Allahun sipas domethënieve të tyre. Kjo e fundit bëhet në dy mënyra:

E para: Ta lutësh Allahun me ta, siç thotë Ai (Subhanehu ue Te‘Ala): “Me të vërtetë Allahut i përkasin emrat më të bukur, prandaj lutjuni Atij me to ...” (Araf, 180), duke i bërë mjet për arritjen e kërkesës tënde dhe duke zgjedhur emrin e përshtatshëm për këtë kërkesë. Kur kërkon falje, të thuash: “O Falës, më fal mua!”. Nuk është e përshtatshme të thuash: “O Ndëshkues i Rreptë, më fal mua!” Madje, kjo duket si tallje, por mund të thuash: “Më

[1] Grada e hadithit është përmendur më parë.

[2] Ahmedi, Ibn Hibani, Tebarani. Grada e hadithit është përmendur më parë.

shpëto nga dënimi Yt!"

E dyta: T'i përmbahesh këtyre emrave në adhurimin tënd. Emri *Err Rrahim* do të thotë Mëshirues, prandaj bëj vepra të mira, që të fitosh mëshirën e Allahut. Emri *El Gafurr* do të thotë Falës, prandaj bëj gjithçka që të fitosh faljen e gjynaheve të tua.

Nëse përmbushen këto kushte, atëherë e fiton çmimin e futjes në Xhenet. Kjo nuk është meritë e plotë, që duhet shlyer, por është thjesht një shkak, sepse veprat e mira janë shkak për futjen në Xhenet e jo kompensim. Një hadith i saktë nga Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) thotë: "Askush prej jush nuk ka për t'u futur në Xhenet me punën e tij." E pyetën: "As ti, o Pejgamberi i Allahut?!" Ai tha: "As unë, por Allahu do të më përfshijë në mëshirën e Tij".[1] Prandaj, o vëlla, mos u mashtro me punën tënde dhe mos u kënaq me veten e të thuash se do të futesh në Xhenet patjetër, pasi ke bërë këtë e atë vepër të mirë. Allahu thotë: "Ata e quajnë si favor për ty (Muhamed), që ata kanë përqafuar Islamin. Thuaj: 'Mos e quani si favor për mua se keni pranuar Islamin, përkundrazi, Allahu ju ka dhuruar mirësi dhe ju ka udhëzuar në besim ..." (Huxhurat, 17). Por ne e kemi detyrë që ta shohim mirësinë e Allahut mbi ne. Ndërsa për sa i përket shpërblimit, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "A ka shpërblim tjetër për të mirën, veç të mirës?!" (Rrahman, 60). Pra, ne besojmë se Allahu e shpërblen të mirën veç me të mirë.

7. Emrat e Allahut duke marrë parasysh kuptimin që përputhet shënojnë njëherësh qenien e Allahut dhe atributin e Tij. Duke marrë parasysh atë që përfshinë, shënon veças qenien e Allahut dhe veças atributin e Tij. Ndërsa Me anë të kuptimit që rrjedh pashmangshmërisht nga emri, të cilin në fakt nuk e përmban vetë domethënia e emrit, por është një rrjedhim i domosdoshëm i tij. Ky quhet nënkuptimi i pashmangshëm (*iltizam*). Për shembull, emri *El Khalik* (Krijuesi) shënon njëherësh Qenien e Zotit dhe cilësinë e krijimit duke marrë parasysh kuptimin që përputhet. Duke marrë parasysh atë që përfshinë, shënon veças qenien e Allahut dhe veças atributin e Tij. Dhe së fundi, në mënyrë të pashmangshme nënkupton edhe dijen e fuqinë e Tij

8. Besimi në emrat e Allahut, – kur emri është edhe atribut që

[1] Buhariu, Muslimi.

përshkruan një veprim, – është i plotë vetëm nëse përmbushen këto tri kushte:

1) të besosh vërtet se ai është emër i Allahut;

2) të besosh atributin që ai përshkruan;

3) të besosh pasojat dhe rezultatet që jep ai atribut.

Në lidhje me emrin "*El Alim*" (i Dituri), për shembull, nuk plotësohet besimi në të, derisa të besosh se El Alim është një nga emrat e Allahut, të besosh atributin që ai përshkruan, pra të besosh se Allahu është i ditur, si dhe të besosh rezultatin që rrjedh prej tij, domethënë që Ai di gjithçka.

E nëse emri është atribut që nuk përshkruan një veprim, atëherë duhet ta besojmë se ai është një nga emrat e Allahut dhe të besojmë atributin që ai përshkruan.

9. Ka emra të Zotit që janë të posaçëm për Të, siç janë: *Allah*, *Err Rrahman*, *Rrabil Alemin* (Zotëruesi i botërave) e të tjerë, por ka edhe emra që nuk janë të posaçëm për Të, si: *Err Rrahim* (i Mëshirshëm), *Es Semi* (Dëgjues), *El Alim* etj. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Në të vërtet, Ne e krijuam njeriun nga një pikël fare të përzier, për ta sprovuar dhe e bëmë atë dëgjues e shikues." (Insan, 2). Po kështu, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë për Profetin e Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "... dhe është i butë e i mëshirshëm për besimtarët." (Teube, 128).

– *"Respektimi i emrave të Allahut ..."* - Kjo do të thotë që respektimi i emrave të Allahut është detyrë, sepse respekti ndaj tyre është respekt ndaj Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Rrjedhimisht, askush nuk duhet të emërtohet me një emër që është i posaçëm për Allahun. Në këtë aspekt, ka dy lloje të emrave të Allahut:

1- Emra me të cilët nuk lejohet të thirret askush tjetër veç Allahut. Këta janë emra vetëm të Allahut, e nëse me një nga këta emra quhet dikush tjetër, ky e ka detyrë ta ndryshojë atë. Emra të tillë janë: *Allah, Err Rrahman, Rrabil Alemin* e të tjerë.

2- Emra me të cilët lejohet të thirren edhe të tjerë veç Allahut, si: *Rrahim, Semi, Besir* etj. Megjithatë, nëse merret parasysh atributi që emri përshkruan, përsëri ndalohet emërtimi me ta, por nëse është thjesht një emër i përveçëm që tregon një qenie të caktuar, emërtimi lejohet.

> Transmetohet se Ebu Shurejhu thirrej fillimisht Ebul Hakem (Babai i Gjykimit). Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i tha: “Gjykues është Allahu; Atij i përket gjykimi.” Ebu Shurejhu i tregoi: “Në fisin tim, kur kishin mosmarrëveshje për ndonjë çështje, vinin tek unë. Kur unë gjykoja ndërmjet tyre, të dyja palët kënaqeshin.” Profeti i tha: “Sa gjë e mirë kjo! Sa fëmijë ke ti?” Ai iu përgjigj: “Shurejhun, Muslimin dhe Abdullahin.” – “Kush është më i madhi i tyre.” – pyeti Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ai i tha: “Shurejhu.” Profeti tha: “Atëherë ti je Ebu Shurejhu (Babai i Shurejhut).”[1]

– *“Ebu Shurejhu ...”* – Ky qe Hani Ibn Jezid el Kindi, i cili shkoi tek Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) si delegat nga populli i tij.

– *“... thirrej fillimisht Ebul Hakem ...”* – Nëse paraprihet emri i njeriut, tek arabët, nga fjala “babai”, “nëna”, “vëllai”, “xhaxhai” ose “daja”, ai quhet *kunie*. Ky emërtim zakonisht ndërtohet për të shërbyer si një formë lavdëruese, siç është rasti në këtë hadith (Babai i Gjykuesit, Ligjvënësit, Gjykatësit). Po mund të përdoren edhe në forma përbuzëse, si për shembull, Ebu Xhehli (Babai i Injorancës). Këta elementë mund të shërbejnë gjithashtu, për të treguar një shoqërues tipik të të emërtuarit, si për shembull, Ebu Hurejre (Babai i Maces). Por ata mund të jenë thjesht për të ndërtuar emra të përveçëm, për t’u njohur, si për shembull, Ebu Bekër (r.a.) ose Ebu Abas Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!), i cili në fakt nuk pati fëmijë.

– *“Gjykues është Allahu; Atij i përket gjykimi ...”* – Kjo do të thotë se Ai meriton të jetë Gjykatës absolut i robërve të Tij. Gjykimi i Allahut është dy llojesh:

1- Gjykimi i përgjithshëm, mbi krijimin, të cilin askush nuk mund ta prapësojë. Për këtë flet ajeti: “... Nuk do të largohem prej

[1] Buhariu në "Et-Tarih el-Kebir", Ebu Daudi dhe të tjerë. Sipas Albanit zinxhiri transmetimit të këtij hadithi është i mirë.

këtij vendi, derisa të më lejojë babai im, ose të më gjykojë Allahu, sepse Ai është Gjykatësi më i mirë." (Jusuf, 80)

2- Gjykimi fetar, sipas të cilit njerëzit ndahen në dy grupe: besimtarë dhe jobesimtarë. Kush kënaqet dhe e zbaton atë, është besimtar, ndërsa ai që nuk kënaqet dhe as nuk gjykon me të, është jobesimtar. Për këtë flet ajeti: "Dhe në çfarëdo që të diskutoni (e të haheni), gjykimi për të është tek Allahu ..." (Shura, 10).

Ndërsa ajetet: "A nuk është Allahu Gjithëgjykuesi më i Urtë?" dhe: "E kush është më i mirë (më i drejtë) në gjykim sesa Allahu, për njerëzit që besojnë bindshëm?" (Maide, 50), flasin për gjykimin e përgjithshëm, mbi krijimin dhe për gjykimin fetar, edhe pse në ajetin e dytë duket se qëllimi është për gjykimin fetar, sipas kontekstit. Gjykimi fetar shoqërohet me pëlqim ose me urrejtje, ndërsa ai mbi krijimin është për çdo krijesë.

Hadithi tregon gjithashtu se nga emrat e Allahut, është edhe *El Hakem*. Ndërsa disa sahabë kanë thënë që Allahu është *El Hakem* (Gjykues) dhe *El Adl* (i Drejtë), mirëpo unë nuk e di që të ketë ndonjë dëshmi të tillë, që t'i atribuohet Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Por fjala e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "E kush është më i mirë në gjykim sesa Allahu, për njerëzit që besojnë bindshëm?" (Maide, 50), nuk ka dyshim që e përfshin drejtësinë, madje dhe më tepër se aq.

– *"... Ebu Shurejhu i tregoi: "Në fisin tim, kur kishin mosmarrëveshje për ndonjë çështje, vinin tek unë ...""* – Ai po tregonte arsyen përse e thirrnin ashtu.

– *"... Sa gjë e mirë kjo! ..."* – Domethënë sa gjë e mirë ishte ajo që bënte ai dhe jo emri i tij, sepse Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ia ndërroi në fund.

– *"... Shurejhun, Muslimin dhe Abdullahin ...*" – Me sa duket ai nuk kishte vajza, përndryshe do t'i përmendte edhe ato, sepse pyetja iu bë për të gjithë fëmijët, pa dallim gjinie.

– *"... Atëherë ti je Ebu Shurejhu.*" – Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ia ndryshoi emrin për dy arsye:

1- El Hakem është Allahu, prandaj kur të thirrej: "O Ebul Hakem!", do të ishte njësoj sikur t'i thuhej: "O Ebu Allah!".

2- Në emërtimin e këtij burri me këtë emër është marrë parasysh edhe kuptimi i atributit që përmban, pra të gjykuarit. Si i tillë, ai barazohej me emrat e Allahut, duke mos qenë thjesht një emër shenjues, por emër që kishte qëllim edhe domethënien e tij. Për këto arsye, Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i vuri atij një emër tjetër.

Dobitë e temës

- Respektimi i emrave dhe cilësive të Allahut, duke mos i përdorur ata për njerëzit, edhe nëse qëllimi nuk është te domethënia e tyre.

Unë kam njëfarë rezerve brenda vetes në lidhje me këtë pohim, pasi kur nuk është për qëllim domethënia e emrit, atëherë përdorimi i tij për njerëz është i lejuar, përveç atyre emrave që janë posaçërisht për Allahun. Ka pasur edhe sahabë që quheshin, për shembull, *Hakem*[1] apo *Hakim*[2], e që Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk ua ka ndryshuar, sepse emri u shërbente thjesht si shenjues. Kështu që emrat e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) që nuk duhet të përdoren për njerëz janë ata që janë të posaçëm veç për Të, ose edhe emrat e tjerë që përdoren për të dalluar atributin që ata përshkruajnë.

- Ndryshimi i emrit të njeriut për shkaqet e mësipërme.

- Zgjedhja e fëmijës më të madh për t'u thirrur sipas emrit të tij.

[1] Si El Hakem Ibn Harith Es Sulemij, El Hakem Ibn Seid Ibn El As, El Hakem Ibn Abdilah Eth Thekafij e të tjerë (radijallahu an hum).
[2] Si Hakim Ibn Hizam, Hakim Ibn El Harith Et Taij, Hakim Ibn Talik El Emevij e të tjerë (radijallahu an hum).

Kështu bëri Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) me Ebu Shurejhun.

- Nga hadithi nuk del se pseudonimi është diçka e pëlqyer, sepse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk e urdhëroi thjesht që të thirrej me një pseudonim, por bëri zëvendësimin e një pseudonimi me një tjetër të lejuar.

Po kështu prej hadithit përfitohet:

- Njerëzit që këshillojnë e udhëzojnë duhet që, kur u mbyllin njerëzve portën e një harami, t’u tregojnë atyre të lejuarën. Këtë e kemi trajtuar më lart.

- Gjykimi i përket vetëm Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), siç ka thënë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) *"... Atij i përket gjykimi* …”.

Në lidhje me atë të krijimit, nuk ka diskutime: askush nuk mund ta kundërshtojë Allahun në vendimet e Tij të krijimit.

Ndërkaq, gjykimi i Sheriatit është kriteri i sproves. Kush sjell ndonjë ligj tjetër për njerëzit veç atij të Allahut, duke menduar se ai është më i mirë e më i dobishëm, ose që është i barabartë me ligjin e Allahut, ose që lejohet heqja dorë nga ligji i Allahut për hir të tij, është qafir, sepse e bën veten e tij të barabartë me Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala), qoftë në çështjet e adhurimit, qoftë në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Dëshmi për këtë është ajeti: “A mos kërkojnë ata gjykimin e (kohës së) injorancës? E kush është më i mirë në gjykim sesa Allahu, për njerëzit që besojnë bindshëm?” (Maide, 50). Ajeti tregon se askush nuk është më i mirë – apo dhe i barabartë – në gjykim sesa Allahu. Kush e pretendon diçka të tillë, vetëm se ka mohuar Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala). Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur Allahu, të tillët janë qafirë të vërtetë.” (Maide, 44). Ky është argument se nuk lejohet shmangia nga ligji i Allahut për një ligj tjetër dhe se një vepër e tillë është kufër.

Nëse pyesin për ajetin: “Le të gjykojnë ithtarët e Ungjillit ashtu siç ka shpallur Allahu në të. Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur Allahu, është i pabindur.” (Maide, 47), përgjigjemi se Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë në ajetin tjetër: “A nuk i ke parë ti ata që pretendojnë se kanë besuar në atë që të është shpallur ty

dhe Profetëve të tjerë para teje? Ata kërkojnë gjykimin e zotave të rremë, ndërkohë që janë urdhëruar t'i mohojnë ato. Shejtani dëshiron që t'i nxjerrë ata krejtësisht nga udha e drejtë. Po kur u thuhet atyre: 'Ejani tek ajo që ka shpallur Allahu dhe tek Pejgamberi, i sheh hipokritët se si largohen prej teje me neveri.'" (Nisa, 60-61). Ky dëshmon se ata janë jobesimtarë, sepse ata "pretendojnë se kanë besuar", pra nuk besojnë realisht. Nga ajeti duket se ata pretendojnë, duke qenë të pabesë e gënjeshtarë.

Përfundimisht, thënia e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Atij i përket gjykimi, vendimi, ligjvënia", tregon se ai që ia jep kompetencën e gjykimit dhe ligjvënies dikujt tjetër veç Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) ka bërë *shirk*.

Shënim: Është detyrë për nxënësin e dijes që të dijë ndryshimin ndërmjet ligjvënies, duke bërë rregulla me fuqi ligjore e duke zëvendësuar me to Kuranin, dhe gjykimit jo me ligjin e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) në ndonjë çështje të caktuar. Kush e bën këtë të fundit mund të jetë qafir, i prishur ose i padrejtë. Është qafir kur beson se ai është më i mirë se Sheriati ose i barabartë me të; është i prishur kur e bën për shkak të egos mëkatare; është i padrejtë kur e bën që të dëmtojë atë që gjykohet.

- Ndryshimi i emrit me një tjetër më të mirë, kur ai përmban diçka që nuk shkon siç bëri Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Me ndryshimin e emrit nuk ka nevojë për therjen përsëri të kurbanit (akikas), siç mendojnë disa njerëz.

Tema 48

Tallja me diçka që lidhet me Allahun, me Kuranin apo Profetin.[1]

Titulli i kësaj teme është disi i paqartë. Me sa duket, qëllimi është për talljen me Sheriatin, ose talljen me Kuranin dhe Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Fjala “Profetin” këtu nënkupton të gjithë Profetët, e jo vetëm Muhamedin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

– *“Tallja me diçka ...”* – Tallja është nënçmim i diçkaje, duke e parë atë si lojë e jo si një gjë serioze. Kush tallet me Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala), me shenjat (argumentet) e krijimit, me Sheriatin ose me Profetët e Tij, është jobesimtar, sepse kundërshtimi që tallja i bën imanit është tepër i ashpër. E si mund të tallesh me diçka që e beson seriozisht?! Kur beson në diçka, ajo është e shenjtë në zemrën tënde.

Ka dy forma mosbesimi: 1- me indiferentizëm; 2- me kundërvënie. Tallja është kufër me kundërvënie. Ajo është më e rëndë sesa përulja para një idhulli. Rreziku i saj është tepër i madh. Veç një fjalë goje mund ta çojë njeriun në shkatërrim, pa e kuptuar fare. Një fjalë goje, që s’i ke dhënë rëndësi, por që e hidhëron

[1] Që do të thotë se ai, me këtë shpërfillje që i bën pozitës së Krijusit dhe shpalljes, bën kufër, sepse kjo bie ndesh me teuhidin. Prandaj dijetarët kanë rënë në unanimitet se ai që vepron diçka të tillë është qafir. Ai që tallet me Allahun, ose librin e Tij, ose të Dërguarin e Tij, ose fenë e Tij, ka bërë kufër edhe nëse e bën këtë për shaka dhe lojë e nuk ka për qëllim talljen në realitet, ky është qëndrim unanim i dijetarëve. (marrë nga Tejsirul Azizil Hamid).

Allahun e Madhëruar, e përfundon në Zjarr.

Sipas mendimit unanim të dijetarëve muslimanë, kush tallet me namazin, qoftë edhe me atë nafile, me zekatin, agjërimin ose haxhin, është qafir. Po kështu, kush tallet me treguesit apo ligjësitë e krijimit, si për shembull, të thotë se ditët e ngrohta në dimër, ose ditët e ftohta në verë janë idiotësi, ka bërë kufër që e nxjerr krejtësisht nga feja, sepse Allahu i Lartësuar bën gjithçka sipas Urtësisë së Tij absolute. Ne ndoshta nuk i kuptojmë, dhe sigurisht që nuk mund të arrijmë t'i kuptojmë gjithmonë ato urtësi.

Dijetarët kanë mospërputhje në lidhje me çështjen: a i pranohet pendimi atij që shan Allahun, të Dërguarin apo Librin e Tij?

Mendimi i parë: Pendimi i tij nuk pranohet. Ky është mendimi më i njohur në medhhebin Hanbeli. Sipas tyre, ai vritet si qafir dhe nuk i falet namazi i xhenazes, nuk bëhet lutje për mëshirë dhe varroset larg nga varrezat e muslimanëve. Për ata, në këtë rast pendimi nuk vlen, sepse vepra është dalje nga Islami dhe mjaft e rëndë.

Mendimi i dytë: I pranohet pendimi, nëse sigurohemi për këtë, nëse ai e pranon gabimin dhe e përshkruan Allahun e Madhëruar me ato cilësi që Ai e meriton. Ky mendim bazohet në argumentet e përgjithshme që flasin për pranimin e pendimit, siç është ajeti: "Thuaj: 'O robërit e Mi që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën te mëshira e Allahut! Allahu me siguri i fal të gjitha gjynahet. Vërtet Ai është Falës i madh dhe Mëshirëploti" (Zumer, 53). Ka qafirë që e shajnë Allahun, megjithatë atyre u pranohet pendimi; kjo është e vërteta. Por ai që ofendon Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), megjithëse i pranohet pendimi, duhet ekzekutuar patjetër[1], ndryshe nga ai që shan Allahun. Atij që shan Allahun i pranohet pendimi dhe nuk ekzekutohet, jo se e drejta e Allahut është më e vogël se ajo e Profetit, porse Allahu na ka treguar se Ai fal për shkeljen e së drejtës së Tij, kur njeriu pendohet, sepse Ai i fal të gjitha gjynahet.

Ndërkaq, kush fyen Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) përballet me dy statuse të tij në gjykim:

1- me statusin e tij si Pejgamberi i Allahut. Në këtë aspekt, i pranohet pendimi;

2- me statusin e tij si njeri, që ishte edhe i Dërguar i Zotit.

[1] Pohime të tilla u referohen vendeve ku autoriteti zbaton ligjet e fesë.

Statusi i dytë e bën të detyrueshëm ekzekutimin e fyesit, për të vënë në vend të drejtën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Megjithatë, nëse është penduar, atij i pranohet pendimi, prandaj, pas ekzekutimin trajtohet si musliman. Trupi i tij duhet të lahet, të qefinoset, t’i falësh namazin e xhenazes dhe ta varrosësh me muslimanët. Ky është mendimi që ka zgjedhur edhe shejhu i Islamit Ibn Tejmije në kohën e tij, i cili ka shkruar edhe një libër në lidhje me këtë, me titull “*Es-sarimu el meslul fi hukmi katli sabi err-Rresul*” ose “*Es-sarimu el meslul ala shatim err-Rresul*” (Shpata e zhveshur ndaj atij që shanë Profetin). Kush ofendon Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ka cenuar rëndë të drejtën e tij. Po kështu, kush e akuzon në nder Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), duhet të vritet e jo të fshikullohet me kamxhik.

Lind pyetja: Po a nuk është e vërtetë se ka pasur njerëz që e kanë sharë Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ndërsa ai i ka toleruar dhe i ka lënë të lirë?

Përgjigje: Sigurisht që kjo është e vërtetë, por kjo ka ndodhur gjatë jetës së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ai vetë ka toleruar në të drejtën e tij, por pas vdekjes, ne të tjerët nuk mund ta dimë këtë. Atëherë, ne kryejmë detyrën tonë kundrejt atij që ofendon Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Pyetje: Fakti që Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) edhe mund të falte, a nuk dëshmon se ne nuk duhet të veprojmë?

Përgjigje: Jo, se po të bëhej ashtu, nga një anë e keqja ndodhi me sharjen, nga ana tjetër, largimi i rrjedhojës së kësaj sharje nuk dihet. Parimsht ajo mbetet në fuqi (pra dënimin e fyesit).

Pyetje: A nuk është e vërtetë që, në të shumtën e rasteve, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka falur ata që e kanë fyer?

Përgjigje: Po, e vërtetë është. Kur Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte në këtë jetë, falja që ai bënte kishte mjaft dobi, siç qe për shembull ruajtja e unitetit. Të njëjtën gjë ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) bëri edhe me munafikët, të cilët ai i njihte, por nuk i vrau, me qëllim që njerëzit të mos thoshin se Muhamedi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) po vriste shokët e vet. Mirëpo tani, nëse është e sigurt se dikush është munafik, duhet të ekzekutohet. Ibn Kajimi thotë se munafikët e njohur nuk vriteshin vetëm gjatë kohës kur Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte në këtë jetë.

> "Nëse i pyet ata, do të thonë: 'Ne vetëm po flisnim kot dhe po luanim!' Thuaju: 'Vallë, me Allahun, ajetet e Tij dhe me të Dërguarin e Tij po talleshit?'" (Teube, 65)

– *"Nëse i pyet ata, do të thonë ..."* – Fjalët i drejtohen Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) me këtë kontekst: nëse i pyet ata që flasin kot dhe tallen me Allahu, Librit të Tij, Profetin e Tij dhe sahabët, ata do të përgjigjen ...

– *"... Ne vetëm po flisnim kot dhe po luanim ..."* – Pra, ne nuk kishim ndonjë qëllim, por po flisnim kot, po luanim.

– *"Thuaju: 'Vallë, me Allahun, ajetet e Tij dhe me të Dërguarin e Tij po talleshit?'"* – Pyetja tregon kundërshtim dhe habi. Allahu e ndalon talljen me këto çështje të rëndësishme dhe çuditet se si mund të bëhet e vërteta e të vërtetave objekt për tallje.

– *"... me Allahun ..."* – Pra, me Qenien dhe atributet e Tij.

– *"... ajetet e Tij ..."* – Kjo nënkupton të gjitha simbolet e fesë, siç është tallja me Kuranin, duke e quajtur, për shembull, "përrallë e vjetër" – Allahu na ruajtë! – ose tallja me ndonjë nga adhurimet bazë si: namazi, zekatin, agjërimi dhe haxhi. Por kjo përfshin edhe talljen me shenjat (argumentet) e krijimit dhe ligjësitë e Tij, si tallja me atë që ka përcaktuar Zoti, për shembull: "Si mund të vijë kjo tani, në këtë kohë?", "Si mund të dalin këto fruta nga kjo pemë?" ose "Si e ka krijuar Zoti këtë që u bën dëm apo që i vdes njerëzit?" etj.

– *"... dhe me të Dërguarin e Tij ..."* – Qëllimi këtu është Muhamedi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

Më pas vazhdon ajeti: "Mos u shfajësoni! Ju e mohuat fenë, pasi patët besuar. Nëse Ne i falim disa prej jush, do t'i ndëshkojmë të tjerët, ngase janë kriminelë."

"Mos u shfajësoni! ...". Pra, mos kërkoni ndjesë. Qëllimi ishte prerja e shpresave për pranimin e justifikimit të tyre.

"... Ju mohuat, pasi kishit besuar ...". Ata nuk kishin qenë munafikë të plotë, por besimtarë të dobët, me aq besim sa vajtën e u tallën me Allahun, ajetet, dhe të Dërguarin e Tij.

"... Nëse Ne i falim disa prej jush, do t'i ndëshkojmë të tjerët, ngase janë kriminelë." – Përemri në shumës "Ne" tregon madhështinë e Allahut. Disa dijetarë thonë se ata që u falën kishin qenë në ato çaste me munafikët dhe madje e urryen veprimin e atyre, por që gjithsesi nuk i kundërshtuan, ndaj gati u gjykuan njëlloj, duke pasur njëfarë lehtësimi, për arsye të urrejtjes që ndjenë ndaj asaj talljeje. Si rrjedhojë, Allahu i fali ata, i udhëzoi në besim dhe i bëri të pendohen.

"... do t'i ndëshkojmë të tjerët ...". Pra, nuk mund t'i falim të gjithë: disa do t'i falim, por të tjerët do të dënohen patjetër.

"... ngase janë kriminelë". Me talljen ata u bënë kriminelë, ata bënë krim, Allahu na mbrojtë! Për këtë arsye, nuk mund t'u jepej sukses në pendim, që t'u falej mëkati.

Dobitë e ajeteve

- Dija e Allahut të Madhëruar për çka do të ndodhë. Argument është thënia e Tij: "Nëse i pyet ata, do të thonë ...". Pra, flet për të ardhmen. Allahu e di se çfarë ka qenë, çfarë është e çfarë do jetë; e di edhe atë që nuk është, si do të ishte, nëse do të ishte: "Allahut i di të fshehtat e qiejve dhe të tokës dhe çdo gjë kthehet tek Ai ..." (Hud, 123).

- Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) gjykonte sipas asaj që zbriti Allahu, duke qenë se Ai e urdhëroi të thoshte: "Vallë, me Allahun, me ajetet e Tij dhe me të Dërguarin e Tij po talleshit?".

- Kufri më i madhi është tallja me Allahun, ajetet dhe të Dërguarin e Tij. Argument është fakti që ajeti vjen në formën pyetëse dhe dënuese.

- Tallja me Allahun, ajetet dhe të Dërguarin e Tij, është tallja më e rëndë dhe më e shëmtuar. Pyetja në ajet sikur do të thotë: a nuk ka mbetur gjë tjetër me të cilën të talleni, përveç këtyre, që nuk janë objekt për tallje, madje janë më të shenjtit.

- Kush tallet më Allahun bën kufër. Argument është ajeti: "Mos u shfajësoni! Ju mohuat pasi patët besuar ...".

- Ashpërsia në vend të mëshirës. Si rregull, kush vjen të kërkojë

ndjesë, mëshirohet, por këtu s'ka vend për mëshirë.

- Pranimi i pendimit të atij që tallet me Allahun. Argument është ajeti: "Nëse Ne i falim disa prej jush ...". Kështu ka ndodhur. Disa prej tyre u falën dhe u udhëzuan në Islam, u penduan dhe Allahu ua pranoi pendimin. Kjo është provë që dëshmon se atij që tallet me Allahun i pranohet pendimi, por patjetër nevojitet të vërtetohet që pendimi është i sinqertë, sepse ky kufër është nga më të rëndët ose më i rëndi. Ai nuk është si kufri me indiferentizëm.

- Shoqëruesit e autorëve të veprës u barazuan me vetë autorët në gjykim. Allahu i Madhëruar thotë: "Ai jua ka shpallur në Libër (Kuran). Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e Allahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrini me ata, derisa të ndërrojnë bisedën, përndryshe do të jini si ata ..." (Nisa, 140). Ata kishin pasur mundësi të largoheshin prej tyre. Kur Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) zbatoi urdhrin e Allahut mbi ata, një burrë shkoi të kërkonte falje, por Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i lexonte në mënyrë të përsëritur ajetin: "Thuaju: 'Vallë, me Allahun, ajetet e Tij dhe me të Dërguarin e Tij po talleshit? Mos u shfajësoni! Ju mohuat, pasi patët besuar ...". Ai nuk shtojë fjalë tjetër, me gjithë mundësinë për ta qortuar ose dënuar.

> Ibn Omeri, Muhamed Ibn Kabi, Zejd Ibn Eslemi dhe Katadja tregojnë, duke plotësuar njëri-tjetrin, se në luftën e Tebukut një burrë tha: "Nuk kemi parë si këta hafizët tanë: më barkmëdhenjtë, më gënjeshtarët dhe më frikacakët në beteja!" Ai kishte për qëllim Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe shokët e tij hafizë. Auf Ibn Maliku i tha: "Gënjeve! Ti je munafik! Unë do të shkoj t'ia tregoj të Dërguarit të Allahut." Ai shkoi tek Pejgamberi i Allahut për ta lajmëruar, por Kurani i kishte treguar para tij. Burri që kishte folur shkoi tek i Dërguari (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), i cili sapo ishte nisur dhe hipur mbi deve. Burri i tha: "O Pejgamberi i Allahut, ne ishim duke folur kot, sa për të harruar lodhjen e rrugës." Ibn Omeri rrëfen: "Sikur e kam përpara syve: i lidhur pas rripit të kapistrës së devesë së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-

> lem), gurët i dërrmonin këmbët, teksa thoshte: 'Ne vetëm po flisnim kot dhe po luanim'. Ndërsa Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ia kthente "Vallë, me Allahun, me ajetet e Tij dhe me të Dërguarin e Tij po talleshit?", pa e kthyer kokën nga ai dhe pa shtuar më shumë se kaq."[1]

– *"... në luftën e Tebukut ..."* – Tebuku ndodhet në anët e Shamit. Kjo luftë ka ndodhur në muajin *Rexheb*, në kohën kur frutat ishin gati për t'u vjelë. Bashkë me Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), në këtë luftë u nisën fillimisht rreth tridhjetë mijë vetë. Por rrugës, Abdullah Ibn Ubeji u kthye mbrapsht me afërsisht gjysmën e ushtrisë, aq sa thuhej se nuk dihej se cila ushtri ishte më e madhe, ajo që u kthye apo ajo që vazhdoi rrugën. Kjo dëshmonte se ç'përmasa kishte marrë hipokrizia atë kohë, kur ishte viti i 9-të hixhri.

Shkak i nisjes drejt kësaj beteje u bë informacioni që iu dha Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), se ushtria romake dhe një pjesë e arabëve të krishterizuar ishin bashkuar kundër Tij. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) vendosi t'i luftonte ata, për të treguar forcën e besimtarëve, duke qenë të bindur në ndihmën e Allahut.

– *"... Nuk kemi parë si këta hafizët tanë ..."* – Fjalët nënkuptonin Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe shokët e tij.

– *"... më barkmëdhenjtë ..."* – Barku i madh tregon dëshirën e madhe për të ngrënë.

– *"... më gënjeshtarët ..."* – Gënjeshtra është e kundërta e të vërtetës.

– *"... dhe më frikacakët në beteja ..."* – Frika është dobësia që ndjen njeriu në vetvete, e cila e ndalon njeriun të ndeshet me atë që e urren. Ajo është një cilësi e ulët, prandaj edhe Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) kërkonte mbrojtje prej saj. Ajo të pengon nga një veprim që duhet ndërmarrë patjetër.

---

[1] Ibn Xheriri dhe Ibn ebi Hatimi.

Përshkrimet e mësipërme janë të përshtatshme për një munafik, jo për besimtarin. Besimtari ha me një zorrë: një të tretën e barkut e ka për ushqim, një të tretën për ujë dhe një të tretën për të marrë frymë, ndërsa qafiri ha me shtatë zorrë.[1]

Besimtari është më i vërteti në njerëz kur flet, sidomos Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe shokët e tij. Allahu i ka përshkruar ata si besnikë në thënien e Tij: "Një pjesë e plaçkës u takon muhaxhirëve të varfër, të cilët u përzunë nga vendlindja dhe pasuritë e tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Allahut dhe duke ndihmuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht ata janë besimtarët e vërtetë." (Hashr, 8).

Hipokritët janë njerëzit më gënjeshtarë, siç thotë Allahu për ata: "... Allahu dëshmon se ata janë vërtet gënjeshtarë." (Hashër, 11). Ndërsa Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e ka konsideruar gënjeshtrën si një nga shenjat e hipokritëve[2]. Hipokritët janë njerëzit më frikacakë. Allahu i Madhëruar thotë: "Ata kujtojnë se çdo thirrje që dëgjojnë është kundër tyre ..." (Munafikun, 4). Kur dëgjojnë ndonjë që e ngre zërin, se kërkon plaçkën që i ka humbur, thonë: "Armiku, armiku!" Ata e duan dynjanë më shumë se gjithë njerëzit. Dynjaja është burimi i hipokrizisë së tyre: ata janë të tillë që t'u mbrohet gjaku, pasuria dhe nderi i tyre.

– *"... Gënjeve! ..."* – Pra, the diçka të pavërtetë. Kjo tregon domosdoshmërinë e përgënjeshtrimit të gënjeshtrës, sido që të jetë çështja dhe se heshtja ndaj saj nuk lejohet.

– *"... Ti je munafik! ..."* – I tha kështu, sepse ato fjalë për Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe shokët e tij, nuk mund t'i thotë kurrë një musliman, por vetëm një munafik.

Nga kjo kuptohet, gjithashtu, se kush shan shokët e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), është qafir, sepse sharja e tyre është sharje ndaj Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), Profetit dhe fesë së Tij.

---

[1] Siç përmendet në hadithin e shënuar në sahihun e Buharit dhe Muslimit.

[2] Siç përmendet në hadithin e shënuar në sahihun e Buharit dhe Muslimit.

Është sharje ndaj Allahut, sepse është fyer Urtësia e Tij, pasi mëtohet se Allahu zgjodhi si shokë për më të mirin e krijesave, më të këqijtë e krijesave të Tij.

Është sharje për Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), sepse ata janë shokët e tij dhe njeriu është në fenë e shokut të tij. Për të vlerësuar që njeriu është i rregullt apo i prishur, me moral të mirë apo të keq, shihen shokët e tij.

Është sharje për fenë, sepse ata njerëz janë ndërmjetësit mes nesh dhe Profetit në përcjelljen e fesë, dhe nëse ata do të kishin të tilla cilësi, as feja jonë nuk do qe e sigurt.

– *“... por Kurani i kishte treguar para tij ...”* – Pra, me shpalljen e Allahut të Madhëruar, Allahu është i Gjithëditur për çka vepronin, donin dhe thurnin tinëzisht intrigat. Allahu i Madhëruar thotë: “Ata fshihen nga njerëzit, por nuk fshehin dot nga Allahu. Ai është pranë tyre edhe natën, kur trillojnë gjëra me të cilat Ai nuk është i kënaqur ...” (Nisa, 108).

– *“... gurët i dërrmonin këmbët ...”* – Kjo do të thotë se, gjatë ecjes, gurët i goditnin këmbët, me sa duket – dhe Allahu është më i ditur – nga ecja e shpejtë e tij. Mirëpo ai nuk i ndjente dhimbjet, sepse donte të fitonte faljen.

– *“... dhe pa shtuar më shumë se kaq.”* – Pra, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk shtonte tjetër, veç fjalëve të Allahut, duke zbatuar më përpikëri urdhrin e Tij dhe duke u mjaftuar me fjalët e tij. Ato fjalë mjaftonin për të treguar zemërim dhe qortim ndaj tyre.

Dobitë e temës

- Tema është tepër delikate: kush tallet me ato që thamë, është qafir.

Kjo do të thotë se kush tallet me Allahun (Subhanehu ue Te‘Ala), me shenjat e krijimit, me argumentet e fesë, ose me Profetin e Tij,

është jobesimtar.

> ➢ Ky është edhe gjykimi që del nga komenti i ajetit për atë që e vepron diçka të tillë, kushdo qoftë.

Kjo do të thotë se është njëlloj, qoftë apo jo munafik, nese ai tallet ka mohuar.

> ➢ Dallimi ndërmjet spiunimit dhe këshillës për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Spiunimi është përcjellja e fjalëve të dikujt te dikush tjetër, me qëllim të keq. Ky është gjynah tepër i madh. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Spiuni nuk futet në Xhenet."[1] Po ashtu, ai ka treguar se një burrë po ndëshkohej në varr, ngaqë merrej me spiunime[2].

Ndërsa këshilla për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij nuk ka atë qëllim, por ka respektimin e simboleve të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), zbatimin e dispozitave të Tij dhe ruajtjen e fesë së Tij. Auf Ibn Maliku tregoi se çfarë tha ai burrë (në hadith), me qëllim që mbi të të zbatohej dënimi, apo cilado dispozita që është detyrë të zbatohet mbi të. Pra, ai nuk kishte për qëllim thjesht përcjelljen e fjalëve. Kur një person i beson dikujt, ndërsa ky i fundit ia zbulon sekretet e tij dhe tallet me të në sy të botës: nëse e informon të parin, ky nuk është spiunim, por këshillë.

> ➢ Dallimi ndërmjet faljes që e do Allahu dhe ashpërsisë ndaj armiqve të Tij.

Falja që e do Allahu, është ajo që sjell pajtim e rregull, siç thotë Ai: "... por, atë që fal dhe pajton, e pret shpërblimi i Allahut ..." (Shura, 40). Pra, falja duhet të shoqërohet me pajtimin. Disa të tjerë thonë se falja është rregullim i dashurisë ndërmjet Zotit dhe atij që sillet keq me Të, por ky është shpjegim i mangët. E sakta është se

[1] Buhariu, Muslimi.
[2] Buhariu dhe Muslim.

me faljen e Tij bëhet i mundur pajtimi e rregullimi. Ndërsa kur falja sjell prishje dhe jo pajtim, atëherë ajo është mëkat, siç kuptohet nga ajeti: "... por, atë që fal dhe pajton ...". Falja është mirësi, ndërsa prishja është e keqe. Largimi i së keqes ka më tepër përparësi dhe falja në këtë rast është haram.

Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) u soll ashpër ndaj atij burri, duke mos e kthyer kokën nga ai, dhe duke i përsëritur veç fjalët e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), edhe pse atij po i vriteshin këmbët nëpër gurë. Ai (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk u soll butë me të, sepse sipas vendit bëhet edhe kuvendi. Njeriu duhet të jetë i rreptë aty ku duhet rreptësi dhe i butë aty ku duhet butësi. Për sa u përket armiqve të Allahut, parimisht, sjellja me ta duhet të jetë e rreptë. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) në përshkrimin e Profetit dhe shokëve të tij thotë: "... të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre ..." (Fet'h, 29); "O Profet! Luftoji jobesimtarët dhe hipokritët dhe bëhu i ashpër ndaj tyre! Vendbanimi i tyre do të jetë Xhehenemi. Eh, sa i shëmtuar është ai vendbanim!" (Tehrim, 9). Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e ka pohuar këtë në dy sure në Kuran, gjë që tregon për rëndësinë e saj, por butësia mund të jetë e mirë ndonjëherë, për t'i ftuar njerëzit në Islam dhe për t'u fituar zemrat.

- Ka raste që kërkimi i faljes nuk duhet të pranohet.

Parimisht, falja duhet të pranohet, e sidomos kur gabimtari është njeri i mirë, por ka shkarë diku. Por nëse është e qartë se kërkimi i faljes është i padrejtë, atëherë nuk pranohet.

Tema 49

Thënia e Allahut: “Nëse pas një fatkeqësie, Ne i japim të shijojë nga mirësitë Tona, me siguri do të thotë: ‘Këtë e meritoj! …’” (Fusilet, 50)

Kjo temë është pjesë e librit të teuhidit për arsye se njeriu, kur i konsideron të mirat si fryt të punës së tij, ka bërë një lloj barazie në veprat unike të Allahut. Edhe kur e di që është Allahu Ai që ia ka dhënë mirësitë, njeriu bën një lloj kryelartësie në adhurim nëse mëton se i ka merituar plotësisht ato, dhe se nuk ka qenë prej bujarisë së Allahut.

Autori ka sjellë dy ajete në këtë temë.

Ajeti i parë është ai që ndodhet në titull të temës:

“Nëse pas një fatkeqësie, Ne i japim të shijojë nga mirësitë Tona, me siguri do të thotë: ‘Këtë e meritoj! …”

Sipas kontekstit të ajetit, qëllimi është për njeriun në përgjithësi. Është thënë gjithashtu se flitet për jobesimtarët. Megjithatë, me sa duket, për qëllim është njeriu si krijesë, duke përjashtuar besimtarët, të cilët i largon besimi nga kjo sjellje. Besimtarët nuk thonë kurrë të tilla gjëra. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) para këtij ajeti thotë: “Vetëm Allahu e di se kur do të vijë Ora (çasti i fundit). Kurrfarë fruti nuk mund të dalë prej kupës së lules dhe asnjë femër nuk mund të mbetet shtatzënë apo të lindë pa dijeninë e Tij. Ditën kur Ai t’i thërrasë ata (idhujtarët) e t'u thotë: ‘Ku janë ata zota që i quanit si ortakët e Mi?’, ata do të përgjigjen: ‘Askush prej nesh nuk dëshmon sot se ata janë ortakët e Tu'. Idhujt që ata i adhuronin më

parë do t'i zhgënjejnë dhe ata do ta dinë se nuk ka më shpëtim. Njeriu nuk lodhet kurrë duke kërkuar të mirën, por, nëse e godet e keqja, ai menjëherë bie në dëshpërim dhe humb shpresën." (Fusilet, 47-49). I tillë është njeriut si natyrë, por besimi e largon atë nga cilësitë e këqija të lartpërmendura.

– *"... Nëse pas një fatkeqësie ..."* – Pra, jo duke i shijuar të mirat që në fillim, por pasi i ka provuar një herë fatkeqësitë, si: varfëri, humbje të fëmijëve etj. Më pas, i jepen të mirat, të cilat i shijon, ashtu siç shijon ushqimin pas urisë.

– *"... nga mirësitë Tona ..."* – Allahu ia ka përshkruar Vetvetes, për të qartësuar se ajo është nga Ai, dhe për të treguar mirësinë e Tij të plotë me të.

– *"... me siguri do të thotë: 'Këtë e meritoj! ...'"* – Ky është mohim i mirësisë së Allahut dhe pëlqim i vetes.

Më tej ajeti vazhdon: "... Unë nuk besoj se do të vijë Ora (e Kijametit), por, edhe nëse kthehem te Zoti im, sigurisht që Ai do të më japë shpërblimin më të mirë." Në të vërtetë, Ne do t'i njoftojmë mohuesit për atë që kanë bërë dhe do t'i bëjmë të shijojnë një dënim të ashpër."

"... Unë nuk mendoj se do të vijë Ora (e Kijametit) ...". Pasi zhytet në dynja, ai harron ahiretin. Ndryshe vepron besimtari, i cili, edhe nëse e zë ndonjë e keqe, kthehet tek Allahu. Kur Allahu ia largon të keqen, ai gëzohet dhe falënderon Allahun për këtë. Ndërsa ai i pari harron dhe e mohon ahiretin.

"... por, edhe nëse kthehem te Zoti im, sigurisht që Ai do të më japë shpërblimin më të mirë ...". Pra, me këtë kuptim: nëse supozojmë se do të kthehem te Zoti im, do të gjej edhe më mirë se kaq.

"... Në të vërtetë, Ne do t'i njoftojmë mohuesit për atë që kanë bërë ...". Kjo do të thotë: do t'ia tregojmë këtij lloj njeriu.

> Fragmentin e ajetit: "Këtë e meritoj!" Muxhahidi e komenton kështu: "Kjo është në sajë të punës sime dhe

> unë e kam merituar atë.". Ndërsa Ibn Abasi i jep domethënien: "E kam nga vetja ime", pra jo nga Allahu.
>
> Ajeti i dytë është: "Kjo më është dhënë vetëm prej diturisë sime ..." (Kasas, 78)
>
> Katadeja e zbërthen kështu ajetin: "Kjo më është dhënë si rezultat i njohjes sime të rrugëve të përfitimit." Të tjerët thonë: "Prej njohjes që më ka dhënë Allahut, sepse unë e meritoj atë." Ky është edhe kuptimi i shpjegimit të Muxhahidit: "Më është dhënë në sajë të fisnikërisë sime."

Në Kuran janë dy ajete të tillë. Në ajetin e parë, thuhet: "... Kjo më është dhënë vetëm prej diturisë sime. Nuk është kështu! Kjo është vetëm një provë, por shumica e tyre nuk e dinë." (Zumer, 49), ndërsa në të dytin: "Kjo më është dhënë vetëm prej diturisë sime ...". Me sa duket nga komenti i autorit, ai ka pasur për qëllim të dytin.

Ajeti flet për njërin nga këto raste:

1- Kur mohohet që burimi i mirësive është bujaria e Allahut, me pretendimin se ato vijnë vetëm si fryt i punës, diturisë dhe aftësisë së njeriut.

2- Kur mohohet bujaria e Allahut, me pretendimin se Allahu ia ka borxh t'ia japi ato mirësi, sepse i meritonte ato.

Në të dy rastet ai është mosmirënjohës ndaj Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). E vërteta është se çdo begati që na jepet, është nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Ai na e lehtëson, derisa e përfitojmë atë. Gjithçka që ne e arrijmë në dituri, mundësi ose vullnet, është nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Është detyrë për ne që t'ia njohim këto mirësi Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Allahu i Madhëruar thotë: "Çdo mirësi që keni, është nga Allahu ..." (Nahl, 53).

Edhe nëse këtë begati e arrin me dijen ose aftësinë tënde, përsëri duhet të dish se është Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) dhuruesi i kësaj dije apo aftësie. Pastaj, dija dhe aftësia mund të mos jetë shkak për përfitimin e rrizkut. Sa prej njerëzve janë të ditur, të aftë

e të zgjuar, e megjithatë nuk u jepet sukses, madje edhe dështojnë.

Falënderimi i Allahut për mirësitë ngrihet mbi tri shtylla:

1- Njohja e tyre me zemër.
2- Falënderimi i Allahut me gjuhë.
3- Kryerja e veprave konkrete, që e kënaqin Dhuruesin.

Kështu, kush ndjen se është vetë i zoti për aftësitë, mirësitë dhe zgjuarsinë që ka, nuk është mirënjohës ndaj Allahut. Po kështu, nëse mirësitë ia njeh dikujt tjetër veç Allahut, ose bën vepra që kundërshtojnë Atë, nuk është mirënjohës ndaj Tij (Subhanehu ue Te'Ala).

> Nga Ebu Hurejra përcillet se ai e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) duke thënë: "Allahu deshi njëherë të provonte tre persona nga bijtë e Israilit: një lebros, një qeros dhe një të verbër, prandaj i dërgoi secilit prej tyre një melek. Fillimisht, meleku shkoi tek lebrosi dhe i tha: 'Çfarë dëshiron më tepër ti?' Ai iu përgjigj: 'Ngjyrë të bukur dhe lëkurë të mirë. Dua që të shërohem prej asaj gjëje, që i bën njerëzit të kenë neveri ndaj meje.' Meleku e preku dhe atij menjëherë iu largua e liga, iu dha një ngjyrë e mirë dhe lëkurë e bukur. E pyeti përsëri: 'Ç'lloj pasurie pëlqen më tepër?' Ai tha: 'Deve (ose lopë – Is'haku ka dyshuar për këtë)'. Kështu, atij iu dha një deve e mbarsur, dhe iu tha: 'Allahu të bekoftë me të!' Pastaj shkoi te qerosi dhe i tha: 'Çfarë dëshiron më tepër ti?' Ai u përgjigj: "Flokë të bukur. Dua që të shërohem prej asaj gjëje, që i bën njerëzit të kenë neveri ndaj meje. Meleku e preku dhe atij menjëherë iu largua e liga e iu dhanë flokë të bukur. E pyeti përsëri: 'Ç'lloj pasurie pëlqen më tepër?' Ai i tha: 'Lopë (ose deve).' Kështu, atij iu dha një lopë e mbarsur dhe iu tha: 'Allahu të bekoftë me të!' Shkoi tek i verbri dhe i tha: 'Çfarë dëshiron më tepër ti?' Ai tha: 'Dua që Allahu të më kthejë dritën e syve, që të mund të shikoj njerëzit.' Meleku e preku dhe Allahu ia ktheu sytë. E pyeti përsëri: 'Ç'lloj pasurie pëlqen më

tepër?' Ai iu përgjigj: 'Dhentë.' E atij iu dha një dele gati në lindje. Dy të parët arritën të merrnin prodhim nga deveja dhe lopa, ndërsa të tretit i lindi delja. I pari u bë me një kope me deve, që mbushte një luginë, edhe i dyti me një tufë me lopë, që mbushte një luginë, edhe i treti me një tufë dhen, që mbushte një luginë. Pas kësaj, meleku shkoi sërish te ish-lebrosi, me të njëjtën formë e paraqitje, por tani i tha: 'Jam një rrugëtar i shkretë, që kam mbetur e nuk mund ta vazhdoj udhëtimin tim. Unë nuk mund të mbërrij sot në familjen time, përveçse me Allahun, pastaj me ty. Të lutem ty, në emër të Atij që të ka dhënë ngjyrë të bukur, lëkurë të mirë dhe pasuri, të më japësh një deve, që të arrij atje ku jam nisur!' Ai ia ktheu: 'S'kam ç'të bëj! Kam shumë detyrime të tjera!' Atëherë meleku i tha: 'Unë më duket se të njoh! A nuk ke qenë ti një lebros, që të kishin neveri njerëzit, e i varfër dhe Allahu të dha pasuri?' Ai iu përgjigj: 'Këtë e trashëgoj të madh pas të madhi!' Meleku i tha: 'Nëse po gënjen, atëherë Allahu të bëftë siç ke qenë njëherë!' Pastaj shkoi te qerosi, me të njëjtën formë e paraqitje, dhe i tha të njëjtat gjëra që i tha dhe të parit, por edhe ai iu përgjigj në të njëjtën mënyrë. Meleku i tha: 'Nëse po gënjen, atëherë Allahu të bëftë siç ke qenë njëherë!' Në fund shkoi tek i verbri, me të njëjtën formë e paraqitje, e i tha: Jam një rrugëtar i shkretë, që kam mbetur e nuk mund ta vazhdoj udhëtimin tim. Unë nuk mund të mbërrij sot në familjen time, përveçse me Allahun, pastaj me ty. Të lutem ty, në emër të Atij që të ka dhënë dritën e syve, të më japësh një dele, që ashtu të arrij në vend!' Ai iu përgjigj: 'Nuk ka dyshim që unë kam qenë dikur i verbër, por Allahu ma ktheu sërish shikimin, ndaj, merr ç'të duash nga pasuria ime! Betohem në Allah, se nuk kam për të thënë asgjë, për gjithçka që do të marrësh për hir të Allahut.' Meleku iu përgjigj: 'Jo, mbaje pasurinë që ke. Ju u vutë në provë.

> Allahu është i kënaqur me ty dhe i zemëruar me dy shokët e tu!'"[1]

– *"Nga Ebu Hurejra përcillet se ai e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) duke thënë: "Allahu deshi njëherë të provonte tre persona nga bijtë e Israelit ..."* – Të gjitha historitë që përmenden në Kuran dhe në Sunetin e saktë, nuk kanë për qëllim thjesht lajmërimin, por përmes tyre synohet marrja e mësimeve dhe këshillave, bashkë me qetësinë dhe gëzimin që fiton vetja. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Në tregimet e tyre (të Dërguarve) ka këshilla për ata që janë me mend...". (Jusuf, 111)

– *"... bijtë e Israilit ..."* – Këta janë pasardhësit e Jakubit, të birit të Is'hakut, të birit të Ibrahimit *(alejhim esal-latu ue teslim)*.

– *"... një lebros ..."* – Pra, lëkurën e tij e kishte prekur lebra, e cila është një sëmundje e njohur. Ajo është nga sëmundjet e pashërueshme që nuk kurohet plotësisht. Ndoshta kohët e fundit mjekët kanë arritur ta frenojnë përhapjen e saj në lëkurë, por largimi i saj është i pamundur. Prandaj, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e ka bërë këtë mrekulli për Isain *(alejhi selam)*: "... se si me vullnetin Tim i shëroje të lindurit të verbër e të lebrosurit ..." (Maide, 110).

– *"... Allahu deshi ..."* – Për qëllim këtu, është dëshira e krijimit.

– *"... të provonte ..."* – Pra, t'i vërë në provë, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë ..." (Enbija, 35); "Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më provuar a jam mirënjohës apo mohues ..." (Neml, 40).

– *"... një melek ..."* – Melekët janë një botë e fshehtë për ne. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) i ka krijuar ata nga drita dhe i ka bërë të bindur ndaj Tij. Ata nuk hanë, nuk pinë dhe e lartësojnë Allahun natë e ditë, pa u lodhur. Ata kryejnë punë dhe kanë funksione të

[1] Buhariu dhe Muslimi.

caktuara, të cilat janë përmendur në Kuran dhe Sunet. Të besosh në ekzistencën e tyre është detyrë dhe madje një nga gjashtë kushtet e besimit.

– *"... e preku atë ..."* – Kjo shërben për të treguar se çdo gjë e ka një shkak, megjithëse ai u shërua me vullnetin e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

– *"... dhe atij menjëherë iu largua e liga ..."* – U largua njëherë e keqja, para se t'i vinte e mira, sepse fillimisht zhduket e keqja, e shëmtuara dhe pastaj zëvendësohet me të mirën, të bukurën, sikurse thuhet: pastrimi bëhet para zbukurimit.

– *"... Ai tha: 'Deve (ose lopë – Is'haku ka dyshuar për këtë) ..."* – Me sa duket nga konteksti, ka qenë deve. Is'haku ka qenë njëri nga përcjellësit e hadithit.

– *"... atij iu dha një deve e mbarsur ..."* – Barra mund të ketë qenë tetë ose dhjetë muajshe, e kështu Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e bëri që ai ta shfrytëzonte. Ka mundësi, gjithashtu, që kafsha të ketë qenë afër melekut, i cili ia ka dhënë pastaj njeriut.

– *"... Allahu të bekoftë me të! ..."* – Mund të ketë qenë urim, – dhe kjo është më afër të vërtetës, – por mund të merret edhe si fjali thjesht dëftore, pra: "Allahu të ka begatuar me të."

– *"... Pastaj shkoi te qerosi ..."* – Ky është personi i dytë i ngjarjes.

– *"... 'Çfarë dëshiron më tepër ti?' Ai u përgjigj: "Flokë të bukur ..."* – Këtij nuk i mjaftonin vetëm flokët, por donte flokë të bukur.

– *"... Dua që të shërohem prej asaj gjëje, që i bën njerëzit të kenë neveri ndaj meje..."* – Pra, të shërohej prej të qenit qeros, nga e cila njerëzit kanë neveri. Kjo tregon gjithashtu, se ata nuk i mbulonin kokat me çallmë ose me gjëra të tjera. Thuhet se mund të ketë pasur çallmë, por përsëri një pjesë e kokës duket anash, që mund të dallohet nga njerëzit.

– *"... atij iu largua e liga ..."* – Lidhur me paraprirjen e largimit të të ligës, thuhet ajo që u përmend më parë. Është mirësi nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) që Ai i përgjigjet njeriut.

– *"... Lopë (ose deve). ..."* – Ky është dyshim nga Is'haku, por konteksti i hadithit tregon se atij i është dhënë një lopë.

– *"... shkoi tek i verbri ..."* – Ky ishte personi i tretë në këtë histori.

– *"... 'Dua që Allahu të më kthejë dritën e syve, që të mund të shikoj njerëzit ...'."* –Nuk kërkoi sy të bukur, siç kërkuan dy shokët e tij, por kërkoi vetëm sy, që të shihte njerëzit. Kjo tregon se ai kënaqej me aq sa ishte e mjaftueshme.

– *"... Allahu ia ktheu sytë ..."* – Me sa duket, ishin ato sy dhe shikim që kishte pasur më parë.

– *"... Ai u përgjigj: 'Dhentë ...'"* – Kjo dëshmon modestinë e tij, ashtu siç tregon se ai ishte njeri i qetë dhe i thjeshtë, sepse qetësia është karakteristikë e barinjve të deleve.

– *"... me të njëjtën formë e paraqitje ..."* – Domethënë me të njëjtin trup dhe veshje. Forma ka lidhje me trupin, ndërsa paraqitja ka lidhje me veshjen, ky është edhe ndryshimi ndërmjet tyre.

– *"... Jam një rrugëtar i shkretë ..."* – Në arabisht është përdorur fjala "*miskin*", që do të thotë "varfanjak". Varfëria e pengon njeriun të udhëtojë dhe e poshtëron atë, kurse i pasuri ka fuqi dhe mundësi udhëtimi.

– *"... Unë nuk mund të mbërrij sot në familjen time, përveçse me Allahun, pastaj me ty ..."* – Pra, nuk ka gjë që më dërgon sot mua në shtëpi, përveç Allahut, pastaj ti, prandaj kërkesa është e domosdoshme.

– *"... Të lutem ty, në emër të Atij që të ka dhënë ngjyrë të bukur,*

lëkurë të mirë dhe pasuri ..." – I tha: "Të lutem ty, në emër të Atij që të ka dhënë..." dhe jo thjesht: "Të lutem ty në emër të Allahut...", me qëllim që t'i vinte në dukje faktin se ato të mira i kishte nga Allahu. Ai renditi dy fakte në lutjen e tij: skamjen dhe faktin se kishte mbetur në mes të rrugës, dy arsye që e detyronin dhënien.

– *"... një deve ...*" – Kjo tregon se atij iu dha një deve, ndërsa shprehja e Is'hakut "deve ose lopë", është në aspektin e devotshmërisë[1].

– *"... që kam mbetur e nuk mund ta vazhdoj udhëtimin tim ...*" – Pra, jo se i pëlqenin devetë, por që të arrinte të shkonte pranë familjes.

– *"... Kam shumë detyrime të tjera! ..."*– Pra, kam shumë detyrime që duhej t'i shlyej me këtë pasuri, nuk je vetëm ti. Ai harroi – Allahu na ruajtë! – se ishte Allahu Ai që u tregua bujar, duke i dhënë lëkurë të mirë, ngjyrë të bukur dhe pasuri.

– *"... A nuk ke qenë ti një lebros, që të kishin neveri njerëzit ...*" – Meleku i kujtoi bujarinë e Allahut mbi të dhe cenet që kishte pasur më parë, në mënyrë që të njihte vlerën e bujarisë.

– *"... Këtë e trashëgoj të madh pas të madhi ...*" – Pra, e trashëgoj nga babai e ai nga gjyshi. Ai e mohoi që pasurinë e kishte nga Allahu, por nuk mundi të mohojë edhe shërimin nga lebra.

Është thënë gjithashtu, se flitet për pasurinë jomateriale, me kuptimin: ne jemi fisnikë e prijës, prandaj pasurinë e kemi pasur në fis. Shprehja i përmban të dyja domethëniet së bashku.

– *"... Nëse po gënjen, atëherë Allahu të bëftë siç ke qenë njëherë! ..."* – Kjo është një lutje e kushtëzuar, e cila vlen edhe për të kundërtën e saj, që është: "Nëse thua të vërtetën, Allahu t'i lëntë mirësitë që ke!"

Përse fjalia është në një formë të tillë, kur meleku e dinte fare

[1] Pra kjo tregon për devotshmërin e tij, pasi ai nuk ishte i sigurt se cila u përmend, deveja apo lopa, i përmendi të dyja.

mirë që personi po gënjente? Ndonjëherë tregohet një formë e tillë lëshimi apo tolerimi me kundërshtarin gjatë debatit, me qëllimi që të dalë në pah mjaft mirë pavlefshmëria e pretendimit të tij. Kjo mënyrë përdoret shpesh, edhe kur flitet për çështje të sigurta, siç është ajeti: "Kush është më i mirë, Allahu apo ata (zota) që ia shoqërojnë Atij?!" (Neml, 59). Dihet se nuk ka nevojë për krahasim dhe se Allahu është më i mirë se idhujt që ia shoqërojnë Atij. Kjo është një mënyrë polemike me kundërshtarin, për të hedhur poshtë argumentet e tij.

– *"... Pastaj shkoi te qerosi, me të njëjtën formë e paraqitje, dhe i tha të njëjtat gjëra që i tha dhe të parit, por edhe ai iu përgjigj në të njëjtën mënyrë ..."* – Pra, që të dy – Zoti na ruajt! – u treguan mosmirënjohës ndaj të mirave të Allahut: nuk i pranuan ato e as udhëtarin e shkretë nuk e ndihmuan.

– *"... Nëse po gënjen, atëherë Allahu të bëftë siç ke qenë më parë! ..."* – Pra, Allahu të ktheftë në gjendjen që ishe: qeros të neveritshëm dhe të varfër!

– *"... Allahu ma ktheu sërish shikimin ...*" – Ky është pohim i mirësisë së Allahut, që është edhe një nga kushtet e falënderimit. Kushti i dytë është puna konkrete në bindje të Dhuruesit, ndërsa i treti është pohimi i mirësisë me zemër.

– *"... Betohem në Allah, se nuk kam për të thënë asgjë, për gjithçka që do të marrësh, për hir të Allahut ...*" – Pra, nuk do të të rëndoj ty, as duke ta ndaluar dhe as duke ta përmendur atë që do të jap. Pohimi i tij me gjuhë, ishte në përputhje të plotë me atë që kishte në zemër.

– *"... merr ç'të duash nga pasuria ime ...*" – Kjo qe shprehje e falënderimit me vepër konkrete, duke i përmbushur kështu të gjitha kushtet e falënderimit.

– *"... për hir të Allahut ...*" – Ky është një tregues i qartë për sinqeritetin e tij. Pra, çdo gjë që të marrësh për Allahun, unë nuk

kam për ta penguar.

– *"... Ju u vutë në provë ..."* – Ai që i provoi ishte Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Me sa kuptohet, ata të tre e njihnin historinë e njëri-tjetrit. Përgjithësisht, ngjarje të tilla njerëzit i marrin vesh.

– *"... Allahu është i kënaqur me ty ..."* – I kënaqur sepse ai e falënderoi Allahun me zemër, gjuhë dhe vepra konkrete.

– *"... dhe i zemëruar me dy shokët e tu."* – I zemëruar sepse ata të dy i mohuan mirësitë, e mohuan se ishte Allahu Ai që ua fali ato.

Dobitë e hadithit

- Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka treguar ngjarje me bijtë e Israilit, që ne të marrim mësim prej tyre. Hadithi është një dëshmi që tregon se normat e bashkësive pararendëse, vlejnë edhe për ne, përderisa nuk ka ndonjë fakt që tregon se normat tona janë në kundërshtim me to.
- Pasqyrimi i fuqisë së Allahut të Madhëruar në shërimin e lebrosit, qerosit dhe të verbrit, nga të metat që kishin, vetëm me prekjen e engjëllit.
- Melekët ndryshojnë formë, aq sa mund të marrin edhe formën e njeriut. Por kjo – dhe Allahu është më i ditur – nuk është diçka që ata e bëjnë vetë, por ndodh veç me urdhrin e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).
- Melekët janë qenie fizike. Ata nuk janë shpirtra ose koncepte, apo vetëm forcë.
- Përkushtimi i madh i përcjellësve të hadithit. Kjo duket në luhatjen e vogël që Is'haku nuk e mbajti të fshehur, por e shprehu.
- Njeriu nuk e ka detyrë që të jetë i kënaqur me atë që vjen si pasojë e caktimit të Allahut. Personat e hadithit, të prekur nga ato prova, thanë se gjëja më e dashur për ta ishte largimi i të keqes së tyre, gjë që tregon njëfarë pakënaqësie të tyre.

Në fatkeqësi, njeriu mund të shprehë një nga katër sjelljet e mëposhtme:

1- Mosdurim, i cili është haram.

2- Durim, i cili është detyrë.

3- Kënaqësi, e cila është e pëlqyeshme.

4- Falënderim, i cili është më i miri.

Këtu ka diçka që duhet sqaruar: Si ta falënderojë njeriu Zotin për fatkeqësinë, ndërkohë që ajo nuk i vjen për shtat atij?

Përgjigje: Nëse njeriu beson në shpërblimin madhështor që vjen nga ajo goditje, kupton se ajo është mirësi dhe, si rrjedhojë, për mirësinë duhet të falënderosh. Ndërsa në hadithin e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): Kush kënaqet me provën që i ka caktuar Allahu, do fitojë kënaqësinë e Tij, e kush nuk kënaqet, do të marrë hidhërimin e Tij", kënaqësia e përmendur në këtë hadith nënkupton durimin ose nënkupton kënaqësinë me origjinën e caktimit, që është veprimi i Allahut.

Është detyrë të pëlqehet veprimi i Zotit prej të cilit ka ardhur si rrjedhim fatkeqësia për robin, sepse Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) është më i Urti[1].

Kështu, ka ndryshim ndërmjet caktimit si veprim i Allahut dhe caktimit si rezultat. Për sa i përket caktimit si rezultat, ai mund të jetë: 1- fatkeqësi, me të cilën njeriu nuk e ka detyrë të jetë i kënaqur; 2- rregulla fetare, me të cilat është detyrë të jetë gjithnjë i kënaqur.

- Lejimi i lutjes në formë kushtore. Në Kuran, Allahu i Madhëruar thotë: "… dhe herën e pestë të kërkojë mallkimin e Allahut ndaj vetes, nëse ka gënjyer." (Nur, 7); ose: "… dhe herën e pestë të kërkojë zemërimin e Allahut ndaj vetes, nëse i shoqi ka thënë të vërtetën." (Nur, 9). Po kështu, në lutjen e *istihare*-s, Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "O Allah! Nëse e di se …".

- Lejohet toleranca (lëshimi) në debat me kundërshtarin me qëllim që t'i mbyllësh gojën atij. Meleku – në hadith – e dinte se njeriu po gënjente, por e mori për bazë pohimin e tij. I tillë është ajeti: "Ne nuk mund të jemi që të dyja palët në rrugën e drejtë: ose ju, ose ne jemi në humbje të qartë." (Sebe, 24). Dihet se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe shokët e tij ishin në rrugën e drejtë, ndërsa ata ishin në humbje, por ky lëshim është një mënyrë

[1] Është e pëlqyeshme dhe jo detyrë të pëlqehet fatkeqësia duke e parë si rrjedhojë të veprimit (paracaktimit) të Zotit.

diskutimi për të nxjerrë në pah humbjen e kundërshtarit dhe për të treguar drejtësi.

- Bereqeti i Allahut nuk ka të mbaruar. Për këtë, njërit prej burrave iu dha një luginë me deve, të dytit një luginë me lopë dhe të tretit një luginë me dhen.

- A mund të kuptohet nga hadithi se lutja e melekëve është e pranueshme, apo ky është një rast i veçantë? Me sa shihet nga konteksti i hadithit, ky është një rast i veçantë. Përndryshe, do të ishte i tillë edhe rasti kur dikush lutet për vëllain e tij, duke mos qenë i pranishëm ky i fundit, dhe meleku thotë: "Amin, edhe për ty njëlloj!" Nga kjo do të mësonim se lutja është pranuar.

- Falënderimi për një mirësi bëhet sipas mundësisë dhe llojit të saj. Falënderimi i Allahut për pasurinë bëhet duke shpenzuar në rrugë të Tij. Falënderimi për diturinë bëhet duke ia përcjellë atij që e pyet. Falënderimi i përgjithshëm bëhet duke iu bindur Dhuruesit në çdo gjë.

Pak a shumë, kështu ndodh edhe me pendimin, i cili duhet bërë për çdo gjynah, sipas llojit. Megjithatë, njeriu nuk quhet se është penduar plotësisht, nëse nuk heq dorë nga të gjitha mëkatet.

- Lejimi i maskimit. Kjo do të thotë se lejohet që njeriu të hiqet si i varfër, si pasanik etj., kur është e dobishme dhe kur do që të vërë në provë një person të caktuar.

- Prova mund të jetë e përgjithshme dhe e dukshme. Kjo del nga thënia e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Ju u provuat."

- Vlera e devotshmërisë dhe e moskërkimit të luksit. Kjo gjë mund ta çojë njeriun në një fund të mirë. I verbri nuk kërkonte luks në dynja, por ishte falënderues ndaj begative të Allahut.

- Ligji i trashëgimisë egzistonte edhe në bashkësitë e mëparshme.

Nga atributet e Allahut të Madhëruar janë Kënaqësia, Zemërimi dhe Dëshira. Ehli Suneti i pohon ato ashtu siç i përshtaten Allahut.

Dëshira e Allahut është dy llojesh: dëshira për krijimin dhe dëshira për fenë. Ndryshimi ndërmjet tyre është se dëshira për krijimin do të ndodhë patjetër dhe nuk është e domosdoshme që Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) ta pëlqejë atë. Nëse Allahu dëshiron diçka, i thotë asaj "Bëhu!" dhe ajo bëhet. Ndërkaq, dëshira fetare nuk është e domosdoshme që të ndodhë, por është patjetër e pëlqyer nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Prandaj, themi se

dëshira e Tij për fenë tregon edhe dashurinë e Tij, ndërsa dëshira për krijimin tregon vullnetin e Tij[1].

Pyetje: Allahu e dëshiron të mirën dhe të keqen në aspektin e krijimit apo në atë fetar?

Përgjigje: Kur ndodh diçka e mirë, atë e dëshiron Allahu, si në aspektin e krijimit, po ashtu dhe në atë fetar; nëse nuk ndodh, atëherë Allahu e dëshiron atë vetëm në aspektin fetar. Ndërsa, nëse ndodh diçka e keqe, atë e dëshiron Allahu vetëm në aspektin e krijimit, por jo në atë fetar; kur ajo nuk ndodh, atëherë Allahu nuk e dëshiron as në aspektin e krijimit, as në atë fetar. Pastaj dije se, kur ndodh diçka e keqe, nuk i atribuohet veprimit të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), por krijesave të Tij. Çdo veprim i Allahut është mirësi, sepse ai buron nga urtësia dhe mëshira. Për këtë arsye, Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "E mira është në dorën Tënde, ndërsa e keqja nuk të atribuohet Ty!"[2] E për sa u përket krijesave të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), në to ka mirësi dhe ligësi.

Pohimi i atributit të Kënaqësisë për Allahun, nuk do të thotë mohim i cilësisë së urtësisë. Ndryshe ndodh me krijesën: me kënaqësinë e saj mund të mohohet urtësia. Njeriu, për shembull, kur është i kënaqur me dikë, ndjenjat mund ta shtyjnë që të kënaqet me çdo gjë të tij, pa e kontrolluar veten. Një poet thotë:

Syri i kënaqur nuk sheh asnjë të metë,
Por kur zemërohet, i pjell të ligat vetë!

---

[1] *Irade keunije* (dëshirë për krijimin, për ekzistencën e diçkaj, çka domosdo do të ndodhë, do të bëhet realitet), ose ndryshe mund të quhet edhe *irade kaderije*.
Pra, fjala *irade* (dëshira e Allahut) mund të shënojë dëshirën për krijimin ose për sjelljen e diçkaje në ekzistencë dhe mund të shënojë dëshirën fetare që ka karakter ligjvënie. Kështu, sipas kuptimit të parë ajo quhet *irade keunije kaderije,* ndërsa sipas të dytit quhet *irade sherije dinije.* Atëherë, kur Allahu dëshiron të krijojë diçka, të sjellë diçka në ekzistenë, apo të ndodhë diçka, edhe nëse e urren, ajo domosdoshmërisht do të bëhet realitet, ndërsa kur Allahu shpreh dëshirën të respektohet një normë a një rregull fetarë, ose shpreh dëshirën dukë vënë një normë fetare, nuk është e thënë që dëshira e Tij të bëhet realitetet, edhe pse Ai e pëlqen të respektohen ligjet e Tij fetare, dhe kjo për urtësi e qëllime madhore.

[2] Muslimi.

Por kënaqësia e Allahut është bashkë me urtësinë e Tij. Edhe zemërimi i Allahut nuk është si zemërimi i krijesave: ai nuk e cenon urtësinë e Tij. Ndryshe ndodh me njeriun, të cilin zemërimi – sidomos kur është shumë i nxehur – mund ta bëjë ta harrojë urtësinë dhe të sillet në mënyrë të papërshtatshme.

Nga ana tjetër, interpretimi i Kënaqësisë së Allahut si "sevape" – ose si "Vullneti i Tij" – nuk pranohet. Nëse thuhet se domethënia e "Kënaqësisë së Tij" është: "Dëshira e Tij për të shpërblyer", kështu na del që Allahu nuk kënaqet. Kush deklaron se Allahu nuk kënaqet, ka bërë kufër, jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, por në mënyrë të tërthortë, duke i interpretuar si të figurshme kuptimet e drejtpërdrejta. Kjo është një mënyrë shumë e rrezikshme, prandaj shejhu i Islamit Ibn Tejmije dhe Ibn Kajim el Xheuzije, kanë deklaruar se nuk ka figura alegorike as në Kuran, as në gjuhën arabe, ndryshe nga qëndrimi tjetër ekstrem se çdo dukuri në gjuhë është figurative.

- Emërtimi "shok" mund të përdoret për të treguar ngjashmërinë që një person ka me të tjerë në diçka dhe, nuk është e thënë që ata të jenë bashkë, sipas thënies së Profetit në hadithë: "... dhe i zemëruar me dy shokët e tu", shoqërimi këtu ka të bëjë me ngjashmërin e gjendjes së tyre në begatimin pas sprovës që kaluan.
- Prova e Allahut nëpërmjet mirësive që iu dha.
- Këshilla mund të bëhet me fjalë, vepra dhe sjellje.

Dobitë e temës

- Komenti i ajetit.

"Nëse pas një fatkeqësie, Ne i japim të shijojë nga mirësitë Tona, me siguri do të thotë: 'Këtë e meritoj!'".

- Kuptimi i shprehjes "... me siguri do të thotë: 'Këtë e meritoj!...".

- Domethënia e ajetit: "Kjo më është dhënë vetëm prej diturisë sime...".

- Në këtë ngjarje të çuditshme ka mjaft mësime madhështore.

Shumë prej të cilave i përmendëm, por ka edhe të tjera, si për shembull, ndryshimi në tregim ndërmjet lebrosit, qerosit dhe të verbrit. I sëmuri me lebër dhe qerosi i mohuan begatitë e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), ndërsa i verbri e pranoi begatinë e Tij. Kur meleku kërkoi ndihmë nga i verbri, ai i tha: "... merr ç'të duash nga pasuria ime ...". Kjo dëshmonte për bujarinë, por dhe sinqeritetin e tij për Allahun, sepse, në vijim, ai i tha: "... Betohem në Allah, se nuk kam për të thënë asgjë, për gjithçka që do të marrësh për hir të Allahut. ..." Ndërsa dy të tjerët ishin koprracë dhe mosmirënjohës.

Tema 50

Thënia e Allahut: "Por, pasi Ai u dhuroi atyre pasardhës të shëndoshë e të mirë, ata të dy i veshën Allahut ortakë, në lidhje me atë që u kishte dhënë. Por Allahu është shumë lart nga ajo që ata ia veshin Atij si ortakë!" (Araf, 190)

– *"... Por, pasi Ai u dhuroi atyre ..."* – Përemri "atyre" i referohet njeriut dhe bashkëshortes së tij, të cilët përmenden në ajetin paraardhës, nga ku duhet të nisë edhe shpjegimi: "Është Ai që ju krijoi nga një njeri i vetëm, prej të cilit krijoi edhe bashkëshorten e tij, që të gjente qetësi tek ajo. Kur ai e mbuloi bashkëshorten e vet, ajo u ngarkua me një barrë të lehtë, që e kaloi pa e ndjerë për ca kohë. Dhe, kur ajo u rëndua, ata të dy iu lutën Allahut, Zotit të tyre: 'Nëse na dhuron pasardhës të saktë, do të jemi vërtet mirënjohës." (Araf, 189)

"*Është Ai që ju krijoi nga një njeri i vetëm ...*". Në lidhje me komentin shprehjes "një njeri i vetëm", ka dy mendime:

Mendimi i parë: Flitet për një person të caktuar, i cili është Ademi (alejhi selam), ndërsa bashkëshortja e tij është Havaja, e cila u krijua nga brinja e Ademit (alejhi selam).

Mendimi i dytë: Shprehja "një njeri i vetëm" nënkupton llojin, pra: po nga ky lloj e krijoi bashkëshorten e tij, dhe jo nga ndonjë lloj tjetër. Me këtë kuptim fjala "*nefs*" (njeri, person, qenie) përdoret edhe në ajetin: "Vërtet Allahu derdhi mbi besimtarët mirësi të madhe, kur Ai çoi ndërmjet tyre një të Dërguar (Muhamedin) nga lloji i tyre..." (Ali Imran, 164).

"*... që të gjente qetësi tek ajo ...*". Qetësimi i burrit te gruaja mund të kuptohet në dy mënyra:

Së pari, kur ndërmjet çiftit ka dashuri e dhimbsuri, ato sjellin prehje dhe qëndrueshmëri.

Së dyti, qetësohet epshi. Kjo është një qetësi e veçantë, e cila nuk ka të ngjashme; ajo nuk përafrohet as me qetësinë e nënës me fëmijën e saj.

"*Kur ai e mbuloi bashkëshorten e vet ...*". Kjo do të thotë se kreu marrëdhënie intime me të. Në Kuran dhe Sunet, kur flitet për marrëdhëniet seksuale ndërmjet burrit dhe gruas së tij, përdoren shprehje të tërthorta. Për shembull, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): thotë: "... ose keni prekur gratë ..." (Nisa, 43); "... me të cilat keni pasur marrëdhënie bashkëshortore ..." (Nisa, 23); "... kur ju i jeni dhënë njëri-tjetrit ..." (Nisa, 21). Duket se turpi nga përmendja e emrit të qartë, është diçka e natyrshme. Natyra e shëndoshë njerëzore urren që të tilla gjëra të përmenden me emër, me përjashtim të rasteve kur është e domosdoshme, siç pyeti Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) Maizin, kur ky i fundit pohoi se kishte kryer imoralitet: "A ke kryer marrëdhënie në organ."[1] Këtu qe i nevojshëm të folurit shkoqur, pasi flitej për një çështje penale, që shoqërohej me ndëshkim, por ky nuk zbatohet nëse ka dyshime mbi faktet.

Krahasimi i qëndrimit të burrit mbi gruan, me mbulimin, është i kuptueshëm, ashtu sikurse nata mbulon tokën me errësirën e saj. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Për natën që mbulon ..." (Lejl, 1). Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) është shprehur me fjalën arabe "*tegash'shaha*", që përmban në kuptimin e saj diçka më shumë sesa thjesht mbulim; ajo përfshin edhe njëfarë lëvizjeje. Prandaj, në hadith ka ardhur: "Kur të shtrihet ndërmjet katër gjymtyrëve të saj, pastaj e lëviz atë."[2] Shtrirja ndërmjet katër gjymtyrëve të saj është mbulimi, ndërsa lëvizja e saj është diç më tepër sesa mbulimi, siç thuhet në ajet.

"*... ajo u ngarkua me një barrë të lehtë ...*". Barra është e lehtë në fillimin e saj. Një pikë, pastaj një copë gjaku i ngrirë, pastaj një copëz mishi pa formë.

---

[1] Buhariu.

[2] Buhariu dhe Muslimi.

"... që e kaloi pa e ndjerë, për ca kohë. ..." – Domethënë e kaloi pa lodhje dhe mundim.

"*... Dhe, kur ajo u rëndua...*". Rëndimi ndodh në periudhën e fundit të barrës.

"... ata të dy iu lutën Allahut, Zotit të tyre ...". Lutja është tregues i teuhidit të adhurimit dhe teuhidit të veprave unike të Allahut.

Është tregues i teuhidit të adhurimit, sepse robi u lut. Kurse lutja është adhurim.

Është tregues i teuhidit rrububije, sepse me anë të lutjes njeriu i kërkon Allahut të realizojë diçka, duke e njohur Atë si të Vetmin që mund ta bëjë.

"*... Nëse na dhuron pasardhës të saktë ...*". Fjala "të saktë" ka për qëllim rregullsinë trupore apo atë fetare? Cili është kuptimi: Nëse Ti na jep një njeri të saktë, pa cene në trup"? Apo të saktë në fe, duke qenë i devotshëm dhe zbatues i detyrave fetare? Në fakt, ajeti i përfshin të dyja kuptimet. Shumë komentues të Kuranit japin veç shpjegimin e parë, por nuk ka pse të mos jetë përfshirë edhe kuptimi i dytë.

"*... do të jemi vërtet mirënjohës.*". Pra, prej atyre që falënderojnë për fëmijën e saktë.

– *"Por, pasi Ai u dhuroi atyre pasardhës të shëndoshë e të mirë ..."* – Tani, pasi u përmbush lutja, por nuk u krye falënderimi që i ishte premtuar Allahut, përkundrazi, i veshën Atij ortakë në lidhje me atë që u dha.

– *"... ata të dy i veshën Allahut ortakë në lidhje me atë që u kishte dhënë ..."* – Kjo pjesë e ajetit tregon se idhujtaria nga ana e tyre ndodhi pasi iu dha fëmija, ndërkohë që ai ishte i vogël.

Një fëmijë i tillë nuk dihet a do bëhet i mirë në fe apo jo, prandaj shumica e komentuesve të Kuranit e kanë komentuar saktësinë e tij si saktësi trupore.

Zotimi që njeriu i bën Zotit të tij, për ta adhuruar Atë, për mirësitë që i fal Ai, në shumicën e rasteve nuk përmbushet. Në suren "Teube" Allahu thotë: "Ka nga ata që bëjnë besëlidhje me Allahun, duke thënë: 'Nëse Ai na jep nga mirësitë e Tij, sigurisht që ne do të japim lëmoshë dhe sigurisht që do të bëhemi njerëz të

mirë!' Por kur Ai u jep atyre nga mirësitë e Veta, ata bëhen koprracë dhe kthejnë shpinën, duke u larguar." (Teube, 75-76). Ndërsa në këtë ajet, Allahu thotë: "'Nëse na dhuron pasardhës të saktë, do të jemi vërtet mirënjohës. Por, pasi Ai u dhuroi atyre pasardhës të shëndoshë e të mirë, ata të dy i veshën Allahut ortakë në lidhje me atë që u kishte dhënë ...". Kështu, ata ishin idhujtarë dhe jo falënderues. Prej kësaj kuptojmë urtësinë e ndalesës së zotimit nga Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Zotimi është besëlidhje me Allahun (Subhanehu ue Te'Ala). Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e ka ndaluar atë duke thënë: "Zotimi nuk sjell të mira; ai buron nga koprraci."[1]

Shumë dijetarë mendojnë se zotimi është haram. Me sa duket nga fjalët e shejhut të Islamit Ibn Tejmijes, ai anon nga mendimi se zotimi është haram, sepse Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e ka ndaluar dhe e ka mohuar që ai sjell ndonjë të mirë. Çfarë mund të përfitosh nga diçka që Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e ka ndaluar dhe ka thënë se nuk sjell ndonjë të mirë? Asgjë tjetër nuk përfiton, veç vështirësive dhe ngarkimit të vetes me diçka që nuk e ke detyrim. Prandaj, mendimi se zotimi është haram është mjaft i fortë. Vlerën e këtij mendimi e njeh vetëm ai që e di se njerëzit që janë zotuar ndonjëherë, pyesin çdo dijetar që të munden, me shpresë se do të gjejnë shpëtim nga detyrimi që i kanë bërë vetes.

Pyetje: Allahu u dhuroi vetëm një fëmijë, atëherë e si bënë ortak në lidhje me këtë fëmijë, madje ortakë?

Themi se kjo mund të ndodhë në tri mënyra:

E para, duke besuar se këtë fëmijë ua dha një njeri "i shenjtë". Ky është shirk i madh, sepse i njihet krijimi dikujt tjetër veç Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Kjo ndodh në mjaft vende islame sot. Gratë që nuk lindin, shkojnë te varri i ndonjë njeriu të mirë, siç pretendojnë – dhe Allahu e di se a është i tillë apo jo – dhe lutet: "O i nderuar, më fal një fëmijë mua!"

E dyta, duke ia njohur shëndetin e plotë të të sapolindurit, mjekëve, mamive dhe këshillave të tyre, duke thënë, për shembull, se fëmija shpëtoi sepse mamia ishte shumë e aftë. Ky është një lloj

[1] Muslimi. Po kështu Buhariu dhe Muslimi shënojnë një hadith të ngjashëm me këtë.

shirku, por nuk arrin në shirk të madh, për arsye se mirësia i është njohur shkakut, duke harruar Krijuesin e shkakut, Allahun (Subhanehu ue Te'Ala).

E treta, duke mos bërë shirk në aspektin e rrububijes (veprave të Allahut), duke e besuar se foshnja lindi pa të meta në sajë të Mirësisë dhe Mëshirës së Allahut, por duke bërë shirk në adhurim, pasi do më tepër fëmijën sesa Allahun dhe Profetin e Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Dashuria për fëmijën e largon atë nga bindja ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Allahu i Madhëruar thotë: "Pasuria dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë për ju, ndërsa Allahu ka shpërblim të madh (Xhenetin)." (Tegabun, 15)

E si mund të jetë më e madhe dashuria për fëmijën sesa dashuria për Allahun, kur është Allahu Ai që ta fal atë?! Për këtë arsye, ajeti vijues është kritikë e ashpër ndaj kësaj sjelljeje. Pastaj thotë: "... Por Allahu është shumë lart nga ajo që ata ia veshin Atij si ortakë!" (Araf, 190), që do të thotë se Allahu është i dëlirë dhe larg çdo të mete që i përshkruajnë Atij.

Nëse thellohesh pak në ajet kupton se "nga një njeri i vetëm" do të thotë: "prej një lloji të vetëm", e nuk flitet në asnjë lloj aspekti për Ademin dhe Havanë. Kjo është dukuri e njohur në gjuhën arabe, e cila haset edhe në vende të tjera në Kuran, siç është ajeti: "Vërtet, Allahu derdhi mbi besimtarët mirësi të madhe, kur Ai çoi ndërmjet tyre një të Dërguar (Muhamedin) nga lloji i tyre ..." (Ali Imran, 164). Një koment i tillë largon çdo tymnajë që mund të përhapet në kokën e njeriut.

Më pas, në dashtë Allahu, do tregojmë më gjerë pse është i dobët mendimi se ajeti flet për Ademin dhe Havanë, sipas të cilit ata të dy bënë shirk, por – siç thonë ata – ishte shirk në bindje, jo shirk në adhurim. Në fakt, ky mendim përputhet me shpjegimin që përcillet nga Ibn Abasi (r.a.).

Po kështu, ka edhe një mendim të tretë, se fillimi i ajeti: "është Ai që ju krijoi nga një njeri i vetëm prej të cilit krijoi edhe bashkëshorten e tij, që të gjente qetësi tek ajo", ka për qëllim Ademin dhe Havanë (alejhi selam), ndërsa vazhdimi: "Kur ai e mbuloi bashkëshorten e vet ...", bën një kapërcim dhe flet për njeriun në përgjithësi. Prandaj, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë:

"Por Allahu është shumë lart nga ajo që ata ia veshin Atij si ortakë!", dhe nuk thotë: "ata të dy". Një dukuri të ngjashme – sipas atyre që përkrahin këtë mendim – has edhe në ajetin tjetër, ku Allahu thotë: "Ne e kemi zbukuruar qiellin më të afërt me yje të shkëlqyeshme dhe i kemi bërë ato si predha, për të larguar shejtanët ..." (Mulk, 5), që do të thotë: Ne i bëmë meteorët, që dalin prej yjeve, gjuajtës për shejtanët, dhe jo vetë yjet. Po kështu edhe në ajetin: "Me të vërtetë, Ne e krijuam njeriun prej palcës së baltës, e pastaj, e bëmë atë pikë fare ..." (Mu'minun, 12-13), që do të thotë: bëmë njeriun si lloj.

Atëherë, sipas kësaj, fillimi i ajetit është për Ademin dhe Havanë, pastaj bëhet një kalim te pasardhësit e tyre. Ky koment është i arsyeshëm. Ai e sheh Ademin dhe Havanë larg prej idhujtarisë, porse në këtë kuptim hasim një formulim sintaksor disi të dobët, për shkak të shpërqendrimit të përemrave.

> Ibn Hazmi ka thënë: "Dijetarët janë të një mendimi për sa i përket ndalimit të çdo emri që tregon robëri ndaj dikujt tjetër veç Allahut, si: Abdu Amru (Robi i Amrit), Abdul Kabeh (Robi i Qabes) e të tjerë, përveç emrit Abdul Mutalib."

Ixhmaja (mendimi unanim i dijetarëve) është njëri nga themelet e Sheriatit, mbi të cilin mund të ndërtohen dispozitat e tij. Themelet e tjera janë: Kurani, Suneti, dhe analogjia.

– *"... e të tjerë ..."* – Shembuj të tjerë janë: Robi i Hysejnit, Robi i Mesihut, Robi i Profetit, Robi i Aliut. Ndërsa në hadithin e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Është shkatërruar robi i dinarit, ka dështuar robi i argjendit, ka dështuar robi i veshjes së bukur, ka dështuar robi i shtresës së butë ...", nuk flitet për emra njerëzish, por është bërë një krahasim. Ai i ka krahasuar njerëzit që angazhohen me pasion pas të tilla gjërave si robër të tyre, si të thuash "rob i parasë". Ky hadith nuk ka lidhje me qëndrimin unanim të dijetarëve për çështjen e mësipërme.

– *"... përveç Abdul Mutalib."* – Për këtë emër nuk ka unanimitet. Disa thonë se nuk është i ndaluar, pasi vetë Profeti (sal-lAllahu

‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Unë jam Profet pa gënjeshtra! Unë jam i biri i Abdul Mutalibit.” Dhe ai nuk bënte vepra të ndaluara. Pra, lejohet emërtimi Abdul Mutalib, vetëm nëse gjendet një argument tjetër që e anulon këtë gjë. Kështu thotë Ibn Hazmi.

E sakta është që ndalohet edhe një emër i tillë. Askujt nuk i lejohet që ta emërtojë djalin e vet “Abdul Mutalib”. Ndërsa me deklaratën e tij: “Unë jam i biri i Abdul Mutalibit”, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thjesht po bënte një kumtim, po tregonte se kishte pasur një gjysh me emrin Abdul Mutalib, dhe jo se po quante veten me një emër të ri. Nuk ka dëshmi prej Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) që ai të ketë emërtuar ndonjë me të tillë emër, ose të ketë urdhëruar ndonjë sahab që të mbajë atë emër, apo që t’ia ketë pranuar ndonjërit atë emër.

Ka ndryshim ndërmjet përdorimit të një emri të dikurshëm, që shërben për të treguar diçka ose dikë, dhe një emërtimi të ri apo pranimit të atij emri. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Me të vërtetë Benu Hashimët dhe Benu Abdu Menafët duhet të trajtohen njësoj”[1], ndërkohë që nuk lejohet emërtimi “Abdu Menaf” (Robi i Menafit). Dijetarët thonë se “ai që e tregon kufrin nuk është qafir”. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) fliste për diçka që kishte ndodhur, kaluar e mbaruar.

Përfundimisht, më e sakta është që nuk lejohen emërtimet që tregojnë robëri ndaj dikujt tjetër veç Allahut, qoftë edhe emri Abdul Mutalib, sepse është një shfaqje e shirkut.

> Ibn Abasi, për ajetin e sipërpërmendur, tregon: “Kur Ademi u bashkua me Havanë, ajo mbeti shtatzënë. Atëherë, iu afrua Iblisi e u tha duke i frikësuar: ‘Unë jam shoku juaj, që ju nxora nga Xheneti. Tani, ose do të më bindeni mua, ose do t’i bëj atij (foshnjës në bark) dy brirë cjapi të egër, që të dalë nga barku yt duke e çarë atë! E sigurisht që kam për ta bërë!”. ‘Quajeni atë Abdul Harith![2]’ Por ata nuk pranuan t’i binden atij, dhe fëmija doli i vdekur. Havaja mbeti shtatzënë përsëri, e përsëri

[1] Buhariu.
[2] Thuhet se Harith quhej Shejtani

> Iblisi u shkoi atyre me të njëjtat fjalë. Kësaj here, ata i mundi dashuria për fëmijën dhe e quajtën Abdul Harith. Ja pse Allahu thotë: "... ata të dy i veshën Allahut ortakë në lidhje me atë që u kishte dhënë ...".[1]
> Po nga Ibn Abasi, me zinxhir të saktë nga Katade, përcillet se ka thënë: "Bënë shirk në bindjen ndaj Tij, por jo në adhurimin e Tij[2]."
> Gjithashtu, nga Muxhahidi, me zinxhir të saktë, përcillet se për ajetin: "Nëse na dhuron pasardhës të saktë ...", ka thënë: "Ata të dy patën frikë se (fëmija) nuk do të ishte njeri." Po kështu, përmendet një thënie me të njëjtin kuptim nga Hasani, Seidi e të tjerë.[3]

– *"... Iblisi ..."* – Është thënë se ky emër vjen nga fjala arabe *eblese* që do të thotë: u bë pesimist, sepse ai u bë pesimist që do ta kapë mëshira e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

– *"... Quajeni atë Abdul Harith! ..."* – Zgjodhi këtë emër, sepse ai është emri i tij (i Iblisit) , duke dashur t'i vendosin një emër që tregon robëri ndaj tij.

– *"... fëmija doli i vdekur ..."* – Nuk u realizua kërcënimi i parë, por mund të jetë pjesë e kërcënimeve: "dhe sigurisht do të bëj".

– *"... Bënë shirk në bindjen ndaj Tij, por jo në adhurimin e Tij ..."* –

---

[1] Ibn Ebi Hatim. Sipas Ibn Kethirit dhe Albanit transmetimi është i dobët.
[2] Me vënien e një emri që shprehte robëri ndaj dikujt tjetër veç Allahut ata iu bindën urdhrit të shejtanit, e kjo është një formë shirku, por jo në adhurim. Ka ndryshim ndërmjet bindjes në gjynah dhe ndërmjet adhurimit. Pra, ka ndryshim ndërmjet shirkut në bindje dhe ndërmjet shirkut në adhurim. Nëse dikush i bindet një tjetri për kryerjen e një gjynahu, ai nuk e ka bërë atë shok me Allahun në adhurim, porse ka kryer një gjynah që cenon përsosjen e teuhidit. Shirku në bindje nuk e nxjerr njeriun nga feja, ndërsa shirku në adhurim e nxjerr atë nga feja. Mirëpo në rastin kur dikush tregon bindje ndaj një tjetri në lejimin e asaj që e ka ndaluar Allahu apo në ndalimin e asaj që e ka lejuar Allahu, kjo bindje është shirk i madh që e nxjerr atë nga feja e Allahut.
[3] Shiko tefsirin e Ibn Xheririt dhe Ibn Kethirit.

Ata të dy iu bindën urdhrit të Iblisit, e nuk iu bindën me adhurim. Ka ndryshim ndërmjet bindjes dhe adhurimit. Bindja ndaj dikujt për diçka që e kundërshton Allahun, nuk është shirk në adhurim, por është bindje në kundërshtim të Allahut.

– *"... patën frikë se nuk do të ishte njeri. ..."* – Kjo do të thotë se Ademi dhe Havaja u druajtën se mos fëmija i tyre do të dilte kafshë, xhind ose diçka tjetër.

– *"... Po kështu, përmendet një thënie me të njëjtin kuptim nga Hasani, Seidi e të tjerë ..."* – Në lidhje me Hasanin, e vërteta është se ai ka thënë që ajeti nuk ka për qëllim Ademin dhe Havanë, por idhujtarët nga bijtë e Ademit. Ibn Kethiri, në shpjegimin e tij, thotë: "Për këtë çështje, ne jemi me mendimin e Hasan el Basriut (Allahu e mëshiroftë!), që thotë se, nga konteksti, nuk është për qëllim Ademi dhe Havaja, por idhujtarët nga pasardhësit e tij".

Kjo ngjarje është e pasaktë për disa arsye:

Së pari, ajo nuk përmban ndonjë dëshmi të saktë nga Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), pasi ky është një rrëfim që mund të mësohet veç me Shpallje hyjnore. Ibn Hazmi e quan atë një përrallë, një sajim.

Së dyti, sikur të ishte e vërtetë, Ademi dhe Havaja ose do të pendoheshin për idhujtarinë, ose do të vdisnin në atë gjendje. Nëse do të pranonim se ata kanë vdekur në idhujtari, kjo do të ishte më e rëndë se fjalët e disa hipokritëve qafirë:

Kur kujtojmë Ademin dhe se ç'bëri ai,
Martesën e dy bijave me dy bijtë e tij,
Mësojmë se njerëzit nga kurvëria vijnë,
Kopila të gjithë janë në origjinë.

Kush e quan diçka të mundur vdekjen e Profetëve në idhujtari, ka bërë një shpifje të madhe. Edhe sikur ndonjë Profet të kishte bërë një vepër të tillë, e pastaj të ishte penduar, nuk është prej urtësisë dhe drejtësisë së Allahut që Ai të përmendte gabimin, e të mos na tregonte për pendimin e tyre. Do të ishte e pamundur që Ademi dhe Havaja të bënin atë gabim dhe të ishin penduar, ndërsa Allahu të përmendte veç gabimin e tyre, jo pendimin. Gjithmonë

Allahu i Madhëruar, kur përmend gabimin e disa Profetëve dhe të Dërguarve të Tij, tregon edhe për pendimin e tyre, siç ndodh me rrëfimin e historisë së vetë Ademit (alejhi selam), sipas të cilit ai dhe bashkëshortja e tij hëngrën nga pema e ndaluar dhe pastaj u penduan për atë veprim.

Së treti, Profetët kanë qenë të mbrojtur nga idhujtaria, sipas mendimit unanim të dijetarëve.

Së katërti, në hadithin që flet për ndërmjetësimin në Ditën e Gjykimit, thuhet – me përcjellje të saktë – se njerëzit do të shkojnë tek Ademit dhe do t'i kërkojnë të bëjë ndërmjetësim tek Allahu, por ai nuk pranon duke u arsyetuar me gjynahun e ngrënies nga ana e tij të pemës së ndaluar[1]. Ajo vepër ishte një gjynah, kështu që nëse kjo vepra tjetër do të ishte shirk, atëherë ai do të arsyetohej me të, sepse do të ishte arsyetim më i fortë.

Së pesti, sipas këtij rrëfimi, shejtani shkon tek ata të dy dhe u thotë: "Unë jam shoku juaj, që ju nxora nga Xheneti." Kështu nuk mund të flasë kurrsesi dikush që kërkon të mashtrojë përsëri, pasi ky do të ishte argument që ata të mos e besonin më, edhe sikur të thoshte të vërtetën

Së gjashti, sipas rrëfimit, Iblisi i kërcënon: "… do t'i bëj atij dy brirë cjapi të egër …". Kësisoj, ata ose do ta besonin që ai kishte mundësi ta bënte këtë, dhe kjo do të ishte idhujtari tjetër, në rrububije (veprat e Allahut), sepse atë nuk mund ta bënte askush tjetër veç Allahut; ose nuk do ta besonin, e atëherë nuk do t'i bindeshin urdhrit të tij.

Së shtati, nga ajeti: "Por Allahu është shumë lart nga ajo që ata ia veshin Atij si ortakë!", kuptohet se "ata" është në shumësin e përgjithshëm, ndryshe do të thuhej: "ata të dy" (sipas arabishtes).

Të gjitha këto argumente provojnë se kjo histori nuk është e saktë që në rrënjë. Gjithashtu, nuk lejohet që të besohet për Ademin dhe Havanë se ata kanë rënë në idhujtari, sido që të jetë çështja. Profetët kanë qenë të ruajtur nga idhujtaria, sipas mendimit unanim të dijetarëve.

Përfundimisht, ajeti flet për njerëzit në përgjithësi, nga të cilët disa bien në idhujtari e disa janë monoteistë të vërtetë.

---

[1] Siç shënohet në pëmledhjen e Buhariut dhe Muslimit.

Dobitë e temës

- Ndalimi i çdo emri që tregon robëri ndaj dikujt tjetër veç Allahut.

Kjo është marrë nga *ixhma*-ja që ka ardhur në lidhje me këtë. *Ixhma*-ja është një nga tri bazat te të cilat mbështetet feja. Më parë u përmend se e sakta është që nuk lejohet emërtimi që tregon robëri ndaj Mutalibit, ndërsa thënia e Profetit (salallahu alejhi ue selem): "Unë jam i biri i Abdul Mutalibit."[1], është në aspektin e lajmërimit dhe jo të pohimit dhe emërtimit të ri. Personit i lejohet që të tregojë prejardhjen e tij nga babai, edhe nëse emri i tij tregon robëri ndaj dikujt tjetër veç Allahut. Po kështu, Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: "O Benu Abdu Menaf..."[2], e cila është shprehje që tregon për robëri ndaj dikujt tjetër veç Allahut, por në aspektin e lajmërimit.

- Komenti i ajetit.

"... Por, pasi Ai u dhuroi atyre pasardhës të shëndoshë e të mirë ...".

- Ky shirk ishte thjesht në formën e emërtimit, dhe jo në përmbajtjen e këtij emërtimi.

Kjo vlen nëse bazohemi në komentin e ajetit që ka bërë Ibn Abasi (r.a.). E sakta është se ky shirk është i vërtetë, i plotë. Atë e bëjnë bijtë e Ademit, e jo, vetë Ademi dhe Havaja. Prandaj Allahu, në të njëjtin ajet thotë: "A mos vallë ata i veshin Atij si ortakë idhuj që nuk mund të krijojnë asgjë, ndërkohë që vetë janë të krijuar?!" (Araf, 191).

[1] Buhariu.
[2] Buhariu dhe Muslimi.

- Konsiderohet begati edhe kur Allahu të fal një vajzë të saktë.

Kjo, nëse e marrim rrëfimin si të vërtetë. Kuptimi i fjalës "i saktë" është: "i saktë në të gjitha aspektet". Autori ka përmendur vajzën dhe jo djalin, sepse disa njerëz mendojnë që vajza është fatkeqësi. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Dhe, kur ndonjëri prej tyre merr lajmin se i lindi një vajzë, fytyra i nxihet dhe i mbushet me mjerim. Ai fshihet nga njerëzit për shkak të lajmit të keq dhe s'di: a ta mbajë këtë fëmijë, pavarësisht poshtërimit, apo ta varrosë në dhé. Ah, sa mbrapsht gjykojnë ata!" (Nahl, 58-59). Edhe fëmija mashkull, i saktë, është mirësi, madje më e madhe se femra, ndonëse rritja, përkujdesja dhe edukimi i femrës ka shpërblim mjaft të madh.

- Selefët bënin dallim ndërmjet shirkut në bindje dhe atij në adhurim.

Por, le të sqarojmë ndryshimin ndërmjet bindjes dhe adhurimit. Bindja, kur bëhet ndaj Allahut, nuk ka ndryshim nga adhurimi, sepse adhurimi i Allahut është bindja ndaj Tij. Kurse bindja ndaj dikujt tjetër nuk është adhurim. Ne i bindemi Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), por nuk e adhurojmë atë. Gjithashtu, njeriu mund t'i bindet një mbreti, ndërkohë që e urren atë. Atëherë, shirku në bindje është që t'i bindesh dikujt jo nga ndjenja e dashurisë, nënshtrimit para tij dhe e madhërimit të tij, siç bën me Allahun (Subhanehu ue Te'Ala), por është vetëm zbatim i urdhrit të tij. Sipas rrëfimit, Ademi dhe Havaja iu bindën shejtanit dhe nuk e adhuruan atë, gjithmonë nëse e quajmë histori të vërtetë.

Tema 51

Thënia e Allahut: "Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj lutjuni Atij me to dhe largohuni nga ata që i shtrembërojnë emrat e Tij ..." (Araf, 180)

Kjo temë lidhet me teuhidin në emrat dhe atributet e Allahut, pasi ky libër i përmbledh të tri aspektet e njësimit të Zotit: njësimi në rrububije (veprat e Allahut), njësimi në adhurimin që bën njeriu dhe njësimi në emrat dhe cilësitë e Allahut.

Ky aspekt i teuhidit kërkon të pohosh ato emra dhe atribute të Allahut të vërtetuara nga tekste e dëshmi të sakta, ashtu si ato janë, pa i shtrembëruar kuptimet e tyre, pa i mohuar krejtësisht ato, pa i përqasur me diçka tjetër dhe pa bërë përshkrime dhe shpjegime të hamendësuara të tyre.

Teuhidi plotësohet me dy shtylla: *pohimin* dhe *mohimin*. Nëse diçka vetëm do të mohohej, mohimi do të ishte gjithëpërfshirës, e nëse kjo diçka vetëm do të pohohej, pohimi nuk do të përjashtonte diçka tjetër shoqëruese. Nëse themi, për shembull: "Zejdi u ngrit", ne pohojmë që ai është ngritur, por kjo nuk do të thotë aspak se ishte vetëm ai që u ngrit. Nga ana tjetër, nëse thuhet vetëm "nuk u ngrit", ky është mohim i përgjithshëm (që përfshin edhe Zejdin). Por nëse themi se askush nuk u ngrit, përveç Zejdit, kjo do të thotë se vetëm ai është ngritur, pasi në thënie është përfshirë edhe pohimi, edhe mohimi. Kësisoj, kur thua "Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut", e ke njësuar Allahun në adhurim. Nëse ia pohon Allahut emrat dhe atributet, pa i përngjasuar ato me asgjë, e

ke realizuar këtë teuhid. Nëse ia mohon ato emra dhe atribute, ke bërë mohim të Tij, e nëse ia përngjason ato me të dikujt apo diçkaje tjetër, i ke bërë Zotit të barabartë.

– *"Allahut i përkasin emrat më të bukur ..."* – Emrat e Allahut janë të përkryer dhe më të bukurit. Ato nuk kanë asnjë mangësi, e nuk lënë vend për diskutim.

Fjalët që përdorim për të lajmëruar rreth Allahut dhe atributeve të Tij nuk janë domosdo emra të Tij, kështu që fjalët që përdoren thjesht për informim janë më shumë sesa ato që përmenden si emra të Tij. Fjala vjen, për të treguar rreth Allahut mund të përdorim edhe fjalë të tilla si: 'gjë', 'folës', 'dëshirues' etj. Këto fjalë, përdoren për efekt lajmërimi, por jo si emra të Zotit. Arsyeja përse nuk emërtohet Allahu me fjalë të tilla është se ato, ose nuk tregojnë në vetvete ndonjë kuptim të bukur apo lavdërim, siç është fjala 'gjë', ose nuk përdoren në çdo rast për lavdërim, por mund të përdoren edhe për lavdërim edhe për diçka jo të lavdërueshme, siç janë fjalët 'dëshirues', 'folës' etj.

Më lart kemi trajtuar disa pika të rëndësishme në lidhje me emrat e Allahut:

1. Emrat e Allahut janë njëkohësisht shenjues dhe atribute.
2. Emrat e Allahut janë njëkohësisht sinonimikë dhe polisemikë.
3. Emrat e Allahut, si ndërtime fonetike janë veç fjalë, ndërsa si shenjues ata tregojnë Allahun.
4. Emrat e Allahut merren vetëm nga Kurani dhe Suneti i saktë.
5. Numri i emrave të Allahut nuk është i kufizuar.
6. Kur emrat e Allahut vijnë nga folje që tregojnë veprim, është detyrë të besohet emri, atributi dhe rezultati i atij veprimi. E nëse nuk janë të tillë, është detyrë të besojmë emrin dhe atributin që ai përmban.
7. Ç'do të thotë të mësosh emrat e Allahut për të hyrë në Xhenet:
   - së pari, t'i mësojmë përmendësh, duke u ditur kuptimin;
   - së dyti, ta lusim Allahun me ta, siç thotë Ai (Subhanehu ue Te'Ala): "... prandaj lutjuni Atij me to ..." (Araf, 180),

duke i bërë mjet për të arritur kërkesën tënde;

- së treti, ta adhurojmë Allahun sipas domethënieve të tyre. Kur mëson se Ai është i Mëshirshmi, të shpresosh për mëshirën e Tij; kur mëson se Ai është Falës, të kërkosh faljen e Tij; kur mëson se Ai është Dëgjuesi, t'u ruhesh fjalëve që Ai i urren; kur mëson se Ai është Shikuesi, t'u ruhesh veprave që Ai nuk i pëlqen.

– *"... prandaj lutjuni Atij me to ..."* – Lutja këtu nënkupton kërkesë për diçka. Lutja mund të jetë me fjalë, si për shembull: "O Allah, më fal mua, o Falës!", ose me veprime, duke adhuruar Atë. Për këtë arsye, dijetarët thonë se lutja është kërkesë dhe adhurim, sepse personi i cili kryen adhurimin, shpreson me gjendjen e tij, mëshirën e Allahut dhe i frikësohet dënimit të Tij.

Që t'i lutesh Allahut me emrat e Tij, lipset së pari t'i njohim ata. Kështu kundërshtojmë disa "tolerantë" të kohës sonë, që thonë se studimi i emrave dhe cilësive të Allahut është i panevojshëm. A mos kërkojnë të adhurojnë dikë pa emra dhe atribute? Apo duan të tolerojnë ata shtrembërues të kuptimeve të tyre, duke shmangur debatin dhe dialogun me ta? Është e rrezikshme t'u thuhet njerëzve që të mos i studiojnë emrat dhe cilësitë e Allahut, edhe pse Ai na ka urdhëruar t'i lutemi me to. Urdhri është detyrim, pra është e domosdoshme t'i mësojmë këto emra dhe cilësi.

Natyrisht që ne nuk i mësojmë ata thjesht si fjalë, pa ua ditur kuptimin. Ata kanë kuptime, të cilat ne patjetër duhet t'i studiojmë. Njohja e tyre thjesht si fjalë, nuk ka dobi. Edhe nëse themi se vetëm përmendja e emrave ka vlerë si adhurim, sërish dobia nuk është e plotë.

T'i drejtohesh Allahut me emrat e Tij shërben si:

1- Adhurim, kur e adhuron Allahun sipas përmbajtjes së atyre emrave. Allahu i Madhëruar e quan atë adhurim: "Zoti juaj ka thënë: 'Lutmëni Mua se do t'ju përgjigjem!' Me të vërtetë, ata që nga mendjemadhësia nuk duan të më adhurojnë Mua ..." (Gafir, 60). Nuk thotë: "nuk duan të më luten Mua", por thotë: "... nuk duan të më adhurojnë Mua ...". Kjo dëshmon se lutja është adhurim.

Emri *Err Rrahim* tregon se Ai është Mëshirues, prandaj duhet të bësh gjithçka që të fitosh mëshirën e Tij. Emri tjetër *El Gafurr*

tregon se Ai është Falës, e atëherë lipset të kërkosh e të zbatosh gjithçka që sjell faljen e Allahut të Madhëruar, duke u penduar thellë. *El Karib* do të thotë se duhet të kërkosh veprat që të afrojnë tek Ai, si namazi e të tjera. Njeriu më afër Zotit të tij, është në sexhde, andaj duhet të shtohen sa më shumë ato. *Es Semi* do të thotë se duhet të ruash gjuhën, që Allahu të mos dëgjojë prej teje fjalë që e zemërojnë Atë. *El Besir* do të thotë se duhet ta adhurosh Allahun, në mënyrë që Ai të mos shikojë prej teje veprime që Ai i urren.

2- Si mënyrë për t'iu lutur Atij, duke i përmendur emrat e Tij përpara lutjes tënde, si ndërmjetësim për tek Allahu i Madhëruar. Për shembull: "Ja Haju!" (O i Gjallë, i Përjetshëm), "Ja Kajum!" (O i Vetqëndrueshëm[1],) më fal dhe më mëshiro mua! Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Më fal dhe më mëshiro mua, se vërtet Ti je Falës dhe Mëshirues!"[2]

Kur njeriu e lut Allahun me një emër, për diçka që realizohet në sajë të atributit që përshkruan emri, kështu ai e ka lavdëruar Allahun dhe rrjedhimisht ka realizuar shkakun për përgjigjen e lutjes. Afrimi tek i Luturi me një cilësi të dashur për Të, është shkak për përgjigje.

– *"... dhe largohuni nga ata që i shtrembërojnë emrat e Tij ..."* – Pra, braktisini ata. Pastaj Allahu i kërcënon: "Ata do të shpërblehen për çfarë kanë vepruar." (Araf, 180). Vepra e tyre është kufri, për të cilin do të ndëshkohen. Allahu lidh shpërblimin me punën për të treguar drejtësinë e Tij.

Kuptimi i urdhrit: "largohuni nga ata" është: mos ndiqni rrugën e tyre, sepse ata janë në humbje dhe i kanë kaluar caqet. Kështu që ai nuk duhet kuptuar si urdhër për moskëshillimin e tyre dhe mossqarimin e të vërtetës për ta, sepse zullumqari nuk duhet të lihet në zullumin e tij. Por ai urdhër mund të jetë edhe një lloj kërcënimi për devijuesit.

Devijimi në çështjen e emrave dhe cilësive të Allahut do të thotë të shmangesh nga pohimi i të vërtetave të tyre. Ai ka disa forma:

---

[1] Ai i Cili i mban të gjitha krijesat dhe i bën të qëndrojnë, Ai i Cili rregullon çështjet e krijesave dhe i mbron, i ruan dhe kujdeset për to.
[2] Buhariu dhe Muslimi.

1- Të mohosh diçka që ka të bëjë me emrat e Allahut ose atributet që ato përshkruajnë, ose rezultatet që rrjedhin prej tyre. Devijimi këtu është sepse ai është shmangur asaj që është detyrë lidhur me to. Detyrë në lidhje me emrat është: pohimi i tyre, pohimi i atributeve që përshkruajnë dhe i rezultateve që rrjedhin prej tyre.

2- T'i pohosh Allahut emra me të cilët nuk e ka përshkruar Veten. Për shembull, disa filozofë e quajnë Allahun "Shkak" që vepron në gjithësi, kurse gjithësia është rezultati i tij. E kështu mohuan Zotin. Disa të tjerë e quajnë "Arsyeja e veprimit", ajo që e administron këtë gjithësi. Edhe emri që përdorin të krishterët, "Ati", hyn në këtë kategori.

3- T'i përngjasosh cilësitë që përmbajnë këto emra me cilësitë e krijesave. Kësisoj, meqë Allahu përshkruhet me cilësi të tilla si Dëgjues, Shikues dhe i Pushtetshëm, ashtu si edhe njeriu, atëherë ata duhet të kenë të përbashkëta; meqë përputhen fjalët si shenjues, duhet të përputhen edhe cilësitë reale të të shenjuarve të tyre. Devijimi qëndron në faktin se kuptimet e emrave të Allahut, të cilët janë të tillë që i përshtaten vetëm Atij (Subhanehu ue Te'Ala), nuk mund të jenë të ngjashëm me kuptimet e emrave apo fjalëve që shenjojnë krijesa.

4- Prej këtyre emrave të ndërtosh emra idhujsh, siç quajtën '*Lat*' (emër idhulli) - i formuar nga '*Ilah*', '*Uza*' - i formuar nga '*Aziz*', ose '*Menat*' nga '*Menan*'. Kjo bëhej nga idhujtarët, me qëllim që t'u vishnin idhujve cilësi hyjnore, e kështu të justifikonin veprimet e veta.

Ajo që mohohet në Kuran dhe në Sunet është ngjashmëria dhe krahasimi i Allahut me Krijesat, por ama kjo nuk do të thotë se Allahu nuk ndan asnjë farë koncepti të përbashkët me ekzistencat e tjera, sepse ndërmjet dy qenieve ekzistuese ka patjetër diçka të përbashkët, edhe pse ka secila prej tyre të veçantën e saj. Për shembull, "jeta" është një atribut që i pohohet Krijuesit dhe krijesave, e në këtë atribut ka diçka të përbashkët ndërmjet tyre, por jeta e Krijuesit është në përshtatje me Krijuesin dhe jeta e krijesave është në përshtatje me krijesat. Kështu, e përbashkëta është se secili prej tyre jeton, ndërsa pakrahasueshmëria qëndron në faktin se realiteti i jetës së Krijuesit ndryshon nga realiteti i jetës së krijesës.

Disa njerëz duke mos pranuar asnjëfarë përbashkësie mes Krijuesit dhe krijesave, kanë arritur deri aty, sa kanë mohuar edhe ato cilësi që Allahu ia ka pohuar Vetvetes.

Ajeti më pas vazhdon: "... Ata do të shpërblehen për çfarë kanë vepruar."

"... Ata do të shpërblehen ...". Allahu nuk ka thënë që do të ndëshkohen për të treguar se shpërblimi bëhet sipas llojit të veprës. Ky është një kërcënim, ashtu si tek ajeti tjetër: "Ne do të merremi me llogarinë tuaj, o ju dy barrët (njerëz dhe xhindë)!" (Rrahman, 31). Kjo nuk do të thotë se tani Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) është i zënë me punë, e më pas Ai do të jetë i lirë për t'u marrë me ta.

"... për çfarë kanë vepruar ...". Kjo përfshin fjalët dhe veprat. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë gjithashtu: "Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë (apo sa një milingonë), do ta shohë atë, kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë (apo sa një milingonë), do ta shohë atë." (Zelzele, 7-8).

> Ibn Ebu Hatimi përcjell nga Ibn Abasi se: "... i shtrembërojnë emrat e Tij ...", do të thotë: bëjnë shirk. Po nga ai përcillet se idhujt Lat dhe Uza u quajtën ashtu duke u mbështetur tek emrat Ilah dhe Aziz." Ndërsa El Ameshi e ka shpjeguar: "Fusin emra që nuk janë prej tyre"[1]

Shtrembërimi i emrave të Allahut mund të jetë shirk − sipas Ibn Abasit − në dy raste:

1- Kur i përngjason ato me emrat e krijesave.

2- Kur i përdor ato për të emërtuar idhuj.

Në rastin e parë është shirk, sepse konsiderohet dikush tjetër si i ngjashëm me Allahun. Edhe në rastin e dytë është shirk, sepse idhujt përngjasohen me Allahun (Subhanehu ue Te'Ala).

Ndërsa sipas Ameshit, një tjetër lloj i shtrembërimit është ta thërrasësh Atë me emra që Ai nuk e ka emërtuar Veten. Kush bën të tilla shtesa vetëm se ka mohuar. Ne kemi detyrë të qëndrojmë brenda kufijve të fesë.

[1] Ibn Ebi Hatim.

Shtojcë

Shtrembërimi mund të bëhet edhe në argumente, siç thotë Allahu: "Ata që i shtrembërojnë argumentet Tona, nuk mund të na fshihen." (Fusilet, 40). Ky ajet është edhe kërcënim, sepse: "nuk mund të na fshihen", do të thotë: "do t'i ndëshkojmë ata".

Argumentet e Allahut janë:

1- *Argumente të krijimit.* Këtu futen të gjitha krijesat, si qiejt, toka, yjet, malet, pemët, kafshët etj., siç thotë një poet:

Gjithçka dëshmon, çdo gjë,
që Zoti ynë është Një.

Shtrembërimi i argumenteve të krijimit paraqitet në tri forma:

a) Kur beson se dikush tjetër përveç Allahut i realizon ato ose disa prej tyre.

b) Kur beson se dikush tjetër i ka krijuar ato bashkë me Allahun.

c) Kur beson se Allahu ka ndihmësa për krijimin dhe për rregullimin e çështjeve të tyre, siç thuhet në Kuran: "Thuaju (O Muhamed): 'Thirrini ata të cilët ju i hyjnizoni krahas Allahut! Ata nuk kanë në sundim as sa pesha e një grimce (e një milingone), qoftë në qiej apo në tokë; për ata nuk ka pjesë as në qiej, as në Tokë dhe Allahu nuk ka asnjë ndihmës nga radhët e tyre." (Sebe, 22).

Çdo gjë që cënon teuhidin rrububije (veprave të Allahut) hyn në shtrembërimin e argumenteve të krijimit.

2- *Argumente të fesë.* Janë ato pjesë të Shpalljes hyjnore, me të cilat u dalluan Profetët, siç është, për shembull, Kurani. Allahu i Madhëruar thotë: "Përkundrazi! Ai (Kurani) është plot argumente të qarta në zemrat e atyre, të cilëve u është dhënë dija" (Ankebut, 49).

Edhe shtrembërimi i argumenteve të fesë ka tri forma:

a) Mohimi i kumtit që ato përcjellin.

b) Kundërshtimi i dispozitave që ato përmbajnë.

c) Shtrembërimi i kumtit dhe i dispozitave që ato përmbajnë.

Shtrembërimi i argumenteve të krijimit dhe të fesë është haram. Ndonjëherë ai është kufër, si për shembull, mohimi i tyre. Kush mohon diçka, duke e ditur se atë e kanë pohuar Allahu i Madhëruar dhe Pejgamberi i Tij, ai është qafir. Megjithatë, ai mund të jetë edhe gjynah i madh, siç janë vrasja dhe imoraliteti, ose gjynah i vogël, siç

është shikimi i gruas së huaj, për shkak të epshit.

Allahu i Madhëruar thotë: "... ata që synojnë ta përdhosin (Xhamin e Qabes) me të keqe, Ne do t'i bëjmë të shijojnë dënim të dhembshëm" (Haxh, 25). Këtu shtrembërimi është quajtur "përdhosje, shkelje", shmangie nga detyrimi. Detyra është të ecim në rrugën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala); kush e kundërshton këtë, ka devijuar.

Dobitë e temës

- Pohimi se Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) ka emra.

Argument është ajeti: "Allahut i përkasin emrat më të bukur ...". Ndërsa *xhehmi*-të dhe ekstremistët *mutezil*-ë i kanë mohuar emrat e Allahut.

- Emrat e Allahut janë më të bukurit.
- Urdhërimi për t'iu lutur Allahut me to.

Lutja shërben për t'i kërkuar Allahut dhe për ta adhuruar Atë. Në të dyja rastet duhet t'i lutesh Allahu me emrat e Tij të bukur.

- Largimi prej injorantëve dhe mohuesve të emrave të Allahut.

Mirëpo kjo nuk do të thotë që të mos i ftojmë ata për të mos u treguar të vërtetën. Ajeti që flet për këtë përmban edhe kërcënim.

- Shpjegimi i shtrembërimit të emrave të Allahut.
- Kërcënimi ndaj atyre që bëjnë diçka të tillë.

Kjo del nga fjala e Tij: "... Ata do të shpërblehen për çfarë kanë

vepruar.”

Tema 52

Nuk thuhet: *Es-selamu alall-llahi* (Paqja qoftë për Allahun)!

Dijetari (Allahu e mëshiroftë!) e nis këtë temë me mohimin e një vepre, që do të thotë se ajo mund të jetë e urryer ose haram. Hadithi që sillet si argument dëshmon se ajo është haram dhe, në fakt, ashtu është.

Fjala *'selam'* ka disa kuptime:

1. Përshëndetje. E tillë është në shprehjen: "Çoji selam atij!", pra, përshëndete atë prej meje.

2. Shpëtim nga mangësitë dhe të këqijat. E tillë është në shprehjen: "*Es-selamu alejke ejuhen-nebiju ue rahmetullahi ue berekatuhu*!" (Paqja, shpëtimi, mëshira dhe mirësitë e Allahut qofshin për ty, o Pejgamberi i Allahut!)

3. Është një nga emrat e Allahut të Madhëruar. Allahu i Madhëruar thotë: "Ai është Sunduesi, i Shenjti, *Selami* ..." (Hasher, 23).

Nuk thuhet "Selami qoftë për ty, o Zot!", për arsyet e mëposhtme:

E para, një lutje e tillë të jep përshtypjen e mangësisë së Allahut, pra, të lutësh Allahun që Ai të shpëtojë Vetveten. Lutja me selam (shpëtim) bëhet vetëm për atë që e meriton dhe i nevojitet diçka e tillë, ndërsa Allahu është i pastër nga mangësitë.

E dyta, nëse e lut Allahun që Ai të shpëtojë Vetveten, ke kundërshtuar të vërtetën, sepse Allahut i lutemi për vetet tona dhe jo për Veten e Tij, sepse Ai nuk ka nevojë për ne. Nga ne, Ai duhet të falënderohet, duke përmendur cilësitë e përsosura të Tij, si: *Gafurr*

(Falës), *Semiun* (Dëgjues), *Alim* (i Ditur) etj.

Është e qartë lidhja e temës me teuhidin e atributeve të Allahut, të cilët janë të plotë e të përsosur, ashtu siç janë edhe emrat e Tij, më të bukurit. Dëshmi që cilësitë e Tij janë të larta e të përsosura është ajeti kuranor: "Atyre që nuk besojnë në jetën tjetër u takojnë cilësitë e shëmtuara, kurse Allahut i përkasin cilësitë më të larta ..." (Nahl, 60), si edhe: "Atij i përkasin cilësitë më të larta në qiej e në tokë ..." (Rrum, 27).

Nëse themi "Selam për Allahun!", kjo të jep përshtypjen se Allahu mund të jetë i mangët, kjo kundërshton përsosmërinë e cilësive të Tij.

Lidhja me temën pararendëse është e dukshme, sepse ajo fliste për pohimin se Allahu ka emrat me të bukur, ndërsa kjo temë pohon se cilësitë e Tij janë të pastra nga çdo e metë. Ky pohim nuk plotësohet ndryshe, veçse duke deklaruar se cilësitë e Allahut janë të përsosura, duke mohuar gjithçka që i cenon ato. Krijuesi i Madhëruar ka cilësi të përsosura, por nëse mohon që ato kanë mangësi, ato bëhen edhe më të plota.

Autori e ka pasuar temën paraardhëse me këtë, për të treguar gjithashtu se emrat e bukur dhe cilësitë e përsosura të Allahut nuk kanë asnjë të metë.

Es-Selamu është emër *pohues* dhe *mohues*. Është pohues, sepse pohon një cilësi të përsosur të Allahut, dhe është *mohues* sepse mohon çdo të metë që mund të parafytyrojë mendja.

> Sipas një hadithi të saktë, Ibn Mesudi rrëfen: "Kishte ndodhur që gjatë namazeve me Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) të thonim: "***Es-selamu alall-llahi*** **(Selami qoftë për Allahun) prej robërve të Tij, selami qoftë për filanin dhe filanin!" Për këtë arsye, Profeti *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* na tha: *"Mos thoni: "Selami qoftë për Allahun!" sepse Allahu është es-Selamu (Paqedhënësi)***"[1]

– *"... Kishte ndodhur që gjatë namazeve me Profetin (*sal-lAllahu

[1] Buhariu dhe Muslimi.

‘alejhi ue sel-lem*)* …” – Namazet e falura bashkë me Profetin (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kanë qenë në shumicën e rasteve namaze farze, sepse ato janë që falen me xhemat, ndërsa në namazet nafile me xhemat janë të rrallë, siç është, për shembull, namazi për kërkimin e shiut.

– *“…**Es-selamu alall-llahi*** **(Selami qoftë për Allahun)** *prej robërve të Tij …”* – Kjo do të thotë që ata kërkonin shpëtim për Allahun nga çdo e keqe; i kërkonin Allahut që të shpëtonte Veten e Tij nga të këqijat.

“*Es-Selamu alejkum*”, është lutje që përmban dy kuptime: 1. “Për ty qofshin mirësitë e Tij, me emrin e Tij!”; 2. “Shpëtimi nga Allahu qoftë për ty!”

– *“… selami qoftë për filanin dhe filanin! …”*– Pra, për Xhibrilin dhe Mikailin. Në një përcjellje tjetër thuhet: “Selami qoftë për Xhibrilin dhe Mikailin!”[1].

Ndalimi që bëri Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) për shprehjen: “***Es-selamu alall-llahi*** **(Selami qoftë për Allahun)**”, tregon se ajo është haram. Allahu nuk ka nevojë për selam (paqe), pasi Ai vetë (Subhanehu ue Te‘Ala) është *Selam* (Paqedhënësi), i Pastri nga të metat dhe mangësitë. Ndërsa urimi për melekët nuk u ndalua. Njëherë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i përcolli Aishes se Xhibrili e kishte përshëndetur atë me selam, dhe ajo ia ktheu: “Edhe për të qoftë selami!.”[2]

Dobitë e temës

- Kuptimi i fjalës “*Selam*”.

Si emër i Allahut, domethënia e saj është: i Pastri nga të metat dhe mangësitë. Ndërsa si përshëndetje, ka dy kuptime: “Për ty

[1] Buhariu.
[2] Buhariu dhe Muslimi.

qofshin mirësitë e Tij, me emrin e Tij!"; 2. "Shpëtimi nga Allahu qoftë për ty!"

- Selami është edhe përshëndetje.

- Nuk duhet të thuhet: "***Es-selamu alall-llahi* (Selami qoftë për Allahun)**".

Kjo do të thotë se ajo është haram.

- Arsyeja se pse nuk vlen të thuhet: "***Es-selamu alall-llahi* (Selami qoftë për Allahun)**".

Ajo është se vetë Allahu është Selam.

- Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) u mësoi përshëndetjen që vlen për Allahun (Subhanehu ue Te'Ala).

Kjo del nga vijimi i hadithit: "... kur të falni namaz, thoni: '*Et-tehijatu li-lahi* ...".

Nga kjo përfitojmë gjithashtu prej stilit didaktik të Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Kështu, së pari, ai tregoi arsyen e ndalesës, dhe kjo përmban disa urtësi, si:

- njeriu e pranon më qetë gjykimin, kur ai shoqërohet me arsyen e tij;

- nxjerrja në pah e pozitës së lartë të Sheriatit, duke treguar se urdhrat dhe ndalesat e tij kanë urtësi, sepse vetë arsyeja është urtësi;

- arsyetimin e një gjykimi mund ta bësh duke krahasuar dy çështje të ngjashme.

Së dyti, pasi i ndaloi nga një shprehje, u mësoi atyre atë që ishte e lejuar. Për këtë metodë ka dëshmi të shumta nga Kurani dhe Suneti, për të cilat kemi folur më herët.

- Nuk lejohet pohimi i haramit, siç tha Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Mos thoni: "***Es-selamu alall-llahi* (Selami qoftë për Allahun)**" Kjo është detyrë e çdo muslimani. Edhe për

dijetarët është detyrë të sqarojnë çështjet e fesë, me qëllim që njerëzit të mos vazhdojnë në harame, duke i menduar si të lejuara. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Kujtoje (o Muhamed) kohën kur Allahu mori premtimin nga ata që u është dhënë Libri, se do t'ua shpjegonin atë njerëzve dhe nuk do të fshihnin asgjë nga ai ..." (Ali Imran, 187).

Tema 53

Lutja: "O Allah, më fal mua, nëse dëshiron!"

Autori (Allahu e mëshiroftë!) e ka renditur këtë temë në këtë libër, për shkak se hadithi që ai sjell përshkruan pushtetin absolut, bujarinë dhe mirësinë e pakufishme të Allahut.

– *"O Allah, më fal mua …"* – Fjala arabe "*el magfiretu*" (falje) do të thotë: mbulim i mëkateve, duke mos i marrë parasysh. Kjo fjalë vjen nga "*el magfer*", që është një lloj helmete, e cila shërben për t'u mbrojtur nga shigjetat në luftë. Këtë e dëshmon edhe fjala e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) drejtuar robit të Tij besimtar (sipas një hadithi kudsij) kur të jetë vetëm për vetëm me të Ditën e Kijametit, dhe kur do ta bëjë atë që t'i pohojë mëkatet e tij: "Unë t'i mbulova ato në dynja dhe Unë po t'i fal ato sot."[1]

– *"… nëse dëshiron!"* – Kjo do të thotë: nëse dëshiron të më falësh, më fal, e nëse dëshiron, mos më fal.

> Sipas një hadithi të saktë, përcjellë nga Ebu Hurejre, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Të mos thotë asnjëri: 'O Allah, më fal, nëse dëshiron! O Allah, më mëshiro mua, nëse dëshiron!' Jini të vendosur në kërkesë, sepse Allahun s'ka kush ta detyrojë." (Buhariu). Ndërsa në variantin e Muslimit, thuhet: "Kërkoni pa u

[1] Buhariu, Muslimi.

> kursyer, sepse për Allahun nuk është e madhe asgjë që jep."[1]

Në fjalinë e parë, shprehja "*më fal mua …*" është lutje për të shpëtuar nga e urryera, ndërsa në të dytën, "*më mëshiro mua …*" është lutje për të arritur tek e dëshiruara. Atëherë, kjo lutje është për të shpëtuar nga gjithçka që është e urryer dhe për të arritur gjithçka që është e dëshiruar.

– "*… Jini të vendosur në kërkesë …*" – Pra, nuk duhet të kesh mëdyshje në kërkesë, duke thënë "nëse dëshiron".

– "*… sepse Allahun s'ka kush ta detyrojë. …*" – Kjo shërben si arsyetim i ndalesës së mësipërme. Pra, askush nuk mund ta detyrojë Allahun të mos bëjë çka Ai dëshiron, apo ta detyrojë të bëjë çka Ai nuk e dëshiron, sepse i gjithë pushteti i përket Allahut të Vetëm.

Ky ndalim ka tri arsye:

1- Në atë mënyrë, njeriu ndjen se dikush e detyron Allahu për veprimin e diçkaje dhe se dikush mund ta pengojë Atë. Pra, lutësi me këtë formë duket sikur thotë: "Unë nuk të detyroj Ty: nëse dëshiron, më fal, e nëse jo, mos më fal!"

2- Kur thuhet: "nëse dëshiron", ngjan sikur njeriu e sheh si të vështirë për Allahun, prandaj Ai ndoshta nuk e dëshiron. Kjo është si t'i thuash dikujt, - shembulli që po sjellim është për të treguar formën dhe jo realitetin -: "Më jep një milion lekë, nëse dëshiron." Ti shprehesh kështu, pasi ndoshta është e vështirë ose e papërballueshme për të që të realizojë kërkesën tënde, kësisoj ti i thua: "… nëse dëshiron", për t'ia lehtësuar disi. Ndërkaq, Allahu i Madhëruar nuk ka nevojë t'i thuash "nëse dëshiron", sepse asgjë që Ai jep, nuk është e vështirë për Të. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sellem) ka thënë: "Kërkoni pa u kuryer, sepse për Allahun nuk është e madhe asgjë që jep". Pra, kërkoni çfarë të doni, qoftë e vogël apo e madhe, pa menduar se: kaq është shumë, prandaj nuk ia kërkoj Allahut. Allahu i Madhëruar do t'i ringjallë krijesat − dhe kjo është e

[1] Buhariu dheMuslimi.

jashtëzakonshme − me një fjalë të vetme, por që për Allahun është e lehtë Allahu thotë: "Thuaj (o Muhamed): 'Po, për Zotin tim, me siguri që do të ringjalleni e pastaj do të njoftoheni për atë ç'keni bërë!' Dhe kjo është e lehtë për Allahun." (Tegabun, 7). Pra, për Të çdo gjë që ua jep krijesave nuk është e madhe.

3- Duket sikur ai që lutet është i panevojshëm për Allahun; është njësoj si të thotë: nëse dëshiron, bëje, e nëse nuk dëshiron, mos e bëj, nuk më intereson shumë. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Kërkoni pa u kursyer...". Pra, kërkoni ç'të doni, pa ngurrim, ndërsa varësia e kërkesës nga dëshira e mohon këtë, sepse ajo tregon që nuk është e domosdoshme ajo që kërkohet. Njeriu duhet të lutet duke ndjerë nevojën e madhe të tij për Allahun, duke e ditur se Allahu është i Plotpushtetshëm për t'i plotësuar çdo kërkesë dhe se asgjë nuk është e vështirë për Të, përkundrazi gjithçka është e lehtë.

Kështu një normë e lutjes është që të mos përdoren të tilla shprehje, por kërkesa të bëhet në formë të prerë: "O Allah, më fal! O Allah, më mëshiro! O Allah, më jep sukses!" e të ngjashme.

Po përgjigjja e lutjes a është e sigurt? Në aspektin e pushtetit dhe mundësisë së Allahut ajo është tërësisht e sigurt, sepse Allahu është i Plotpushtetshëm. Ai thotë: "Lutmuni Mua, se do t'ju përgjigjem ..." (Gafir, 60).

Ndërsa në aspektin e lutësit, duhet të merren parasysh pengesat që ai mund të ketë ose shkaqet që nuk realizohen. Në këtë rast, mund të kesh mëdyshje për përgjigjen e lutjes, megjithatë, gjithmonë duhet të kesh mendim të mirë për Allahun. Ai thotë: "Lutmuni Mua, se do t'ju përgjigjem ...". Ai i Cili të mundësoi që t'i lutesh Atij, do të të begatojë me përgjigjen e saj, sidomos kur i ke përmbushur shkaqet e përgjigjes dhe i ke shmangur pengesat.

Ndër pengesat që çojnë në mospërgjigjen e lutjes janë: tejkalimi i kufijve në lutje, si për shembull, të lutesh për një haram, të lutesh për ndërprerjen e lidhjeve farefisnore, ose të lutesh për diçka të pamundur në fe ose në praktikë. Diçka e pamundur në fe është, për shembull, lutja: "O Allah, më bëj mua Profet!". Ndërsa në praktikë është, për shembull, lutja që Allahu i Madhëruar të bashkojë dy gjëra të kundërta. Kjo gjë është e pamundur.

Kalimi i kufijve në lutje është një pengesë për përgjigjen dhe është

i ndaluar, sipas fjalës së Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "Lutjuni Zotit tuaj përulshëm dhe ngadalë! Vërtet Ai nuk i do ata që e kalojnë kufirin." (Araf, 55). Lutje të tilla ngjajnë më tepër si tallje me Allahun e Madhëruar.

Kjo çështje lidhet me teuhidin në dy aspekte:

1. Në atë të rrububijes (veprave të Zotit). Kush përdor shprehje që të bën të ndjesh se është dikush që e detyron Allahun, ai nuk e ka të plotë besimin për veprat e Allahut të Madhëruar. Tregues i pastërtisë së këtij besimi është bindja se Ai nuk ka ndonjë që e detyron, madje Ai nuk pyetet për çka vepron: "Ai nuk pyetet për çfarë vepron, kurse ata (njerëzit) do të pyeten." (Enbija, 23). Kjo është mangësi edhe në një kuptim tjetër: besohet se nga gjërat që jep Allahu, ka disa që janë të mëdha për Të. Kështu cenohet bujaria e Tij.

2. Nga ana e robit, sepse shprehje të tilla në lutje tregojnë se robi ndihet i panevojshëm për Zotin e tij. Kjo është një mangësi e madhe në teuhid, qoftë në aspektin e adhurimit të njeriut, qoftë në rrububije (veprat e Allahut), qoftë në aspektin e emrave dhe cilësive të Tij, që zbulon gjithashtu arsyen pse autori e ka lidhur këtë çështje me temën e emrave dhe cilësive të Allahut.

Po për lutjen e *istihare*-s: "O Allah, me dijen Tënde kërkoj zgjedhjen Tënde. Kërkoj prej Teje ta lehtësosh për mua atë dhe kërkoj prej mirësisë Tënde, sepse Ti ke fuqi, e unë nuk kam fuqi. Ti e di, e unë nuk di. Ti je Njohësi i të fshehtave. O Allah, nëse e di se kjo çështje është e mirë për fenë time, jetën time dhe fundin e çështjes sime, atëherë ma cakto atë, ma lehtëso, e më pas më jep begati në të! E nëse e di që kjo çështje është e keqe për fenë time, jetën time dhe fundin e çështjes sime, atëherë largoje prej meje, më largo mua prej saj, më cakto mirësinë kudo që të jetë, e më pas më bëj të kënaqur me të!"?[1]

Po për lutjen tjetër të njohur: "O Allah, më jep jetë, nëse jeta është e dobishme për mua, dhe ma merr shpirtin, nëse vdekja është më e dobishme për mua!"?[2] Çfarë mund të thuhet për këto dy lutje?

Përgjigje: Në to nuk ka ndonjë lidhje të kërkesës me dëshirën, pra, nuk thuhet: "Ma cakto atë, nëse dëshiron". Ne nuk e dimë nëse

[1] Buhariu.
[2] Buhariu.

një çështje, para se ta kryejmë atë, është e mirë apo e keqe për ne, ndërsa Allahu e di. Ne themi: "O Allah, nëse e di se kjo çështje është e mirë për mua, ma cakto atë!" Kjo do të thotë t'ia lësh Allahut në dorë që të zgjedhë, sepse Ai e di, kurse ne nuk e dimë a është e mirë apo jo.

I njëjti arsyetim vlen edhe për hadithin tjetër: njeriu nuk e di nëse jeta e tij është për mirë apo për keq. Prandaj, disa dijetarë e quajnë të urryer ta urosh dikë: "Allahu të dhëntë jetë të gjatë!" Jeta e gjatë mund të jetë për mirë, por mundet të jetë edhe për keq, prandaj urimi bëhet: "Allahu të dhëntë jetë të gjatë në bindje të Tij!".

Përfundimisht, nuk ka mospërputhje ndërmjet hadithit të temës dhe dy hadithe të lartpërmendur, ku lutja është e prerë dhe jo e lidhur me dëshirën. Ndalesa është për lutjet që lidhen me dëshirën.

Dobitë e temës

- Ndalimi i vënies së një kushti në lutje.
- Sqarimi i arsyeve të kësaj ndalese.

Më parë u përmendën tri arsye: 1) Të bën të ndjesh se ka dikush që e detyron Allahu, mirëpo nuk është kështu. 2) Ngjan sikur njeriu e sheh si të vështirë për Allahun, e ndoshta është e rëndë për Të dhe e pa mundur për t'u realizuar, mirëpo nuk është kështu. 3) Duket sikur ai që lutet është i panevojshëm për Allahun, gjë që nuk është e përshtatshme dhe nuk është prej edukatës.

- **Në lutje duhet të jesh i vendosur për atë çfarë kërkon, pa mëdyshje**.
- Moskursimi në lutje.

Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) thotë: "Kërkoni pa u

kursyer ...", pra kërkoni ç'të doni, se nuk ka gjë të vështirë e të pamundur për Allahun (Subhanehu ue Te'Ala).

- Arsyeja pse të jemi të pakursyer në lutje.

Pejgamberi tregon arsyet: "... sepse për Allahun nuk është e madhe asgjë që jep..." ose: "... sepse Allahun s'ka kush ta detyrojë."

Këtu shfaqet mënyra e bukur e mësimdhënies së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i cili tregonte arsyet e çështjeve. Kjo ka disa funksione të rëndësishme:

Së pari, nxirret në pah pozita e lartë e kësaj feje, duke treguar se çdo gjykim i saj ka një arsye dhe një urtësi të caktuar.

Së dyti, kur njeriu e kupton arsyen, i shtohet qetësia. Njëherë, Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) u pyet për shitjen e hurmave të buta me të thata, dhe në përgjigjen e tij nuk tha është hallall apo haram, por pyeti: "A pakësohen ato kur thahen?" – "Po." – i thanë. Atëherë, ai u tha se është e ndaluar[1]. Gjithashtu, në një rast tjetër, kur një burrë i tha se e shoqja kishte lindur një fëmijë të zi, Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk i tha që fëmija ishte i tij, por e pyeti: "A ke deve?" – "Po." – iu përgjigj ai. E pyeti përsëri: "Çfarë ngjyre kanë ato?" – "Të kuqe." – tha. E pyeti përsëri: "A ka ndërmjet tyre të murrme?" – "Po." – u përgjigj sërish burri. – "Si ka mundësi?" e pyeti Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Ai i tha: "Mund të kenë marrë ngjyrën e ndonjë paraardhësi." Atëherë i tha: "Edhe yt bir mund të ketë marrë ngjyrën e ndonjë paraardhësi të tij."[2] Shoqërimi i gjykimit me arsyen e tij sjell paqëtim, bën që ta duash Sheriatin dhe të kesh dëshirë të punosh me të.

Së treti, rasteve analoge ligjërisht u jepet i njëjti gjykim.

[1] Ahmedi dhe Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.
[2] Buhariu.

Tema 54

Nuk thuhet “robi im” dhe “robëresha ime”.

Ky titull tregon se një shprehje e tillë është e urryer ose e ndaluar. Dijetarët kanë mendime të ndryshme për këtë çështje, të cilën do ta shtjellojmë më poshtë.

> Sipas një hadithi të saktë, përcjellë nga Ebu Hurejre, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Askush të mos thotë: “Çoji ushqim dhe jepi ujë për abdest zotërisë tënd!” Thoni: ‘i nderuari im’ ose ‘pronari im’. Askush të mos thotë: ‘robi im’, ‘robëresha ime’, por thoni: ‘djali im’, ‘vajza ime’, ‘shërbëtori im’.”[1]

Pra, njeriu nuk duhet të thotë: “robi im” për skllavin e tij dhe “robëresha ime” për skllaven e tij.

Ka dy raste të ndryshme, të cilat kanë gjykim të veçantë:

1- Ta thuash këtë për dikë tjetër, jo për veten tënde. Kjo është e lejuar. Allahu i Madhëruar thotë: “I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju, si dhe skllevërit dhe skllavet tuaja që janë besimtarë të ndershëm ...” (Nur. 32). Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) gjithashtu thotë: “Nuk është detyrë për muslimanin të japë zekat për robin e tij dhe kalin e tij.”[2]

2- Ta thuash për veten tënde. Kjo mund të bëhet në dy mënyra:

a) Thjesht si kumt, për shembull: “i dhashë bukë robit tim”,

[1] Buhariu dhe Muslimi.
[2] Buhariu dhe Muslimi.

ose: "e vesha robin tim", ose "ia fala lirinë robit tim" etj. Nëse e thua këtë kur robi ose robëresha nuk janë të pranishëm, nuk ka ndonjë gjë të keqe, po nëse ata janë të pranishëm, e kjo dëmton robin ose zotërinë, atëherë ndalohet, e nëse jo, nuk ndalohet, sepse nuk është për qëllim të theksohet nënshtrimi, por pronësia e skllavit.

b) Në formë thirrjeje, si për shembull, kur zotëriu thotë: "O robi im …" ose "O robinja ime, ma sill pak atë". Kjo është e ndaluar.

Dijetarët kanë mendime të ndryshme për formën e ndalesës: a është e urryer apo haram. Kjo ka nevojë për shtjellim. Më e pakta është të thuhet që të tilla forma janë të urryera.

– *"… Çoji ushqim dhe jepi ujë për abdest zotërisë tënd!"* – Pra, të mos ia thuash këto fjalë robit të dikujt tjetër. Këtu mund të përfshihet edhe vetë pronari kur i drejtohet me fjalë të tilla skllavit të vet, për të treguar madhështi.

Dije se fjala "zot" ka disa përdorime, kur tregon për dikë tjetër veç Allahut:

1- I shoqëruar me përemër pronor të vetës së dytë, si: 'Çoji ushqim zotërisë tënd!", ose: "jepi ujë për avdes zotërisë tënd!" etj. Kjo është e urryer për dy arsye:

E para, nga ana formale, ajo mund të çojë në keqkuptimin e fjalës "Zot", me të cilin thirret Allahu i Madhëruar, pasi Ai ushqen dhe nuk ushqehet, edhe pse në shprehjet e mësipërme, fjala "zotëri" nuk nënkupton Zotin e botëve, i Cili ushqen dhe nuk ushqehet, por problemi këtu qëndron në etikën e të folurit.

E dyta, nga ana kuptimore, robi ose robëresha mund të ndihen të poshtëruar, sepse kur pronari është zot, atëherë robi ose robëresha janë nën zotërim.

2- I shoqëruar me përemër pronor të vetës së tretë, siç është hadithi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), që flet për shenjat e Kijametit: "… robëresha do të lindë zotërinë e saj …"[1] ose hadithi që flet për mallin e humbur, te Buhariu dhe Muslimi: "… derisa ta gjejë atë i zoti i saj." Disa dijetarë kanë thënë se në këtë hadith, malli i humbur janë kafshët. Ato nuk adhurojnë dhe nuk tregojnë përulshmëri ndaj Zotit të tyre, pra nuk janë si njeriu. Por e vërteta është se nuk ka dallim, sepse edhe kafshët e adhurojnë Allahun me

[1] Buhariu dhe Muslimi.

një mënyrë të posaçme për to. Allahu i Madhëruar thotë: "A nuk e sheh ti se, në të vërtetë, Allahut i përulen në sexhde ata që gjenden në qiej dhe në tokë: edhe Dielli, edhe Hëna, edhe yjet, edhe malet, edhe drurët, edhe kafshët ...". Ndërsa për njerëzit thotë: "... dhe shumë nga njerëzit? ...", pra, jo të gjithë ata: "... Por ka shumë njerëz që meritojnë dënimin." (Haxh, 18).

Përfundimisht, lejohet të thuash: "Robi i çoi ushqim zotëriut të tij", e kështu me radhë.

3- I shoqëruar me përemër pronor të vetës së parë, si për shembull: "Ky është zotëriu im". A është e lejuar kjo? Ndoshta dikush thotë se kjo është e lejuar, meqë thuhet nga vetë robi për zotërinë e tij. Allahu i Madhëruar tregon se ç'thoshte Jusufi (alejhi selam) për pronarin e tij "... ai, zotëriu im, ka treguar kujdes për mua." (Jusuf, 23). "Zotëriu im" do të thotë: "pronari im". Shprehje të tilla janë të urryera sepse poshtërohet robi, mirëpo në rastin konkret kjo nuk ekziston, pasi është vetë robi që thotë: "Ky është zotëriu im".

4- Kur pronari përcakohet me emër, jo përemër, për shembull: "Ky është zotëriu i djaloshit". Me sa duket nga hadithi, kjo lejohet. Dhe kështu është, përderisa nuk ka diçka që ta ndalojë, siç ndodhte me rastet e tjera.

– *"... Thoni: 'i nderuari im' ose 'pronari im'...."* – Pritej që Pejgamberi 'alejhis–selam të përmendte përemrin pronor të vetës së dytë njësoj si në fjalinë e parë, në të cilën ndalimi është në vetën e dytë, por në fakt Pejgamberi 'alejhis–selam rekomandimin e ka bërë duke përmendur përemrin pronor të vetës së parë, gjë prej të cilës autori ka kuptuar – siç do ta shohim te dobitë e temës – se kjo tregon që, kur dikush tjetër ndalohet t'i thotë robit: "Çoji ushqim zotërisë tënd!", atëherë vetë robi e ka më të fortë ndalesën të përdorë shprehje si: "I çova ushqim zotërisë tim", por duhet të thotë: "... pronarit tim"ose "... të nderuarit tim".

Dikush mund të thotë se ndalesa për shprehjen: "Çoji ushqim zotërisë tënd!" vlen vetëm për atë që i drejtohet robit. Shkaku është se kjo formë e poshtëron robin, ndryshe kur ai vetë thotë: "I çova ushqim zotërisë tim", ku nuk ka poshtërim. Por ne përgjigjemi se Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), së pari, mësoi të tjerët se

si t'u drejtohen robërve, pastaj iu drejtua vetë robërve, duke i mësuar: "Thoni: 'i nderuari im' ose 'pronari im'" në vend të: "zotëria im".

– "... *'i nderuari im'* ..." – Fjala "*es sejid*", në gjuhën arabe, ka si kuptim të parë: "gradë e lartë, e cila vjen nga fama, nderi, pushteti e të ngjashme". Por ajo përdoret me disa kuptime, si: mbret, bashkëshort, fisnik, i nderuar, zotëri, padron, madhëri etj.

Ndërsa "*sejid'i*" (pronari im) përcaktohet me një përemër pronor. Si e tillë, ajo është edhe e kufizuar.

Es Sejid, në formë të pakufizuar, i thuhet vetëm Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "*Es Sejid* (Madhëri) është Allahu."[1] Kur fjala *sejid* është e përcaktuar, atëherë ajo mund të tregojë edhe dikë tjetër veç Allahut. Allahu thotë: "...Te dera, ata hasën *sejideha* (burrin e saj)." (Jusuf, 25). Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Unë do të jem *sejid*-i (zotëriu, më i nderuari) i bijve të Ademit në Ditën e Kijametit."[2]

Vërejtje:

Disa njerëz përdorin dendur formën femërore "*es sejidetu*" ('zonjë', ose 'e nderuar'), duke bërë ndarjen: "kjo për burra, ndërsa kjo tjetra për gratë". Por ky është tjetërsim koncepti, sepse *sejid* mund të jenë vetëm burrat. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "...Te dera, ata hasën *sejideha* (burrin e saj)." (Jusuf, 25); ose: "Burrat janë kujdestarë për gratë dhe kanë autoritet mbi to ..." (Nisa, 34). Ndërsa Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Gratë janë robëresha tek ju."[3], që do të thotë se ato janë në rangun e robinjës[4]. Ndërsa për burrin ka thënë: "Ai është kujdestar në familjen e tij dhe do të pyetet për atë që ka nën kujdestarinë e

[1] Ahmedi, Buhariu në "Edeb el mufred". Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.
[2] Ahmedi, Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.
[3] Ahmedi, Tirmidhiu, Ibn Maxhja, Nesaiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.
[4] Pejgamberi ('alejhis–selam) e ka krahasuar gruan me robinjën, meqë pas martese ajo i shërben burrit, i bindet atij dhe është nën gjykimin e tij, por jo se në të vërtetë ajo është robinjë në dorë të burrit.

tij."[1] E drejta është që të përdoren format thirrëse: "grua" ose "gra".

– *"... 'pronari im' ..."* – Në hadith përdoret fjala arabe "*meulai*"-pronar, (kujdestar, mbrojtës, ndihmues, drejtues, kontrollues, administrues).

Koncepti "*el uilaje*" (mbrojtje, kujdestari, drejtim, kontroll etj.) ka dy kuptime:

1- *Uilaje* e pakufizuar, të cilën e ka vetëm Allahu dhe askush tjetër. *Uilaje* e Allahut është dy llojesh:

a) E përgjithshme, e cila i përfshin të gjithë krijesat. Allahu thotë: "Pastaj ata kthehen tek Allahu, *Meula* i tyre. Vetëm i Tij është gjykimi dhe Ai është më i shpejti në llogari." (En'am, 62). Pra kjo *uilaje* e Zotit i përfshin edhe shpifësit, për të cilët flet ajeti.

b) E posaçme për besimtarët. Allahu thotë: "… Kjo, për shkak se Allahu është *Meula* i atyre që besojnë, kurse për mosbesimtarët nuk ka asnjë *Meula*." (Muhamed, 11). Ajeti ka kuptimin se Allahu nuk është *Meula* për qafirët e as për miqtë e tyre. "Zotat" e tyre nuk kanë për t'i ndihmuar kurrë ata, sidomos Ditën e Kijametit, kur ata "zota" do të distancohen prej adhuruesve të tyre.

2- *Uilaje* e kufizuar, e përcaktuar. Këtë mund ta ketë edhe dikush tjetër veç Allahut. Kjo ka kuptime të shumta gjuhësore, si: ndihmues, drejtues çështjesh, përgjegjës apo ish-pronar skllavi. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "… Nëse ju të dyja bashkoheni kundër tij (Muhamedit), (dijeni se) Allahu është *Meula* i tij, Xhibrili dhe besimtarët e mirë. Veç tyre, edhe engjëjt janë *meula* të tij." (Tahrim, 4). Ndërsa Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Atë që e dua unë, e do edhe Aliu, ose: "Nëse dikush bëhet *meula* për mua, për atë do të bëhet *meula* Aliu."[2] Ai (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë gjithashtu: "'Të drejtën për të trashëguar ish-skllavin (*el uilaje*) e ka ai që e ka liruar nga skllavëria."[3] Prijësit të muslimanëve mund t'i thuhet "*uelijul emri*", ndërsa ai që ka liruar një skllav quhet *meula* i ish-skllavit.

Përfundimisht, nuk ka arsye për të kundërshtuar formën e adresimit ndaj ndonjë mbreti: "*Meula*-i", sepse ajo nënkupton

[1] Buhariu.
[2] Ahmedi, Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.
[3] Buhariu Muslimi.

"Drejtuesi im". Nuk ka dyshim se prijësi i vendit është drejtuesi i punëve të atij vendi, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut, bindjuni Profetit (Muhamedit) dhe atyre që drejtojnë punët tuaja..." (Nisa, 59).

– *"... Askush të mos thotë: 'robi im', 'robëresha ime'..."* – Kjo u drejtohet pronarëve, që ata të mos thonë "*robi im*" dhe "*robëresha ime*", sepse ne të gjithë jemi robër të Allahut dhe gratë tona janë robëreshat e Allahut. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Mos i ndaloni robëreshat e Allahut nga xhamitë e Allahut."[1]

Pronarët e kanë të ndaluar të shprehen kështu, sepse krahasohen me Allahun e Madhëruar, qoftë edhe vetëm nga kuptimi sipërfaqësor i fjalës, sepse Allahu i Madhëruar i drejtohet njeriut: "Robi Im", siç thuhet në hadithin: "Robi Im, të kërkova ty të më ushqesh dhe nuk më ushqeve...",[2] etj. Edhe pse me këtë shprehje pronari ka për qëllim vetëm pronësinë mbi skllavin, ndalesa është për t'u ruajtur nga çdo formë përngjasimi me Allahun. Kështu mbrohet teuhidi dhe largohemi nga shirku, deri edhe në shprehje.

Disa dijetarë, ndër të cilët edhe Abdurrahman Es Sadi (Allahu e mëshiroftë!), mendojnë se ndalimi në hadith nuk është i formës së prerë, por tregon se cila është gjëja më e mirë për t'u bërë. Gjykimi i kësaj çështjeje u shpjegua më lart, në mënyrë të detajuar.

– *"... por thoni: 'djali im', 'vajza ime', 'shërbëtori im'."* – Këto janë forma të lejuara.

Dobitë e hadithit

- Mënyra e bukur e mësimdhënies së Profetit (salallahu alejhi ue selem), pasi i ndaloi, duke u thënë: "Askush nga ju të mos thotë: 'robi im', 'robëresha ime', i orientoi për te e lejuara me fjalën: "por le të thotë: 'djali im', 'vajza ime', 'shërbëtori im'." Gjithashtu kjo është edhe mënyra që Allahu përdor në Kuran. Allahu (subhanehu ue

[1] Buhariu Muslimi.

[2] Trasmeton Muslimi. Fjalën "Robi Im, të kërkova ty të më ushqesh dhe nuk më ushqeve, të kërkova të më japësh të pi po nuk më dhe...", Allahu e ka sqaruar më pas me fjalën e Tij: "Robi Im filani u urit ndërsa ti nuk e ushqeve, të kërkoj të pijë ndërsa ti nuk i dhe të pijë".

teala) ka thënë: "O besimtarë! Mos thoni "Ra'ina" (na shiko me kujdes që të kuptojmë), por thoni "Undhurna!" (Na shiko!)[1] Dhe dëgjoni! Për mohuesit ka dënim të dhimbshëm." (Bekare, 104). Kështu duhet të veprojnë dijetarët dhe thirrësit. Kur ata u mbyllin njerëzve një portë të ndaluar, le t'u hapin atyre një tjetër të lejuar, me qëllim që të mos ua zënë rrugët para tyre. Kjo mënyrë sjell dy dobi të mëdha:

E para, ua lehtëson njerëzve braktisjen e së ndaluarës, pasi njeriu nuk e ka të vështirë ta lërë të ndaluarën kur e di se mund ta zëvendësojë atë me diçka tjetër.

E dyta, del në pah përsosmëria e fesë islame dhe gjithëpërfshirja e saj , pasi çdo gjë për të cilën kanë nevojë njerëzit, gjendet e përfshirë në këtë fe. Prandaj, njerëzve nuk u ndalohet ndonjë fjalë apo veprim, vetëm se duke u treguar atyre çka është e lejuar. Kjo, pa dyshim është nga përsosmëria e kësaj feje.

- Urdhri në hadith vjen për lejim: "... Thoni: 'i nderuari im' ose 'pronari im'." Dijetarët kanë thënë se kur përmendet urdhri pas një ndalimi, atëherë ai tregon lejim. Në rastin tonë, urdhri ka ardhur pas ndalimit. Njëlloj si kjo, është fjala e Allahut: "Pas heqjes së *ihram*-it, gjuani ..." (Ali Imran, 2).

Dobitë e temës

- Ndalimi i shprehjeve "robi im" dhe "robëresha ime".
- Robi nuk duhet të thotë: "zotëriu im", e as nuk duhet t'i thuhet atij: "Jepi ushqim zotërisë tënd".
- Mësimi i pronarit të shprehet me fjalët: "djali im", "vajza ime", "shërbëtori im".

[1] "*Ra'ina*" dhe "*Undhurna*" janë dy fjalë që në arabisht kanë kuptim të njëjtë, por në hebraishten-arabe të shekullit të shtatë fjala "*Raina*" ishte sharje me kuptimin "O i keqi ynë". Kjo qe arsyeja që u ndalua përdorimi i fjalës së parë.

- Mësimi i skllavit të shprehet me fjalët: “pronari im”.

- Rrëfimi se cili është qëllimi i vërtetë i këtyre normave: pastërtia e teuhidit, qoftë edhe në të shprehur.

Kjo temë ka edhe dobi të tjera, por këto ishin ato më kryesoret.

Tema 55

Nuk refuzohet ai që kërkon diçka në emër të Allahut.

– *"Nuk refuzohet ..."* – Kjo tregon se e kundërta mund të jetë e urryer ose haram.

– *"... ai që kërkon diçka në emër të Allahut ..."* – Ka dy mënyra kërkesash në emër të Allahut:

1- Kërkesa në emër të Allahut, e shprehur qartë me fjalë, si në hadithin e provimit të tre personave, kur meleku tha: "Të lutem ty, në emër të Atij që të ka dhënë ngjyrë të bukur, lëkurë të mirë ..."[1].

2- Kërkimi i diçkaje që e ke të drejtë nga Sheriati, si, për shembull, i varfri kur kërkon nga zekati, kur kërkon të mësosh një çështje të caktuar të fesë, etj.

A është i urryer apo haram refuzimi i një kërkese të tillë, kjo varet nga gjendja e refuzuesit dhe kërkuesit.

Lind pyetja: a lejohet që njeriu të kërkojë në emër të Allahut apo jo?

T'i kërkosh diçka tjetrit është në vetvete e urryer. Njeriu nuk duhet t'i kërkojë askujt ndonjë gjë, përveç rastit kur e ka të domosdoshme. Një nga premtimet që Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) u mori shokëve të tij, ishte se nuk do t'u kërkonin asgjë njerëzve, aq sa kur ndonjërit i binte shkopi duke qenë hipur mbi kafshë, nuk i thoshte askujt që t'ia jepte, por zbriste dhe e merrte vetë.[2]

---

[1] Ky hadithi është përmendur më parë.

[2] Muslimi.

Qëllimi është se kështu e nderon veten tënde. Duke mos u kërkuar njerëzve, mbetesh i nderuar tek ata dhe ke ngritur një fortesë ndaj poshtërimit. Kur e përul veten ndaj dikujt, duke i kërkuar diçka, ndoshta atij i duhet vetë ajo gjë dhe nuk dëshiron që ta japë, mirëpo nëse ia kërkon, ai është i detyruar që të përgjigjet. Për këtë arsye, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Tregohu i panevojshëm për atë që kanë njerëzit, që ata të të duan ty.”[1] Pra, të kërkosh, parimisht, është e urryer ose haram, përveç rastit kur është e domosdoshme.

Të kërkosh pasuri është e ndaluar, përveçse kur je i shtrënguar nga rrethanat. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Njeriu që kërkon e u kërkon njerëzve, do të vijë Ditën e Kijametit pa asnjë copë mishi në fytyrë.”[2] Kjo tregon se vepra është haram. Ndërsa të kërkosh ndihmë me pozitën e dikujt ose ndihmë fizike me trup, është e urryer.

Kërkimi i diçkaje mund të bëhet veç në njërën prej këtyre dy mënyrave:

1. Thjesht duke e kërkuar, si për shembull: “Të lutem, ma jep mua këtë!” Nëse njeriu e ka të drejtë nga Sheriati, atëherë duhet t’ia japim.

2. Të kërkohet në emër të Allahut. Këtij duhet t’i përgjigjemi, edhe nëse nuk e meriton, sepse ka kërkuar në emër të Allahut të Madhëruar dhe t’i përgjigjesh atij është madhërim i Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala). Megjithatë, nëse tjetri kërkon diçka që është haram, ose po t’i përgjigjesh, dëmtohesh ti vetë, atëherë nuk duhet t’ia plotësosh kërkesën, si për shembull, të kërkojë para për të blerë alkool apo të të kërkojë që t’i tregosh se çfarë bën në fshehtësi me familjen tënde.

> Nga Ibn Omeri (r.a.) përcillet se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kujtdo që ju kërkon në emër të Allahut, jepini! Këdo që ju kërkon mbrojtje në emër të Allahut, mbrojeni! Kujtdo që ju thërret përgjigjuni! Kush ju bën një të mirë, shpërblejeni, e nëse nuk keni me çfarë

[1] Ibn Maxhja. Sipas Albanit hadithi është i mirë.
[2] Buhariu, Muslimi.

> ta shpërbleni, bëni lutje për të derisa të mendoni se e keni shpërblyer."[1]

– *"... Kujtdo që ju kërkon në emër të Allahut, jepini! ..." – Urdhri* tregon se kjo është detyrim, − përderisa kërkesa nuk është për diçka të ndaluar apo përderisa nuk dëmtohet ai që i kërkohet, − sepse kur i japim, i përgjigjemi nevojës së tij dhe madhërojmë Allahun e Madhëruar, me emrin e të Cilit bëhet kërkesa. Nuk është kusht që kërkesa të jetë vetëm me emrin e Allahut, por mund të jetë me të gjithë përshkrimet e Tij të posaçme, ashtu siç kërkoi engjëlli në ngjarjen me lebrosin, qerosin dhe të verbrin.

– *"Këdo që ju kërkon mbrojtje në emër të Allahut, mbrojeni! ..." –* Pra, kur dikush thotë: "I kërkoj Allahut të më mbrojë prej teje", atëherë, e ke detyrë ta mbrosh, sepse ai ka kërkuar mbrojtje në emër të të Madhëruarit. Kur e bija e El Xhunit i tha Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "I kërkoj Allahut të më mbrojë prej teje.", ai i tha: "Vërtet u mbrojte me të Madhëruarin – ose Atij që mbron. Shko te familja jote!"[2]

Përjashtohet rasti kur kërkohet mbrojtje për një çështje që e ka detyrë ta kryejë, si, për shembull, që të falë namazin me xhemat. Në këtë rast, nuk duhet ta mbrosh atë. Po ashtu, edhe kur e detyron dikë të heqë dorë nga një haram, ndërsa ai i kërkon mbrojtje Allahut prej teje, mos e mbro atë, pasi do të ishte bashkëpunim në mëkat e armiqësi dhe sepse Allahu nuk e mbron mëkatarin, i cili, përkundrazi, duhet të ndëshkohet e jo të mbrohet.

Ndërsa kush kërkon mbrojtje në një vend, − që Sheriati e ka përcaktuar si mbrojtës, – edhe nëse nuk thotë: "I kërkoj Allahut të më mbrojë", bëhet detyrë që ta mbrosh. Dijetarët thonë: Nëse dikush bën një krim e pastaj strehohet në Vendin e Shenjtë, mbi të nuk zbatohet dënimi e as masat e dënimit, por bojkotohet, duke mos i shitur, blerë apo dhënë me qira banesë, derisa të dalë. Ndryshe është ai që bën krim brenda në Vendin e Shenjtë. Qëndrimi në Vendin e Shenjtë nuk bëhet mbrojtje për të, sepse ai e ka cenuar

[1] Ebu Daudi dhe Nesaiu me zinxhir transmetimi të saktë. Sipas Albanit hadithi është i saktë.
[2] Buhariu.

shenjtërinë e atij vendi.

– *"... Kujtdo që ju thërret, përgjigjuni! ..."* – Nga konteksti i hadithit duket se qëllimi me thirrjen është ftesa për ta nderuar dhe jo thirrja me emër. Po kështu, nga hadithi kuptohet se pranimi i ftesës është detyrë në çdo rast; ky është edhe qëndrimi i *medhhebit dhahiri*. Megjithatë, shumica e dijetarëve janë të mendimit se është sunet, përveç ftesës për dasmë, pranimi i së cilës është i detyrueshëm, siç dëshmon thënia e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Ushqimi më i keq është ushqimi i dasmës ku ftohet ai që e refuzon atë (i pasuri) dhe pengohet ai që vjen në të (i varfri). Kush nuk i përgjigjet, ka kundërshtuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij."[1]

Sido që të themi, detyrë apo sunet, ftesa ka disa kushte:

1- Ftuesi të mos jetë nga ata që është detyrë ose e pëlqyeshme që të bojkotohet.

2- Në gosti të mos ketë harame. Nëse mund t'i largojmë haramet, prania atje bëhet dyfish e detyrueshme: sepse duhet t'i përgjigjemi ftesës dhe sepse duhet të largojmë haramet. Nëse kjo është e pamundur, atëherë pjesëmarrja është e ndaluar.

3- Ftuesi të jetë musliman. Nëse nuk është i tillë, nuk e ke detyrë ta pranosh. Këtë e dëshmon hadithi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Të drejtat e muslimanit ndaj muslimanit janë gjashtë...", dhe ndër to ka përmendur: "...kur të fton, duhet ta pranosh...".[2]

4- Të ardhurat e tij të mos jenë fituar në haram, sepse kështu vajtja atje të bën të konsumosh ushqim të ndaluar. Ky është qëndrimi i disa dijetarëve, ndërsa disa të tjerë kanë thënë se, në këtë rast, gjynahet i merr vetëm ftuesi dhe jo i ftuari, ndryshe kur ushqimet janë në vetvete haram, si: pijet alkoolike, sendet e grabitura etj. Mendimi është i fortë dhe i pranueshëm, për të cilin dëshmon fakti se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka blerë ushqim për familjen e tij nga hebrenjtë,[3] ka ngrënë mishin e deles që ia dhuroi gruaja hebreje në Hajber[4] dhe i është përgjigjur gjithashtu ftesës së një hebreu tjetër. Dihet se shumica e hebrenjve

[1] Buhariu, Muslimi.
[2] Muslimi.
[3] Buhariu.
[4] Buhariu, Muslimi.

punojnë me kamatë dhe hanë harame. Ndoshta këtë mendim e përforcon edhe fjala e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) në lidhje me mishin që iu dha sadaka Berires: “Ai për të është sadaka, ndërsa për ne është dhuratë.”[1]

Sipas mendimit të parë, vajtja në një gosti të tillë është e urryer në varësi të masës së pasurisë që është fituar në rrugë haram. Sa më e madhe të jetë kjo pasuri, aq më shumë bëhet e urryer vajtja atje, dhe sa më e vogël të jetë pasuria haram, aq më pak është e urryer.

5- Vajtja në gosti të mos pengojë kryerjen e një detyrimi fetar ose të diçkaje tjetër që është më e domosdoshme se gostia. Në të kundërt, pranimi i ftesës bëhet i ndaluar.

6- Pranimi i ftesës të mos bëhet shkak për dëmtimin e të ftuarit, si, për shembull, kur i duhet të udhëtojë ose të lërë familjen e tij, e cila ka shumë nevojë për të.

Pyetje: Përgjigjja e ftesës, a është e drejtë e Allahut apo e njeriut?

Përgjigje: Ajo është drejtë e Allahut dhe e njeriut bashkë. Nëse i kërkon ftuesit që ta tërheqë ftesën dhe ai pranon, ti nuk ke gjynah. Ajo është detyrë, me urdhër të Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), prandaj duhet të shikosh si bindje ndaj Allahut dhe si përmbushje e detyrimit ndaj vëllait tënd. Është e drejtë e ftuesit që ta pezullojë ftesën, ashtu siç ka të drejtë që të mos e bëjë atë. Mirëpo nëse ai e tërheq ftesën nga turpi prej teje, pa qenë i kënaqur, nuk duhet t’ia kërkosh atë, por duhet t’i përgjigjesh.

Pyetje: Ftesat që dërgohen me shkrim, a janë njëlloj si ato që bëhen gojarisht?

Përgjigje: Po, kanë të njëjtin gjykim.

– *“... Kush ju bën një të mirë, shpërblejeni ...”* – Pra, nëse dikush të bën një të mirë, si dhuratë apo diçka tjetër, ktheja me të njëjtën formë, nëse të ndihmon të mbarosh një punë, shpërbleja, e kështu me radhë. Por nëse është një njeri me pozitë të lartë, për shembull, që nuk mund të shpërblehet, siç janë mbretërit dhe prijësit, duhet të lutesh për të, sepse nëse ti e shpërblen me të njëjtën formë, do të ishte një lloj nënvlerësimi i meritës së tij, atëherë kështu sillesh keq

[1] Buhariu.

me të, ndërsa Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë duhet ta shpërblejmë.

Shpërblimi i së mirës në të njëjtën formë, është i rëndësishëm për dy arsye:

1- Nxit tjetrin në rrugën e mirësisë.

2- Shmang përuljen e vetes, sepse vepra të tilla kanë gjithnjë ndikim. Kthimi i të mirës me të mirë, e largon këtë gjë.

Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Dora e sipërme është më e mirë se dora e poshtme.”[1] Dora e sipërme është dora që jep. Këtu ka një mësim të madh për mirëbërësin: ai nuk duhet të presë të mirë nga askush përveç Allahut të Madhëruar. Mirëpo disa njerëz janë shumë bujarë: nëse ua kthen të mirën, të japin edhe më shumë se më parë. Njerëz të tillë nuk duan shpërblim, por duan që të lutesh për ta, siç ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) “… e nëse nuk keni me çfarë ta shpërbleni, bëni lutje për të …”. Po kështu, nëse i varfri nuk gjen me çka t’ia kthejë të mirën të pasurit, bën lutje për të.

Lutja duhet të bëhet menjëherë, sepse ky është shpejtim në zbatimin e urdhrit të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), por kjo sjell kënaqësi edhe për bamirësin.

– *“… derisa të mendoni se e keni shpërblyer.”* – Pra, kur të mendoni në veten tuaj se e keni shpërblyer, mos u lutni më.

Dobitë e temës

- Strehimi i atij që kërkon mbrojtje me emrin e Allahun.
- T’i japësh atij që të kërkon në emër të Allahut.
- Detyra e pranimit të ftesës.

[1] Buhariu, Muslimi.

- Kthimi i të mirës me të mirë.

- Me lutje shpërblehet mirëbërësi të cilit nuk mund t'ia kthejmë të mirën me të njëjtën formë.

- Lutjet për bamirësin nuk duhet të ndërpriten, derisa të mendosh se e ke shpërblyer.

Kjo temë përmban edhe çështje të tjera të rëndësishme, mirëpo theksi vihet vetëm tek ato që ka renditur autori.

Tema 56

Me Fytyrën e Allahut nuk kërkohet asgjë tjetër përveç Xhenetit.

Tema ka lidhje me teuhidin, sepse qëllimi i saj është madhërimi i Fytyrës së Allahut, duke mos kërkuar nëpërmjet saj asgjë tjetër përveç Xhenetit.

> Nga Xhabiri përcillet se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Nuk kërkohet me Fytyrën e Allahut asgjë tjetër përveç Xhenetit."[1]

Për kuptimin e këtij hadithi ka dy mendime:

Mendimi i parë: Qëllimi është që me Fytyrën Allahut të mos i kërkosh asnjë krijese. Nëse dëshiron që t'i kërkosh dikujt prej krijesave, mos i kërko me Fytyrën e Allahut, sepse me të kërkohet vetëm Xheneti, të cilin krijesat nuk kanë mundësi ta japin.

Dijetari (Allahu e mëshiroftë!), me sa duket, përkrah këtë mënyrë të të kuptuarit të hadithit, ashtu siç thotë në fjalinë e parë menjëherë pas titullit.

Mendimi i dytë: Nëse i kërkon Allahut Xhenetin dhe ato çfarë e bëjnë të mundshme hyrjen në të, atëherë mund t'ia kërkosh atë me Fytyrën e Tij, por nëse kërkon diçka që i përket kësaj bote, mos e kërko me Fytyrën e Tij, sepse ajo është tepër e lartë që të kërkosh nëpërmjet saj diçka nga dynjaja. Çështjet e ahiretit mund t'i

[1] Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

kërkosh me Fytyrën e Allahut, si për shembull, të thuash: "Të kërkoj Ty, me Fytyrën Tënde, të më shpëtosh nga Zjarri!". Kur zbriti fragmenti i ajetit (En'am, 65): "Thuaj: 'Ai ka fuqi t'ju dënojë prej së larti ...", Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) tha: "Mbrohem me Fytyrën Tënde!", kur zbriti: "... ose nga poshtë këmbëve tuaja ...", tha: "Mbrohem me Fytyrën Tënde!", ndërsa për pjesën: "... apo t'ju ndajë në grupe e ta luftoni njëri-tjetrin ..." tha: "Kjo është më e lehtë."[1]

Do të ishte e arsyeshme sikur të themi se hadithi i përfshin të dyja kuptimet.

– "*... me Fytyrën e Allahut ...*" – Kjo pohon ekzistencën e Fytyrës së Allahut të Madhëruar. Atë e pohon Kurani, Suneti dhe unanimiteti i selefëve.

Në Kuran janë ajetet: "... Çdo gjë do të shkatërrohet, përveç Fytyrës së Tij! ..." (Kasas, 88); "... ata që durojnë për Fytyrën e Zotit të tyre ..." (Rrad, 22), si dhe shumë të tjera. Ndërsa nga Suneti, është hadithi i mësipërm, ku Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) tha: "Mbrohem me Fytyrën Tënde!"

Në lidhje me Fytyrën që Allahu i ka atribuuar Vetes së Tij, ka pasur mendime të ndryshme. A është ajo një Fytyrë reale? A mos është fjalë që tregon Qenien e Tij dhe Allahu nuk ka fytyrë? A mos është një shprehje që përdoret për një punë që kryhet për Fytyrën e Allahut, e jo se fytyra është një atribut real i Zotit? Apo është një shprehje që tregon një anë të caktuar? A mos nënkupton ajo shpërblimin e Allahut?

Mendimet janë të shumta, por Allahu, me vullnetin e Vet, i udhëzoi besimtarët që ta kuptonin të vërtetën, për të cilën të tjerët nuk pajtoheshin, duke thënë që ajo është Fytyrë e vërtetë: "... ndërsa do të mbetet vetëm Fytyra e Zotit tënd, plot madhëri dhe nderim." (Rrahman, 27). Ndërsa kur nuk ka për qëllim Qenien e Vet, thotë: "Qoftë lartësuar emri i Zotit tënd, me madhëri dhe nderim!" (Rrahman, 78). Fjala '*dhi*' (me) tregon cilësi të Zotit dhe jo të emrit, kurse '*dhu*' (plot) tregon cilësi të Fytyrës dhe jo cilësi të Zotit. Kur Fytyra përshkruhet si "plot madhëri e nderim", ajo kurrsesi nuk mund të nënkuptojë shpërblimin e Allahut, anën apo Qenien, sepse

[1] Buhariu.

Fytyra nuk është Qenia.

Mohuesit e cilësive thonë se 'Fytyra' nënkupton Qenien, anën ose shpërblimin. Ata thonë se po t'i pohojmë Allahut një fytyrë të vërtetë, atëherë Ai do të kishte patjetër edhe një trup, dhe të gjithë trupat i shëmbëllejnë njëri-tjetrit. Kështu bëhet shëmbëllim i Allahut të Madhëruar, ndërkohë që Ai thotë: "Asgjë nuk i shëmbëllen Atij ..." (Shura, 11). Ta bësh këtë është mohim i Kuranit, ndërsa ju, o ndjekës të Sunetit, – thonë ata – thoni se kush beson që Allahu ka ndonjë shëmbëlltyrë në cilësitë që janë të posaçme për Të, është qafir?!

Ne u përgjigjemi:

Së pari, çfarë nënkuptoni ju me trupin e Allahut, që e mohoni? A keni për qëllim trupin e ndërtuar nga eshtrat, nervat, mishi dhe gjaku, ku çdo pjesë e tij ka nevojë për tjetrën? Nëse nënkuptoni këtë, ne pajtohemi me ju se Allahu nuk është dhe as nuk mund të jetë kështu. Por nëse me "trupin e Allahut" nënkuptohet Qenia e Tij e vërtetë, e përshkruar me cilësitë e përsosura, atëherë nuk ka asgjë të ndaluar. Allahu e ka përshkruar Veten e Tij si të Vetëm dhe *Es Samed*: "Thuaj: 'Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është *Es Samed*." (Ihlas, 1-2). Ibn Abasi (r.a.) ka thënë: "*Es Samed* do të thotë: Ai, i Cili nuk ka zbrazëti të përbrendshme."[1]

Së dyti, mëtimi juaj se të gjithë trupat i shëmbëllejnë njëri-tjetrit, është tejet i pasaktë. A është trupi i ariut si trupi i milingonës? Midis tyre ka ndryshime shumë të mëdha në madhësi, ndërtim, funksion, etj. Nëse bie kjo provë, bie edhe rezultati i saj, që ishte: domosdoshmëria e shëmbëllimit të Allahut me krijesat e Tij.

Ne gjithashtu shohim se as njerëzit nuk ngjajnë në pamje me njëri-tjetrin. Nuk gjen dy persona me të njëjtën fytyrë, qoftë edhe binjakë. Madje thuhet se shenjat e gishtave të një personi nuk përputhen me të askujt tjetër.

Ndërsa sa i përket hadithit të Ebu Hurejres, që Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Me të vërtetë Allahu e krijoi Ademin në pamjen e Tij"[2], – ndërsa, nga ana tjetër, Fytyra e Allahut nuk u shëmbëllen fytyrave të krijesave, – themi se kjo nuk do të thotë pamja e njeriut i shëmbëllen pamjes së Krijuesit të

[1] Ibn Xheriri.

[2] Buhariu, Muslimi.

Madhëruar, sipas mendimit unanim të muslimanëve dhe të diturve. Vetëm *Kursij*-a e Allahut të Madhëruar përfshin qiejt dhe tokën. Qiejt dhe tokat, në raport me *Kursij*-in – që është vendi i dy këmbëve – janë si një unazë e hedhur në shkretëtirë, ndërsa madhësia e Fronit ndaj *Kursij*-ut, është si madhësia e kësaj shkretëtire ndaj unazës. Ç'mund të mendosh pra për Zotin e botëve?! Askush nuk mund ta përfytyrojë Atë. Ai që përshkruhet si i tillë, nuk mund të jetë kurrsesi në formën e Ademit, gjatësia e të cilit ishte gjashtëdhjetë kut, por hadithi i Ebu Hurejres ka njërin nga dy kuptimet e mëposhtme:

1- Allahu i dha Ademit një pamje që Ai e zgjodhi, duke i zbukuruar posaçërisht fytyrën. Për këtë, fytyra nuk duhet të përçudnohet ose të goditet, sepse kur Ai ia atribuon Vetes së Tij, ajo meriton të respektohet.

2- Vërtet Allahu e krijoi Ademin me pamjen e Tij (Subhanehu ue Te'Ala), por kjo nuk do të thotë që ata ishin të ngjashëm. Për shembull, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) thotë: "I pari grup që do të futet në Xhenet, do të ketë pamjen e hënës kur është e plotë, pastaj ata që vijnë pas tyre, do të jenë si ylli më i shndritshëm në qiell."[1] Kjo nuk do të thotë që do të kenë krejtësisht pamjen e hënës, sepse hëna është më e madhe se banorët e Xhenetit. Gjatësia e një banori të Xhenetit do të jetë 60 kut ndërsa gjerësia 7 kut, siç citohet në disa hadithe.

Disa dijetarë kanë thënë se shprehja "në pamjen e tij", do të thotë: në pamjen e Ademit. Pra, Allahu e krijoi Ademin që në fillim në këtë pamje, jo si bijtë e tij, të cilët kalojnë nëpër etapa të ndryshme të zhvillimit të tyre: nga një pikë, pastaj gjak i mpiksur, pastaj copë mishi etj. Por imam Ahmedi (Allahu e mëshiroftë!) e ka kundërshtuar këtë, duke thënë se ai është interpretimi i *xhehmi*-ve, pasi ai del i tëri nga domethënia e hadithit. Po kështu, është një variant tjetër i hadithit, që sqaron se kujt i referohet përemri, duke thënë: "… në pamjen e të Gjithëmëshirshmit."

Dobitë e temës

[1] Buhari dhe Muslim.

- Ndalimi i të kërkuarit me Fytyrën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), me përjashtim të kërkesës më të lartë Xhenetit.

Kjo del nga hadithi i temës, të cilin disa dijetarë e kanë quajtur të dobët, por duke marrë në konsideratë mundësinë e saktësisë së tij, është element i edukatës që me Fytyrën e Allahut të kërkohen vetëm gjëra që kanë të bëjnë me botën tjetër, fitimin e Xhenetit ose shpëtimin nga Xhehenemi.

- Pohimi se Allahu ka Fytyrë.

Tema 57

Argumentet në lidhje me fjalën “sikur”.

Dijetari (Allahu e mëshiroftë!) e ka lënë çështjen të hapur, duke mos dhënë një gjykim të prerë, sepse fjala “sikur” përdoret në disa forma:

1- Në kundërshtim të Sheriatit. Kjo është haram. Allahu i Madhëruar thotë: “...Sikur të na kishin dëgjuar ne, nuk do të ishin vrarë.” (Ali Imran, 168). Në luftën e Uhudit, Abdullah Ibn Ubeji u kthye gjatë rrugës me një të tretën e ushtrisë. Kur shtatëdhjetë muslimanë ranë dëshmorë, hipokritët që i kishin kthyer shpinën urdhrit të Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), thanë: “Sikur të na kishin dëgjuar ne dhe të kthеheshin ashtu si ne, nuk do të vriteshin. Mendimi ynë qe më i mirë se i Muhamedit.” Kjo është haram dhe ndoshta arrin deri në kufër.

2- Në kundërshtim të kaderit. Edhe kjo gjithashtu është haram. Allahu i Madhëruar thotë: “O ju që keni besuar! Mos u bëni si ata (hipokritët) që mohuan, të cilët u thonin vëllezërve të tyre, kur këta niseshin në udhëtim ose në luftim: ‘Sikur të rrinit me ne, as nuk do të vdisnit, as nuk do të vriteshit ...” (Ali Imran, 156). Pra, sikur ata të qëndronin, nuk do të vriteshin. Duke u shprehur kështu, ata refuzuan caktimin e Allahut.

3- Si pasojë e dështimit dhe dëshpërimit. Edhe kjo është haram, sepse çdo gjë që sjell dëshpërim është e ndaluar, pasi dëshpërimi sjell pikëllim, ndërsa Allahu kërkon nga ne që të jemi të qetë e të lumtur. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kushtoji rëndësi asaj që të bën dobi, kërkoji ndihmë Allahut dhe mos u bëj i paaftë. Nëse të godet diçka, mos thuaj: ‘*Sikur të bëja kështu, nuk do*

të ndodhte ashtu', (por thuaj: 'Qe caktimi i Allahut, i Cili, çfarë deshi, bëri'), sepse fjala '*sikur'* i hap rrugën shejtanit."[1] Dikush, për shembull, blen diçka, duke menduar se me të do fitojë, por del me humbje, prandaj thotë: "Sikur të mos e blija, nuk do të kisha humbur." Ky është dëshpërim dhe ndodh shpesh, por është e ndaluar.

4- Si arsyetim me anë të kaderit, për një gjynah të bërë, siç thonin idhujtarët: "Sikur të kishte dashur Allahu, ne nuk do të kishim adhuruar tjetër veç Tij..." (En'am, 148); apo: "Sikur të kishte dashur Mëshirëploti, ne nuk do t'i kishim adhuruar ata...." (Zuhruf, 20). Kjo është e papranueshme.

5- Për të shprehur një dëshirë ose shpresë për të ardhmen. Gjykimi për këtë bëhet sipas llojit të dëshirës apo shpresës: nëse janë për të mira, janë të mira, nëse janë për keq, janë të këqija. Në një hadith të saktë nga Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), ku përshkruhen katër lloj njerëzish, njëri prej tyre thotë: "Sikur të kisha pasurinë e filanit, do të bëja ashtu si bën ai." Ky dëshironte të bënte të mira. Edhe i dyti tha: "Sikur të kisha pasurinë e filanit, do të bëja ashtu si bën ai." Ky dëshironte të bënte diçka të keqe. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) tha për të parin: "Ai do të shpërblehet sipas nijetit të tij. Të dy janë të barabartë në shpërblim." Ndërsa për të dytin tha: "Ai do të shpërblehet sipas nijetit të tij. Të dy janë të barabartë në gjynah."[2]

6- Për të treguar një fakt. Kjo lejohet. Për shembull: "Sikur të isha në mësim, do të përfitoja". Kështu ka thënë Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Sikur ta dija që në fillim atë që di tani,[3] nuk do të kisha marrë me vete kurbanin dhe do të isha liruar nga ndalesat e *ihram*-it me ju."[4] Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) tregoi se sikur ta dinte që do të ndodhte ashtu me sahabët, nuk do ta merrte kurbanin me vete dhe do të ishte liruar nga ndalesat e ihramit. Kështu e kuptoj unë hadithin. Megjithatë, të tjerë thonë se kjo qe një dëshirë e shprehur nga Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue

[1] Muslimi. Pjesa ndërmjet kllapave nuk është përmendur në këtë vend, por në transmetimin vijues.
[2] Ahmedi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.
[3] Flitej për lejimin e umres në muajt e haxhit.
[4] Buhariu dhe Muslimi.

sel-lem), pra fjalia është: "Ah, sikur të dija që në fillim atë që di tani …". Por, me sa duket, nuk është ashtu, sepse Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk dëshironte diçka që ishte në kundërshtim me atë që kishte përcaktuar Allahu.

Në këtë temë, autori ka sjellë dy ajete:

> Ajeti i parë: "Sikur të pyeteshim ne për këtë gjë, nuk do të vriteshim këtu …" (Ali Imran, 154).
>
> Ajeti i dytë: "Ata që thanë për vëllezërit e vet (të vrarë), ndërsa vetë qëndruan (në shtëpitë e tyre): 'Sikur të na kishin dëgjuar ne, nuk do të ishin vrarë …" (Ali Imran, 168).

– *"(Ata thoshin:) Sikur të pyeteshim ne për këtë gjë, nuk do të vriteshim këtu …"*, − Flitet për ngjarjen në Uhud. Kundërpërgjigjja ndaj tyre ishte ajeti: "Thuaju: 'Edhe sikur të kishit qenë në shtëpitë tuaja, përsëri atyre që u qe shkruar të vriteshin, do të dilnin në vendin e vrasjes …". Ata nuk mund t'i shmangeshin asaj që Allahu dëshironte për ta.

Qëndrimi i tyre ishte kundërshtim i Sheriatit, sepse ata qortuan Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), që ai doli të luftonte pa pëlqimin e tyre, por mund të jetë gjithashtu pakënaqësi ndaj caktimit të Allahut. Pra, komenti është: Në qoftë se do të ishim pyetur për strategjinë dhe mendimin tonë, nuk do të dilnim e të vriteshim.

– *"… Ata që thanë për vëllezërit e vet (të vrarë), ndërsa vetë qëndruan …"* – Këta përshkruhen me dy cilësi: 1. si kundërshtues të kaderit, kur thanë: "Sikur të na kishin dëgjuar ne, nuk do të ishin vrarë …"; 2. si frikacakë në zbatimin e Sheriatit "… ndërsa vetë qëndruan …". Ky qe poshtërim për ta, pasi folën ashtu, duke qëndruar vetë në shtëpitë e tyre. Sikur të kishte hajër tek ta, do të kishin dalë bashkë me njerëzit e tjerë në luftë, por ata ishin kundër besimtarëve dhe kundër caktimit të Allahut.

– *"... vëllezërit e vet ..."* – Komentohet si "vëllezërit nga gjaku" e jo "vëllezërit në fe". Por shpjegohet edhe si "vëllezërit në fe" sipas aspektit të jashtëm, sepse munafikët shtiren si muslimanë. Do të ishte e saktë edhe nëse do të thuhej se ngërthehen të dyja kuptimet.

– *"... Sikur të na kishin dëgjuar ne, nuk do të ishin vrarë..."* – Kjo nuk ishte e vërtetë, prandaj Allahu u kundërpërgjigjet atyre: "Thuaju: 'Prapësojeni vdekjen nga vetja, nëse flisni të vërtetën!" Pra: edhe nëse qëndroni në shtëpitë tuaja, nuk mund ta shmangni vdekjen.

Ky ajet dhe ai para tij tregojnë se njeriut i ndodhin gjërat sipas caktimit të Allahut, ashtu sikundër ai duhet të veprojë sipas Sheriatit të Allahut.

Tema lidhet me teuhidin sepse "*sikur*-i" është mospranim i kaderit, dhe kush kundërshton caktimin e Allahut, nuk është i kënaqur me Allahun si Zot, dhe ai që nuk është i kënaqur me Allahun si Zot, nuk e ka realizuar teuhidin *rububije* (njësimi i Allahut në veprat e Tij).

Është detyrë që të kënaqesh me Allahun si Zot. Nuk mund të qetësohesh ndryshe, vetëm nëse kënaqesh plotësisht me Allahun si Zot. Edhe sikur të kishe fletë, do të anoje aty ku e ka caktuar Allahu. Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Çudi me besimtarin. Vërtet e gjithë çështja e tij është mirësi. Nëse i ndodh diçka e keqe, bën durim, e kjo është mirësi për të; nëse i ndodh diçka e mirë, falënderon, dhe kjo është mirësi për të."[1] Sido që të jetë, do të ndodhë ajo që ka qenë caktuar. Nëse nisesh për udhëtim, gjatë të cilit të ndodh ndonjë fatkeqësi, mos thuaj: "Sikur të mos isha nisur, nuk do të më ndodhte kjo.", sepse ajo ka qenë e caktuar që patjetër do të ndodhte.

> Sipas një hadithi të saktë, përcjellë nga Ebu Hurejre, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Interesohu për atë që të bën dobi, kërkoji ndihmë Allahut dhe mos trego paaftësi[2]. Nëse të godet diçka, mos thuaj:

[1] Muslimi.

[2] Paaftësia tregohet në dy forma:
E para: duke mos vepruar shkaqet.

> ‘Sikur të bëja ashtu, nuk do të ndodhte kështu’, por thuaj: ‘Qe caktimi i Allahut, i Cili, çfarë deshi, bëri’, sepse fjala ‘*sikur’* i hap rrugën shejtanit.”[1]

– *“Sipas një hadithi të saktë …*” – Hadithi ndodhet te Muslimi. Autori (Allahu e mëshiroftë!) nuk ka përmendur një fjali të hadithit, por vetëm aq sa i përshtatet temës. Fjalia e papërmendur është: “Besimtari i fortë është më i mirë dhe më i dashur për Allahun sesa besimtari i dobët, por në çdonjërin prej tyre ka mirësi.”

“… Besimtari i fortë …”. Pra, me besim të fortë, me siguri të plotë, që nuk mund ta godasë dyshimi, me vepra të mira si xhihadi, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, me vendosmëri në adhurim, etj.

A futet këtu forca e trupit? Jo, nuk futet, vetëm nëse fuqia e trupit i shton imanin ose të çon drejt tij, sepse forca duhet të jetë e besimit. Megjithatë, nuk ka dyshim se forca trupore është mirësi që, nëse e përdor në të mira, është e mirë dhe nëse e përdor për të këqija, është e keqe.

“… më i mirë dhe më i dashur për Allahun …”. Domethënë i mirë në ndikimin dhe rezultatet e tij. Ai u bën dobi të tjerëve dhe merret si shembull prej tyre. Ai është gjithashtu më i dashur për Allahun, në aspektin e shpërblimit.

“… sesa besimtari i dobët …”. Domethënë me dobësi në besim ose në gjërat që çojnë drejt tij.

“… por në çdonjërin prej tyre ka mirësi.” Pra, edhe nga të fortit, edhe nga të dobëtit ka të mira. Kjo thuhet, që të mos mendojë kush se nuk ka hajër nga besimtari i dobët. Kur dëgjon fillimisht se besimtari i fortë është më i mirë dhe më i dashur për Allahun sesa besimtari i dobët, mund të krijohet një ndjenjë nënçmimi për besimtarin e dobët, mirëpo kur thuhet se në çdonjërin prej tyre ka mirësi, përshtypja ndryshon pozitivisht. E tillë është pak a shumë edhe fjala e Allahut: “Nuk janë të barabartë ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar para fitores me ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar më pas. Ata kanë shkallë më të lartë, mirëpo Allahu u premton të gjithëve më të mirën (Xhenetin). (Hadid, 10).

E dyta: duke i vepruar shkaqet por nuk i mbeshtetesh Zotit. (shën. për).

[1] Muslimi.

– *"...Interesohu për atë që të bën dobi..."* – Pra, përpiqu të arrish atë që të bën dobi, në çështjet e fesë ose të dynjasë.

Veprat e njeriut klasifikohen detyrimisht në njërën prej këtyre katër kategorive:

1. të dobishme, dhe këto janë të urdhëruara;
2. të dëmshme, të cilat janë të ndaluara;
3. të dëmshme, por që kanë edhe disa dobi;
4. as të dëmshme, as të dobishme.

Për këto të fundit nuk ka as urdhër e as ndalim, por në të shumtën e rasteve ato të çojnë ose drejt veprave të urdhëruara, ose drejt të ndaluarave, kështu që marrin të njëjtin gjykim si qëllimi tek i cili të shpien, sepse mjetet trajtohen sipas qëllimeve apo objekteve tek të cilat të çojnë.

Pra asgjë nuk del jashtë të qenit e dobishme ose e dëmshme, në vetvete ose jo në vetvete. Një bisedë e jona mund të mos duket as e dobishme e as e dëmshme, mirëpo ndoshta një fjalë e thua që të kënaqësh dikë, e kështu biseda bëhet e dobishme. Megjithatë, i mençuri e kursen kohën e tij nga gjërat që nuk kanë as dobi e as dëm. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Kush beson në Allahun dhe Ditën e Fundit, të flasë mirë ose të heshtë!".[1]

Kjo çështje lidhet me atë para saj, sepse fokusimi tek e dobishmja është tregues i forcës së besimit. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë që t'i kushtojmë rëndësi të dobishmes. Jo vetëm kaq, por edhe mes dy gjërave të dobishme, ne duhet t'i japim përparësi asaj që ka dobi më të madhe, për dy arsye: 1. ajo sjell dobi më shumë; 2. kur çështja ka një motiv ligjor, ajo theksohet në varësi të fuqizimit dhe theksimit të këtij motivi.

Nga hadithi mësojmë se është detyrë të largohemi nga gjërat e dëmshme, sepse kjo sjell dobi dhe shpëtim.

– *"... kërkoji ndihmë Allahut ..."* – Sipas kontekstit, kërkimi i ndihmës është renditur pas kushtimit rëndësi (lakmisë) ndaj të dobishmes, sepse gjithmonë lakmia duhet para veprimit.

Ndihma e Zotit kërkohet me lutje, si: "O Allah, më ndihmo!", ose: "*La haule ue la kuuete il-la bil-lah."* (S'mund të bëhët asnjë lëvizje

[1] Buhariu dhe Muslimi.

dhe s'ka fuqi për asgjë veçse mevullnetin e Allahut), kur fillon ndonjë punë. Por ajo është edhe ndjesi në zemër se ke nevojë për Zotin tënd, që të ndihmojë në një punë të caktuar, se nëse Ai të lë të mbështetesh në veten tënde, të ka lënë në dorë të dobësisë, paaftësisë dhe mangësisë. Mund të jetë edhe me të dyja së bashku, sepse në përgjithësi, kush kërkon ndihmë me gojë, ka kërkuar edhe me zemër.

Nëse njeriu ka nevojë për ndihmën e një krijese, si për shembull të mbajë një arkë, lejohet ta kërkojë, por duke mos ndjerë në vetvete se ajo është njëlloj si t'i kërkosh ndihmë Krijuesit. Është detyrë që të ndjesh atë si ndihma që disa gjymtyrë të tuat u bëjnë gjymtyrëve të tjera: kur nuk ke mundësi ta ngresh diçka me njërën dorë, atëherë përdor edhe tjetrën.[1]

---

[1] Ibn Kajimi ka thënë: "Lumturia e njeriut është në kushtimin rëndësi (lakminë e tij) ndaj gjërave që i bëjnë dobi në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. *El hirs* (fjalë kjo që është përdorur në hadith) është përpjekja me të gjitha mundësitë. Nëse kjo përkon me atë që ai ka dobi, atëherë lakmija e tij është e lavdëruar. E gjithë përsosmëria e tij është në bashkimin e këtyre dy çështjeve: të jetë lakmues dhe lakmija e tij të jetë në atë që ai ka dobi. Nëse ai lakmon ato që nuk i bëjnë dobi, ose vepron atë që nuk i bën dobi pa qënë lakmues, ai humb nga përsosja, sipas asaj që ka humbur prej kësaj. E gjithë e mira është në lakminë ndaj asaj që të bën dobi."

Për pjesën "kërkoi ndihmë Allahut" Ibn Kajimi ka thënë: "Përderisa lakmija e njeriut dhe veprimi i tij është me ndihmën e Allahut, dëshirën dhe suksesin e Tij, Ai e ka urdhëruar atë që të kërkojë ndihmën e Tij. Kjo, me qëllim që të arrijë në gradën: 'Vetëm Ty të adhurojmë dhe Vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë', pasi lakmija e tij ndaj asaj që i bën dobi, është adhurim për Allahun, e kjo nuk mund të përmbushet vetëm se me ndihmën e Tij. Prandaj, Ai e ka urdhëruar që ta adhurojë Atë dhe të kërkojë ndihmë prej Tij."

Ndërsa të tjerë në lidhje me shprehjen "kërkoi ndihmë Allahut", kanë thënë: Në të gjitha çështjet e tua kërko ndihmë nga Allahu e jo nga të tjerët, siç ka thënë Allahu: "Vetëm Ty të adhurojmë dhe Vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë." Robi është i pamundur, ai nuk ka mundësi për asgjë, nëse nuk e ndihmon Allahu. Atëherë, nuk ka ndihmues për të në ato që i bëjnë dobi qoftë në çështjet e fesë apo të dynjasë, veç Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Atë që e ndihmon Allahu, është i ndihmuar dhe atë që e braktis Allahu (nuk e ndihmon), është i braktisur. I Dërguari (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) thoshte në hutben e tij dhe ua mësonte edhe shokëve të tij të thoshin: "Falënderimi i takon Allahut. Atij i kërkojmë që të na ndihmojë dhe Atij i kërkojmë që të na

– *"... dhe mos trego paaftësi ..."* – Pra, mos u bëj dembel dhe i pavendosur para vepra që ke mundësi t'i kryesh. Qëllimi nuk është te paaftësia që godet njeriun, sepse paaftësia për kryerjen e diçkaje është ndryshe nga të treguarit i paaftë, pasi paaftësia që godet njeriun nuk është zgjedhje e tij dhe nuk është në mundësin e tij. Për këtë arsye, Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i ka thënë dikujt që nuk kishte mundësi të falej normalisht: "Falu në këmbë! Nëse nuk ke mundësi ashtu, falu ulur, e nëse as ashtu nuk ke mundësi, falu në brinjë!"[1] Kur bashkohet lakmija dhe mospërtacia, janë bashkuar qëllimi i vërtetë me lakminë dhe vendosmëria me mosdembelizmin.

Disa njerëz vendosin të bëjnë diçka të dobishme, por pastaj tregohen të plogësht dhe e lënë atë përgjysmë. Kjo është në kundërshtim me urdhrin e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Përderisa e di që është e dobishme, mos e lër në mes, sepse ashtu humb punën që ke nisur e, gjithashtu, mësohesh me dembelizmin. Sa njerëz e kanë filluar një punë të dobishme, pastaj u ka shkuar shejtani dhe i ka shkurajuar? Megjithatë, nëse gjatë kryerjes së punës del se ajo është e dëmshme, është detyrë që ta ndërpresësh atë, sepse kthimi tek e drejta është më i vlefshëm sesa vazhdimi në të pavërtetën.

Në jetëshkrimin e gjuhëtarit El Kisai thuhet se, kur e nisi fillimisht studimin e gramatikës arabe, iu duk tepër e vështirë, prandaj e la. Por, një ditë, ai pa një milingonë që mbarte ushqim, duke dashur të ngjitej mbi një mur. Sa bënte të ngjitej pak, ajo rrëzohej poshtë, e ia niste nga e para. Ajo vazhdoi kështu, derisa

---

udhëzojë...". Po kështu, në duanë e kunutit thoshte: "O Allah! Kërkojmë që të na ndihmosh!" Ai e ka urdhëruar Muadh ibn Xhebelin (radijallahu anhu) të mos lërë pa thënë pas çdo namazi: "O Allah, më ndihmo mua të përmend, të falënderoj Ty dhe të adhuroj Ty sa më mirë!". Kjo ka qenë pjesë e lutjes së tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Gjithashtu, i Dërguari (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "O Allah! Më ndihmo mua dhe mos ndihmo kundër meje!" Nëse robi realizon gradën e kërkimit të ndihmës dhe vepron me të, është i ndihmuar nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), i është mbështetur Atij, është shpresues tek Ai dhe i frikësuar prej Tij. Atëherë, meriton gradën e Teuhidit, inshallah. (Marrë nga "Tejsir el Aziz el Hamid")

[1] Buhariu.

arriti të ngjitej. Atëherë, El Kisai mori mësim prej saj, prandaj u përpoq e u lodh derisa u bë një nga prijësat në gramatikë.

– *"... Nëse të godet diçka, mos thuaj: 'Sikur të bëja ashtu, nuk do të ndodhte kështu'..."* – Ky është mësimi i katërt i atij hadithi madhështor. Mësimi i parë qe të përqendrohesh te veprat që janë të dobishme; mësimi i dytë: t'i kërkosh ndihmë Allahut (Subhanehu ue Te'Ala); mësimi i tretë: të jesh këmbëngulës në punë, duke larguar plogështinë; dhe mësimi i katërt është: kur rezultati i punës nuk del ashtu siç e kishe parashikuar, atëherë dorëzoja çështjen Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), sepse ajo nuk të përket ty, por ka ndodhur me caktimin e Tij.

– *"... nëse të godet diçka ..."* – Pra, nëse të godet diçka që nuk e dëshiron e që të pengon në arritjen e objektivit fillestar.

Ka dy mënyra të kundërshtimit të kaderit, që shprehen kështu:

1. "Sikur të mos bëja ashtu, nuk do të ndodhte kështu", për shembull: "Sikur të mos kisha shkuar atje, nuk do të kisha dalë i humbur."

2. Kjo është për diçka që nuk është bërë: "Sikur të bëja ashtu, do të ndodhte kështu", për shembull: "Sikur të kisha shkuar atje, do të kisha dalë i fituar."

Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka përmendur rastin e dytë e jo të parin, sepse në rastin e parë, njeriu të paktën veproi, ka bërë diçka, ndryshe nga rasti i dytë, kur njeriu nuk ka bërë asgjë, sepse e përbuz punën.

– *"... por thuaj: 'Qe caktimi i Allahut'..."* – Pra, ky ishte *kaderi* i Allahut. Fjala "*kaderullahi*" (caktimi i Allahut) përdoret për përcaktimin si veprim i Allahut, por përdoret edhe për të shënuar objektivin dhe rezultatin e këtij përcaktimi. Në tekstin tonë përdoret me kuptimin e dytë, sepse flitet për diçka që ka ndodhur. Pra, "caktim i Allahut" do të thotë "i përcaktuar prej Tij". Çdo gjë përcaktohet vetëm nga Ai, sepse e vepruara është pasojë e veprimit.

Domethënia është: "Kjo që ndodhi ishte caktimi i Allahut dhe nuk më përkiste mua. Për sa i përket pjesës sime, unë u përpoqa në atë që e pashë të dobishme, siç jam urdhëruar." Ky është dorëzim i

plotë ndaj përcaktimit të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Nëse njeriu zbaton urdhrat hyjnorë në përputhje me Sheriatin, atëherë nuk qortohet për asgjë, sepse ia ka dorëzuar çështjen Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

– "*... i Cili, çfarë deshi, bëri ...*" – Çka dëshiron Allahu ta bëjë, e bën, sepse Atë nuk e pengon asgjë nga ajo që ka përcaktuar dhe nuk ka kush që të kthejë mbrapsht gjykimin e Tij. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Allahu gjykon, dhe askush nuk mund ta kthejë gjykimin e Tij; Ai është i shpejtë në llogari." (Rrad, 41). Një rregull thotë: Çdo veprim që lidhet me dëshirën e Allahut, është gjithashtu pjesë e urtësisë së Tij, pasi Ai çdo veprim e bën vetëm nëse dëshiron. Allahu nuk vepron apo përcakton ndryshe, por vetëm me urtësi. Kur kemi të bëjmë me vullnetin e Allahut, ai do të ndodhë patjetër. Prandaj, muslimanët thonë "Çfarë dëshiron Allahu, bëhet, dhe çfarë nuk e dëshiron Ai, nuk bëhet".

Por duhet të bëjmë dallim ndërmjet dëshirës si vullnet i Allahut dhe dëshirës si pëlqim i Tij. Dëshira si pëlqim i Allahut nuk është e domosdoshme të ndodhë. Allahu thotë: "Allahu dëshiron t'jua pranojë pendimet tuaja ..." (Nisa, 27). Kuptimi i ajetit është që Allahu e pëlqen këtë, se po të ishte me kuptimin e vullnetit, Allahu do ta pranonte pendimin nga të gjithë njerëzit. Për dëshirën si vullnet i Tij, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Sikur të dëshironte Allahu, ata nuk do të vriteshin me njëri-tjetrin, por Allahu bën si të dojë Vetë." (Bekare, 253).[1]

---

[1] Pra, fjala *irade* (dëshira e Allahut) mund të tregojë dëshirën për krijimin ose për sjelljen e diçkaje në ekzistencë dhe mund të shënojë dëshirën fetare. Kështu, sipas kuptimit të parë ajo quhet *irade keunije kaderije,* ndërsa sipas të dytit quhet *irade sherije dinije.* Atëherë, kur Allahu dëshiron të krijojë diçka, të sjellë diçka në ekzistencë, apo të ndodhë diçka, edhe nëse e urren, ajo domosdoshmërisht do të bëhet realitet, ndërsa kur Allahu shpreh dëshirën të respektohet një normë a një rregull fetarë, ose shpreh dëshirën dukë vënë një normë fetare, nuk është e thënë që dëshira e Tij të bëhet realitetet, edhe pse Ai e pëlqen të respektohen ligjet e Tij fetare, dhe kjo për urtësi e qëllime madhore.
E tillë është edhe leja; Allahu i lartësuar nëse lejon diçka, kjo nuk do të thotë me domosdo se Ai ka dashuri për atë gjë, dhe e do në vetvete. Pra Ai mund të lejojë të ndodhë diçka që nuk e do. Sepse lejimi i Allahut të lartësuar është dy llojesh:

– *"... sepse fjala 'sikur' i hap rrugën shejtanit ..."* – Pra, kjo fjalë hap punën e shejtanit. Puna e tij është të fusë dëshpërim, brengë dhe mërzitje në zemrën e njeriut. Shejtani e do këtë gjë: "Bisedat e fshehta janë vetëm nga shejtani, për t'i dëshpëruar besimtarët. E megjithatë, ai nuk mund t'u shkaktojë kurrfarë të keqeje, përveçse me lejen e Allahut..." (Muxhadele, 10). Deri edhe në gjumë ai i shfaq ëndrra të frikshme, me qëllim që t'ia prishë qetësinë besimtarit dhe t'ia turbullojë mendimet, sepse ashtu ai nuk mund të jetë i gatshëm për ta bërë adhurimin siç duhet. Ndërsa Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka ndaluar të falet namazi kur mendja nuk është e përqendruar dhe e qetë, duke thënë: "Nuk ka namaz në prani të ushqimit dhe as duke mbajtur me vështirësi dy rrugët e jashtëqitjes."[1] Nëse njeriu është i kënaqur me Allahun si Zot të tij, duke thënë se ky ishte caktimi i Allahut, që patjetër do të ndodhte, qetësohet në vetvete dhe i mbushet zemra.

Dobitë e hadithit

- Pohimi i dashurisë së Allahut, sipas hadithit: "... më i mirë dhe më i dashur për Allahun ...".

- Ndryshimi i njerëzve në bazë të forcës dhe dobësisë së imanit, sipas hadithit: "Besimtari i fortë është më i mirë dhe më i dashur për Allahun sesa besimtari i dobët, por në çdonjërin prej tyre ka

---

Idhnun Kaderij. Lejim sipas përcaktimit të Allahut. Pra që Allahu i lartësuar e ka dëshiruar që të ekzistojë me urtësinë e Tij si provë për njerëzit, pavarësisht se ajo mund të jetë e urrejtur tek Ai.
Idhun Sherij. Lejim sipas asaj që e diktojnë dispozitat e drejta të sheriatit të Allahut. Pra ky lejim me fjalë të tjera është, më shumë, një *urdhërim* i dhënë prej Allahut për diçka. Nëse lejimi i parë mund të jetë ose jo i urryer tek Allahu i lartësuar, lloji i dytë nuk mund të jetë veçse i dashur për të. Sepse Allahu i lartësuar nuk urdhëron me dispozitat e Tij veçse për atë që është e mirë dhe e dashur për të. Një ndryshim tjetër mes dy llojeve të lejimeve të Zotit është edhe fakti që; Nëse lejimi i parë duhet domosdo të vijë në ekzistencë dhe të ekzekutohet, sepse vetëm në këtë mënyrë do të shfaqen urtësitë e të Urtit mes krijesave të Tij duke i provuar ato; lloji i dytë i cili përfaqëson urdhrat dhe ndalesat e Allahut mund të vihet në jetë ose jo nga të urdhëruarit dhe të ndaluarit, sepse, këto urdhra janë vendosur nga i Madhëruari si provë për krijesat, për të cilat do të merren në përgjegjësi.
[1] Muslimi.

mirësi.”.

- Imani rritet dhe pakësohet, sepse forca e tij është rritje, ndërsa dobësia është pakësim i tij. Ky është mendimi i saktë, që mbizotëron tek Ehli Suneti.

Disa qëndrime nga Ehli Suneti thonë se besimi shtohet por nuk pakësohet, sepse pakësimi i tij nuk përmendet në Kuran. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “... e t’u shtohet besimi atyre që besojnë ...” (Mudethir, 31); “... për t’ua shtuar besimin, krahas besimit që patën ...” (Fet’h, 4). Megjithatë, më i drejti është mendimi i parë, sepse nëse pohon shtimin, atëherë ke pranuar detyrimisht edhe pakësimin. Sipas kësaj, Kurani pohon edhe pakësimin e imanit, në mënyrë të pashmangshme. Ndërsa Suneti e ka deklaruar qartazi këtë çështje, në fjalën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Nuk kam parë më të mangëta në logjikë dhe fe, që t’ia marrin mendjen një burri të vendosur, sesa ju (gratë).”[1]

Besimi shtohet në masë dhe cilësi. Rritja në masë është shtimi i veprave të dukshme, ndërsa shtimi i “punëve të padukshme”, siç është siguria, është rritje në cilësi. Prandaj Ibrahimi (alejhi selam) tha: “O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit”- Zoti i tha: “A nuk beson?” - “Po, besoj" u përgjigj Ibrahimi, por dëshiroj të më qetësohet zemra ...” (Bekare, 260). Njeriun, kur e lajmëron një njeri i besueshëm për diçka, e pastaj vjen një tjetër dhe i përcjell të njëjtën gjë, i shtohet siguria. Për këtë arsye, dijetarët thonë se lajmi që vjen në rrugë të shumta është i sigurt. Kjo dëshmon se zemrat ndryshojnë për sa i përket gjendjes së besimit. Ndërsa për veprat kjo është e qartë, për shembull, falja e katër rekatëve namaz është më shumë sesa falja e dy rekatëve.

- Te besimtari ka mirësi, edhe nëse është me besim të dobët, sipas thënies së Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... por në çdonjërin prej tyre ka mirësi.”

- Sheriati ka ardhur për plotësimin dhe realizimin e gjërave të dobishme, sipas thënies së Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “*Interesohu për atë që të bën dobi...*”. Kur besimtari zbaton urdhrin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), ka bërë një adhurim ndaj Allahut, edhe nëse vepra e dobishme hyn në çështjet e dynjasë.

---

[1] Buhariu, Muslimi. Transmetimi është sipas variantit të Muslimit.

- I mençuri nuk duhet t'i shpenzojë energjitë e tij në gjëra që nuk bëjnë dobi, sipas thënies së Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "*Interesohu për atë që të bën dobi*...".

- Njeriu duhet të bëjë durim e të vazhdojë në rrugën e së mirës, sipas thënies: "mos u bëj i paaftë ...".

- Për çështjet ku njeriu s'ka mundësi të ndikojë, ka të drejtë të justifikohet me kaderin, sipas fjalës së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "... por thuaj: 'Qe caktimi i Allahut, i Cili, çfarë dëshiroi, bëri ...'." Ndërsa për gjërat e mundshme për të, nuk ka të drejtë të justifikohet me kaderin.

Në dialogun ndërmjet Ademit dhe Musait, ky i fundit e qorton Ademin (alejhi selam) duke i thënë: "Përse na nxore nga Xheneti, ne dhe veten tënde?" Ai i përgjigjet: "A po më qorton për diçka që Allahu e kishte shkruar për mua?!"[1] Ky qe argumentim me anë të kaderit. *Kaderij*-të, ata të cilët e mohojnë kaderin, e mohojnë këtë hadith, − sepse bidatçinjtë e kanë zakon që çdo argument që kundërshton qëndrimin e tyre, nëse mund ta mohojnë, e mohojnë, e nëse jo, e deformojnë, − por hadithi gjendet në dy Sahih-ët (të Buhariut dhe Muslimit) dhe në libra të tjerë. Për të, Ibn Tejmije ka thënë: "Kjo është në aspektin e justifikimit me kaderin për fatkeqësit, jo për mangësit. Pra, Musa nuk iu kundërvu Ademit për gjynahun që u bë shkaku i daljes nga Xheneti, por për vetë daljen nga Xheneti. Kuptimi është: "Veprimi yt u bë shkak për daljen tonë nga Xheneti". Për Musain (alejhi selam) as nuk mund të mendohet se do të qortonte 'babain' e tij për një gjynah, për të cilin ai ishte penduar, dhe që Zoti i tij zgjodhi dhe e udhëzoi. Ky është edhe interpretimi që i përputhet hadithit."

Ndërsa Ibn Kajimi ka një mendim tjetër në lidhje me kuptimin e këtij hadithi. Sipas tij, Ademi (alejhi selam) u justifikua me kaderin, pasi ishte penduar për veprimin e tij, dhe jo si ata që justifikohen me kaderin për të vazhduar në gjynahet e tyre. Idhujtarët thanë: "... Sikur të kishte dashur Allahu, ne nuk do të kishim adhuruar tjetër veç Tij, as edhe baballarët tanë ..." (En'am, 148). Por Allahu i përgënjeshtroi ata, sepse ata nuk u justifikuan për diçka që kishte kaluar e të thonin se ishin penduar tek Allahu, por justifikoheshin me kaderin për të mos hequr dorë nga idhujtaria.

[1] Trasmeton Buhariu dhe Muslimi.

- Shejtani ka ndikim te bijtë e Ademit, sipas fjalës së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "... sepse fjala '*sikur*' i hap rrugën shejtanit.". Në këtë nuk ka dyshim, pasi Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë gjithashtu: "Shejtani qarkullon në birin e Ademit, ashtu siç qarkullon gjaku."[1] Disa dijetarë thonë se kuptimi i hadithit është që, nëpër damarë qarkullojnë ngacmimet që shejtani hedh në zemër. Por nga teksti kuptohet se vetë shejtani qarkullon në birin e Ademit, siç qarkullon gjaku. Kjo nuk është diçka e vështirë për fuqinë e Allahut të Madhëruar. Edhe shpirti qarkullon në trup siç qarkullon gjaku. Ai ndodhet në trup, pastaj kur nxirret, mbështillet, parfumoset dhe ngrihet në qiell nga melekët.

Prej bujarisë së Allahut, është se për shejtanin Ai ka bërë diçka tjetër, që i kundërvihet atij, melekun. Shejtani afrohet dhe e godet zemrën e njeriut me vesvese, po kështu edhe meleku afrohet dhe e frymëzon për mirë. Tek personi që i është dhënë sukses, frymëzimi i melekut ngadhënjen mbi vesvesin që hedh shejtani. Ata të dy gjithmonë grinden, pra, "*nefsi i qetë*" dhe "*nefsi urdhërues për të keqen*". Ndërsa "*nefsi qortues*" është përshkrim për të dy nefset së bashku.

- Mënyra e bukur e mësimdhënies së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), duke bërë një ndalesë, por duke e shoqëruar atë me sqarimin e shkakut të saj, me qëllim që të kuptohet urtësia e Sheriatit dhe që besimtarit t'i shtohet besimi dhe bindja ndaj zbatimit të urdhrit.

Dobitë e temës

- Komenti i dy ajeteve në suren Ali Imran.

"Ata që thanë për vëllezërit e vet (të vrarë), ndërsa vetë qëndruan (në shtëpitë e tyre): 'Sikur të na kishin dëgjuar ne, nuk do të ishin vrarë ...", dhe: "Sikur të pyeteshim ne për këtë gjë, nuk do të vriteshim këtu ...". Mirëpo Allahu e hodhi poshtë këtë me fjalën e

[1] Buhariu dhe Muslimi.

Tij: "Thuaju: 'Edhe sikur të kishit qënë nëpër shtëpitë tuaja, përsëri atyre që u ishte shkruar të vriteshin, do të dilnin në vendin e vrasjes...".

Po kështu, edhe ajetin tjetër: "Sikur të na kishin dëgjuar ne, nuk do të ishin vrarë...", Allahu e hedh poshtë, duke thënë: "Thuaju: 'Prapësojeni vdekjen nga vetja, nëse flisni të vërtetën!", pra: Nëse thoni të vërtetën në lidhje me qëndrimin në shtëpi dhe se mosdalja në fushën e betejës do ta pengonte vrasjen, largojeni vdekjen nga vetja juaj. Ata nuk do të shpëtonin nga vdekja, përkundrazi, do të vdisnin patjetër, por po t'u bindeshin atyre e të linin xhihadin, do të ishin në një humbje të qartë.

- Ndalimi i qartë i fjalës "sikur" kur të bie një fatkeqësi.

Kjo del prej fjalës së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "... Nëse të godet diçka, mos thuaj: "Sikur të bëja ashtu, nuk do të ndodhte kështu ...".

- Arsyeja e kësaj ndalese është se ajo i hap rrugën shejtanit".

Pra, shkaku i ndalimit të fjalës 'sikur' është se ajo hap punën e shejtanit, që janë vesveset, e si rrjedhojë njeriu dëshpërohet, zmbrapset dhe pikëllohet.

- Udhëzimi drejt fjalës së mirë.

Mësuar nga thënia e Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "... por thuaj: 'Qe caktimi i Allahut...'".

- Urdhri për për t'u interesuar për të dobishmen, bashkë me kërkimin e ndihmës nga Allahu.

Kjo sipas fjalës së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Kushtoji rëndësi asaj që të bën dobi, kërkoji ndihmë Allahut ...".

- Ndalimi nga e kundërta e kësaj, e që është të

tregohesh i paatë.

Kjo sipas fjalës së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... dhe mos mos trego paaftësi ...”.

Dikush mund të pyesë: paaftësia nuk është në zgjedhjen e njeriut, të cilin, për shembull, mund ta godasë ndonjë sëmundje dhe të bëhet i pa aftë, atëherë si ka ndaluar Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nga diçka për të cilën njeriu nuk ka mundësi? Ne përgjigjemi, duke thënë se me paaftësinë këtu nënkuptohet neglizhenca dhe dembelizmi për të vepruar diçka, kur ai ka mundësi ta kryejë atë.

Tema 58

Ndalimi i sharjes së erës.

Autori (Allahu e mëshiroftë!) thotë që është e ndaluar, por nuk sqaron se a është e tillë me kuptimin e drejtpërdrejtë, apo do të thotë se kjo vepër është e urryer. Kjo çështje - në dashtë Zoti - do të sqarohet më poshtë nga hadithi.

Era është lëvizja që Allahu i Madhëruar i bën ajrit. Ajo nis në njërën nga katër pikat e horizontit: veriu, jugu, lindja ose perëndimi. Ajo që ndodhet midis tyre quhet e paqëndrueshme, sepse është duke lëvizur nga veriu apo nga jugu, nga lindja apo nga perëndimi. Lëvizja e saj është prej shenjave të Allahut të Madhëruar. Ndonjëherë ajo është e fortë, shkul pemët, shemb shtëpitë, mbulon të mbjellat dhe shkakton përmbytje. Ndonjëherë ajo është e qetë, ndonjëherë e ftohtë, ndonjëherë e nxehtë, ndonjëherë e lartë, e ndonjëherë e ulët. Të gjitha këto ndodhin me caktimin e Allahut. Sikur të mblidhen të gjitha krijesat për t'ia ndryshuar drejtimin që ia ka caktuar Allahu, nuk do të mundeshit kurrë. Edhe sikur të mblidhnin mjetet më moderne të botës për të krijuar një erë të fortë, nuk do të mundeshin, ndërsa Allahu i Madhëruar me fuqinë e Tij, e lëviz atë si të dojë dhe nga të dojë.

A ka të drejtë muslimani ta shajë erën? Jo, sepse era është e nënshtruar dhe e komanduar, ashtu si dielli, që nganjëherë i djeg pemët, e megjithatë nuk i lejohet askujt që ta shajë. Për këtë arsye, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Mos e shani erën! …"

> Ubej Ibn Kabi (r.a.) përcjell se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Mos e shani erën! *Kur shihni* diçka që nuk ju pëlqen*, thoni: ‘O Allah, të kërkoj Ty nga e mira e kësaj ere, nga e mira që ajo mbart dhe nga e mira që është urdhëruar me të! Më mbro nga e keqja e kësaj ere, nga e keqja që ajo mbart dhe nga e keqja që është urdhëruar me të!*”[1]

– *“Mos e shani erën!...”* – Sharje do të thotë të përdorësh fjalë të këqija, të përmendësh të meta, të mallkosh etj. Kjo sharje e krijesës ndalohet sepse ajo është sharje edhe për Krijuesin e saj. Kur sheh mangësi në një kështjellë të ndërtuar dhe e shan, kjo sharje bie mbi atë që e ka ndërtuar. E tillë është edhe sharja e erës, sepse ajo është e komanduar dhe e nënshtruar sipas Urtësisë së Allahut të Madhëruar. Por nëse era është e mërzitshme, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na ka mësuar se çfarë duhet të themi: “... thoni: ‘O Allah, të kërkoj Ty nga e mira e kësaj ere ...”.

– *“... nga e mira e kësaj ere ...”* – Era ka në vetvete të mira e të këqija. Ajo mund të jetë furtunë që shkul pemët dhe shemb shtëpitë, trazon detrat e lumenjtë, por mund të jetë e qetë, që freskon motin, nxit aktivitetet njerëzore etj.

– *“... nga e mira që ajo mbart ...”* – Era mund të mbartë të mira, si: pjalmimin e pemëve apo aromë të këndshme, por mund të mbartë edhe të këqija, si: largimin e pjalmimit të pemëve, sëmundje për njerëzit dhe kafshët, etj.

– *“... dhe nga e mira që është urdhëruar me të! ...”* – E tillë mund të jetë për shembull, shtyrja e reve dhe drejtimi i tyre atje ku do Allahu.

– *“Më mbro nga e keqja e kësaj ere ...”* – Pra, nga e keqja që ajo ka në vetvete, si: shkulja e pemëve, mbulimi i të mbjellave, shembja e shtëpive etj.

---

[1] Ahmedi dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

– *"... nga e keqja që ajo mbart ..."* – Pra, nga gjërat e dëmshme që mbart ajo, si: era e keqe, papastërtitë, sëmundjet, etj.

– *"... dhe nga e keqja që është urdhëruar me të!"* – Të tilla janë, për shembull, shkatërrimi dhe shfarosja në tokë. Për erën e popullit të Adit, Allahu i Madhëruar thotë: "Shkatërronte çdo gjë me urdhrin e Zotit të saj ..." (Ahkaf, 25). Ajo than tokën, prish të mbjellat dhe shkatërron rrugët. Ajo urdhërohet me një të keqe, për shkak të ndonjë urtësie të madhe, të cilën ndoshta ne jemi të paaftë ta zbulojmë.

– *"... që është urdhëruar me të!"* – Flitet për urdhër të vërtetë. Allahu e urdhëron që të fryjë era ose që të ndalojë. Të gjitha krijesat e marrin urdhrin e Allahut. Allahu i Madhëruar i tha tokës dhe qiellit: "Ejani të dy, me dëshirë apo pa dëshirë. Ata u përgjigjën: 'Erdhëm me gjithë dëshirë e të bindur.'" (Fusilet, 11) Po kështu, i ka thënë penës: "Shkruaj! Ajo tha: ' Zoti im, e çfarë të shkruaj?' I tha: 'Shkruaj çfarë do të bëhet deri në Kijamet.'"[1]

Dobitë e temës

- Ndalimi i sharjes së erës.

Kjo ndalesë tregon se është haram, sepse sharja e saj është sharje për Atë që e ka krijuar dhe dërguar erën.

- Udhëzimi për të thënë fjalë të mira, kur njeriu sheh çka nuk i pëlqen.

Pra, kur ai sheh prej erës atë që nuk e pëlqen të thotë: "O Allah, të kërkoj Ty nga e mira e kësaj ere ..." e deri në fund. Gjithashtu, duhen marrë masa konkrete, si: ngritja e mureve mbrojtës, e digave

[1] Ebu Daudi, Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

etj.

- Mësimi se era është e urdhëruar.

Sipas fjalës së Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... që është urdhëruar me të!”.

- Ajo mund të urdhërohet për mirësi, por mund të urdhërohet edhe për keq.

Sipas fjalës së Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... dhe nga e mira që është urdhëruar me të!” dhe: “... nga e keqja që është urdhëruar me të!”

Si përfundim, themi se është detyrë për njeriun që të mos kundërshtojë caktimin e Allahut dhe të mos e shajë erën. Ai duhet të jetë i dorëzuar ndaj ligjeve universale (të krijimit) të Tij, ashtu siç duhet të jetë i dorëzuar ndaj ligjeve fetare të Tij, sepse krijesat vetë nuk kanë në dorë të veprojnë asgjë, vetëm se me lejen e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala).

Tema 59

Thënia e Allahut të Madhëruar: "... ata menduan keq për Allahun, ashtu si paganët. Ata thoshin: 'A kemi gjë në dorë lidhur me këtë çështje?' Thuaju: 'Në fakt, të gjitha çështjet janë në dorë të Allahut!' Ata fshehin në vete atë që nuk duan të ta shfaqin ty. Ata thoshin: 'Sikur të pyeteshim ne për këtë gjë, nuk do të vriteshim këtu'. Thuaju: 'Edhe sikur të kishit qenë nëpër shtëpitë tuaja, përsëri ata që u ishte shkruar të vriteshin, do të dilnin në vendin e vrasjes'. Allahu e bëri këtë për të provuar atë që keni në kraharorët tuaj dhe për t'ju pastruar atë që keni në zemrat tuaja. Vërtet, Allahu di mirë se ç'keni në zemër." (Ali Imran, 154)

– *"... ata menduan keq për Allahun ..."* – Ata të cilët menduan keq ishin munafikë. Fjala arabe *'edh-dhan'* tregon mundësinë më të saktë, por mund të përdoret edhe për bindje të sigurt, siç është rasti në fjalën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "Ata janë të bindur se do të takohen me Zotin e tyre." (Bekare, 46), që do të thotë se janë të sigurt. E kundërta e mundësisë më të saktë është hamendësimi.

– *"... ashtu si paganët ..."* – Kjo do të thotë se ata menduan për

Allahun ashtu si njerëzit në kohën e xhahilijetit, të cilët nuk e njihnin vlerën dhe madhështinë e Allahut. Ai qe një mendim i keq, që vinte prej injorancës.

Mendimi për Allahun mund të jetë i mirë ose i keq. Mendimi i mirë shfaqet në dy aspekte:

A- Në lidhje me veprimet e Allahu në gjithësi. Është detyrë të mendosh mirë për Allahun e Madhëruar dhe të besosh se çka bën Ai është rezultat i një urtësie të madhe, të cilën mendja mund ta kuptojë ose jo. E tillë është madhështia dhe urtësia e Allahut në përcaktim.

Asnjëherë të mos mendohet se Allahu, kur bën diçka në gjithësi, e bën se dëshiron të keqen. As aksidentet dhe brengat nuk i ka krijuar për shkak të dëshirës së keqe, domethënë për shkak se dëshiron të bëjë keq, sepse Allahu nuk bën asgjë keq. E keqja në asnjë rrethanë dhe në asnjë rast nuk është atribut i Zotit. Ajo assesi nuk mund ti atribuohet Zotit apo veprave të Tij. Të gjitha veprat e Zotit janë të mira dhe të lavdishme. Ato nuk mund të cilësohen aspak si të këqija. Por me dëshirën e Zotit mund t'u ndodhin krijesave gjëra të dëmshme dhe të këqija, ndodhi të cilat rrjedhin nga veprat e Zotit. E në këtë kuptim mund të thuhet se Zoti dëshiron që ndokujt t'i ndodhë diçka e keqe, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Thuaju: 'Kush është ai, që do t'ju ruajë nga Allahu, nëse Ai dëshiron që t'ju godasë e keqja, ose dëshiron t'ju japë mëshirë?" (Ahzab, 17). Gjithsesi, në rastin e fundit e keqja i adresohet krijesës dhe jo Krijuesit.

B- Në lidhje me veprimet e Allahut ndaj teje. Edhe për këto është detyrë të kesh për Allahun mendimet më të mira, por së pari duhet të plotësosh kushtin që e bën të detyrueshëm këtë: ta adhurosh Allahun me sinqeritet, sipas rrugës që dikton feja e Tij.

Kështu, kur njeriu pendohet për një gjynah, le ta përmirësojë mendimin për Allahun, se Ai e pranon pendimin prej tij. Por nëse ai i lë mangët detyrimet, vepron haramet, duke menduar se Allahu është i mirë, prandaj mund t'i bëjë të gjitha këto, atëherë themi se ky është mendimi i neglizhentit, të shkatërruar me iluzione, madje është mendimim i keq për Allahun, sepse Urtësia e Tij nuk e pranon diçka të tillë.

Forma e dytë e shfaqjes së mendimit të keq për Allahun, është: të

mendosh se në veprimet e Tij ka mendjelehtësi, padrejtësi etj. Ky është ndër gjynahet më të mëdha dhe më të shëmtuara, i njëjtë me atë që bënë ata munafikë të përshkruar në ajetin kuranor dhe të tjerë si ata.

– *"... Ata thoshin: 'A kemi gjë në dorë lidhur me këtë çështje?' ..."* – Me këtë, ata kishin dy qëllime: të largonin qortimin nga vetja dhe të kundërshtonin kaderin e Zotit.

– *"... Në fakt, të gjitha çështjet janë në dorë të Allahut! ..."* – Pra, nuk ka mundësi që ju të ndryshoni caktimin e Allahut të Madhëruar, pasi Ai vepron çka të dojë. Çdo gjë që lidhet me veprimet e Allahut dhe veprimet e krijesave, i takon plotësisht Allahut të Madhëruar. Ai përcakton poshtërimin dhe lartësimin, të mirën dhe të keqen, por e keqja është te krijesat (që janë pasojë e veprimit të Tij) dhe jo në veprimet e Tij.

– *"... Ata fshehin në vete atë që nuk duan të ta shfaqin ty ..."* – Një nga cilësitë e munafikëve është mosshprehja hapur e fjalëve dhe e së vërtetës. Munafikët fshehin në vetvete çfarë nuk duan t'ua shfaqin të tjerëve, nga frika se po të thonë të vërtetën, do t'ju vijë fundi. Ata fshehin kufrin, shthurjen dhe kundërshtimin.

– *"... nuk do të vriteshim këtu ..."* – Pra, nuk do të vriteshin në Uhud. Ata që u vranë ishin muslimanë, dëshmorët e Uhudit. Ndërsa Abdullah Ibn Ubeji u kthye mbrapsht nga lufta me afërsisht një të tretën e ushtrisë, duke thënë: "Muhamedi më kundërshton mua dhe u bindet të vegjëlve e të rinjve."

– *"... Thuaju: 'Edhe sikur të kishit qenë nëpër shtëpitë tuaja, përsëri ata që u ishte shkruar të vriteshin, do të dilnin në vendin e vrasjes' ..."* – Kjo ishte kundërpërgjigje ndaj thënies së tyre: "Sikur të pyeteshim ne për këtë gjë, nuk do të vriteshim këtu ...". Pretendimi i tyre nuk kishte bazë, se po të përcaktonte Allahu vdekjen për ta, nuk do t'i ruante kurrsesi shtëpia e tyre, përkundrazi, do të dilnin e do të vdisnin në vendin ku u ishte caktuar vdekja.

Vendimi i shkruar i Zotit është dy llojesh:

1- Vendimi fetar. Ky nuk është i thënë të ndodhë patjetër, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Vërtet namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar ..." (Nisa, 103); ose: "O ju që keni besuar! Është përcaktuar për ju agjërimi ..." (Bekare, 183).

2- Vendimi i krijimit. Ky është i sigurt që do të ndodhë, siç thuhet në ajetin e temës apo në ajetet e tjera: "Ne shkruam në Zebur, pas shënimit të mëparshëm (në Leuhi Mahfudh), se tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë ..." (Enbija, 105) dhe: "Allahu ka shkruar (në Leuhi Mahfudh): Unë dhe Profetit e Mi do të triumfojmë, me siguri." (Muxhadele, 21).

– *"... Allahu e bëri këtë për të provuar atë që keni në kraharorët tuaj ..."* – Pra, për të provuar besimin në caktimin e Allahut dhe në urtësinë e Tij. Allahu provon zemrën e njeriut, duke përcaktuar gjëra të papëlqyera për të, me qëllim që të dallohet ai që i dorëzohet caktimit të Allahut dhe urtësisë së Tij nga ai që nuk është i tillë.

– *"... dhe për t'ju pastruar atë që keni në zemrat tuaja ..."* – Kur sprova pritet me durim, atëherë ajo pastron zemrën, duke larguar prej gjithçka që nuk duhet. Prova dhe pastrimi ndodhi në luftën e Uhudit, sepse më pas, kur Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) u bëri thirrje sahabëve, atyre u thanë: "'Vërtet populli (idhujtar) ka grumbulluar kundër jush (një ushtri të madhe), kështu që frikësojuni atyre!'" (Ali Imran, 173), por pavarësisht nga kjo ata dolën në vendin e quajtur *Hamrau-ul Esed*. Megjithatë, atje nuk pati luftë, prandaj u kthyen mbrapsht: "Ata u kthyen me dhuntitë dhe mirësitë e Allahut, nuk i gjeti asgjë e keqe dhe fituan kënaqësinë e Allahut. Allahu është Zotëruesi i mirësive të mëdha."[1] (Ali Imran, 174).

– *"... Allahu di mirë se ç'keni në zemër."* – Kjo pohon se Allahu e di shumë mirë se çfarë fshihet në zemër, siç thotë në një ajet tjetër: "Në të vërtetë atyre nuk u janë verbuar sytë, por u janë verbuar zemrat në kraharor." (Haxh, 46). Pra, Allahut nuk i fshihet asgjë. Ai di ç'ka dhe ç'nuk ka në zemrën e robit, kur do të jetë dhe si do të

[1] Kjo ndodhi shënohet te Buhariu dhe Muslimi.

jetë.

> Allahu i Madhëruar thotë: "... të cilët mendojnë keq për Allahun; Radha e fatkeqësisë le t'i godasë ata! Allahu është zemëruar me ata, i ka mallkuar dhe u ka përgatitur Xhehenemin, sa përfundim i keq është ai." (Fet'h, 6)

– *"... të cilët mendojnë keq për Allahun ..."* – Ajeti flet për munafikët dhe idhujtarët. Allahu i Madhëruar thotë: "Gjithashtu (Ai e bëri këtë) për t'i ndëshkuar hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët e idhujtaret, të cilët mendojnë keq për Allahun...". Pra, kanë mendime të liga, siç u tha më parë: "ashtu si mendonin paganët". E tillë është edhe ajo që autori citon nga Ibn Kajimi, Allahu e mëshiroftë: "Ata mendonin se feja e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) do të zhdukej dhe se ai nuk mund të kthehej (të triumfonte).", e të ngjashme.

– *"... Radha e fatkeqësisë le t'i godasë ata*!" – Pra, e keqja le t'i përfshijë ata që të gjithë, nga të gjitha anët. Ashtu si rrethi përfshin ç'ka në brendësi të tij, po ashtu do t'i rrethojë ata e keqja.[1] Ata menduan se Allahu e kishte braktisur të Dërguarin e Tij dhe se feja e tij do të zhdukej, por e vërteta e mposhti mendimin e tyre dhe e keqja do të bjerë mbi ta.

- *"... Allahu është zemëruar me ta ..."* – Zemërimi i Allahut është prej cilësive vepruese të Allahut që lidhen me dëshirën e Tij, e prej tij rrjedh hakmarrja. Ndërsa mohuesit e cilësive të Zotit kanë thënë se Ai nuk zemërohet realisht. Prej tyre ka që thonë se qëllimi me zemërimin e Tij, është hakmarrja. Të tjerë mendojnë se ai nënkupton dëshirën për hakmarrje, sepse zemërimi është vlimi i gjakut të zemrës në kërkim të hakmarrjes. Prandaj − sipas tyre − dhe Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Ai (zemërimi) është një urë zjarri, të cilën shejtani e hedh në zemrën e

[1] Fjala arabe *'daire'* e permendur në ajet është rreth, nëse do të përkthehej fjalë për fjalë.

njeriut."[1]

Por ne përgjigjemi duke thënë se i tillë është zemërimi i njeriut dhe nuk është e domosdoshme që kur format gjuhësore të shprehjes përputhen, të përputhet edhe përmbajtja reale e tyre. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Asgjë nuk i shëmbëllen Atij ..." (Shura, 11). Po kështu, Ai tregon se hakmarrja e Tij është tjetër dhe zemërim është tjetër: "E kur Na zemëruan, Ne u hakmorëm ndaj tyre ..." (Zuhruf, 55).

– *"... i ka mallkuar ..."* – Mallkimi është largim dhe përzënie nga mëshira e Allahut.

– *"... dhe u ka përgatitur Xhehenemin ..."* – Pra, Xhehenemin e ka bërë vendbanimin dhe vendqëndrimin e tyre.

– *"... sa përfundim i keq është ai."* – Pra, sa i keq është Xhehenemi, në të cilin do të përfundojnë ata.

> Në lidhje me ajetin e parë, Ibn Kajimi ka thënë: "Dijetarët në shpjegimin e ajetit kanë sqaruar se mendimi i keq i munafikëve ka qenë që Allahu i Madhëruar nuk po e ndihmonte të Dërguarin e Tij dhe se kauza e tij po merrte fund'. Një shpjegim tjetër është se ata menduan se sprova që i ra atij nuk ishte me caktimin dhe urtësinë e Allahut. Kështu mendimi i tyre i keq është shpjeguar me atë se ata mohonin urtësinë dhe kaderin e Allahut dhe se feja e Profetit të Tij nuk do të përmbushej dhe nuk do të triumfonte mbi të gjitha fetë e tjera. Këto ishin mendimet e këqija të munafikëve dhe idhujtarëve që përmenden në suren 'Fet'h'.
>
> Ishin mendime të këqija, sepse nuk i takonin Allahut, nuk përshtaten me urtësinë e Tij, me lavdinë e Tij dhe as me Premtimin e Tij të vërtetë. Kush mendon se Allahu e

[1] Ahmedi, Tirmidhiu. Ky fragment është shkëputur nga një hadith i gjatë për të cilin shejh Albani thotë se është i dobët.

ndihmon gënjeshtrën që të fitojë mbi të vërtetën, deri sa e vërteta të zhduket, kush mohon që gjithçka që ndodh, ndodh me caktimin e Tij për një urtësi të madhe, për të cilën Allahu meriton të falënderohet, me pretendimin se ajo është thjesht një dëshirë e Allahut pa ndonjë urtësi, kush ka mendime të tilla u përket atyre që nuk besojnë. "Mjerë për ata që nuk besojnë, kur të hidhen në Zjarr!" (Sad, 27).

Shumica e njerëzve ose mendojnë keq për Allahun, sa u përket caktimeve të Tij për ata apo për të tjerët. Nga ky koncept i keq shpëtojnë veç ata që e njohin Allahun, shpëtojnë ata që njohin Atë, emrat dhe atributet e Tij, si dhe frytet që sjellin urtësia dhe lavdia e Tij.

Njeriu i mençur, që ia do të mirën vetes, le t'i kushtojë rëndësi kësaj, le të pendohet tek Allahu dhe le t'i kërkojë falje Atij për mendimet e këqija në lidhje me Zotin e tij.

Po t'i këqyrësh me kujdes (njerëz të tillë), do t'i gjesh kundërshtues, duke fajësuar kaderin e Allahut e duke thënë se duhej të ishte kështu e ashtu. Disa njerëz e kanë më pak të theksuar këtë veti, e disa të tjerë më shumë. Atëherë, kontrollo veten: a je i dëlirë nga kjo?

Nga kjo veti në je i pastër, sprovë të madhe ke larguar,

e nëse kështu nuk ndodh me ty, them se keqas je ngatërruar."

Ibn Kajimi është Muhamed Ibn Kajim el Xheuzije, njëri nga nxënësit e shejhut të Islamit Ibn Tejmijes. Pjesa e mësipërme është marrë nga libri i tij "*Zadul Mead*", pas kapitullit që trajton betejën e Uhudit, në studimin e urtësive dhe mësimeve që rrodhën prej saj.

– *"... në lidhje me ajetin e parë ..."* – Domethënë për ajetin: "... ata menduan keq për Allahun, ashtu si paganët ...".

– *"...Dijetarët në shpjegimin e ajetit kanë sqaruar se mendimi i keq i munafikëve ka qenë që Allahu i Madhëruar nuk po e ndihmonte të*

Dërguarin e Tij dhe se kauza e tij po merrte fund. Një shpjegim tjetër është se ata menduan se sprova që i ra atij nuk ishte me caktimin dhe urtësinë e Allahut…" – Ky koment është bazuar në ajetin: "Sikur të pyeteshim ne për këtë gjë, nuk do të vriteshim këtu …".

– *"… Një shpjegim tjetër thotë se mendimi i keq ishte që urtësia dhe kaderi i Allahut nuk ekzistonin, dhe se feja e Profetit të Tij nuk do të përmbushej dhe nuk do të triumfonte mbi të gjitha fetë e tjera …"* – Me fjalë të tjera, është komentuar me çka përbën cënim të rrububijes (veprave të Allahut), emrave dhe cilësive të Tij. Kundërshtimi i kader përbën cënim në rrububije (veprave të Allahut), pasi besimi se gjithçka që ndodh në gjithësi është me caktimin e Allahut është pjesë plotësuese e besimit në veprat unike të Tij. Mosnjohja e emrave dhe cilësive të Tij sjell gjithashtu mosnjohje të veprave dhe urtësisë së Tij. Mendimi se Allahu nuk do ta ndihmonte të Dërguarin e Tij dhe se kauza e tij do të zhdukej do të thotë se dërgimi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ishte kotësi, pasi ç'kuptim do të kishte që Ai të dërgonte atë duke e urdhëruar për luftë, – e cila shkakton dëme materiale dhe humbje në njerëz, – e rezultati të ishte zhdukja dhe harrimi i fesë së tij?! Kjo është e pa mundur, sidomos për Pejgamberin tonë (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), i cili qe vula e profetëve, për të cilin Allahu ka përcaktuar që feja e tij të mbetet deri në Kijamet.

Të mendosh keq për Allahun, sipas Ibn Kajimit, do të thotë ta bësh këtë në tri mënyra:

1- Të mendosh se Allahu e ndihmon gënjeshtrën që të fitojë mbi të vërtetën, deri sa e vërteta të zhduket. Ky qe mendimi i idhujtarëve dhe munafikëve, për të cilët flitet në suren "Fet'h": "Jo! Ju menduat se Pejgamberi dhe besimtarët nuk do të ktheheshin kurrë te familjet e tyre …" (Fet'h, 12).

2- Të mohosh se diçka ka ndodhur me caktimin e Allahut. Kjo do të thotë se nën sundimin e Tij, mund të ndodhë diçka që Ai nuk e dëshiron! E vërteta është që gjithçka ndodhet nën sundimin e Tij dhe gjithçka është me dëshirën dhe caktimin e Tij.

3- Të mohosh se në përcaktimin e Tij ka urtësi, për të cilat Ai meriton të lavdërohet. Kjo do të thotë se përcaktimet e Tij mund të jenë joserioze dhe të kota, por ne jemi të sigurt se Allahu përcakton

diçka vetëm me urtësi, që ne mund ta kuptojmë, por edhe mund të mos e kapim me mendjen tonë. Prej kësaj të fundit ndodh që njerëzit nuk përputhen ndonjëherë me njëri-tjetrin, kur është fjala për arsyet e gjykimeve fetare.

Xhehmitë dhe *kaderitë* mendojnë se Allahu i përcakton gjërat thjesht nga dëshira, e jo nga urtësia sepse Ai nuk pyetet për çka vepron. Ky është një nga mendimet më të këqija për Allahun, sepse edhe kur njeriu vepron pa mençuri, konsiderohet mendjelehtësi. E atëherë, ç'mund të mendohet për Krijuesin, Gjykuesin e Urtë?! Allahu i Madhëruar thotë: "Ne nuk i kemi krijuar kot qiellin, Tokën dhe çfarë ndodhet midis tyre. Kjo është hamendja e jobesimtarëve ..." (Sad, 27). Mendimi se ato janë krijuar pa ndonjë qëllim dhe pa urtësi, është mendimi i mohuesve. Po kështu, Ai thotë: "Ne nuk i krijuam më kot qiejt, Tokën dhe çfarë ndodhet midis tyre. Ne i kemi krijuar ato me qëllim të vërtetë ..." (Duhan, 38-39), pra, jo pa qëllim. Ata thanë se Allahu i ka krijuar ato kot, pa ndonjë urtësi, por Ai thotë se: "Kjo është hamendja e jobesimtarëve ...".

Ndërsa *mutezilët* janë në ekstremin e kundërt. Ata thonë se Ai përcakton vetëm me urtësi dhe i vënë detyrë Allahut gjithçka duan. Autori i librit "*Muhtesar et-Tehrir el-Futuhij*" (Allahu e mëshiroftë!) thotë se, në lidhje me këtë çështje, ka dy mendime në *medhheb*, por qëndrimi më i drejtë, pa dyshim, është se Ai gjithmonë vepron diçka, përcakton diçka mbi robin e Tij apo bën të ligjshme diçka veçse me një urtësi të plotë, për të cilën meriton falënderim dhe mirënjohje.

– *"... Mjerë për ata që nuk besojnë, kur të hidhen në Zjarr..."*– Fjala '*Uejl'* (e përkthyer 'Mjerë') është fjalë kërcënimi dhe jo luginë në Xhehenem, siç thonë disa. Prandaj ne përdorim shprehjet: "Mjerë ti, nga i ftohti!" ose: "Mjerë ti, nga filani!". Po kështu, ai që vuan thotë "I mjeri unë!". Edhe pse kjo fjalë mund të tregojë një luginë të Xhehenemit me emrin '*Uejl'*, por në të tillë ajet si ky, ajo është një fjalë që tregon kërcënim.

– *"... Shumë njerëz ..."* – Pra, nga bijtë e Ademit, jo nga besimtarët.

– *"... mendojnë keq për Allahun sa u përket caktimeve të Tij për ta*

...” – Për shembull, dikush e lut Allahun në mënyrë të ligjshme, por mendon se Allahu nuk do t’i përgjigjet. Dikush tjetër e adhuron Allahun sipas mënyrës të përcaktuar në fenë e Tij, por mendon se Allahu nuk do t’ia pranojë adhurimin. Ky është mendim i keq sa u përket caktimeve të Tij për ta.

– *“... apo për të tjerët ...”* – Për shembull, dikush shikon qafirët që fitojnë një betejë ndaj muslimanëve dhe mendon se Allahu i ka bërë qafirët që t’i sundojnë vazhdimisht muslimanët.

Detyrë për muslimanin është që të mendojë mirë për Allahun, duke pasur parasysh edhe kushtet përkatëse.

– “*Nga ky koncept i keq shpëtojnë veç ata që e njohin Allahun, shpëtojnë ata që njohin Atë, emrat dhe atributet e Tij, si dhe frytet që sjellin urtësia dhe lavdia e Tij....*” – Të vërtetën ka thënë, Allahu e mëshiroftë! Nga mendimi i keq shpëton vetëm ai që e njeh Allahun, që pranon urtësitë dhe misteret e përcaktimeve dhe ligjeve të Tij, ai që njeh emrat dhe atributet e Tij ashtu siç duhet, pa i ndryshuar dhe pa i keqinterpretuar ato.

Kush i ndryshon dhe i keqinterpreton emrat dhe atributet e Allahut, do të thotë që nuk i njeh ato. Në shumicën e rasteve zemrat e tyre janë të nxira dhe njerëz të tillë përpiqen të ngjallin turbullira, dyshime e polemika, por ata që i kuptojnë emrat dhe atributet e Allahut ashtu siç janë, duke ndjekur kështu rrugën e selefëve, nuk preken nga këto dyshime, siç ndodh me ata që i kanë zemrat të devijuara.

Të devijuarit mendojnë keq për Allahun, sepse thonë që tekstet e Kuranit dhe Sunetit nuk shihen me kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë, por me atë që nënkuptohet prej tyre, duke i parë vetëm si metafora e shëmbëllime. Kështu ata, duke ndryshuar fjalët nga kuptimi i tyre i vërtetë, nuk bëjnë gjë tjetër por vetëm mohojnë atë që ka pohuar Allahu për Veten e Tij. Prandaj, shejhu i Islamit Ibn Tejmija, ka thënë: “Çdo mohues është shëmbëllyes dhe çdo shëmbëllyes është mohues.”

Çdo mohues është shëmbëllyes sepse mendon që tekstet e Kuranit dhe Sunetit nuk kanë kuptimin e parë që ato tregojnë, por një kuptim tjetër metaforik. Pas këtij mendimi të keq, detyrimisht ai

kërkon të gjejë atë "kuptimin tjetër", figurativ. Rrjedhimisht, duke i dhënë një kuptim tjetër, ai bëhet mohues i kuptimit të vërtetë. Nga ana tjetër, kur ai mohon cilësitë e Allahut nga frika e përngjasimit të Tij me diçka që ekziston, nuk ka bërë gjë tjetër, por vetëm se e ka përngjasuar Allahun me diçka që nuk ekziston.

Ndërsa çdo shëmbëllyes është mohues, sepse duke e përngjasuar Allahun me krijesën, që është jo e përsosur, ai i ka mohuar Atij përsosmërinë absolute. Nga ana tjetër, ai mohon çdo argument që dëshmon se Krijuesi nuk përngjan me krijesën.

Përfundimisht, ai që njeh emrat dhe cilësitë e Allahut, ashtu siç i kanë njohur selefët dhe imamët e këtij umeti, dhe kush kupton nga Urtësia e Allahut, nuk mund të mendojë kurrsesi keq për Të. Mëso nga urtësitë e mëdha që u arritën për muslimanët, nga humbja e tyre në Hunejn dhe Uhud, Në atë që ndodhi pati urtësi të mëdha të cilat Allahu i ka përmendur në suren "Ali Imran" dhe "Teube". Nëse njeriu i njeh këto urtësi, nuk mund të mendojë kurrë keq për Allahun, nuk mund të mendojë se Ai deshi të braktiste Pejgamberin dhe pasuesit e tij. Gjithçka në këtë botë, qoftë edhe mosprodhimi i tokës apo skamja, ndodh për shkak të një urtësie të madhe, të cilën ne ndoshta nuk e dimë. Nuk mundet kurrsesi që Allahu t'u tregohet i kursyer robërve të Tij, sepse Ai është Bujari i bujarëve. Kështu mendo për çdo çështje tjetër.

– *"... Njeriu i mençur, që i do të mirën vetes, le t'i kushtojë rëndësi kësaj ..."* – Pra, le të ketë mendim të drejtë për Allahun, e jo mendim të keq, mendim injorance.

– *"... le të pendohet tek Allahu ..."* – Pra, të kthehet tek Ai, sepse pendimi është kthimi nga mëkati, në adhurim.

– *"... Po t'i këqyrësh me kujdes (njerëz të tillë), do t'i gjesh kundërshtues, duke fajësuar kaderin e Allahut..."* – Pra, nëse Allahu përcakton diçka atyre që nuk u shkon për shtat, nisin e thonë: ne duhet të kishim fituar, pse nuk bie ky shi, pse të na binte neve epidemia, ne meritojmë më tepër e kështu me radhë.

– *"... Atëherë, kontrollo veten: a je i shpëtuar nga kjo? ..."*– Kjo vlen

për të gjitha detyrimet që të ka ngarkuar Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Pra, kontrollo veten: a je i shpëtuar nga mangësitë në kryerjen e këtyre detyrimeve dhe nga rënia në harame.

Dobitë e temës

- Komenti i ajetit të sures Ali Imran.

"... ata menduan keq për Allahun, ashtu si paganët ...". Ky ajet flet për hipokritët.

- Komenti i ajetit të sures Fet'h.

"... të cilët mendojnë keq për Allahun ...". Edhe ky ajet flet për hipokritët.

- Mësimi se të menduarit keq për Allahun ka numër të pakufizuar formash.

Disa prej tyre janë ato që ka përshkruar edhe Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë!). E përbashkëta është: të mendosh për Allahun çka nuk i përshtatet Atij.

- Nga mendime të tilla shpëton vetëm ai që njeh mirë emrat dhe atributet e Allahut, si dhe vetveten tij.

Pra, nga mendimi i keq për Allahun shpëton vetëm ai që njeh Atë, emrat dhe cilësitë e Tij, njeh urtësinë dhe meritën e Tij për t'u falënderuar. Jo vetëm kaq, por ky njeri duhet të njohë mirë edhe vetveten, duke e kontrolluar atë. Njeriu vetë është i mangët dhe me ligësi, ndërsa Allahu është absolutisht i përsosur, pa asnjë lloj të mete, në asnjë lloj aspekti. Mos mendo keq për Zotin tënd, se vërtet Allahu është më i Miri.

Kjo çështje lidhet me temën e librit, sepse mendimi i keq për

Allahun e cenon teuhidit dhe besimin në emrat dhe atributet e Allahut, sepse Allahu në lidhje me emrat e Tij thotë: “Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj lutjuni Atij me to ...” (Araf, 180). Nëse mendon keq për Allahun, atëherë kjo do të thotë se Ai nuk do të kishte emrat më të bukur. Ndërsa për atributet thotë: “... kurse Allahut i përkasin atributet më të larta.” (Nahl, 60). Nëse mendon keq për Allahun, do të nënkuptonte se Ai nuk do të kishte atributet më të larta.

Tema 60

Mohuesit e kaderit.

Kader quhet përcaktimi i Allahut të Madhëruar për krijesat. Ai është sekret i ruajtur, që nuk e di askush përveç Allahut, ose edhe ndonjë nga krijesat e Tij, që Ai dëshiron që ta dijë.

Disa dijetarë kanë thënë: "Kaderi është e fshehta e Allahut të Madhëruar për krijesat e Tij, të cilin ata e mësojnë vetëm pasi ai realizohet, qoftë e mirë apo e keqe."

Fjala *'kader'* përdoret me dy kuptime: 1. përcaktimin, si veprim i Allahut, si vullnet i Tij; 2. objektivin dhe rezultatin e këtij përcaktimi.

Përcaktimi i Zotit i paraprin dhe e shoqëron veprimin. Si paraprijës është paracaktimi i ngjarjes nga Allahu para se të ndodhë, ndërsa si shoqërues është përcaktimi me anë të të cilit realizohet veprimi. Për shembull, krijimi i foshnjës në barkun e nënës. Fillimisht, ky krijim është paracaktuar shumë më herët, pesëdhjetë mijë vjet para se të krijoheshin qiejt dhe toka. Por kur vjen koha e realizimit, atëherë është përcaktimi që shoqëron krijimin dhe formimin. Me këtë përcaktim pra, bëhet veprimi.

Besimi në kaderin e Allahut lidhet veçanërisht me teuhidin *rububije*. Por ai ka lidhje edhe me njësimin e Zotit në emrat dhe atributet e Tij, sepse kaderi përbën një nga atributet e përsosura të Allahut të Madhëruar.

Në lidhje me kaderin, njerëzit ndahen në tri grupe:

Grupi i parë: *Xhebrij el xhehmije*. Këta e pranojnë rolin e kaderit të Allahut, por duke e tepruar, aq sa e mohojnë krejtësisht që njeriu mund të zgjedhë. Ata thonë se njeriu nuk ka mundësi

zgjedhjeje në lidhje me atë që vepron ose jo. Ngrënia, pirja, gjumi, zgjimi, adhurimi dhe kryerja e gjynaheve, të gjitha ndodhin pa zgjedhjen e tij. Pra, sipas tyre, nuk ka asnjë ndryshim ndërmjet rastit kur një njeri zbret nga çatia nëpërmjet shkallëve, i lirë, me dëshirën e tij, dhe rastit kur bie nga çatia poshtë, i detyruar.

Grupi i dytë: *Kaderij el mu'tezile*. Këta e pranojnë mundësinë e njeriut për të zgjedhur, por duke e ekzagjeruar, saqë e mohojnë që Allahu e krijon apo e dëshiron veprën e robit. Ndërkaq, ekstremistët e këtij grupimi mohojnë gjithashtu dijen e Allahut për veprat e robit, para se ato të ndodhin. Ngrënia, pirja, gjumi, zgjimi, adhurimi dhe gjynahet e tij, që të gjitha ndodhin me zgjedhjen dhe mundësinë e tij, ndërsa Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) nuk ka lidhje me to, as në krijim, as në dëshirë, madje as që nuk i di para se të ndodhin.

Xhebrij-të argumentohen me fjalën e Allahut: "Allahu është Krijues i çdo gjëje ...". (Zumer, 62). Kështu, − thonë ata, − njeriu dhe veprimet i tij janë pjesë e gjërave. Ata argumentohen edhe me ajetet: "Ndërsa Allahu ju ka krijuar ju dhe gjithçka që ju veproni" (Safat, 96); dhe: "Kur gjuajte, nuk ishe ti (Muhamed) që gjuajte, por ishte Allahu Ai që gjuajti ..." (Enfal, 17). Në këtë ajet − thonë ata, − Allahu e ka mohuar gjuajtjen nga ana e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), kur ai gjuajti, dhe e ka pohuar atë për Veten e Tij. Si argument tjetër sjellin edhe ajetin: "Idhujtarët do të thonë: 'Sikur të kishte dashur Allahu, ne nuk do të kishim adhuruar tjetër veç Tij, as edhe baballarët tanë, dhe nuk do të kishim bërë të ndaluar asgjë ...'" (En'am, 148). Dyshimet e tyre janë edhe për tekste të tjera, të cilat ne nuk i përmendëm, për të mos u zgjatur.

Tani ne do të paraqesim kundërpërgjigjen për dyshimet e tyre.

Së pari, sa i përket argumentimit të tyre me ajetin: "Allahu është Krijues i çdo gjëje...", themi se interpretimi që bëjnë ata bie ndesh me shumë argumente të tjera që dëshmojnë se njeriu ka liri zgjedhjeje, se ai punon dhe vepron, në bazë të së cilës do të shpërblehet me nderim ose poshtërim, ndërkohë që të gjitha janë prej Allahut. Nëse njeriu do të ishte i detyruar, nuk do të kishte kuptim puna e tij dhe shpërblimi për të.

Ndërsa ajeti: "Ndërsa Allahu ju ka krijuar ju dhe gjithçka që ju veproni", dëshmon kundër tyre, sepse ai pohon që njerëzit i kryejnë vetë veprat. "Allahu krijon atë që ne veprojmë" ka këtë kuptim:

njeriu vepron me vullnetin dhe zgjedhjen e tij të plotë, kurse vullneti dhe zgjedhja janë krijesa të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), kështu që edhe vepra që ndodh si rrjedhojë e këtyre të dyjave, është krijesë e Allahut.

Edhe ajeti: "Kur gjuajte nuk ishe ti (Muhamed) që gjuajte, por ishte Allahu Ai që gjuajti ...", është argument kundër tyre, sepse Allahu e pohon që Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka gjuajtur.

Për të kuptuar ajetin, duhet të kemi parasysh dy momente:

- Së pari, në fjali nuk përmendet, jo pa qëllim, se me çfarë u bë goditja, por vetëm fakti që ai gjuajti, dhe ky ishte veprimi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), siç e pohon Allahu i Madhëruar.

- Së dyti, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e bëri gjuajtjen, në betejën e Bedrit, por hedhjen dhe dërgimin e një grushti dheu në sytë e të gjithë jobesimtarëve që ishin aty e bëri Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), pasi Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) vetë, nuk kishte se si t'i çonte grimcat e dheut në sytë e çdonjërit prej tyre.

Gjithashtu, edhe ajeti: "Idhujtarët do të thonë: 'Sikur të kishte dashur Allahu, ne nuk do të kishim adhuruar tjetër veç Tij, as edhe baballarët tanë, dhe nuk do të kishim bërë të ndaluar asgjë ...'" (En'am, 148), është provë kundra këtyre *xhebrijve*, për atë Zot! Allahu e ka hedhur poshtë edhe justifikimin e idhujtarëve me kaderin për mosbesimin e tyre, kur në të njëjtin ajet thotë: "Kështu mohuan edhe ata para tyre, derisa shijuan ndëshkimin Tonë ..." (En'am, 148). Allahu nuk do t'i ndëshkonte, po qe se justifikimi i tyre do të ishte i drejtë.

Mendimi se njeriu vepron i detyruar, pa patur vullnet dhe liri zgjedhjeje është i pasaktë sipas Kuranit, Sunetit, logjikës, përvojës dhe qëndrimit unik të selefëve. Një gjë të tillë nuk mund ta thotë ai që e vlerëson Allahun ashtu siç duhet dhe ai që kupton urtësinë dhe mëshirën e Tij.

Dëshmi nga Kurani janë:

- "Disa nga ju dëshirojnë këtë botë, ndërsa të tjerë nga ju dëshirojnë botën tjetër..." (Ali Imran, 152). Në këtë ajet, Allahu pohon se njeriu ka dëshirë.

- "... me gojën e tyre flasin atë që nuk e kishin në zemrat e tyre

…” (Ali Imran, 167);

- “Ai di mirë çdo gjë që veproni ju …” (Neml, 88);
- “Allahu di mirë çdo gjë që veproni ju.” (Munafikun, 11).

Pra, në këto ajete pohohet se njeriu dëshiron, flet vetë dhe vepron vetë.

Dëshmi nga Suneti, janë hadithet e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem):

- “Vërtet punët shpërblehen sipas qëllimit; çdo njeri do të marrë atë që ka pasur për qëllim …”.[1]
- “Kur t'u ndaloj nga diçka, largohuni asaj, dhe kur t’u urdhëroj për ndonjë çështje, kryejeni atë me sa të keni mundësi.”[2]

Nëse njeriu detyrohet të thotë një fjalë ose të bëjë një veprim, ndërkohë që me zemër është plotësisht kundra, atëherë ai nuk mban përgjegjësi për ato, siç do të ndodhte po t’i bënte me vullnet të lirë.

Gjithashtu, selefët kanë qenë unikë për pasaktësinë e idesë se njeriu vepron gjithnjë i detyruar. Nuk ka asnjë dëshmi që ndonjëri prej tyre të ketë pasur qëndrim të kundërt. Përkundrazi, ajo që dihet me siguri është që selefët e kanë hasur këtë bidat dhe e kanë mohuar atë kategorikisht.

Nga ana logjike, nëse njeriu do të ishte i detyruar në veprat e tij, atëherë ndëshkimi i gjynahqarëve do të ishte padrejtësi, ndërsa shpërblimi i të bindurve, diçka e kotë. Por Allahu është i pastër, si nga e para, ashtu edhe nga e dyta.

Po kështu, nëse njeriu do të ishte i detyruar në veprat e tij, atëherë nuk do të ishte ngritur argumenti me dërgimin e Profetëve, pasi kaderi (që sipas tyre do të thotë se njeriu gjithnjë është i detyruar) vazhdon me gjithë dërgimin e tyre. Allahu i Lartësuar nuk sjell për njerëzit argumente që, në fakt, nuk janë argumente.

Edhe përvoja jetësore dëshmon pasaktësinë e këtij qëndrimi, sepse, për shembull, vetë njeriu arrin ta dallojë ndryshimin midis veprimeve që i bën me zgjedhjen e tij, si: ngrënia, pirja, ulja apo ngritja, dhe atyre që i bën duke qenë i detyruar, si: dridhja nga të ftohtët, frika, e të ngjashme.

---

[1] Buhariu, Muslimi.
[2] Buhariu, Muslimi.

Grupi i dytë, *kaderij*-të, argumentohet me ajetin: "Disa nga ju dëshirojnë këtë botë, ndërsa të tjerë nga ju dëshirojnë botën tjetër ..." (Ali Imran, 152). Pra, − thonë ata, − Allahu pohon dëshirën për njeriun. Po kështu, ajeti tjetër: "Kush bën mirë, e bën për dobi të vet, e kush punon keq, punon në dëm të vet ..." (Fusilet, 46), dhe plot dëshmi nga Kurani dhe Suneti, tregojnë se robi ka dëshirë dhe se ai është veprues, fitues, se ai bën ruku, sexhde etj.

Përgjigjja ndaj tyre është:

Së pari, ajetet dhe hadithet që ata shfrytëzojnë, flasin për vullnetin dhe veprimet e njeriut në dy këndvështrime: 1. si të kufizuara; 2. si të lira.

1. Si të kufizuara, ato trajtohen në ajetet e mëposhtme:

"... për secilin nga ju që dëshiron të ndjekë rrugën e drejtë; por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me dëshirën e Allahut, Zotit të botëve!" (Tekuir, 28-29).

"Vërtet që këto (Vargje të Kuranit) janë këshillë përkujtuese. Kush të dojë, le të ndjekë rrugën që e shpie te Zoti i tij, por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me dëshirën e Allahut. Ai është vërtet i Gjithëditur e i Urtë." (Insan, 29-30).

"Sikur të donte Allahu, njerëzit që erdhën pas të Dërguarve nuk do të vriteshin me njëri-tjetrin pas ardhjes së provave të qarta, por ata u përçanë: disa besuan, kurse të tjerët mohuan. Sikur të donte Allahu, ata nuk do të vriteshin me njëri-tjetrit, por Allahu bën si të dëshirojë Vetë." (Bekare, 253).

2. Si të lira trajtohen në ajetet:

"... prandaj iu afroni arave (grave) tuaja si të doni ..." (Bekare, 223).

"Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë ..." (Kehf, 29).

"Kushdo që dëshiron jetën e kësaj bote ...", që vijon: "... Sa për atë që dëshiron botën tjetër dhe përpiqet për të me gjithë shpirt e duke qenë besimtar, përpjekja e tij do të (pranohet nga Allahu dhe) shpërblehet." (Isra, 18- 19).

Megjithatë, vullneti dhe veprimet e njeriut që paraqiten si të lira në ajetet e grupit të dytë, interpretohen edhe si të kufizuara, siç është e njohur një gjë e tillë te dijetarët.

Së dyti, të pohosh pavarësinë e plotë të njeriut në veprimet e tij,

edhe pse ai është pronë e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), do të thotë të pohosh që në sundimin e Allahut mund të ndodhë diçka që Ai nuk e dëshiron. Kjo është një lloj barazie me Të. Prandaj Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i ka quajtur *kaderij*-të si *mexhuz*-ët[1] e këtij umeti.[2]

Së treti, u themi: A e pranoni ju që Allahu e di shumë mirë se çfarë kanë për të bërë robërit e Tij? Ata – përveç disa ekstremistëve – e pranojnë këtë. Atëherë, i pyesim përsëri: A do të ndodhin veprimet e robërve në përputhje me atë që ka ditur Allahu apo do të ndodhin ndryshe? Nëse përgjigjen se do të ndodhin në përputhje me dijen e Tij, ua kthejmë duke u thënë se, meqë është kështu, ajo ka qenë dëshira e Allahut. Por nëse përgjigjen se veprimet e njerëzve do të ndodhin ndryshe nga ajo çfarë ka ditur Ai, atëherë kështu ata mohojnë se Ai ka dituri absolute. Dijetarët thonë për *kaderij*-të: "Polemizoni me ta duke u sjellë argumentin e dijes absolute të Allahut. Nëse e pranojnë atë, janë mundur, por nëse e mohojnë, kanë bërë kufër."

Këto dy grupe – *xhebrijtë* dhe *kaderijtë* – e kanë humbur rrugën e së vërtetës, sepse gjenden përkatësisht në ekstremet e teprimit dhe të shpërfilljes. *Xhebrijtë* e tepruan me rolin e kaderit, duke shpërfillur zgjedhjen dhe vullnetin e njeriut, ndërsa *kaderijtë* e tepruan me rolin e zgjedhjes dhe vullnetit të njeriut, duke shpërfillur kaderin.

Për këtë arsye, më i argumentuari me fakte dhe më i urti në arsye e logjikë është:

Grupi i tretë, *ehli suneh uel xhema'a*. Ky është grupi i mesëm, që bashkon argumentet dhe metodën e atyre që janë më të mirët në fe. Ata besojnë në caktimin e Allahut, dhe se robi ka vullnet dhe liri zgjedhjeje. Gjithçka që ekziston ose nuk ekziston, që lëviz ose jo, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e di dhe vepron me të si dëshiron. Gjithçka është krijesë e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Nuk ka Krijues tjetër veç Allahut dhe nuk ka Rregullues tjetër për çështjet e krijesave, veç Tij (Subhanehu ue Te'Ala). Po kështu, besojnë se njeriu ka dëshirë dhe liri zgjedhjeje, por dëshira e tij

[1] '*Mexhuz*' quhen adhuruesit e zjarrit.

[2] Ahmedi dhe Ebu Daudi. Ky hadith eshtë i njohur dhe qarkullon tek dijetarët, por në të ka dobësi. Ndërsa, sipas Albanit hadithi është i mirë.

është e lidhur me dëshirën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), siç thotë Ai (Subhanehu ue Te'Ala): "... për secilin nga ju që dëshiron të ndjekë rrugën e drejtë. Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me dëshirën e Allahut, Zotit të botëve!" (Tekuir, 28-29). Nëse robi dëshiron diçka dhe e vepron atë, mësojmë se dëshira e Allahu i ka paraprirë asaj dëshire.

Ky grup përdor në mënyrë të harmonizuar argumentet e Kuranit, Sunetit dhe logjikës. Për pohimin e rolit të kaderit, ata shfrytëzojnë të njëjtat argumente si *xhebrij*-të, por *ehli suneti* u jep vendin e duhur, duke i gërshetuar me argumentet që paraqesin edhe mohuesit e dëshirës dhe lirisë së zgjedhjes së njeriut.

Përfundimisht, mësojmë se të dyja grupimet ekstreme, *xhebrij*-të dhe *kaderij*-të, i kanë hetuar argumentet me një sy të mbyllur, duke parë vetëm njërën anë të çështjes. Allahu, me vullnetin e Tij, e udhëzoi *ehli suneti*-n që të kuptonin të vërtetën në ato çështje për të cilat të tjerët nuk pajtoheshin. Allahu shpie në udhë të mbarë kë të dëshirojë.

Tregim:

Tregohet se kadiu Abdul Xhebar el Hamedhani, i cili ishte *mutezil*, shkoi të takonte Sahib Ibn Abadin, edhe ky *mutezil*, tek i cili ishte mësuesi Ebu Is'hak el Isfiraini. Abdul Xhebari menjëherë tha: "Lavdia i takon Atij që është larg ligësive." Ebu Is'haku menjëherë tha: "Lavdia i takon Atij, në sundimin e të Cilit ndodh vetëm ajo që Ai dëshiron." Abdul Xhebari, pasi e kuptoi se ai e kishte kapur se ku rrihte qëllimi e tij, i tha: "A dëshiron Zoti ynë që të kundërshtohet?" Ebu Is'haku iu përgjigj me një pyetje: "A kundërshtohet Zoti ynë me forcë?" Abdul Xhebari i tha: "Ç'mendon ti, nëse Ai më privon nga udhëzimi dhe përcakton për mua të keqen, ka bërë mirë ndaj meje apo keq?" Ebu Is'haku iu përgjigj: "Nëse do të privonte diçka që të përket ty, do të kishte vepruar keq. Por nëse do të privonte diçka që i përket Atij, atëherë themi se Ai veçon me mëshirën e Tij, kë të dëshirojë." Të pranishmit u larguan duke thënë: "Vallahi, nuk ka përgjigje për këtë pyetje!"

Shejhu i Islamit Ibn Tejmije ka thënë se *ehli suneti* janë mesatarë ndërmjet grupeve të bidatçinjve në pesë çështje parimore, të cilat i

ka përmendur në veprën "*Akide Uasitije*", kështu që le të shihen atje[1].

Katër shkallët e kaderit

Është detyrë të besohen të katër shkallët e kaderit, të cilat janë:

1- Dija e Allahut. Të besosh se Allahu di gjithçka, në përgjithësi dhe me hollësi. Ai di ç'ka qenë dhe ç'do të jetë. Çdo gjë është e ditur për Allahun (Subhanehu ue Te'Ala), qoftë e vogël apo e madhe, nga veprimet e Tij ose veprimet e krijesave të Tij. Argumentet për këtë në Kuran janë të shumta, ndër të cilat fjala e Tij: "Ai e di ç'ka në tokë dhe në det; asnjë gjethe nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e Qartë (Leuhi Mahfudh)." (En'am, 59). Allahu di edhe për gjethet që bien pa jetë, qofshin të mëdha ose të vogla, në det ose në tokë, e jo më pastaj gjethet e reja, që krijohen rishtas.

Medito pak për diturinë absolute të Allahut dhe gjithëpërfshirjen e saj. Imagjino një natë e errët, pa hënë, me re të dendura njëra mbi tjetrën dhe me shi, dhe një bërthamë që ndodhet në fundin e detit të dallgëzuar e të thellë. Sa shumë errësira janë: errësira e shtresës së tokës, errësira e detit, errësira e reve, errësira e shiut dhe errësira e natës! Të gjitha këto përfshihen në thënien e Tij: "... dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës ...". Më pas, vjen përgjithësimi i pakufizuar: "... as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e Qartë (Leuhi Mahfudh)." Shënimi, shkrimi i diçkaje mund të bëhet vetëm pasi e di atë. Kështu ajeti pohon se Allahu di gjithçka dhe ka shkruar gjithçka.

Argument tjetër është edhe ajeti: "A nuk e di ti, se Allahu di çdo

---

[1] - Ata janë mesatarë në temën e cilësive mes mohuesëve, xhehmije dhe shembëllyesëve, përngjasues.
- Ata janë mesatarë në veprimet e Allahut të Lartësuar mes xhebrijeve dhe kaderive.
- Ata janë mesatarë në paralajmërimin për dënimin e Allahut të Lartësuar mes murxhieve dhe ueidijeve si kaderitë e të tjerë.
- Ata janë mesatarë në temën e imanit dhe fesë mes harurijeve (havarixhëve) dhe mu'tezilëve, mes murxhijeve dhe xhehmive.
- Ata janë mesatarë në lidhje me shokët e Profetit mes rrafidave (shija) dhe havarixhëve.

gjë, që është në qiej e në Tokë? Të gjitha këto janë shënuar në Libër (Leuhi Mahfudh). Me të vërtetë kjo është e lehtë për Allahun." (Haxh, 70). Edhe ky ajet pohon se Allahu di gjithçka dhe ka shkruar gjithçka.

2- Shkrimi i Allahut. Dy ajetet e mësipërme dëshmojnë edhe për këtë.

3- Dëshira e Allahut. Ajo është gjithëpërfshirëse. Nuk ka asgjë në qiej dhe në tokë vetëm se ekziston me vullnetin e Allahut dhe Dëshirën e Tij. Nuk mund të jetë kurrë nën Sundimin e Tij ajo që Ai nuk e dëshiron, qoftë kjo në atë që vepron Vetë, qoftë në atë që veprojnë krijesat. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Vërtet, urdhri i Tij kur Ai dëshiron diçka, është që t'i thotë asaj: 'Bëhu!' dhe ajo bëhet." (Ja Sin, 82). "Sikur të donte Allahu, njerëzit që erdhën pas të Dërguarve nuk do të vriteshin me njëri-tjetrin ..." (Bekare, 253).

4- Krijimi. Allahu është Krijuesi, Sunduesi dhe Rregullatori i çdo gjëje në qiej e në tokë. Allahu i Lartmadhëruar thotë: "Allahu është Krijues i çdo gjëje ..." (Zumer, 62). Ky përgjithësim nuk ka ndonjë përjashtim, madje as edhe për veprimet e krijesave, sepse ato janë atribute të krijesave. Njeriu vetë dhe atributet e tij janë të krijuara, sepse veprimi vjen si rezultat i dy faktorëve: dëshirës së vendosur dhe mundësë së plotë.

Allahu është Ai që ka krijuar te njerëzit dëshirën e vendosur dhe fuqinë e plotë. Për këtë, njëherë e pyetën një beduin arab: "Si e njohe Zotin tënd?" Ai tha: "Prej tërheqes nga vendimet dhe ndryshimit të dëshirave."

Veprimi i njeriut ka të bëjë me dy gjëra: a) krijimi, i cili i përket Allahut; b) ushtrimi i veprimit, i cili lidhet me njeriun dhe i përket atij.

Allahu thotë: "... si shpërblim për atë që kanë punuar." (Uakia, 24); "Hyni në Xhenet, si shpërblim për atë që keni punuar." (Nahl, 32). Nëse ushtrimi i veprimit nuk do t'i përkiste njeriut, nuk do të kishte vlerë lavdërimi dhe shpërblimi për besimtarin e bindur, e as qortimi dhe dënimi i atij që bën gjynahe.

Ehli suneh uel xhema' besojnë në të katërta këto shkallë të kaderit.

Janë edhe disa përcaktime të tjera, të ndërmjetme, të Zotit:

1- Përcaktimi i fatit të jetës. Kjo ndodh kur embrioni i njeriut mbush katër muaj në barkun e nënës. Atëherë i dërgohet meleku, i cili pasi i fryn shpirtin, shkruan për të rrizkun, afatin e jetës, veprat dhe përfundimin e tij, i mirë do të jetë apo i keq.

2- Përcaktimi vjetor. Ky është përcaktimi që Allahu bën Natën e Kadrit, kur shkruhet se çfarë do t'i ndodhë njeriut gjatë një viti. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "… Atëherë (atë natë) vendoset çdo çështje në mënyrë të përpiktë …" (Duhan, 4).

3- Përcaktimi ditor. Disa dijetarë e kanë përmendur këtë duke u argumentuar me thënien e Allahut: "Ai çdo ditë është i angazhuar në çështje të reja …" (Rrahman, 29). Ai çdo ditë pasuron të varfrin ose varfëron të pasurin, krijon diçka që nuk ka ekzistuar më parë, shton ose pakëson begatitë, formon retë dhe shiun etj.

Pyetje: A bie ndesh besimi në kaderin me faktin e njohur se njeriu vepron sipas zgjedhjes së tij personale?

Përgjigjemi se nuk ka mospërputhje, pasi njeriu vepron me zgjedhjen e tij, por pa dalë prej caktimit të Allahut. Njëherë, prijësi i besimtarëve, Omeri, kur po i afrohej Shamit, i thanë se atje, në Sham, kishte rënë sëmundja e kolerës, e cila po shfaroste njerëzit. Ai mblodhi sahabët dhe u konsultua me ta. Disa i thanë që të ktheheshin dhe ai ashtu bëri, vendosi që të ktheheshin. Në këtë kohë, shkon besniku i këtij umeti, Ebu Ubejde Amir Ibn Xherahu, dhe i thotë: "O prijësi i besimtarëve, a po ikën nga caktimi i Allahut?" Omeri iu përgjigj: "Po ikim nga caktimi i Allahut, për në caktimin e Allahut."[1] Kuptimi ishte: nëse vazhdojmë udhëtimin, kjo do të ndodhë me caktimin e Allahut, e nëse kthehemi, edhe kjo do të ndodhë me caktimin e Allahut.

Pastaj Omeri i solli atij një shembull: "Po të kishe një tufë devesh e të ndodheshe në një luginë me dy parcela: njëra kullotë e gjelbëruar, ndërsa tjetra e thatë dhe e shkretuar. Nëse do t'i fusje kafshët në kullotën e gjelbëruar, kjo do të ndodhte me caktimin e Allahut, e nëse do t'i drejtoje tek parcela e shkretuar, gjithashtu kjo do të ndodhte me caktimin e Allahut."

Në fund i bëri pyetjen: "Po t'i fusje në tokën e shkretuar, e jo në të gjelbëruarën, vallë si mendon, a do të ishte kjo mungesë zotësie nga ana jote?" – "Po" – u përgjigj ai. – "Atëherë vazhdo, pra!" – i tha

[1] Buhariu dhe Muslimi.

Omeri.

Kur njeriu vepron, vepron me caktimin e Allahut.

Lind pyetja: Po të pohohet kjo, do të thotë se kush bën gjynahe është i justifikuar për ato, sepse i ka bërë me caktimin e Allahut?

Themi se justifikimi me kaderin për kryerjen e gjynaheve, është i pasaktë, sipas argumenteve të fesë dhe atyre logjike.

Për sa i përket pasaktësisë nga ana e fesë, Allahu i Lartmadhëruar thotë: "Idhujtarët do të thonë: 'Sikur të kishte dashur Allahu, ne nuk do të kishim adhuruar tjetër veç Tij, as edhe baballarët tanë dhe nuk do të kishim bërë të ndaluar asgjë …'" (En'am, 148). Ata u arsyetuan me kaderin për kundërshtimin e Allahut, por Ai ua ktheu: "Kështu mohuan edhe ata para tyre, derisa shijuan ndëshkimin Tonë…" (En'am, 148). Sikur justifikimi i tyre të ishte i saktë, Allahu nuk do t'i ndëshkonte ashpër. I Lartmadhëruari thotë: "Thuaju: 'A keni ndonjë provë të na e paraqitni? Ju mbështeteni vetëm në hamendje dhe jeni vetëm gënjeshtarë." (En'am, 148). Kjo është dëshmi e qartë e pavlefshmërisë së justifikimit të tyre me kaderin.

Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) gjithashtu thotë: "… të Dërguar, përgëzues dhe paralajmërues, në mënyrë që njerëzimi të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të Dërguarve." (Nisa, 165). Siç shihet, me dërgimin e Profetëve, Allahu e bëri të papranueshëm justifikimin e njerëzve. Sikur kaderi të ishte justifikim, ai nuk do të binte (rrëzohej si arsyetim) me dërgimin e Profetëve, sepse kaderi është i vazhdueshëm edhe pas dërgimit të tyre. Pra, këto janë prova të pavlefshmërisë së justifikimit me caktimin e Allahut të atij që bën gjynahe.

Ndërsa për pasaktësinë nga ana logjike, do të japim një shembull për ta kuptuar. Kështu, kur një gazetë lajmëron për dy vende pune: një me pagë të lartë dhe një tjetër me pagë më të vogël, ti do të kërkosh, së pari, vendin e punës me pagën më të lartë. Nëse nuk e arrin atë, do të kërkosh punën tjetër, që paguhet më pak, e nëse as atë nuk e arrin, patjetër që do ta qortosh veten për neglizhencën dhe paaftësinë tënde. Ne kemi punët e fesë. Pesë namazet fshijnë gjynahet që bëhen në periudhën kohore ndërmjet tyre. Ato janë si një lumë te dera e shtëpisë, në të cilin lahesh pesë herë në ditë. Nga ana tjetër, namazi me xhemat është njëzet e shtatë herë më i

vlefshëm sesa namazi vetëm. Atëherë, përse i lë këto punë e arsyetohesh me kaderin? Për të arritur qëllimet e tua në dynja, i shfrytëzon të gjitha rrugët e mundësitë, nuk i lë ato në dorë të fatit, ndërsa për çështjet e ahiretit justifikohesh me kaderin e Zotit!

Le të japim edhe një shembull tjetër: Dikush shpreson që Zoti ta begatojë me një djalë të ditur dhe adhurues, ndërkohë nuk martohet. E këshillojmë këtë njeri që të martohet, në mënyrë që të ketë fëmijë, por ai nuk pranon. Qëllimi i tij mund të përmbushet nga Allahu vetëm nëse ai martohet. Po ashtu, kush kërkon të fitojë Xhenetin dhe të shpëtojë nga Zjarri, por nuk punon për këtë synim, nuk mund ta arrijë atë.

Përfundimisht, justifikimi me kaderin për kundërshtimin e Allahut nuk qëndron, si nga ana fetare dhe ajo logjike. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë diçka mjaft të goditur për këtë çështje: "Çdonjërit prej jush i është caktuar vendi: në Xhenet ose në Zjarr." Të pranishmit i thanë: "O Pejgamberi i Allahut, a t'i lëmë veprat dhe t'i mbështetemi kësaj? Ai u përgjigj: "Punoni, se çdonjërit i është lehtësuar ajo për çka është krijuar!".[1] Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë një fjalë: "Punoni …", e cila është në mënyrën urdhërore.

Besimi në kader ka dobi të mëdha:

- Me të plotëson teuhidin *rububije*.
- Të jep mbështetje të vërtetë tek Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), sepse kur e di se çdo gjë ndodh me caktimin e Allahut, mbështetja tek Ai bëhet e vërtetë.
- Besimi në kader e qetëson zemrën, sepse kur e di se ajo që të ka ndodhur nuk mund të mos ndodhte, kurse ajo që nuk të ka ndodhur, nuk mund të ndodhte, qetësohesh për çfarë të ka goditur, pasi i ke kryer të gjitha shkaqet e vlefshme.
- Ai e pengon njeriun nga vetëkënaqësia pasi ka bërë ndonjë vepër për të cilën falënderohet nga të tjerët, sepse e di që ishte Allahu Ai që u tregua bujar me të, duke ia përcaktuar kryerjen e asaj vepre: "S'ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë shkruar në Libër (Leuhi Mahfudh), më parë se Ne ta krijojmë atë.

[1] Buhariu dhe Muslimi.

Kjo për Allahun është vërtet e lehtë! (Këtë përcaktim e kemi bërë) Që ju të mos dëshpëroheni për atë që u ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë …" (Hadid, 22-23), - domethënë, për mos kaluar në eufori dhe vetëkënaqësi.

- Mospikëllimi me fatkeqësinë që të zë, sepse e di që ajo është nga Zoti, që do të thotë se ka buruar nga mëshira e urtësia.
- Njeriu realizon shkaqet e nevojshme, sepse beson në urtësinë e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) dhe beson se Ai i ka përcaktuar gjërat të lidhura me shkaqet e tyre.

> Ibn Omeri ka thënë njëherë: "Betohem për Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti i Ibn Omerit, se, sikur ndonjëri prej tyre të kishte florinj sa mali i Uhudit, e pastaj ta shpenzonte atë në rrugë të Allahut, Allahu nuk do ta pranonte prej tij, derisa të besonte në kader." Pastaj u argumentua me thënien e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Imani është të besosh Allahun, në melekët e Tij, librat e Tij, Profetët e Tij, Ditën e Fundit dhe të besosh kaderin, në të mirën dhe të keqen e tij."[1]

– *"Betohem për Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti i Ibn Omerit …"* – Kjo është një formë betimi, i cili vazhdon: "… sikur ndonjëri prej tyre të kishte florinj sa mali i Uhudit, e pastaj ta shpenzonte atë në rrugë të Allahut, Allahu nuk do ta pranonte prej tij, derisa të besonte në kader."

Ibn Omeri (r.a.), duke dhënë gjykimin për këta lloj njerëzish, nuk thotë se ata janë qafirë, por se atyre nuk u pranohen veprat e mira. Megjithatë, mospranimi i veprave të mira nga ana e Allahut nënkupton se ata patjetër janë qafirë.

Kjo ishte përgjigjja e Ibn Omerit, kur i treguan se disa individë në Basra thonin se Allahu nuk i ka përcaktuar veprimet e njeriut, por ato janë të pa paracaktuara, se Allahu nuk i di veprimet e njeriut, derisa ai t'i veprojë ato.

Ibn Omeri ka gjykuar se ata janë qafirë, siç kuptohet një gjë e tillë nga thënia e tij: "Allahu nuk do ta pranonte prej tij, derisa të

[1] Muslimi.

besonte në kader". Atyre që nuk u pranohet sadakaja, janë qafirë. Argument është ajeti kuranor: "Asgjë tjetër nuk pengon që t'u pranohet ndihmesa e tyre, përveç asaj se ata nuk besuan në Allahun dhe të Dërguarin e Tij." (Teube, 54)

– "... Pastaj Ibën Umeri u argumentua me thënien e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): *"Imani është të besosh Allahun, në melekët e Tij, librat e Tij, Profetët e Tij, Ditën e Kijametit dhe të besosh në kaderin, në të mirën dhe të keqen e tij."*– Pra, duhet t'i besosh të gjitha këto. Nëse mohon njërën prej tyre, i ke mohuar të tëra, sepse imani është një i tërë, nuk ndahet, ashtu siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "... duke thënë: 'Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë' dhe duke dashur që kështu të zgjedhin një rrugë të ndërmjetme; pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë ..." (Nisa, 150-151).

Argumenti i Ibn Omerit është se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e ka bazuar imanin në këto gjashtë shtylla, që, nëse shembet njëra prej tyre, e tërë ndërtesa bie. Kjo do të thotë që nëse njeriu mohon vetëm njërën nga gjashtët shtyllat, bëhet qafir, e nëse është qafir, Allahu nuk pranon asgjë prej tij.

– *"... të besosh Allahun ..."* – Ky besim përbëhet nga katër elementë:

1- Besimi në ekzistencën e Allahut.

2- Besimi në veprat e Tij.

3- Besimi se askush tjetër përveç Allahut nuk e meriton adhurimin.

4- Besimi në emrat dhe atributet e Tij.

Kështu, kush mohon ekzistencën e Allahut, nuk është besimtar. Kush beson ekzistencën e Tij dhe se Ai është Krijuesi i gjithçkaje, por mohon emrat dhe atributet e Tij, ose mohon që Ai është cilësuar me to, nuk e beson Allahun.

– "... *melekët e Tij* ..." – Besimi në melekët përbëhet gjithashtu nga katër gjëra:

1. Besimi në ekzistencën e tyre.
2. Besimi në emrat e atyre që njohim.
3. Besimi në veprat e tyre.

4. Besimi në cilësitë e tyre.

Nga melekët, të cilëve ua njohim cilësitë, është Xhibrili (alejhi selam). Na është bërë e ditur se ai ka 600 krahë, me të cilët njëherë ka zënë krejt horizontin, siç ka treguar Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Kjo dëshmon për madhësinë gjigante të tij. Ai e tejkalon çdo lloj përfytyrimi tonin. Megjithatë, ai ka marrë edhe pamjen e njeriut: një herë është shfaqur me pamjen e Dihjete el Kelbijut dhe një herë tjetër me pamjen e një burri me flokë shumë të zeza dhe rroba shumë të bardha, mbi të cilin nuk dalloheshin shenja udhëtimi, e që askush nga sahabët nuk e njihte. Ai u ul para Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), siç ulet një nxënës i edukuar[1].

– *"... librat e Tij ..."* – Pra, te librat që u ka zbritur Profetëve të Tij.

Besimi në librat hyjnorë nënkupton:

1. Besimin se ato janë të vërtetë dhe nga Allahu.

2. Besimi i lajmeve të tyre.

3. Respektimin i ligjeve që ato përcjellin dhe që nuk janë shfuqizuar.

Sipas kësaj, ne nuk e kemi detyrë të respektojmë ligjet e librave të mëparshëm, sepse të gjitha ato janë zhvlerësuar me ardhjen e Kuranit, përveç atyre që vetë Kurani i pohon. Po ashtu, ne nuk jemi të detyruar të zbatojmë ligjet dhe normat e shfuqizuara të Kuranit, sepse edhe ai përmban ligje të shfuqizuara.

4. Besimin në librat e përcaktuar me emër, si: Teurati, Zeburi, Ungjilli, Kurani dhe Fletushkat e Ibrahimit dhe Musait.

5. Besimi se çdo Profet ka ardhur nga Allahu me një libër, ashtu siç thotë Ai (Subhanehu ue Te'Ala): "Ne i çuam të Dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjtë) dhe Peshoren." (Hadid, 25). Isai (alejhi selam) ka thënë: "Unë jam robi i Allahut; Ai më ka dhënë Librin (Ungjillin) dhe më ka bërë Profet". (Merjem, 30). Po ashtu edhe Jahja (alejhi selam), siç tregon Allahu (Subhanehu ue Te'Ala).

Vërejtje: Librat që janë në duart e çifutëve dhe të krishterëve sot, kanë pësuar deformime dhe fshehje të pjesëve të tyre, kështu që ata

[1] Muslimi

janë të pabesueshëm. Atëherë, qëllimi ynë për sa thamë është për besimin në origjinën e këtyre librave.

– *"... Profetët e Tij ..."* – Besimi te Profetët nënkupton:

1- Besimin se ata qenë të besueshëm dhe thonin të vërtetën.

2- Besimin në kumtet e përcjella në rrugë të sakta, porositë, ligjet dhe gjithçka tjetër të tyre, që janë dëshmuar saktë dhe që nuk janë shfuqizuar.

3- Besimin në ata që i njohim konkretisht, ndërsa të tjerët që nuk i njohim, i besojmë në mënyrë të përgjithshme.

Ne besojmë se çdo umet ka pasur një Profet. Allahu ka dërguar për çdo popull Profet si provë të pakundërshtueshme: "... të Dërguar, përgëzues dhe paralajmërues, me qëllim që njerëzimi të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të Dërguarve." (Nisa, 165).

Njerëzit që nuk u ka shkuar ndonjë Profet, që t'u tregojë atyre rrugën e Zotit, janë të arsyetuar, sepse do të thonë: "O Zoti ynë, nuk ke sjellë tek ne ndonjë të Dërguar prej Teje." Allahu i Lartmadhëruar thotë: "Sikur Ne t'i kishim shkatërruar ata para kësaj (para se të dërgonim tek ata të Dërguar dhe t'u shpallnim libër), ata, me siguri do të thoshin: 'O Zoti ynë! Sikur të na kishe sjellë një të Dërguar, që t'u përmbaheshim fakteve Tua, para se të poshtëroheshim dhe turpëroheshim!" (Ta Ha, 133). Profeti është i domosdoshëm, sepse me anë të tij, Allahu ka udhëzuar krijesat.

Po ajeti kuranor: "... pas një periudhe ndërprerjeje të vargut të të Dërguarve ..." (Maide, 19), që tregon se ka kaluar një periudhë pa pasur të Dërguar? A kanë pasur provë nga Zoti për njerëzit e asaj kohe? Përgjigjja është se periudha ndërmjet Isait (alejhi selam) dhe Muhamedit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) vërtet ishte e gjatë, por sërish ka ekzistuar prova e Zotit e ngritur para tyre, sepse edhe atëherë kishte njerëz që qëndruan gjithnjë në fenë e pastër, siç thuhet në një hadith të saktë, të sjellë nga Muslimi: "...Allahu vështroi në banorët e tokës dhe i urreu ata, arabë e joarabë, me përjashtim të disave nga ithtarët e Librit, të cilët kishin mbetur të kapur pas fesë së tyre të vërtetë e të pandryshuar ...",[1] ose siç ka thënë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "... Sikur të kishte pasur

[1] Muslimi.

njerëz të mençur te popujt para jush, të cilët të pengonin ngatërresat në Tokë, përveç disave prej tyre që i shpëtuam Ne?! ...” (Hud, 116)

– “... *Ditën e Fundit* ...” – Pra, në ditën pas së cilës nuk ka ditë tjetër, e ajo është Dita e Kijametit të Madh.

Shejhu i Islamit Ibn Tejmije thotë në librin “*Akide Uasitije*” se besimi në Ditën e Fundit përfshin besimin te gjithçka që do të ndodhë pas vdekjes, ashtu siç ka treguar Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Libri në fjalë është i vogël, përmbledhës, por një nga më të vlefshmit në fushën e tij.

Sipas këtij qëndrimi, besimi në sprovën e varrit, në dënimin dhe shpërblimin e tij, në fryrjen e Surit dhe në daljen e njerëzve nga varret e tyre, përpara Zotit të botëve, të zbathur, të zhveshur të pa bërë sunet, besimi për peshoret, shënimet e veprave, Siratin, Haudin dhe ndërmjetësimin te Zoti, besimi për Xhenetin dhe të gjitha begatitë e tij, për Zjarrin dhe ndëshkimin e dhembshëm që ndodhet në të, të gjitha së bashku përbëjnë besimin në Ditën e Fundit. Disa prej tyre janë përcjellë në Kuran, e disa në Sunet me rrugë të shumta transmetimi ose edhe vetëm me një rrugë. Përfundimisht, ne kemi detyrë të besojmë çdo fakt të Ditës së Fundit, që është përcjellë saktë nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

– “... *të besosh kaderin, në të mirën dhe të keqen e tij* ...” – Këtu, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e ka përsëritur fjalën “të besosh”, duke mos u mjaftuar vetëm me lidhëzën “dhe”, sepse besimi te kaderi është mjaft i rëndësishëm, si një çështje e pavarur në vetvete.

Besimi në kaderin do të thotë të besosh në përcaktimet e Allahut për të gjitha gjërat, qofshin veprime të Tij apo veprime të krijesave. Allahu i ka caktuar dhe i ka shkruar ato 50 mijë vjet para se të krijonte qiejt dhe tokën. Është e kuptueshme se diçka nuk mund të shkruhet, pa pasur më parë dije për të; dija radhitet përpara shkrimit. Gjithashtu, jo çdo gjë që di Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) është e shkruar, sepse e shkruar është gjithçka që do të ndodhë deri në Ditën e Kijametit, ndërsa shumë e më shumë ngjarje të

tjera, pas Ditës së Kijametit, që Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) i di, nuk janë të shkruara e nuk janë të treguara as në Kuran, as në Sunet.

Disa dijetarë kanë thënë që kaderi është një prej sekreteve të Allahut. Allahu nuk ia ka bërë të njohur askujt, as ndonjë meleku të afërt, as ndonjë Profeti, përveç asaj që Allahu ua ka shpallur të dërguarve ose pasi ka ndodhur e kanë mësuar njerëzit. E kësisoj ai është vetëmse një sekret i fshehur, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Asnjë njeri nuk di ç'do të fitojë nesër..." (Lukman, 34). Kur themi "sekret", kjo nënkupton që nuk mund të ketë justifikim me kaderin për ata që bëjnë gjynahe. Atyre u themi: "Ku e dinit ju se çfarë qe caktuar për ju, para se të mëkatonit? A nuk do të ishte më mirë të mendonit se Allahu kishte përcaktuar për ju fatin e mirë dhe kryerjen e veprave që bëjnë fatlumët. Ju nuk mund ta mësonit se Allahu kishte shkruar për ju kryerjen e mëkateve, përpara se t'i realizonit ato. Allahu i Madhëruar thotë: "E kur ata u larguan (nga e vërteta), Allahu i largoi zemrat e tyre (nga rruga e drejtë) ..." (Saf,5).

Fakti se kaderi është një nga sekretet e Allahut, që mund t'i bëhet e ditur krijesës vetëm pasi ai të ndodhë, e qetëson njeriun. Ai gjithashtu zhvlerëson justifikimet e dembelëve.

– "... *në të mirën dhe të keqen e tij* ..." – E mira është ajo që i përshtatet robit, ndërsa e keqja është ajo që nuk i përshtatet atij. Dihet se gjërat e përcaktuara janë të mira dhe të këqija. Bindja ndaj Allahut është gjë e mirë, ndërsa kundërshtimi i Tij është diçka e keqe; pasuria është e mirë, varfëria është e keqe; shëndeti është i mirë, sëmundja është e keqe, e kështu me radhë.

Kur përcaktimi është nga Allahu, si mund të thuhet: "të besosh kaderin, në të mirën dhe të keqen e tij", ndërkohë që e keqja nuk mund t'i atribuohet Allahut?

Është e vërtetë se e keqja nuk i atribuohet Allahut. Profeti (sallAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "E keqja nuk të përshkruhet Ty." [1] E keqja nuk i atribuohet Allahut, as në veprim, as në përcaktim, as në gjykim, por e keqja është tek ata që i veprojnë ato dhe jo në veprimin e Allahut. Veprimi i Tij është krejtësisht i mirë dhe plot urtësi.

[1] Muslimi.

Përcaktimi i të këqijave nga ana e Allahut ka urtësi të mëdha. Medito në fjalën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e veprave të këqija të njerëzve, kështu që Allahu do t'i bëjë 'të shijojnë' pjesë nga ajo që kanë vepruar, me qëllim që ata të kthehen (nga të këqijat dhe të kërkojnë Faljen e Tij)." (Rum, 41). Kësisoj, të këqijat në tokë dhe në det shfaqen me qëllim që me anë të tyre të shpresohet përfundimi i mirë: kthimi tek Allahu.

Ndryshimi mes veprimit dhe pasojës së veprimit do të sqarohet në shembujt e mëposhtëm.

Kur djali jot ankohet nga ndonjë sëmundje e cila ka nevojë të mjekohet me hekur të nxehtë, ti e di se ky lloj mjekimi është i dhembshëm, i keq, por ti synon të mirëne e djalit tënd. Megjithatë, ajo çfarë përcakton Allahu nuk është krejtësisht e keqe, por është vetëm në vendin dhe kohën e saj. Nëse Allahu e dënon mizorin, ashtu siç i takon të Plotfuqishmit dhe të Plotpushtetshmit të dënojë, për mizorin ajo është e keqe, – por edhe për të mund të jetë e mirë në ndonjë aspekt, – ndërsa për të tjerët, të cilët marrin mësim nga pësimi i tij, bëhet e mirë. Allahu i Madhëruar thotë për ata që nuk e respektuan urdhrin e ditës së shtunë: "Këtë dënim e bëmë paralajmërim për bashkëkohësit dhe për brezat e tyre pasardhës, si dhe këshillë për ata që i frikësohen Allahut." (Bekare, 65).

Gjithashtu, kur njeriut i vazhdojnë begatitë, shpeshherë ai bëhet mendjemadh dhe mospërfillës. Kur nuk i ndodh ndonjë e keqe, që t'ia frenojë euforinë e nefsit, ai shkujdeset dhe harron të pendohet, mashtrohet me veten dhe i pëlqen sjellja e tij.

Sa njerëz bëjnë gjynahe, por pastaj kujtohen, kërkojnë falje dhe, pas pendimit, bëhen më të mirë nga ç'ishin më parë, sepse sa herë që kujtojnë gjynahet e tyre, e nënçmojnë veten dhe e thyejnë kryelartësinë. Ademi (alejhi selam) e arriti gradën e tij si i zgjedhur prej Allahut, si i penduar dhe i udhëzuar veçse pasi hëngri pemën, nga e cila përfitoi dëshpërimin dhe tha: "O Zoti ynë! Ne i kemi bërë padrejtësi vetes sonë, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtetë që do të jemi prej të humburve." (Araf, 23). Allahu për të thotë: "Pastaj, Zoti i tij e zgjodhi atë, ia pranoi pendimin dhe e udhëzoi." (Ta Ha, 122). Tre sahabët, të cilëve iu shty pranimi i pendimit pas mëkatit dhe fatkeqësisë që i goditi, aq sa

toka u bë e ngushtë për ta, sado e gjerë që është ajo, ata të cilët u ngushtuan në shpirt, ata që njerëzit filluan t'i largojnë, madje edhe të afërmit e tyre filluan t'i shohin si të huaj, nga gjithë kjo brengë e madhe ata filluan të urrenin edhe veten. Megjithatë, pas pendimit, e gjithë kjo ngushticë u kthye në një gëzim të pashembullt për ta. Gjendja e tyre, pasi Allahu ua pranoi pendimin, ishte shumë herë më e mirë se përpara. Përmendja e tyre nga Allahu pas pendimit ishte shumë herë më e mirë se përpara. Ata u përmendën duke u cilësuar. Allahu thotë për ta: "… (Ai ua pranoi pendimin) edhe atyre të treve, që iu shty aq shumë (pranimi i pendimit), saqë toka u bë e ngushtë për ta, – përkundër gjerësisë së saj, – shpirtrat iu `ngushtuan, derisa që u bindën se nuk ka strehim prej Allahut, përveç tek Ai. Pastaj Ai i mëshiroi, që të pendohen. Me të vërtetë Allahu pranon pendimin dhe është Mëshirëplotë." (Teube, 118). Ky ajet i bukur lexohet e ka për t'u lexuar në mihrabet dhe minberet e muslimanëve deri në Ditën e Kijametit, e kjo është fantastike.

Vlerësimi i mësipërm është i njëllojtë, si për çështjet fetare, edhe për ato të krijimit. Është një parim i detyrueshëm për t'u mësuar: e mira dhe e liga nuk përshkruajnë caktimin e Allahut të Madhëruar si vendim të Tij, pasi caktimi i Allahut është krejtësisht i mirë; edhe ajo që duket e keqe, në thelb është e mirë. E keqja shihet në aspektin e rezultatit të përcaktimit, ndërsa vetë caktimi i Allahut është i mirë. Këtë e dëshmon thënia e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "E mira është në Dorën Tënde, ndërsa e keqja nuk të përshkruhet Ty."[1] Nuk ka thënë: 'e keqja është në Dorën Tënde'. E keqja nuk i përshkruhet kurrë Allahut, aq më tepër të jetë në Dorën e Tij!

E keqja nuk i përshkruhet Allahut as në vullnetin e Tij, as në përcaktimin e Tij. Me caktimin e së keqes, Allahu nuk dëshiron vetë të keqen, por ajo është në pasojën e përcaktimit. Pasoja ndoshta i përshtatet njeriut, ndoshta jo, mund të jetë bindje ndaj Allahut e mund të jetë kundërshtim ndaj Tij. Megjithatë, edhe pse mund të jetë e keqe në një aspekt, ajo është e mirë në një aspekt tjetër. Ajo nuk mund të jetë krejtësisht e keqe, qoftë edhe si pasojë.

Le të japim një shembull për këtë: thatësira dhe varfëria janë të këqija, por prej tyre rrjedhin të mira të mëdha, prandaj si të tilla ato

[1] Muslimi.

edhe vetë quhen të mira. Allahu i Madhëruar thotë: “Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e veprave të këqija të njerëzve, kështu që Allahu do t’i bëjë ‘të shijojnë’ pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen.” (Rum, 41). Kthimi tek Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), nga kundërshtimi i Tij për në bindjen e Tij, nuk ka dyshim se është një e mirë e madhe, që sjell shumë të mira të tjera. Dhimbja e varfërisë, e thatësirës, e sëmundjes, e humbjes së njerëzve, të gjitha ëmbëltohen kur pas tyre vijnë të mira. Prandaj Allahu thotë: “...me qëllim që ata të kthehen ...”. Sa e sa njerëz i kanë kaluar caqet duke shpërdoruar pasurinë dhe e kanë harruar Allahun, por që e kanë kuptuar këtë vetëm pasi i ka kapur sërish varfëria. Veç atëherë janë kthyen tek Allahu dhe e kanë kuptuar se kanë qenë të humbur. Kështu pra, e keqja e tyre iu bë e mirë nga ana tjetër.

Edhe prerja e dorës së hajdutit, s’ka dyshim se është e keqe mbi të, por është gjithashtu e mirë në lidhje me të dhe me të tjerët. Në lidhje me të, është e mirë sepse ajo i shlyen atij dënimin në ahiret, kur dihet se dënimi i dynjasë është më i lehtë se dënimi i Ahiretit. Ajo është më e mirë edhe në lidhje me të tjerët, sepse u tërheq vërejtje atyre që vuajnë nga ky ves. Një e mirë tjetër e saj është në ruajtjen e pasurisë nga vjedhja. Njeriu, kur e di se po të vjedhë, do t’i pritet dora, nuk i afrohet asaj vepre, dhe kështu shpëton pasuria e tjetrit.

Një munafik ka thënë:

Një dorë shpaguhet me pesëqind dinarë,[1]
dhe veç për një çerek, të pritet me hanxhar![2]
Çudi! Është pa kuptim dhe ne s’hapim gojë,
Zotit i kërkojmë prej Zjarrit të na mbrojë!

Dikush i dha atij një përgjigje, që t’ia mbyllte gojën:

Thuaj Muarit[3] që është turp e marri,
kur je pa devocion e s’ke dituri!
Një dorë shpaguhet me pesëqind dinarë,
dhe veç për një çerek, të pritet me hanxhar,

[1] Sipas ligjit islam, nëse njeriut i pritet dora padrejtësisht, shpaguhet me pesëqind dinarë.
[2] Kjo do të thotë se kur vjedh një çerek dinari, hajdutit i pritet dora.
[3] Muar'ri ka qenë hipokriti, të cilit i është kthyer përgjigjja.

se trupi i njeriut shumë lart e ka çmuar,
ndërsa mall' i tij e ka zhvlerësuar!
Kuptoje pra ti, çfarë Zoti ka synuar!

> Përcillet se Ubade Ibn Samiti i ka thënë të birit: "O biri im! Nuk ke për ta provuar shijen e imanit, derisa të dish se ajo që të ka ndodhur nuk mundej që mos të të ndodhte, kurse ajo që nuk të ka ndodhur, nuk mundej që të të ndodhte. E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) të thotë: 'E para gjë që ka krijuar Allahu është Pena, e pastaj i tha: 'Shkruaj!' Ajo tha: 'Çfarë të shkruaj?' I tha: 'Shkruaj përcaktimet e çdo gjëje, derisa të bëhet Kijameti.' O biri im, e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë: "Kush vdes me bindje tjetër, ndryshe nga kjo, nuk është prej meje.'"[1]

– "*... Ubade Ibn Samiti i ka thënë të birit: "O biri im!"* – Nga kjo mësojmë se babai duhet të këshillojë fëmijët dhe familjen e tij, duke zgjedhur shprehje që e zbusin zemrën, si: "O biri im!".

– "*... Nuk ke për ta provuar shijen e imanit ...*" – Kjo na tregon se imani ka shije, ashtu siç na është përcjellë në Sunet. Shija e imanit nuk është si shija e ushqimeve. Shija e një ushqimi largohet kur pas tij vjen ushqim tjetër, ndërsa shija e imanit qëndron për një periudhë të gjatë. Kur njeriu bën ndonjë adhurim me çiltërsi, me zemër të përqendruar dhe përulshmëri të plotë për Allahun e Madhëruar, e ndjen shijen e tij për një kohë të gjatë. Imani ka shije të ëmbël, të cilën e shijon vetëm ai që Allahu i ka falur mirësi.

– "*... derisa të dish se ajo që të ka ndodhur, nuk mundej që mos të të ndodhte ...*" –Është çështje e përfunduar që, çfarë i ka ndodhur njeriut, nuk mund të ishte ndryshe. Kjo fjali interpretohet me njërën nga dy mënyrat e mëposhtme ose edhe me të dyja së bashku:

1- Me "ajo që të ka ndodhur" nënkuptohet caktimi i Allahut,

[1] Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

sepse çfarë ka përcaktuar Ai, ndodh patjetër. Nuk mund të ndodhë ndryshe, çfarëdo që të veproje.

2- Mos mendo se ajo që të ka ndodhur, të ka ndodhur gabimisht. Mos thuaj se "sikur të veproje ashtu, nuk do të ndodhte kështu", sepse çfarë të ka ndodhur, nuk mund që të mos të ndodhte. Të gjitha hamendjet e tjera – pra, sikur të veproja ashtu, nuk do të më ndodhte kështu – nuk vlejnë; sido që të jenë, nuk ndikojnë në asgjë.

Të dyja interpretimet janë të sakta. Kur Allahu cakton për njeriun që ta godasë diçka, patjetër do ta godasë dhe nuk mund të ndodhë ndryshe. Njeriu nuk mund ta pengojë e ta largojë atë. Me një bindje të tillë, ai e shijon ëmbëlsinë e imanit, sepse qetësohet pasi e di që çështjet e kryera kurrë nuk mund të ishin ndryshe. Për shembull, del dikush në shëtitje me fëmijët e tij, njëri nga të cilët i afrohet një gjoli me ujë, bie atje dhe mbytet. Ky njeri nuk duhet të thotë se, po të mos dilte, fëmija nuk do t'i vdiste. Patjetër që do të ndodhte ashtu sikurse ndodhi, e ajo nuk mund të ndryshonte. Duke e ditur se nuk ka pasur rrugë për ta shmangur ngjarjen, njeriu qetësohet dhe e di se të gjitha mendimet që i vijnë në mendje janë prej shejtanit.

Mos thuaj "sikur të bëja kështu dhe kështu", sepse fjala "*sikur*" i hap rrugë shejtanit. Atëherë, njeriu kënaqet dhe shpëton. Allahu i Madhëruar flet për këtë çështje në ajetin e Tij: "S'ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë shkruar në Libër (Leuhi Mahfudh) më parë se Ne ta krijojmë atë. Kjo për Allahun është vërtet e lehtë! Që ju të mos dëshpëroheni për atë që u ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë. Allahu nuk i do kryelartët mburravecë." (Hadid, 22-23).

Kur e mëson këtë dije dhe e ke këtë bindje në zemrën tënde, shijon ëmbëlsinë e besimit, qetësohesh, dhe përqendrohesh. Ti e di se çështja rrodhi ashtu siç rrodhi, e nuk mundej që të ishte ndryshe. Shpesh njeriu, kur shqyrton ngjarjet, sheh se ato kanë rrjedhur pikërisht në atë mënyrë që të arrinin deri në fatkeqësinë e caktuar. Ai e sheh se ka bërë disa veprime që nuk i ka pasur zakon t'i bënte, pikërisht për të arritur aty ku ka dëshiruar Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Kjo tregon se gjithçka ndodh me caktimin e Allahut.

– "*... kurse ajo që nuk të ka ndodhur, nuk mundej që të të ndodhte*

…" – Shpjegimi i kësaj fjalie është i njëjtë me atë paraardhës, pra: çfarë është caktuar të mos ndodhë, nuk ka për të ndodhur. Për shembull, dikush dëgjon për hapjen e një panairi diku. Merr paratë dhe niset atje për të bërë tregti, por kur mbërrin atje sheh se panairi është mbyllur. Këtij i themi se fitimin për të cilin u përgatit, nuk do ta kishte marrë, çfarëdo që të ndodhte e çfarëdo që të vepronte. I themi gjithashtu se nuk do ta arrinte atë fitim, pasi gjërat shkojnë gjithnjë ashtu siç e ka caktuar Allahu. Provoje me veten tënde: nëse e arrin këtë bindje, ke për të shijuar ëmbëlsinë e imanit.

Më pas, transmetuesi i hadithit, sjell hadithin e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "E para gjë që ka krijuar Allahu është Pena …" – Fjala "*el Kalem*" (Pena) vjen në dy variante: një herë në rasën emërore (*el kalemu*), dhe një herë në rasën kallëzore (*el kaleme*).

Sipas variantit në rasës emërore, kuptimi është se e para gjë që ka krijuar Allahu është Pena, por jo para çdo krijese, siç do ta sqarojmë më poshtë.

Ndërsa sipas variantit në rasën kallëzore, Allahu e ka urdhëruar Penën që të shkruante në fillim të krijimit të saj, pra, e krijoi dhe pastaj e urdhëroi të shkruante. Me këtë formë, nuk ka asnjë problem, por problemi qëndron te varianti me rasën emërore të emrit. A është Pena e para nga të gjitha krijesat?

Jo, sepse po të themi që pena është krijesa e parë, e cila u urdhërua të shkruante kur u krijua, ne biem në kundërshtim me faktin se krijesat e Allahut zënë fill 50.000 vjet para krijimit të qiejve dhe tokës. Po ashtu ne dimë se Allahu ka krijuar gjëra të tjera para kësaj periudhe, në një kohë që vetëm Ai e di (Subhanehu ue Te'Ala), sepse Ai ka qenë dhe vazhdon të jetë Krijues. Sipas kësaj, pohimi se e para gjë që ka krijuar Allahu është Pena, ka nevojë për t'u interpretuar, në mënyrë që të përputhet me parimin e njohur se: Allahu ka krijuar edhe para kësaj periudhe.

Dijetarët e interpretojnë kështu: E para gjë që ka krijuar Allahu është Pena, vetëm në raport me ato krijesa që ne i shohim e njohim, si: qiejt, toka etj.

Ibn Kajimi, në "*Nunie*", thotë: "Dijetarët nuk janë pajtuar për çështjen e penës (kalemit), me të cilin Allahu shkroi përmasat e gjërave: a është krijuar ajo para Arshit apo pas tij. Pra, janë dy

mendime, siç ka thënë Ebu Ala el Hamedhani. Por, në të vërtetë, Arshi është krijuar më përpara, sepse ka qenë i ngritur në shtylla para se të shkruheshin gjërat."

– *"... i tha: 'Shkruaj!' ..."* – Allahu i Madhëruar i drejtohet Penës. Pena është send pa shpirt, por çdo send, përpara Allahut bëhet me logjikë dhe vullnet. Për këtë dëshmojnë ajetet e Tij: "Thuaj: 'Vallë, a me të vërtetë ju e mohoni Atë që e krijoi Tokën për dy ditë dhe Atij i përshkruani shokë, e Ai është Zoti i botëve. Ai vendosi në Tokë male të pa lëvizshme që ngrihen lart, ia shtoi të mirat asaj dhe brenda katër ditëve të plota caktoi të gjitha kushtet për të jetuar në të. Ky është shpjegimi për ata që pyesin. Pastaj Ai iu kthye qiellit, që ishte në gjendje mjegullie e i tha atij dhe Tokës: 'Ejani të dy me dëshirë ose me dhunë!' Ata u përgjigjën: 'Erdhëm me gjithë dëshirë e të bindur!'" (Fusilet, 9-31). Pra, urdhrit të Allahut do t'i nënshtroheshin me dëshirë ose me dhunë, por ato pranuan me dëshirë: "Erdhëm me gjithë dëshirë e të bindur!" Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) u është drejtuar qiellit dhe tokës dhe ato të dyja i janë përgjigjur. Pra, çdo gjë përpara Allahut është me ndijim, dëshiron, përgjigjet dhe zbaton urdhrin.

- *"... tha: 'Zoti im, e çfarë të shkruaj?'..."* – Kjo pyetje që bëri Pena, argumenton se, kur gjërat janë të paqarta, nuk ka problem që të kërkohet sqarim, domethënë nuk është mëkat. Nuk ka dyshim se Pena ishte e bindur ndaj urdhrit të Allahut, e megjithatë ajo pyeti: "O Zoti im, e çfarë të shkruaj?" E Allahu iu përgjigj: "Shkruaj përcaktimet e çdo gjëje, derisa të bëhet Kijameti." Dhe Pena ashtu bëri.

Pyetje: A i di Pena çështjet e *gajb*-it (dijes së fshehtë)? Jo, nuk i di, por Allahu e urdhëroi e ajo patjetër do ta zbatonte urdhrin e Tij.

Pena, që sipas të kuptuarit tonë konsiderohet e pashpirt, shkroi çdo gjë që e urdhëroi Allahu të shkruante, sepse kur Allahu do diçka, i thotë asaj "Bëhu!" dhe ajo bëhet sipas dëshirës së Tij.

- *"... Shkruaj përcaktimet e çdo gjëje, derisa të bëhet Kijameti. ..."* – Fjala "çdo", është fjalë gjithëpërfshirëse: ajo përfshin çdo veprim, i Allahut qoftë apo i krijesave.

Kijameti është çasti kur njerëzit do të hutohen. Ai do t'i përfshijë të gjithë e do të ndodhë kur t'i fryhet Surit.

– *"... O biri im, e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë: "Kush vdes me bindje tjetër, ndryshe nga kjo, nuk është prej meje.""* – Flitet për besimin se Allahu ka shkruar përcaktimet e çdo gjëje.

– *"... nuk është prej meje."* – Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është i distancuar prej tyre, sepse njerëz të tillë janë jobesimtarë, dhe Profeti është larg çdo qafiri.

Dobitë e hadithit

- Butësia me fëmijët, kur u jep këshilla. Kjo del nga shprehja: "O biri im!", që në gjuhën arabe është një formë ledhatuese.

- Fëmijëve duhet t'ua mësojmë rregullat të argumentuara. Ubadeja nuk i tha të birit vetëm: "Allahu ka shkruar..." dhe kaq, por i tregoi hadithin e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

Kështu, për shembull, nëse i kërkon fëmijës të thotë *'Bismilah'* në fillim të ngrënies dhe në fund "*Elhamdulilah*", ia ke mësuar një normë, por nëse e mëson se ne themi "*Bismilah*" në fillim dhe "*Elhamdulilah*" në mbarim të ngrënies, ngaqë Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Allahu kënaqet nga robi që ha dhe pi diçka, e pastaj e falënderon Atë për këtë",[1] ke bërë dy gjëra të dobishme: së pari, e mëson fëmijën të ndjekë rregulla të argumentuara fetarisht dhe, së dyti, e edukon atë me dashurinë për Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe me parimin se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është prijësi që duhet pasuar, këshillat e të cilit i kemi detyrë t'i marrim. Shumë njerëz janë të shkujdesur ndaj kësaj metode, duke u mësuar fëmijëve vetëm me rregullat, pa i lidhur ato me burimet e tyre: Kuranin dhe Sunetin.

> Në variantin që sjell Ahmedi thuhet: "E para gjë që krijoi Allahu i Madhëruar është pena (kalemi), të cilës i tha: 'Shkruaj!' Në atë çast, pena shkroi çdo gjë që do të

[1] Muslimi.

> ndodhë deri në Ditën e Kijametit."[1]

Nga ky variant i dytë, dhe pikërisht nga pjesa: "Në atë çast, pena shkroi çdo gjë ...", del diçka më tepër se nga ai i mëparshmi. Ky tregon qartë se Pena e zbatoi urdhrin që iu dha, ndërsa në hadithin e parë nuk thuhet se ajo shkroi, por vetëm nënkuptohet se ajo domosdo do të shkruante, si zbatim të urdhrit të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Atëherë, nga ky hadith del se shkrimi i Allahut i ka paraprirë çdo gjëje, deri në Kijamet. Kjo thuhet edhe në Kuran, në ajetin: "A nuk e di ti, se Allahu di çdo gjë, që është në qiej e në Tokë? E të gjitha këto janë (shënuar) në Libër (Leuhi Mahfudh). Kjo për Allahun është vërtet e lehtë." (Haxh, 70), si edhe: "S'ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë shkruar në Libër (Leuhi Mahfudh), më parë se Ne ta krijojmë atë ...", – që do të thotë: para se të krijojmë krijesat, – "... Kjo për Allahun është vërtet e lehtë! ..." (Hadid, 22-23).

– "... *deri në Ditën e Kijametit."* – Flitet për Ditën e Ringjalljes. Ajo është quajtur "Dita e Kijametit" (Dita e Ngritjes) me këtë emër për tri arsye:

1- Atë ditë, njerëzit do të ngrihen nga varret e tyre, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Ditën kur njerëzit do të ngrihen, për të dalë para Zotit të botëve?!" (Mutafifin, 6).

2- Atë ditë do të ngrihen dëshmuesit, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Sigurisht që Ne do t'i nxjerrim fitimtarë të Dërguarit Tanë dhe ata që besojnë, në jetën e kësaj bote dhe Ditën kur do të ngrihen e të paraqiten dëshmitarët." (Gafir, 51)

3- Do të ngrihet drejtësia, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Ne do ngremë peshojat e drejtësisë në Ditën e Llogarisë ..." (Enbija, 48).[2]

> Sipas transmetimit të Ibn Uehbit, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Atë që nuk beson kaderin, në të mirën dhe të keqen e tij, Allahu do ta djegë në Zjarr."

[1] Ahmedi.

[2] Në tre ajetet e mësipërme është përmendur fjala *kijam*.

– *"Sipas transmetimit të Ibn Uehbit ..."* – Me sa duket, ky është hadithi i Ubades, ndërsa Ibn Uehbi është njëri nga përcjellësit e tij.

– *"... Atë që nuk beson kaderin, në të mirën dhe të keqen e tij, Allahu do ta djegë në Zjarr."* – Kjo dëshmon se besimi në kader është kusht. Pa të, imani është i mangët, dhe kush nuk e beson kaderin, digjet në Xhehenem.

Ndaj kaderit të Zotit ka tri qëndrime:

1- Besim dhe bindje e plotë ndaj tij, me të katër elementët përbërës.

2- Mohim i plotë i tij.

Këto dy qëndrime janë të qarta: i pari është besim, ndërsa i dyti është kufër.

3- Dyshim ndaj tij. Edhe ky qëndrim është kufër, njësoj si qëndrimi i dytë.

Fragmenti që thotë: "... Allahu do ta djegë në Zjarr", është argument se ndëshkimi i Zjarrit është djegës. Gjithashtu, ata që do të futen në Xhehenem, nuk do të përshtaten me të asnjëherë, aq sa të mos e ndjejnë më djegien e tij – siç mendojnë disa bidatçinj. Përkundrazi, ata do ta ndiejnë dhimbjen, sepse Zjarri do t'u djegë lëkurën. Në *hadithin e ndërmjetësimit*, thuhet se Allahu do të nxjerrë nga Zjarri ata besimtarë, që janë bërë si thëngjill i zi[1]. Për këtë tregon edhe Kurani në fjalën e të Lartmadhërishmit: "Shijoni dënimin me djegie të tmerrshme." (Haxh, 22) dhe: "Sapo t'u digjet lëkura, Ne do t'ua ndërrojmë atë me lëkurë tjetër, për të shijuar dënimin ..." (Nisa, 56).

> Në "*Musned*-in" dhe në "*Sunen*-in" e Ibn Dejlemijut, përcillet se ai ka thënë: "Shkova tek Ubej Ibn Kabi e i thashë: "Jam disi i paqartë në vetvete, në lidhje me çështjen e kaderit, kështu që më thuaj diçka, në mënyrë që Allahu të ma heqë këtë paqartësi që kam në zemër." Ai më tha: "Edhe nëse shpenzon flori sa mali i Uhudit,

[1] Buhariu dhe Muslimi.

> Allahu nuk ka për ta pranuar prej teje, derisa të besosh plotësisht në kader, duke qenë i bindur se ajo që të ka ndodhur nuk mundej që mos të të ndodhte, kurse ajo që nuk të ka ndodhur, nuk mundej të të ndodhte. Nëse vdes me bindje tjetër, ndryshe nga kjo, do të jesh prej banorëve të Zjarrit.' Shkova te Abdullah Ibn Mesudi, Hudhejfe Ibn Jemani dhe Zejd Ibn Thabiti, e që të gjithë më thanë të njëjtën gjë, nga Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem)."[1]

– "*... Jam disi i paqartë në vetvete, në lidhje me çështjen e kaderit* ..." – Në tekst nuk është sqaruar, por ndoshta flitet për bidatin e parë në këtë umet, kur njerëzit filluan të kishin dyshime e të flisnin për të. Para këtij bidati, njerëzit kanë qenë në të vërtetën.

Njëherë, kur Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) shkoi te sahabët, i gjeti duke folur për çështjen e kaderit. Ai (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) u zemërua nga kjo, prandaj i urdhëroi që ata të mos hynin më në polemika rreth një çështjeje të tillë. Kësisoj, njerëzit hoqën dorë prej saj[2], derisa u shfaq bidati i *kaderijve*. Në këtë moment lindën përsëri paqartësi, dhe kështu Ibn Dejlemiju thotë: "... Jam disi i paqartë në vetvete, në lidhje me çështjen e kaderit ...".

– "*... më thuaj diçka, në mënyrë që Allahu të ma heqë këtë paqartësi që kam në zemër. ...*" – Në analogji, është detyrë për njeriun, që, kur e godet ndonjë sëmundje, të shkojë te mjekët. Ndërsa mjekët e sëmundjeve shpirtërore janë dijetarët, e sidomos sahabët, si Ubej Ibn Kabi. Pra, çdo sëmundje ka edhe ilaçin e saj.

– "*... Edhe nëse shpenzon flori sa mali i Uhudit, Allahu nuk ka për ta pranuar prej teje...*" – Kjo tregon se kush nuk beson në kader është qafir, sepse vetëm qafirëve nuk u pranohet sadakaja. Këtë ka thënë edhe Ibn Omeri (r.a.).

---

[1] Ahmedi Ebu Daudi dhe Hakimi. Sipas Albanit transmetimi është i vërtetë.

[2] Ibn Maxhe dhe Ahmedi. Sipas Albanit hadithi në të cilin përmendet kjo ndalesë është i mirë.

– *"... duke qenë i bindur se ajo që të ka ndodhur nuk mundej që mos të të ndodhte, kurse ajo që nuk të ka ndodhur, nuk mundej të të ndodhte..."* – Kemi folur më parë për këtë çështje.

– "*... Nëse vdes me bindje tjetër, ndryshe nga kjo, do të jesh prej banorëve të Zjarrit. ...*" – Ubej Ibn Kabi ka qenë krejt i sigurt se kush vdes me bindje të ndryshme nga kjo, do të jetë prej banorëve të Zjarrit, pasi kush mohon kaderin është qafir, dhe qafiri do të jetë përgjithmonë në Xhehenem.

A është ky paralajmërim një ilaç i dobishëm? Po. Çdokush që beson Allahun, kur ta mësojë se cili është përfundimi i atij që nuk beson në kader, patjetër që do të ketë kujdes dhe do të besojë në kader, sipas Librit të Allahut dhe Sunetit të Profetit të Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

– *"... Shkova te Abdullah Ibn Mesudi, Hudhejfe Ibn Jemani dhe Zejd Ibn Thabiti, e që të gjithë më thanë të njëjtën gjë, nga Profeti (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*)."*– Pra, për besimin në Kader dhe që njeriu ta dijë se ajo që i ka ndodhur, nuk mundej të mos i ndodhte, kurse ajo që nuk i ka ndodhur, nuk mundej t'i ndodhte. Këta dijetarët të nderuar ishin që të gjithë hafiza të Kuranit.

Vetë Ubej Ibn Kabi ishte prej atyre që shkruanin Kuranin. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e ka ftuar njëherë e i ka lexuar suren "*Bejineh*". Para se t'ia lexonte i tha: "Allahu më ka urdhëruar të ta lexoj atë ty." Ubeji i tha: "O Pejgamberi i Allahut! A ta ka përmendur Allahu emrin tim?" – "Po." – i tha. Ubeji nisi të qante nga gëzimi se Allahu ia kishte përmendur emrin e tij Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), duke e urdhëruar që t'i lexonte atë sure[1]

Ndërsa për Abdullah Ibn Mesudin, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Kush dëshiron që ta lexojë Kuranin të pandryshuar, ashtu siç është zbritur, le ta lexojë ashtu si Ibn Umi Abdi."[2]

Zejd Ibn Thabiti ka qenë një nga shkruesit e Kuranit në kohën e Ebu Bekrit[3].

---

[1] Transmeton Buhariu.
[2] Ahmedi dhe Ibn Maxhe. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.
[3] Buhariu.

Hudhejfe Ibn Jemani ka qenë 'Ruajtësi i sekreteve', të cilit Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i la sekret emrat e hipokritëve të asaj kohe.[1]

Si përfundim, kjo temë tregon domosdoshmërinë e besimit në kaderin e Allahut, bashkë me katër elementët përbërës të tij.

A është besimi në kader i lidhur me teuhidin rrububije (njësimin e Allahut në veprat e Tij), me njësimin e Allahut në adhurim apo me njësimin e Allahut në emrat dhe atributet e Tij?

Lidhja e besimit në kader me njësimin Allahut në veprat e Tij është më e madhe sesa lidhja e tij me njësimin e Allahut në adhurim apo me njësimin e emrave dhe atributeve të Allahut. Nga ana tjetër, lidhja e tij me njësimin e Allahut në emrat dhe atributet e Tij është më e madhe sesa lidhja me njësimin e Allahut në adhurim. Gjithashtu, lidhja e tij me adhurimin është e qartë, sepse adhurimi është veprim i njeriut, kështu që ai ka lidhje me kaderin. Atëherë, besimi në kader është pjesë e të gjitha llojeve të teuhidit.

Po a kanë mospërputhje njerëzit në lidhje me çështjen e kaderit? Po, kanë mospërputhje, duke u ndarë në tri grupe, siç u përmend në fillim të temës.

Dobitë e temës

Te ndryshohen pikat

- Mësimi se besimi në kader është detyrë.

Këtë e dëshmon hadithi: "Imani është të besosh Allahun, në melekët e Tij, librat e Tij, Profetët e Tij, Ditën e Fundit dhe të besosh kaderin, në të mirën dhe të keqen e tij."

- Shpjegimi konkret i besimit në kader.

Të besosh kaderin, do të thotë të besosh se ajo që të ka ndodhur, nuk mundej që mos të të ndodhte, kurse ajo që nuk të ka ndodhur, nuk mundej të të ndodhte.

[1] Buhariu.

Autori nuk ka folur për katër shkallët e kaderit, por ato i treguam ne.

- Asgjësimi i veprave të atij që nuk beson në kader.

Kjo del nga fjala e Ibn Omerit, se: "… sikur ndonjëri prej tyre të kishte florinj sa mali i Uhudit, e pastaj ta shpenzonte atë në rrugë të Allahut, Allahu nuk do ta pranonte prej tij, derisa të besonte në kader." Kjo, – siç thamë edhe më lart, – tregon se kush nuk beson në kader, është qafir, sepse qafirit nuk i pranohen veprat.

- Mësimi se askush nuk e provon shijen e besimit, derisa të besojë në kader.

Kjo del nga këshilla e Ubade Ibn Samitit drejtuar të birit: "O biri im! Ti nuk ke për ta provuar shijen e besimit …" e deri në fund, ngjarje kjo e sjellë nga vetë autori.

Siç u tha edhe më lart, besimi në kader e qetëson njeriun përkundër caktimit të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), sepse e di që çështja do të ndodhë sipas asaj që është përcaktuar, e nuk vonon kurrë momentin e saj. Mos thuaj: 'Sikur të bëja ashtu, nuk do të ishte kështu', sepse fjala *'sikur'* i hap rrugën shejtanit. Sado të thuash *'sikur'*, nuk mund ta largosh më atë çfarë të ka ndodhur.

- Mësimi se cili qe sendi i parë që ka krijuar Allahu (Subhanehu ue Te'Ala).

Me sa duket, autori anon nga mendimi se Pena është e para gjë që ka krijuar Allahu (Subhanehu ue Te'Ala). Mirëpo e vërteta është ndryshe. Nuk është Pena krijesa e parë i Allahut, sepse në "*Sahih*-un" e Buhariut përcillet hadithi që thotë: "Ishte Allahu dhe nuk kishte asgjë para Tij, ndërsa Froni i Tij ishte mbi ujë. Pastaj Ai krijoi qiejt e tokën dhe shkroi në *Edh Dhikr* përmasat e gjithçkaje".[1] Ky transmetim tregon qartë radhën e krijimit, prandaj themi se e vërteta është që Pena u krijua pas Fronit.

[1] Buhariu.

Më lart, ne i përmendëm të dyja variantet e hadithit. Varianti që, sipas kuptimit të drejtpërdrejtë të tij, tregon se Pena është sendi i parë i krijuar, interpretohet duke thënë se ajo është e para gjë që Allahu ka krijuar në lidhje me atë që i përket kësaj bote, pra, botës së dukshme. Ajo u krijua para qiejve dhe tokës, prandaj renditja e saj si e para në listë, është me kuptim relativ.

- Pena shkroi në atë çast përmasat e gjërave që do të jenë e ndodhin deri në Ditën e Kijametit.

Sipas hadithit: "Në atë çast, Pena shkroi çdo gjë që do të ndodhë deri në Ditën e Kijametit."

Nga ky hadith nxjerrim edhe mësime të tjera, si fakti që Allahu u drejtohet me urdhra edhe sendeve pa shpirt. Pena e kupton urdhrin e Tij, sepse iu përgjigj, por duke e pyetur së pari: "... Zoti im, çfarë të shkruaj?"

- Distancimi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nga ai që nuk beson kaderin.

Kjo del nga hadithi: "Kush vdes me bindje tjetër, ndryshe nga kjo, ai nuk është prej meje." Ky është distancim i plotë, sepse ai që nuk beson në kader është qafir, duke bërë kufër që të nxjerr nga feja.

- Tradita e selefëve, ishte që t'i largonin paqartësitë me anë të pyetjes së dijetarëve.

Ibn Dejlemiju tregon: "Shkova tek Abdullah Ibn Mesudi, Hudhejfe Ibn Jemani dhe Zejd Ibn Thabiti. ..." pasi kishte shkuar te Ubej Ibn Kabiti.

Këtu del edhe një mësim tjetër: të pyesësh më tepër se një dijetar, për t'u siguruar, ashtu siç bëri Ibn Dejlemiju. Megjithatë, të pyesësh disa dijetarë për të gjurmuar tolerimet, nuk lejohet, siç kanë thënë edhe vetë dijetarët. Kjo i ngjan traditës së çifutëve. Në Teurat thuhej që imorali të goditej me gurë deri në vdekje kur ishte i martuar, por kur në radhët e fisnikëve të tyre u shtua imoraliteti, ata e ndryshuan këtë dënim penal. Njëherë, kur Profeti (sal-lAllahu 'alejhi

ue sel-lem) ndodhej në Medinë, një burrë prej fiseve çifut bëri imoralitet me një grua. Njerëzit e tij, domethënë çifutët e tjerë, i thanë që të shkonte te Profeti, se ndoshta ai mund të kishte ndonjë ligj tjetër. Kështu ata gjurmonin tolerimet.

- Dijetarët i dhanë Ibn Dejlemijut një përgjigje që i shmang paqartësitë, për faktin se ata iu referuan vetëm Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Nëse i referohesh Allahut (kuranit) dhe Profetit të Tij traditës së tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), nuk ka më paqartësi. Megjithatë, kjo ndodh me besimtarët, ndërsa me jobesimtarët nuk bën dobi. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “… Por shenjat dhe qortimet nuk u bëjnë kurrfarë dobie njerëzve që nuk besojnë.” (Junus, 101). “Vërtet, ata që merituan Fjalën e Zotit tënd (zemërimin dhe dënimin e Tij), nuk besojnë. Edhe sikur t’u vijnë të gjitha shenjat, derisa të shohin dënimin e dhembshëm.” (Junus, 96-97). Ndërsa për besimtarët, Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe Pejgamberi i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyren …” (Ahzab, 36).

Njëherë, Aishja i tha një gruaje: “Edhe ne na ndodhte kjo, – duke pasur për qëllim menstruacionet, – e urdhëroheshim të zëvendësonim agjërimin dhe nuk urdhëroheshim të zëvendësonim namazet.”[1] Ajo kështu nuk e zgjati me ndonjë argument logjik.

Megjithatë, nuk ka ndonjë gjë të keqe nëse një gjykim fetar shoqërohet me arsyen e tij, për atë që nuk beson, se ndoshta, në këtë mënyrë, ai mund të besojë. Edhe Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala), kur flet për ringjalljen e të vdekurve, sjell argumente logjike dhe praktike. Si argument logjik, është: “Ai, e fillon krijimin dhe Ai e përsërit atë (pasi të jetë shuar) e për Atë kjo (përsëritja) është edhe më e lehtë …” (Rrum, 27). Logjikisht njeriu e pranon se kush ka mundësi të krijojë diçka për herë të parë, pa diskutim që ka mundësi edhe ta përsërisë atë. Ndërsa si argument praktik, është ajeti: “Ndër shenjat e Tij është edhe toka që ti e sheh të thatë e të

[1] Buhariu dhe Muslimi.

shkretë, por kur zbresim shi mbi të, ajo lëviz dhe gjallërohet. Pa dyshim, Ai që e ngjall atë, i ngjall edhe të vdekurit (Ditën e Ringjalljes) ...". (Fusilet, 39).

Përfundimisht, argumentet logjike ose praktike janë të pranueshme, me qëllim që të bindet kundërshtari dhe t'i shtohet më shumë bindja besimtarit.

Një argument i katërt është *fitra*, natyrshmëria njerëzore. Edhe ajo mund të përdoret si argument për të vërtetën që thua, për të mposhtur kundërshtarin dhe për të qetësuar atë që e pranon atë. Dijetarët vazhdojnë ta ndjekin këtë rrugë. Më lart ne kemi përmendur ngjarjen e Ebu Meal El Xhuvejnit me El Hamedhanin. Kur Ebu Meal el Xhuejni – Allahu na faltë ne dhe atë! – ishte i vendosur për mohimin e lartësimit të Allahut mbi Fronin e Tij, El Hamedhani i tha atij: "Mjaft na fole më për Fronin, po çfarë përgjigje na jep ti për këtë të vërtetë, që çdokush e ka në zemër: kurrë ndonjë i ditur nuk ka thirrur: 'O Allah!', pa ndjerë thellë në zemër që patjetër duhet ta ngrejë kokën lart, në qiell." Ebu Meali klithi dhe, duke i rënë kokës me grushte, thoshte: "Më ngatërroi El Hamedhani, më ngatërroi El Hamedhani!"

Atëherë, provat dëshmuese janë nga Kurani, Suneti, logjika, *fitra* dhe praktika. Besimtari bindet më tepër nga argumentet e Kuranit dhe Sunetit, sepse e di se çdo gjë që kundërshton Kuranin dhe Sunetin është e pasaktë, edhe pse mendja mund t'i thotë që është e saktë.

Tema 61

Argumentet që paralajmërojnë ata që bëjnë figura frymorësh[1]

Tema lidhet me teuhidin sepse në bërjen e figurave të frymorëve është një lloj ngjashmërie me veprën krijuese të Allahut.

> Nga Ebu Hurejre përcillet se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Allahu i Madhëruar ka thënë: 'Kush është më mizor se ai që provon të bëjë krijesa si krijesat e Mia? Le të krijojë një milingonë ose një farë, apo le të krijojë kokërr elbi!"[2]

Ky është një hadith *kudsij*. Kemi folur më parë për këtë lloj hadithi. Pyetja është retorike, me përgjigje negative, që do të thotë se: askush nuk është më mizor se njerëz të tillë. Kur mohimi shprehet me forma pyetëse si kjo, është më shumë sesa thjesht mohim: ai është një sfidë e hapur, madje që e përçmon kundërshtarin.

Po si harmonizohet kuptimi i këtij hadithi me ajetet: "Kush është më mizor se ai që pengon të përmendet nëpër xhamitë e Allahut, emri i Tij ..." (Bekare, 114); "Kush është më mizor se ai që trillon

[1] Këtu hyjnë të gjitha format e frymorëve, qofshin me trup apo pa trup, dydimensionale apo tredimensionale, me hije apo pa hije. Këtu hyn prodhimi me mjetet e kohës, gdhendja, pikturimi, vizatimi, fotografimi, qëndisja, endja apo thurja në rrobë, perde, qilim, etj..

[2] Buhariu dhe Muslimi.

gënjeshtër ndaj Allahut ...” (En’am, 21), si edhe me tekste të tjera të ngjashme?

Ka dy shpjegime për këtë. Së pari, këto vepra janë të barabarta, për sa i përket shkallës së tyre të mizorisë. Sipas shpjegimit të dytë, mizoria është relative, pra: askush nuk është më mizor se ai në atë kategori veprash, jo në çdo gjë. Për shembull: kush është më mizor në përngjasimin e veprave, sesa ai që kërkon të bëjë si krijesat e Allahut? Kush është më mizor në pengimin e së drejtës, sesa ai që pengon të përmendet nëpër xhami emri i Allahut? Kush është më i keq në të gënjyer, sesa ai që gënjen ndaj Allahut?

– “... *të bëjë krijesa* ...” – Akti i krijimit, si veprim i njeriut, ka nevojë paraprakisht për studim, mendim dhe përcaktim. Ndryshe është krijimi që bën Allahu: Ai nuk ka nevojë për studim dhe përcaktim paraprak, për shkak të dijes së plotë të Tij.

– “... *të bëjë krijesa si krijesat e Mia* ...” – Kjo tregon se lejohet të thuash “krijon” për dikë tjetër veç Allahut, siç është sqaruar edhe në fillim të librit.

– “... *Le të krijojë një milingonë* ...” – Kjo është sfidë në fushën e krijimit. Ndërkaq, fjala e Allahut: “Atëherë le të sjellin një libër të ngjashëm me të, nëse ajo që thonë është e vërtetë!” (Tur, 34), shpreh sfidë në fushën fetare.

Në hadith përdoret fjala “*dherr-rreh*”, që do të thotë “milingonë”. Disa thonë se “*dherr-rreh*” quhet grimca atomike, por janë të gabuar, sepse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u foli sahabëve me gjuhën që ata kuptonin, dhe atëherë nuk e njihnin grimcën atomike. Allahu sjell shembullin e mizës, sepse ajo ka shpirt dhe është ndër gjallesat më të vogla.

– “... *ose një farë* ...” – Këtu kalohet nga sfida në krijimin e gjallesave me shpirt, në krijimin e një fare, zanafillës së bimëve, të cilat nuk kanë shpirt.

– “... *apo le të krijojë një kokërr elbi.*” – Mund të flitet për bimën e elbit, duke pasur parasysh që, para kësaj, u fol për farën, zanafillën

e bimës. Por mund të flitet edhe për kokrrën e elbit, nëse e shohim si shembull konkret të një kategorie të përgjithshme, që ishte kategoria e farave të bimëve. Megjithatë, lidhëza "ose" mund të tregojë edhe dyshim nga përcjellësi i hadithit. Pra, Allahu i Madhëruar thërret në sfidë krijesat, deri në Ditën e Kijametit, që të krijojnë një mizë të vogël, një farë ose elb.

Ndonjëri mund të thotë se në Amerikë prodhohet një lloj orizi teknologjik, por ne përgjigjemi se, gjithsesi, ai nuk mbin, si orizi natyral. Ndoshta sekreti i sfidës së Tij: "...ose le të krijojë një farë, apo *le të krijojë një kokërr elbi*...", është pikërisht fakti që, kur fara hidhet në tokë, është Allahu Ai që e zbërthen atë: "Me të vërtetë, Allahu është zbërthyes i farës dhe i bërthamës (së pemës)." (En'am, 95);

Allahu i Madhëruar thotë: "Vërtet ata që po i adhuroni në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse mblidhen të gjithë për të ...", që do të thotë: edhe sikur të bashkoheni për krijimin e saj, duke ndihmuar njëri-tjetrin e duke dhënë gjithçka që keni.

Në një ajet tjetër thotë: "E po ashtu, nëse miza ua rrëmben atyre ndonjë send, nuk do ta shpëtojnë atë prej saj. I dobët është edhe lutësi, dhe i luturi." (Haxh, 73). Duke e shpjeguar, dijetarët thonë se, sikur edhe një mizë të prekte ato idhuj e të thithte diçka nga parfumi i tyre, ata nuk mund ta merrnin mbrapsht prej saj, duke dalë edhe miza fituese ndaj tyre. "I dobët është edhe lutësi ...", pra: adhuruesi i tyre, "... dhe i luturi", domethënë idhulli.

Nga hadithi mësohet se ndalohet portretizimi. Arsyeja është që ky akt përbën një tentativë për të krijuar ashtu siç ka krijuar Allahu.

Ka disa lloje figurash që ndërtojnë njerëzit:

- E para: figura të gdhendura frymorësh, që lëshojnë hije (tre-dimensionale), për shembull, statuja njeriu, deveje, luani etj. Për këtë lloj, dijetarët janë të një mendjeje se janë haram, me aq sa di unë.

Po figurat që nuk bëhen për krahasim me krijesat e Allahut, por për të luajtur, për shembull, lodra fëmijësh prej balte, druri ose guri, në formën e një kafshe, a janë objekt i këtij hadithi?

Po, janë objekt i hadithit, sepse edhe këtu flitet për shëmbëllim të krijesave të Allahut, dhe në hadith veprimi nuk është i kushtëzuar

nga qëllimi. Pra, ku ka rivalizim, sido që të jetë, ka gjykim të rivalizimit. Me një shembull tjetër, nëse dikush mban një veshje që është karakteristike e qafirëve, e pretendon se nuk ka si qëllim përngjasimin me ta, i themi se ai konsiderohet përngjasim, me apo pa qëllim. Po ashtu, nëse një burrë vishet si grua, i mban flokët si grua, etj., e pastaj thotë se nuk e bën për t'u përngjasuar me gratë, themi se, pavarësisht nga pretendimi i tij, ai gjykohet si përngjasues me gratë.

- E dyta: figura frymorësh të vizatuara apo të pikturuara (dy-dimensionale). Edhe këto janë të ndaluara, për shkak të kuptimit të përgjithshëm të hadithit të mësipërm.

Kjo përforcohet edhe nga një hadith tjetër, që tregon se si, njëherë, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) kur bëri të futej në shtëpi, pa atje një jastëk me figura frymorësh të vizatuara. U step. Në fytyrë iu shfaq zemërimi. Aishja i tha: "Çfarë gjynahu kam bërë, o Pejgamberi i Allahut?" Ai iu përgjigj: "Me të vërtetë, ata që i kanë bërë këto figura do të ndëshkohen në Ditën e Kijametit, duke iu thënë: 'Ngjallini ato që krijuat!'"[1]

Pikturat dhe vizatimet janë njëlloj si skulpturat, për nga gjykimi i tyre. Ndërsa për sa i përket hadithit në "*Sahih*-un" e Buhariut, që thotë: "... me përjashtim të pikturave mbi rroba", gjykojmë se – po të jetë i saktë ky transmetim, – ai flet për figura pemësh e të ngjashme.

- E treta: fotografi frymorësh, të cilat fiksojnë pamjet, pa ndryshime nga dora e njeriut. Për to, dijetarët e sotëm nuk janë të një qëndrimi.

A- Sipas një mendimi, ato janë imazhe krijesash dhe se mekanizmi i prodhimit të fotos është një ndërhyrje e njeriut, pa të cilin imazhi nuk do të shfaqej në letër. Gjithashtu, ne pajtohemi se ajo është një imazh, një figurë, prandaj ajo futet në kategorinë e figurave, sido që të realizohen ato.

B- Sipas mendimit tjetër, nuk kemi të bëjmë me krijim figurash nga njeriu, por një fiksim të realitetit nga aparati. Një shembull tjetër: nëse marrim një faqe libri dhe e vendosim në fotokopje, shkronjat dhe fjalët në letrën e fotokopjuar janë fryt i atij që i ka shkruar për herë të parë, dhe jo të atij që vë në punë aparatin e fotokopjes, sepse atë mund ta përdorë edhe një i pashkolluar apo

[1] Buhariu dhe Muslimi.

një i verbër. Kësisoj, fotografuesi nuk konsiderohet si autor i imazhit.

Mendimi i dytë është më afër të vërtetës, sepse fotografia – sipas këtij shpjegimi – nuk është krijim i imazhit. Megjithatë, duhet të shqyrtuar më tej se a lejohet gjithmonë një veprim i tillë apo jo.

Nëse bëhet për qëllime të ndaluara, ky veprim është i ndaluar, e nëse bëhet për qëllime të lejuara, është i lejuar, sepse mjetet trajtohen sipas qëllimeve apo objektivave tek të cilat të çojnë. Kështu, nëse fotografitë bëhen thjesht "për kujtim", që të kënaqemi kur t'i shohim apo për t'u çmallur, është e ndaluar, nuk lejohet. Ndërsa kur ato shërbejnë për dokumente, për shembull, për patenta, pasaporta, letërnjoftime etj., janë të lejuara. Njeriun që realizon foto të tilla, foto të çastit, pa ndonjë përpunim e ndërhyrje nga ana e tij, nuk e përfshin paralajmërimi i këtij hadithi. Mirëpo nëse fotografon për qëllime të tjera, themi se ka ndihmuar në mëkat dhe në diçka të keqe.

- E katërta: figura të sendeve pa shpirt. Këto ndahen në dy grupe të mëdha.

1. Figura të sendeve që prodhohen nga njeriu. Për këto, nuk ka ndonjë pengesë, me pajtimin e të gjithë dijetarëve: përderisa lejohet prodhimi i sendeve, lejohet edhe bërja e figurave të tyre. Për shembull, nëse lejohet prodhimi i një makine, lejohet edhe krijimi apo fotografimi i imazhit të saj

2. Figura të sendeve që nuk bëhen nga njeriu, por që i ka krijuar Allahu. Edhe këto ndahen në dy nëngrupe:

a) figura të sendeve që nuk rriten e nuk zhvillohen;

b) figura të sendeve që rriten e zhvillohen.

Te nëngrupi i parë futen figurat e maleve, luginave, deteve, lumenjve etj. Për këto nuk ka ndonjë ndalesë, sipas mendimit unanim të dijetarëve.

Kurse për nëngrupin e dytë, dijetarët nuk janë të një mendimi. Shumica e tyre e quajnë të lejuar atë, sipas disa haditheve që do të vijojnë më poshtë, ndërsa disa nga dijetarët e hershëm dhe të mëvonshëm, mendojnë se është haram, duke u mbështetur në faktin kryesor se ato janë krijesa të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), për të cilat flet tekstualisht edhe hadithi: "Kush është më mizor se ai që kërkon të bëjë si krijesat e Mia...". Allahu i sfidoi ata me

krijimin e një fare ose të një kokrre elbi. Fara dhe kokrra e elbit nuk kanë shpirt, mirëpo pa dyshim ato rriten e zhvillohen. Rrjedhimisht, krijimi figurave të tyre është haram. Ky ka qenë mendimi i Muxhahidit (Allahu e mëshiroftë!), i cili ka qenë tabiini më i ditur në *tefsir*. Ai ka thënë se njeriu e ka të ndaluar të bëjë figura pemësh, por, siç thamë më lart, shumica e dijetarëve e quajnë të lejuar.

Atëherë ky hadith, a është provë për shumicën e dijetarëve apo për Muxhahidin dhe shokët e tij?

Hadithi është në favor të qëndrimit të Muxhahidit dhe të atyre që mendojnë si ai. Së pari, është pjesa përgjithësuese e tij: "Kush është më mizor sesa ai që kërkon të bëjë si krijesat e Mia ...". Së dyti, është pjesa që flet për çështje konkrete: "... Le të krijojë një mizë të vogël ose një farë, apo të krijojë elb."

Megjithatë, dijetarët e tjerë, që përbëjnë shumicën, sjellin si dëshmi hadithet, ku thuhet: "Ngjallini ato që keni krijuar!" dhe: "...do detyrohet t'u japë shpirt..."[1]. Këto tregojnë se qëllimi është vetëm për qeniet me shpirt, ndërsa fjalia: "...Le të krijojë një mizë të vogël ose një farë, apo të krijojë elb", është një thirrje për sfidë, që do të thotë se ata që bëjnë figura, në të vërtetë janë të paaftë të krijojnë, qoftë edhe diçka që nuk ka shpirt.

> Buhariu dhe Muslimi sjellin hadithin që përcjell Aishja (radijallahu anha) nga Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sellem), **se *"Njerëzit që do të ndëshkohen më ashpër Ditën e Kiametit do të jenë ata që imitojnë* (shëmbëllejnë) *krijesat e Allahut*"**[2].

– "*njerëzit që do të ndëshkohen më ashpër...*" – Fjala arabe "*adhab*" e përdorur në hadith, ka kuptimin "ndëshkim për një faj të bërë", por do të thotë edhe "vuajtje e lëndime", pa qenë ndëshkim. Me kuptimin e parë është në ajetin: "Hidhini ithtarët e Faraonit në dënimin më të rëndë!" (Gafir, 46). Ky është ndëshkim dhe vuajtje, sepse Faraoni do të futet në Zjarr, – Allahu na ruajtë! – siç thuhet në ajetin tjetër: "Ai do ta udhëheqë popullin e tij në Ditën e

[1] Më pas hadithi do të përmendet i plotë.
[2] Buhariu dhe Muslimi.

Kijametit e do ta çojë në Zjarr ...” (Hud, 98). Ndërsa me kuptimin e dytë, është në hadithin e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Udhëtimi është një pjesë e ndëshkimit”[1] ose: “I vdekuri ndëshkohet për vajtimin me kujë mbi të.”[2]

– “... *Ditën e Kijametit* ...” – Kjo është dita kur do të ringjallen njerëzit. Më lart kemi treguar pse quhet kështu.

– “... *ata që imitojnë (shëmbëllejnë) krijesat e Allahut.*” – Këta janë portretizuesit të cilët bëjnë forma frymorësh, qofshin trupore (tre-dimensionale) apo përshkruese (dy-dimensionale). Atëherë, përveç portretizimit të trupit, këtu hynë edhe prodhimi apo ngjyrosja e imazheve të frymorëve, siç është pikturimi dhe vizatimi, sepse në fakt kur ngjyros apo vizaton me dorë imazhe frymorësh bën përshkrim të krijesës. Edhe pse letrën nuk e krijon vetë, ngjyrat që vendos në të, bëjnë përshkrim të veprës së krijimit.

Hadithi tregon se këta do të ndëshkohen, madje do të jenë njerëzit që do të ndëshkohen më rëndë. Arsyeja është se ata imitojnë (shëmbëllejnë) krijesat e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala), dhe jo sepse – si pretendojnë mjaft njerëz, – duan t’i adhurojnë veç Allahut. Kjo e dyta është gjë tjetër, pasi kush bën diçka për ta adhuruar veç Allahut, edhe pa shëmbëllyer krijesat e Tij – qoftë, për shembull, edhe një dërrasë – është haram, sipas ajetit: “... mos e ndihmoni njëri-tjetrin në mëkate e armiqësi ...” (Maide, 2), për shkak se ai ndihmon njerëzit në mëkate e armiqësi.

Po imitimi (shëmbëllimi), a duhet të jetë patjetër me qëllim, apo quhet i tillë edhe kur bëhet pa qëllim?

Themi se ai gjykohet njëlloj, qoftë edhe pa qëllim, sepse harami qëndron tek shëmbëllimi i krijesave dhe jo tek qëllimi i shëmbëllimit. Kështu, nëse dikush thotë që, me pikturën, nuk ka qëllim të imitojë (shëmbëllejë) krijesën e Allahut, por e bën thjesht për kujtim, i themi se, gjithsesi, vepra është haram, pasi sa herë ka imitim (shëmbëllim), me apo pa qëllim, pasoja është e njëjtë. Kur realizohet shkaku, do të vijë edhe pasoja. Siç thamë më lart, kur dikush mban një veshje që është karakteristike e qafirëve, ai e ka të

[1] Buhariu dhe Muslimi.
[2] Buhariu dhe Muslimi.

ndaluar veshjen e saj. Edhe nëse pretendon se nuk ka si qëllim imitimin e tyre, prapëseprapë themi se ai konsiderohet imitim, me apo pa qëllim, sepse kur dispozita ligjore ka një shkak, ajo vepron sa herë që gjendet ky shkak, pa marrë parasysh qëllimin.

Dobitë e hadithit

- Ndalimi i bërjes së figurave të qenieve me shpirt, sepse është një nga gjynahet e mëdha, duke u bazuar në kërcënimin që përcillet në lidhje me të. Shkaku i ndalimit të tij është sepse ai përbën shëmbëllim të krijesave të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

- Domosdoshmëria e ruajtjes së teuhidit *rububije*, me kuptimin që askush të mos lakmojë të krijojë si ato gjëra që ka krijuar Allahu. Kjo, sipas hadithit: "*... ata që imitojnë (shëmbëllejnë) krijesat e Allahut.*" Po për këtë arsye, është i ndaluar kryelartësia, sepse përbën shoqërim me Allahun (Subhanehu ue Te'Ala). Edhe ai që prodhon diçka, duke imituar me të krijesat e Allahut, veprimi i tij është shoqërim me Allahun (Subhanehu ue Te'Ala) në veprat e Tij.

Në hadith thuhet: "Njerëzit që do të ndëshkohen më ashpër ...". Këtu mund të ketë ndonjë pështjellim, sepse ka njerëz që bëjnë mëkate më të mëdha se portretizuesit, siç janë idhujtarët dhe qafirët, të cilët duhet të kenë ndëshkim akoma më të ashpër. Ka disa shpjegime të kësaj çështjeje:

1. Përcaktimi nuk është absolut, që do të thotë se këta do të jenë ndër njerëzit që do të ndëshkohen më shumë.

2. Ndëshkimi i ashpër ndaj tyre, nuk do të thotë se i përjashton të tjerët, që bëjnë vepra të tjera. Allahu thotë: "Hidhini ithtarët e Faraonit në dënimin më të rëndë." (Gafir, 46). Por këtu lind pyetja: nëse portretizuesi bën vetëm mëkat të madh, atëherë si mund të barazohet me ata që janë jashtë feje apo me mendjemëdhenjtë?!

3. Ndëshkimi më i ashpër këtu është brenda një kategorie të caktuar, që do të thotë se ndër ata që prodhojnë dhe shpikin gjëra, më ashpër do të ndëshkohen ata që imitojnë krijimin e Allahut. Ky shpjegim është më pranë së vërtetës.

4. Kjo formë e të shprehurit shërben thjesht si paralajmërim, që njerëzit të largohen nga ajo vepër. Mirëpo unë nuk kam njohur e nuk di ndonjë që ta ketë thënë këtë. Nëse do të ishte e saktë, do të kishim shpëtuar nga të gjitha këto paqartësi. Sido që të jetë, ne na

takon të themi vetëm ashtu siç ka thënë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Njerëzit që do të ndëshkohen më ashpër Ditën e Kiametit do të jenë ata që imitojnë (shëmbëllejnë) krijesat e Allahut”.

> Ibn Abasi përcjell se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të thotë: “Çdo portretizues do të jetë në zjarr, dhe për çdo figurë që ka punuar, do t’i bëhet një qenie me të cilën do të dënohet në Xhehenem.”[1]

– *“Çdo portretizues do të jetë në Zjarr...”* – Kjo përfshin figura njerëzish, kafshësh, pemësh ose detrash, por vijimi i hadithit: “...dhe për çdo figurë që ka punuar, do t’i bëhet një qenie me të cilën do të dënohet në Xhehenem”, tregon se flitet për figurat e qenieve me shpirt.

– “*... dhe për çdo figurë që ka punuar, do t’i bëhet një qenie me të cilën do të dënohet në Xhehenem.*” – Mënyra e ndëshkimit do të shpjegohet në hadithin vijues: do të detyrohet që t’u japë shpirt, por ai nuk mund ta bëjë këtë.

Për *mutezil*-ët dhe *havarixh*-ët, qëndrimi i tyre në Zjarr do të jetë i përhershëm, sepse për ata, kush bën një gjynah të madh do të jetë përgjithmonë në Xhehenem. Ndërsa për *murxhij*-të, qëllimi është vetëm për portretizuesin jobesimtarë, sepse sipas tyre, besimtarët nuk futen kurrë në Zjarr. *Ehli suneh uel xhema’* mendojnë se kush e bën këtë punë, e meriton të hyjë në Zjarr. Megjithatë, ai mund të futet aty ose jo, por edhe nëse futet, nuk do të mbetet atje përgjithmonë.

Shprehja: “...për çdo figurë që ka punuar...”, do të thotë që, nëse ai bën dhjetë kopje të njëjta figurash, do t’i bëhen dhjetë figura dhe do të urdhërohet t’u japë atyre shpirt. Me sa kuptohet nga teksti i drejtpërdrejtë i hadithit, ai do të mbetet në Zjarr i ndëshkuar, derisa të mbarojnë këto figura.

> Po ata të dy (Buhariu dhe Muslimi) sjellin hadithin: “Kush bën figurë frymori në dynja, do të detyrohet që t’u japë

[1] Buhariu dhe Muslimi.

> shpirt, por ai nuk mund t'ua japë."

– "*... do të detyrohet që t'u japë shpirt* ..." – Ai që do ta detyrojë do të jetë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala).

– "*... por ai nuk mund t'ua japë* ..." – Ai do të detyrohet nga Allahu me diçka që e ka të pamundur ta bëjë, e kjo si formë ndëshkimi. Qëllimi është që të provojë pasojat e asaj që veproi. Atij do t'i shtohen vuajtjet dhe pikëllimi, për diçka që, në dynja, ai e kishte parë si të rehatshme dhe fitimprurëse, dhe si një vepër që ai e bënte për të kënaqur dikë ose për të treguar se sa 'mjeshtër' ishte.

> Muslimi sjell rrëfimin e Ebu Hejaxhit, i cili tregon se Aliu i ka thënë: "Po të dërgoj për atë që më ka dërguar mua Pejgamberi i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): të mos lësh figurë pa prishur dhe as varr të ngritur pa e rrafshuar!"

– "*... rrëfimin e Ebu Hejaxhit* ..." – Ky ka qenë nga brezi i tabiinëve.

– "*... Aliu i ka thënë* ..." – Bëhet fjalë për Ali Ibn Ebu Talibin (r.a.).

– "*... Po të dërgoj* ..." – Dërgimi bëhet për çështje të rëndësishme, siç është thirrja në rrugë të Allahut, i Cili thotë: "Çdo populli Ne i çuam një të Dërguar ..." (Nahl, 36).

– "*... për atë që më ka dërguar mua Pejgamberi i Allahut (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ..."* – Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e kishte dërguar Aliun (r.a.) në Jemen, e ai u kthye te Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), kur ky ishte në Mekë, në Haxhin e Lamtumirës.[1]

– "*... të mos lësh figurë pa prishur dhe as varr të ngritur pa e rrafshuar* ..." – Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e çoi Aliun

[1] Buhariu dhe Muslimi.

(r.a.) për më shumë se kaq, por kjo ishte njëra nga arsyet e dërgimit.

Urdhri: "të mos lësh figurë pa prishur", është gjithëpërfshirës për sa u përket figurave, mirëpo shumica e dijetarëve thonë se e ndaluar është vetëm krijimi i figurave të frymorëve, sipas hadithit të Xhibrilit, sjellë në "*Sunen*", ku Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sellem) ka thënë: "... Prandaj, urdhëro që figurave t'u pritet koka e të mbeten si trungje pemësh."[1] Pak më lart u sqarua kjo çështje.

– "... *pa prishur* ..." – Pra, nëse janë piktura ose vizatime, t'u prishësh ngjyrat dhe vijat, nëse janë skulptura, t'u heqësh kokat, – siç u tha në hadithin e Xhibrilit pak më parë, – e nëse janë të skalitura, të prishësh të gdhendurat, derisa të mos u duken shenjat e fytyrës. Pra, ka disa mënyra të prishjesh, sipas rastit.

Nga hadithi kuptohet se bëhet fjalë si për figurat që adhurohen veç Allahut, edhe për ato që nuk adhurohen.

– "... *as varr të ngritur pa e rrafshuar* ..." – Në arabisht, shprehja ka dy domethënie: 1. ta barazosh varrin me varret e tjera; 2. ta bësh të rregullt, sipas Sheriatit. Për këtë, Allahu thotë: "... i Cili krijoi gjithçka dhe e ka rregulluar drejt." (A'la, 2), që do të thotë se i bëri krijesat e Tij në mënyrën më të mirë të mundshme. Shpjegimi i dytë është më i drejtë, ndonëse domethëniet janë të përafërta.

"Varr i ngritur" (në arabisht) ka disa kuptime:

1. Varr i dallueshëm me anë të shenjave të mëdha (gurë, pllaka etj.), të vendosura mbi të.

2. Varr mbi të cilin ngrihet një ndërtesë (mauzole). Një vepër e tillë është gjynah i madh, sepse: "Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sellem) i ka mallkuar ata që i bëjnë varret faltore dhe që i ndriçojnë ato."[2]

3. Varr i zbukuruar me ngjyra.

4. Varr me kurriz dheu të ngritur, që të jetë i dallueshëm nga të tjerët.

Siç shihet, përkufizimet kapin çdo gjë që e bën varrin të dallohet mbi tjerët, rrjedhimisht, hadithi tregon që të tëra këto duhen

[1] Ahmedi, Ebu Daudi dhe Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.
[2] E transmetojnë autorët e katër "Suneneve".

prishur, në mënyrë që varri të barazohet me të tjerët. Qëllimi është që ai të mos i shtyjë njerëzit në teprim dhe idhujtari.

Vendosja e çështjes së krijimit të figurave me ngritjen e varreve, është bërë sepse që të dyja veprat janë shkaqe të mundshme të politeizmit. Zanafilla e kësaj dukurie te populli i Nuhut, qe pikërisht krijimi i figurave të disa burrave të mirë, të cilat pas një farë kohe u kthyen në objekte adhurimi. Po kështu, edhe varret e ngritur janë shkak i nderimit të tepruar të tyre, derisa të bëhen idhuj që të adhurohen veç Allahut. Ç'është e vërteta, kjo është sëmundja e sotme e përhapur në disa vende islame.

Shpjeguesi (mbase e ka fjalën për sheh Sulejmanin, autorin e '*Tejsiri*-t') ka folur më gjatë për çështjen e ngritjes së varreve, për arsye se ajo është një sprovë e hershme në vendet islame, e cila akoma vazhdon, me përjashtim të vendeve tona, dhe falënderimi i takon Allahut për këtë.[1] E lusim Allahun që të vazhdojmë kështu e që t'i mbrojë vendet e muslimanëve nga kjo e keqe.

Më poshtë, do të japim përshkrimin e dënimit të atij që krijon figura frymorësh:

- Do të jetë njeriu që do të ndëshkohet më ashpër, ose nga njerëzit që do të ndëshkohen më ashpër.
- Allahu do të bëjë për çdo figurë që ai ka krijuar, një qenie me të cilën do të dënohet në Xhehenem.
- Ai do të detyrohet që t'u japë shpirt figurave të veta, ndërkohë që e ka të pamundur ta bëjë.
- Do të jetë në Zjarr.
- Së fundmi, ai është njeri i mallkuar, siç thuhet në hadithin e Ebu Xhuhejfes, që gjendet në "Sahihun" e Buhariut e në libra të tjerë.

Le të trajtojmë dy çështje të rëndësishme:

1. "Do të detyrohet që t'u japë figurave shpirt, por ai nuk mund t'u japë", nënkupton se flitet për krijimin e figurave që e paraqesin trupin të plotë. Sipas këtij konteksti, nëse bën figurën e kokës pa trup ose vetëm të trupit pa kokë, lejohet. Këtë e përforcon edhe hadithi i Xhibrilit: "Prandaj, urdhëro që figurave t'u hiqet koka …", ku nuk është thënë që të prishen plotësisht. Megjithatë, për sa më

[1] Ndoshta shejhu ka për qëllim Arabinë Saudite.

përket mua, unë ngurroj t'i quaj të lejuara figurat që paraqesin vetëm kokën, pa trupin, ndërsa për trupat pa kokë, jam i sigurt që lejohen.

2. Nga hadithi i Aliut (r.a.): "... të mos lësh figurë pa prishur ...", mësohet se nuk lejohet të bësh asnjë lloj fotografie, por kjo ka nevojë për sqarim, pasi fotografitë mund të bëhen e të mbahen për disa arsye:

a) Si nderim për njeriun e fotografuar, për shkak se ka pushtet, është i ditur, i devotshëm apo qoftë edhe prind. Kjo është e ndaluar. Melekët nuk futen në një shtëpi ku ka imazhe frymorësh. Nderimi i atyre që kanë pushtet, duke u mbajtur fotografinë, është mangësi në aspektin e rrububijes (veprave të Allahut), ndërsa mbajtja e fotove të devotshmëve si shenjë nderimi për ta, është mangësi në aspektin e adhurimit.

b) Për të kënaqur syrin, duke i parë. Kjo është gjithashtu haram, për shkak të fitnes, që çon në vese të ulëta.

c) Për kujtim, siç janë fotografitë e fëmijëve të tyre të vegjël. Edhe kjo është e ndaluar, sipas kërcënimit të përmendur në fjalën Profetit ('alejhis–selam): "Vërtetë melekët nuk futen në atë shtëpi që ka imazhe frymorësh"[1].

d) Pa i pasur ato si qëllim, por diçka tjetër që gjendet e shoqëruar me to, siç ndodh me revistat e gazetat. Njeriu mund t'i marrë ato pa pasur qëllim fotot, por lajmet, studimet e gjëra të tjera që ato përmbajnë. Pra, në këtë rast, nuk ka ndonjë të keqe, por gjithsesi, nëse prishen lehtë, është më mirë.

e) Për t'i nënçmuar, si për shembull, duke i hedhur në plehra ose në tokë, për t'i shkelur. Për shumicën e dijetarëve, kjo nuk përbën ndonjë gjynah. A kanë të njëjtin gjykim veshjet me figura të tilla, e sidomos veshjet e poshtme, nëse i shohim si nënçmim për to? Jo, nuk kanë të njëjtin gjykim, përkundrazi, veshjet me të tilla figura janë të ndaluara, për të mëdhenj a për të vegjël qofshin. Ato nuk konsiderohen si shtrojet e gjërat që janë si ato; ndryshimi mes tyre është i qartë. Dijetarët (Allahu i mëshiroftë!) janë shprehur hapur se veshjet me figura frymorësh, – qofshin veshje të sipërme apo të brendshme, madje edhe kapele, – janë haram.

Pyetje: Kohët e fundit kanë dalë edhe peceta të posaçme për

[1] Buhariu dhe Muslimi.

foshnjat apo për gratë me menstruacione, të cilat thithin papastërtitë nga poshtë. A konsiderohen këto si artikuj që i nënçmojnë figurat sipër tyre apo jo?

Përgjigje: Më shumë anohet nga përgjigjja pohore, megjithatë, meqë çështja nuk është e qartë, të ruhesh nga kjo është më mirë.

f) Për dokumente, si për pasaporta, diploma, monedha etj. Për këto nuk ka ndonjë gjynah, për shkak të pamundësisë së shmangies së tyre. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "... nuk ju ka detyruar me ndonjë vështirësi në fenë tuaj ..." (Haxh, 78).

Dobitë e temës

- Kërcënimi i ashpër ndaj atyre që bëjnë figura frymorësh

Kjo del nga hadithi: "Njerëzit që do të ndëshkohen më tepër ...".

- Mësimi se cila është arsyeja e këtij ndëshkimi: sjellja e mbrapshtë me Allahun. Kjo del nga hadithi *kudsij*: "Kush është më mizor se ai që provon të bëjë krijesa si krijesat e Mia...".

Ai që kërkon të bëjë si krijesat e Allahut, ka treguar sjellje të mbrapshtë me Allahun (Subhanehu ue Te'Ala), ashtu sikurse ai që e kundërshton Sheriatin e Tij.

- Paraqitja e fuqisë absolute të Allahut dhe e pamundësisë së atyre që bëjnë ato figura. Kjo del nga pjesa e hadithit: "... Le të krijojë një milingonë, një farë ose të krijojë një kokërr elbi".

Allahu ka krijuar gjëra më të mëdha se këto, ndërsa ata janë të

pamundur të krijojnë qoftë edhe një mizë të vogël apo elb.

- Deklarimi se ata janë njerëzit që do të ndëshkohen më ashpër.

- Allahu do të krijojë qenie për çdo figurë të bërë nga ata njerëz, me të cilën do të ndëshkohet në Xhehenem.

Kjo del nga hadithi: "... dhe për çdo figurë që ka punuar, do t'i bëhet një qenie me të cilën do të dënohet në Xhehenem."

- Portretizuesi do të detyrohet t'u japë shpirt krijimeve të veta, (ndërkohë që nuk ka mundësi ta bëjë këtë).

Kjo është nxjerrë nga hadithi që thotë kështu. Ky lloj ndëshkimi do të jetë nga më të vështirët.

- Urdhri për prishjen e çdo figure.

Kjo del nga fjala e Profetit ('alejhis–selam): "...të mos lësh figurë pa prishur...". Gjithashtu, ka një urtësi që, brenda një hadithi janë sjellë dy probleme: ai i skulpturave dhe ai i ngritjes së varreve: "të mos lësh figurë pa prishur dhe as varr të ngritur pa rrafshuar", pasi secili prej tyre përbën një rrugë që të çon drejt politeizmit.

Nga hadithi mësohet edhe se ndëshkimi në Ditën e Gjykimit, ashtu si shpërblimi, do të jetë sipas llojit të veprës që ka kryer këtu: për çdo figurë që ka punuar, do t'i bëhet një qenie me të cilën do të dënohet në Xhehenem.

Tema 62

Argumentet që flasin për betimet e shumta.

Tema lidhet me teuhidin, sepse betimet e shumta në Allah tregojnë se në zemrën e betuesit mungon madhështia e Allahut, gjë të cilën e kërkon serioziteti i një betimi. Madhërimi i Allahut është prej teuhidit të plotë.

> Allahu i Madhëruar thotë: "... Ruani betimet tuaja." (Maide, 89)

Ky ajet vjen pas çështjes së shlyerjes së betimit. Çdo betim ka fillim, mbarim dhe mes. Fillimi është bemtimi, mbarimi është shlyerja e betimit, ndërsa mesi është thyerja e tij. Kjo e fundit do të thotë që njeriu të bëjë atë që është betuar për të mos e bërë, ose të mos bëjë atë që është betuar për ta bërë. Duke u nisur nga kjo, nuk mund të ketë kurrë shkelje betimi për diçka të shkuar. Ajo që nuk konsiderohet shkelje, nuk ka nevojë as për shlyerje. Megjithatë, nëse është betim për diçka të vërtetë, është i rregullt, e në se jo, është gjynah. Ndërsa shlyerje betimi ka vetëm kur betohesh për diçka që do të ndodhë në të ardhmen.

A lejohet që njeriu të betohet për diçka që ashtu e mendon se është?

Po, dhe për këtë ka argumente të shumta. E tillë është ngjarja me personin që iu betua Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), pasi kishte kryer marrëdhënie seksuale me bashkëshorten e tij gjatë ditës së Ramazanit: "Për Zotin, nuk ka familje ndërmjet dy kodrave

më të varfër se e imja!" Mirëpo, nëse betohet për diçka që do të ndodhë në të ardhmen, duke u nisur nga mendimi i vet, dhe ajo nuk ndodh ashtu, atëherë e ka detyrim shlyerjen e atij betimi. Sipas një qëndrimi tjetër, nuk e ka detyrë shlyerjen, e ky është qëndrimi më i saktë, ashtu si betimi për diçka të shkuar. Për shembull, kur thua: "Për Zotin, ai nesër do të vijë!", thjesht nga hamendja jote, nëse ai nuk vjen, gjykimi i saktë është se nuk e ke detyrim shlyerjen e betimit, sepse je betuar duke u mbështetur tek ajo që kishe në zemër. Kjo është njëlloj si të thuash: "Për Zotin, kështu mendoj unë!" A lejohet të betohesh për atë që mendon …? Kjo çështje u sqarua më parë.

Atëherë, fjala e Allahut: "Ruani betimet tuaja", çfarë nënkupton: fillimin, mbarimin apo mesin e betimit? Me fjalë të tjera, a është për qëllim mosteprimi me betime në Allahun e Lartësuar, detyrimi për të mos e shkelur atë, apo detyrimi që, kur betohesh dhe e shkel betimin, të mos rrish pa e shlyer atë?

Qëllimi i ajetit është për të gjitha momentet e betimit. Megjithatë, autori e ka sjellë në këtë temë, për të argumentuar momentin e parë: mosteprimin me betime. Është një parim i rëndësishëm në studimet fetare: nëse një argument nga Kurani ose Suneti përmban disa kuptime, të cilët nuk bien ndesh me njëri-tjetrin, dhe asnjëri prej tyre nuk ka epërsi mbi të tjerët, është detyrë që argumenti të interpretohet e pranohet me të gjitha ato kuptime.

Qëllimi me mos teprim në betime është për ato betime që bëhen qëllimisht (kur bëhen për të dhënë garanci dhe për të shtuar besimin). Betimet e paqëllimta, si: "Jo, për Zotin…", "Po, Për Zotin…", gjatë një bisede, nuk llogariten këtu, bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar: "Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta." (Maide, 89).

Të ruash betimin do të thotë gjithashtu, edhe të mos e shkelësh atë. Mirëpo, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i ka thënë njëherë Abdurrahman Ibn Semuras: "Nëse betohesh se do të bësh diçka, por më vonë sheh se është më mirë të bësh diçka tjetër, atëherë bëj atë që është më e mirë dhe bëj shlyerjen e betimit të parë."[1] Kjo do të thotë që betimin nuk duhet ta shkelësh, por kur është më e udhës që ta thyesh atë, atëherë duhet ta thyesh, duke bërë

[1] Buhariu, Muslimi.

shlyerjen e tij.

Për shembull, dikush thotë: "Për Zotin, nuk i flas më atij!", ndërkohë ai është prej besimtarëve që është e ndaluar t'i bojkotosh. Atëherë, ai që u betua, e ka detyrë t'i flasë besimtarit, duke e thyer kështu betimin dhe, nga ana tjetër, të bëjë shlyerjen që i ngarkohet.

Po kështu, edhe nëse betohesh: "Për Zotin, unë do ta ndihmoj atë në haram." Thyerja e këtij betimi është detyrë, sepse Allahu thotë: "...mos e ndihmoni njëri-tjetrin në gjynahe e armiqësi..." (Maide, 2)

Nëse të dyja mundësitë janë të barabarta, pra edhe përmbushja, edhe thyerja e betimit janë njëlloj si gjynahe, atëherë më e mirë është përmbushja e betimit.

Ruajtja e betimit nënkupton edhe shlyerjen e tij, mbasi është thyer, madje ky është detyrim i menjëhershëm, sepse parimisht, duhet të nxitosh në zbatimin e detyrave, që, në rastin tonë, do të thotë se duhet ta kryesh detyrimin për mospërmbushjen e betimit.

Shlyerja e betimit të thyer bëhet ose duke ushqyer dhjetë të varfër me mesataren e ushqimit të familjes suaj, ose duke i veshur ata, ose duke liruar një rob. Këto tri mënyra janë sipas dëshirës, me zgjedhje. E kush nuk ka mundësi të bëjë asnjërën prej tyre, atëherë duhet të agjërojë tri ditë dhe, sipas leximit që Ibn Mesudi i bën Kuranit, këto ditë duhet të jenë të njëpasnjëshme.[1]

Përfundimisht, 'ruajtja e betimit' ka tri kuptime:

1. Të mos e teprosh me betime në Allahun e Lartësuar. Duhet të dihet se betimet e shumta e dobësojnë besueshmërinë e personit, madje ngjallin dyshime në fjalët e tij.

2. Të mos e shkelësh betimin, me përjashtimet që u thanë më lart.

3. Të mos rrish pa e shlyer atë, pasi e ke thyer.

> Ebu Hurejre tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) të thotë: "Betimi nxit shitjen e mallit, por ia heq fitimin"[2]

Këtu flitet për betimin e rremë, ashtu siç sqarohet në hadithin që

---

1 Ibn Xheriri, Abdurrezaku dhe Bejhakiu. Sipas Albanit ky transmetim është i vërtetë.

2 Buhariu dhe Muslimi.

sjell Ahmedi. Ndërsa për betimin e vërtetë nuk ka dënim, por, sidoqoftë, nuk duhet të betohesh shpesh, siç u tha pak më parë.

– "*Betimi nxit shitjen e mallit …*" – Betimi për mallin mund të jetë për origjinën, llojin, cilësinë dhe vlerën e tij, për shembull:

- Për origjinën: betimi se malli është i një fabrike, që është e mirënjohur (nuk është falso), ndërkohë që e vërteta nuk qëndron ashtu.
- Për llojin: betimi se malli është prej hekuri, ndërkohë që, në fakt, është prej druri.
- Për cilësinë: betimi se malli është i mirë, ndërsa ai është i keq.
- Për vlerën: betimi se vlera e tij është dhjetë dinarë, ndërsa ajo është tetë.

– "*…por ia heq fitimin.*" – Pra, e prish pasurinë. Kjo prishje mund të jetë konkrete, për shembull me zjarr, grabitje, përmbytje, ose edhe duke u sëmurur pronari, i cili duhet ta shpenzojë pasurinë për t'u mjekuar.

Por prishja mund të jetë edhe jomateriale. Allahu ia largon bereqetin nga pasuria, dhe pronari nuk ka më dobi prej saj, as nga ana fetare, as nga ana e dynjasë. Sa njerëz kanë pasuri të vogël, por Allahu ua bën të bereqetshme, për ata vetë, për të tjerë dhe për pasardhësit e tyre. E sa njerëz kanë pasuri, por ajo nuk u bën dobi, bëhen (Allahu na ruajtë!) koprracë dhe jetojnë si të varfër, sepse u ka humbur bereqeti.

> Selmani përcjell se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Tre lloje njerëzish ***nuk ka për t'u folur Allahu, as nuk ka për t'i pastruar, por do të kenë dënim të dhimbshëm***: imoralit të thinjur, të varfrit mendjemadh dhe ai që e ka bërë betimin në Allahun si mall tregu, duke shitur apo blenë vetëm duke u betuar në Të"[1].

[1] Tabarani me zinxhirë të saktë. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

– "... *nuk ka për t'u folur* ..." – E folura quhet e tillë kur fjalët artikulohen me zë dhe bëhen të dëgjueshme, ndërsa kur njeriu mendon në vetvete, ky proces, si rregull, nuk konsiderohet si e folur, si ligjërim, edhe pse në një kontekst të veçantë ajo mund të quhet e tillë, siç ndodh në ajetin e Allahut: "... dhe thonë me vete: 'Pse nuk na dënon Allahu për këtë që po flasim ..." (Muxhadele, 8). Po kështu, Omeri (r.a.), për ngjarjen e Sakifes,[1] ka thënë: "... Mendova disa fjalë në vetvete ...."[2] Mirëpo, parimisht, e folura – ose ligjërimi – ndërtohet me fonema dhe tinguj të dëgjueshëm.

Për çështjen e të folurës së Allahut ka pasur mjaft mosmarrëveshje, rreth tetë qëndrime, siç thotë Ibn Kajimi në librin "*Es Sauaikal Mursele*". Mirëpo nëse i kthehemi Librit të Allahut dhe Sunetit të Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), – që ta marrim besimin tonë të pastër prej tyre e t'i ndërpresim polemikat, pasi çdo popull që merret me polemika, e ka humbur rrugën e drejtë – mësojmë se e folura e Allahut është reale dhe e dëgjueshme, por zëri i Tij nuk është si ai i krijesave. E folura e Allahut është e përbërë nga fonema, tinguj dhe fjalë, të cilat janë të njëjta me ato të gjuhës së personit të cilit ato i drejtohen. Në të kundërt, e folura e Tij nuk do të kuptohej kurrë. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) i drejtohet çdokujt sipas gjuhës së tij.

Gjithashtu, në këtë hadith, mohimi i të folurës së Allahut ndaj një grupi të caktuar njerëzish, pohon se Allahu do t'u flasë disa të tjerëve. Me të njëjtën mënyrë, disa dijetarë argumentojnë se besimtarët do ta shohin Allahun Ditën e Kijametit, nisur nga ajeti i Tij: "Nuk është ashtu! Në të vërtetë ata (keqbërësit) do të pengohen nga shikimi i Zotit të tyre atë ditë." (Mutafifin, 15). Meqë të këqijtë do të pengohen ta shohin atë, kjo do të thotë se do ta shohin të mirët. Nëse nuk do të mund ta shihte askush, atëherë të këqijtë dhe të mirët do të ishin njëlloj. Po kështu, nëse mohon se Allahu i flet ndonjërit, kushdo qoftë ai, atëherë nuk do të kishte arsye pse të veçoheshin në hadith ata që Allahu nuk do t'u flasë.

Që Allahu flet, kjo nuk do të thotë patjetër që Ai ka aparat të foluri njëlloj si njeriu, që përbëhet nga gjuha, dhëmbët, fyti, etj. Po

---

[1] Sakife quhet vendi ku Ebu Bekri u zgjodh halif, nga i cili mori emrin edhe kjo ngjarje e rëndësishme.

[2] Buhariu.

ashtu, fakti që Allahu dëgjon, nuk do të thotë patjetër që Ai ka veshë. Toka për shembull, dëgjon dhe flet, ndërkohë që nuk ka as gjuhë, as veshë. Allahu thotë: "Atë ditë ajo do të tregojë lajmet e saj, sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë." (Zelzele, 4-5). Edhe lëkura do të flasë Ditën e Kijametit: "Kur të vijnë afër Zjarrit, kundër tyre do të dëshmojnë veshët, sytë dhe lëkura e tyre, për atë që kanë bërë." (Fusilet, 20). Po ashtu, duart dhe këmbët: "... atë Ditë që do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për atë që kanë bërë." (Nur, 24). Duart, këmbët, gjuha, veshët dhe sytë nuk kanë as gjuhë, as buzë, ashtu siç i njohim ne.

Por Allahu do t'u flasë atyre që kanë bërë krim edhe më të madh se këta dhe që do të jenë banorë të Zjarrit? Përgjigjja për këtë është se hadithi mohon të folurën e Allahut që shpreh kënaqësi, dhe jo të folurën që shpreh zemërim dhe qortim.

– "... *as nuk ka për t'i pastruar* ..." – Pastërtia për ata nënkupton besueshmërinë dhe drejtësinë. Ditën e Kijametit atyre nuk do t'u besohet, nuk do t'u merret parasysh drejtësia dhe as nuk do te dëshmohet për besimin e tyre (nuk dëshmohet se ata janë besimtarë), për shkak të veprimeve të poshtra që kanë bërë.

– "... *por do të kenë dënim të dhimbshëm* ..." – Pra, ndëshkimi ndaj tyre do të jetë i dhimbshëm.

– "... *imoralit të thinjur* ..." – Pra, në kokë i kanë dalë thinja të bardha, që tregon se është i moshuar. Epshi i është ftohur, prandaj nuk ka arsye për imoralitet, por pavarësisht nga kjo, ai e bën atë vepër, gjë që tregon se sa njeri i ndyrë është ai, ndonëse mosha i dikton mençurinë. Logjika te ai duhet të sundoi më tepër se epshi. Kështu që imoraliteti nga ana e tij është i pazakonshëm. Veprimet e tij nuk i nxit afshi i mishit, por qëllimet e ulëta dhe besimi i dobët. Kësisoj, shtytësit e tij në imoralitet janë mjaft të dobët. Përvoja jetësore është e gjatë dhe pjekuria duhet të ishte e madhe, por megjithatë, ai veproi atë çka bie ndesh me këtë.

Imoraliteti është akt në pjesët e përparme ose të prapme. Allahu i Madhëruar e ka ndaluar këtë vepër, duke treguar se ajo është poshtërsi: "Dhe mos iu afroni kurvërisë, se ajo është ligësi dhe rrugë

e shëmtuar!” (Isra, 32).

– “*… të varfrit mendjemadh …*” – Fjala ‘*ailun*’ në hadith, (në arabisht), do të thotë: ‘i varfër’, siç thuhet në fjalën e Allahut të Madhëruar: “… të gjeti të varfër (*ailen*) e Ai të begatoi.” (Duha, 8).

Mendjemadhësia është arrogancë dhe mbivlerësim i vetes. Ajo ka dy forma:

1. Mendjemadhësi ndaj së vërtetës, duke e refuzuar ose duke mos e përfillur atë.

2. Mendjemadhësi ndaj krijesave, duke i nënçmuar dhe poshtëruar ato. Kështu ka thënë edhe Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Mendjemadhësia është refuzimi i së vërtetës dhe nënçmimi i njerëzve.”[1]

Tek i varfri, motivet për mendjemadhësi janë të dobëta, prandaj kur bëhet edhe ai mendjemadh, kjo tregon se çfarë besimi të dobët dhe çfarë morali të fëlliqur ka ai. Për këtë arsye, dënimi i tij do të jetë i ashpër.

– “*… dhe atij që e ka bërë betimin në Allah si mall tregu, duke shitur apo blerë vetëm duke u betuar në Të.”* – Pra, betimin në Allahun e ka bërë si plaçkë të tij. Ky koment këtu është i pranueshëm sepse vetë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem.) e ka komentuar kështu duke thënë: “duke shitur apo blerë vetëm duke u betuar në Të.”. Në qoftë se vetë folësi e nxjerr nga domethënia e drejtpërdrejtë e saj, atëherë ai është më i ditur për qëllimin e tij. E tillë është edhe ajo që përmendet në hadithin kudsij: “Robi im, të kërkova ty të më ushqesh dhe nuk më ushqeve, të kërkova të më japësh të pi po nuk më dhe …”, Allahu e ka sqaruar më pas me fjalën e Tij: "Robi Im filani u urit ndërsa ti nuk e ushqeve, të kërkoj të pijë ndërsa ti nuk i dhe të pijë"[2].

Kështu që fjala: “… duke shitur apo blerë vetëm duke u betuar në Të.”, është koment i fjalës: "…e ka bërë betimin në Allah si plaçkë tregu…". Që do të thotë se, sa herë që shet diçka, betohet e betohet për të shitur e fituar sa më shumë. Ai e meriton dënimin, sepse edhe po të mos gënjejë, betimet e shumta të tij, tregojnë që ai i

[1] Muslimi.

[2] Trasmeton Muslimi.

nënçmon ato. Ai kundërshton edhe fjalën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "...Ruani betimet tuaja.".

E nëse betohet rrejshëm, ka bërë katër të këqija:

1. Ka nënvlerësuar betimin dhe ka kundërshtuar urdhrin e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) për ruajtjen e betimit.
2. Ka gënjyer.
3. Ka fituar pasuri në rrugë të padrejtë.
4. Ka bërë betim të rrejshëm.

Në rrugë të sakta, përcillet se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Kush betohet duke gënjyer dhe përvetëson në këtë mënyrë pasurinë e muslimanit, do ta takojë Allahun të hidhëruar me të."[1]

Është detyrë të ruhemi dhe të largohemi nga gjithçka që thotë hadithi, se përndryshe, ç'dobi do të kishte ai, nëse mësimet e tij nuk shfaqen në besimin, fjalët dhe veprat tona? Kështu ne do të bëheshin njëlloj me injorantët, madje në rrezik më të madh se ata. Prandaj, ne duhet që jo vetëm t'i njohim domethënien, por edhe të zbatojmë porositë e tij. Për ne, – që thonë se jemi dijetarë – është detyrë gjithashtu që t'ua përcjellim edhe të tjerëve paralajmërimet e haditheve, me qëllim që të jemi vërtet trashëgimtarë të Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), sepse Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ishte i ditur, veprues dhe thirrës. Nxënësi i dijes bëhet trashëgimtar i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) atëherë kur vepron ashtu siç veproi ai (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), në të gjitha aspektet.

Përfundimisht, është detyrë për ne që t'u tërheqim vërejtjen vëllezërve tanë muslimanë nga kjo vepër, e cila është shumë e përhapur sot: kthimi i betimit në Zot në plaçkë tregu, duke shitur apo blerë vetëm duke u betuar në Të.

Hadithi lidhet me temën, sepse kush e bën si mall tregtie betimin në Allah, tregon se ai betohet mjaft shpesh.

> Imran Ibn Husejni tregon se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Njerëzit më të të mirët e umetit tim janë ata të brezit tim, pastaj ata që do të vijnë pas tyre

[1] Buhariu, Muslimi.

> (Imrani thotë se nuk e di, a përmendi pas brezit të tij dy herë apo tri). Pastaj, pas jush do të vijnë njerëz që dëshmojnë pa u kërkuar të dëshmojnë, tradhtojnë dheprandaj njerëzit nuk ua besojnë amanetin, zotohen e nuk e përmbushin zotimin dhe që do të jenë mjaft të shëndoshur [1].”[2]

– “*Më të mirët e umetit tim janë ata të brezit tim …*” – Në një transmetim po të tyre (Buhariut dhe Muslimit), thuhet: “Më të mirët nga ju, janë ata të brezit tim…”, ndërsa në hadithin e Ibn Mesudit, thuhet: “Më të mirët e njerëzve janë ata të brezit tim.”[3] Ky është dhe qëllimi: që e mira përshkruhet si cilësi e njerëzve në përgjithësi, dhe jo vetëm e umetit. Për këtë, përcillet në rrugë të saktë se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Unë jam dërguar nga brezat më të mirë të bijve të Ademit.”.[4] Ndërsa për hadithin që thotë: “Më të mirët e umetit tim …”, thuhet se nëse mirësia është atribut i njerëzve në përgjithësi, atëherë këtu hyn edhe ky umet, por nëse e veçojmë këtë umet, do të përjashtoheshin njerëzit e tjerë. Marrja në konsideratë e të përgjithshmes, e cila përfshin edhe të veçantën, është më e mirë se e anasjella e saj. Ndoshta domethënia e të dyja shprehjeve është e njëjtë, pasi ky umet është më i miri i umeteve dhe, meqë sahabët kanë qenë më të mirët e brezave të tij, del se ata janë më të mirët e të gjithë njerëzve.

Ndërsa fjala ‘*karn’* (brez, gjeneratë), e përmendur në hadith, ka në zanafillë kuptimin ‘bashkim’. Atëherë, qëllimi është për atë grup njerëzish që i bashkojnë me njëri-tjetrin disa gjëra, si feja, mosha e të ngjashme. Disa dijetarë e kanë përkufizuar thjesht si ‘grup’, e disa të tjerë e kanë përkufizuar si kohë, epokë. Për këtë të fundit ka

---

[1] Përsa i përket dhjamosjes flitet për ata njerëz që janë të dhën pas ushqimit e pijes dhe i japin rëndësi shëndoshjes. Ndërsa ata që shëndoshjen e kanë jo nga dëshira dhe vullneti i tyre, por i tillë është konstrukti i tyre. Ata edhe pse hanë pak ushqim dhe nuk dëshirojnë dhjamosjen, ajo është jasht dëshirës së tyre. Hadithi nuk bën fjalë për ta, por për njerëz që janë të dhënë pas ngrënies dhe pirjes. Pra për njerëz që mendojnë për dynjanë dhe e kanë mendjen te ngrënia.

[2] Buhari dhe Muslimi.

[3] Buhariu, Muslimi.

[4] Buhariu.

pasur gjithashtu përcaktime të ndryshme. Disa thonë që është një periudhë dyzetvjeçare, disa thonë tetëdhjetë vjeçare, disa njëqind vjeçare dhe disa të tjerë njëqind e njëzet vjeçare.

Atëherë, sipas mendimit të parë, kuptimi i hadithit: "Më të mirët e umetit tim janë ata të brezit tim ...", është: më të mirët e umetit tim janë sahabët, kanë arritur ose jo njëqind vjet. Dihet se sahabi i fundit ka vdekur në vitin 110 ose 120 (sipas hixhrit), prandaj nëse pranojmë se flitet për një epokë njëqind e njëzet vjeçare, këtu futen të gjithë sahabët. Nëse e llogarisim epokën që nga momenti i parë i Shpalljes hyjnore, bëhen njëqind e tridhjetë e tre vjet, sepse kalendari islam e nis numërimin e viteve që nga koha kur ndodhi Hixhreti, domethënë trembëdhjetë vjet pas momentit të parë të Shpalljes hyjnore. Ky është brezi (periudha) i parë.

Ndërsa tabiini i fundit ka vdekur në vitin 180. Atëherë, largësia ndërmjet tabiinëve dhe sahabëve është gjashtëdhjetë vjet. Ndërsa tabi-tabiini i fundit ka vdekur në vitin 220. Ky është edhe fundi i brezit të tretë.

Përfundimisht, brezi i sahabëve është 133 vjet, nëse fillohet që nga momenti i parë i Shpalljes hyjnore, e nëse fillohet që nga Hixhreti, është 120 vjet. Brezi i tabiinëve është gjashtëdhjetë vjet, ndërsa brezi i tabi-tabiinëve është dyzet vjet.

Për këtë çështje, shejhu i Islamit Ibn Tejmije, ka thënë: "Një brez përcaktohet sipas shumicës së njerëzve që jetojnë në atë kohë. Nëse shumica e njerëzve janë sahabë, atëherë quhet brezi i sahabëve; nëse shumica e njerëzve janë tabiinë, atëherë është brezi i tyre, e kështu me radhë."

– "*... umetit tim ...*" – Umeti nënkupton bashkësinë e njerëzve që i janë përgjigjur thirrjes së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), dhe jo të gjithë ata të cilëve iu është bërë thirrja, sepse disa prej tyre nuk e kanë besuar atë, rrjedhimisht tek ata dhe nuk ka ndonjë mirësi.

– "*... Imrani thotë se nuk e di, a përmendi pas brezit të tij dy herë apo tri ...*" – Kjo do të thotë se, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e ka përmendur të paktën dy herë. Brezat më të mirë janë tre, dhe kjo njihet gjerësisht.

– "*... pas jush do të jenë njerëz që dëshmojnë pa u kërkuar të dëshmojnë ...*" – Pra, njerëz që dëshmojnë për atë që dinë, që kanë parë, dëgjuar, prekur ose e ndjerë. Dëshmia është pohim i njeriut për atë që di. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "... përveç atyre të cilët dëshmojnë për të vërtetën dhe e dinë mirë atë ...." (Zuhruf, 86). Nuk është kusht që dëshmia të nisë me fjalën 'dëshmoj', sipas mendimit më të saktë.

– "*... pa u kërkuar të dëshmojnë ...*" – Dijetarët kanë qëndrime e shpjegime të ndryshme në lidhje me domethënien e kësaj shprehjeje, si më poshtë.

1. Atyre nuk u kërkohet të dëshmojnë, sepse nuk dinë gjë për të vërtetën. Kësisoj, ata bëhen dëshmitarë të rremë.

2. Ata dëshmojnë para se t'u kërkohet dëshmia. Nxitimi i tyre për të dëshmuar tregon mosvlerësim të dëshmisë.

Ky shpjegim i dytë është disi i paqartë, duke pasur parasysh hadithin e Zejd Ibn Halidit, sjellë nga imam Muslimi, se Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "A t'ju lajmëroj për dëshmitarin më të mirë? Është ai që dëshmon, para se t'i kërkohet ajo.".[1] Ky është vlerësim i dëshirës për të dëshmuar para se ajo të kërkohet.

Siç shihet, hadithi i mësipërm nuk përputhet me hadithin e Imranit.

3. Disa dijetarë janë përpjekur ta shuajnë këtë kontradiktë, duke thënë se hadithi i Zejdit flet për njeriun që dëshmon për të vërtetën, që nuk e di ai për të cilin dëshmohet.

4. Disa thonë se hadithi i Zejdit flet për ata që dëshmojnë për çështjet që i përkasin vetëm të drejtës së Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), pra që nuk i kërkon dikush tjetër. Atëherë, këta janë urdhëruesit për të mirën dhe ndaluesit nga e keqja[2] e të ngjashëm me ta.

5. Ndërsa dijetarë të tjerë, përsëri duke harmonizuar faktet, thonë se në hadithin e Zejdit shprehja është figurative, pasi ajo

[1] Muslimi.

[2] Pra ata që punojnë në grupin e urdhëruesve për të mirën dhe ndaluesve nga e keqja, që gjenden në vendet ku gjykohet me Sheriat.

nënkupton dëshmitarin që dëshmon aq shpejt, sa duket sikur e kryer këtë detyrë para se t'i kërkohet ajo.

Disa dijetarë i kanë dhënë epërsi hadithit të Imranit mbi hadithin e Zejd Ibn Halidit, sepse i pari është në të dy *Sahih*-ët (të Buhariut dhe Muslimit), ndërsa i dyti është vetëm te *Sahih*-u i Muslimit. Mirëpo kur është i mundur harmonizimi mes tyre, nuk lejohet t'i japësh epërsi njërit, sepse kjo nënkupton anulim të tjetrit, ndërkohë që të dy janë të vlefshëm.[1]

– "*... që tradhtojnë dhe prandaj njerëzit nuk ua besojnë amanetet...*" – Kjo është cilësia e dytë e tyre: ata janë tradhtarë dhe nuk e mbajnë amanetin, kështu që njerëzit nuk u besojnë.

Nuk është thënë: "e marrin përsipër amanetin dhe pastaj tradhtojnë", sepse tradhtia është si veti e natyrshme e tyre, për shkak të së cilës atyre nuk u besohet.

Tradhtia është pabesi, shkelje e besës. Ajo është cilësi negative në çfarëdo lloj situate. Ndërsa ngritja e kurtheve dhe mashtrimi mund të jenë negative në një situatë të caktuar dhe pozitive në një tjetër. Prandaj, Allahut i përshkruhet ngritja e kurtheve dhe mashtrimi në rastet kur ato janë vlera pozitive. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "... ata po ngrinin kurthe, por edhe Allahu po ngrinte kurthe ..." (Enfal, 30); "Pa dyshim që hipokritët mundohen të mashtrojnë Allahun, por është Allahu Ai që i mashtron ata." (Nisa, 142).

Kurse tradhtia nuk i përshkruhet kurrë Allahut, sepse ajo është negative në çdo situatë. Prandaj, shprehje të tilla si: "Allahu e tradhton atë që tradhton", janë haram, sepse është përshkruar Allahu me një veti që nuk është e Tij. Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "Por në qoftë se ata mundohen të të tradhtojnë ty, ata vërtet që e kanë tradhtuar Allahun. Kështu që Ai tashmë të dha forcë mbi ta ..." (Enfal, 71), e nuk ka thënë: "Edhe Ai i tradhton ata".

– "*...dhe prandaj njerëzit nuk ua besojnë amanetet...*" – Pra, nuk

[1] Pastaj ka përmendur se çdo të ndodhë pas tre shekujsh, siç është shmangia nga feja dhe rendja e tepërt pas epshit. Ka thënë: "*... pastaj, pas jush janë njerëz që dëshmojnë pa u kërkuar të dëshmojnë ...*", për shkak të mospërfilljes (mosdhënies rëndësi) së çështjes së dëshmisë dhe moskërkimit nga ana e tyre të së drejtës. Kjo, për arsye të fesë së paktë të tyre dhe Islamit të tyre të dobët. (Marrë nga "Tejsir el Aziz el Hamid")

janë të besës. Prej tyre nuk ka siguri për jetën, pasurinë, nderin dhe as për ndonjë gjë tjetër.

Nga konteksti i hadithit duket se bëhet fjalë për shekullin e katërt hixhri. E ç'mund të thuhet për sot, për shekullin e 15-të?!

Në një hadith tjetër thuhet: "... ndër ta do të përhapet gënjeshtra".[1]

– "*... që zotohen e nuk e përmbushin zotimin ...*" – Kjo është cilësia e tretë e tyre. Zotim është detyrimi që njeriu i ngarkon vetes. Detyrim mund të jetë ndaj të tjerëve, duke u kthyer në një kontratë ndërmjet tij dhe të tjerëve, por mund të jetë edhe detyrim ndaj Allahun, për shembull, për kryerjen e ndonjë adhurimi.

Njerëz të tillë i zotohen Allahut dhe nuk e zbatojnë zotimin, u zotohen krijesave dhe nuk e mbajnë zotimin. Kjo është gjithashtu nga cilësi e munafikëve.

– "*... dhe që do të jenë mjaft të shëndoshur.*" – Kjo është cilësia e katërt. Kjo pjesë e hadithit është disi e paqartë. Nëse shëndoshja e tepërt nuk është në dëshirën e njeriut, atëherë përse kjo është një cilësi negative?

Megjithatë, dijetarët thonë se qëllimi është për ata që angazhim kryesor kanë mënyrat që çojnë në dhjamosje, të cilat janë ushqimet dhe pijet e tepërta. Ndërsa shëndoshja që nuk është në dorën e njeriut, nuk është e dënueshme, ashtu siç nuk qortohet njeriu se është i gjatë ose i shkurtër, i zi ose i bardhë.

> Ibn Mesudi përcjell se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "*Më të mirët e njerëzve* janë brezi im, pastaj ata që vijnë pas tyre, pastaj ata që vijnë më pas. ***Pas këtyre, do të vijnë njerëz, dëshmia e të cilëve do t'i paraprijë betimit dhe betimi do t'i paraprijë dëshmisë.[2]***".[1]

[1] Ahmedi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe.

[2] Për shkak se janë të pabesueshëm, këta njerëz betohen sa herë japin dëshminë. Kështu ndodh që ndonjëherë ata japin dëshminë para se të betohen dhe ndonjëherë betohen para se të japin dëshminë. Këta njerëz nuk i kushtojnë rëndësi as dëshmisë dhe as betimit.

– "*Më të mirët e njerëzve janë brezi im* ..." – Kjo është argument se brezi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) janë njerëzit që qëndruan me të. Sahabët e tij janë më të mirë se ndihmuesit e Isait dhe më të mirë se shtatëdhjetë vetët që zgjodhi Musai (alejhi selam).

– "... *Pas këtyre* ..." – Pra, tani flitet për njerëzit pas tre brezave.

– *"... do të vijnë njerëz, dëshmia e të cilëve do t'i paraprijë betimit dhe betimi do t'i paraprijë dëshmisë ..."* – Kjo ka dy shpjegime:

1. Për shkak të besueshmërisë së vogël të tyre, të cilët dëshmojnë vetëm se duke u betuar; ndonjëherë paraprin dëshmia, e ndonjëherë betimi.

2. Shprehja është figurative, që tregon se ata nuk duan t'ia dinë për dëshminë e as për betimin. Për ta, dëshmia dhe betimi janë një lojë.

Shpjegimet nuk bien ndesh me njëri-tjetrin, prandaj të dy merren si të pranueshëm.

– "... *Pas këtyre, do të vijnë njerëz ..."* – Shprehja tregon se në këtë përshkrim nuk përfshihen të gjithë pjesëtarët e brezit, pasi nuk është thënë: "Pastaj njerëzit do të jenë ...", ku ndryshimi është i qartë.

Mirësia e brezave të parë kuptohet si cilësi e përgjithshme e kategorisë së tyre, pra nuk do të thotë se ndër pasuesit e tabiinëve nuk ka pasur më të mirë se tabiinët, apo se ndër tabiinët nuk ka pasur më të ditur se ndonjë nga sahabët. Vlerën e sahabëve askush nuk e arrin dot, por për sa i përket diturisë dhe adhurimit, mund të ketë ndonjë pas sahabëve që ndoshta ua ka kaluar disave prej tyre.

> Ibrahimi ka thënë: "Kur ishim të vegjël, na rrihnin për dëshminë dhe besën."[2]

– "*Ibrahimi ka thënë ..."* - Flitet për Ibrahim Nehaiu, *tabiin* dhe njëri nga dijetarët e tyre.

---

[1] Buhari dhe Muslimi.
[2] Buhariu dhe Muslimi.

– "… *na rrihnin* …" – Me sa kuptohet, ata që i rrihnin ishin kujdestarët e tyre.

– "… *na rrihnin për dëshminë* …", Kjo kuptohet: Na rrihnin për dëshminë e rreme, ose për mosdëshmi, kur ishim dëshmitarë. Ata rriheshin, me qëllim që të nxiteshin të dëshmonin dhe të jepnin besën. Kështu e ka komentuar Ibn Abdul Berri.

– "… *dhe besën* …" – Pra, kur jepnin besën, i rrihnin me qëllim që ta çonin në vend atë.

– "*Kur ishim të vegjël*. …" – Kjo tregon se rrahja bëhej për t'i edukuar.

Nga fjalët e Ibrahimit mësohet se dëshmia pranohet edhe prej minorenëve, por për këtë qëndrim ka pasur edhe kundërshtime dijetarësh.

Disa prej tyre thonë se është kusht që personi i cili jep dëshminë të jetë në moshë madhore. Nëse ai e ka dëshmuar ngjarjen në moshë të vogël, përsëri nuk i pranohet dëshmia, derisa të arrijë moshën e pjekurisë.

Të tjerë thonë se minorenëve u pranohen dëshmitë vetëm për çështje që ata kanë me njëri-tjetrin, sepse në mes të fëmijëve rrallë gjendet ndonjë me moshë madhore.

Po kështu, disa dijetarë thonë se dëshmia e minorenëve për njëri-tjetrin është e pranueshme vetëm kur jepet në moment, sepse më vonë, pas largimit nga vendi, ata mund të harrojnë ose mund të flasin atë çka u diktohet.

Atëherë, rruga e vetme është që të pranohet dëshmia e tyre për njëri-tjetrin, ose përndryshe do të humbnin shumë të drejta ndërmjet të vegjëlve.

Gjithashtu, nga hadithi mësohet se lejohet rrahja e të vegjëlve, me qëllim për t'i edukuar ata, kur nuk ka rrugë tjetër edukimi.

Dobitë e temës

- Porosia për ruajtjen e betimeve.

Kjo del nga ajeti: "... Ruani betimet tuaja." Porosia është urdhër.

- Mësimi se betimi nxit shitjen e mallit, por ia heq fitimin.

Kjo del nga fjala e Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Betimi nxit shitjen e mallit, por ia heq fitimin"

- Kërcënimi i ashpër për ata që shesin e blejnë vetëm duke u betuar.

Kjo del nga fjala e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "... atij që e ka bërë betimin në Allah si plaçkë tregu, duke shitur apo blerë vetëm duke u betuar në Të.". Ky do të jetë prej atyre tri kategorive të njerëzve që Allahu as nuk ka për t'u folur e as nuk ka për t'i pastruar.

- Sa më i dobët të jetë motivi që të shtyn në gjynah, aq më i madh konsiderohet gjynahu.

Kjo del nga fjala e Selmanit, ku thuhet se imorali plak dhe i varfri mendjemadh do të kenë ndëshkim mjaft të ashpër, për motivet e tyre të dobëta në kryerjen e mëkatit.

- Qortimi i atyre që betohen edhe atëherë kur nuk u kërkohet ta bëjnë.

Kjo mësohet nga pjesa e hadithit: "...atij që e ka bërë betimin në Allah si plaçkë tregu, duke shitur apo blerë vetëm duke u betuar në Të.".

Por kjo nuk është absolute, pasi Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është betuar pa iu kërkuar të betohej, në mjaft raste. Madje

Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) e ka urdhëruar tri herë të betohet në Kuran, pa iu kërkuar një gjë e tillë: "Ata kërkojnë shpjegim prej teje: 'A është e vërtetë (ajo që na ke premtuar)?' Thuaj: 'Po, për Zotin tim!...'" (Junus, 53). "Ata që nuk besuan, mendojnë se kurrë më nuk do të ringjallen. Thuaj (o Muhamed): 'Po, për Zotin tim, me siguri që do të ringjalleni e pastaj do të njoftoheni për atë ç'keni bërë!'..." (Tegabun, 7); "Ata që nuk besojnë, thonë: 'Ora nuk do të vijë tek ne.' Thuaju (o Muhamed): 'Po, për Zotin tim! Ajo do të vijë ...'". (Sebe, 3). Përfundimisht, kur është e nevojshme dhe frytdhënëse, lejohet të betohesh pa t'u kërkur betimi, madje mund të jetë e pëlqyer. Në ngjarjen që flet për rastin e gruas së fisit Mahzum, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) u betua: "Për Allahun, sikur Fatimja, bija e Muhamedit, të vidhte, unë do t'ia prisja dorën asaj."[1] Kjo pati një ndikim të madh te njerëzit që u shqetësuan nga çështja e asaj gruaje, por edhe te brezat pasardhës.

> ➢ Lavdërimi që Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) u bëri tre ose katër brezave dhe përshkrimi se çfarë do të ndodhë pas tyre.

Kjo mësohet nga hadithi: "Më të mirët e njerëzve janë ata të brezit tim ...".

Autori thotë: "... tre ose katër brezave, duke u bazuar në hadithin ku përmenden katër breza, mirëpo shumica e hadithеve të tjera nuk e kanë këtë shtesë.

Gjithashtu, do të ishte më mirë sikur çështja e përshkrimit se çfarë do të ndodhë pas atyre brezave të renditej në një pikë të veçantë, pasi përmbushja e një parashikimi është argument për profetësinë e Muhamedit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

> ➢ Qortimi i atyre që dëshmojnë, pa iu kërkuar ta bëjnë këtë.

Kjo del nga hadithi i Imranit, ku dënohen edhe ata që tradhtojnë dhe nuk e mbajnë amanetin, ata që zotohen dhe nuk e përmbushin

[1] Buhariu dhe Muslimi.

zotimin dhe ata që kujdesen për shëndoshjen e tepërt të trupit, ndërkohë që nuk e vrasin mendjen për shëndoshjen e zemrës me besim dhe dituri.

- Selefët i rrihnin fëmijët e tyre, për çështjet e dëshmisë dhe besës.

Kjo del nga fjala e Ibrahim Nuhaiut: "Kur ishim të vegjël, na rrihnin për dëshminë dhe besën."

Nga kjo thënie mësohet gjithashtu sesa të shenjta janë besa dhe dëshmia, pasi edhe të vegjlit rriheshin për to.

Këtu kuptohet edhe se sa rëndësi që u kanë kushtuar selefët edukimit të fëmijëve. Një nga metodat e tyre të edukimit ishte edhe rrahja, duke u mbështetur në këshillën e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) për fëmijën që ka mbushur dhjetë vjeç dhe nuk dëgjon të falë namaz. Megjithatë, rrahja si praktikë e lejuar, ka disa kushte, si:

a) I vogli të jetë i aftë që ta kuptojë qëllimin e rrahjes.

b) Edukimi të bëhet nga ai që është përgjegjës për fëmijën.

c) Të mos teprohet me rrahjen, qoftë në masë, formë, lloj, vend etj.

d) Të ushtrohet vetëm kur fëmija ka bërë vërtetë diçka që e meriton dënimin.

e) Duhet pasur parasysh që qëllimi të jetë edukimi i tij e jo hakmarrja, se qëllimi i hakmarrjes nuk është edukimi, por epërsia mbi tjetrin.

Tema 63

Argumentet për ruajtjen e besës me Allahun dhe me Profetin e Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Besa është marrëveshje, kontratë që duhet respektuar. Ajo quhet kështu, për arsye se, nëpërmjet saj, personi merr përsipër respektimin e marrëveshjes, siç merr përsipër borxhliu shlyerjen e borxhit.

Allahu i Madhëruar u ka marrë besën të gjithë robërve të Tij që ta adhurojnë Atë dhe të mos i shoqërojnë asgjë në adhurim. Ndërsa Allahu u ka dhënë besën robërve që të mos e dënojë atë që nuk i shoqëron asgjë Atij. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “Në të vërtetë, Allahu mori besëlidhjen nga bijtë e Israilit (çifutët) dhe Ne caktuam dymbëdhjetë udhëheqës prej tyre. Allahu tha: ‘Unë jam me ju, nëse ju kryeni rregullisht faljet, jepni zekatin dhe besoni në Profetët e Mi, nderojini dhe i ndihmojini ata dhe lini tek Allahu hua të mirë …”. Kjo është besa që Allahu ka marrë prej tyre. Pastaj thotë: “Pa dyshim që Unë do t’jua fal gjynahet dhe do t’ju pranoj në Kopshte, poshtë të cilëve rrjedhin lumenj.” (Maide, 12). Kjo është besa që Allahu u ka dhënë atyre. Po kështu, Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) thotë: “… dhe përmbushni kërkesat e Mia ndaj jush, që Unë pastaj të përmbush kërkesat tuaja ndaj Meje …” (Bekare, 40).

Edhe Profeti ka marrë një premtim nga umeti i tij: të pasojnë fenë e tij dhe të mos shtojnë sajesa në të. Po ashtu, edhe umeti ka marrë një premtim nga Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): t’ua përcjellë atyre fenë, pa u fshehur gjë. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka

treguar se: "Nuk ka ndonjë Profet, që nuk e ka pasur për detyrë ta udhëzojë umetin e tij në atë që është më e mira."[1]

Besa lidhet ndërmjet dy palëve, ashtu si një kontratë, siç qe, për shembull, Marrëveshja e Hudejbies, që Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) bëri me banorët e Mekës.

> Allahu i Madhëruar thotë: "Zbatoni besëlidhjen e Allahut, kur ta merrni mbi vete, dhe mos i thyeni betimet, pasi t'i keni vërtetuar ato, kur Allahun e bëni dorëzanin tuaj. Vërtet, Allahu e di se çfarë punoni." (Nahl, 91)

– "*Zbatoni besëlidhjen e Allahut, kur ta merrni mbi vete...*" – Pra, nëse keni dhënë besën, atëherë duhet ta përmbushni atë. Pastaj, Allahu e përforcon më tej këtë ide, duke thënë: "... mos i thyeni betimet, pasi t'i keni vërtetuar ato ...".

– "*.. .kur Allahun e bëni dorëzanin tuaj.*" – Kjo është pjesë e qortimit të fortë ndaj atij që thyen besën dhe betimin, sepse kur është dhënë besa, është thënë se garant për të është Allahu.

- "*Vërtet, Allahu e di se çfarë punoni.*" – Ajeti përfundon me kërcënimin ndaj thyerjes së besës, sepse kur njeriu e mëson se Allahu di gjithçka që ai vepron, atëherë nuk e thyen besën.

Tema lidhet me teuhidin, sepse mospërmbushja e besës me Allahun do të thotë mungesë në madhërimin e Tij, e kjo është mangësi në teuhid.

> Nga Burejde përcillet se Pejgamberi i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), kur caktonte një komandant për ushtrinë ose për një njësi të ushtrisë, e porosiste për devotshmëri ndaj Allahut, për sjellje të mirë me muslimanët dhe thoshte: "Luftoni me emrin e Allahut, në rrugën e Allahut! Luftoni ata që e mohojnë Allahun. Luftoni dhe mos e përvetësoni në fshehtësi plaçkën e luftës, mos tradhtoni, mos gjymtoni, as mos vrisni fëmijë.

[1] Muslimi.

> Kur të ndesheni me armiqtë idhujtarë, ftoji në tri gjëra. Nëse u përgjigjen njërës prej tyre, pranojeni dhe mos i luftoni:
> Së pari, ftoji ata në Islam; nëse ju përgjigjen, pranojeni prej tyre dhe mos i luftoni. Pastaj ftoji që të shpërngulen nga vendi i tyre, drejt vendit të muhaxhirëve (emigrantëve). Tregoju atyre se do të kenë ato të drejta dhe ato detyrime që kanë edhe muhaxhirët. Nëse nuk duan të largohen prej tij, tregoju se do të trajtohen si beduinët muslimanë, duke u zbatuar mbi ta gjykimi i Allahut: nuk do të kenë pjesë në plaçkën e luftës e as pjesë nga thesari, vetëm nëse luftojnë bashkë me muslimanët. Nëse refuzojnë të pranojnë islamin, kërkoju të japin *xhizjen*. Nëse janë dakord të japin xhizjen, pranoje dhe mos i luftoni.
> Nëse refuzojnë të japin xhizjen, kërkojini ndihmë Allahut dhe luftojini. Nëse i rrethon banorët e një fortese dhe ata kërkojnë prej teje që t'u jepësh besën e Allahut dhe të Profetit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), mos u jep atyre besën e Allahut dhe besën e Profetit të Tij, por jepu besën tënde dhe besën e shokëve tu, sepse nëse ju e shkelni besën tuaj dhe të shokëve tuaj, kjo është më e lehtë sesa të shkelet besa e Allahut dhe e Profetit të Tij. Nëse i rrethon banorët e një fortese dhe ata kërkojnë prej teje që t'u japësh vendimin (ligjin) e Allahut, mos e prano këtë kusht, por jepu vendimin tënd, sepse ti nuk e di a gjen për ta vendimin e duhur të Allahut, apo jo.”[1]

– “… *kur caktonte një komandant për ushtrinë* …” – Komandanti, në fillimet e Islamit, merrte përsipër ekzekutimin e vendimeve, gjykimet, fetvatë dhe drejtimin e namazeve me xhemat.

– “… *ose për një njësi* …” – Lidhëza *‘ose’* këtu nuk tregon dyshim

[1] Muslimi.

nga përcjellësi, por llojshmëri. Ushtria quhet e tillë kur numri i ushtarëve i kalon katërqind burra, ndërsa njësia është më e vogël.

Njësitë ushtarake, sipas funksioneve që kanë, ndahen në tri lloje kryesore:

1- Njësitë që zhvendosen nga vendi. Këto e ndajnë plaçkën e luftës që zënë.

2- Njësitë pararojë, kur në luftë del e gjithë ushtria.

3- Njësitë që kthehen të fundit nga lufta.

Dijetarët i dallojnë këto njësi nga njëra-tjetra, në lidhje me plaçkën e luftës. Njësisë pararojë i takon çereku i plaçkës pas ndarjes së një të pestës, sepse ajo ka ushtrinë që i vjen pas, e cila do ta ndihmojë. Ndërsa njësisë që mbetet e fundit në kthim, i takon një e treta e plaçkës pas një të pestës, sepse ushtria e ka lënë pas, kështu që rreziku për të është më i madh. Megjithatë, e gjithë kjo varet nga vendimi i komandantit: nëse ai dëshiron t'u japë, u jep, e nëse nuk dëshiron, nuk u jep, si të jetë më e volitshme.

– "*... e porosiste ...*" – Porosia është një këshillë dhe udhëzim tepër i rëndësishëm.

– "*... për devotshmëri ndaj Allahut ...*" – Devotshmëria është zbatimi i urdhrave të Allahut dhe largimi nga ndalesat e Tij, me vetëdije. Fjala arabe "*takua*" (devotshmëri) rrjedh nga fjala "*el uikaje*" (mburojë). Pra, kuptimi është që të krijosh një mbrojtje ndaj ndëshkimit të Allahut, e cila mund të arrihet vetëm duke zbatuar detyrimet dhe duke u larguar nga haramet. Të tjerë kanë thënë se "*takua*" do të thotë të punosh duke qenë i bindur ndaj Allahut, i ndriçuar nga Ai, duke shpresuar shpërblimin e Tij, duke lënë atë që ka ndaluar Ai dhe duke iu frikësuar ndëshkimit të Tij. Ndërsa disa të tjerë e kanë bërë përkufizimin me një strofë:

Lëri mëkatet, të vogla e të mëdha,
Takua është kjo, e tjetër nuk ka!
Vepro si ai që ecën mbi gjemba,
që hapin e ruan, kudo ku shkel këmba!
Të voglin gjynah mos nënçmo kurrë,
Se një mal të rëndë e kanë bërë shumë gurë!
Këto këshilla tona, të gjitha sa u thanë,

Ta dish, o njeri, kuptimin një e kanë!

Komandanti i ushtrisë porositej për devotshmëri, sepse në përgjithësi, pushteti sjell mendjemadhësi, dhe prej kësaj lind frika se ai nuk do të mbajë drejtësi. Po ashtu, devotshmëria e tij është shkak për devotshmërinë e vartësve të tij.

– "*... për sjellje të mirë me muslimanët ...*" – Është porositur që, ndaj muslimanëve të cilët ka pranë, të bëjë më të mirën, qoftë për çështjet e dynjasë apo ahiretit. Të zgjedhë për ta atë çfarë është më e lehta, të kërkojë për ta tokën më pjellore – kur janë mbi kuaj ose deve, – t'i mbrojë nga padrejtësia, t'i urdhërojë për të mirën dhe t'i ndalojë nga të këqijat, e të tjera.[1]

Prej kësaj pjese të hadithit, mësohet se është detyrë për drejtuesit e muslimanëve, që të zgjedhë për ta rrugën më të mirë. Gjithashtu, ndryshe nga ç'mund të bëjë për veten e tij, të tjerët duhet t'i urdhërojë vetëm për çështje që janë detyrime.

– "*... Luftoni me emrin e Allahut ...*" – Qëllimi mund të jetë që luftëtarët t'i kërkonin ndihmë Allahut, ose që ta nisnin betejën me emrin e Allahut.

Mendimi i parë duket më i qartë, por edhe i dyti është i mundshëm, sepse nisja për luftë e një ushtrie është çështje mjaft e rëndësishme, dhe çdo çështje e rëndësishme që nuk fillon me emrin e Allahut, është pa bereqet.

– "*... në rrugën e Allahut ...*" – Lidhja është me fjalën: "Luftoni...". Kjo është një vërejtje nga Pejgamberi për të rregulluar nijetin, sepse luftëtarët mund të kenë qëllime të ndryshme, por lufta e suksesshme, me të cilën arrihet njëra nga dy mirësitë, është ajo që bëhet vetëm për Allahun, domethënë të luftosh që fjala e Allahut të jetë më e larta, e jo për fanatizëm, për trimëri, për t'u dukur ose për të arritur diçka nga dynjaja. Lufta në mbrojtje të atdheut, kur vendi është në fenë Islame, prandaj duhet mbrojtur ai dhe muslimanët e tij, përbën një nijet të saktë fetarisht. E nëse lufton vetëm për atdhe,

[1] E ka porositur të veprojë më të mirën me muslimanë që janë me të, si: sjellja butë me ta, bamirësia ndaj tyre, shtrirja e krahut me dashamirësi ndaj tyre dhe lënia e madhështimin mbi ta. ("Fethul Mexhid")

kjo luftë nuk është në rrugë të Allahut.

Shprehja: "...në rrugën e Allahut..." përshkruan qëllimin dhe veprën. Për qëllimin u fol më lart, ndërsa vepra "në rrugë të Allahut" do të thotë që lufta të jetë sipas ligjeve të fesë së Tij, sipas udhëzimeve të Allahut.

– "*... Luftoni ata që e mohojnë Allahun...*" – Fjala "Luftoni" është në mënyrën urdhërore, duke treguar një detyrë. Ajo do të thotë që është detyrë për ne të luftojmë ata që e mohojnë Allahun. Allahu thotë: "O ti Pejgamber! Luftoji mosbesimtarët dhe munafikët dhe bëhu i ashpër ndaj tyre!" (Tahrim, 9). "O ju që keni besuar! Luftojini mosbesimtarët që i keni afër jush ..." (Tebe, 123). Nëse luftojmë atë që janë pranë nesh dhe ata e pranojnë Islamin, atëherë luftojmë ata që vijnë pas tyre, e kështu me radhë, derisa të përfundojmë në skajet lindore dhe perëndimore të tokës.

– "*... ata që e mohojnë Allahun ...*", do të thotë: luftojini ata për shkak të kufrit të tyre. Kësisoj, ne nuk i luftojmë njerëzit për fanatizëm apo për nacionalizëm, por i luftojmë për shkak të kufrit të tyre, në fakt për të mirën e tyre, që të shpëtojnë nga zjarri i Xhehenemit.

Kufri vërtitet rreth mohimit dhe mendjemadhësisë, që do të thotë se qafirët tregojnë mendjemadhësi ndaj adhurimit ose mohojnë atë që është detyrë të pranohet e të besohet.

– "*... Luftoni...*" – E ka përsëritur këtë fjalë, për ta përforcuar idenë, sikur ka dashur të thotë: mos e nënvlerësoni asnjëherë luftën.

– "*... dhe mos e përvetësoni në fshehtësi plaçkën e luftës ...*" – Kjo gjë është një nga gjynahet e mëdha. Allahu thotë: "Kushdo që përvetëson në mënyrë të fshehtë prenë e luftës, do të vijë i ngarkuar me të Ditën e Kijametit ..." (Ali Imran, 161). Kush e bën këtë, Ditën e Kijametit do të ndëshkohet me plaçkën që ka grabitur, ndërsa në këtë botë ka masa të tjera ndëshkuese. Dijetarët thonë se atij që përvetëson fshehurazi plaçkën e luftës, i digjet e gjithë pasuria e tij, me përjashtim të:

1. librit të Kuranit, për shkak se është i shenjtë;
2. armëve, për shkak të vlerës së tyre;
3. qenieve me shpirt, pasi nuk lejohet ndëshkimi i tyre me zjarr.

– "... *mos tradhtoni* ..." – Kjo është pjesa e hadithit që dëshmon për çështjen në fjalë. Nëse bën një marrëveshje, është haram shkelja e saj. Nga ana tjetër, kur nuk ka marrëveshje, lejohet të dredhosh, sepse lufta është dredhi. Për këtë, tregohet se, njëherë, Ali Ibn Ebu Talibit i doli një idhujtar për dyluftim. Kur ai u afrua, Aliu thirri: "Unë nuk kam dalë që të luftoj me dy burra!" Idhujtari ktheu kokën, duke menduar se prapa kishte ardhur ndonjë shok i tij për ta ndihmuar, por në këtë çast Aliu (r.a.) e vrau.

Marrëdhëniet tona me idhujtarët mund të jenë në njërën nga këto tri gjendje:

1- Kur ndërmjet nesh dhe atyre nuk ka ndonjë marrëveshje. Në këtë rast, është detyrë luftimi i tyre, pasi i kemi ftuar në Islam, ndërsa ata e kanë refuzuar këtë ftesë dhe pasi kanë refuzuar të japin *xhizjen*, e mbi të gjitha, kur i kemi mundësitë ta bëjmë këtë.

2- Kur ndërmjet nesh dhe atyre ka marrëveshje, së cilës ata i përmbahen. Në këtë rast, edhe ne e kemi detyrë t'i përmbahemi besëlidhjes me ta, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Sa kohë që ata t'i përmbahen marrëveshjes, përmbajuni edhe ju ..." (Teube, 7) dhe "Respektojeni marrëveshjen me ta deri në fund ..." (Teube, 4).

3- Kur ndërmjet nesh dhe atyre ka ndonjë marrëveshje, mirëpo ne kemi frikë se ata do ta tradhtojnë atë. Në këtë rast është detyrë që ta prishim marrëveshjen, por duke i lajmëruar ata se nuk ka më marrëveshje, siç thotë Allahu (Subhanehu ue Te'Ala): "Nëse keni frikë se ndonjë popull e thyen besën, atëherë edhe ti prishe marrëveshjen me të njëjtën mënyrë, sepse Allahu nuk i do ata që tradhtojnë." (Enfal, 58).

- "... *mos gjymtoni* ..." – 'Gjymtim' do të thotë prerje e disa pjesëve të trupit, si të hundës, gjuhës e të tjera. Kjo mund të ndodhë kur e kap armikun rob, por kjo nuk lejohet. Ai është një veprim i panevojshëm, një hakmarrje jo në vendin e duhur.

Megjithatë, ka mendime të tjera dijetarësh në lidhje me rastin kur ata e veprojnë me ne diçka të tillë.

Është thënë se nuk duhet të veprohet në të njëjtën mënyrë ndaj tyre, sepse ndalimi është gjithëpërfshirës. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk ka bërë ndonjë përjashtim. Gjithashtu, si mund t’i gjymtojmë ata, kur mbase ndonjëri prej tyre nuk e ka miratuar veprimin e popullit të vet.

Nga ana tjetër, është thënë se edhe ne mund t’i gjymtojmë, ashtu siç bëjnë ata me ne. Ndalimi gjithëpërfshirës vihet përballë një përgjithësimi tjetër, që është fjala e Allahut (Subhanehu ue Te‘Ala): “Atëherë, nëse ndonjë i kalon kufijtë ndaj jush, edhe ju keni të drejtë t'i kaloni kufijtë ndaj tij, në atë masë që i kaloi ndaj jush …”. (Bekare, 194). Nëse ne nuk ua kthejmë atyre me të njëjtën formë, kjo mund të interpretohet si dobësi, prandaj ne duhet të demonstrojmë forcë ndaj tyre, që ata të mos sillen më ashtu me ne.

Më afër të vërtetës është mendimi i dytë. Nëse thuhet se kështu mund të gjymtojmë ndonjë që nuk e ka miratuar këtë veprim, kur e kanë bërë njerëzit e vet, ne përgjigjemi se veprimi i një individi në një popull, konsiderohet si veprim i gjithë atij populli. Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) u është drejtuar jehudive në kohën Profetit tonë (‘alejhis–selam) për çështje që kanë ndodhur në kohën e Musait (‘alejhis–selam) Allahu thotë: “Dhe, pasi vratë një njeri e u grindët me njëri-tjetrin në lidhje me të …” (Bekare, 72); dhe: “Kur morëm besën tuaj dhe ngritëm mbi ju malin e Turit …” (Bekare, 93), e të tjera të ngjashme.

- “*… as mos vrisni fëmijë…*” – Arsyet janë se fëmijët nuk luftojnë dhe se ndoshta ata mund të bëhen muslimanë.

Në hadithe të tjera thuhet se nuk vriten edhe murgjit, të moshuarit e shtyrë në moshë dhe as gratë[1], vetëm nëse ata luftojnë, nxisin për luftë ose japin këshilla për luftën. Kështu u vra Durejd Ibn Samme në luftën e Thekifit, edhe pse ishte plak e i verbër[2].

Ky hadith është sjellë si argument që lufta nuk bëhet që të tjerët të pranojnë Islamin, por për ta mbrojtur Islamin. Nga ky mendim ka anuar edhe shejhu i Islamit Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!). Ai ka shkruar edhe një broshurë në lidhje me këtë çështje, të titulluar “*Kital el kufar*”.

[1] Buhariu dhe Muslimi.
[2] Buhariu

– "*… Kur të ndesheni me armiqtë idhujtarë …*" – I ka quajtur "armiq", me qëllim që njerëzit të nxiten më tepër për luftë ndaj tyre. Kur je i vetëdijshëm se dikush është armiku yt, kjo të motivon më tepër për ta luftuar atë, prandaj edhe Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) thotë: "O ju që keni besuar! Mos i bëni armiqtë e Mi dhe armiqtë tuaj miq e shokë …" (Mumtehine, 1). Ky ajet është më i përgjithshëm sesa ajeti tjetër: "O ju që keni besuar! Mos i zini çifutët dhe të krishterët për miq …." (Maide, 51), ku veçohen hebrenjtë dhe të krishterët. Armiku është i kundërti i mikut (*uelij*), mbrojtësit, përkrahësit. Mik është ai që merr përsipër çështjet e tua, kujdeset për ty, të ndihmon e të mbron, ndërsa armiku të lë në baltë, largohet prej teje dhe të bën padrejtësi.

– "*… me armiqtë idhujtarë …*" – Kjo përfshin të gjithë jobesimtarët, deri edhe hebrenjtë e të krishterët.

– "*… ftojini në tri gjëra. Nëse u përgjigjen njërës prej tyre, pranojeni dhe mos i luftoni. Së pari, ftojini ata në Islam …*" – Në këtë rast, në "Islam" futet edhe imani, sepse kur nocioni "Islam" përmendet veçmas, ai përfshin edhe imanin, ndërsa kur përmenden të dy në një kontekst, atëherë secili ka domethënien e tij të posaçme, siç bëri Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) në ngjarjen me Xhibrilin.

Imani, sipas *ehli sunetit*, përfshin edhe veprat, pasi Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) thotë: "Imani ka shtatëdhjetë e ca degë, më e larta ndër të cilat është fjala "*La ilahe il'All-llah*", ndërsa më e ulëta është largimi i pengesës nga rruga. Turpi është degë e imanit."[1]

Nëse ata e pranojnë Islamin, atëherë kjo është ajo që duan muslimanët, prandaj nuk lejohet që t'i luftojmë.

– "*… Pastaj ftojini që të shpërngulen nga vendi i tyre, drejt vendit të muhaxhirëve…*" – Kjo shprehje të jep të kuptosh se flitej për banorët e bjeshkëve, beduinët. Nëse ata e pranonin Islamin, u kërkohej që të vinin në vendin e muhaxhirëve. Qëllimi ishte që ata të mësonin fenë e Allahut, sepse jetesa në izolim është jetë edhe larg

[1] Buhariu dhe Muslimi.

diturisë. Allahu ka thënë: "Beduinët janë mohuesit dhe hipokritët më të mëdhenj dhe më të prirë për të mos njohur kufijtë që Allahu ia ka shpallur Profetit të Tij ..." (Teube, 97). Ky është, në parim, gjykimi për ata që banojnë në zona të izoluara.

– "*... drejt vendit të muhaxhirëve ..."* – Ndoshta flitet për Medinën, por mund të jetë për qëllim edhe cilido vend që është i vlefshëm për të emigruar atje, domethënë kur është vend islam, qoftë apo jo Medina. Interpretimin e dyte – pra, cilido vend që është i vlefshëm për të emigruar - e fuqizon fakti se po të ishte për qëllim Medina, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) do ta përmendte emrin e saj, pa i bërë vetëm një përshkrim të përgjithshëm. Ndërsa mendimin e parë e fuqizon fakti se vendi i parë i muhaxhirëve ishte Medina, dhe ky mendim duket më i mundshëm.

- "*... Tregojuni atyre se nëse e zbatojnë atë, do të kenë ato të drejta dhe ato detyrime që kanë edhe muhaxhirët ...*" – Kjo është drejtësi e plotë. Nuk thuhet se vetëm banorët vendas kishin të drejta të plota. Të sapoardhurve do t'u takonte pjesë nga plaçka e luftës dhe nga pasuria e fituar pa luftë, njëlloj si muhaxhirët, por ata do të kishin edhe detyrime të njëjta me ta, si për shembull, xhihadi dhe dhënia e ndihmës.

– "*... nuk do të kenë pjesë në plaçkën e luftës e as pjesë nga thesari* (*el fej*) *...*" – Kjo do të thotë se nëse ata nuk shpërnguleshin në vendin e muhaxhirëve, nuk do t'u takonte asgjë nga plaçka e luftës dhe nga thesari i shtetit. Thesari i shtetit është pasuria e përbashkët e muslimanëve, ku futen të ardhurat që vijnë nga një e pesta e një të pestës së plaçkës së luftës, nga *xhizja*, nga haraçi e të tjera.

– "*... vetëm nëse luftojnë bashkë me muslimanët ...*" – Nga kjo pjesë mësohet se nëse ata luftojnë, u takon të marrin nga plaçka e luftës, ashtu si edhe të tjerëve.

Ndërsa në lidhje me përfitimin nga thesari i shtetit, dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme. Imam Ahmedi thotë se atyre u takon të përfitojnë lirisht nga kjo pasuri, ndërsa plaçka e luftës iu takon

vetëm nëse luftojnë. Të tjerë kanë thënë se atyre nuk u takon pjesë nga thesari i shtetit, pasi ky u takon veç vendasve, duke u bazuar te përjashtimi që bëhet në hadith "vetëm nëse luftojnë". Por ky përjashtim, në fakt, është për plaçkën e luftës, pasi banori i qendrave urbane a rurale është gjithnjë në gatishmëri për xhihadin, për mësimin e fesë dhe përhapjen e saj, ndryshe nga beduinët, që rrinë larg në stane, me kafshët e tyre.

Nëse ata bëhen muslimanë, ka tri raste të trajtimit të tyre:

1- Nëse shpërngulen në vendin e muhaxhirëve, atëherë atyre u takojnë po ato të drejta dhe detyrime që kanë edhe muhaxhirët.

2- Nëse qëndrojnë në vendet e tyre, por marrin pjesë në xhihad, atëherë kanë pjesë në plaçkën e luftës, ashtu si edhe muhaxhirët, ndërsa për pjesë nga thesari, mendimet janë të ndryshme.

3- Nëse qëndrojnë në vendet e tyre dhe nuk marrin pjesë në xhihad, atëherë atyre nuk u takon pjesë as nga plaçka e luftës e as nga thesari.

– "*... Nëse refuzojnë, kërkojuni të japin xhizjen ...*" – *Xhizje* do të thotë: shpagim për diçka. Ajo është pasuria që paguajnë jomuslimanët, si kompensim për mbrojtjen dhe qëndrimin e tyre në vendet tona (islame).

Dhimij-u[1] e ka të mbrojtur pasurinë, gjakun dhe pasardhësit e tij, përkundrejt *xhizjes*. Allahu thotë: "... derisa të japin *xhizjen* në dorë, duke qenë të përulur." (Teube, 29). Pra, ta dorëzojnë me dorën e tyre, të mos e çojnë atë *(xhizjen)* me shërbëtorët ose fëmijët e tyre; duhet të vijnë ata vetë për ta sjellë.

"*... duke qenë të përulur...*" do të thotë se është detyrë që të ndihen si të poshtëruar dhe të nënçmuar, kur e japin atë. Pra, të mos e japin me salltanet e kryelartësi, me shërbëtorë e kortexhë, e të tjera si këto. Ndërsa disa dijetarë, thonë se ata duhet t'i lësh gjatë duke pritur, kur t'u merret xhizja[2].

---

[1] Rezidenti jomusliman në vendet islame.

[22] Kështu e ka komentuar shejhu (Allahu e mëshiroftë). Ndërsa dijetarë të tjerë lidhur me fjalën e Allahut të Lartësuar "i përulur" në këtë ajet kanë mendim tjetër. Prej tyre është Imam Shafiu i cili thotë se qëllimi me fjalën e Allahut "i përulur": është për qëllim të jetë i përulur ndaj ligjeve të islamit. Vetëkuptohet që bëhet fjalë për ato vende ku gjykohet sipas ligjit islam (shën.për).

– "*... Nëse refuzojnë, kërkojini ndihmë Allahut dhe luftojini ...*" – Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka filluar me kërkimin e ndihmës nga Allahu (Subhanehu ue Te'Ala), se nëse Ai nuk të ndihmon në xhihad kundër armiqve të Tij, atëherë je i humbur.

– "*... Nëse i rrethon banorët e një fortese dhe ata kërkojnë prej teje ...*" – Pra, nëse i rrethon në atë mënyrë që ata nuk mund të dalin nga kështjella e tyre dhe askush nga jashtë nuk mund të futet tek ata. Ndërsa 'fortesë' quhet gjithçka që i mbron njerëzit në kohë luftë, si: kështjella, një vend i rrethuar etj.

– *"... ata kërkojnë prej teje që t'ju japësh besën e Allahut dhe të Profetit të Tij (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*), mos u jep atyre besën e Allahut dhe besën e Profetit të Tij ..."* – Pra, nëse banorët që janë brenda fortesave kërkojnë besën e Allahut dhe të Profetit të Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), nuk lejohet t'ua japësh këtë besë, sepse – siç ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), – "... nëse ju e shkelni besën tuaj dhe të shokëve tuaj, kjo është më e lehtë sesa të shkelet besa e Allahut dhe e Profetit të Tij ...".

– *"... por jepuni besën tënde dhe besën e shokëve tu, sepse nëse ju e shkelni besën tuaj dhe të shokëve tuaj, kjo është më e lehtë sesa të shkelet besa e Allahut dhe e Profetit të Tij. ..."* – Shkelja e besës së Allahut dhe e Profetit të Tij është më e rëndë.

Trajta "më e lehtë" këtu është shkalla krahasore e mbiemrit "e lehtë". Ajo, si rregull, tregon shkallën më të lartë të shfaqjes së saj në një dukuri, në krahasim me shfaqjen e saj në një dukuri tjetër. Por, kjo nuk do të thotë se shfaqja e kësaj cilësie në njërën anë të krahasimit të jetë gjithnjë e pranueshme ose e vërtetë. Kështu, në rastin tonë, shkelja e besës, qoftë me Allahun dhe Profetin e Tij, qoftë me luftëtarët, nuk është asnjëherë e lehtë. Mirëpo në rastin konkret lehtësia është relative.

Këtu, ata kërkojnë të bëjnë marrëveshje armëpushimi pa caktuar ndonjë kusht paraprak, por thjesht për mbrojtjen e pasurisë, jetës, grave dhe fëmijëve të tyre, kështu që ne duhet t'ua japim këtë mundësi.

– *“… Nëse i rrethoni banorët e një fortese dhe ata kërkojnë prej teje që t’u japësh vendimin (ligjin) e Allahut, mos e prano këtë kusht, por jepu vendimin tënd, sepse ti nuk e di a e gjen për ta vendimin e duhur të Allahut, apo jo.”*– Pra, nëse ata vënë si kusht që mbi ta të zbatohet ligji i Allahut, ne nuk u përgjigjemi atyre, sepse nuk e dimë a e rrokim vendimin e duhur të Allahut për ta apo jo.

Më pas, i ka thënë komandantit: “…por jepu vendimin tënd…”, por nuk thotë edhe të shokëve tuaj, siç tha për besën, sepse në ushtri, vendimet i merr komandanti, ndërsa marrëveshjen duhet ta zbatojnë të gjithë luftëtarët; askujt nuk i lejohet që ta shkeli atë.

– *“… sepse ti nuk e di a e gjen për ta vendimin e duhur të Allahut, apo jo.”* – Për këtë çështje, ka qëndrime të ndryshme dijetarësh. Disa thonë se njerëzve të rrethuar në fortesa nuk u jepet vendimi i Allahut, sepse prijësi i ushtrisë, edhe pse përpiqet për ta rrokur vendimin e Allahut ndaj tyre, nuk dihet a e qëllon apo jo, se jo çdo vendimmarrës fetar (*muxhtehid*) e qëllon të vërtetën.

Të tjerë thonë se përkundrazi, atyre u jepet vendimi i Allahut, ndërsa ndalimi në këtë hadith është i veçantë vetëm për kohën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ajo ishte koha kur gjykimi i Allahut mbi ta mund të ndryshonte. Kësisoj, komandantët e muslimanëve nuk mund ta dinin në do ta rroknin gjykimin e ri të Allahut apo jo? Ndërsa tani, pas vulosjes përfundimtare të Shpalljes hyjnore, atyre u jepet vendimi i Allahut dhe përpjekja për të dhënë saktë ligjin e Allahut konsiderohet gjithnjë e drejtë, nëse nuk ka ndonjë devijim të madh, sepse Allahu nuk e detyron njeriun përtej mundësive të tij. Ai thotë: “…frikësojuni Allahut sa të mundeni…” (Tegabun, 16). Ky është edhe qëndrimi më i saktë. Gjykimi i *muxhtehidit* shihet si i saktë, nëse përputhet, me aq sa duket, me Sheriatin, edhe pse ai mund të gabojë.

Megjithatë, nëse bëhet kujdes e themi se u jepet vendimi i Allahut ashtu si e kuptojmë, kështu është më mirë. Kur thua: “ashtu si e kuptojmë” e bën të qartë se gjykimi i vërtetë i Allahut ndoshta nuk është i tillë, por ne bëjmë ashtu si e kuptojmë atë.

Ne zgjodhëm këtë shprehje, sepse ixhtihadi mund të ndryshoj, ndoshta interpretimi i një ligji mund të ndryshojë kur vjen një komandant tjetër, që lufton me ata jobesimtarë ose me të tjerë, e

atëherë jobesimtarët do të thonin se ligjet e muslimanëve janë kontradiktore.

Dobitë e hadithit:

- Ndalimi i gjymtimit të armiqve, i përvetësimit të plaçkës së luftës fshehurazi, i tradhtisë dhe i vrasjes së fëmijëve.

- Prijësi i besimtarëve e ka të ligjshëm dërgimin në luftë të ushtrisë.

- Nuk lejohet t'i luftosh të tjerët para se t'i ftosh në Islam, sepse Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e ka përcaktuar luftën si zgjidhje të fundit.

Ndërsa për ngjarjen që përshkruhet në dy *Sahih*-ët, se Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i ka sulmuar Benu Mustalikët pa paralajmërim,[1] themi se atyre u kishte arritur ftesa për në Islam, dhe përsëritja e kësaj ftese është e pëlqyeshme dhe jo detyrë. Po kështu, në çdo rast shihet edhe sesa dobi ka.

- Lejimi i marrjes së *xhizjes* edhe të tjerëve veç çifutëve, krishterëve dhe mexhuzëve. Për ndjekësit e Librit ka argument nga Kurani, ndërsa për mexhuzët ka argument nga Suneti.

Për grupet e tjera, dijetarët kanë mendime të ndryshme. Disa thonë se *xhizja* nuk merret nga të tjerë veç grupeve që përshkruhen në Kuran dhe Sunet. Po kështu, është thënë se ajo nuk merret nga idhujtarët arabë, sepse marrja e *xhizjes* përbën poshtërim. Megjithatë, e drejta është se ajo merret nga të gjithë jobesimtarët, sipas fjalës gjithëpërfshirëse të Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "… ata që mohojnë Allahun …", duke mos përcaktuar vetëm çifutët dhe të krishterët.

- Në hadith tregohet qartë se lufta nuk është për të detyruar njerëzit që të futen në Islam, sepse po të ishte ashtu, nuk do të ligjërohej *xhizja*. Ky është qëndrimi më i saktë, i mbështetur nga Kurani dhe Suneti.

Për sa i përket thënies së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Jam urdhëruar t'i luftoj njerëzit, derisa…",[2] themi se hadithi është i përgjithshëm, i cili specifikohet me argumentet që flasin për xhizjen.

- Shenjtërimi i besës, e sidomos kur është për Allahun dhe të

[1] Buhariu, Muslimi.

[2] Buhariu dhe Muslimi.

Dërguarin e Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

- Lejohet që njerëzve të fortesave t'u jepet vendimi i udhëheqësit të besimtarëve.

- Nuk lejohet që njerëzve të fortesave t’u jepet vendimi i Allahut. Kjo mund të vlente vetëm për kohën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), por mund të vlejë edhe sot, siç u sqarua më lart.

- *Muxhtehid*-i mund t’ia qëllojë të vërtetës, por edhe mund të gabojë, siç ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “... sepse ti nuk e di a e gjen për ta vendimin e duhur të Allahut, apo jo.” Po kështu, ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Kur gjykatësi gjykon sipas vlerësimit të tij dhe e qëllon të vërtetën, ka dy shpërblime, ndërsa kur gjykon sipas vlerësimit të tij dhe gabon, ka një shpërblim.”[1]

A do të thotë kjo se muxhtehidi ia ka qëlluar të vërtetës, edhe nëse gabon?

Çdo muxhtehid ia qëllon të vërtetës.

Është thënë se jo çdo muxhtehid e rrok të vërtetën. Po kështu, është thënë se muxhtehidi mund ta gjejë të vërtetën në degët e fesë e jo në bazat e saj; kjo thuhet për të qenë të kujdesshëm ndaj bidatçinjve, të cilët ndërhyjnë në çështjet themelore të fesë.

Qëndrimi i saktë është se *muxhtehidi* ia arrin qëllimit me gjykimin e tij, ndërsa për sa i përket rrokjes së të vërtetës, ai mund të ketë sukses ose të gabojë. Këtë e dëshmon hadithi: “... Kur gjykatësi gjykon sipas vlerësimit të tij dhe e qëllon të vërtetën, ka dy shpërblime, ndërsa kur gjykon sipas vlerësimit të tij dhe gabon, ka një shpërblim”, i cili bën të qartë se *muxhtehidët* edhe mund të gabojnë. Me sa duket nga konteksti, hadithi flet për çdo çështje të fesë, dytësore apo themelore, pasi faktet fetare tregojnë se Allahu nuk e detyron njeriun më tepër sesa ka mundësi.

Megjithatë, mendimi i *muxhtehidit* që bie në kundërshtim me mendimin unik të selefëve, është i gabuar, sepse është e pamundur që ai ta ketë gjetur të vërtetën, ndërsa selefët jo, qoftë kjo për çështje dytësore apo themelore të fesë.

Nga ana tjetër, shejhu i Islamit Ibn Tejmije dhe Ibn Kajimi, e kanë kundërshtuar ndarjen e çështjeve të fesë në dytësore apo themelore, duke thënë se kjo ndarje është krijuar vetëm pas kohës së

[1] Buhariu dhe Muslimi.

sahabëve. Kemi parë, për shembull, se ata që bëjnë një ndarje të tillë, e fusin namazin – një nga shtyllat e Islamit – te çështjet dytësore të fesë. Po ashtu, disa çështje të akides, për të cilat ka pasur mospërputhje te selefët, ata i kanë parë si çështje dytësore.

Nëse këta njerëz, me 'çështje themelore' kanë për qëllim vetëm ato të *akides*, atëherë u themi se të gjitha çështjet e fesë janë themelore, sepse kryerja e detyrimeve fetare, qofshin ato financiare ose trupore, mund të quhet adhurim për Allahun, vetëm pasi të besosh që ato janë të ligjshme. Pra, besimi i paraprin punës: po nuk e besove diçka, veprimi i saj nuk quhet adhurim.

Përfundimisht, qëndrimi i saktë është se porta e *ixhtihad*-it[1] është e hapur, qoftë për ato që quhen çështje themelore, qoftë për çështje dytësore, por duhet pasur parasysh se gjykimet individuale që bien ndesh me qëndrimin e selefëve, nuk mund të pranohen kurrsesi si të sakta.

- Porta e *ixhtihad*-it vazhdon të jetë e hapur, sipas hadithit të Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "*...sepse ju nuk e dini a e gjeni për ta gjykimin e duhur të Allahut, apo jo.*"

Kjo tregon dobësinë e mendimit se nuk ka më vend për *ixhtihad*, prandaj tani është detyrë ndjekja e imamëve. Por rrjedhoja e kësaj është që t'i kthesh shpinën Kuranit dhe Sunetit, për të shkuar pas mendimit të njerëzve. Ky qëndrim, është i gabuar.

Është detyrë për çdonjë që ka mundësi të nxjerrë rregulla e gjykime nga Kurani dhe Suneti, që ta bëjë këtë punë. Mirëpo, për shkak se dija e Sunetit është mjaft e gjerë dhe e shpërndarë, nuk duhet që të japësh gjykimin për një çështje thjesht sepse ke dëgjuar një hadith në lidhje me të, por duhet të sigurohesh mirë, sepse ai gjykim mund të jetë shfuqizuar, ose të jetë i kufizuar apo i përgjithshëm, ndryshe nga ç'mendon ti.

Ndërsa të thuash: mos shiko në Kuran dhe Sunet, se nuk je i aftë për të bërë *ixhtihad*, kjo nuk është e saktë. Po ashtu, që dera e *ixhtihad*-it është e hapur, nuk do të thotë që të nënçmosh mendimet e dijetarëve të parë, të ulësh vlerën e tyre. Kjo nuk lejohet kurrë, sepse ata janë lodhur dhe janë përpjekur për gjetjen e gjykimit të

[1] *Ixhtihadi* është përpjekja maksimale e një dijetari mysliman për të nxjerrë një normë ligjore nga parimet dhe tekstet fetare. Dijetari i këtij niveli quhet *'muxhtehid'*.

drejtë, megjithëse e dimë që nuk ishin të pagabueshëm. Nuk lejohet gjithashtu t'i përflasësh ata apo t'i tregosh vlerësimet e tyre si anekdota, me qëllim që njerëzit të tallen me to. Nëse përgojimi i një njeriu të thjeshtë është haram, ç'mund të thuhet për përgojimin e atyre që e kanë kaluar tërë jetën e tyre me shoshitjen e argumenteve dhe fakteve fetare?! E jo me disa, që kanë dalë kohët e fundit e që thonë se ata dijetarët e hershëm nuk merrnin vesh, ata merreshin me raste të pamundura etj., etj., kur dihet se dijetarët supozojnë për raste të rralla jo gjithmonë sepse mendojnë që ato do të ndodhin, por edhe për të ushtruar nxënësit me situata të ndryshme problemore.

- Në hadith pohohet se Allahu gjykon.

Dobitë e temës

- Dallimi ndërmjet besës së Allahut, Profetit të Tij dhe besës së muslimanëve.

Nëse do të thuhej: 'Ndryshimi i besës së Allahut dhe e Profetit të Tij me besën e muslimanëve', do të ishte më e qartë, sepse ashtu siç është fjalia, mund të mendosh se ndryshimi është ndërmjet të treve, por nuk është kështu, pasi besa e Allahut dhe e Profetit të Tij është e njëjtë. Ndryshimi pra, është ndërmjet këtyre të dyjave dhe besës së muslimanëve. Ky ndryshim qëndron në faktin se t'i japësh të rrethuarve besën e Allahut dhe të Profetit të Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), është haram, ndërsa dhënia e besës së rrethuesve është e lejuar.

- Kur kemi dy çështje, të veprojmë atë që është me rrezik më të vogël.

Sipas pjesës së hadithit, që thotë: "… por jepuni besën tuaj dhe besën e shokëve tuaj …" e deri në fund. Ky është një rregull mjaft i rëndësishëm që, me fjalë të tjera, thuhet: kur jemi përballë dy çështjeve të dëmshme, të tilla që s'mund të shmangen të dyja dhe

patjetër duhet të veprohet njëra prej tyre, atëherë veprohet ajo që sjell dëmin më të vogël. Këtë e dëshmon Allahu, kur thotë: "Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë Allahun armiqësisht, nga padija ..." (En'am, 108). Poshtërimi i "zotave" të idhujtarëve është vepër e kërkuar, por kur ajo çon në sharjen e Allahut të Madhëruar nga ana e tyre, bëhet e ndaluar, sepse e keqja e sharjes së Allahut të Madhëruar është më i madhe sesa mossharjes e "zotave" të tyre. Ky mosveprim, edhe pse përmban në vetvete një anë negative, duhet me qëllim që të shmanget një e keqe akoma më e madhe. Këtë parim e pranon dhe e mbron edhe logjika e shëndoshë.

Përballë këtij parimi, del parimi tjetër: kur jemi përballë dy çështjeve të mira dhe patjetër duhet të heqim dorë nga njëra prej tyre, atëherë lihet ajo që është më pak e dobishme, që të arrihet ajo më e dobishmja.

Përfundimisht, nëse përplasen dy të mira, të tilla që s'mund të bëhen që të dyja, duhet t'i jepet përparësi asaj që është më e rëndësishme. Nga ana tjetër, nëse përplasen dy të këqija, të tilla që s'mund të shmangen të dyja, shmanget e keqja më e madhe, duke bërë të keqen më të vogël.

- Thënia: "Luftoni me emrin e Allahut, në rrugën e Allahut ...".

Nga kjo mësohet se është detyrë të luftosh duke kërkuar ndihmën e Allahut, me sinqeritet dhe në pajtueshmëri me fenë e Tij.

- "Luftoji ata që e mohojnë Allahun ...".

Pra, është detyrë të luftohen qafirët, dhe shkaku i luftimit është kufri i tyre.

Kjo nuk do të thotë se luftohen vetëm ata që bëjnë kufër, përkundrazi, kufri është njëri nga shkaqet e luftës. Të tjerët luftohen, për shembull, edhe nëse pengojnë dhënien e zekatit, nëse nuk falin namazin e bajramit, nëse nuk thërrasin ezanin dhe ikametin, edhe pse nuk janë qafirë. Po kështu, kur dy grupe muslimanësh luftojnë me njëri-tjetrin, luftohet ai që refuzon t'i

bindet urdhrit të Allahut. Përfundimisht, lufta ka edhe shkaqe të tjera, veç mohimit të Allahut dhe fesë.

> ➢ Thënia e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “… kërkoji ndihmë Allahut dhe luftoji ata …”.

Nga kjo mësohet se është detyrë t’i kërkosh ndihmë Allahut, dhe jo të mbështetesh në mundësitë dhe fuqitë e tua.

> ➢ Dallimi ndërmjet vendimit të Allahut dhe vendimit të dijetarëve.

Ndryshimet janë dy:

1. Vendimi i Allahut është absolutisht i saktë, ndërsa vendimi i dijetarëve mund të jetë i saktë ose jo.

2. Nuk lejohet që njerëzve të rrethuar t’u japësh vendimin e Allahut.

Kjo e dyta mund të vlejë vetëm për kohën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), por ndoshta edhe për sot. Ndërsa dhënia e vendimit të dijetarëve, e të ngjashëm, është i lejuar.

Shënim:

Nuk lejohet ta pyesësh myftiun me këtë formë: “Cili është gjykimi i Islamit në lidhje me …?”, ose: “Cili është qëndrimi i Islamit në lidhje me …?”, sepse ndoshta myftiu gabon, e nuk të thotë gjykimin e vërtetë të Islamit. Po kështu, edhe muftiu, nga ana e tij, nuk duhet të përgjigjet me këtë formë: “Gjykimi i Islamit është ….”, se mund të gabojë, por ta kufizojë çështjen, duke thënë “Gjykimi i Islamit – sipas mendimit tim, – është …”. Megjithatë, nëse ka një argument të qartë fetar në lidhje me çështjen, atëherë nuk ka problem, si për shembull, pyetja: Cili është gjykimi i Islamit në lidhje me ngrënien e mishit të ngordhur? Dhe përgjigjja: “Gjykimi i Islamit thotë se kjo gjë është haram”.

> ➢ Sahabët, në raste nevoje, jepnin gjykime që nuk e dinin a përputheshin me gjykimin e Allahut apo jo.

Kjo nuk është e posaçme për sahabët, por vlen edhe për ata që vijnë pas tyre. Kësisoj, njeriu ka të drejtë që, në rast nevoje, të japë një gjykim, të cilin e mendon se është në përputhje me gjykimin e Allahut.

Tema 64

Betimet ndaj Allahut.

Të betohesh ndaj Allahut do të thotë të betohesh që Ai do ta bëjë diçka, ose që nuk do ta bëjë, si për shembull, "Vallahi, Allahu do ta bëjë këtë!", ose "Vallahi, Allahu nuk do ta bëjë këtë!".

Ka disa forma të këtij betimi:

1. Të betohesh për diçka që e ka pohuar Allahu dhe Pejgamberi i Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

Kjo nuk ka ndonjë të keqe, përkundrazi, është argument për sigurinë e personit ndaj asaj që ka lajmëruar Allahu dhe Pejgamberi i Tij, si për shembull: "Vallahi, Allahu do ta lejojë të Dërguarin e Tij që të ndërmjetësojë për krijesat në Ditën e Kijametit!" Ose: "Vallahi, Allahu nuk e fal atë që i bën shok Atij!".

2. Të betohesh ndaj Allahut, ngase shpreson fort dhe ke mendim të mirë për Atë.

Kjo lejohet. Argument është miratimi që Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i bëri në ndodhinë e hallës së Enes Ibn Malikut, Rubejia Bintu en Nadrit. Ajo i theu një ensareje një dhëmb, prandaj të dyja palët shkuan të gjykohen te Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) urdhëroi të zbatohej ligji i barazisë në ndëshkim (*kisas*). Palës tjetër iu ofrua pajtim, por ata kundërshtuan. Atëherë Enes Ibn en Nadri u çua dhe tha: "A do t'i thyhet dhëmbi i parmë Rubejias? Vallahi, o i Dërguar i Allahut, jo, nuk ka për t'u thyer dhëmbi i parmë i Rrubejias!" Ky betim i tij nuk kishte për qëllim mospranimin e gjykimit të Sheriatit. Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i tha: "O Enes! Libri i Allahut përcakton *kisas*-in, që do të thotë: dhëmbi për dhëmbin. Enesi tha

përsëri: "Vallahi, jo, nuk ka për t'u thyer dhëmbi i parmë i Rrubejias!" Ai betohej kështu për shkak të vendosmërisë së fortë që dhëmbi të mos thyhej, edhe nëse do t'i duhej të sakrifikonte gjithçka. Kur pala tjetër pa se sa këmbëngulës qe ai, Allahu futi në zemrat e tyre ndjenjën e faljes, prandaj ata e falën. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) tha: "Ka nga robërit e Allahut që, nëse betohet për Të, Ai ua përmbush kërkesën."[1]

Enesi e lidhi betimin me Allahun, për shkak të shpresës së fortë që kishte tek Ai dhe mendimit të mirë për Të. Si rezultat, Allahu futi në zemrat e ensarëve ndjenjën e faljes, edhe pse më parë ata këmbëngulnin para Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) për *kisas*-in. Ata e falën gruan dhe morën kompensimin.

Lavdërimi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) për të dëshmonte se ai burrë qe njëri nga robërit e mirë të Allahut dhe se Allahu ia përmbushi betimin dhe i zbuti zemrat e tyre (ensarëve). E si jo, kur ai thoshte se e ndiente erën e Xhenetit poshtë Uhudit. Kur ai ra shehid, u gjend me tetëdhjetë e ca goditje shpatash apo shigjetash, nga të cilat askush nuk e njohu, përveç motrës së tij, që e njohu nga mollëzat e gishtërinjve[2]. E ajo ishte Rrubejia, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë dhe me të! Për këtë betim, flet gjithashtu edhe hadithi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Ndoshta ndonjë flokëshprishur e i pluhurosur, kur do që të futet në ndonjë vend, nxirret jashtë nga porta me përçmim, por nëse ai betohet për Allahun për diçka, Allahu e përmbush betimin e tij."[3] Një kuptim i fjalës arabe '*kasem*' është edhe 'lutje', ndërsa kuptimi i '*eberr-rrehu*' është: 'i përgjigjet, e përmbush kërkesën'.

3. Të betohesh ndaj Allahut, i shtyrë nga pëlqimi i vetes ose nga mendimi i keq për Allahun e Madhëruar. Kjo është e ndaluar dhe kush e bën këtë, Allahu pothuajse ia asgjëson veprat. Për këtë flet hadithi, që do të përmendet më poshtë.

Tema lidhet me teuhidin, sepse kushdo që betohesh ndaj Allahut për të tilla qëllime, është sjellë keq me Atë, e ka ngushtuar

[1] Buhariu dhe Muslimi.
[2] Buhariu dhe Muslimi.
[3] Muslimi. Allahu i Lartësuar e përmbush atë që ai kërkon përmes betimit, si nderim për të dhe si ruajtje të betimit të tij nga thyerja, për shkak të gradës së lartë të tij tek Allahu.

konceptin për mirësinë e Tij dhe ka menduar keq për Të, që do të thotë se ka cenuar teuhidin, ndoshta edhe vetë bazën e tij. Ngushtimi i konceptit të mirësisë së Allahut, që është më Fisniku, konsiderohet si fyerje ndaj Tij.

> Xhundub Ibn Abdullahi (r.a.) përcjell se Pejgamberi i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka treguar se: "Njëherë, një burrë tha: 'Vallahi, Allahu nuk e fal filanin!' Allahu i Madhëruar tha: 'Kush është ai që betohet në Mua se nuk e fal filanin?! Unë e fal atë dhe ta asgjësoj punën tënde.'"[1]

– *"... Njëherë, një burrë tha ..."* – Mundet që të jetë fjala për të njëjtin burrë që përmendet edhe në hadithin e Ebu Hurejrës, që do vijojë më poshtë.

– *"... Vallahi, Allahu nuk e fal filanin ..."* – Kjo shpreh humbje shprese tek mëshira e Allahut, nënçmim të robërve të Tij dhe pëlqim të vetes.

– *"... Kush është ai që betohet në Mua se nuk e fal filanin? ..."* – Pra, kush është ai që e bën të ngushtë mirësinë dhe begatinë Time, që të mos e fal atë rob Timin që punon keq? Formë pyetëse e fjalisë tregon që kjo vepër është e ndaluar.

Ngjarja përshkruhet më hollësisht në hadithin e Ebu Hurejres, ku tregohet se ishte një burrë i zellshëm në ibadet, që kishte një shok që bënte gjynahe. Sa herë që i zellshmi në ibadet e shihte tjetrin të bënte gjynahe, i thoshte: "Mos bëj ashtu!" Kështu, edhe një ditë, kur e gjeti duke bërë gjynah i tha: "Lëre, mos e bëj!" Tjetri iu përgjigj: "Mjaft u more me çështjet ndërmjet meje dhe Zotit tim. Mos vallë je caktuar kujdestari im?" Adhuruesi i zellshëm i tha: "Për Allahun! Ty nuk ka për të falur Allahu, ose nuk ka për të futur në Xhenet ...".

Duket se gjynahqari kishte mendim të mirë për Allahun dhe

[1] Muslimi.

shpresonte tek Ai. Ai bënte gjynahe dhe pendohej, duke i lënë ato çështje midis vetes dhe Zotit, sepse ai i tha: "Mjaft u more me çështjet ndërmjet meje dhe Zotit tim".

Nëse njeriu bën një gjynah dhe pendohet sinqerisht, por pastaj bën sërish gjynah, pendimi i parë mbetet i saktë. Edhe nëse pendohet për së dyti, pendimi i tij është sërish i saktë, sepse një kusht i pendimit është që njeriu të jetë i vendosur që të mos i kthehet gjynahut, dhe jo që të mos e bëjë më atë gjynah.

Ky burrë, të cilin Allahu e fali, ose i plotësonte kushtet e faljes duke u penduar, ose gjynahet e tij ishin më të vogla se shirku. Po të kish bërë *shirk* dhe të vdiste pa u penduar, ky mëkat nuk do t'i falej kurrë, sepse Allahu thotë: "Padyshim që Allahu nuk fal që Atij t'i vihen shokë, por Ai fal përveç kësaj (çdo gjë tjetër), për këdo që Ai dëshiron." (Nisa, 48).

– *"... ta asgjësoj punën tënde."* – Nga konteksti i hadithit shihet se Allahu ia ka asgjësuar krejt veprat e tij. Kjo, sipas asaj që kuptojmë, ndërsa të vërtetën e di Allahu.

Ky burrë e adhuronte Allahun dhe vetëkënaqej me punën e tij, duke pandehur se ç'po bënte për Allahun, a thua se me veprat e tij po i bënte nder Allahut! Kështu, ai prishi një nga shtyllat e adhurimit, që është përulshmëria dhe nënshtrimi. Në zbatimin e urdhrave dhe fesë së Allahut, duhet të tregohesh patjetër rob i Tij. Shumë njerëz e adhurojnë Allahun jo sipas Shpalljes së Tij. Atyre u bëhet e vështirë të kthehen nga mendimet e tyre, kur u sqarohet gabimi nëpërmjet Librit të Allahut dhe Sunetit të Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), dhe për këtë arsye, ata shtrembërojnë tekstet dhe faktet.

Mundet që kuptimi i: "*...ta asgjësoj punën tënde*", të jetë: ta asgjësoj atë punë për të cilën po mburreshe. Kjo është më e lehtë, sepse tregon që prishet vetëm ajo vepër, e jo veprat e tjera. Megjithatë, po të shohësh hadithin e Ebu Hurejres, ky interpretim është i pamundur, pasi atje thuhet se Allahu urdhëron: "... Çojeni atë në Zjarr!".

I ngjashëm me këtë, është hadithi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), rrëfyer nga Behz Ibn Hakimi, ndërsa ky e përcjell nga i ati, e ky nga gjyshi i Behzit, në lidhje me atë që nuk jep zekatin, i cili

thotë: "... ne do t'ia marrim atë dhe gjysmën e pasurisë së tij, se kjo është detyrë për të ruajtur të drejtën e Zotit tonë."[1] Edhe këtu lind pyetja: Me "gjysmën e pasurisë", nënkuptohet gjysma e gjithë pasurisë së tij, apo e vetëm asaj pasurie që ai nuk i nxjerr zekatin?

Për shembull, nëse dikush ka njëzet deve, zekati i të cilave është katër deve, por që ai nuk i jep, a t'i marrim vetëm dhjetë deve, apo nëse ai ka pasuri tjetër, si: lopë, dele apo para, t'i marrim gjysmën e të gjithë kësaj, bashkë me zekatin?

Ka dy përgjigje nga dijetarët, që përfshin të dyja mundësitë e përshkruara, por qëndrimi i saktë është se kjo varet nga mendimi i të parit të muslimanëve, sipas asaj që ai e shikon më të dobishme. Nëse ai mendon se vlen më tepër marrja e gjysmës së të gjithë pasurisë, i merr gjysmën e të gjithë pasurisë, në të kundërt, i merr gjysmën e asaj pasurie që ai nuk i nxjerr pre saj zekatin.

> Sipas hadithit të Ebu Hurejrës, tregohet se ai burri që tha se vallahi Allahu nuk e fal filanin ishte një burrë i zellshëm në ibadet, por ai tha diçka, që i shkatërroi atij dynjanë dhe ahiretin.[2]

– *"... tha diçka ..."* – Ai tha: "Për Allahun! Allahu ty nuk ka për të falur."

– *"... i shkatërroi atij dynjanë dhe ahiretin."* – Kjo, sepse ai të cilit i asgjësohen veprat, e ka humbur edhe dynjanë, edhe ahiretin. Ahiretin e ka humbur, pasi do të jetë nga banorët e Zjarrit, Allahu na ruajtë prej tij! Ndërsa dynjanë e ka shkatërruar, sepse e mira e dynjasë për njeriun është kur ajo mbushet me vepra të mira, e në të kundërt, ajo është krejt humbje. Allahu i Madhëruar thotë: "Për kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrin të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrin durimin." (Asr, 1-3). "Thuaj (o Muhamed): Të humburit janë ata që do të humbin vetveten dhe familjet e tyre në Ditën e Kijametit. A nuk është kjo tamam humbja e qartë?!" (Zumer, 15). Ai, të cilit nuk i jepet sukses në besim dhe vepra të

[1] Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i mirë.
[2] Ahmedi dhe Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

mira, e ka humbur dynjanë e tij të vërtetë, sepse në fund dynjaja do të zhduket dhe çdo gjë e zhdukur është njëlloj sikur nuk ka ekzistuar kurrë. Krahasoje këtë me të kaluarën e jetës sate: kur kujton se çfarë ka ndodhur e nuk është më, të duket sikur nuk ka qenë asnjëherë. Kjo vjen prej urtësisë së Allahut, që njerëzit të mos anojnë më tepër nga dynjaja.

Dobitë e temës

- Paralajmërimi për betimin ndaj Allahut.

Flitet për betimin se Ai nuk ka për të falur ndonjë. Këtë e tregon hadithi: "Kush është ai që betohet në Mua se nuk e fal filanin?" dhe fakti që, për shkak të këtij veprimi, Allahu ia shkatërron të gjitha punët njeriut.

- Fakti se Zjarri është më afër nesh sesa rripi i sandales.

- Fakti se kaq afër është edhe Xheneti.

Këto dy fakte dalin prej hadithit që Buhariu sjell nga Ibn Mesudi (r.a.), sipas të cilit Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Xheneti është më afër jush sesa rripi i sandales së tij, e po kështu edhe Zjarri." Kështu ai donte të tregonte se sa afër janë Xheneti dhe Xhehenemi.

- Dëshmi për këtë është edhe thënia e Pejgamberit ('alejhis–selam): "Dikush thotë një fjalë…".

Autori e ka fjalën për hadithin: "Dikush thotë një fjalë, së cilës nuk i jep rëndësi, por prej saj ai do të fundoset në Xhehenem shtatëdhjetë vjeshta."[1] Ose siç vjen në një variant tjetër: "… më larg

[1] Ahmedi, Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

se distanca ndërmjet lindjes dhe perëndimit."[1] Kjo tregon se duhet të jemi shumë të kujdesshëm ndaj shkarjeve të gjuhës, sepse ato mund të sjellin shkatërrim. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë gjithashtu: "Kush më siguron mua atë që është midis këmbëve të tij dhe atë që është midis buzëve, unë i siguroj Xhenetin."[2] Po kështu, ai i ka thënë njëherë Muadhit: "Frenoje këtë!", duke i treguar gjuhën. Muadhi tregon se e ka pyetur: "O Pejgamberi i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), a do të merremi në llogari për ato që flasim?" Ai ia ktheu: "Të humbtë nëna o Muadh, a i fut njerëzit në Zjarr me fytyra dhe hundë diçka tjetër përveç asaj që kanë korrur me gjuhët e tyre?!"[3] E sidomos kur shkarja u ndodh njerëzve që janë shembull për të tjerët, siç ndodh me thirrësit e humbur, Allahu na mbroftë! Të tillët do të kenë peshën e gjynahut të vet dhe të atyre që i pasojnë, deri në Ditën e Kijametit.

> ➢ Ndoshta dikujt mund t'i falen gjynahet nga diçka që ai e urren më tepër.

Këtë çështje, unë nuk e shoh të shprehur qartë në hadithi. Ndoshta ajo del nga pjesa: "Në të vërtetë, Unë e fal atë ...". Nuk ka dyshim se njeriut mund t'i falen gjynahet nëpërmjet diçkaje që ai nuk e pëlqen, siç është xhihadi në rrugë të Allahut: "Lufta është bërë detyrim për ju, ndonëse e urreni. Por mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju ..." (Bekare, 216).

[1] Muslimi.
[2] Buhariu.
[3] Buhariu.

Tema 65

Kurrë nuk i kërkohet Allahut të ndërmjetësojë te krijesat e Tij.

Ndërmjetësimi është një ndërhyrje që bëhet te dikush, për të arritur një të mirë ose për të shmangur një të keqe prej tij.

Tema lidhet me teuhidin, sepse po të ishte Allahu i Madhëruar ndërmjetësues te krijesat e Tij, kjo do të qe mangësi për Allahun, sepse do të tregonte që pozita e Tij na qenka më e vogël se pozita e krijesave! Pozita më e lartë nuk ka nevojë të ndërmjetësojë te niveli më i ulët, por thjesht e urdhëron atë. Allahu i Madhëruar nuk ndërmjetëson tek asnjë krijesë e Tij, sepse Ai është më i Larti dhe më Madhi. Për këtë arsye, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e kundërshtoi beduinin, në ngjarjen që do të tregohet më poshtë.[1]

> Xhubejr Ibn Mut'imi tregon: “Njëherë, një beduin shkoi te Pejgamberi i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe i tha: ‘Trupat na janë dobësuar, familjet i ka pllakosur uria, pasuria na është mpakur dhe bagëtitë po na shuhen, prandaj kërkoji Zotit tënd të na sjellë shi. Ne i kërkojmë Allahut të ndërmjetësojë tek ti, dhe të kërkojmë ty të ndërmjetësosh tek Allahu. Profeti tha: ‘Subhan-

[1] Nuk ka dyshim se personi, të cilit i drejtohet ndërmjetësimi, është në gradë më të lartë se ndërmjetësuesi, në shumicën e rasteve. Atëherë, bërja e Allahut ndërmjetësues është e ndaluar, sepse pozita e ndërmjetësuesit është më e vogël se pozita e personit, të cilit i drejtohet ndërmjetësimi. (Marrë nga botimi i parë.)

> Allah, Subhan-Allah!'. Vazhdoi të thoshte 'Subhan-Allah', derisa ajo u duk në fytyrat e shokëve të tij. Pastaj tha: 'I mjeri ti! A e di ti kush është Allahu? Me të vërtetë pozita e Allahut është më e madhe. Nuk i kërkohet Allahut që të ndërmjetësojë tek asnjë nga krijesat e Tij ...'."[1]

– *"... një beduin ..."*– Beduinët janë njerëz që jetojnë të izoluar, në stane. Në përgjithësi, ata janë të ashpër dhe nuk i njohin kufijtë e Allahut.

– *"... Trupat na janë dobësuar, familjet i ka pllakosur uria, pasuria na është mpakur dhe bagëtitë po na shuhen ..."* – Shkaku për të gjitha këto qe thatësira, mungesa e shiut.

– *"... kërkoji Zotit tënd të na sjellë shi. ..."* – Kjo kërkesë nuk ka ndonjë të keqe, sepse t'i kërkosh të lutet dikujt që ti shpreson se do t'i pranohet lutja, është një nga rrugët që sjell pranimin e saj.

– *"... Ne i kërkojmë Allahut të ndërmjetësojë tek ti ..."* – Kuptimi është: Ne e bëjmë Allahun ndërmjetësin tonë tek ti, që ti ta lutësh Atë për ne. Ky veprim e konsideron pozitën e Allahut më të ulët se pozita e Profetit të Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

- *"... dhe të kërkojmë ty që të ndërmjetësosh tek Allahu ..."* – Pra, kërkojmë prej teje që të jesh ndërmjetësues për ne tek Allahu, e ta lusësh Allahun për ne. Kjo është e saktë.

– *"... Subhan-Allah! Subhan-Allah! ..."* – Kjo mënyrë të shprehuri e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) tregonte rrezikshmërinë e madhe të atij mendimi që kishin beduinët dhe, njëkohësisht, qëndrimin e tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) kundërshtues për të, duke pohuar se Allahu i Madhëruar është larg çdo të mete, siç qe kjo që beduinët i mveshën Atij.

Shprehja "*Subhan-Allah*" është deklaratë se Allahu është i pastër nga gjithçka që nuk i përshtatet Atij, nga mangësitë dhe nga

[1] Ebu Daudi. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

shëmbëllimi me krijesat, sepse shëmbëllimi me të mangëtit, është vetë tregues i mangësisë. Madje, edhe krahasimi i të përkryerit me të mangëtin, e cenon përsosmërinë e të parit, siç thotë poeti:

A s'e sheh, vallë, si shpatën përçmojnë,
kur me një shkop atë e krahasojnë?

– *"... Vazhdoi të thoshte 'Subhan-Allah', derisa ajo u duk në fytyrat e shokëve të tij..."* – Pra, kjo e shprehur e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) la gjurmë edhe në fytyrat e shokëve të tij, sepse e dinin që Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) thoshte '*Subhan-Allah"* në mënyrë të përsëritur veçse për çështje tejet serioze. Thënia subhanallah nga ana e Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ishte sepse ai burrë kishin thënë diçka që cenonte madhërinë e Allahut, prandaj ai (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) deklaroi dëlirësinë e Zotit të tij nga ajo që nënkuptohej prej asaj fjale.

Për të njëjtën arsye, kur Pejgamberi i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe shokët e tij zbrisnin ndonjë tatëpjetë, thoshin '*Subhan-Allah*', si pohim që Allahu i Madhëruar është larg të qenit poshtë, ndërsa kur ngjiteshin në lartësi, thoshin "*Allahu Ekber*", duke pohuar se Allahu është më i Madhi[1] dhe Atij i përket tërë madhështia në qiej dhe në Tokë.

– *"... I mjeri ti! ..."* – Fjala *'uejheke'* (e përdorur në hadith), fjala *'uejl'* dhe fjala *'uejs'*, kanë kuptime të përafërta me njëra-tjetrën, por disa gjuhëtarë thonë se *'uejheke'* shpreh mëshirë, ndërsa 'uejl' përdoret për kërcënim. Me fjalë të tjera, *'uejheke'* do të thotë: unë i kërkoj Allahut që të të mëshirojë ty, sepse më vjen keq për ty. Dijetarë të tjerë thonë se të trija këto fjalë shprehin kërcënim.

Sipas kuptimit të parë, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) kërkoi mëshirë për personin që e tha atë fjalë, sepse ai nuk e njihte vlerën e Allahut.

– *"... A e di ti se kush është Allahu? ..."* – Pyetja është retorike, që nënkupton përgjigjen se Allahu është Madhështor. Por mund të ketë edhe kuptimin: ti nuk e di kush është Allahu.

[1] Buhariu

– *"... Me të vërtetë, pozita e Allahut është më e madhe ..."* – Pra, Madhështia e Allahut është më e lartë seç e përshkrove ti, me atë shprehje.

– *"... Nuk i kërkohet Allahut që të ndërmjetësojë tek asnjë nga krijesat e Tij..."* – Kjo do të thotë se nuk kërkohet prej Allahut që të ndërmjetësojë te dikush, dhe kjo, për shkak të Madhështisë dhe Lartësisë absolute të Tij (Subhanehu ue Te'Ala).

Në autenticitetin e hadithit ka dobësi, por kuptimi është gjithsesi i saktë. Pra, nuk i lejohet askujt të thotë: do të bëj Allahun ndërmjetës tek ti.

Pyetje: Po a nuk ka thënë Pejgamberi i Allahut: "Kush kërkon në emër të Allahut, t'i jepni atij."? Kjo tregon se lejohet të kërkosh në emër të Allahut. Sikur të mos lejohej, nuk do të ishte detyrë t'i jepje atij që të kërkon kështu.

Përgjigje: Të kërkosh në emër të Allahut, nuk do të thotë se pozita e Tij është më e ulët se e atij që i kërkohet, përkundrazi: tregon se pozita e Allahut është shumë herë më e lartë; pra është ndryshe nga ndërmjetësimi. Kur kërkon në emër të Allahut, i jepet.

Disa dijetarë kanë thënë se: "Kush kërkon në emër të Allahut ...", do të thotë: "Kush ju bën një pyetje sipas fesë së Allahut, jepini përgjigje", e jo: kush kërkon diçka materiale.

Megjithatë, shpjegimi i parë është më i saktë. Atë e përforcon thënia e melekut, në një ngjarje që e kemi treguar më parë: "Të lutem ty në emër të Atij që të ka dhënë ngjyrë të bukur e lëkurë të mirë."

Dobitë e temës

- Kundërshtimi që Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i bëri atij që tha: "Ne i kërkojmë Allahut të ndërmjetësojë tek ti ...".

Kjo kuptohet nga fjala e tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem):

"*Subhan-Allah*! *Subhan-Allah*! A e di ti kush është Allahu?... Nuk i kërkohet Allahut që të ndërmjetësojë tek asnjë nga krijesat e Tij."

- Ndryshimi i gjendjes së Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), i cili u pasqyrua edhe në fytyrat e shokëve të tij, nga ajo kërkesë.

Kjo del nga hadithi: "... vazhdoi të thoshte '*Subhan-Allah'*, derisa ajo u duk në fytyrat e shokëve të tij." Përsëritja nga ana e tij e fjalës "*Subhan-Allah!*", tregon se ai ndryshoi aq shumë, saqë kjo u shfaq edhe në fytyrat e shokëve të tij. Kjo tregon gjithashtu, se ai mendim për Allahun është i urryer dhe mjaft i rrezikshëm.

- Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk e kundërshtoi pjesën tjetër të kërkesës së beduinit: "... dhe të kërkojmë ty që të ndërmjetësosh tek Allahu ...".

Kjo tregon se ajo lejohet.

Është një rregull, që thotë: kur në tekstet hyjnore nuk shprehet qëndrim ndaj disa çështjeve, kur ato paraqiten mes disa të tjerave, kjo tregon se çështjet që nuk janë kundërshtuar, janë të vërteta. Diçka e tillë përmendet në fjalën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "Kur ata bëjnë një vepër të shëmtuar, thonë: 'Ne i gjetëm baballarët tanë të veprojnë kështu, por edhe Allahu na ka urdhëruar për këtë.' Thuaj: 'Allahu nuk urdhëron që të bëhen vepra të pahijshme!'" (A'raf, 28). Allahu e ka mohuar fjalën e tyre: "... por edhe Allahu na ka urdhëruar për këtë ...", ndërsa ka heshtur ndaj pohimit tjetër: "Ne i gjetëm baballarët tanë të veprojnë kështu ...", çka tregon se kjo është e vërtetë. Po kështu, në ajetin tjetër, kur flitet për numrin e banorëve të shpellës, Allahu thotë: "Thonë: 'Ata ishin tre veta e qeni i tyre ishte i katërti'. Disa thonë: 'Ata ishin pesë veta e qeni i tyre ishte i gjashti', duke hamendësuar për atë që është e fshehtë ...". (Kehf, 22). Por më tej, për pjesën: "...'Ata ishin shtatë veta e qeni i tyre ishte i teti'..." nuk thotë gjë.

- Komenti i shprehjes: "Subhan-Allah!".

Ky koment është pjesa e hadithit: "Me të vërtetë pozita e Allahut është më e madhe …".

> ➢ Muslimanët i kërkuan Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) të lutej për shi.

Kjo vlente për kohën kur ai (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) qe gjallë. Pas vdekjes së tij, muslimanët nuk e bëjnë më një gjë të tillë, sepse Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) iu ndërpre vepra dhe adhurimi i tij. Në kohën e Omer Ibn Hatabit (r.a.), kur pati një thatësirë të madhe, ai kërkoi shi me anë të lutjes së Abasit, duke thënë: "O Allah! Ne më parë ndërmjetësonim tek Ti me anë të Profetit tonë, dhe Ti na jepje shi. Tani po ndërmjetësojmë tek Ti me anë të xhaxhait të Profetit tonë, prandaj na jep sërish shi!"

Ndërmjetësimi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ishte kërkesa e tyre që ai të lutej. Prandaj, në disa transmetime thuhet se Omeri (r.a.) e urdhëronte Abasin të lutej, e atëherë ai ngrihej dhe lutej.

Ky fakt përforcon gjithashtu se ndodhia vijuese, e përcjellë nga njëfarë Utbij, nuk është e vërtetë. Kështu, ky Utbiju, ishte ulur njëherë pranë varrit të Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), kur aty kishte shkuar një beduin dhe kishte thënë: "Selam alejkum, o Pejgamberi i Allahut! Me të vërtetë, Allahu thotë: 'Në qoftë se ata, që i kanë bërë padrejtësi vetes së tyre, vijnë tek ti (Muhamed) për t'i kërkuar falje Allahut, dhe Pejgamberi i lutet Allahut për faljen e tyre, do ta shohin se Allahu është vërtet Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.' (Nisa, 64). Prandaj, unë kam ardhur të kërkoj falje për mëkatin, duke të marrë ty si ndërmjetës për tek Zoti im." Pastaj recitoi disa vargje:

Prehesh këtu brenda, o më i miri njeri,
por dheu që t'rri sipër, ndjen fat e lumturi!
Bujar e fisnik është varri që të mban,
Lutu ti për mua, t'u bëfsha o kurban!

E kështu, ishte larguar. Pastaj Utbiju tregon se e kishte zënë gjumi dhe kishte parë në ëndërr Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) që i kishte thënë: "O Utbij! Përgëzoje beduinin, se Allahu e ka falur atë!"

Ky rrëfim është i pasaktë, sepse, së pari, personazhi i tij është i panjohur, e po kështu edhe ata që e përcjellin ngjarjen nga ai. Ai nuk mund të jetë e saktë, edhe sepse ajeti thotë: "... që i kanë bërë padrejtësi vetes së tyre ..." dhe nuk thotë: 'kur ata i bëjnë padrejtësi vetes'. Fjala arabe *'idh'* tregon se veprimi i përket së kaluarës, ndryshe nga fjala *'idha'*. Kur sahabët i goditi thatësira, në kohën e Omerit, nuk e kërkuan shiun me anë të Profetit të Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), – i cili kishte ndërruar jetë atëherë, – por iu drejtuan Abas Ibn Abdul Mutalibit, – që ishte i pranishëm midis tyre, – që të lutej.[1]

Dobitë e hadithit:

- Njeriu që kërkon, duhet të shfaqë ato gjëra që ngjallin keqardhje te tjetri, siç bëri beduini kur tha: "Trupat na janë dobësuar...".

- Mëshirimi i atij që bën gjynahe, nëse themi se fjala "I shkreti ti!", është për mëshirim.

[1] Buhariu.

Tema 66

Mbrojtja paraprake e teuhidit dhe mbyllja e rrugëve të shirkut.

Pasi dijetari ka folur më parë për realizimin e plotë të teuhidit dhe për faktorët që e cenojnë atë, tani sjell argumentet që flasin për mbrojtjen paraprake të teuhidit dhe për detyrën e mbylljes së çdo shtegu që të çon në politeizëm, qoftë ky i demonstruar edhe në të folur. Kështu teuhidi mbetet i pastër nga çdo e metë.

> Abdullah Ibn Esh Shihiri tregon: "Isha me delegacionin e Benu Amirit, kur shkuam te Pejgamberi i Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe i thamë: "Ti je Madhëri (*Sejiduna*) për ne!" Ai na tha: "Madhëri (*Es Sejid*) për ne është Allahu, *Tebareke ue Teala*." Atëherë ne i thamë: "O më i miri, më i nderuari dhe më bujari nga ne ..." Ai na e ktheu: "Thoni fjalët që thatë, ose disa prej fjalëve që thatë, por mos e lini shejtanin që t'ju tërheqë pas vetes."[1]

– *"Isha me delegacionin e Benu Amrit ..."* – Ky grup duhet të ketë shkuar te Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) në vitin 9 hixhri, vit kur erdhën shumë delegacione, aq sa është quajtur edhe "Viti i delegacioneve".

---

[1] Ebu Daudi me zinxhirë të mirë. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë. Një pjesë e hadithit është përmendur në temën e pesëdhjetë e katërt, në komentin e fjalës 'Es-Sejid'.

– *"... Ti je Madhëri për ne! ..."*– 'Madhëri' quhet ai që ka pushtet, lavdi, respekt etj.

– *"... Madhëri për ne është Allahu ...*" – Siç shihet, Profeti (sallAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk tha "Madhëri për ju ...", por "Madhëri për ne ...", e kjo ka dy shpjegime:

1. Trajta e shquar i jep kuptimit të emrit (në arabisht) gjithëpërfshirje në konceptin e tij, kur nuk është përcaktor i ndonjë fjale tjetër. Kështu, domethënia e fjalës "*Es Sejid*" është: Ai që ka pushtet e respekt absolut, dhe i tillë është vetëm Allahu i Madhëruar. Ndërsa kur '*sejid'* përdoret si përcaktim i dikujt, atëherë kuptimi i saj është i kufizuar vetëm për atë që përcaktohet, si për shembull: "*Sejid*-i (zotëriu, më i nderuari) i fisit", ose "*Sejid* (më i nderuari) i njerëzve", etj.

2. Që mos të mendojë ndonjë se Allahu është Madhëri vetëm për një grup të kufizuar, sepse Ai është Madhëri për çdo krijesë.

Es Sejid është një nga emrat e Allahut. Ai është gjithashtu një prej kuptimeve të emrit tjetër të Allahut, Es Samed, që – siç ka thënë Ibn Abasi, – do të thotë: Ai që ka dituri, butësi dhe sundim absolut.[1]

– *"... Tebareke ...*" – Dijetarët thonë se "*Tebareke*" ka kuptimin: "Begatuesi dhe Bujari më i Madh. Kjo është arsyeja që me këtë veçori nuk duhet të përshkruhet askush tjetër përveç Allahut.

Megjithatë, shprehja "Na begatove ti", që e përdorin njerëzit e rëndomtë, nuk ka për qëllim cilësinë e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), por përdoret për të treguar vetëm shkakun.

Gjithashtu, si i begatë mund të përshkruhet edhe një njeri që e meriton atë. Prandaj Usejd Ibn Hudejri, kur zbriti ajeti i *tejemum*-it

[1] Ibn Xheriri. Gjithashtu është thënë se *Es-Samed*, është Ai, të Cilit i drejtohen krijesat për nevojat e tyre, meqenëse Ai është i fuqishëm t'i plotësojë ato. Ndërsa Ibn Abasi ka thënë: "*Es-Samed* është Zotëriu, i Cili është i përkryer në zotërimin e Tij, Ai është i Shenjti, i Cili është i përkryer në shenjtërinë e Tij, Ai është Madhështori, i Cili është i përkryer në madhështinë e Tij, Ai është i Buti, i Cili është i përkryer në butësinë e Tij, Ai është i Urti, i Cili është i përkryer në urtësinë e Tij dhe Ai është i Dituri, i Cili është i përkryer në dijen e Tij.

për shkak të varëses që i humbi Aishes, tha: "Nuk qe begatia juaj e parë kjo, o familja e Ebu Bekrit!"[1]

– *"... O më i miri, më i nderuari dhe më bujari nga ne ..."* – Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk e ndaloi këtë mënyrë adresimi.

– *"... Thoni **fjalët që thatë**..."* - urdhëri këtu është për lejim, siç është sqaruar edhe më parë. Qëllimi me thënien *"... Thoni **fjalët që thatë**..."* është për fjalën e tyre *"... O më i miri, më i nderuari dhe më bujari nga ne ..."*.

- "*...ose disa prej fjalëve që thatë...*" – Kjo shprehje mund të jetë pasiguri nga ana e transmetusit, po kështu mund të jetë edhe prej fjalëvetë tekstit të hadithit. Që do të thotë: qëndroni në një pjesë të asaj që thatë.

– *"... por mos e lini shejtanin që t'ju tërheqë pas vetes ..."* – Pra, të mos ju bëjë shejtani të thoni shprehje të ndaluara. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i mësoi se çfarë duhet të bënin dhe nga çfarë të ruheshin, si mbrojtje paraprake për teuhidin.

Ndërsa Ibn Ethiri në "*En-Nihaje*", ka thënë se: "... por mos e lini shejtanin që t'ju tërheqë pas vetes ..." ka kuptimin: mos e lini t'ju sundojë e t'ju bëjë misionarët e tij. Sipas të dyja komenteve, qëllimi i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ishte mbrojtja paraprake e teuhidit dhe mbyllja e rrugëve që të çojnë në shirk.

Sa më e madhe të jetë e keqja dhe sa më shumë tenton egoja t'i afrohet asaj, aq më të forta janë masat mbrojtëse kundër tij. Kështu Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka marrë masat maksimale ndaj shirkut, duke bllokuar të gjitha shtigjet që mund të çojnë drejt tij. Ai ka marrë masa edhe kundra imoralitetit, si për shembull, duke ndaluar që femra të dalë e zbukuruar dhe me fytyrë të zbuluar, duke ndaluar që ajo të veçohet me ndonjë burrë të huaj pa qenë i pranishëm ndonjë i afërm i saj e të tjera, me qëllim që këto të mos bëhen shkaqe për imoralitet, të cilin e kërkon epshi. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka bërë kujdes maksimalisht edhe ndaj shtegut të kamatës, deri aty sa ka ndaluar që një njësi me

[1] Buhariu dhe Muslimi.

grurë të mirë të këmbehet me dy njësi grurë të cilësisë më të dobët. Ai e ka quajtur këtë lloj këmbimi si një formë kamate, edhe pse në dukje nuk ka padrejtësi.

Shirku mund të jetë një vepër që nuk e josh shumë egon, por ai është zullumi më i madh. Shejtani është i interesuar që ta çojë birin e Ademit në shirk, me çdo lloj mënyre, por Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) siguroi ndaj tij një mbrojtje të plotë, që njeriu të mos futet në të. Ky është edhe qëllimi i kësaj teme.

Vërejtje:

Ndër interpretuesit e këtij hadithi, ka qarkulluar mendimi se Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e ka ndaluar t'i thuash dikujt: '*Sejiduna*', kështu që ata janë përpjekur të harmonizojnë dëshminë me thëniet e tjera të Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), si: "Unë jam *sejid*-i (zotëriu) i bijve të Ademit"; apo: "Çohuni te *sejid*-i juaj …"[1], apo: "Le të thotë: '*i nderuari im*', '*pronari im*'." Ata kanë dhënë tri shpjegime:

1. Ndalimi tregon që vepra është e urryer, duke shërbyer kjo si formë edukimi. Ndërsa lejimi tregon që vepra nuk është haram.

2. Vepra është e ndaluar në ato raste kur shihet se mund të ketë pasoja të rrezikshme, kur teprohet; në të kundërt, lejohet.

3. E ndaluar kjo shprehje është vetëm kur përdoret si formë adresimi ndaj njerëzve, si për shembull, t'i thuash drejtpërdrejt dikujt: "Ti je *sejid*-i im" ose: "… *sejid*-i ynë", ndryshe nga rasti kur nuk është i pranishëm. Arsyeja është, sepse tjetrit mund t'i pëlqejë vetja e të bëhet arrogant. Kjo ka edhe një arsye tjetër: kështu njeriu që i drejtohet tjetrit me të tilla forma, mund të shihet si i nënshtruar, si i përulur para atij, ndryshe kur adresimi bëhet nga një i tretë, siç ka thënë Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Çohuni tek *sejid*-i juaj …", ose fakti që skllavi mund të thotë për zotëriun e vet, kur ky i fundit nuk është i pranishëm: "*Sejid*-i im". Por çështja sërish pështjellohet, nëse marrim parasysh lejimin nga Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) që skllavi t'i thotë pronarit të vet: "*Sejid*-i im".

Sipas meje, nuk ka asnjë mospërputhje mes haditheve. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka lejuar atë formë emërtimi, por ka

[1] Buhariu.

ndaluar që njerëzit të shtyhen nga shejtani drejt teprimeve, si për shembull të përdorin për krijesat formën "*Es Sejid*" (në trajtën e shquar), i cili është nga emrat e Allahut të Madhëruar.

Gjithashtu, lejohet që dikush të thirret: "*sejid*-i ynë" ose "*sejid*-i fisit e të tjera si këto, por me kusht që ai ta meritojë këtë emërtim. Nëse nuk e meriton, si për shembull kur është mëkatar ose hipokrit, nuk duhet të thirret ashtu, edhe nëse mund të ketë pozitë e pushtet në këtë dynja. Në një hadith thuhet: "Mos i thoni hipokritit "O *sejid*-i ynë", sepse kjo e hidhëron Allahun."[1]

> Nga Enesi përcillet: "Njëherë, disa njerëz i thanë Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "O i Dërguari i Allahut, o më i miri ynë dhe biri i më të mirit tonë! O *sejid*-i ynë, dhe biri i *sejid*-it tonë!" Ai ua ktheu: "O njerëz, ***thoni fjalët që thatë, por mos e lini shejtanin që t'ju bëjë për vete***! Unë jam Muhamedi, robi i Allahut dhe i Dërguari i Tij. Nuk dua që të më ngrini më lart se grada ku më ka ngritur Allahu i Madhëruar."[2]

- "*O i Dërguari i Allahut...*" – Kjo thirrje është në përputhje me ajetin: "Mos e bëni thirrjen e Profetit mes jush, siç thërrisni njëri-tjetrin..." (Nur, 63). Pra: mos e thërrisni atë me emër: "O Muhamed!", por thoni: "O i Dërguari i Allahut!", ose "O Pejgamberi i Allahut". Ajeti, në fakt, ka edhe një kuptim tjetër: kur t'ju ftojë Pejgamberi, mos e konsideroni atë si thirrjen që i bëni njëri-tjetrit: nëse doni i përgjigjeni, e nëse nuk doni, jo. Po kështu, edhe në ajetin: "O ju që keni besuar! Përgjigjuni Allahut dhe Profetit, kur ai (Muhamedi) ju thërret drejt asaj që do t'ju japë jetë dhe dijeni se Allahu ..." (Enfal, 24). Sipas kuptimit të parë, thirrja i përket atij që i është bërë, ndërsa në të dytin, i përket vetë thirrësit.

– *"... o më i miri ynë ..."* – Ky përshkrim është i saktë. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është më i miri ndër ne, për sa i përket

[1] Buhariu, Ahmedi. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.
[2] Ahmedi dhe En-Nesaiu me zinxhir të mirë. Sipas Albanit hadithi është i vërtetë.

prejardhjes, pozitës dhe fetarisë.

– *"... dhe biri i më të mirit tonë! ..."* – Kjo është e saktë në lidhje me prejardhjen, por jo në lidhje me pozitën dhe fetarinë.[1] E njëjta gjë thuhet për thirrjen: "...biri i *sejid*-it tonë!".

– *"... O njerëz, thoni fjalët që thatë..."* – Për këtë folëm më lart.

– *"... por mos e lini shejtanin që t'ju bëjë për vete..."* – Pra, të mos ju tërheqë shejtani, që të ndiqni rrugët e tij e të arrini në teprim, siç thotë Allahu: "... si puna e atij, të cilin e kanë tërhequr shejtanët në rrugën e gabuar, që endet në botë si i hutuar..." (En'am, 71).

- "*Unë jam Muhamedi, robi i Allahut dhe i Dërguari i Tij ...*" – Muhamed është emri i tij i përveçëm, ndërsa robi i Allahut dhe Pejgamberi i Tij, janë dy tituj të tij, që janë gjithashtu dy përshkrimet më të mira dhe më të plota për Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

Allahu e ka përshkruar atë si "rob" në kontekstet më sublime. Ai e ka quajtur ashtu, kur flet për zbritjen e Kuranit: "Ai që ia shpalli Furkanin robit të vet (Muhamedit) që të bëhet Pejgamber i botës, është i Madhëruar." (Furkan, 1); kur flet për *Isra*-në: "Pa të meta është Lartmadhëria e Atij, që robin e vet e kaloi në një pjesë të natës nga Mesxhidi Harami deri në Mesxhidi Aksa." (Isra, 1); kur flet për Mirazhin: "... Dhe i shpalli robit të Tij atë që ia shpalli." (Nexhm, 10); kur flet për privilegjin e tij si 'i mbrojtur' dhe për sfidën: "Nëse ju dyshoni për atë (Kuranin) që ne i kemi zbritur robit Tonë ..." (Bekare, 23).

Kjo vlen edhe për Profetët e tjerë si në ajetin e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "O pasardhës të atyre që Ne i mbartëm (në anije) bashkë me Nuhun! Vërtet që ai ishte rob mirënjohës e falënderues." (Isra, 3). Ky status robërie është i posaçëm, dhe më i larti i kësaj kategorie.

---

[1] Sepse babai i Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) nuk ishte musliman. Por, nëse kishin për qëllim mirësinë e prejardhjes, kjo është e saktë, sepse babai i tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ishte nga fisi Beni Hashim, e ata ishin nga më të ndershmit (fisnikë) e kurejshëve dhe prijësve të tyre.

Robëria ndaj Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) është ndër virtytet më të nderuara të njeriut, sepse ai nëse nuk adhuron Allahun, do të adhurojë shejtanin. Allahu i Madhëruar thotë: "Vallë, a nuk ju kam urdhëruar, o bij të Ademit, që të mos adhuroni shejtanin, se ai vërtet është armiku juaj i hapur, por të më adhuroni vetëm Mua?! Kjo është rruga e drejtë." (Ja Sin, 60-61).

Ibn Kajimi ka thënë:

Ikën nga robëria që për të u krijuan,
Të vetes e të djallit, si rob përfunduan.

Ndërsa një poet ka thënë:

Më thirrni, o njerëz, veç "O robi i saj",
Kryelartë do t'jem, që emrin ta mbaj!

– *"... dhe i Dërguari i Tij ..."* – Pra, i Dërguar prej Tij për të gjithë njerëzit, siç thotë Allahu i Madhëruar: "Thuaj (o Muhamed): 'O njerëz! Vërtet që unë jam sjellë te ju të gjithë si i Dërguar i Allahut ...'" (Araf, 158).

Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është në gradën më të lartë të njerëzve të mirë. Allahu thotë: "Kushdo që i bindet Allahut dhe Profetit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë dhunti: me Profetët, besnikët e dalluar, dëshmorët e të mirët. Sa shokë të mirë janë ata!" (Nisa, 69). Në grupin e Profetëve bën pjesë Pejgamberi ynë, madje ai është më i miri prej tyre. Autori e ka përshkruar kështu Pejgamberin e Allahut: "Rob, që nuk adhurohet dhe i Dërguar, që nuk mohohet".

Dy grupe njerëzish e kanë tepruar në lidhje me të Dërguarin e Allahut: ata që kanë kaluar në adhurimin e tij, duke iu drejtuar atij me lutje në vështirësi dhe mirësi, dhe ata që e kanë mohuar, duke thënë se ai ishte gënjeshtar, magjistar, poet, i çmendur etj.

Përgjigjja ndaj këtyre dy ekstremeve është përshkrimi i Pejgamberit: "Rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij.".

– *"... Nuk dua që të më ngrini më lart ..."* – Pra, nuk e dua ngritjen tuaj, mbi gjendjen time reale, as në përshkrime, as në tituj, as në pozitë.

– *"... se grada ku më ka ngritur Allahu i Madhëruar."* – Nga kjo

mësohet se është Allahu Ai që e përcakton mirësinë ndër robërit e Tij dhe Ai që vendos pozitat e tyre.

Dobitë e temës

- Paralajmërimi i njerëzve për t'u ruajtur nga teprimi.

Kjo del nga fjala e tij: "... por mos e lini shejtanin që t'ju tërheqë pas vetes ...". Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e konsideroi këtë gjë si ngasje të shejtanit, të cilit njeriu duhet t'i ruhet në çdo drejtim.

- Si duhet të reagojë ai të cilit i thuhet: "ti je sejidi ynë".

Ai duhet të thotë që Es Sejid është Allahu.

- Vërejtja e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "... mos e lini shejtanin që t'ju tërheqë pas vetes ...", edhe pse ata thanë vetëm të vërtetën.

Nga fjala e autorit, duket se të tilla shprehje vijnë prej ngasjes së shejtanit. Po kështu, ajo mund të interpretohet: "Përdoreni këtë fjalë, por ruhuni nga teprimi, sepse ai është tërheqje e shejtanit". Shpjegimi i dytë duket më i goditur, siç u tha më lart.

- Thënia e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "Nuk dua që të më ngrini më lart se grada ku më ka ngritur Allahu i Madhëruar ".

Pra, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e urrente ngritjen mbi pozitën e tij reale, që ia kishte dhënë Allahu i Madhëruar: "Rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij". Kjo nxjerr në pah gjithashtu edhe thjeshtësinë e tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

Tema 67

> **Thënia e Allahut: "Ata nuk e kanë vlerësuar Allahun me madhështinë që i takon. Ditën e Kijametit, e tërë Toka do të jetë në Grushtin e Tij, ndërsa qiejt të mbështjellë në të Djathtën e Tij. Ai është i pastër nga të metat dhe i lartësuar mbi gjithçka që ia shoqërojnë!" (Zumer, 67) [1]**

– *"Ata nuk e kanë vlerësuar..."* – Janë idhujtarët që nuk e madhërojnë Allahun ashtu si i takon Atij, por i shoqëruan të tjerë, nga krijesat e Tij.

– *"... Ditën e Kijametit, e tërë toka do të jetë në grushtin e Tij ..."* – Kjo tregon për madhështinë e Allahut të Madhëruar.

E tërë toka, me gjithë ç'ka në të, Ditën e Kijametit do të jetë në Grushtin e Tij. Grusht quhet dora e mbledhur, dhe ai këtu nuk

---

[1] Shejh Sadi, në "El kaul es-sedid" thotë: "Autori e përfundon librin e tij me këtë temë dhe tregon argumente të qarta mbi madhështinë e Krijuesit, madhështinë e Lartmadhërisë së Tij dhe nënshtrimin e krijesave me robërinë e tyre, për Madhështinë e Tij. Këto cilësi madhështore dhe përshkrime të përsosura, janë argumentet më të mëdha se Ai është i Adhuruari i Vetëm dhe i Falënderuari i Vetëm. Kështu që është detyrë t'i kushtohet kulmi i nënshtrimit, madhërimit, dashurisë dhe adhurimit. Ai është i Vërteti, e ç'janë përveç Tij, janë të rremë. Ky është realiteti i Teuhidit, esenca, shpirti i tij dhe krejt sinqeriteti. (Marrë nga futnota e botimit të parë.)

nënkupton sundimin e Allahut.

– *"... e tërë toka ..."* – Kjo përfshin detrat, lumenjtë, pemët dhe çdo gjë që është në të. Pra, Ditën e Kijametit, e tërë toka do të jetë në grushtin e Tij. Qiejt, me tërë madhësinë dhe gjerësinë e tyre, do të jenë të mbështjellë në të Djathtën e Tij. Allahu i Madhëruar thotë: "... atë ditë kur Ne do ta palosim qiellin, siç palosen fletët e një libri. Ashtu sikur e kemi filluar Krijimin dhe e rikthejmë ..." (Enbija, 104).

– *"... Ai është i pastër nga të metat dhe i lartësuar mbi gjithçka që ia shoqërojnë!"* – Kjo është deklaratë për pastërti nga çdo e metë, dhe këtu hyn edhe shirku që njerëzit bëjnë ndaj Tij. Prandaj, më pas thotë: "... dhe i lartësuar mbi gjithçka që ia shoqërojnë!", që do të thotë: "... larg nga çdo shoqërim që i bëjnë Atij, qoftë kjo në konsiderimin e Krijuesit si krijesat, qoftë e kundërta".

> Ibn Mesudi (r.a.) ka thënë: "Një nga rabinët e çifutëve erdhi te Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe tha: 'O Muhamed! Ne (në Teurat) gjejmë se Allahu i ka vendosur qiejt mbi njërin gisht, tokat mbi njërin gisht, pemët mbi njërin gisht, dheun mbi njërin gisht, të gjitha krijesat mbi njërin gisht dhe thotë: 'Unë jam Sunduesi.' Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) qeshi, si pohim për thënien e rabinit, derisa iu dukën dhëmballët, e pastaj lexoi ajetin: 'Ata nuk e kanë vlerësuar Allahun me madhështinë që i takon ...'."[1]

– *"... Profeti qeshi..."* – Sikur rrëfimi të ndalej këtu, ky reagim do të interpretohej si kundërshtim, sepse kur qesh me diçka, tregon se ajo nuk ta ka mbushur mendjen. Por, në fakt, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e pohoi thënien e rabinit, e vërtetuar kjo me vijimin e rrëfimit: "... pastaj lexoi ajetin: 'Ata nuk e kanë vlerësuar Allahun me madhështinë që i takon ...". Leximi i ajetit nga Libri i Allahut, tregon se e qeshura e tij qe pohim për atë çfarë tha rabini. Ai qeshi sepse u gëzua që Kurani përputhej me atë që ai dijetar

[1] Buhariu dhe Muslimi.

kishte mësuar nga librat e tij.

Nuk ka dyshim, se kur paraqitej diçka që e vërtetonte Kuranin, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) gëzohej me të. Edhe pse Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) qe i sigurt se Kurani është nga Allahu, ai gëzohej sepse gërshetimi i argumenteve e përforcon një fakt. Këqyr historinë e Usame Ibn Zejdit dhe babait të tij Zejd Ibn Harithes. A kishte pasur ndonjëherë dyshime Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) se Usame ishte djali i Zejdit? Natyrisht që jo. Por, një ditë, Muxheziz el Mudlixhi – një fizionomist i njohur asokohe – pa këmbët e Usames dhe të babait të tij, të cilët vetë ishin të mbuluar me rroba, dhe tha: “Në të vërtetë, këto këmbë janë prej njëra-tjetrës.”. Kur e dëgjoi këtë vlerësim, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) u gëzua pa masë. Ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) shkoi tek Aishja e i tha: “A e more vesh se Muxheziz el Mudlixhi pa Usame Ibn Zejdin dhe Zejdin e tha: ‘Me të vërtetë këto këmbë janë prej njëra-tjetrës.’?”[1] Gëzimi u duk në fytyrën e tij, sepse u mbështet e vërteta.

Idhujtarët e përflisnin Usame Ibn Zejdin dhe babain e tij për shkak të ndryshimit të ngjyrës së tyre: Usame ishte shumë i zi, ndërsa i ati ishte shumë i bardhë. Por e vërteta nuk ishte siç e pandehnin ata, të cilët ishin gënjeshtarë. Ndryshimi i ngjyrës sjell dyshime vetëm tek ata që ndjekin egon e sëmurë, sepse dihet që burimi i këtij ndryshimi mund të jetë nga ndonjë paraardhës i afërt ose i largët.

– *“... Unë jam Sunduesi. ...”* – Atë ditë, askush tjetër nuk ka pushtet, siç thotë Allahu i Madhëruar: “... ditën kur ata do të dalin (nga varrezat) në shesh, e Allahut nuk mund t’i fshihet asnjë gjë e tyre. I kujt është sundimi sot (bëhet pyetja)? I Allahut, i Atij që është Një, i Fuqiplotit!” (Gafir, 16).

Atë ditë, të gjithë njerëzit, mbretër dhe vegjëli, do të jenë të barabartë. Të gjithë do të ringjallen të zbathur, të zhveshur dhe të pabërë sunet. Atëherë do të shfaqet qartë sundimi i Allahut të Madhëruar, i Cili do të thërrasë: “I kujt është sundimi sot?”. Askush nuk do të përgjigjet, prandaj vetë Ai do të thotë: “I Allahut, i Atij që është Një, i Fuqiplotit!”.

---

[1] Buhariu dhe Muslimi.

‘*El Melik*’ (Sunduesi, - që është përmendur në hadith), nuk është thjesht urdhërues e komandues, por është Ai që ka pushtet, madhështi dhe urdhra të realizueshme. Ndërsa ‘*El Malik*’ është gradë pak më e ulët, prandaj Allahu, kur e lavdëron Veten, thotë se është *El Melik*.

Edhe ajeti i Fatiha-së ka ardhur me dy lexime: “*Meliki jeumiddin*” dhe “*Maliki jeumiddin*”, me qëllim që të sqarohet se Ai është edhe *Melik*, edhe *Malik*. Sundimi i Allahut të Lartësuar përfshin pushtetin e përkryer, komandimin, urdhërimin dhe rregullimin e punëve të krijesave, ndryshe nga krijesat. Ka mbretër të kësaj bote që mund të jenë *melik*, por që nuk janë *malik, sepse nuk komandojnë*, ose që janë *malik* (komandues, urdhërues), por nuk janë *melik, sepse nuk kanë sundim të plotë*.

– *“… derisa iu duk fundi i dhëmballëve …”* – Kjo qeshje nga ana e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte si pohim për fjalën e rabinit, siç thotë edhe vetë Ibn Mesudi. Nëse do ta kundërshtonte, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk do të qeshte dhe as nuk do të kishte lexuar ajetin, por do ta quante atë një gënjeshtër, siç i kundërshtoi ata që pretenduan se imorali nuk gurëzohet deri në vdekje.

– *“… pastaj lexoi ajetin: ‘Ata nuk e kanë vlerësuar Allahun me madhështinë që i takon …’.”* – Ky është kuptimi i ajetit, dhe s’ka kuptim tjetër: qiejt janë të palosur në të Djathtën e Tij, siç palosen fletët në një libër, pra në dorën e Tij të Begatuar dhe të Madhëruar. Ky është edhe *tefsiri* i Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Tefsiri që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) i ka bërë Kuranit, vjen i dyti për nga renditja, por në vlerë, – për sa i përket pranimit dhe argumentimit, – ai është si tefsiri që Kurani i bën Kuranit, i cili është i pari në radhë.

Ndërsa komentimi se fjala e tij “në Grushtin e Tij”, do të thotë: “në sundimin dhe komandimin e Tij”, është e gabuar, sepse sundimi dhe komandimi i Tij janë të përhershëm, si në Ditën e Gjykimit, ashtu edhe para saj. I gabuar është edhe komentimi se “qiejt janë të palosur” do të thotë: “qiej do të zhduken e do të harrohen”, siç harrohet kujtimi i dikujt. Po kështu edhe komenti që i bëhet “të

Djathtës së Tij", duke thënë se është "betimi i Tij", pasi në hadith përdoret fjala *'jemin'*, që në arabisht ka edhe domethënien 'betim'.

Këto dhe të tjera keqinterpretime, vijnë për shkak të mendimit të prishur që kanë ata njerëz për Allahun (Subhanehu ue Te'Ala), të cilët pretendojnë që pohimi i atributeve të tilla, e bën të pashmangshëm krahasimin e Allahut me krijesat. Ata mohojnë atë që Allahu ia ka pohuar Vetes, atë që ia ka pohuar Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) dhe dijetarët e parë të umetit; këtë e bëjnë nëpërmjet dyshimeve, të cilat i marrin për argumente.

Atyre u bëhet pyetja: A mos jeni ju më të ditur për Allahun sesa Ai për Veten? Nëse përgjigjen "po", bëjnë kufër, e nëse thonë "jo", u themi përsëri: A mos i dini ju kuptimet e shprehjeve më mirë sesa vetë Allahu? Nëse përgjigjen "po", bëjnë kufër, e nëse thonë "jo", janë mundur.

Me të vërtetë, Allahu e ka rrëfyer mjaft qartë, se e tërë toka do të jetë në Dorën e Tij Ditën e Kijametit. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), nga ana tjetër, ia pohoi rabinit atë që ai tha, duke treguar përputhjen e asaj me ajetin kuranor. A jeni ju – i pyesim ata njerëz – më tepër udhëzues sesa Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) për robërit e Allahut? Patjetër që do të thonë "jo".

Kur e dimë që fjala e Allahut është më e qarta, më e besueshmja dhe që Ai është më i dituri për çfarë thotë, atëherë është detyrë për ne që të themi ashtu siç ka thënë Ai (Subhanehu ue Te'Ala) për Vetveten, e nuk jemi gjynahqarë. Gjynah merr ai që e ndërron kuptimin e vërtetë të fjalës së Tij, kuptimin që Allahu ka dashur të na e përcjellë ne.

Dobitë e hadithit:

- Pohimi se Allahu i Madhëruar ka gishtërinj, sipas miratimit që Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) i bëri rabinit. Gishtat e Allahut të Madhëruar janë të vërtetë dhe ashtu siç i përshtatet Atij. E tillë është edhe Dora e Tij.

Thënia e rabinit: "Allahu i ka vendosur qiejt mbi njërin gisht ..." e deri në fund, nuk nënkupton vetëm lehtësinë e Allahut për të komanduar qiejt dhe tokën, siç thonë shtrembëruesit e atributeve të Tij. Ky është një gabim, që kundërshton domethënien e drejtpërdrejtë të shprehjes dhe të shtjellimit që bëhet në hadith, të

cilën e miratoi Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Po ashtu, Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë: “Me të vërtetë, zemrat e bijve të Ademit, janë ndërmjet dy prej gishtave të Mëshirëplotit.”[1]

Që zemrat e njerëzve janë ndërmjet dy gishtave të Allahut, nuk do të thotë patjetër që gishtat e Allahut i preken ato. Shiko ajetin: “... dhe në retë, që qëndrojnë ndërmjet qiellit e tokës ...” (Bekare, 164). Dihet se retë nuk prekin as qiellin, as tokën. Po kështu, kur thua se Unejzeh është ndërmjet Ez Zelfit dhe Er Resit, e nuk është e domosdoshme që këto vende të jenë ngjitur me njëri-tjetrin. Kur thua se muaji *shaban* është ndërmjet *dhul kades* dhe *xhumadas*, kjo nuk nënkupton se këto muaj vijnë menjëherë njëri pas tjetrit, e kështu me radhë.

Edhe një shembull tjetër: Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka thënë se Allahu i Madhëruar është përballë fytyrës së personit që fal namaz.[2] Kjo nuk do të thotë patjetër që Allahu është ndërmjet njeriut dhe objektit përpara. Njeriu është përballë fytyrës së Allahut, edhe pse Ai është i lartësuar mbi Fronin e Tij. Dielli, për shembull, që ndodhet lart në qiell, mund të dalë edhe para fytyrës tënde. Siç shihet pra, këta keqinterpretues janë në qorrsokak.

Njerëz të tillë pretendojnë se rruga e tyre është më e ndriçuar me dituri dhe urtësi. Më konkretisht, ata thonë: “Rruga e selefëve është më e sigurt për shpëtim, ndërsa rruga e të mëvonshmëve ka më tepër dituri dhe urtësi.” Kjo thënie, e cila mund të arrijë deri në kufër, ka mjaft kontradikta, si më poshtë:

1. Si ka mundësi që një rrugë të ketë më tepër dituri dhe saktësi sesa ajo që është shpëtimtare më e sigurt?! Nuk ka shpëtim pa i ditur faktorët e shpëtimit dhe urtësisë, dhe pa i zbatuar ato.

2. Ku ka dituri dhe saktësi te shtrembërimi dhe mohimi i fakteve?

3. Sipas pohimit të tyre, dijetarët e mëvonshëm e njihkan më mirë Allahun sesa Profeti i Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe shokët e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), pasi rruga e selefëve është vetë rruga e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe shokëve të tij.

---

[1] Muslimi.

[2] Siç trasmetohet në “Sahihun” e Buhariut dhe Muslimit.

Ky pohim i fundit mund të arrijë deri në kufër, sepse nënkupton që Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ka qenë i paditur dhe mendjelehtë. Padituria është e kundërta e diturisë, ndërsa mendjelehtësia është e kundërta e urtësisë. Kjo thënie pra, është e pavlefshme dhe mjaft e rrezikshme, edhe pse qëllimi mund të jetë për aspektin e drejtë të saj.

Njerëz që flasin kështu kanë kërkuar e janë thelluar në çështje për të cilat selefët nuk kanë folur. Pikërisht kjo gjë i dëmtoi ata, duke i çuar në dilema dhe dyshime. Të vërtetën ka thënë Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “U shkatërruan ekstremistët …”[1] Sikur ata të qëndronin në rrugën e selefëve, pa u zhytur në të tilla çështje, nuk do të kishin arritur në dyshime, hutime e deformime, derisa disa prej prijësve të atyre që njihen si *ehlul kelam*-ë dëshironin të vdisnin me besimin e nënave të tyre të vjetra, që nuk e kishin njohur këtë humbje. Një tjetër thoshte: “Unë po vdes në akiden e plakave të Nisaburit.” Kjo vinte nga ankthi që sillnin dyshimet dhe dilemat e tyre.

Mos mendo se njeriu mund të jetojë i qetë me një doktrinë të prishur; ose do të jetojë me *akide* të saktë, ose në të kundërt do të provohet me dyshime, shqetësime dhe hutime. Disa prej tyre kanë thënë se njerëzit që kanë më tepër dyshime në momentin e vdekjes, janë *ehlul kelam*-ët. E si do të jetë halli – Allahu na ruajtë! – kur ke dyshime në çastet e vdekjes, po të mbyllet jeta pa pasur fare besim tek e vërteta?

Mirëpo, nëse *akide*-n e marrim nga Kurani dhe Suneti i Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), me thjeshtësi dhe sipas rrugës së selefëve, do të themi si Er Rrazi, i cili, në fillimet e veta ishte njëri nga dijetarët e tyre: “Pashë se rruga më e afërt me të vërtetën është rruga e Kuranit. Lexo pohimin: “Mëshirëploti u ngrit mbi Arshin.” dhe pohoje; lexo mohimin: “Asgjë nuk i shëmbëllen Atij …”, “… ata nuk mund ta ngërthejnë Atë me dije”, dhe mohoje. Kush provon siç e provova unë, do të mësojë, siç mësova unë.” Përpara kësaj, ai thotë: “Studiova *ilmul kelam*-in dhe filozofinë, por nuk pashë se ato të shuanin etjen e të shëronin sëmundjen. Pashë se rruga më e afërt me të vërtetën është rruga e Kuranit …”

Me pak fjalë, këta mohues të një pjese të emrave dhe cilësive të

[1] Muslimi.

Allahut (Subhanehu ue Te'Ala) që gjenden në Kuran dhe Sunet, duke u mbështetur në hamendjen e pasaktë se kjo të çonte në përngjasim, nuk bënë gjë tjetër, por vetëm se humbën nga e vërteta.

A diskutuan sahabët me Profetin (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) për të tilla çështje? Kemi bindjen ose përshtypjen se kur ata hasnin në këto çështje, e pranonin në realitetin e saj, por duke qenë të vetëdijshëm se Allahu nuk ka të ngjashëm. Kështu, ata gërshetonin pohimin dhe mohimin.

Përfundimisht, qëndrimi ynë ndaj hadithit që flet për gishtërinjtë e Allahut të Madhëruar, është se ne e pohojmë dhe e pranojmë këtë fakt. Megjithatë, nuk mjaftohemi vetëm me kaq, duke e pranuar verbërisht, pa ditur e pa shpjeguar kuptimin, por themi: Gishtërinjtë e Allahut janë të vërtetë, dhe mbi to Ai vendos këto gjëra të mëdha. Por ne nuk na lejohet kurrë të imagjinojmë me mendjen tonë, apo të themi me gojën tonë se ata janë si gishtat tanë, përkundrazi, themi se Allahu është Ai që e di më së miri formën e këtyre gishtave. Ashtu sikurse nuk e dimë se si është Qenia e Tij e Shenjtë, po ashtu nuk e dimë edhe formën e këtyre atributeve, por ia lëmë këtë çështje Allahut të Madhëruar.

> Në variantin e Muslimit thuhet: "... i vendos malet dhe pemët në njërin gisht, pastaj i shkund ato dhe thotë: 'Unë jam Sunduesi, Unë jam Allahu.'"
> Në variantin e Buhariut thuhet: "I vendos qiejt mbi njërin gisht, ujin dhe dheun mbi njërin gisht, dhe krijesat e tjera mbi njërin gisht."

– "*... pastaj i shkund ato* ..." – Kjo do të thotë se i shkund me të vërtetë. Qëllimi është që, me këtë gjest të frikshëm, t'u shpalosë robërve Madhështinë dhe Fuqinë e Tij.

Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e lexonte këtë ajet,[1] teksa gishtat i shtrëngonte e i hapte, ndërsa minberi nën këmbë lëkundej.[2] Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) po fliste këto fjalë, ndërsa zemra e tij ishte e mbushur me madhërimin e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

[1] Ajetin e lartpërmendur të sures Ez-Zumer.
[2] Ahmedi dhe Muslimi me kuptim.

A mund t'i lëvizim ne duart ashtu siç ka bërë Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem)?

Kjo varet nga pasojat që mund të sjellë, pasi jo çdokush që është i pranishëm apo e dëgjon këtë, e pranon ashtu siç duhet, pa ndjerë ndonjë farë krahasimi. Prandaj, nuk duhet të bëjmë gjeste të tilla, pasi kjo nuk është detyrë. Mirëpo, nëse jemi duke folur me nxënësit e dijes, ose me një person kokëfortë, që e mohon këtë dhe kërkon t'i ndryshojë domethënien, duke i dhënë një kuptim jo të vërtetë, veprojmë ashtu si Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem).

Dikush mund të thotë se vërtet Allahu quhet Dëgjues dhe Shikues, por Ai është Shikues që nuk shikon dhe Dëgjues që nuk dëgjon, megjithëse Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) kur ka lexuar fjalën e Tij (Subhanehu ue Te'Ala): "Allahu ju urdhëron që amanetet t'jua ktheni atyre që u përkasin dhe, dhe kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni drejt. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. Vërtetë, Allahu është Dëgjues, Shikues." (Nisa, 58), e ka vendosur gishtin e tij të madh në vesh dhe gishtin që vjen pas tij, në sy. Ebu Hurejre gjithashtu, kur e ka lexuar këtë hadith, ka vepruar kështu.[1] Kësisoj, për të sqaruar një njeri të tillë, që e pranon emërtimin si Dëgjues dhe Shikues, por jo atributin e dëgjimit dhe të shikimit, mund të bëjmë gjestin që përmendet në hadithin e mësipërm. Po në të njëjtën mënyrë mund të sqarojmë edhe atë që mohon vërtetësinë e dorës së Allahut, duke thënë se Ai nuk i mbështjell qiejt me dorën e djathtë të Tij dhe se kjo do të thotë: i vë nën komandimin e Tij. Megjithatë, çështja nuk është e lehtë, përkundrazi, është një çështje e vështirë dhe delikate në kulm, pasi ekziston frika që dikush të marrë ndonjë përshtypje të gabuar, kur ishte mundësia të mënjanohej, duke mos bërë asnjë gjest. Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), kur i druhej ndonjë fitneje ose pasoje më të rëndë, ai e shtynte ndonjë veprim. Ai shtyu, për shembull, ndërtimin e Qabes mbi themelet e Ibrahimit, nga frika se mos kjo i trazonte kurejshët, që sapo kishin hyrë në Islam.[2]

---

[1] Ebu Daudi. Sipas Albanit zinxhiri i transmetimit është i saktë. Profeti e ka vendosur gishtin në sy dhe në vesh për të treguar se Allahu dëgjon dhe shikon, dhe jo për të krahasuar Allahun me krijesat.

[2] Buhariu, Muslimi.

– *"... ujin dhe dheun mbi njërin gisht ..."* – Kjo nuk bie ndesh me fjalën e tij: "... tokat mbi njërin gisht ...", sepse kur thuhet: "... ujin dhe dheun mbi njërin gisht ...", nënkuptohet që e gjithë toka është mbi njërin gisht. Fjala 'gisht' nuk tregon se është vetëm një i tillë, se përndryshe do të binte ndesh me domethënien e hadithit para tij: "... pemët mbi njërin gisht, ujin mbi njërin gisht dhe dheun mbi njërin gisht ...".[1] Në arabisht, kur emrat në trajtë të pashquar përsëriten, në shumicën e rasteve i dyti është tjetër nga i pari. Ndërsa kur përsëriten emrat në trajtë të shquar, në të shumtën e rasteve i dyti është i njëjtë me të parin.[2] Atëherë thuhet se uji dhe dheu janë përmendur si simbole përfaqësuese të të gjithë tokës. Ose mund të thuhet se ka treguar që ujin dhe dheun i vendos mbi njërin gisht, ndërsa për të tjerat, për efekt përmbledhje, ose shkurtimi, nuk ka treguar gjë.

> Ibn Omeri transmeton se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sellem) ka thënë: "Allahu i palos qiejt në Ditën e Kijametit, i merr ata në dorën e Tij të djathtë, e pastaj thotë: 'Unë jam Sunduesi! Ku janë tiranët? Ku janë mendjemëdhenjtë?' Pastaj i palos shtatë tokat dhe i merr ato në të majtën e Tij, e pastaj thotë: 'Unë jam Sunduesi! Ku janë tiranët? Ku janë mendjemëdhenjtë?'."[3]

– *"... Allahu i palos qiejt ..."* – Domethënia e kësaj shprehjeje u tregua më lart.

– *" ...pastaj thotë: 'Unë jam Sunduesi!' ..."* – E thotë këtë si lavdërim ndaj Vetvetes, si njoftim për Madhështinë dhe Sundimin e Tij të plotë. Ai është Sundues, Mbret me Sundim absolut.

– *"... Ku janë tiranët?..."* – Pyetja është sfiduese, pra: ku janë ata mbretër që sundonin në dynja dhe tregoheshin kryelartë e arrogantë ndaj robërve të Allahut? Atë ditë, ata do të ringjallen si grimca, që

[1] Këtë transmetim nuk e kam gjetur te Muslimi.
[2] Në trajtën e shquar përmenden; pemët, uji dhe toka.
[3] Muslimi.

do të shkelen me këmbë nga njerëzit.

– *"... Pastaj i palos shtatë tokat ..."* – Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) në Kuran ka lënë të kuptohet se tokat janë shtatë, megjithatë ky numër nuk është i qartë: "Allahu është i Cili ka krijuar shtatë qiej dhe nga toka të ngjashme me to ...". (Talak, 12). Ngjashmëria këtu është e saktë vetëm në numër, sepse përngjasimi në formë është i pamundur. Ndërkaq, në Sunet thuhet qartë, në disa hadithe, se ato janë shtatë toka.

– *"... pastaj i merr ato në të majtën e Tij ..."* – Për fjalën "të majtën", transmetuesit kanë mosmarrëveshje. Disa prej tyre e pohojnë, e disa e rrëzojnë. Ata që e pohojnë, thonë se është i parregullt, pasi kundërshton dy përcjellës të besueshëm në hadithin që vjen nga Ibn Omeri. Dikush thotë se përcjellësi i tij është i besueshëm, por kjo pjesë që diskutohet nuk i përket hadithit, por janë fjalë të përcjellësit.

Vlerësimi i kësaj pjese si "e gabuar" e ka burimi nga hadithi tjetër, që gjendet në "Sahihun" e Muslimit, sipas të cilit Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Të drejtët do të jenë në shkallë drite, në të djathtën e Rrahmanit. Që të dyja Duart e Tij janë të djathta." Kjo nënkupton pra se nuk ka një të djathtë e një të majtë.

Megjithatë, nëse fjala "të majtën" është e saktë, pjesë reale e hadithit, për mua ajo nuk bie ndesh me pohimin se "që të dyja Duart e Tij janë të djathta", pasi ai do të thotë që dora tjetër nuk është si dora e majtë për krijesat, e cila shihet si inferiore ndaj së djathtës. "Që të dyja Duart e Tij janë të djathta" ka kuptimin se asnjëra prej tyre nuk ka mangësi. Këtë e përforcon edhe fjala e Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) në hadithin e Ademit: "Zgjodha të djathtën e Zotit tim, e që të dyja Duart e Tij janë të djathta e të begatshme." [1] Meqë gabimisht dikush mund të mendonte se dora tjetër, e majta ka mangësi, u tha: "... që të dyja Duart e Tij janë të djathta." Po kështu, edhe hadithi tjetër: "Të drejtët do të jenë në shkallë drite, në të djathtën e Rrahmanit. Që të dyja Duart e Tij janë të djathta". Me të synohet të tregohet vlera dhe grada e tyre, duke qenë në të djathtën e Rrahmanit.

[1] Tirmidhiu. Sipas Albanit hadithi është i saktë.

Gjithsesi, Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) pa dyshim ka dy duar, e çdonjëra është ndryshe nga tjetra. Nëse dorën tjetër do ta përshkruajmë si të majtë, nuk do të thotë se ajo ka më pak forcë se e djathta. Megjithatë, të dyja duart e Tij janë të djathta.

Detyrë për ne është të themi se nëse kjo vërtetohet nga Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), atëherë ne e besojmë, pa parë ndonjë kundërshtim me hadithet e tjera, që flasin për këtë çështje, siç u sqarua më parë; e nëse nuk vërtetohet, atëherë nuk e pranojmë.

> Ibn Abasi ka thënë: "Shtatë qiejt dhe shtatë tokat në pëllëmbën e Rrahmanit, janë si fara e sinapit në dorën tuaj."[1]

– *"... në pëllëmbën e Rrahmanit ..."* – Kjo pohon se Allahu (Subhanehu ue Te'Ala) ka pëllëmbë, nëse përcjellja është e saktë, e nëse jo, atëherë përforcon faktin që ka dorë. Megjithatë, që ka pëllëmbë, pohohet edhe në hadithe të tjera të sakta.

– *"... vetëm si fara e sinapit ..."* – Kjo farë është mjaft e vogël. Ajo sillet si shembull i vogëlsisë. Nga ana tjetër, krahasimi ilustron Madhështinë e Tij (Subhanehu ue Te'Ala) megjithëse Ai nuk përfshihet prej askujt dhe asgjëje. Çështja është më e madhe se ky shembull përafrues, sepse Ai (Subhanehu ue Te'Ala) nuk përfshihet nga shikimi dhe të kuptuarit tonë.

> Ibn Xheriri thotë: "Më tregoi Junusi, të cilit i kishte thënë Ibn Uehbi, këtij Ibn Zejdi dhe këtij babai i tij (Zejdi), se Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Shtatë qiejt kundrejt *Kursi*-ut, janë si shtatë derhemë që hidhen në një parzmore."[2]
> Po ashtu, Ebu Dherri ka thënë se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) të thotë: "*Kursi*-u kundrejt Arshit, është si një hallkë hekuri

[1] Ibn Xheriri.
[2] Ibn Xheriri.

që hidhet në një shkretëtirë."[1]

– *"Ibn Xheriri ..."* – Ky ka qenë një komentues mjaft i shquar. Ai ka një *tefsir*, i cili konsiderohet si komentim me thënie sahabësh. E meta e tij është se nuk i ka pastruar këto thënie, duke sjellë rrëfime të sakta e të dobëta, si dhe shumë të dobëta. Ai duket sikur ka dashur që fillimisht t'i shkruajë, pastaj t'ia lërë lexuesit të gjykojë se cilat janë të dobëta dhe cilat të sakta, ose ka dashur t'i pastrojë në fund, por që nuk i është mundësuar diçka e tillë.

– *"... Shtatë qiejt kundrejt Kursi-ut, janë si shtatë derhemë që hidhen në një mburojë ..."* – *Kursij*-a është vendvendosja e dy këmbëve të Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), siç ka thënë Ibn Abasi (r.a.). Derhemi është një monedhë argjendi, ndërsa parzmorja është një veshje prej lëkure ose dërrase, që mbahet për t'u mbrojtur në luftë nga shpatat, shigjetat etj.

– *"... Kursi-u kundrejt Arshit ..."* – Arshi është krijesa madhështore mbi të cilin është ngritur Mëshirëploti dhe askush nuk mund ta vlerësojë madhësinë e tij, veç Allahut (Subhanehu ue Te'Ala). Hallka nënkupton hallkën e parzmores që është e vogël, e nuk është asgjë në lidhje me shkretëtirën e tokës.[2]

Ky hadith përshkruan Madhështinë e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), e kjo është lidhja e tij me komentin e ajetit që autori e ka vendosur në titull të temës në fjalë.

Nga Ibn Mesudi përcillet: "Largësia ndërmjet qiellit të dynjasë dhe atij që vjen pas tij, është pesëqind vjet;

[1] Ibn Xheriri dhe Muhamed Ibn Ebi Shejbe. Sipas Albanit hadithi është i saktë.

[2] *Kursi*-u është një krijesë e madhe e Allahut. Ai është një trup tjetër dhe jo vetë Arshi (Froni) i Allahut. Me madhësinë që ka *Kursi*-u përfshin qiejt dhe tokën, edhe pse është shumë më i vogël sesa Arshi. Pejgamberi ('alejhis–selam) ka bërë të ditur në një hadith se vëllimi i *Kursi*-ut është aq i madh, saqë qiejt dhe toka në krahasim me të duken si një unazë e hedhur në një shkretëtirë. Ndërsa diferenca e madhësisë së Arshit në krahasim me *Kursi*-un është si diferenca e përmasava të asaj shkretëtire në krahasim me unazën e flakur në të. *Kursi*-u ndodhet përpara Arshit si shkalla përpara fronit. Ibn Abasi ka shpjeguar se Kursi-u është vendi ku vendosen këmbët.

> ndërmjet çdo dy qiejve është pesëqind vjet; ndërmjet qiellit të shtatë dhe *Kursi*-ut është pesëqind vjet; ndërmjet *Kursi*-ut dhe ujit është pesëqind vjet; Arshi është mbi ujin dhe Allahu është mbi Arshin. Ai i di të gjitha veprat tuaja."[1]

Ky hadith është *meukuf*, që arrin deri tek Ibn Mesudi, por këtu tregohen për gjëra që një njeri nuk mund të flasë kurrë nga mendja e tij, prandaj gjykohet sikur hadithi është dëgjuar nga Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Këtu bën përjashtim rasti kur dihet se rrëfyesi është nga ata që mbështeten në tregimet e Benu Israilëve, por Ibn Mesudi nuk njihet si i tillë.

– *"... Largësia ndërmjet qiellit të dynjasë dhe atij që vjen pas tij, është pesëqind vjet..."* – Nisur nga kjo, largësia ndërmjet qiellit të dynjasë dhe ujit, është katër mijë vjet. Ndërkaq, në një hadith tjetër thuhet se: "Trashësia e çdo qielli është pesëqind vjet."[2] Sipas kësaj shprehjeje, distanca ndërmjet qiellit të dynjasë dhe ujit, është shtatëmijë e pesëqind vjet, nëse hadithi është i saktë. Megjithatë, thelbi i tij është që Allahut i Madhëruar qëndron shumë shumë lart.

Po nëse thuhet se këto fakte kundërshtohen nga shkencëtarët bashkëkohorë, të cilët shprehen se ndërmjet nesh dhe disa yjeve e galaktikave ka largësi shumë herë më të mëdha? Ne përgjigjemi se, nëse hadithet që flasin për këto çështje janë vërtet nga Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem), atëherë thëniet që kundërshtojnë ato ne i hedhim tej. Mirëpo, nëse supozohet se diçka ne arrijmë ta shohim me sytë tanë ose e perceptojmë nëpërmjet shqisave tona, atëherë bëjmë njërin prej dy veprimeve të mëposhtme:

1. Përpiqemi të gjejmë rrugët e pajtimit të tekstit fetar dhe realitetit, me çfarëdo lloj mënyre të mundshme.

---

[1] Ibn Mehdiju nga Hamad ibn Seleme, ky nga Asimi, ky nga Zerri e ky nga Abdullahu.
Në të njëjtën mënyrë e përcjell edhe Mesudiju nga Asimi, ky nga Ebi Uaili e ky nga Abdullahu. Këtë e ka thënë Hafidh Dhehebiu, i cili tregon se ka edhe rrugë të tjera. Gjithashtu e kanë përmendur Daremiju, Ibn Huzejmja dhe Bejhakiu.

[2] Por ky është hadith i dobët.

2. Nëse ky pajtim është i pamundur, atëherë thuhet me siguri se hadithi është i dobët, pasi është e pamundur që një hadith i saktë të kundërshtojë diçka të provuar, siç ka thënë shejhu i Islamit në librin e tij "*El Akl ue en Nakl*": "Nuk mund të bien ndesh me njëri-tjetrin dy fakte të padiskutueshme. Zgjidhja është: ose nuk ka aspak mospërputhje, ose do të përputhen dy gjëra të kundërta, e cila është e pamundur. Nëse mendohet se ka kundërshtim ndërmjet tyre: atëherë ose nuk ka kundërshtim, e kështu gabim është në të kuptuarin e tyre, ose njëri nga argumentet është me siguri të diskutueshme dhe tjetri me siguri absolute."

Nëse një çështje aktuale, tek e cila nuk ka aspak paqartësi, vjen në kundërshtim me kontekstin e jashtëm të një ajeti kuranor ose hadithi, atëherë konteksti i jashtëm i tekstit, komentohet në një mënyrë që të jetë në pajtim me realitetin. Për këtë mund të sjellim si shembull fjalën e Allahut: "I Lartësuar me Madhështi qoftë Ai që ka vendosur në qiell yje, dhe që vuri në të edhe një ndriçues të madh (diellin) dhe hënën që jep dritë." (Furkan, 61), si dhe fjalën e Tij: "… dhe e ka bërë hënën dritë në të …" (Nuh, 16).

Ajeti i dytë është më i paqartë se ajeti i parë, sepse për të parin mund të themi se atje, fjala *sema* (qiell) është *ulú*-u (lartësimi). Ndërkohë, për sa i përket ajetit të dytë, ne e dimë nga përvoja dhe nga ajo që shihet, se hëna nuk ndodhet në qiell, por në një orbitë ndërmjet qiellit dhe tokës.

Atëherë përgjigjja jonë është se, nëse Kurani do ta tregonte qartë e prerë se hëna ndodhet në qiell, atëherë do të thoshim se kush pretendon se ka arritur deri në hënë, e ka gabim, sepse ka shkelur vetëm një trup në hapësirë, të cilin e ka menduar sikur është hëna.

Por e vërteta është që Kurani nuk tregon qartë se hëna ndodhet në qiell. Për ajetin e sures "Furkan", ku Allahu thotë: "I Lartësuar me Madhështi qoftë Ai që ka vendosur në qiell yje, dhe që vuri në të edhe një ndriçues të madh (diellin) dhe hënën që jep dritë", mund të themi se fjala 'qiell' nënkupton lartësi, siç është rasti në ajetin tjetër të Allahut: "Ai lëshoi ujë nga qielli …" (Rrad, 17). Shiu zbret nga retë, të cilat ndodhen ndërmjet qiellit dhe tokës, siç thotë përsëri Allahu: "… dhe të reve që mbahen mes qiellit e tokës …" (Bekare, 164). Ky do të ishte dhe interpretimi i përafërt i ajetit.

Ndërsa fjala e Tij: "… dhe e ka bërë hënën dritë në të …", mund të

interpretohet gjithashtu, se hëna ndodhet në lartësi, afër qiellit. Në këtë mënyrë, mund të bëhet pajtimi ndërmjet ajeteve dhe realitetit.

– *"... Allahu është mbi Arshin. ..."* – Ky është një tekst i qartë, që pohon lartësinë e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala), pra, lartësinë e Qenies së Tij.

Lartësia e Allahut ka dy aspekte:

1. Lartësia e cilësive të Tij. Këtë nuk e ka mohuar askush që ka përkatësi islame. Ai nënkupton se atributet e Allahut janë të përsosura.

2. Lartësia e Qenies së Tij. Këtë e kanë mohuar disa nga ata që i përkasin Islamit, duke thënë se çdo lartësi që i përshkruhet Allahut, nënkupton lartësinë e cilësive të Tij.

Në lidhje me fjalën e Profetit të Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sellem): "... Allahu është mbi Arshin", ata thonë se Allahu është mbi Arsh me fuqinë, dominimin dhe sundimin e Tij, e jo me Qenien e Tij. Nuk ka dyshim se ky është një shtrembërim dhe mohim i atributeve të Allahut.

Mohuesit e lartësimit të Allahut me Qenien e Tij, ndahen në dy kategori:

1. Ata që thonë se Allahu është me Qenien e Tij kudo, në çdo vend. Ky qëndrim nuk ka dyshim që është humbje dhe kufër.

2. Ata që thonë se Ai nuk është as lart, as poshtë, as djathtas, as majtas, as ngjitur me krijesat dhe as i shkëputur prej tyre. Ky është mohim, – Allahu na ruajtë! – madje, disa dijetarë kanë thënë se, sikur të na kërkohej të përshkruanim asgjënë, nuk do të kishte përshkrim më të arrirë se ky. Ata iu larguan argumenteve, logjikës dhe *fitre*-s (natyrshmërisë), duke shkuar te një përfundim që këto tri faktorë e mohojnë.

– *"... Atij nuk i fshihet asgjë nga veprat tuaja."* – Këtu përfshihen veprat e zemrës, që nuk shihen e dëgjohen, dhe ato të trupit, të cilat shihen dhe që dëgjohen, për shkak të dijes së tërësishme dhe të gjerë të Tij. Kjo është thënë pas përshkrimit të lartësisë së Tij, me qëllim që të theksohet se lartësimi i Allahut, nuk e pengon dijen e Tij për veprat tona. Kjo është gjithashtu, një shenjë e qartë për lartësimin e Qenies së Tij.

> Abas Ibn Abdul Mutalibi tregon: "Pejgamberi i Allahut na tha njëherë: "A e dini sa është largësia ndërmjet qiellit dhe tokës?" Ne i thamë: "Allahu dhe Pejgamberi i Tij janë më të diturit." Ai tha: "Ndërmjet tyre është pesëqind vjet largësi në ecje. Prej çdo qielli në qiellin tjetër, është pesëqind vjet largësi në ecje. Trashësia e çdo qielli është pesëqind vjet largësi në ecje. Ndërmjet qiellit të shtatë dhe Arshit është një det, ku nga fundi i tij e deri në fillimin e tij, është sa largësia ndërmjet qiellit dhe tokës, ndërsa Allahu i Madhëruar është mbi këtë. Ai i di të gjitha veprat e bijve të Ademit."[1]

– *"... A e dini sa është ..."* – Forma pyetëse ka dy funksione:

1. Motivimin për të dëgjuar atë që do të thuhet më pas.

2. Përqendrimin në dëgjim. Kjo është si pyetja në thënien e Allahut të Madhëruar: "A të erdhi ty lajmi për atë që kaplon?" (Gashije, 1), e cila gjithashtu shërben për ta përqendruar dhe motivuar dëgjimin e mrekullive të Allahut. Edhe pyetja në ajetin: "O ju që keni besuar! A t'ju tregoj për një tregti, e cila ju shpëton nga një dënim i dhimbshëm?!" (Saf, 10), shërben për ta përqendruar dhe motivuar mësimin e rrugës së Allahut, që përbëhet nga besimi dhe vepra e mirë. Ndërsa pyetja: "Thuaj: 'A t'ju tregojmë për më të dëshpëruarit në veprat e tyre?'" (Kehf, 103), është vërejtje dhe paralajmërim, ashtu si në ajetin: "A doni t'ju tregoj kush do të dënohet me (ndëshkim) më të rëndë se kjo te Allahu?'" (Maide, 60), që është gjithashtu vërejtje dhe paralajmërim.

Funksionet e ndryshme të pyetjes varen nga konteksti, ndërsa roli kryesor i saj është kërkimi i njohjes së diçkaje të caktuar.

– *"... Ne i thamë: 'Allahu dhe Pejgamberi i Tij janë më të Diturit.' ..."* – Dija e Profetit vjen pas dijes së Allahut, sepse atë ia ka dhënë pikërisht Allahu; Ai i mësoi Profetit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) atë që njeriu nuk mund ta arrijë vetë.

---

[1] Ebu Daudi dhe të tjerë. Sipas Albanit hadithi është i dobët.

Kështu thuhet edhe për çështjet e tjera të Sheriatit: Allahu dhe Pejgamberi i Tij janë më të diturit. Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ishte njeriu më i ditur në lidhje me fenë e Allahut, dhe kjo dije e tij rridhte nga dija e Allahut.

Kjo çështje nuk është si thënia drejtuar Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem): “Çfarë të dëshirojë Allahu dhe ti bëhet”, e cila lidhet me kaderin dhe vullnetin e Allahut, ku Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk mund të bëhet ortak. Përkundrazi, thuhet “Çfarë të dëshirojë Allahu, pastaj ti”, pra përdoret lidhëza nënrenditëse “pastaj”. Rregulli është se, në çështjet e fesë, mund të përdoret lidhëza bashkërenditëse “dhe”, ndërsa në ato të krijimit, jo.

Nga kjo kuptohet gabimi edhe injoranca e atyre që shkruajnë për disa vepra: “Thuaj: ‘Veproni, se veprën tuaj do ta shohin Allahu dhe Pejgamberi i Tij…” (Teube, 105), pas vdekjes së Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), kur dihet pamundësia e shikimit nga ana tij. Allahu e shikon veprën, por Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) nuk mund ta shohë, pas vdekjes. Pra, diçka e tillë nuk lejohet të thuhet, sepse është një gënjeshtër ndaj tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

– *“… Ndërmjet qiellit të shtatë dhe Arshit është një det, ku nga fundi i tij e deri në fillimin e tij, është sa largësia ndërmjet qiellit dhe tokës …”* – Pra, pesëqind vjet.

– *“… Allahu i Madhëruar është mbi këtë …”* – Ky është një argument tjetër që flet për lartësimin madhështor të Allahut të Madhëruar. Ai është mbi gjithçka. Asgjë nga krijesat e Tij nuk e përfshin Atë, as qiejt e asgjë. Për Të (Subhanehu ue Te‘Ala) nuk mund të thuhet se Ai ka një anë nga e cila mund të përfshihet, sepse mbi qiejt dhe Arshin nuk ka asgjë. Nisur nga ky fakt, në disa libra të *ehlul kelam*-it thuhet se nuk lejohet absolutisht të përcaktosh anën nga ndodhet Allahu (el xhihetu). Ata e mohojnë gjithashtu të qenët e Allahut në lartësi prej pandehmës së tyre se përcaktimi i anës nga ndodhet do të thotë të pranosh se Ai përfshihet nga ajo anë, por nuk është kështu, sepse ne e dimë se mbi Fronin nuk ka asgjë, pra nuk ka krijesa; mbi të është vetëm Allahu i Madhëruar. Për rrjedhojë, Ai nuk mund të përfshihet kurrë

nga krijesat e Tij.

Për sa i përket përcaktimit të anës, pohimi i saj ka nevojë të sqarohet: ajo as nuk pohohet dhe as nuk mohohet në mënyrë kategorike, sepse nuk përcillet që Ai është në ndonjë anë, dhe as që nuk është në ndonjë anë, por sqarojmë dhe themi që Allahu ndodhet lart. Njëherë, Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) pyeti një robëreshë: "Ku është Allahu?" Dhe ajo tha: "Në qiell." Kështu, ajo e pohoi që Allahu ndodhet lart dhe Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) ia miratoi këtë, duke thënë pronarit të saj: "Liroje atë, sepse është besimtare."[1] Ndërsa keqinterpretuesit e argumenteve thonë se fjala pyetëse "*ku*" ka kuptimin "kush", domethënë, sipas tyre pyetja ishte: "Kush është Allahu?" E ajo tha: "Në qiell." Pra, – sipas tyre, – përgjigjja qe: "Ai që është në qiell". Kështu, ata e mohojnë lartësinë.

Ibn Kajimi iu është kundërpërgjigjur këtyre në librat e tij, ndër të cilët është edhe "*En Nunije*". Ai thotë se, në gjuhën arabe, fjala '*ejne'* (ku) nuk ka si të marrë kuptimin '*men'* (kush), sepse mes tyre ka ndryshim të madh. Allahu assesi nuk mund të jetë në anën e poshtme, pasi vetë fitra e njeriut, logjika e pastër dhe argumentet fetare e kundërshtojnë këtë dhe pohojnë që Ai ndodhet lart. Po kështu, Allahu nuk kufizohet as nga ana e sipërme, sepse kur dihet që *Kursij*-a, e cila është vendi i këmbëve të Tij, përfshin qiejt dhe tokën, atëherë si mund ta kufizojë Atë ndonjëra nga krijesat e Tij?

Ai ndodhet lart, por ama asgjë nuk e përfshin Atë, sepse ne themi që mbi Arshin nuk ka asgjë tjetër veç Allahut të Madhëruar, siç thotë Pejgamberi (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "... Allahu i Madhëruar është mbi këtë."

– "*... Atij nuk i fshihet asgjë nga veprat e bijve të Ademit.*" – Termi "veprat", nëse përmendet bashkë me termin "fjalët", shënon veprat e trupit dhe fjalët e gjuhës. E nëse ai përmendet veçmas, atëherë përfshin veprat e trupit, fjalët dhe veprat e zemrës. Në rastin tonë, "veprat" paraqitet e veçuar, kështu që përfshin çdo akt e vepër të gjuhës, zemrës dhe trupit. Madje edhe më shumë se kaq: Atij nuk i fshihet asnjë vepër e bijve të Ademit që i përket edhe të ardhmes. Ai di se çfarë do të ndodhë, pa diskutuar këtu ato që kanë ndodhur në të kaluarën. Allahu i Madhëruar thotë: "Ai e di atë që është para

[1] Muslimi.

tyre dhe atë që është pas tyre ...". (Ta Ha, 110). Pra, atë që do të vijë dhe atë që ka kaluar. Kur Faraoni i tha Musait: "Si është gjendja e popujve të mëparshëm?" Musai tha: "Dija për ta është te Zoti im, e shënuar në një libër. Zoti im as nuk gabon e as nuk harron." (Ta Ha, 51-52).

Profeti (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) e nisi me një pyetje, për të rritur motivimin dhe përqendrimin e dëgjuesve, dhe që të përforconte besimin se Allahu i Madhëruar, me Qenien e Tij, është mbi çdo gjë dhe përfshin gjithçka me dijen e Tij, siç thotë Profeti: "Atij nuk i fshihet asgjë nga veprat e bijve të Ademit." Kur e mësojmë këtë, bëhet detyrë për ne të madhërojmë Atë dhe të ruhemi nga kundërshtimi i Tij, sepse Ai është mbi ne, ndërsa urdhri i Tij na përfshin ne.

Në hadith gjenden dy atribute të Allahut:

1. Njëra e shprehur me pohim, që është lartësimi i Tij. Kjo del nga pjesa e hadithit: "Allahu i Madhëruar është mbi këtë."

2. Ndërsa tjetra është e shprehur me mohim: "Atij nuk i fshihet asgjë nga veprat e bijve të Ademit."

Nuk ka cilësi të Allahut që tregon thjesht mohim. Përkundrazi, cilësitë e mohuara në të drejtën e Allahut janë mohime që tregojnë pohimin e të kundërtave të tyre në mënyrën më të përsosur. Në këtë rast, mohohet që Atij mund t'i fshihet diçka, për arsye se Ai ka një dije të përkryer. Po kështu, Atij i mohohet lodhja, për të treguar fuqinë absolute të Tij; i mohohet pamundësia, për të treguar pushtetin e plotë të Tij e të tjera si këto. Allahu, me cilësitë që i ka mohuar Vetvetes tregon dhe pohon të kundërtat e këtyre cilësive, pra ky mohim nuk është thjesht për t'i mohuar ato.

Allahu i Madhëruar thotë: "... Atë nuk e kap as kotje, as gjumë ..." (Bekare, 255). Kjo tregon se Ai është i Gjalli dhe Mbikëqyrësi absolut. Sikur të kishte jetë të mangët, Ai do të kishte nevojë për gjumë. Sikur të flinte, nuk do të ishte Mbikëqyrësi absolut i krijesave të Tij. Prandaj edhe banorët e Xhenetit nuk do të flenë, sepse do të bëjnë një jetë të përkryer. Gjumi në Xhenet do t'u harxhonte atyre kot një pjesë të kohës pa gëzim e pa e shijuar, sepse gëzimi atje do të jetë i përhershëm. Gjumi është një vdekje e vogël, ndërsa në Xhenet nuk ka aspak vdekje.

Në cilësitë e Allahut nuk ka mohim të plotë, sepse mohimi i plotë

do të thotë asgjë. Ai nuk përmban as lavdërim, as përsosmëri, por asgjë.

Mohimi bëhet ndonjëherë për të treguar paaftësi të plotë, si për shembull kur thua se muri nuk bën padrejtësi.[1] Ky lloj mohimi përdoret ndonjëherë edhe për të shprehur qortim, për shembull:

Një poet ka thënë:

Është një fis që besën s'e thyen
Duart n'zullum kurrë s'i përlyen…

Këto vargje, në fakt, nuk janë lavdërim për këtë fis. Qëllimi i poetit është të thotë se ata nuk kanë mundësi që ta thyejnë besën dhe të bëjnë padrejtësi, jo sepse nuk duan ta thyejnë besën, por se kanë frikë nga fiset e tjera.

Një tjetër thotë:

Të madh e kam fisin, me numër jo pak,
Por që s'bën për sherr e as për dajak.

Mizorët për mizoritë me falje i shpërblen,
të këqijve të keqen me të mira ua kthen.

Akoma s'ka dalë një popull në dritë,
Që para të mive t'ia mbathin me vrik!

Një popull tjetër të më quante 'bir',
që luftën e nis, do t'ishte më mirë!

Poeti mohon që ata mund të shkaktojnë ndonjë trazirë dhe tregon se kjo vjen për shkak të pazotësisë së tyre për të mbrojtur vetveten. Kështu, ai ka dashur të ishte pjesë e një populli tjetër, njerëzit e të cilit do të ishin më të fortë dhe më të mirë.

Dobitë e temës

[1] Nga ana tjetër, n.q.s. do të thuhej që mbreti nuk bën padrejtësi, ky mohim tregon për përsosmërinë e së kundërtës së padrejtësisë, që është drejtësia. Kjo, sepse mbreti është i aftë për të bërë padrejtësi, e përderisa nuk e bën një gjë të tillë, kjo tregon se ai është i drejtë.

- Komenti i ajetit: "… Në Ditën e Kijametit, e tërë Toka është në grushtin e Tij …".

Më lart, në hadithin e Ibn Mesudit, u tha se Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e miratoi fjalën e rabinit, se: Allahu (Subhanehu ue Te‘Ala) do t’i vendosë qiejt në njërin gisht … .

- Këto fakte çifutët i kanë ditur deri në kohën e Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), e ata as nuk i kanë mohuar dhe as nuk i kanë interpretuar.

Autori sikur do të thotë me këtë se çifutët ishin më të mirë se shtrembëruesit e sotëm të teksteve hyjnore, sepse çifutët nuk i mohuan dhe nuk i keqinterpretuan ato. Ndërkaq, nga ky umet ka njerëz që thonë se Allahu nuk ka gishtërinj, por se ata nënkuptojnë forcën e Tij!

- Kur rabini i bëri Profetit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ato përshkrime, ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) ia vërtetoi, ndërkohë që pati shpallje Kurani për pohimin e tyre.

Në dukje, fjalët e autorit: "… ndërkohë që pati shpallje Kurani për pohimin e tyre", nënkuptojnë se kjo ka ndodhur menjëherë pas përshkrimit të rabinit, por e vërteta nuk është kështu, sepse në hadithin e Ibn Mesudit thuhet: "… pastaj lexoi ajetin: ‘Ata nuk e kanë vlerësuar Allahun me madhështinë që i takon …". Kjo tregon se ajeti ka zbritur më përpara, prandaj themi se qëllimi i autorit është të tregojë se Kurani zbriti për vërtetimin e kësaj.

- Profeti (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) qeshi për çka tha rabini nga kjo dije e madhe.

Kjo dëshmon se lejohet e qeshura në shenjë pohimi për diçka,

kur ajo tregon për pëlqim dhe jo urrejtje.

- Deklarimi në mënyrë të qartë se Allahu ka dy duar, se qiejt janë në dorën e Tij të djathtë, ndërsa tokat në dorën tjetër.

Dy duart i janë pohuar Allahut nga Kurani, Suneti dhe qëndrimi unik i selefëve. Autori shprehet "... ndërsa tokat në dorën tjetër", por nuk do të thotë që ai e mohon faktin që njëra dorë cilësohet si e majtë, për arsye se këtë e thotë më poshtë.

- Cilësimi i një dore të Allahut si "e majtë".

Më lart folëm për këtë.

- Përmendja e çështjes së tiranëve dhe e arrogantëve në Ditën e Kijametit.

Qëllimi është që: le ta mësojë se si e ka fundin çdo tiran dhe mendjemadh i sotëm.

- Krahasimi i Pejgamberit (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem): "... si fara e sinapit në dorën tuaj."

Autori flet për pjesën e hadithit: "Shtatë qiejt dhe shtatë tokat në pëllëmbën e Mëshirëplotit janë ashtu si fara e sinapit në dorën tuaj." Ai (Allahu e mëshiroftë!) për këtë pikë ka përmendur edhe një rrëfim tjetër. Shih se çfarë kemi thënë për të më lart.

- Madhësia e *Kursi*-ut në raport me qiellin.

Qiejt, në krahasim me *Kursi*-un, janë si shtatë dërhemë që hidhen në një parzmore.

- Madhështia e Arshit të Allahut në raport me *Kursi*-un.

Kursi-u kundrejt Arshit, është si një hallkë hekuri që hidhet në

mes të shkretëtirës.

- Arshi është diçka tjetër nga *Kursi*-u dhe uji.

Nuk di deri tani ndonjë që të thotë se Arshi është vetë uji, por ka që thonë se Arshi është *Kursi*-u, duke u nisur nga hadithi: "Allahu do të vendosë *Kursi*-un e Tij në Ditën e Kijametit ..."[1], duke menduar se *Kursi*-u është vetë Arshi. Po kështu, ka të tjerë që thonë se *Kursi*-u nënkupton dijen e Allahut. Fjalën e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala): "*Kursi*-u i Tij shtrihet mbi qiejt dhe tokën ...", (Bekare, 255) ata e interpretojnë duke thënë se ajo që shtrihet është dija e Tij. Por e vërteta është se *Kursi*-u është vendvendosja e dy këmbëve të Allahut, Arshi është Froni mbi të cilin është ngritur Mëshirëploti (Subhanehu ue Te'Ala), ndërsa dija është tërësia e njohurive që ka një i ditur.

- Largësia e qiejve ndërmjet njëri-tjetrit.

Ajo është pesëqind vjet.

- Largësia ndërmjet qiellit të shtatë dhe *Kursi*-ut.

Ajo është pesëqind vjet.

- Largësia ndërmjet *Kursi*-ut dhe ujit.

Ajo është pesëqind vjet.

- Arshi është mbi ujë.

Kjo shprehet qartë në tekst.

- Allahu është mbi Arsh.

Kjo shprehet qartë në tekst, gjithashtu.

[1] Hakimi.

- Largësia ndërmjet qiellit dhe tokës.

Ajo është pesëqind vjet.

- Trashësia e çdo qielli është pesëqind vjet.

- Deti që është mbi shtatë qiejt, nga fundi në sipërfaqe është pesëqind vjet, dhe Allahu është më i ditur.

Për të gjitha këto çështje kemi folur më lart, duke sjellë edhe argumentet e tyre.

Dobitë e haditheve

- Allahut nuk i fshihet asgjë nga veprat e bijve të Ademit.
- Paralajmërimi që bëhet për kundërshtimin e Allahut (Subhanehu ue Te'Ala).

Në fund themi: Allahu është më i dituri.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botërave!

Lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi Profetin tonë, Muhamedin!

E lus Allahun që përfundimin tonë dhe tuajin ta bëjë në Teuhid!

Amin!

Përmbajtja

TEMA 29 1

STUDIMI I YJEVE DHE BESIMI NË NDIKIMIN E TYRE (ASTROLOGJIA). 1

Dobitë e temës 9

TEMA 30 11

LIDHJA E RESHJEVE ME YJET. 11

Dobitë e temës 25

TEMA 31 29

THËNIA E ALLAHUT: "E MEGJITHATË, DISA NJERËZ ZGJEDHIN (PËR TË ADHURUAR) NË VEND TË ALLAHUT (ZOTA) TË TJERË SI TË BARABARTË ME ALLAHUN. ATA I DUAN IDHUJT SIÇ DUHET ALLAHU ...". (BEKARE, 165) 29

Dobitë e temës 40

TEMA 32 45

THËNIA E ALLAHUT: "KJO ËSHTË PREJ SHEJTANIT, QË JU FRIKËSON ME NDIHMËSIT E VET. JU MOS KINI FRIKË PREJ ATYRE, POR FRIKËSOHUNI VETËM PREJ MEJE, NËSE JENI BESIMTARË." (ALI IMRAN, 175) 45

Dobitë e temës 58

TEMA 33 61

THËNIA E ALLAHUT: "NË QOFTË SE JENI BESIMTARË, ATËHERË MBËSHTETUNI TEK ALLAHU." (MAIDE, 23) 61

Dobitë e temës 68

TEMA 34 71

THËNIA E ALLAHUT: "A JANË TË SIGURT ATA NGA PLANI I ALLAHUT? PLANIT TË ALLAHUT NUK I FRIKËSOHEN VETËM ATA QË JANË TË HUMBUR." (ARAF, 99) 71

Dobitë e temës 77

TEMA 35 79

DURIMI NDAJ CAKTIMIT TË ALLAHUT VJEN PREJ BESIMIT. 79

Dobitë e temës 91

TEMA 36 93

ARGUMENTET NË LIDHJE ME SYEFAQËSINË. 93

Dobitë e temës 101

TEMA 37 103

FORMË POLITEIZMI ËSHTË EDHE KUR NJERIU, ME ANË TË VEPRAVE TË TIJ, SYNON DYNJANË. 103

Dobitë e temës 111

TEMA 38 113

KUSH U BINDET DIJETARËVE DHE PRIJËSVE NË NDALIMIN E ASAJ QË E KA LEJUAR ALLAHU OSE NË LEJIMIN E ASAJ QË AI E KA NDALUAR, I KA KONSIDERUAR ATA SI ZOTA. 113

Dobitë e temës 125

TEMA 39 129

THËNIA E ALLAHUT: "A NUK I KE PARË ATA QË PRETENDOJNË SE E BESOJNË ATË QË TË ËSHTË SHPALLUR TY DHE PROFETËVE TË TJERË PARA TEJE? ATA KËRKOJNË GJYKIMIN E ZOTAVE TË RREMË, NDËRKOHË QË JANË URDHËRUAR T'I MOHOJNË ATA. SHEJTANI DËSHIRON QË T'I NXJERRË ATA KREJTËSISHT NGA UDHA E DREJTË." (NISA, 60) 129

Dobitë e temës 138

TEMA 40 141

GJYKIMI MBI MOHUESIN E EMRAVE DHE ATRIBUTEVE TË ZOTIT. 141

Dobitë e temës 154

TEMA 41 157

THËNIA E ALLAHUT: "ATA I NJOHIN MIRËSITË E ALLAHUT, POR PASTAJ I MOHOJNË, SE SHUMICA E TYRE JANË JOBESIMTARË". (NAHL, 83) 157

Dobitë e temës 161

TEMA 42 163

THËNIA E ALLAHUT: "PRANDAJ MOS I VINI SHOKË ALLAHUT, DUKE E DITUR!" (BEKARE, 22) 163

Dobitë e temës 172

TEMA 43 173

PARALAJMËRIMET PËR ATË QË NUK KËNAQET ME BETIMIN NË ALLAH.

173

Dobitë e temës *175*

TEMA 44 **177**

SHPREHJA: "ÇFARË TË DËSHIROJË ALLAHU DHE TI." **177**

Dobitë e temës *182*

TEMA 45 **185**

KUSH SHAN KOHËN, KA FYER ALLAHUN. **185**

Dobitë e temës *191*

TEMA 46 **193**

EMËRTIMI: "GJYKATËSI I GJYKATËSVE". **193**

Dobitë e temës *197*

TEMA 47 **199**

RESPEKTIMI I EMRAVE TË ALLAHUT DHE NDRYSHIMI I EMRIT, PËR SHKAK TË TIJ. **199**

Dobitë e temës *204*

TEMA 48 **207**

TALLJA ME DIÇKA QË LIDHET ME ALLAHUN OSE TALLJA ME KURANIN APO PROFETIN. **207**

Dobitë e temës *214*

TEMA 49 **217**

THËNIA E ALLAHUT: "NËSE PAS NJË FATKEQËSIE, NE I JAPIM TË SHIJOJË NGA MIRËSITË TONA, ME SIGURI DO TË THOTË: 'KËTË E MERITOJ! ...'" (FUSILET, 50) **217**

Dobitë e temës *230*

TEMA 50 **231**

THËNIA E ALLAHUT: "POR, PASI AI U DHUROI ATYRE PASARDHËS TË SHËNDOSHË E TË MIRË, ATA TË DY I VESHËN ALLAHUT ORTAKË, NË LIDHJE ME ATË QË U KISHTE DHËNË. POR ALLAHU ËSHTË SHUMË LART NGA AJO QË ATA IA VESHIN ATIJ SI ORTAKË!" (ARAF, 190) **231**

Dobitë e temës *239*

TEMA 51 **243**

THËNIA E ALLAHUT: "ALLAHUT I PËRKASIN EMRAT MË TË BUKUR, ANDAJ LUTJUNI ATIJ ME TO DHE LARGOHUNI NGA ATA QË I SHTREMBËROJNË EMRAT E TIJ ..." (ARAF, 180) **243**

Dobitë e temës *249*

TEMA 52 **251**

NUK THUHET: SELAM PËR ALLAHUN! 251

Dobitë e temës 253

TEMA 53 255

LUTJA: "O ALLAH, MË FAL MUA, NËSE DËSHIRON!" 255

Dobitë e temës 259

TEMA 54 261

NUK THUHET "ROBI IM" DHE "ROBËRESHA IME". 261

Dobitë e temës 266

TEMA 55 269

NUK REFUZOHET AI QË KËRKON DIÇKA NË EMËR TË ALLAHUT. 269

Dobitë e temës 274

TEMA 56 275

ME FYTYRËN E ALLAHUT NUK KËRKOHET ASGJË TJETËR PËRVEÇ XHENETIT. 275

Dobitë e temës 278

TEMA 57 279

ARGUMENTET NË LIDHJE ME FJALËN "SIKUR". 279

Dobitë e temës 290

TEMA 58 293

NDALIMI I SHARJES SË ERËS. 293

Dobitë e temës 295

TEMA 59 297

NDALIMI I MENDIMIT TË KEQ PËR ALLAHUN. 297

Dobitë e temës 306

TEMA 60 309

MOHUESIT E *KADER*-IT. 309

Dobitë e temës 335

TEMA 61 339

PARALAJMËRIMET E ASHPRA MBI ATA QË BËJNË FIGURA FRYMORËSH. 339

Dobitë e temës 350

TEMA 62 353

NDALIMI DHE PARALAJMËRIMI PËR BETIMET E SHUMTA. 353

Dobitë e temës _____ *365*

TEMA 63 _____ **369**

ARGUMENTET PËR RUAJTJEN E BESËS ME ALLAHUN DHE ME PROFETIN E TIJ (SAL-LALLAHU 'ALEJHI UE SEL-LEM). _____ **369**

Dobitë e temës _____ *383*

TEMA 64 _____ **387**

BETIMET NDAJ ALLAHUT. _____ **387**

Dobitë e temës _____ *391*

TEMA 65 _____ **393**

KURRË NUK I KËRKOHET ALLAHUT TË NDËRMJETËSOJË TE KRIJESAT E TIJ. _____ **393**

Dobitë e temës _____ *396*

TEMA 66 _____ **399**

MBROJTJA PARAPRAKE E TEUHIDIT DHE MBYLLJA E RRUGËVE TË SHIRKUT. _____ **399**

Dobitë e temës _____ *405*

TEMA 67 _____ **407**

THËNIA E ALLAHUT: "ATA NUK E KANË VLERËSUAR ALLAHUN ME MADHËSHTINË QË I TAKON. DITËN E KIJAMETIT, E TËRË TOKA DO TË JETË NË GRUSHTIN E TIJ, NDËRSA QIEJT TË MBËSHTJELLË NË TË DJATHTËN E TIJ. AI ËSHTË I PASTËR NGA TË METAT DHE I LARTËSUAR MBI GJITHÇKA QË IA SHOQËROJNË!" (ZUMER, 67) _____ **407**

Dobitë e temës _____ *425*

PËRMBAJTJA _____ **429**